

ENVER HOXHA, DITËTRIPUNËM TRAJTORE TË ÇËSHTJES
PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

ENVER HOXHA

DITAR

PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

(1972-1974)

7

TIRANË, 1983

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DITAR

PËR QËSHITJE NDËRRKOMBËTARE

(1972-1974)

1972

TRANË 1981

PARAQITJE REAKSIONARE E NJË REVOLUCIONARI TË MADH FRANCEZ

Lexova librin e A. Malros «Trikëndëshi i zi», pjesën për Sen Zhystin¹. Sigurisht libri është shkruar mirë dhe nga një njeri me kulturë, por nuk më pëlqeu mënyra se si e trajton ai personalitetin e Sen Zhystit, revolucionar i madh, mik i Robespierit, duke e nxjerrë atë si «paraardhës» të Napoleonit. Aty del pikëpamja reaksionare e autorit që, pa pasur fakte e dokumente, përpiqet të vërtetojë se Sen Zhysti përgatiste «rrëzimin» e Robespierit dhe idetë e tij mund «të quhen, më në fund, si frymëzuese të partive komuniste dhe fashiste»(!).

¹ Anëtar i Komitetit të Shpëtimit Publik gjatë Revolucionit Francez të vitit 1789.

E HËNË
3 JANAR 1972*

Ç'PO NGJET ME GRUPIN E LIN BIAOS?

Shokët kinezë vazhdojnë të mos na thonë asgjë në lidhje me çështjen e Lin Biaos dhe të ushtarakëve të tjerë, që janë zhdukur nga skena që nga muaji shtator i vitit 1971.

Tash, zhdukja e Lin Biaos nga skena është një fakt i pamohueshëm, pse shumë «manifestime zyrtare» u zhvilluan në Kinë dhe u vërtetua që ai nuk është më në udhëheqje. Siç dihet, shumë spekulime po bëhen në botë mbi këtë çështje, vetëm se Pekini as pohon, as mohon gjë. Kinezët nuk të flasin, veç lënë të kuptohet se «këto janë çështjet tona të brendshme, të huajve nuk u interesojnë». Kjo në parim mund të jetë e drejtë deri në njëfarë shkalle dhe për njëfarë kohe, por për një çështje kaq të madhe, kur këputet e gjithë koka e ushtrisë, kur kalojnë kaq muaj dhe kur rreth këtij problemi kinez po përqendrohet gjithë interesimi i opinionit botëror, spekulimeve duhet t'u pritët hovi. Le të marrin vesh njerëzit çfarë ka ngjarë dhe të mbledhin mendjen. Sidoqoftë, miqtë e Kinës nuk duhet të ngelen në errësirë dhe të gjykojnë me supozime.

Ndaj nesh, për këtë problem, mbahet një qëndrim i palejueshëm heshtjeje bile, edhe në qoftë se na vënë në dijeni tërthorazi, kjo është një metodë jomiqësore, joserioze dhe pa përgjegjësi. Edhe u themi, edhe nuk u themi! Deri tash janë shoferët kinezë ose përkthyesit kinezë të ambasadës sonë, «anëtarë partie», që na japin

versione «zyrtare» të ndodhisë, versione të cilat janë të ndryshme. Të gjithë këta na thonë: «Këto që po ju tregojmë, na i kanë thënë në parti dhe na kanë këshilluar të mos ia themi kujt, por ju ju kemi miq besnikë. Ne besojmë se ambasadori juaj është në dijeni; sidoqoftë, ju lutemi, i mbani sekret».

Atëherë duhet të supozojmë që këta njerëz, të cilët vijnë na thonë neve, janë të vënë nga udhëheqja, apo e marrin vetë iniciativën, duke na konsideruar miq nga më të ngushtët dhe duke supozuar që ne jemi vënë në dijeni? Por deri tash duhet të themi se kinezët janë fanatikë në ruajtjen e sekreteve.

Rëndësi ka ç'na thonë! Ato që na thonë neve, pretendojnë, dhe ne i besojmë, se ua kanë shtruar në parti dhe se nuk dinë më shumë se ç'na thonë neve, ose duhet të supozojmë se u kanë thënë: «Thuajuni shqiptarëve kaq dhe jo më shumë».

Thelbi i thënieve është i përgjithshëm, por në mes të versioneve ka diferenca dhe kontradikta, ka gjëra me dy kuptime, të errëta, me një fjalë ka kinezëri.

Të gjitha versionet thonë se «në udhëheqje ka pasë qenë organizuar një komplot i rrezikshëm nga ushtarakët, me Lin Biaon në krye».

Shoferi na thotë se «Lin Biaoja me gjithë gruan, pasi u orvatën pa sukses të vritnin Maon, pse ishin kundër tij, tok me konspiratorët e tjerë morën avionin dhe u nisën të arratiseshin për në Bashkimin Sovjetik, por u diktuan në kufi, ku avioni u godit dhe u rrëzua i djegur në Mongolinë e Cedenbalit». Ky version ngjason me ato të agjencive perëndimore, sido që ky shofer, «anëtar partie», pretendon se një gjë të tillë ua kanë shtruar në parti dhe i kanë porositur të mos ua thonë të huajve.

Por versioni më i sigurt që ne duhet ta konsiderojmë si gjysmëzyrtar, si të sajuar që të na thuhet, është ai i përkthyesit kinez të zyrës së shtypit të ambasadës

sonë (i caktuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kinës), për të cilin jemi të sigurt që është anëtar i Partisë Komuniste të Kinës. Ky na thotë se «Lin Biaoja ka luftuar shumë kundër Maos, Çen Jisë, Kan Shenit, Çu En Lait e të tjerëve. Në plenumin e shtatorit të vitit 1970 Lin Biaos iu vunë në dukje shumë gabime, por ai me arrogancë nuk i pranoi ato dhe u vërsul kundër shumë kuadrove të vjetër, me akuzën se gjoja nuk janë besnikë të Mao Ce Dunit. Në periudhën gusht-shtator të vitit 1971 kryetari Mao ishte për vizitë në Jug. Lin Biaoja me agjentët e vet ngarkoi një komandant armate që ta vriste Mao Ce Dunin gjatë kthimit nga Shangai e pastaj të akuzohej Çan Çun Çiaoja si komplotist.

Sipas urdhrorit të komplotistëve, një oficer i vjetër ishte ngarkuar që, kur të kalonte treni në një urë midis Shangait e Nankinit, të vendoste atje mina. Mirëpo kryetari Mao u kthye para kohe në Pekin dhe vetë oficeri, që e donte kryetarin Mao, u bë si i sëmurë, kështu që komploti dështoi. Në këtë kohë Lin Biaoja dhe grupi i tij gjoja ishin me pushime në Pei Da-he, por ai kishte dhënë urdhër që flota, portet kufitare e njësitë luftarake të ishin në gatishmëri për të marrë pushtetin, pasi të vritejshin Mao Ce Duni në Shangai dhe Çu En Lai në Pekin. Kur u zbulua komploti, me urdhër të Maos u siguroa kufiri dhe u shpall gatishmëria luftarake. Një avion me dokumente sekrete për armët bërthamore u kap pa u ngritur nga aeroporti. Po kështu dështoi edhe orvatja për arratisje».

Kur shoku ynë e pyeti këtë përkthyes se ç'bëhet tash me Lin Biaon, për të cilin agjencitë e lajmeve thonë që është vrarë, ai iu përgjigj: «Nuk dimë gjë, kaq na kanë thënë», pastaj vazhdoi se «Vu Fa Sjeni, marшал i forcave ajrore, ishte i poshtër, se komandën e aviacionit e kishte lënë në dorën e djalit 24-vjeçar të Lin Biaos. Gruaja e Lin Biaos, Je Çyni, të cilën ky e kishte bërë anëtare të Byrosë Politike, ka qenë spiune e të huajve, mundet e

sovjetikëve. Lin Biaoja kishte një përcëim për Maon dhe për Çu Denë, të cilin e quante të trashë nga koka. Ai ishte një tip që i bënte shumë lajka Maos, por fshehtazi komplotonte kundër tij. Maoja e zbuloi komplotin dhe gjendja tash është e shkëlqyer, të ligjtë u spastruan». Tamam një roman i verdhë i vërtetë me komplete, me hedhje trenash në erë, me spiunë në shërbim të të huajve etj., etj.

Ç'mund të nxjerrim ne nga këto thënie? A janë të vërteta? Mos janë të sajuara nga njerëz që dëgjojnë radiot e huaja dhe kurdisin lloj-lloj versionesh, apo janë vënë njerëz për të na thënë ato që nuk na i njoftojnë zyrtarisht?

Po të supozojmë këtë rast të fundit, mund të themi se një qëndrim i tillë ndaj Partisë sonë nuk është aspak korrekt nga ana e Partisë Komuniste të Kinës. Këto ngjarje, ashtu siç na thuhet, janë *rocambolique*¹, naive, për njerëz krejt të thjeshtë, që as kuptojnë fare nga politika. Në qoftë se udhëheqja kineze ia shtron partisë me të vërtetë kështu, siç na thonë këta njerëz, kjo është vetëm për të impresionuar anëtarët e partisë dhe jo për t'u shpjeguar atyre të vërtetën.

Mënyra si e paraqesin kinezët «punën komplotiste të Lin Biaos» nuk ndryshon shumë nga ajo që na komunikuan zyrtarisht mbi çështjen e Çen Po Tasë. Edhe në drejtim të tij bëhej fjalë «për lajka nga njëra anë për Maon, por edhe për komplete në prapaskenë, për politikë sektare kundër kuadrove besnikë të kryetarit Mao» dhe më në fund e cilësuan «spiun të të huajve».

Se ku konsistojnë kundërshtimet politike dhe ideologjike të këtyre njerëzve me Mao Ce Dunin, ata asgjë nuk i thonë partisë së tyre, pale neve që s'na thonë gjë.

Shtrohet pyetja: Pse ta vriste Maon Lin Biaoja dhe

1 Frëngjisht — me peripeci të jashtëzakonshme, që s'qëndrojnë në këmbë, të pabesueshme.

pse t'ia zinte vendin, kur ai vetë kishte pikërisht vendin më kryesor pas Maos, ishte zëvendësi i tij i caktuar me statut dhe nga vetë Maoja? Lin Biaoja ishte shumë i njohur në Kinë. Revolucioni Kulturor, «vepra e kryetarit Mao», ia kishte ngritur atij prestigjin. Atëherë çfarë ngjau që ky «besim politik reciprok dhe kjo bindje ideologjike» u zhdukën përnjëherë në mes Maos dhe Lin Biaos, sa ta bënte këtë të dytin të arrinte derisa t'i organizonte atentatet Maos? Dhe ky veprim duket si ato atentatet e Xheims Bondit. Derisa synohej për të marrë fuqinë, përse të zgjidheshin metoda kaq të pasigurta, kur ata ishin njerëz intimë të Maos dhe mund ta likuidonin më kollaj me metoda të tjera? Jo, po kjo duhej «të bëhej impresionuese për popullin», «të hidhej treni në erë; vetë Maoja personalisht ta zbulonte dhe të jepte urdhra për likuidimin e komplotit».

Ashtu si në një roman, Maoja përpara «ditës fatale» shkoi nga Shangai në Pekin, oficeri që do të vinte minën dhe që «e donte shokun Mao», u bë si i sëmurë, kurse Lin Biaoja priste «në një vend» rezultatin që të merrte fuqinë. Hajde hajde këtë version! Sidoqoftë, ne pse nuk na vënë në korent zyrtarisht? Sigurisht, ata mund të na vënë në korent «edhe me versione të tilla» të njëllajta me atë të Çen Po Tasë, derisa kështu i kanë thënë edhe partisë së tyre, por unë mendoj se në këtë mes duhet të ketë medoemos çështje politike dhe këto janë kryesoret. Më parë se çdo gjë duhet të ketë pasur kontradikta në vijë, debate, kundërshtime. Ku kundërshtoheshin «mendimet e Maos nga Lin Biaoja dhe majtistët»? Kjo nuk na thuhet.

Maoja me Çu En Lain ndërtuan një «strategji të re» me rastin e vajtjes së Niksonit në Pekin dhe këtë na e thanë edhe neve zyrtarisht. A ishin dakord Lin Biaoja dhe «majtistët» për vajtjen e Niksonit, a ishin dakord me këtë «strategji të re të Maos dhe të Çusë»? Këtë nuk na e thonë, por mbajnë heshtje të plotë, bile as njerëzve të ty-

re, as partisë së tyre nuk ia thonë. Pse nuk ia thonë? Sepse sigurisht në parti dhe në popull ka një korent të fortë kundër vizitës së Niksonit në Pekin. Atëherë udhëheqja kineze, mendoj unë, këtë periudhë, derisa të vijë e të ikë Niksoni, do që ta kalojë me këtë version që ka dhënë për «grupin e Lin Biaos». Kështu partia dhe populli të heqin vëmendjen nga evenimenti politik i ardhjes së Niksonit dhe ta përqendrojnë te komploti, pastaj, «shohim e bëjmë». Kur të ikë Niksoni nga Pekini, dhe, sipas rezultateve që do të arrihen, mund të adoptohen versione të reja, definitive dhe atëherë «situata u poq», hetimet mbaruan dhe një ditë më parë se ta marrë vesh gjithë bota, «versionin definitiv të komplotit» do të na e thonë edhe neve, shqiptarëve, «shokëve më të ngushtë të armëve».

Ne do të bëjmë pyetjet që kemi bërë kurdoherë: «Pse ngjanë këto gjëra? Si ndodhën?». Natyrisht, këto pyetje ia bëjmë vetes përpara «paraqitjes» që shokët kinezë na e bëjnë «si kofini pas të vjeli». Kështu ngjau me grupin e Liu Shao Çisë, i cili kishte vite e vite me radhë që vepronte hapur dhe as që shqetësohej nga kurrkush. Filloi Revolucioni i Madh Kulturor, vepër e Mao Ce Dunit dhe i udhëhequr efektivisht nga Çen Po Taja. U bënë gjithë ato veprime dhe, më në fund e më në bisht, erdhën një mëngjes e na thanë se «Çen Po Taja ishte më i keqi nga të gjithë, agjent i vjetër i Guomindanit, spiun» etj., etj. Nga ana tjetër, Çen Po Taja ishte kuadër i vjetër, i njohur, ai kishte arritur të bëhej edhe sekretar i Maos e, më në fund, në momentet më të vështira, kur shpërtheu Revolucioni Kulturor, ky u bë anëtar i Byrosë Politike dhe ishte nga kryesorët, në mos më kryesori, që udhëhiqte Revolucionin Kulturor.

Kur Revolucioni Kulturor ishte duke përfunduar, Çen Po Taja doli «tradhtar, armik, spiun, atentator». Pastaj doli çështja e Lin Biaos «zëvendësit të Mao Ce Dunit dhe shokut të tij besnik të armëve», i vënë e i konsakruar

me statutin e partisë, që aprovoi Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës, kongres që u mbajt pasi kishin kaluar afro 12-13 vjet nga ai i 8-ti dhe pas gjithë atyre evenimenteve që tronditën Kinën.

Njeriu me të drejtë habitet dhe pyet: Si ngjasin dhe si lejohen të bëhen këto gjëra? A vepron, a gjykon partia në këto çështje kaq të rëndësishme, apo mos veprojnë atje grupe rivale? Logjika marksiste-leniniste e Partisë sonë nuk mund t'i quajë të rregullta dhe të drejta të gjitha këto veprime. Nuk është çështja këtu që ne të mbrojmë Lin Biaon apo grupin e tij, pse duhet të dish të vërtetën lakuriq që të mund të gjykos. Por, në bazë të këtyre evenimenteve, ashtu si ngjasin, si zhvillohen, si marrin fund e si u jepet zgjidhje, ne përpiqemi të depërtojmë në disa të vërteta, duke bërë konkluzione dhe duke pasur kurdoherë parasysh vijën e drejtë dhe politikën marksiste-leniniste që duhet të ndjekë një parti marksiste, në këtë rast Partia Komuniste e Kinës.

Në fakt kush është Lin Biaoja? Për ne është njeriu më i panjohur. Është e vërtetë se ai ishte një komandant të cilit iu besua çlirimi i Pekinit. Mund të ishte edhe një komandant i mirë, por kaq. Për kinezët dhe për të huajt Ushtria Nacionalçlirimtare e Kinës kishte komandantë më të shquar se Lin Biaoja. Ky u bë ministër i Mbrojtjes, pasi u qërua Pin De Huaja. Lin Biaoja mbeti ministër i Mbrojtjes, pavarësisht se u bë edhe anëtar i Byrosë Politike. Por ky njeri u ngrit me «paterica», u fry «si tullumbace» nga të tjerët, nga Maoja dhe «shkëlqeu» pa u dukur asgjekundi. Të gjithë dilnin, drejtonin, duartrokiteshin, kurse ky qëndronte në prapaskenë, i padukshëm, misterioz. Thuheshin për të vetëm elozhe, por as nuk shihej, as nuk njihej, askush nuk bisedonte me të. Preteksti për këtë ishte gjetur: «është i sëmurë». Po çfarë sëmundje ishte kjo? Përgjigjja ishte misterioze: «Nuk e sheh dot ujin me sy».

Shokët tanë që kanë vajtur me radhë në Pekin, shumë herë edhe zyrtarisht (me përjashtimin tim që kam vajtur vetëm një herë më 1956), shumë rrallë ia kanë parë fytyrën Lin Biaos. Vetëm sa i kanë dhënë dorën dhe asnjë bisedë nuk kanë bërë me të. Ai nuk u dilte, se gjoja ishte i sëmurë. Maon po, e shihnin dhe bisedonin sa herë që shkonin në Kinë, lëre pastaj me Çu En Lain, me të cilin bisedonin vazhdimisht. I vetmi udhëheqës nga kryesorët që punon në Kinë, ishte dhe mbetet Çu En Lai. Kjo është e padiskutueshme, pavarësisht nga pikëpamjet e tij.

Por cilat kanë qenë pikëpamjet e Lin Biaos, ne nuk i dimë dhe as që i kemi dëgjuar ndonjëherë të na i thotë me gojën e tij. Vetë Maoja me shokët e tij kanë thënë se «Lin Biaoja është kështu e ashtu...», vetë ata do të na thonë përsëri se «Lin Biaoja ishte kështu e ashtu...». Edhe ne kemi të drejtë të gjykojmë mbi çka na thonë dhe të themi: «Po ku keni qenë? Si i bëni këto punë partie? Si i trajtoni kështu këta kuadro?». Ka mundësi që Lin Biaoja të mos ketë qenë gjë, por u pompua, atij iu fry mendja dhe e konsideroi veten sikur ishte me të vërtetë «njeri i madh». Njerëz të tillë pa parime bëhen të rrezikshëm.

Në një fletë të Ditarit tim për Kinën, në kohën e Revolucionit Kulturor, në kohën e krizës që kalonte Kina dhe kur ne përpiqeshim të nxirrnim vetë konkluzione për të mbajtur qëndrime të drejta, sepse edhe atëherë si tani shokët kinezë nuk na thoshin asgjë, më kujtohet të kem ngritur hipotezën e një grusht-shteti ushtarak për të dominuar në parti¹. Një veprimtari të tillë e dënoja dhe është në çdo moment e dënueshme. Ushtria duhet të jetë armë e diktaturës në dorën e partisë dhe jo partia të bëhet vegël dhe të komandohet nga ushtria. Çdo gjë mund

¹ Shih: Enver Hoxha. «Shënime për Kinën» vëll. I, f. 272.

të ngjasë në një vend, kur partia nuk është në krye dhe e fortë, monolite dhe marksiste-leniniste në parime dhe në veprime. Çdo gjë mund të presim nga grupi i Lin Biaos, siç mund të presim edhe nga ai i Çu En Lait. Të dy ekstremet puqen.

Përsëri, në shkrimet e mia të mëparshme, duke nxjerrë konkluzione nga shtypi kinez, se shokët kinezë asnjëherë nuk na kanë informuar mbi këto çështje, konstatoja si një gabim parimor të madh që udhëheqjen e partisë «ta merrnin në dorë ushtarakët» ose «të dominojnë ushtarakët». Kjo bëhej gjoja nën pretekstin se udhëheqjet e partisë, me përjashtim të atyre në komuna, ishin nën influencën e grupit të Liu Shao Çisë, domethënë ishin «njerëz të këtij grupi». Kjo nuk thuhej hapur në shtyp, por atje vërtetohej në praktikë. Dilte dhe doli (se më vonë filloi rishtazi riorganizimi i saj) që partia «u shpërnda» dhe «pezulloi» veprimtarinë gjatë Revolucionit Kulturor. Po kështu ndodhi edhe me gjithë organizatat e masave. Në këtë «rrëmujë të organizuar» shpëtuan vetëm fshati dhe ushtria. Pra dilte se ushtria udhëhiqte, ose ushtarakët ishin kryesorët që udhëhiqnin. Duke e konsideruar të padrejtë një gjë të tillë, thoshim se në kulmin e «rrëmujës» kjo gjë «mund të ishte e nevojshme» përkohësisht dhe pastaj çdo gjë duhej vënë brenda normave. Por asgjë s'u bë. Kjo gjendje vazhdoi edhe kur filloi «qetësia», kur rifilloi «organizimi» i partisë dhe i komiteteve revolucionare. Ushtarakët ishin kudo me shumicë, jo një e dy si të zgjedhur pa thonjëza, por të zgjedhur me thonjëza.

Tash, me dënimin e Lin Biaos, që nuk e dimë natyrisht cila është arsyeja e vërtetë dhe që mendojmë se duhet të jetë politike, çështje strategjie, vije, të gjitha këto gabime parimore do t'ia hedhin atij në kurriz, do të thonë se ka qenë vetëm Lin Biaoja shkaktar që ushtarakët morën në fakt drejtimin e partisë dhe e vazhduan

edhe më vonë. Pra, do të dalë që të gjithë këta janë njerëzit e Lin Biaos dhe spastrimi me fshesë, që sigurisht do të bëhet, nga forma do të paraqitet i veshur me «parulla parimore» «për ruajtjen e normave» të partisë, por realiteti do të jetë krejt ndryshe.

Kurdoherë në këto raste bëhet pyetja: Kur duhen ruajtur normat e partisë, pse nuk ruhen vazhdimisht, por shkelen duke u aprovuar nga të gjithë, duke u quajtur të drejta nga të gjithë dhe pastaj «hapen sytë» nga një pjesë, «korrigjohen» dhe ngarkohen me të gjitha gabimet pjesa tjetër?

Artikuj bazë po shkruhen aktualisht në gazetat kineze: «Ushtria duhet të forcojë unitetin me Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës», «Ushtria duhet të mbështetë politikën e qeverisë», «Ushtria duhet të mësojë nga populli dhe populli të mësojë nga ushtria». Slogane të çuditshme!! Çfarë gjendjeje, çfarë situatash kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në Kinë! Ku është udhëheqja e partisë, e Komitetit Qendror? Ushtria vepron nga njëra anë, qeveria nga ana tjetër, përmbysen situata, por çfarë situatash të reja krijohen? Në ç'baza? Në ç'norma? Natyrisht, thuhet, ose më mirë lihet të kuptohet «në rrugë partie, në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e ideve të Mao Ce Dunit», por, pas një periudhe, trak, na del diçka tjetër serioze.

Le të shpresojmë se s'do të dalë ndonjë gjë e rrezikshme për socializmin në Kinë, por, që të mos ngjasë kjo, e vetmja garanci është ekzistenca e një partie marksiste-leniniste, monolite.

NË AMBASADAT TONA SECILI DUHET T'I VIHET PUNËS ENERGJIKISHT

Bisedova me shokët sekretarë që shokët e ambasadës sonë në Pekin duhet të lënë grindjet subjektive dhe të sëmura në mes tyre, për mustaqet e Çelos, dhe t'i vihen punës energjikisht, që nga ambasadori dhe deri te më i vogli. Me Kinën kemi marrëdhënie ekonomike më të zgjeruara, import-eksporti me të duhet ndjekur në mënyrë aktive dhe jo nga zyrat e ambasadës. Teknikë dhe studentë nga tanët shkojnë atje, ka fabrika që prodhojnë për ne, ka portë ku ngarkohen e shkarkohen mallra në destinacion të të dy vendeve. Të gjitha këto probleme duhet të ndiqen, të kontrollohen, të ndihmohen.

SHËNIM

Pasdreke na erdhën për vizitë Hysniu me Viton. Gjatë bisedës, midis të tjerash, folëm edhe për perspektivën e mundshme të zgjidhjes së problemit të Bangladeshit. Deri ku do të ndikojë Kina te Butoja¹, që paraqitet proamerikan?

¹ Ali Buto, në atë kohë president i Republikës Islamike të Pakistanit.

NIKSONI «MYSAFIR» — ARMIK I KINËS

Shkuam për t'i bërë vizitë Hysniut dhe Vitos.
Biseda, përveç të tjerave, u vërtit rreth deklaratave të Niksonit, i cili tha se në bisedimet e Pekinit «e ekskludon njohjen e qeverisë së Pekinit dhe ndryshimin e gjendjes dhe të marrëdhënieve aktuale me Formozën». Çfarë i mbetet Kinës të bisedojë me këtë «mysafir» armik?!!

VDIQ ÇEN JIA

Vdiq Çen Jia, anëtar i shquar i Partisë Komuniste të Kinës, mik i Partisë dhe i popullit tonë. E kam njohur personalisht, ishte shok me pikëpamje të gjera, njeri i dashur dhe i hapur. Në ceremoninë e varrimit kishte shkuar edhe Mao Ce Duni. Fjalimin e përmortshëm e kishte mbajtur Çu En Lai. Kishte kurorë dhe nga Kan Sheni. Vitet e fundit nuk qe mbajtur qëndrim korrekt karshi tij, prandaj ceremonia e varrimit duket si një reabilitim «post mortem».

E DIEL
16 JANAR 1972

POHIME TË NJË AGJENTI TË CIA-S RRETH KOMPLOTEVE ANTISHQIPTARE TË AMERIKANO-ANGLEZËVE DHE TË GREKO-JUGOSLLAVËVE

Lexova librin: «Dans le tourbillon de l'histoire»¹ të amerikanit C. L. Sulberger. Janë kujtimet «gazetareske» të këtij njeriu, që hiqet si gazetar, por në fakt është një nga agjentët më të kualifikuar të zbulimit amerikan, CIA-s e të djallit me të birin. Nëpërmjet këtij libri atë e shikon të hajë e të pijë me të gjithë njerëzit e sferave të larta, të dijë e t'i besojnë të gjitha të fshehtat dhe misione diplomatike për t'i kryer.

Në kapitullin për Ballkanin ai zë në gojë Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore, natyrisht me përbuzje, duke thënë se populli shqiptar «di vetëm të çajë dru dhe të shesë lajthi qosheve të rrugëve». Urrejtja që ushqen për Shqipërinë e bën atë jo vetëm të nënçmojë luftën e popullit tonë, por duke i ardhur keq që ne erdhëm në fuqi, zbulon intrigat dhe komplotet që kanë kurdisur anglezët, amerikanët dhe miqtë e tyre për të likuiduar «qeverinë e Hoxhës», siç e quan ai pushtetin e popullit.

Më 1949 Sulberger vë në gojë e Xhulian Emerit, oficer i misionit anglez te ne në kohën e luftës dhe pas

luftës ministër, se «anglezët dhe amerikanët shumë e kanë tjerrur deri në verë organizimin e revoltës brenda në Shqipëri». «Unë jam i mendimit, thotë Emeri, se me pak flori mund të ngremë fiset e Veriut të Shqipërisë kundër Hoxhës, pa u bërë vonë etj.». Ja si mendonin dhe vepronin atëherë armiqtë tanë. Tash këtë ata e pohojnë me gojën e tyre.

Sulberger zbulon po ashtu se në nëntor të vitit 1949 anglezët hodhën te ne agjentë sabotatorë të përgatitur në Maltë, të cilët ne i kapëm dhe i shfarosëm. Rëndësi ka që këta i pohojnë tash vetë, se gjyqet tona të atyre kohëve çdo gjë e vunë në dukje me prova të padiskutueshme.

Po ashtu, Sulberger në këtë libër vë në dukje trillimet e Titos, të Gjilasit e të Dedijerit kundër vendit tonë dhe tregon se si këta u lidhën ca me Anglinë, ca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ka rëndësi se si filloi dhe si mbaroi transformimi i tyre në agjentë.

Tradhtarët titistë Gjilas dhe Dedijer, me trillimet më të poshtra kundër nesh, me gojën e tyre, thonë se gjoja: Jemi ne me regjimin tonë «policesk» që provokojmë jugosllavët, që sovjetikët dhe Stalini të kenë kështu një shkak për të ndërhyrë ushtarakisht në Jugosllavi dhe për të likuiduar Titon. Kjo është një shpifje e ndyrë për të fshehur veprimtarinë armiqësore të tyre kundër Shqipërisë socialiste dhe për të krijuar besimin e plotë tek amerikanët se Jugosllavia e Titos po kërcënohet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini.

Sulberger në librin e tij pohon se ka qenë një nga amerikanët më në kuotë në Greqinë monarko-fashiste. Ai hynte e dilte si në shtëpinë e tij te mbreti i Greqisë, te shefi i shtatmadhorisë, te Venizellosi, te P. Kanellopullosi dhe te gjeneral Van Fliti.

Sulbergerin ngarkoi Titoja, nëpërmjet Gjilasit që të shkonte te mbreti i Greqisë dhe te shefi i shtatmadho-

¹ Frëngjisht — «Në vorbullën e historisë».

risë greke e t'u propozonte përfundimin e një pakti Jugosllavi-Greqi-Turqi, që u nënshkrua më vonë. Por rëndësi ka ajo çka shkruan Sulbergeri në këtë libër për ne dhe që po e kopjoj gati fjalë për fjalë:

«Paris 28 prill 1953. Sonte në mbrëmje piva një gotë dhe bisedova me mikun tim të vjetër, Panajot Kanellopulosin, ministër i Mbrojtjes i Greqisë. Kur e pyeta si shkonin marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe me Turqinë, ja ç'më tha haptazi ai: Në rast lufte nuk do të ketë ofensivë të përbashkët greko-jugosllave kundër Shqipërisë. Shpresohet që, brenda dy deri nëntë muajve që vijnë, do të arrijmë të kryejmë një grusht shteti, me anën e të cilit do ta çlirojmë Shqipërinë nga Hoxha dhe nga sovjetikët. Në qoftë se do të jetë e nevojshme, trupat amerikane do të mbajnë qetësinë pas grushtit të shtetit. Grekët pranuan që të mos merren me çështjen dhe lajmëruan, gjithashtu, pak a shumë me terma jo aq të qartë, jugosllavët...»

Megjithatë, në rast se grushti i shtetit nuk përfundon me sukses, me aprovimin e admiralit Karni, u vendos që nuk do të jetë e nevojshme të pushtohet Shqipëria. Kështu divizionet greke dhe jugosllave, që ishin vendosur të sulmonin Shqipërinë dhe të pushtonin vendin, lirohen për të kaluar në veri dhe në lindje».

Kështu shkruan shkurtimisht ky agjent i regjuri amerikan. Sigurisht komplotet e mëdha dhe të rrezikshme të amerikano-anglezëve janë të shumta. Ata nuk guxojnë t'i zbulojnë, por historianët e vendit tonë me fakte dhe me dokumente, i kanë nxjerrë në dritë dhe do të vazhdojnë të shkruajnë për to dhe t'i demaskojnë.

E ENJTE
27 JANAR 1972

KRIZA E REGJIMIT TITIST VAZHDON TË THELLOHET

Tash në Jugosllavi po zhvillohet një konferencë partie në shkallë federative¹. Titoja mbajti një fjalim të shkurtër në hapjen e kësaj konference dhe vetëm sa për të theksuar se «nuk ekziston asnjë krizë në Jugosllavi». Kjo është një gënjeshtër që të bën të qeshësh dhe që kërkon të mbulojë një realitet aq të dukshëm e me rrjedhime aq të rënda për Jugosllavinë, sa referuesi kryesor në konferencë, Vllahoviçi, detyrohet jo vetëm ta zbulojë këtë krizë që nuk mbulohet, por është i detyruar të shtjellojë disa arsye të saj, pse të tëra nuk guxon t'i thotë.

Referati i Vllahoviçit² vë në dukje degjenerimin e partisë nga çdo pikëpamje, nga ana politike, nga ana organizative, nga ana ideologjike. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë është mbushur me elementë joproletarë, me arrivistë, me karrieristë, me elementë të korruptuar të borgjezisë. Ai pohon se Lidhja nuk drejton, nuk është në krye, nuk ekziston centralizmi demokratik. Klasa punëtore nuk është në fuqi në Jugosllavi.

Kjo konferencë gjoja do t'i vërë në vend gjërat. Re-

1 Konferenca e dytë e LKJ.

2 «Analizë e gjithanshme e thelbit dhe e karakterit të ngjajeve në shoqëri dhe në LKJ».

ferati i Vllahoviçit është një demagogji, që fsheh shkaqet e vërteta e të thella që kanë sjellë këtë gjendje tragjike (edhe kaq sa këta antimarksistë dhe agjentë të borgjezisë duan të tregojnë). Kjo është një mbulesë për të fshehur masat shtypëse që po marrin dhe do të marrin për forcimin e diktaturës fashiste. Karakteristika e diskutimeve mbi raportin e Vllahoviçit (të paktën për aq sa jep Tanjugu), është frika që ka mbërthyer diskutantët nga raprezaljet. Asnjëri nga diskutantët, duke u mbështetur edhe në ato gjëra të pakta që pohon Vllahoviçi, nuk merr guximin të diskutojë, por flet në përgjithësi, mburr vet-administrimin, flet kundër «shovinizmit e nacionalizmit», por edhe për këto në surdinë, me parulla të matura. Titoja e la të kuptohej qartë se me shovinistët kroatë të Tripallos e kompani do të veprohet njësoj si me shovinistët serbë, të Rankoviçit. Të dyja palët do të konservohen për të ardhmen «e ndritur» të Jugosllavisë. Aktualisht grupi serb i Nikeziçit «rri urtë», bën «qengjin» dhe në këto situata përpiqet të forcojë pozitën mbi grupin kroat.

Titoja bën «politikën e balancimit», të «timonierit», që «do të drejtojë me një parti të rigjeneruar dhe në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste», kurse ushtria, siç e deklaroi Titoja për të qenë brenda, «është vetëm për të ruajtur kufijtë e Jugosllavisë». Ai, natyrisht, harroi ç'kishte thënë një muaj më parë «mbi rolin e ushtrisë» në këtë gjendje të turbullt të Jugosllavisë.

Sidoqoftë agjencura sovjetike nuk ka qëndruar pa manovruar edhe me ustashët për t'i bërë presione Titos, për t'i krijuar këtij situata të vështira, derisa e detyroi të marrë masa kundër kroatëve, masa që çojnë ujë në mullirin e miqve të rusëve e të serbëve. Revizionistët sovjetikë e pushuan presionin bullgaromadh në drejtim të Maqedonisë, pse këto presione egërsonin reaksionin serb. Reaksioni rus duhet të manovrojë për të ruajtur alean-

cën dhe «miqësinë tradicionale» me reaksionin serbomadh dhe me atë bullgaromadh. Prandaj Brezhnjevi i dha urdhër Zhivkos të heshtë, kur filloi të flasë Tripallosja.

Konferenca e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë do të përfundojë si «bisht peshku» për të gënjyer klasën punëtore dhe popujt e Jugosllavisë se gjoja diçka «e re» u bë në këto situata të vështira, se «diçka është duke u riparuar». Por asnjëri nuk do të gënjehet se asgjë e re nuk po bëhet dhe asgjë s'po ndreqet. Çdo gjë shkon e do të shkojë keq e më keq në skëterrën kapitaliste titiste.

E MARTE

1 SHKURT 1972

PSE KY INTERESIM I TITISTËVE PËR KOSOVËN

Titistët në dokumentet zyrtare të partisë së tyre, që kanë nxjerrë në lidhje me ngjarjet e kohëve të fundit, si edhe në dokumentin që nxorën pas konferencës federative të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, që u mbajt në muajin janar të këtij viti, thonë, veçanërisht për Kosovën se «është prapa ekonomikisht» etj., dhe se medoemos duhet «ndihmuar për të ardhur në nivelin e vendeve të tjera të Jugosllavisë».

Pse ky interesim dhe ky preokupacion i veçantë dhe i theksuar për Kosovën, në këto momente krize dhe paqëndrueshmërie në Jugosllavi? Përse nuk bëhet fjalë po me kaq këmbëngulje edhe për Malin e Zi, që është dhe ai shumë i prapambetur?

Mendoj se titistët nuk shtyhen as nga ndjenja altruiste, as nga ndjenja humanitare, as nga parimi për të ngritur mirëqenien e popullit shqiptar të Kosovës në mënyrë të veçantë, se u ther zemra, por, për të folur më hapur, se i kanë frikë shqiptarët. Janë po këta titistë që u sollën aq egërsisht ndaj gjithë shqiptarëve, që jetonin në tokat e tyre kombëtare në Jugosllavi, të cilët pas çlirimit i vranë, i burgosën, i torturuan, i çarmatosën, i turpëruan, u mohonin gati kombësinë, nuk u hapnin shkolla shqipe. Shqiptarët e Jugosllavisë ishin më të mjeruarit dhe, ekonomikisht, më të rreckosurit. Republika e Serbisë sillej me ta si carët serbokroatë. Fare pak

ndryshime kishte. Me qindra mijë shqiptarë i detyruan të emigronin në Turqi e gjetkë. Kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, siç dihet, titistët vite me radhë mbanin një qëndrim armiqësor aq të egër, saqë ia kalonte Serbisë së vjetër të Karagjorgjeviçëve. Pra te titistët dominonte kudo egërsia më barbare kundër popullit shqiptar si komb, si shtet dhe si pakicë. Nga ana e tyre synohej në likuidim e në gjenocid të kësaj pakice, në skllavërim si popull shqiptar dhe në zhdukjen si shtet i pavarur i Shqipërisë.

Titistët nuk ua arritën dot qëllimeve të tyre, por faktet qëndrojnë fakte. Lufta për ekzistencë u bë nga Republika Popullore e Shqipërisë, dhe shqiptarët e Jugosllavisë kanë luftuar për ekzistencën e tyre, kështu jugosllavët morën një mësim të mirë, se me shqiptarët nuk mund t'ia dalin dot mbanë qëllimeve të tyre. Lufta antishqiptare dhe aktet e tyre barbare ndaj shqiptarëve lanë mbresa si te ne, si te vëllezërit tanë shqiptarë që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi.

Armiku, kur humbet luftën e ul flamurin. Titistët u mundën nga rezistenca jonë heroike si shtet dhe si popull, nga ideologjia dhe nga politika që ndjekim ne me këmbëngulje e me sukses. Vështirësi të mëdha u krijuan në Jugosllavi nga tradhtia titiste, vendi shkoi në kapitalizëm, në degjenerim ekonomik, politik, ideologjik. Lidhja e Komunistëve degjeneroi në agjentë vrasës të UDB-së, filloi dhe u konsumua çarja. Në Brioni u përjashtua grupi terrorist i Rankoviçit dhe iu hodhën këtij të gjitha fajet e gabimet. Të mos zgjatemi në to, por pas Brionit dhe më vonë filloi gjoja një politikë më realiste me shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi etj. Filloi gjoja interesimi, dhënia e të drejtave me anë të kushtetutës, marrja gjoja e disa masave kundër udbashëve, qërimi nga Kosova i Dushan Mugoshës dhe i rankoviçistëve të tjerë me damkë.

Filloi, si me thënë, një qëndrim diçka më ndryshe, sidomos në Kosovë. Dhe kjo situatë do të zhvillohet në favor të shqiptarëve, përderisa udhëheqja shqiptare e Kosovës do të shohë më realisht kalbëzimin e regjimit titist dhe do të dijë t'i shfrytëzojë rrethanat dhe koniunkturaturat që krijohen atje.

Fakt është se reaksioni serb, nën maskën e politikës titiste, u përpoq të pengonte që Kosova të merrte të drejtat që i caktonte kushtetuta, siç është çështja e flamurit. Por demonstratat e studentëve shqiptarë e trembën regjimin. Në një Jugosllavi që rrezikohet nga përçarja serbokroate, shqiptarët janë një forcë e konsiderueshme, kompakte, që është rrezik ta kesh kundër, pale të futesh në luftë të hapët me të. Historia i ka të shkruara ngjarjet dhe betejat në të kaluarën. Sot armiqtë e popullit shqiptar nuk mund t'i bëjnë llogaritë kaluar. Nuk kanë përballë një popull të përçarë, pa shtet, të paarmatosur dhe në numër të vogël, por tre milionë e ca veta. Titistët budallenj nuk janë. Të gjitha këto ata i llogaritin, prandaj po «interesohen» kështu për «ngritjen ekonomiko-kulturore të Kosovës». Por edhe kosovarët, edhe udhëheqësit e tyre, duhet t'i llogaritin këto fitore dhe avantazhe të arritura dhe të dinë të përfitojnë prej tyre.

Populli kosovar, dhe kur themi kosovar ne kuptojmë gjithë vëllezërit tanë, shqiptarët, që rrojnë në trojet e veta në Jugosllavi, është i mrekullueshëm, si i gjithë populli ynë. Ne këndeje kemi për detyrë të luftojmë e të bëjmë sakrifica për të, të bëjmë një politikë të zgjuar e të vendosur, që, duke mbrojtur si sytë e ballit Republikën Popullore të Shqipërisë, të luftojmë edhe për të gjitha të drejtat e popullit të Kosovës. Por ai e di se jetën e ka me Shqipërinë. Se kur do të realizohet kjo, është tjetër çështje, duhen mend, politikë e urtë, trimëri, vendosmëri dhe pjekuri në situatat që krijohen dhe për shfrytëzimin e tyre. Veçanërisht rol të madh do të luajë

vetë populli i Kosovës dhe udhëheqësit e shëndoshë të tij.

Në qoftë se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës lidhen ngushtë me masat e popullit, në qoftë se zemra dhe pulsi i tyre rrahin njësoj me ato të popullit, në rast se ata i studiojnë situatat dhe i zgjidhin problemet në rrugën marksiste-leniniste, pavarësisht nga regjimi titist që sundon atje, pavarësisht se formalisht bëjnë pjesë në një parti revizioniste, siç është Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, punët për popullin e Kosovës mund të shkojnë duke u konsoliduar, në favor të tij. Kjo mund të duket si një gjendje kontradiktore, por është dialektike. U duhet adaptuar situatave që të luftohet për krijimin e situatave më të mira, duhet bazuar në të drejtat e fituara për të fituar të reja, duhet të bësh të gjitha sforcot që të përfitosh sa më shumë nga situatat legale që paraqiten, për të forcuar pozitat e fituara.

Duhet të dish e të mësosh për të qenë «supël» kur duhet, pa bërë lëshime parimore, s'duhet humbur çdo gjë e fituar për të arritur diçka të parëndësishme, duhet me qenë gjakftohtë në veprime për kauzën e madhe të popullit dhe në këtë kohë ndjenjat e zemrës për popullin të jenë të zjarra. Komunisti i vendosur është në gjendje t'i arrijë këto.

Pas Brionit titistët u detyruan të lëshojnë karshi shqiptarëve. Tash, pas ngjarjeve të Kroacisë, detyrohen përsëri të lëshojnë. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës kanë nxjerrë vallë mësimë dhe konkluzione nga këto ngjarje? A kanë nxjerrë mësimë nga e gjithë gjendja në Jugosllavi udhëheqësit shqiptarë të Kosovës? Ku e çoi titizmi atë? Ç'është titizmi në realitet dhe sa të drejta dhe të vërteta ishin vija, rruga dhe qëndrimet e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë?

Unë mendoj se tash, ata jo se i shohin qartë dhe drejt si ne të gjitha këto gjëra, por i kanë sytë më të gelur, disa gjëra i shohin më mirë, vuajtjet i kanë më-

suar të gjykojnë dhe të bëjnë barazime më realiste. Unë mendoj se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës, flas për ata të ndershmit, pavarësisht nga gabimet që mund të kenë bërë, kanë më shumë besim te Republika Popullore e Shqipërisë, te Partia e Punës e Shqipërisë, jo vetëm për arsye nacionale që po e po, që edhe kjo ka rëndësi, por edhe si njerëz politikë.

Unë këtë çështje e quaj shumë pozitive tek ata. Ata shikojnë nga Shqipëria me besim të madh për çështjen e arsimit, të gjuhës, për problemet shoqërore, si: emancipimi i gruas, lufta kundër fesë e zakoneve të këqija, kundër gjakmarrjes. Populli kosovar u bën një presion të madh në këtë drejtim dhe ata i qëndrojnë pozitivisht. Serbomëdhenjve këto nuk u pëlqejnë, po shqiptarëve aq u bën, i kapërcejnë vështirësitë dhe tregohen të shkathët në përdorimin e legalitetit. Në rrugën e kroatëve nuk duhet të shkojnë, se goditen, armiku shkak do, kurse në rrugën konstitucionale zor se i kapin titistët.

Por për ta ka rëndësi, sidomos, marrja e pushtetit plotësisht në duar të besuara të popullit shqiptar të krahinës dhe që në parti të jenë njerëz të ndershëm të tij. Në të dy këto vende kyç duhet të shikohet dhe ana tjetër. Dy rrugë paraqiten: o të punosh në ilegalitet dhe të krijosh një pushtet dhe një parti ilegale, ose të pranosh statukuonë aktuale, të futesh brenda dhe, duke përfutuar nga demagogjia e tyre, ta marrësh kalanë nga brenda dhe pastaj të bësh spastrimet.

Që të dy variantet lypin njerëz të sprovuar, besnikë të marksizëm-leninizmit, që t'i njohin mirë situatat dhe të dinë të veprojnë dhe të manovrojnë me shkathtësi. Ata duhet të mbështeten te populli, të mos bien në pozita shoviniste, të mbështeten edhe në orientimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, të studiojnë me vëmendje materialet e saj. A ka udhëheqës të tillë? Mund të ketë, nuk dimë, pavarësisht nga gabimet që mund të kenë bërë.

Dhe në mos ka sot, lufta do të krijojë të tillë. Kosovarët janë shumë të zgjuar, trima dhe patriotë, ata janë dhe do të bëhen edhe marksistë-leninistë të vërtetë. Ky është besimi dhe bindja ime e plotë dhe e patundur.

Udhëheqja kosovare, e mbështetur dhe e lidhur me popullin, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që të zhvillojë arsimin dhe kulturën kombëtare në masa, të forcojë sidomos mësimin e gjuhës shqipe dhe historinë e popullit shqiptar. Veçanërisht ata, pa e ndarë atë nga luftërat e përpjekjet e popullit shqiptar të Republikës Popullore të Shqipërisë për liri dhe pavarësi, duhet të zhvillojnë dhe t'i mësojnë popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi historinë e luftërave dhe të kryengritjeve të tyre kundër turqve dhe serbo-malazezëve. Për këta të fundit, natyrisht, duhet të atakojnë idenë shtypëse, barbare, anti-shqiptare të serbomëdhenjve, të kralëve të Beogradit dhe të Cetinës, brenda kuadrit historik dhe pa rënë në shovinizëm. Kjo është një punë delikate, por është e domosdoshme që të preket prej tyre. Format duhet t'i gjejnë në bazë të rrethanave dhe të situatave që u paraqiten. Masat e popullit të Kosovës duhet të mbahen në korent për zhvillimin e vendit tonë, ta duan këtë dhe ne duhet të bëjmë çmos t'i ndihmojmë, kuptohet, pa komprometuar politikën e shtetit tonë, se atëherë është dëm për ne dhe për ata.

Në të gjitha hallkat e pushtetit, ata duhet të futin njerëz të besuar, të fortë, të ndershëm, patriotë dhe të zgjuar, që të dinë të mbrojnë popullin shqiptar nga çdo rrezik, të dinë të shfrytëzojnë çdo rrethanë në favor të tij, të spastrojnë të këqijat e çdo lloji, duke shfrytëzuar edhe demagogjinë më të vogël të titistëve. Që të bëhet kjo, duhet një unitet i fortë shqiptar, popull-udhëheqje, pa qenë shovinist, ndaj popujve jugosllavë, pa qenë anti-serb o antimalazez, duhet unitet i çeliktë në kushtet le-gale të realitetit armiqësor titist.

E MËRKURË

2 SHKURT 1972

ÇFARË DUHET TË KEMI PARASYSH NË POLITIKËN TONË NDAJ ITALISË DHE GREQISË

Udhëzime

Nga Ministria e Punëve të Jashtme më vunë në dijeni të «bisedave» që vjen e bën tek ata herë pas here, ambasadori italian. Qëllimi i tij është i dyfishtë, për të «afirmuar», në njëfarë mënyre, politikën e qeverisë italiane dhe për të tatuar pulsën tonë për problemet që ai ngre.

Në përgjithësi, problemet vijnë rreth e rrotull Ballkanit, Mesdheut, «influcencës sovjetike» etj. Ditën e fundit çështja e bisedës ishte Jugosllavia dhe e ardhmja e saj. Para se të fillojë çdo bisedë, ai do t'i «qëndisë» ndonjë elozh «politikës realiste, të drejtë e të pavarur» të Qeverisë Shqiptare, me të cilën ai shton çdo herë se «qeveria italiane është dakord». Në takimin e fundit, ambasadori italian paraqitej i shqetësuar «për çka po ngjet në Jugosllavi, për krizën që kalon ajo, që qeveria italiane është për ekzistencën e Federatës Jugosllave dhe jo për shpërndarjen e saj, se qeveria italiane e aprovon politikën e Titos, që i reziston presionit sovjetik, i cili është i rrezikshëm» etj.

Dhe ai, natyrisht, muhabetin e tjerë në këtë drejtim për të na bërë të kuptojmë se «rreziku sovjetik është kurdoherë si shpata e Damokleut» dhe, që të forcojë

«argumentimin», por edhe të dijë mendimin tonë, tha se «mirë po ja, një mëngjes ne ngrihemi nga gjumi dhe shohim se në Adriatik dhe në portet jugosllave ndodhet nga një kryqëzor ose aeroplanmbajtëse sovjetike, që nuk ishte dje».

Pastaj ai e kapërcen çështjen në përcaktimin e fjalës «irredentizëm», që gjoja gazeta «Rilindja» e Kosovës e ka përdorur, duke dënuar irredentizmin shqiptar, term që përfaqësonte një mendim të gabuar të italianëve (sigurisht bën aluzion me kohën e fashizmit italian dhe të «Shqipërisë së madhe»). E gjithë kjo tiradë provokative bëhet për të marrë vesh ç'mendojmë ne për gjendjen aktuale në Jugosllavi, ç'mendojmë ne për Kosovën.

E lë këtë muhabet dhe hidhet pastaj në çështjen e Maltës, ku na siguron se «nuk do të lejohet që të bëhet një bazë agresive sovjetike» etj.

I këshillova shokët e Ministrisë së Jashtme që këto biseda, duhet jo vetëm të mbahen në shënim, por të studiohen, duhen nxjerrë qëllimet e atyre që thuhën, pse thuhën dhe u duhet dhënë përgjigje në forma të ndryshme diplomatike. Në këtë rast ne duhet t'ia riafirmojmë atij politikën e patundur e të pavarur të shtetit tonë, si kundër NATO-s, edhe kundër Traktatit të Varshavës, se politika e Qeverisë sonë është që të shporren nga Mesdheu të dyja flotat e tyre. Po ashtu dhe ca më shumë akoma që politika e Qeverisë sonë është që në portet e Adriatikut të mos ketë veçse flota të tri shteteve që lagen nga ujërrat e Adriatikut, të Shqipërisë, të Italisë dhe të Jugosllavisë. Adriatiku nuk është as juaji, as yni, as i jugosllavëve, por i të treve dhe se ne nuk pranojmë që flota të huaja të vendosen qofshin nga ju, qofshin nga jugosllavët në portet e bregdetit tuaj. Ne në tonin nuk do të lejojmë kurrë, kush do të orvatet të hyjë me forcë, do t'i përgjigjemi me forcë. Kështu i jemi përgjigjur dy herë pushtimit italian, që ne «jemi të mendimit se

nuk do të ndodhë më», kështu dëbuam flotën e Hrushovit, kështu do të kundërshtojmë me forcë edhe çdo orvatje të NATO-s, të Traktatit të Varshavës e të kujtdo goftë tjetër.

Për sa i përket qëndrimit tonë ndaj Jugosllavisë ia konfirmoni që edhe në këto situata është ai i shpallur zyrtarisht, pra s'ka asnjë ndryshim. Ne nuk përzihemi në çështjet e brendshme të saj, mos bini në provokacionin për «irredentizmin kosovar» dhe i rikujtoni deklaratën e solidaritetit tonë me popujt e Jugosllavisë, në rast se kësaj i shkelet liria dhe pavarësia. Kështu, pra, i trajtoni çështjet në përgjigje të pyetjeve indirekte të tij dhe në konfirmim të politikës sonë të drejtë e të vendosur. I trajtoni çështjet në një mënyrë të atillë që të vihet në dukje se jo ne, por ai ose qeveria italiane ka kundërshtim me politikën tonë, ata le të prononcohen, ne nuk i japim llogari kujt, por afirmojmë politikën tonë të jashtme dhe marrëdhëniet me fqinjët.

Kurdoherë duhet t'u vini kujdes, u theksova shokëve, deri në detaje, thëniet e ambasadorit italian, pse politika borgjeze kapitaliste italiane është shumë e poshtër dhe dinake kundër vendit tonë. Prandaj nuancat më të vogla duhen vënë re. Kërkohet prurëncë e madhe, çdo gjë të shikohet me rezervë me ta, pse politika e tyre nuk ka as atë minimalen «ndershmëri borgjeze», në goftë se mund të shprehemi kështu. Me dhjetëra vjet kanë kaluar nga çlirimi i vendit tonë dhe ne nga ana e qeverive të ndryshme italiane shohim përbuzje dhe indiferencë ndaj vendit tonë. Edhe ne nga ana jonë ua kthejmë po ashtu të njëqindfishuar.

Sidoqoftë, theksova, ne duhet të bëjmë politikë me Italinë, të shfrytëzojmë koniunkturën në favorin tonë, të shfrytëzojmë kontradiktat që ekzistojnë në mes Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë në interesin tonë, të shfrytëzojmë kontradiktat në mes NATO-s dhe Traktatit të Var-

shavës, në interes të lirisë dhe të pavarësisë së vendit tonë.

Më informuan, gjithashtu, për bisedën dhe kërkesat që kishte bërë ambasadori grek, Karajanis, në takimin e fundit me shokët tanë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ambasadori grek paraqitet «shumë dashamirës» për përmirësimin e marrëdhënieve të Greqisë me Shqipërinë. Ai pretendon se tok me Pallamasin kanë qenë pionierët dhe shtytësit pranë qeverisë greke për likuidimin e mbi-shtresave absurde që kishte vënë Greqia për të penguar realizimin e këtyre lidhjeve. Ai pra, si «pionier», ka pasë kërkuar po ashtu nga qeveria e tij që të jetë i pari ambasador i Greqisë në Shqipëri.

Karajanis flet «mirë dhe me simpati» për gjendjen në Shqipëri, pohon se habitet që këtu kudo që shkon e me këdo që piqet gjen kaq bujari dhe mirësjellje për personin e tij si ambasador i Greqisë. Në Greqi, për shkak të propagandës jo të drejtë që është zhvilluar ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, nuk mund ta imagjinojmë kurrë një gjë të tillë, thotë ai. Kjo, për fat të keq, vazhdon ai më tutje, ka lënë akoma mbresa, që ne duhet të bëjmë çmos t'i zhdukim. Ai flet «me simpati» për sukseset që Shqipëria ka bërë në çdo drejtim dhe, nga informatat që kemi, në bisedimet që bën me përfaqësuesit e ambasadave të vendeve revizioniste në Tiranë, ai i kundërshton, pse de-formojnë situatën shqiptare, që është e qartë. Ai thotë se ata gënjejnë dhe përçmojnë gjithçka shihet me sy se është e mirë. Shqipërinë duhet ta gjykojmë si ka qenë dhe si është bërë tash, pavarësisht se je ose nuk je dakord me regjimin aktual. Ne dëshirojmë, deklaroi në Ministrinë tonë të Jashtme ambasadori grek, të rrojmë në fqinjësi të mirë. Çështjes së pretendimeve territoriale nuk i beson njeri në Greqi dhe «gjendja e luftës» ishte një absurditet, pse sulmi italian vërtet erdhi nga terri-

tori shqiptar, por Shqipëria vetë që pushtuar nga italianët dhe luftoi kundër tyre. Kur ne u bindëm se Shqipëria i rezistoi ndërhyrjes sovjetike dhe nuk përbënte më rrezik për Greqinë, tha ai, bashkë me këtë u zhdukën edhe të gjitha arsyet e tjera.

Pas këtyre ambasadori grek kërkoi me «dashamirësi», dhe arsyetoi, që të lejojmë të vijë këtu një gazetar «demokrat» grek me qëllim që të bëjë të njohur në opinionin grek përparimet e vendit tonë. Në këtë mënyrë, tha ai, dëshiroj të kontribuoj në spastrimin e mendimeve të gabuara që kanë në Greqi për Shqipërinë. Pastaj kërkoi t'i krijohej mundësitë nga ana jonë që të vizitojë Sarandën (këtë çështje e ngriti nën pretekstin e shitjes së zarzavateve nga ana jonë Korfuzit), pastaj dhe Gjirokastrën. Ndonjë fshat të Dropullit nuk zuri në gojë, por nuk la pa përsëritur hapjen e kufirit në postën e Kakavijes. Këto janë çështjet që shtroi ambasadori grek në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme.

Këshillova shokët, që, pa humbur vigjilencën, të gjejnë momentin më të përshtatshëm për ne dhe t'i plotësohen këto kërkesa, me përjashtim të çeljes së postës së Kakavijes.

Edhe ne kemi interes që opinioni në Greqi të mendojë ndryshe. Gazetari në fjalë, që merr përsipër dhe rekomandon ambasadori grek, do të shkruajë deri diku si dhe mjaft gazetarë të tjerë borgjezë që kanë ardhur te ne. Pretendime të shumta s'mund të kemi nga një gazetar grek, por ka mundësi që edhe vetë ambasadori për karrierën e tij personale të influencojë tek ai për të mirë. Edhe vajtjen në Jug ne t'ia lejojmë, zaten ambasadorëve të tjerë këtë s'ua ndalojmë. Meqë ky kërkon leje, ne le të tregohemi xhentilë dhe t'i lëmë të kuptojë se s'kemi asgjë t'i fshehim, s'kemi frikë nga ai. Në fakt, vajtja e tij nuk mund të na shkaktojë asnjë shqetësim, pse kalmi i tij në Jug nuk është veçse një paraqitje, dhe ata

që janë të interesuar për të, e dinë që ne lidhëm marrëdhënie diplomatike me Greqinë dhe kjo ka ambasador në vendin tonë. Vajtja e tij një herë nuk sjell asnjë rrezik për ne. Rreziku mund të vijë, dhe këtu ne duhet të jemi vigjilentë, nga puna diversioniste, ilegale, të cilën ai mund ta bëjë që nga Tirana. Kurse kalimi në Jug, do t'i bëjë mirë, pse do t'i spastrojë kokën, duke parë lulëzimin e vendit tonë. Organizojeni. Bile, u thashë shokëve të ministrisë, mund t'i përgatitni të vejë edhe në ndonjë fshat të Dropullit, të takohet me popullin dhe të shohë me sytë e tij se sa mirë jetojnë vëllezërit tanë minoritarë në vendin e vet socialist. Zaten këtu e ka ambasadori grek gjithë hallin, që vjen rreth e rreth lëmit. I dalim ne përpara dhe me këtë i themi se nuk kemi frikë që ti të vesh edhe në Dropull, pse Dropulli është Shqipëri dhe dropullitët janë të lidhur si mishi me kockën me popullin shqiptar dhe me Partinë e Punës, e cila u ka dhënë atyre të njëjtat të drejta, barazi etj., etj.

Ai vetë do të bëjë krahasimin midis realitetit tonë dhe atyre gjërave që shpifin në Greqi për ne, ai do të barazojë vetë jetën e këtejshme me atë të fshatarëve të atjeshëm. Karajanis do të bëjë medoemos raporte në Athinë për ato që sheh e do të shohë, që dëgjon e do të dëgjojë dhe neve na leverdis që ky të raportojë realitetin të paktën. Sjelljet tona korrekte, por plot vigjilencë, mund të ndihmojnë në këtë drejtim.

S'duhet të harrojmë se në mes Italisë dhe Greqisë jo vetëm ka armiqësi të vjetra, pse Italia e ka sulmuar, por ka edhe kontradikta të reja. Regjimi i kolonelëve s'e ka mirë me kolonellët civilë të Romës. Greqia nuk dëshiron që Italia të shkelë Shqipërinë, as Italia nuk lejon Greqinë që të shkelë Shqipërinë. Por tash që të dyja kanë formuar bindjen se Shqipëria është e tillë që u bën ballë edhe njëres, edhe tjetres, edhe të dyjave së bashku, në rast se e prekin. Prandaj që të dyja përpiqen të jenë

miq me ne, «duam që ju të keni një politikë të pavarur», na thonë, sikur këtë politikë të vendosur ne e bëjmë për qejfin e Romës dhe të Athinës! Këto që thashë duhet t'i ketë parasysh Ministria e Punëve të Jashtme në politikën tonë me këto dy vende fqinje.

**E MËRKURË
2 SHKURT 1972***

AMERIKANËT PO I KREHIN BISHTIN ÇU EN LAIT

Amerikanët, mbrëmë, po i bënin shumë lajka në shtyp Çu En Lait. E quanin mendimtar, filozof, deri në të qeshurat e tij. Çuja, sipas tyre, shumë dashamirës, u kishte kërkuar që t'i bënin kritika, të cilat i pranoi, duke thënë se do të marrë masa që «të shpëtojë Pekinin nga smogu». Ai u kishte thënë se ka një admirim të madh për popullin amerikan. Sipas amerikanëve, Çuja e kritikoi butë vijën e Niksonit për luftën në Vietnam, kurse amerikanët e lavdëronin Çunë se punonte shumë, 18 orë në ditë, dhe se ishte i freskët si molla. Po i krehin bishtin.

TRAI NJË LIBËR I MIRË PËR VENDIN TONË

Lexova një recension në shqip të librit «Sfida shqiptare» nga Jan Myrdal, i cili e ka trajtuar mirë çështjen, siç thotë recensionin, me shumë realitet dhe dashamirësi për vendin dhe për popullin tonë.

SHËNIM

Ramizi më raportoi për takimin dhe bisedën që kishite pasur me Sekretarin e Përgjithshëm të PK Peruane, shokun Paredes. Ndonjë gjë të re nuk kishte pasur. Kishte kërkuar një takim lamtumire me mua, pse largohet të martën që vjen. I lashë takim të hënën.

TAKIMI ME SHOKUN PAREDES

Në orën 12⁰⁰ pata një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Komuniste Peruane, shokun Paredes. Bisedimet me të qenë shumë të hapëta, miqësore dhe të sqarta, marksiste-leniniste. Ai foli me dashuri të madhe për Partinë tonë dhe për rolin e madh të saj dhe falënderoi për strehimin bujar që i dhamë gruas dhe tre fëmijëve të tij.

SHËNIM

Shoku Ramiz më propozoi dhe unë isha dakord që të dekorojmë shokët komunistë Tejlor¹ (Zelanda e Re) dhe Anderson² (Suedi), që kanë punuar me vite në Radion tonë dhe në përkthime.

1 Ronald Tejlor

2 Nils Anderson

**VIJA E DEMARKACIONIT MIDIS MARKSISTË-
-LENINISTËVE DHE REVIZIONISTËVE MODERNË
NUK MUND TË SHLYHET**

I dërguam redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» artikullin me titull: «Vija e demarkacionit midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë nuk mund të shlyhet»¹. Do ta botojë në numrin e saj të nesërm.

Është i nevojshëm ky artikull se Partia Komuniste e Kinës po vepron në drejtim të gabuar me Partinë Komuniste të Spanjës (revizioniste), Partinë Komuniste të Rumanisë etj.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 188.

**PARTIA KOMUNISTE E KINËS ËSHTË NË POZITA
REVIZIONISTE**

Gën Biao, ish-ambasadori i Kinës te ne, tash është bërë një personalitet me rëndësi në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës. Ai drejton drejtorinë e jashtme dhe vazhdimisht në shtyp del në radhën e udhëheqësve kryesorë. Ka mundësi që, pas «spastrimit» që u bë në Byronë Politike, një mëngjes të dalë edhe si anëtar i saj. Ishte njeri dinak, «diplomat» i zoti dhe besnik i Çu En Lait. Tash Gën Biaoja pret e përcjell miqtë e shokët e Partisë Komuniste të Kinës, komunistë, revizionistë e trockistë që vizitojnë Kinën, dhe «u jep vijën», natyrisht atyre që e pranojnë.

Me ne, domethënë me ambasadorin tonë, kur i bie rasti të takohet, tregohet sikur «e ka grurë», lëshon formulat e njohura. Por, kur takohet me miqtë dhe me shokët e përbashkët, duke u dhënë vijën e tyre, natyrisht, këto formula i torpilon. Një pjesë e miqve dhe e shokëve kur kthehen nga Kina, vijnë e na thonë se nuk janë dakord me pikëpamjet e kinezëve; një pjesë tjetër, se janë dakord, por, duke menduar se ne jemi «në një vijë me kinezët», duan të arsyetojnë qëndrimet e tyre antimarksiste.

Francezi Zhak Zhyrke, udhëheqësi kryesor i Partisë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste) që bën «ilegalin», pas kthimit nga Pekini, ka nja 6 muaj që u shma-

nget takimeve me shokët tanë në Paris. Ai nuk erdhi as në Kongresin tonë të 6-të, nën pretekstin e «ilegalitetit». Por këto ditë, siç po duket e siç e tha edhe vetë, ngaqë «presioni dhe ndjekjet e policisë kundër tij po pakësohen», vajti në ambasadën tonë. Ai kishte lënë edhe mjekrën që të ishte «plotësisht ilegal».

Ç'u tha Zhyrkeja shokëve tanë? Se partia e tij po forcohet dhe po zgjerohet në fabrikën ku punon Kazasi, që e kanë hedhur jashtë radhëve të partisë, që ka kritikuar pikërisht Zhyrkenë dhe ka kërkuar llogari prej tij, se ka shkelur normat e partisë. Kazasi është punëtor dhe ish-anëtar i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste).

Zhyrkeja u tha pastaj shokëve tanë se është ngarkuar nga Çu En Lai që t'u gjejë kinezëve një shkrimtar të njohur, revizionist në Francë, i cili të shkruajë për Kinën, siç kanë vepruar edhe në Itali, ku një revizioniste e njohur, e cila ka shkruar në Kinë, është ndihmuar dhe ka shkruar një libër. — Dhe unë, vazhdoi t'u thotë Zhyrkeja shokëve tanë, po punoj me shkrimtarin e njohur revizionist Shabrol, që po përpiqem ta bind.

Shokët tanë i thanë Zhyrkesë përse duhet të shkruajnë revizionistët për Kinën, se Shabroli, pavarësisht se ka ikur nga partia revizioniste e Francës, ai prapë është revizionist, njeri i borgjezisë e çfarë të duash.

Nuk ka shumë rëndësi kjo çështje, theksoi Zhyrkeja. Unë bisedova edhe për takimin dhe bisedimin që shokët kinezë bënë në Kinë me Karriljon e Partisë Komuniste (revizioniste) të Spanjës. Biseda ishte e frytshme, më thanë ata, se partia revizioniste spanjolle ka një politikë të jashtme të drejtë dhe ajo ka edhe kontradikta me sovjetikët, prandaj kinezët do të bashkëpunojnë me Karriljon. Shokët kinezë do të marrin kontakt edhe me Partinë Komuniste (revizioniste) të Italisë. Është Rumania, përfundoi Zhyrkeja, që arriti t'i puqë këto parti me Par-

tinë Komuniste të Kinës dhe shokët kinezë e konsiderojnë këtë si një gjë të mirë dhe të nevojshme.

Zhak Zhyrkeja ka përqaftuar plotësisht orientimet e kinezëve. Pas këtyre deklaratave që bëri, ai u tha shokëve tanë se «jemi duke marrë kontakt me Sharl Tijonë, me të cilin po bëjmë bisedime dhe po e afrojmë». Atëherë shokët tanë i thanë: «Po Sharl Tijoni, pavarësisht se është përjashtuar nga PK (revizioniste) e Francës, është deklaruar antistalinist dhe mbrojtës i zjarrtë i Titos, si do të bisedoni dhe si do të bashkoheni ju me të?». Dhe ky revizionist u përgjigj: «Siç po bëni ju me Rumaninë dhe me Jugosllavinë, që thoni se janë revizioniste». Shokët tanë i thanë këtij mendjefryri se ai nuk ka kuptuar asgjë nga vija dhe nga lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit modern dhe në mënyrë të veçantë kundër titizmit, se ai nuk ka marrë as mundimin të lexojë raportin e fundit, atë të Kongresit tonë të 6-të. Ne me Jugosllavinë titiste mbajmë marrëdhënie shtetërore, kurse ideologjikisht jemi në luftë të ashpër e të papajtueshme me të.

Nga ana tjetër, një shok i një partie komuniste marksiste-leniniste, që ishte në Kinë, na shprehu pakënaqësinë e tij për disa pikëpamje në vijë të shokëve kinezë.

«Shokët kinezë, na tha ai, më kërkuan informata për shumë shokë në vendin tim, gjë që më çudit. Unë kërkova të më informonin për çështjen e Lin Biaos etj., po as edhe një fjalë nuk më thanë, e bënë veshin të shurdhër. Diskutuam me shokët kinezë çështjen e vajtjes së Niksonit në Pekin dhe dhamë pikëpamjen tonë për imperializmin amerikan e për qëndrimet tona ndaj tij, qëndrime që puqen plotësisht me vijën e PPSH. Pikëpamjet e kinezëve janë ndryshe. Ata janë për bashkëpunim dhe bashkëveprim kundër një armiku tjetër, domethënë, janë për teorinë që mund të mbështetemi te Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të luftuar sovjetikët dhe më sollën

disa shembuj të çuditshëm: «Partia e Punës e Koresë është antirevizioniste, ajo i lufton revizionistët brenda dhe mban miqësi me revizionistët sovjetikë». Po ashtu, i kishin thënë kinezët, «Partia e Punonjësve të Vietnamit është antirevizioniste dhe mban marrëdhënie të mira me sovjetikët». «Më në fund, tha shoku në fjalë, Çu En Lai na këshilloi që të pajtohemi dhe të bashkëpunojmë me qeverinë borgjeze të vendit. Këto janë gjëra të çuditshme, tha ai, që, po t'i shtroj në parti, do të na shkaktojnë përçarje»».

Është e qartë se këto dhe shumë qëndrime të tjera si këto tregojnë se Kina nuk ndjek një politikë të udhëhequr nga marksizëm-leninizmi. Politika e saj po rreshtohet dhe do të shkojë edhe më shumë drejt politikës së një fuqie të madhe, që po kërkon të konsolidojë pozitën në arenën ndërkombëtare, me miqësi, me aleanca, me lidhje koniunkturale jo të bazuara në parimet e shëndosha marksiste-leniniste dhe në interes të socializmit e të revolucionit botëror, por në interes të një Kine të madhe, të fuqishme, të vetëquajtur socialiste, por që në realitet nuk është e tillë.

Është e qartë tendenca e luftës që ka shpallur Partia Komuniste e Kinës kundër «majtistëve». Kjo do të thotë luftë kundër parimorëve, kundër atyre të cilët duan që lufta të zhvillohet në të njëjtën kohë në të dy frontet: si kundër imperializmit, ashtu edhe kundër revizionizmit.

Kinezët hiqen si antirevizionistë, por bashkëpunojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin me çdo rrymë revizioniste, që gjoja ka kontradikta me revizionistët sovjetikë. Pra praktikisht bashkohen (dhe janë të bashkuar edhe ideologjikisht) me revizionistët për të luftuar revizionistët sovjetikë.

Kinezët hiqen si antiimperialistë, hiqen sikur luftojnë dy superfuqitë imperialiste, por aktualisht po zhvillojnë kontaktet dhe bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara

të Amerikës kundër sovjetikëve. Gjoja shfrytëzojnë kontradiktat. Nuk e thonë shprehimisht se armiku numër një i njerëzimit janë sovjetikët, por e lënë të kuptohet që Shtetet e Bashkuara nuk janë më armiku numër një.

Nesër, në një koniunkturë të re, mund të ndërrohen rolet. Çështja qëndron në atë që Kina, duke bërë politikë joparimore dhe gjoja duke shfrytëzuar kontradiktat dhe koniunkturat, nuk mund të konsolidohet si një vend i fuqishëm socialist dhe Partia Komuniste e Kinës si një parti e patundur marksiste-leniniste që mbron parimet. Përkundrazi, politika aktuale e Kinës bëhet nga pozita revizioniste, që do të thotë se Partia Komuniste e Kinës është në pozita revizioniste, prandaj politika që ndjek nuk mund të jetë politikë e vërtetë e një shteti socialist.

Kjo ne na shqetëson pa masë dhe shqetësimi më i madh është për njerëzimin mbarë.

E MËRKURË

16 SHKURT 1972

ÇFARË DHE SI DUHET BISEDUAR ME FADIL HOXHËN

Udhëzime

Ambasadori ynë në Beograd, na lajmëron se Fadil Hoxha e ka ftuar për drekë, duke i theksuar se «dreka do të bëhet jashtë» dhe, duke dhënë mendimin e tij se duhet ta pranojë, na pyet të vejë apo jo. Ne iu përgjigjëm se duhet të vejë.

Bisedova me shokët e Ministrisë së Jashtme që ambasadori ta pranojë takimin «me dashamirësi» dhe të zhvillojë me të një bisedë «të lirë» dhe «miqësore», pavarësisht se cilat janë qëllimet e Fadilit. Sidoqoftë ai tregohet «i afruar» me ne. Edhe ne duhet të tregohemi po ashtu. Në të njëjtën kohë asnjë dyshim nuk duhet të kemi që ai vjen në këtë takim me dijeninë e Titos dhe të udhëheqjes jugosllave. Atij i kanë rekomanduar të ftojë ambasadorin tonë për drekë dhe, për t'i dhënë takimit një «frymë të veçantë besimi» (këtë gjë po ashtu e di udhëheqja jugosllave), një «intimitet» shqiptarësh, larg çdo «dyshim përgjimi» nga ana e autoriteteve jugosllave, Fadili theksoi se dreka do të hahet jashtë. Me këtë ata, si Fadili, si udhëheqja jugosllave, duan të na tregojnë se «punët kanë ndryshuar në Jugosllavi dhe se te Fadil Hoxha, i cili u bë dhe anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ, kanë besim të plotë». Pra, «politika jugosllave me Kosovën

është në rrugë të drejtë», kështu «duhet të kemi edhe marrëdhënie miqësore me Republikën Popullore të Shqipërisë», duan të na thonë me këtë gjest jugosllavët me anën e Fadil Hoxhës.

Cilat probleme do të trajtojë Fadili në drekë me ambasadorin tonë nuk e dimë, por sidoqoftë mund të bëjmë supozime dhe duhet që ministria ta orientojë ambasadorin për disa qëndrime të mundshme.

Në qoftë se Fadili i shtron çështjen e zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike dhe kulturore me Jugosllavinë, ai t'i thotë se, me gjithë pikëpamjet diametralisht të kundërta ideologjike, ne jemi dakord t'i zhvillojmë ato më tej. Tregtinë me Jugosllavinë e kemi shtuar, mund të shikojmë dhe mundësi të tjera. Për sa i përket marrëveshjes kulturore, ajo nuk po firmoset për fajin e jugosllavëve. Arsyeja që japin ata që emri i Kosovës të mos zihet asnjëherë në gojë në atë marrëveshje, në të cilën gati tri të katërtat e aktiviteteve bëhen në mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe krahinës së Kosovës, e njohur me statutin e Federatës, nuk qëndron aspak në këmbë, atë ne nuk e konsiderojmë të drejtë. Nga ana jonë nuk ka asnjë prapaqëllim, kurse nga pala jugosllave dyshojmë se insistohet në rrugë të gabuar. As Republika Popullore e Shqipërisë dhe as Republika Federative Popullore e Jugosllavisë nuk mund të mohojnë qenien e Kosovës. Vetë Kosova e ka fituar këtë të drejtë me statutin themeltar dhe se këto marrëdhënie me Republikën Popullore të Shqipërisë bëhen dhe do të bëhen në kuadrin e Federatës. S'ka kuptim, ose ka kuptim të keq që në një marrëveshje të tillë të evitohet të shënohet emri i Kosovës, por të supozohet. Ne ngulim këmbë në pikëpamjen tonë të drejtë dhe Fadil Hoxha, si anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ duhet të ndihmojë se ajo që tash, në fakt, po zhvillojmë ne me Kosovën, të figurojë edhe në këtë dokument zyrtar që ka mbetur pezull. Ne mendojmë

se dokumenti duhet të paraqitë realitetin dhe realiteti i përgjigjet plotësisht tezës sonë.

Fadilit t'i thuhet, po ashtu, se problemi i hidrocen-tralit të Fierzës që ngrenë jugosllavët është i kotë dhe pa baza. Ne nuk lëvizim nga teza jonë e drejtë, e bazuar në marrëveshjet e firmosura më parë me jugosllavët. Pengesa këtu nuk duhet të nxjerrin, asgjë nuk pranojmë nga ç'thonë ata dhe Fierza vazhdon dhe do të vazhdojë të ndërtohet. Jugosllavët duhet të marrin masa me kohë në Kosovë, para se të vijë momenti i përmbytjes nga liqeni që do të formohet.

Në qoftë se Fadili do t'i hapë çështjet aktuale që po zhvillohen në Jugosllavi, ambasadori ta dëgjojë me vë-rejtje këtë bisedë dhe vëmendja e tij duhet të konsistojë, jo më shumë në faktet që ai do të radhitë, pse ato ne i dimë dhe ka mundësi që ai neve të na thotë pak, por në qëllimet pse na i thotë dhe me aq sa mund të na thotë, ç'qëllime kërkojnë jugosllavët të arrijnë, duke na i thënë, cila është bindja personale e Fadilit për masat që janë marrë e po merren, bindja e tij në rezultatet dhe në perspektivën e nesërme të Jugosllavisë pas vdekjes së Titos dhe veçanërisht të Kosovës në kuadrin e Federatës. Këto gjëra ambasadori nuk duhet t'ia shtrojë pyetje Fa-dilit, por nga biseda që ai do të bëjë, ky duhet të nxjerrë mendimet e Fadilit. Këtu do të qëndrojë zotësia e tij në interpretimin e atyre çka do t'i thotë Fadili. Këto na in-teresojnë, dhe jo çfarë hëngrën e çfarë pinë.

Nga biseda e Fadilit ambasadori duhet të vërejë nëse ato që na thotë kanë formën dhe, pra, qëllimin që të bëjnë përpara nesh njëfarë autokritike, që po bëhet «një kthesë» në parti, duke ruajtur vetadministrimin, se tash «me këtë kthesë» duhet «të ketë një mirëkuptim më të gjerë» me shqiptarët dhe këto «të bazuara në çka po bëhet tash në Jugosllavi». «Shqipëria duhet të ndihmojë, se kësh-tu na ka ndihmuar edhe ne, kosovarët, në punën tonë» etj.

Pra të gjitha këto e të tjera si këto varen nga zgje-rimi, nga shtjellimi dhe nga toni i bisedës së Fadilit. Nga gjykimi në vend dhe përnjëherë i këtyre problemeve, varet edhe biseda, mënyra dhe forma që duhet të për-dorë edhe ambasadori. Në të gjitha rastet ky nuk duhet të harrojë që është diplomat, por diplomat komunist, gjakftohtë, i sjellshëm dhe duke marrë parasysh se Fadil Hoxha është shqiptar, por edhe titist, edhe kosovar me ndjenja nacionale, por edhe anëtar i Kryesisë së KQ të LKJ, të ketë parasysh që, pavarësisht se bisedimet do të bëhen jashtë, ato mund edhe të regjistrohen.

Sipas bisedës, ambasadori duhet t'i thotë Fadilit se Republika Popullore e Shqipërisë është që Federata e Jugosllavisë duhet të ekzistojë për interesin e popujve të saj dhe duhet të luftojë kundër dy imperialistëve, atyre amerikanë e atyre sovjetikë si dhe NATO-s e Traktatit të Varshavës që e rrezikojnë këtë ekzistencë nga jashtë. Armiqtë e brendshëm, përveç të tjerëve, janë edhe ser-bomëdhenjtë, shovinizmi serb dhe shovinizmi kroat.

Po ashtu, sipas zhvillimit të bisedës, ambasadori ynë mund t'i thotë Fadil Hoxhës, jo me ton të gazetës, se të gjitha këto ç'kanë ngjarë dhe po ngjasin në Jugosllavi, Partia e Punës e Shqipërisë ka meritën e pamohueshme historike t'i ketë parashikuar me kohë, me qëndrimet e saj ajo ka mbrojtur vendin e saj dhe marksizëm-leniniz-min, kuptohet se ka mbrojtur njëkohësisht edhe popujt vëllezër të Jugosllavisë.

Ne akuzoheshim se bënim «një luftë joparimore», se «ishim gjaknxehëtë e shovinistë», kurse ata që na aku-zonin ne dhe që u vunë kazmën partisë e socializmit, hi-qeshin si «marksistë të mëdhenj» etj. Faktet janë krye-neçe, historia dhe zhvillimi i ngjarjeve nuk mund të mbulohen për shumë kohë me demagogji. Përpara ngjar-jeve ne jemi të bindur se njerëzit e ndershëm, marksistët, ata që i duan atdheun dhe popullin e tyre dhe që luf-

tojnë për një kauzë të drejtë, le t'i rilexojnë me gjakftohtësi e pa pasion shkrimet e Partisë sonë, për çdo kohë dhe për çdo problem dhe do të nxjerrin disa konkluzione. Mundet me të gjitha çështjet të mos jenë dakord, por edhe me atë që bien dakord, është diçka e fituar për arsyen e shëndoshë. Ne nuk i themi njeriut të bëjë si kemi bërë ne, të tjerët me radhë na kanë thënë të bënim si mendonin ata. Ne në fillim u kemi besuar, pastaj, kur njohëm falsitetin e ideve të tyre dhe armiqësinë e tyre, i përbuzëm ata dhe i luftuam.

Ambasadori po ashtu mund t'i thotë (por kurdoherë duke u mbështetur në masën sa i hapur do të tregohet Fadili, sa i dispozuar do të duket ai që të dëgjojë dhe kurdoherë me një ton shoqëror, pa lënë përshtypjen se po i shet mend) se Partia jonë, duke zbatuar marksizëm-leninizmin besnikërisht dhe në kushtet konkrete të vendit tonë, ka hasur në pengesa e në vështirësi të mëdha, por i ka kapërcyer, ka mbajtur radhët e Partisë të pastra, se ajo ka vazhduar dhe vazhdon luftën e klasave, si brenda Partisë, edhe jashtë saj, se ajo i ka ngritur Partinë dhe popullin dhe ecën kurdoherë në një luftë revolucionare të vazhdueshme, edukimin ideologjik të Partisë dhe të punonjësve ajo e ka ngritur në një sistem të tërë dhe teorinë e ka lidhur ngushtë me praktikën. Po ta dobësojmë për një çast këtë luftë, atëherë rrezikohet socializmi. Duhet nxjerrë mësim nga historia.

Ne jemi në korrent të atyre që kanë ngjarë dhe po ngjasin në Jugosllavi. Ju thonë se ato po ndreqen. Ashtu goftë, por lufta duhet të jetë e madhe, e ashpër dhe e gjatë. Ne nuk përzihemi në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe urojmë që popujt e Jugosllavisë të dalin nga këto situata të rënda, por të gjykuara nga ana jonë, të para nga eksperiencia jonë dhe në mënyrë objektive, mendojmë se do të duhet një luftë e madhe, e ashpër, e vendosur dhe e mbështetur në parimet e vërteta mark-

siste-leniniste. Ju i njihni pikëpamjet tona në këtë drejtim, — t'i thotë, — dhe nuk është nevoja të zgjatem.

— Por, — më lejoni të them, — t'i thotë ambasadori, — se, nga ato që dëgjojmë dhe lexojmë, ka disa «të thëna» nga Titoja që kanë nevojë për shumë korigjime, sipas pikëpamjes sonë. (Dhe, në qoftë se i kërkon ndonjë shembull, ky t'i thotë atë që vetë Titoja pohon se Partia është mbushur me elementë antiproletarë, por po t'u shkohet çështjeve deri në fund, diçka mund të arrihet në ndonjë drejtim.)

Unë, — të vazhdojë t'i thotë ambasadori, — nuk e njoh me hollësi gjendjen e partisë jugosllave, por, kur lexoj në gazeta se për shembull në Mal të Zi punëtorëve u është hapur dera të ikin nga Lidhja dhe u është mbyllur të hyjnë, ata e marrin me mend si qëndron puna. Thuhet se duhet ndrequr kjo situatë. Shumë bukur. Le të marrim Kosovën, ku personalisht nuk kam qenë asnjëherë, por e di karakterin burrnor, besnikërinë, drejtësinë, mençurinë, guximin e shqiptarëve, pse janë vëllezërit tanë, se jemi të një gjaku. Atëherë, le të spastrohet atje deri në fund partia nga të ligjtë e çdo natyre dhe të çdo kombësie. Le të mbeten në parti në Kosovë njerëzit punëtorë më të pastrit, më të thjeshtët, më të guximshmit shqiptarë, serbë dhe malazez, pse ne e dimë dhe besojmë se ka të tillë të mirë edhe serbë. Por ka edhe serbë të këqij, malazez të këqij siç ka edhe të këqij në mes të shqiptarëve, të këqijat e të cilëve i ka hequr në kurriz populli shqiptar i Kosovës.

Në këtë frymë, me kujdes, në mënyrë diplomatike dhe miqësore, ambasadori mund të trajtojë dhe ndonjë çështje tjetër, që mund të dalë nga biseda e Fadil Hoxhës.

KUJDES NGA PROVOKACIONET E TITISTËVE

Shokëve të Ministrisë së Jashtme u tërhoqa vëmendjen se aktualisht, kur reaksioni po forcohet kundër elementit përparimtar shqiptar në Kosovë, delegacionet e Universitetit Shtetëror të Tiranës, që në bazë të konventës e kanë të lirë të venë, duhet t'i shmangen futjes nëpër fshatra, ngrënies së drekave dhe të darkave nëpër familje shqiptare. Veçanërisht nuk është e rekomandueshme që funksionarë të ambasadës sonë në Beograd të venë të marrin kontakt me ta. Çdo gjë shikohet me dyshim nga reaksioni titist, prandaj kujdes nga provokacionet kundër nesh dhe miqve kosovarë.

PËRSËRI PËR TAKIMIN E AMBASADORIT TONË ME FADIL HOXHËN

Me ministrin e Jashtëm bisedova përsëri për takimin që do të ketë ambasadori ynë në Beograd me Fadil Hoxhën. Ky e kishte ftuar për drekë, pastaj i kërkoi leje që të vinte në drekë edhe një anëtar tjetër i «Byrosë së Lidhjes»¹. Kjo merrte karakter bisede partish prandaj ne nuk e pranuan dhe mbeti që në drekë të jetë vetëm Fadili.

¹ Kryesia e KQ të LKJ.

VIJA KINEZE KUNDËR REVIZIONIZMIT SOVJETIK USHQEHET NGA MOTIVE NACIONALISTE

Në lidhje me vajtjen e Niksonit në Kinë, i cili nisët sonte nga ishulli i Guamit, për të qenë nesër në mëngjes në Pekin, agjencitë e lajmeve thonë se gazetarë të huaj nuk do të shkojnë, përveç amerikanëve dhe atyre që janë të përhershëm në Pekin. Këta, megjithëse i bëjnë shumë bujë vizitës, nuk po zhvillojnë ndonjë zhurmë të madhe për këtë ndalesë. Supozime dhe hipoteza të panumërta po bëhen. Do të ndjekim ngjarjet dhe do të shohim.

Tri vijat e ndryshme

Të dielën që kaloi, në gazetën «Zëri i popullit» të datës 13 shkurt, ne botuam një artikull me titull: «Vija e demarkacionit midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë nuk mund të shlyhet». Në këtë artikull politiko-ideologjik, të bazuar në vijën e Partisë sonë dhe në shënimet e tezat që kam bërë në disa momente të politikës dhe të qëndrimeve të Partisë Komuniste të Kinës, ritheksohet vija e pandryshueshme, revolucionare dhe luftarake e Partisë sonë kundër imperializmit amerikan e reaksionit dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Them e ritheksuam vijën tonë, për

arsye të momenteve të reja që janë dukur në arenën ndërkombëtare dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si edhe në gjirin e revizionizmit modern.

Imperializmi botëror, dhe në veçanti imperializmi amerikan, po kalon një krizë të thellë. Imperializmi amerikan po bën përpjekje të dalë nga kjo krizë me më pak humbje dhe dëmtime për vete dhe që barra e krizës të rëndojë mbi partnerët e tij, shtetet e tjera kapitaliste dhe «mikun» e tij, socialimperializmin sovjetik. Një zhvillim i tillë i thellë i krizës botërore ka krijuar në mes të këtyre shteteve kapitaliste dhe imperialiste kriza të thella, ekonomike dhe politike, që janë larg zgjidhjes. Përkundrazi, ato po thellohen dhe po vënë në rrezik ekuilibrin e forcave kapitaliste botërore. «Statukuonë e arritëm». Vapori, në qoftë se mund ta quajmë kështu «statukuonë», ka marrë ujë nga të katër anët dhe kërkohet ose të dilet prej tij, ose të gjenden rrugë të reja ujdje në mes të ujqve imperialistë.

Në këtë situatë revolucionare në botë (pse e tillë është situata, derisa imperializmi, kapitalizmi dhe socialimperializmi sovjetik janë në krizë të rëndë) roli i Republikës Popullore të Kinës është vendimtar. Për fatet e revolucionit botëror ka rëndësi edhe fakti se ç'rrugë do të marrë vija e Partisë Komuniste të Kinës.

Në artikullin në fjalë ne theksuam disa aspekte themelore të vijës sonë, të cilave u qëndrojmë besnikë, si në strategji edhe në taktikë, se është çështja e mbrojtjes së marksizëm-leninizmit dhe e bazave të tij. Pra Partia jonë as nuk e ka pushuar, as do ta pushojë kurrë luftën kundër imperializmit botëror dhe veçanërisht kundër imperializmit amerikan, armikut numër një të popujve. Krizat aktuale të tij dhe ato që do të lindin në të ardhmen, janë rezultat i luftës së popujve dhe revolucionarët nuk duhet të gënjejnë e ta zbutin luftën kundër tij, të bien në kompromis me të, se imperializmi, i detyruar nga dis-

fatat që po pëson, përpiket të hiqet si qengj. Përfitimet nga disfatat e imperializmit duhet të bëhen në rrugë revolucionare dhe jo liberalo-oportuniste. Ne duhet të përfitojmë nga kontradiktat e mëdha që ekzistojnë në gjirin e imperialistëve, por kurdoherë në rrugë revolucionare, pa shkelur dhe pa shkarë nga parimet. Kjo është pika e parë.

Çështja tjetër po aq e rëndësishme, që shtrohet në artikull, është teza e mirënjohur e Partisë sonë «luftë deri në fund kundër revizionizmit modern dhe në veçanti kundër revizionizmit sovjetik». Asnjë kompromis me ta, asnjëherë të mos e shuajmë polemikën me ta dhe të ndihmojmë forcat e vërteta marksiste-leniniste kudo, që të dallojnë të vërtetën nga gënjeshtra dhe të luftojnë me guxim e me heroizëm për të mbrojtur marksizëm-leninizmin. Pa luftuar revizionizmin, nuk mund të luftohet as kapitalizmi, as imperializmi, as socialimperializmi.

Partitë tona marksiste-leniniste e kanë detyrë nga më të parat të ndihmojnë partitë marksiste-leniniste që janë formuar rishtas, gati në të gjitha vendet e botës. S'mund të bëjmë asnjë kompromis në parimet me revizionistët e çdo ngjyre. Me ta asgjë nuk na afron ideologjikisht e politikisht dhe asgjë nuk na bashkon. Për të ilustruar edhe një herë këto qëndrime tonat parimore, ne morëm çështjen e Partisë Komuniste të Italisë (revizioniste), sikurse mund të merrnim edhe atë të Partisë Komuniste të Spanjës (revizioniste) të Karriljos, ose Partinë Komuniste të Rumanisë së Çausheikut. Këtë nuk e bëjmë për arsye taktike, por të tilla janë faktet, të cilat Partia jonë i analizon në dritën e marksizëm-leninizmit dhe nxjerr prej tyre përfundime të drejta. E tillë është vija jonë, një vijë kurdoherë revolucionare, e papajtueshme si me imperializmin, ashtu dhe me revizionizmin modern.

Vija tjetër është ajo e Partisë Komuniste të Kinës,

që është një vijë e njohur, së cilës ne vazhdimisht i kemi bërë analiza. Ajo paraqitet me hope dhe me periudha. Aktualisht mund të themi se paraqitet kundër revizionizmit sovjetik, por ushqehet nga motive të theksuara nacionaliste, të shtetit të madh, sido që propaganda e saj përpiket ta kamuflojë këtë orientim të shtrembër. Nga ana e saj nuk bëhet luftë e ashpër në platformën parimore marksiste-leniniste dhe në mënyrë të vazhdueshme e konsekuente. Arsyen për këtë ne duhet ta kërkojmë, natyrisht, në lëkundjet e vetë vijës kineze si jashtë edhe brenda. Vija e Partisë Komuniste të Kinës nuk është një vijë marksiste-leniniste e qëndrueshme dhe këtë e vërtetojnë ngjarjet e vazhdueshme dhe serioze të brendshme që janë zhvilluar dhe po zhvillohen në Kinë.

Çështjen e përfitimit nga kontradiktat në botën jokomuniste Partia Komuniste e Kinës nuk e shikon në baza marksiste-revolucionare. Me të gjithë ata që kanë kontradikta me revizionistët sovjetikë, kinezët kanë vendosur të afrohen, qofshin këta revizionistë të tjerë, socialdemokratë, imperialistë amerikanë ose përfaqësues të shteteve të tjera borgjeze. Kjo politikë, natyrisht, nuk zhvillohet hapur në dritën e diellit, por duken sheshit të dhënat «e mira» e të qarta të fillimit të lidhjeve me rumunët, që u bënë edhe ndërlidhësit e kinezëve me revizionistët e tjerë, bisedat e ëmbla me Karriljon, e kështu me radhë. Nga faktet konkluzionet nxirren vetë: **Partia Komuniste e Kinës kërkon të formojë një bllok të ri me disidentët revizionistë që t'i kundërvihet grupimit sovjetik, dhe ky bllok i ri nuk mund të jetë veçse revizionist.**

Me kreun e imperializmit amerikan nesër fillon takimi zyrtar. Niksoni, xhelati i popujve, do t'u shtrëngojë dorën Maos dhe Çu En Lait. Mendimin për këtë takim Partia jonë ua ka thënë kinezëve me letër. Si në drejtim të Bashkimit Sovjetik, ashtu edhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës propaganda kineze vazhdon «sul-

met», por, kuptohet, për SHBA-në edhe do, edhe s'do. Edhe Niksonin e ka në shtëpi, edhe duhet të ruajë faqen ndaj botës. Si do të vejë puna pas këtij takimi? Dy rrugë ka: ose luftë dhe atëherë ky takim ishte një fyçkë, ose kundër imperializmit amerikan do të ecet ashtu siç po ecin revizionistët sovjetikë, domethënë «shaje ditën dhe puthe natën». Intensiteti i «sharjeve dhe i puthjeve» s'do të fshihet dot me demagogji për shumë kohë. Fakt është që takimi dhe bisedimet me amerikanët kanë karakter antisovjetik. Sipas kinezëve, mund të mbështetemi tek amerikanët për të luftuar sovjetikët. Se si duhen shfrytëzuar kontradiktat që ekzistojnë në mes të këtyre dy superfuqive, unë e thashë më lart, por që të futesh në giron¹ e tyre, të shkelësh parimet revolucionare për t'u bërë një fuqi e madhe në këtë rrugë të gabuar, kjo do të thotë të rrëshqasësh nga vija.

Vija tjetër e njohur është ajo e revizionistëve sovjetikë. Këtyre armiqve asgjë nuk u shpëton, këta nuk kanë asnjë skrupull, i kanë gjerrë të gjitha maskat dhe dalin me fytyrën e vërtetë të socialimperialistëve, ashtu siç janë. Udhëheqja e Kremlinit me siguri e ka lexuar artikullin tonë, i cili nuk i ka shpëtuar as udhëheqjes së Pekinit. Reagimet kanë qenë të ndryshme, po kështu edhe veprimet. Udhëheqësit e Kremlinit dolën para dy ditësh me një kryeartikull në gazetën «Pravda», ku, natyrisht, as që zihej në gojë artikulli i gazetës sonë «Zëri i popullit», kurse kinezët heshtin, natyrisht as marrin gjë përsipër, e bëjnë veshin të shurdhër sikur nuk flitet për ta.

Ç'thotë në esencë artikulli teorik i «Pravdës»? «Luftë kundër imperializmit amerikan dhe kundër aleancës kino-amerikane» që po realizohet me vajtjen e Niksonit në Pekin.

E gjithë kjo direktivë — thirrje e Moskës do të thotë:

¹ Frëngjisht — rreth.

Hegjemonia botërore e revizionistëve sovjetikë po rrezikohet nga një fuqi e tretë, që për ta është Kina e Mao Ce Dunit. Revizionistët sovjetikë, duke ditur kontradiktat që ekzistojnë në mes tyre dhe partive të tjera revizioniste, kanë frikë se po izolohen dhe këto parti kalojnë në anën e Kinës «që u hap krahët dhe pushon polemikën ndaj tyre». Ky është rreziku ideologjik. Frika tjetër për revizionistët sovjetikë është se po hyn në mes tyre një fuqi e tretë dhe kështu vihet në rrezik miqësia e tyre me amerikanët, që prish ekuilibrin e vendosur dhe përfitimet imperialiste që buronin nga ai ekuilibër. Të gjitha këto ndryshime në vijë dhe në politikë të Kinës, të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës duhet t'i ndjekim e t'i analizojmë me vëmendjen më të madhe. Jemi përpara ngjarjeve të mëdha me reperkusione të thella.

E HËNË
21 SHKURT 1972

MBI VIZITËN E NIKSONIT NË PEKIN

Protokolli i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RP të Kinës lajmëroi ambasadat e huaja në Pekin që, me rastin e vajtjes së Niksonit, nuk do t'i ftojë titullarët e tyre as në aerodrom dhe as në bankete.

Me këtë kinezët duan të thonë se Niksoni vjen si president, por president «privat» si me thënë, pse «ceremoni unë nuk të bëj, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë lidhje diplomatike me mua».

Për sa i përket ambasadorit tonë ai kishte marrë urdhër nga ne që të mos shkonte në asnjë manifestim edhe në qoftë se do ta ftonin.

Radiot e huaja njoftojnë se Niksoni, që arriti sot në mëngjes në Pekin, u prit në aerodrom vetëm nga Çu En Lai, Li Hsien Nieni, ministri i Jashtëm kinez dhe disa personalitete të tjera. U mbajt nga një fjalim i shkurtër nga të dyja palët, Niksoni kaloi rojën e nderit dhe asgjë tjetër nuk kishte. Popull nuk kishte as në aeroport, as nëpër rrugë ose në sheshin Tien An Men.

E MARTË
22 SHKURT 1972*

MAO CE DUNI PRITI NIKSONIN

Dje Mao Ce Duni priti Niksonin dhe e mbajti në bisedim një orë. Çfarë u bisedua, nuk dihet.
Çu En Lai dhe Niksoni mbajtën nga një fjalim në banketin që u dha për nder të presidentit amerikan, ku merrnin pjesë pesë mijë veta. HSIHUA-ja nuk i ka dhënë fjalimet e tyre, kurse agjencitë e huaja po. Kështu, po të bazohemi në to, fjalimi i Çusë është «dashamirës», shumë korrekt, plot propozime për marrëdhënie miqësore në mes «dy popujve», është kërkesë për të vendosur marrëdhënie normale, edhe diplomatike, në bazë të pesë parimeve. Kurse fjalimi i Niksonit është plot demagogji për paqe, për miqësi me popullin kinez dhe lavdërime ironike për ta, por të holla.

**MENDIME TË NIKSONIT TË THËNA PËRPARA
UDHËHEQËSVE KINEZË**

Disa citate nga fjalimi i Niksonit të mbajtur në banketin e dhënë në Pekin (sipas agjencisë së lajmeve Associated Press).

«Mikëpritje e pakrahasueshme për të cilën populli kinez është i dëgjuar».

«Darkë e shkëlqyer, por edhe muzika që dëgjova këtu po ashtu e shkëlqyer. Kurrë nuk kam dëgjuar një muzikë amerikane të luajtur më mirë në një vend të huaj».

«Fjalët e Çusë i konsideroj të këndshme dhe elo-kuente».

«Çka bëjmë ne këtu, mund të ndryshojë botën».

«Në qoftë se në të ardhmen do të mund të gjejmë një fushë të përbashkët për të punuar së bashku, perspektivat e paqes do të jenë të mëdha».

«Unë shpresoj se fryma e singëritetit do të karakterizojë bisedimet».

«Ne kemi interesa të përbashkët, që i kapërcejnë divergjencat që kemi».

«Le të arrijmë «marshimin e madh» për të arritur ndërtimin e një bote të paqes, të drejtësisë, të gjithë mund të qëndrojnë së bashku në barazi... Nuk ka arsye për të qenë armiq, asnjëri prej nesh nuk synon tokat e tjetrit ose të sundojë tjetrin ose të sundojë në botë».

«Kjo është ora, kjo është dita për të dy popujt tanë që të ngrihen në majë të madhësisë, ku ne mund të ndërtojmë një botë të re etj.».

GRUAJA E NIKSONIT REKLAMON KINËN

Edhe gruaja e Niksonit ka hyrë në vallen e propagandës. Ajo reklamon «kuzhinën kineze, mallrat kineze, artin kinez, pizhamet e mëndafshhta kineze, komunitat popullore». Pat Niksoni u bë një tjetër Strong.

VAZHDOJNË BISEDIMET ÇU EN LAI — NIKSON

Vazhdojnë bisedimet e përzemërta Çu En Lai-Nikson. Propagandë të madhe i bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e tërë bota kapitaliste këtij udhëtimi dhe këtyre bisedimeve, dhe ka arsye pse ta bëjnë.

BURREL, E PREMTE

25 SHKURT 1972*

KINEZËT LUFTOJNË QË T'UA RRËMBEJNË SOVJETIKËVE HEGJEMONINË NË KAMPIN REVIZIONIST

Nga një burim i sigurt marrim vesh se Karriljoja, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste (revizioniste) të Spanjës (krahu i Pasionares), i ka bërë të njohura bisedimet në rrugë «partie» që ka pasur në Pekin me udhëheqës zyrtarë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës.

Ai kishte mbetur «shumë i kënaqur» nga bisedimet që zhvilloi në Pekin. I kishin bërë përshtypje të madhe «përparimet e Republikës Popullore të Kinës, si dhe masat e mbrojtjes që kanë marrë kinezët për t'i bërë ballë çdo sulmi eventual sovjetik». Në këto drejtime Karriljoja jo vetëm flet me simpati të madhe, por është bërë një agjikator i propagandimit të Kinës. **Ai kishte pohuar se gabimi më i madh i partisë së tij ishte qëndrimi që mbajti disa vjet me radhë kundër Partisë Komuniste të Kinës, prandaj «heq kapelën» përpara Çausheikut, që e bëri ta kuptojë Kinën dhe të vijë në kontakt me të.** Karriljoja kishte thënë se sovjetikët ishin shumë të zëmëruar me spanjollët për këtë që bënë, po ashtu edhe Partia Komuniste (revizioniste) e Francës nuk e priti mirë vizitën e revizionistëve spanjollë në Kinë. Ai tha se Dolores Ibarrurin, që është në Moskë, nuk e priti jo vetëm askush nga udhëheqësit kryesorë sovjetikë, por as

dro të rangut të ulët.

Kinezët i kishin thënë Karriljos se «duhen lënë mënjatë divergjencat dhe të gjenden pikat mbi të cilat të dyja palët do të bien dakord». Ata i kishin thënë gjithashtu se në këtë mënyrë dëshirojnë të veprojnë edhe me partitë e tjera (revizioniste, kuptohet). Karriljoja kishte pasur përshtypjen se kinezët dëshirojnë të veprojnë në këtë mënyrë edhe me sovjetikët.

Ky burim informativ i besuar na thotë, gjithashtu, se, kur ishte Çausheku në Pekin, u kishte propozuar udhëheqësve kinezë që Kina të kthehet prapë në organizatat ndërkombëtare të sindikatave, të rinisë dhe të grave. Ndryshe nga ç'na kishin thënë neve më parë vetë kinezët, tani del se udhëheqësit kinezë i ishin përgjigjur Çausheikut pozitivisht, **domethënë se edhe ata mendojnë të kthehen prapë, por duhet lënë të kalojë njëfarë kohe, sepse, po të ktheheshin tani, kjo nuk do të shkaktonte gjë tjetër veçse acarimin e polemikës.** Pra, «të gjendet një kohë më e përshtatshme».

Ky burim na thotë po ashtu se, gjatë vizitës që bëri në Rumani vitin e kaluar një delegacion i Partisë Komuniste të Francës, Çausheku kishte vënë në dijeni Zhak Dyklonë për këto mendime të udhëheqësve kinezë, të cilat i kishin bërë përshtypje. Kjo do të jetë arsyeja, sipas burimit, që Partia Komuniste e Francës, megjithëse mban qëndrim kundër Kinës, nuk zhvillon ndonjë fushatë të ashpër kundër saj.

Nga ana tjetër e barrikadës, revizionistët sovjetikë dhe satelitët e tyre të vendeve të ish-demokracive popullore (me gradacione të ndryshme) kanë shpërthyer një fushatë të madhe propagandistike kundër Kinës dhe kundër vijës së saj politike e ideologjike. Revizionistët mo-

dernë dhe bashkëpunëtorët e hapët me amerikanët e akuzojnë Kinën, me këtë fushatë të orkestruar nga dirijentët e Kremlinit, për degjenerim revizionist dhe për përputhje e afrim me imperialistët amerikanë. Kjo propagandë demaskimi për Kinën nuk ka vetëm karakter rutine, por po i jepet kësaj një karakter preokupant serioz, saqë udhëheqja sovjetike, bullgare, çeke (që dimë ne) kanë nxjerrë letra dhe rezoluta për partitë e tyre dhe për masat e gjera dhe vetë udhëheqësit kryesorë shkojnë në bazë e i punojnë ato. Çështja e Kinës i preokupon, prandaj e sulmojnë atë dhe mundohen të sabotojnë bashkëpunimin kino-amerikan, që po fillon të marrë hov me vajtjen këtë muaj të Niksonit në Pekin.

Nga këto të dhëna ne duhet të nxjerrim disa konkluzione:

Të gjitha këto vërtetojnë dhe përforcojnë parashikimet tona për çështjen në fjalë. Kina javash-javash po e braktis vijën e saj revolucionare si në strategji edhe në taktikë dhe ka hyrë në një rrugë me një vijë oportuniste liberalo-revizioniste. Tash, me këtë vijë, ajo po sulmon në drejtim të zbutjes e të marrëveshjeve me imperializmin amerikan dhe me vendet e tjera kapitaliste. Në këtë drejtim Kina po del si një konkurrence e rrezikshme e sovjetikëve «në përfitimet dhe në të mirat materiale të politikës së balancimit që u sjell «miqësia amerikane»». Të dy, si sovjetikët edhe kinezët, me fjalë bëjnë dhe do të bëjnë bera e rrufera kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por miqësia me to është një «pikë lakmie». Dhe këtu ka e do të ketë konflikte në mes të këtyre dy palë revizionistëve, në interes të imperializmit amerikan. Që të dy këta lloj revizionizmash do të vazhdojnë braktisjen e marksizëm-leninizmit me maskat e shpëlara që po përpiqen t'i ruajnë. Kjo është njëra anë.

Revizionizmi sovjetik do të përpiqet të ruajë hegjemoninë në kampin revizionist, kurse revizionizmi kinez

do të luftojë t'ia rrëmbejë këtë hegjemoni, ose të paktën t'ia përgjysmojë. Njëri mbrohet, tjetri sulmon në këto fusha, natyrisht, me të njëjtat armë, revizioniste, anti-marksiste. Siç deklaroi Kina zyrtarisht në OKB, ajo bën pjesë në «botën e tretë». Edhe në çështjen e partive revizioniste, Partia Komuniste e Kinës po ndërron strategji e taktikë, për të grumbulluar ato parti revizioniste që kanë kontradikta me sovjetikët, siç do të përpiqet të bëjë me vete «botën e tretë».

Vija e kinezëve, e ujditur dhe e akorduar me Çau-sheskun e me Karriljon, i vërteton edhe një herë pikëpamjet dhe parashikimet tona. Kina ecën me të shpejtë dhe gradualisht drejt rrugës së një fuqie të madhe revizioniste, drejt transformimit të vijës së saj në një vijë revizioniste. Aktualisht ajo është në luftë të acaruar më shumë me sovjetikët, që kërcënohen prej saj në hegjemoninë ideologjike revizioniste e si fuqi e madhe social-imperialiste, dhe në buzëqeshje e lidhje miqësore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për kundërbalancim dhe konsolidim, si fuqi e madhe kapitaliste.

Ky është orientimi i strategjisë dhe i taktikës së re, që vendosën rishtazi kinezët dhe që Çu En Lai na i parashitroi gojarisht, kur na komunikoi vajtjen e Niksonit në Pekin. Kjo është esenca, të tjerat janë *fioritura*¹ e koncerto. Si do të zhvillohen kjo strategji dhe kjo taktikë, kjo varet nga shumë rrethana, të cilat nuk mund t'i parashikojmë dot, por në befasi asgjë nuk duhet të na kapë, në gjumë nuk mund të na zënë evenimentet. Beso dhe kontrollo. Vigjilenca duhet kurdoherë të jetë e mprehtë. Interesat e Partisë, të popullit dhe të socializmit nuk duhet të lejojmë të preken, por t'i mbrojmë në rrugën marksiste-leniniste, pa shkarë kurrë nga marksizëm-leninizmi.

1 Italisht — zbulurime, lajlelule.

AMERIKANËT JANË TË KËNAQUR NGA MAO-ÇUJA

Sonte kino-amerikanët lëshuan një komunikatë të përbashkët. Niksoni, siç po del edhe nga sa kemi lexuar në shtyp dhe kemi parë në televizor, është pritur mirë e me dashamirësi nga kinezët, veçanërisht nga Maoja dhe Çu En Lai. Komunikatës sapo i hodha një sy, se isha shumë i lodhur. Natyrisht, atë do ta studiojmë me vëmendjen më të madhe, por, që në vështrimin e parë, duket se prej saj rrjedh mjaltë për imperializmin amerikan. Amerikanët janë të kënaqur nga Mao-Çuja.

SHËNIM

Bisedova me shokët për komunikatën që lëshuan kino-amerikanët rreth vizitës së Niksonit në Pekin dhe qëndrimin që duhet të mbajmë ne në shtyp.

KINEZËT KANË DEVIJUAR ASHTU SI HRUSHOVI

Studiova me kujdes dhe mbajta shënime mbi komunikatën kino-amerikane. Kinezët kanë devijuar me të vërtetë, ashtu siç bëri Hrushovi në kohën e tij. Revizionizmi kinez do të marrë edhe ky zhvillimin e tij, me zigzaget dhe me nuancat e veta, po kurdoherë është revizionizëm, antimarksizëm dhe në bashkëpunim me imperializmin amerikan.

KINEZËT NUK NA KANË DHËNË ASNJË INFORMATË ZYRTARE PËR VIZITËN E NIKSONIT

Komunikata kino-amerikane është nga më të habitshmet. Me të vërtetë Mao Ce Duni, me anën e saj, do t'i tregojë botës se ai po hap «një epokë të re» në historinë e njerëzimit, se po zbaton «një strategji të re» me imperializmin amerikan, siç iu shpreh Çu En Lai ambasadorit tonë në Pekin, kur i njoftoi vendimin që Niksoni do të shkonte në Pekin.

Komunikata, fjalimet dhe pritjet tregojnë se Niksoni u prit në Kinë si mik dhe jo si armik që është. Pavarësisht se u prit, ata mund të mos nxirrnin një komunikatë të tillë të turpshme e diskredituese për socializmin dhe për Kinën, e cila trumbeton se «është një vend socialist që ruan e mbron parimet marksiste-leniniste».

Kinezët mund të kishin pranuar një komunikatë shumë të thjeshtë dhe shumë të ftohtë, ku vetëm sa të përmendnin që morën kontakt, se kishin divergjenca të mëdha, se vendosën kështu ose ashtu për Tajvanin, të vinin në të ato që vendosën ose që nuk vendosën, dhe se mund të bëjnë dhe njëfarë tregtie në mes të dy vendeve.

Çështja tjetër që të bie në sy në komunikatën kino-amerikane, përveç të tjerave, është interesimi i vetëm i Kinës për veten e saj dhe për shtetet rreth e rrotull saj, veçanërisht për ato të Indokinës dhe të Koresë. **Kina tregohet «kundër zonave të influencës», por në komunikatën**

në fjalë, bashkë me amerikanët, përcakton zonat e influencës së saj, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Japonisë, domethënë Azinë dhe Paqësorin.

Kina, një vend «i madh socialist», në mënyrë të çuditshme, dhe jo në bazë të dialektikës marksiste e të materializmit historik, nuk flet fare në komunikatë as për popujt e Evropës, as për ata të Afrikës e të Amerikës Latine dhe as për ata të Lindjes së Mesme!!

Kina, që flet shumë për shfrytëzimin e kontradiktave në gjirin e armiqve tanë, gati i ka harruar këto, ose i ka grumbulluar vetëm në «kontradikta sovjetiko-amerikane», dhe, duke u afruar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mendon se i thelloi këto dhe e kreu gjithë këtë punë. Të mos flasësh për popujt e kontinenteve të tjera që luftojnë, siç veproi Kina në këtë rast, është një gabim kolosal i pariparueshëm, që asaj do t'i kushtojë shtrenjtë. **Për Kinën, siç duket, nuk kanë ekzistuar dhe nuk ekzistojnë popujt e tjerë dhe lufta e tyre. Është e qartë se gjithë këta të tjerët, për të cilët nuk flitet, janë «zonë e influencës së amerikanëve dhe e sovjetikëve». S'ka si kuptohet ndryshe.**

Kina si vend «i madh socialist» në këto momente të një krize të rëndë e të përgjithshme si për imperializmin amerikan edhe për socialimperializmin sovjetik, duhej të luftonte e të manovronte për ta thelluar këtë krizë (për të dobësuar dy superfuqitë, për të mbështetur fuqimisht luftërat nacionalçlirimtare të popujve e lëvizjen revolucionare, për të mos lejuar që të polarizoheshin fuqitë reaksionare në botë, dhe për këtë duhej të inkurajonte në disidencë ato shtete borgjeze kapitaliste që kanë treguar rezistencë dhe kanë kontradikta me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik). **Por në vend që të bënte këtë, ajo u afrua me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe lejoi polarizimin e reaksionit, e ndihmoi atë në këtë krizë, diskurajoi disidentët e Shteteve të**

Bashkuara të Amerikës dhe dobësoi revolucionin. E tërë kjo politikë marksiste-leniniste false bëhet nga ana e kinezëve gjoja në interes të «fitores së revolucionit». Kinezët duan t'u thonë amerikanëve se «ne nuk jemi superfuqi», kurse neve duan të na thonë «t'i gënjejnë armiqtë, të fitojmë kohë, t'u japim përshtypjen se s'jemi për revolucion». As ne, as amerikanët, as kurrkush nuk i ha këto kinezërrira.

Në Evropë, që kinezët nuk e zënë fare në gojë, bën pjesë edhe Shqipëria socialiste. Deri më sot, 4 mars, asnjë informatë zyrtare nuk na ka dhënë qeveria kineze për vizitën e Niksonit dhe për bisedimet që u bënë me të. Heshtje varri! Kurse Niksoni, me të fluturuar nga Shanghai, lëshoi ndihmëssekretarët e shtetit që kishte me vete, drejt vendeve mike e aleate të tij, për t'u shpjeguar më gjerësisht mbi bisedimet dhe rezultatet që pati në Pekin. Maoja dhe Çuja, s'kanë miq, ata nuk i vënë në korent miqtë, se nuk i konsiderojnë miq. Kinezët mund të vënë në dijeni, nga halli, dhe jo për çdo gjë, koreanët dhe vietnamezët, kurse shqiptarët për ta do të jenë vrima e fundit e kavallit. Një gjë të tillë kinezët nuk e thonë, por e dëshmon puna e tyre, ata e thonë tërthorazi dhe komunikata e lë të kuptohet. **Por s'ka gjë, ne jemi në rrugë të drejtë, ne jemi të durueshëm dhe kemi bindjen se nuk do të humbasim, se jemi marksistë-leninistë.**

E DIEL

5 MARS 1972*

NE NXJERRIM KONKLUZIONE NË BAZË TË FAKTEVE

Ambasadori ynë në Pekin, Xhorxhi Robo, na lajmëron se më 4 mars zëvendëshefi i Shtatmadhorisë, Ten Hsiao, priti në takim in e njohjes zëvendësatasheun tonë ushtarak në Pekin, të cilit i foli, në mes të tjerash, për vizitën e Niksonit në Kinë. Ten Hsiao tha: «Niksoni erdhi, por nuk u prit as me popull, as me lule. Po të dilte populli, do ta priste keq. Ne kemi pasur kundërshtime dhe kontradikta të mëdha me Niksonin. Pikëpamjet tona janë shprehur në komunikatë, në të cilën ka edhe disa gjëra të përbashkëta. Ne nuk kemi lëshuar asgjë nga principet tona. Gjatë bisedimit, kryetari Mao i dha Niksonit goditje të rënda. Ne u kërkuam amerikanëve që të tërheqin menjëherë forcat nga Indokina. Për Tajvanin u thamë se është territor i Republikës Popullore të Kinës». Pastaj Xhorxhi Robo shton se shoku kinez, Ten, foli «kundër imperializmit dhe revizionizmit», vuri në dukje «miqësinë që ekziston midis dy vendeve tona», tha se tani «do ta godasim më shumë imperializmin amerikan» dhe se «do të lidhemi më ngushtë me popujt shqiptar, korean, vietnamez dhe ata të Indokinës».

Këto tha kinezi, zëvendëshefi i Shtatmadhorisë së Përgjithshme të Kinës. Informacion i bukur! Ose ky kuadër kinez nuk ka haber hiç se çfarë po ngjet në Kinë dhe në botë, në lidhje me vajtjen e Niksonit në vendin e tij,

ose e kanë porositur: «Shqiptarëve thuaju këto që po të them ty». Dhe ky kuadër mendon se, duke i pasur mjaft këto dijeni për veten e tij, «u mjaftojnë ato edhe shqiptarëve».

Mirëpo për shqiptarët nuk janë aspak të mjaftueshme fjalët që thotë Ten Hsiao se «Maoja i dha goditje të rënda Niksonit». Ne nuk i shohim gjëkund këto «goditje të rënda». Në goftë se kinezët quajnë «goditje të rënda» pse i thanë Niksonit: «Duhet të tërhiqeni nga Indokina dhe se Tajvani është pjesë e RPK», atëherë ata e kanë stomakun të madh. Goditje të rënda nuk ka as në thëniet e zëvendëshefit të Shtatmadhorisë dhe as në komunikatë.

Por një gjë tha, sigurisht padashur, zëvendëshefi i Shtatmadhorisë, se «populli nuk doli ta priste Niksonin, pse, po të dilte, ai do ta priste keq». Kjo do të thotë se populli kinez nuk është dakord me vajtjen e Niksonit në Kinë, domethënë nuk e pëlqen këtë vendim të Mao-Çusë. Zëvendëshefi i Shtatmadhorisë tha, gjithashtu, se këtë e tutje do të shtohet lufta e Kinës kundër imperializmit amerikan.

Pse? Asgjë nuk tregon se lufta do të shtohet. Po ndodh e kundërta e asaj që na thonë. Takimi Nikson-Mao-Çu solli zbutje të luftës dhe jo acarimin e saj. Siç duket, kinezi na merr përleshko. «Mendoni kështu si ju them unë dhe mos nxirrni konkluzione nga ato që bëj unë. S'ka nevojë të punojë koka juaj, derisa punon koka Mao-Çu», don të thotë ai. Mundet që kjo të jetë e vërtetë për kinezët, por jo për shqiptot. Shqipton e mëson Partia e tij dhe marksizëm-leninizmi të gjykojë, të arsyetojë, të nxjerrë konkluzione në bazë të fakteve.

Por shokët kinezë do të mjaftohen vallë vetëm me këtë informacion, apo do të na bëjnë ndonjë informacion tjetër? Do të jetë ky «informacioni zyrtar», apo do ta bëjnë këtë nëpërmjet ambasadorit të tyre? Të shohim!

PROVOKATORËT MARRIN PËRGJIGJEN E DUHUR

Më lajmërojnë se dy specialistë kinezë, njëri në Hidrocentralin e Fierzës, një tjetër në naftë kanë pyetur shokët tanë se ç'mendonin për udhëtimin e Niksonit në Pekin dhe kanë tentuar «t'u imponohen me autoritetin e Maos». Tanët u janë përgjigjur se «ne ndjekim vijën e Partisë sonë dhe të Enver Hoxhës».

MIQ TË MIRË TË VENDIT TONË

Dje pasdreke më erdhi për vizitë shoku Hysni. Më foli për bisedën e lamtumirës që kishte pasur me shokun neozelandez Ronald Tejlor dhe me suedezin Nils Anderson e të shoqen e tij René Anderson. Këta kthehen në vendet e tyre pas disa vjet pune të frytshme te ne. Ata janë shokë të mirë, punëtorë, ndihmuan në përkthime dhe në radiotransmetime në gjuhët e huaja. Ata u larguan të mallëngjyer, më tha Hysni.

E MARTË
14 MARS 1972*

PO NDIQET RRUGA E BOJKOTIMIT TË HESHTUR TË SHQIPËRISË

Ka dy javë që Niksoni është larguar nga Kina. Ka kaluar aq kohë, saqë edhe shtypi botëror tash flet rrallë për këtë «eveniment të madh historik botëror», se i konsumoi sensacionet, supozimet dhe tash pret dhe jep rezultatet e drejtpërdrejta ose të tërthorta që mund të rrjedhin nga këto bisedime. Kështu, shtypi botëror këto ditë vuri në dukje se Parisi u caktua nga Kina dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës si qendra ku do të bëhen takime të rregullta në mes ambasadorit të Niksonit dhe ambasadorit kinez. Varshava nuk është më vendi kryesor i takimeve kino-amerikane. Tash u bë Parisi si vend takimi, kurse ambasadorët e palëve që do të takohen atje, nuk janë as ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as ai i Kinës të akredituar në Francë, siç ndodhte kur këto takime zhvilloheshin në Poloni, por janë të dërguar të veçantë, specialë.

Pra «u vendosën kontakte të rregullta qeveritare në rang ambasadorësh, në mes Kinës dhe SHBA-së», me qendër as në Pekin, as në Uashington, por në Paris. U kapërcye edhe kjo pengesë, u ruajt miqësia Amerikë-Tajvan dhe dinjiteti i Çan Kai Shisë. Këta dy ambasadorë, siç njoftoi shtypi i huaj, pardje bënë takimin e parë «të përzier» prej 55 minutash në ambasadën kineze në Paris. Kjo është e natyrshme, këtej e tutje asgjë s'duhet të na habitë.

Kurse qëndrimi i Kinës ndaj nesh aktualisht është i ftohtë. Asnjë kontakt nuk mbahet me ne, as me ambasadorin tonë në Pekin, as nga ambasadori kinez në Tiranë. Për asgjë, për sa u përket bisedimeve me Niksonin, nuk morën mundimin deri tash të na jepnin një informacion, qoftë të paktën një parafrazim të thjeshtë dhe banal të komunikatës kino-amerikane. Sigurisht një qëndrim të tillë ata nuk e kanë mbajtur as ndaj vietnamezëve, koreanëve, kamboxhianëve dhe as ndaj rumunëve. Me siguri vetë Çu En Lai i ka informuar të tërë këta.

Mund të thuhet, pse duhet të na informojnë, kur ne kemi qenë kundër vajtjes së Niksonit në Pekin? Po, ne kemi qenë kundër, por si miq e shokë ua thamë haptazi mendimet tona. Atëherë ata janë të detyruar, në qoftë se na konsiderojnë miq e shokë, të na informojnë dhe të kenë guximin të na thonë që «gabuat ju» ose «gabua me», ose «nuk gabua me ne, as ju», dhe vetëm për titull informimi: «Nxirrni konkluzione vetë ju, shokë shqiptarë». «Ne ju informojmë, se ju kemi shokë, pavarësisht se për këtë çështje s'jemi dakord». Kjo do të ishte rruga më e drejtë. Këtë rrugë të hapët dhe shoqërore ndoqëm ne. Deri tash kinezët po ndjekin rrugën e heshtjes dhe të bojkotimit të heshtur të Shqipërisë.

Ndërkaq kinezët përpiqen të tregojnë se janë korrekte në marrëdhëniet ekonomike me ne, se interesohen e bëjnë çmos të jenë në rregull. Kur njerëzit tanë që merren me çështjet ekonomike takohen me zyrtarët përkatës kinezë, këta flasin mirë për Shqipërinë etj. Akulli që ka ngrirë lart, nuk është shtrirë deri poshtë. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kinës gjatë kësaj kohe njerëzit tanë priten ftohtë, u thuhet banalitetet nëpër korridore e në sallonet e aeroportit, kur venë e presin ndonjë personalitet. Kurse rumunët i pret vetë Çuja. Ambasadori kinez në Tiranë është mbyllur në «kullën e tij të fildishtë» dhe, kur shkruhet në gazetën «Zëri i popullit» artikulli

kundër Niksonit, ai dërgon agjentët e HSINHUA-së pranë njerëzve tanë për t'i pyetur «kush e ka shkruar këtë artikull, ku ndodhen këto referenca» dhe të tjera pyetje, që duken absurde, por që kanë një qëllim.

Natyrisht, do të shikojmë, por ky bojkotim politik revizionist i Kinës kundër nesh mund të hapet si njollë vaji. Reaksioni dhe revizionistët e tjerë e konstatojnë këtë qëndrim të Kinës dhe kanë filluar ta vënë në dukje. Ne, nga ana jonë, do të forcojmë vijën tonë, do të tregojmë sinqeritetin tonë të madh për miqësinë me popullin vëlla dhe aleat kinez. Por luftën nuk do ta pushojmë kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern. **Në qoftë se Kina puqet me imperializmin amerikan, atëherë kuptohet se kontradiktat dhe lufta me ne do të shtohen. Këtë mundësi ne nuk e urojmë dhe as e duam, por, po erdhi, ne do të luftojmë dhe do ta kapërcejmë, do të mbrojmë vijën tonë marksiste-leniniste dhe do të fitojmë.**

E ENJTE

16 MARS 1972

TË MOS JEMI NE SHKAKTARËT E FTOHJES SË MIQËSISË ME KINEZËT

Shokët e Ministrisë së Jashtme i udhëzova që si vetë ata këtu, ashtu dhe ambasadori ynë në Pekin dhe ambasadorët tanë në vendet e tjera, të mos bien në pozitat e ndonjë ambasadori kinez që mund të ketë tendenca ta ftohë miqësinë me ne, për arsye të marrëveshjeve kino-amerikane. Udhëtimin e Niksonit dhe qëndrimin tonë parimor të tërë e kanë të qartë dhe ky qëndrim nuk lëviz. Megjithëse kemi kontradikta në këtë çështje, që nuk është e vogël, ne jemi që të aktivizohen marrëdhëniet e tjera të shumanshme, për të cilat kemi interes, por që edhe kinezët mund të kenë interes t'i vazhdojnë. Ne të jemi kurdoherë parimorë dhe të hapët dhe të mos jemi shkaktarë të ftohjes së miqësisë, siç e dëshiron ndonjëri prej tyre.

U thashë shokëve që këndeje e tutje diplomacia jonë duhet të jetë shumë më aktive, pse marrëdhëniet e reja kino-amerikane e kanë ndryshuar dhe do ta ndryshojnë situatën e shteteve borgjeze e revizioniste në drejtim të politikës së vendit tonë. Këto, duke menduar se tash ne «mbetëm vetëm» do t'i shtojnë kërcitjet e dhëmbëve, shantazhet dhe provokacionet. Prandaj na duhet vigjilencë e madhe dhe të tregojmë pjekuri akoma më shumë për të përballuar çdo situatë të vështirë që mund të krijohet.

E SHTUNË
18 MARS 1972*

ASNJË ARTIKULL NË GAZETAT KINEZE PËR VIZITËN E NIKSONIT NË KINË

Vajtja e Niksonit në Kinë mund të shkaktojë ftohje në marrëdhëniet miqësore shqiptaro-kineze. Kjo është një çështje e madhe dhe e rëndësishme politike, që shikohet ndryshe nga ne dhe ndryshe nga kinezët. Këtë anë e kam trajtuar edhe herë të tjera, prandaj nuk është nevoja të zgjatem këtu. Kinezët e konsumuan këtë problem, të paktën fazën e parë të tij: e pritën Niksonin ashtu si e pritën (dhe për këtë kam shkruar herë tjetër), tash kanë filluar ose «rifilluar» (natyrisht me të tjera përmbajtje, për të tjera probleme, të një rëndësie të madhe, s'ka dyshim) bisedimet në mes ambasadorëve kinezë dhe amerikanë, por jo në Varshavë, në Paris. Përse po bisedojnë këta ambasadorë? Ky është një mister për të gjithë. Kur bisedohej në Varshavë, thuhej «për çështjen e Tajvanit»; tash ndonjë zyrtar kinez lëshon nga ndonjë fjalë si «**Të shohim a do ta mbajnë fjalën Shtetet e Bashkuara të Amerikës**». Natyrisht, se ç'fjalë duhet të mbajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këto i dinë kinezët, se ne dimë një gjë: që imperializmi amerikan, derisa të shkatërrohet, nuk do të mbajë asnjë fjalë, ai është dhe do të mbetet i pabesë, dinak, gënjeshtar, gjakatar, armik i socializmit dhe i popujve.

Po t'i pyesësh kinezët «çfarë fjale të mbajnë amerikanët», ata me siguri do të thonë se «ato që janë shkruar

në komunikatën kino-amerikane». Por imperializmi amerikan nuk ka thënë kurrë të kundërtën e atyre që tha edhe një herë në atë komunikatë, por ka vepruar kurdoherë në të kundërtën e atyre që ka thënë. Atëherë është më mirë të mos pyesësh dhe sigurisht s'na bie neve t'i pyesim kinezët për këtë çështje, por të presim ç'do të pjellin situatat dhe koha.

Pse nuk na bie neve të pyesim? Kinezëve ne ua thamë zyrtarisht, në rrugë partie dhe shumë shoqërore, mendimin tonë për vajtjen e Niksonit në Pekin. Ata nuk na dhanë asnjë përgjigje, megjithëse u theksonim mirë se, me gjithë dizakordin për këtë problem, ne jemi të bindur se Partia Komuniste e Kinës nuk do të bëjë asnjë lëshim në parime dhe miqësia jonë e madhe marksiste-leniniste do të vazhdojë.

U binte kinezëve të na vinin në korent, qoftë edhe shkurtimisht, për bisedimet me Niksonin. Ata nuk na vunë dhe mendojnë se për ne është i mjaftueshëm leximi i komunikatës publike. Kështu del. Mirë pra. Ne as nuk folëm, as nuk mbajtëm qëndrim zyrtar për vajtjen e Niksonit në Pekin, kurse gjithë bota foli. Ne njëkohësisht vazhduam rrugën tonë pa ndërprerje, luftë kundër imperializmit amerikan, kundër revizionizmit sovjetik, dhe mbrojtëm miqësinë e madhe e të sigurtë me Kinën.
Kush të donte le të nxirrte konkluzione nga vija jonë.

Niksoni u largua, komentet u ulën ca. Kinën e shohim tash të heshtë për këtë çështje, më shumë sesa heshtim ne. Asnjë koment, asnjë artikull në gazetatat kineze për këtë «eveniment historik». Vetëm herë pas here ndonjë gazetë e vogël kineze province, boton «ndonjë» lëvdatë të ndonjë Zhyrkeje, sikur vajtja e Niksonit në Kinë që një fitore për këtë të fundit dhe një disfatë për amerikanët.

Mundet që kinezët dëshirojnë që edhe ne t'i lavdërojmë! Ne nuk do ta bëjmë kurrë këtë. Po ç'do të bëjmë

ne? Do të vazhdojmë vijën tonë, miqësinë tonë, me gjithë këtë dizakord të madh parimor.

Mundet që shokët kinezë të mos e shohin me sy të mirë qëndrimin tonë të drejtë, dhe, të pakënaqur, por, pa e shprehur hapur, mbajnë me ne qëndrime të ftohta, «korrekte» në fillim, pastaj këto nga «korrekte» mund të kthehen në qëndrime «të bashkekzistencës paqësore» dhe vetëm më në fund «diplomatike». Ata mund të tregohen shumë korrektë me angazhimet ekonomike ndaj nesh, por për ne kjo nuk është as e mjaftueshme, as kryesorja. Kryesoret janë lidhjet marksiste-leniniste në mes partive tona, është miqësia jonë. Ata mund të mendojnë se «shqiptarët kanë nevojë për ne», prandaj çdo neglizhencë miqësie nga ana jonë mund të shikohet si ftohje, ftohja të sjellë akullin dhe akulli izolimin tonë nga Kina mike. Por mund të qëllojë që edhe ndonjë i ngurtë nga njerëzit tanë, që s'e kupton si duhet vijën e Partisë sonë, të thotë: «Ne shqiptarët kemi të drejtë ideologjike për këtë problem, Kina na e ka nevojën». Kjo nuk është në vijën tonë.

Prandaj udhëzova shokët e Ministrisë së Jashtme të tjerë që në parimet të mos lëshojnë, por të tregohen të afërt, të dashur e të sinqertë në kontaktet me shokët kinezë. **Oportunistë të mos jenë; kur është rasti, të shfaqin mendimin për një problem vije, të mbrojnë vijën dhe në këtë vijë është edhe miqësia shqiptaro-kineze...**

E MARTE
21 MARS 1972*

UDHËTIMI I NIKSONIT NË KINË, BISEDIMET KINO-AMERIKANE, KOMUNIKATA PËRFUNDIMTARE

Qëndrimi i jashtëm i palës kineze për këtë udhëtim, si para, ashtu edhe gjatë realizimit të tij, ka qenë i ndryshëm. Pala kineze vetëm një ose dy herë vuri në dukje se udhëtimi i presidentit amerikan do të bëhet në filan datë dhe asgjë tjetër. Propaganda kineze mbante «heshtje absolute» për këtë ngjarje, sikur «nuk i interesonte shumë». **Kjo natyrisht nuk përfaqësonte realitetin, nuk përfaqësonte rëndësinë, bile të madhe, që u vinin kinezët këtij udhëtimi dhe rezultateve që do të dilnin prej tij.** Në sipërfaqe dukej sikur kinezët nuk po merrnin masa përgatitore, por kjo nuk ishte e vërtetë: ata pastrojnë qytetet, lyenin dyqanet dhe shtëpitë, sidomos në ato rrugë e zona ku do të kalonte Niksoni, hiqnin të gjitha parullat «e rrezikshme» që mund të zemëronin mysafirin «e shquar», mbushën dyqanet me çdo lloj plaçkash, nxorën në libraritë libra «klasikë kinezë e të huaj», që deri dje ishin zhdukur nga qarkullimi etj. **Të gjitha këto bëheshin nën maskën «e Vitit të ri» kinez.** Por këtë s'e hante kush. **Këto nuk ishin për «vitin e miut», por për «ardhjen e tigrit... prej letre».**

Shtypi kinez e kishte pushuar propagandën kundër imperializmit amerikan, por, gjatë pritjes së Niksonit, ai ishte i detyruar të shkruante disa herë «për të mbrojtur» Vietnamin, i cili veçanërisht në këto momente po bom-

bardohej ashpër nga amerikanët. Pra, pikërisht në këtë kohë, kur kinezët pritnin Niksonin, vietnamezët aktivizuan goditjet, Niksoni aktivizoi bombardimet, kurse revizionistët sovjetikë na dolën si «miqtë e vetëm e të sinqertë të vietnamezëve», si «anti-amerikanë të tërbuar» dhe akuzonin Kinën se «bëri aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër Vietnamit». Kinezët gjatë kësaj kohe e mbyllën gojën kundër propagandës sovjetike dhe kuptohet lehtë pse u detyruan ta bënin këtë. Arsyeja është sepse ata u gjendën në pozita të dobëta ndaj Vietnamit dhe duan të mos tregohen sikur bisedimet me Niksonin do të zhvillohen kundër Bashkimit Sovjetik.

Kurse pala tjetër, imperializmi amerikan dhe gjithë bota kapitaliste, i bënë një reklamë shumë të madhe këtij udhëtimi, gërmuan tokën e qiellin dhe nuk lanë gjë pa thënë e pa supozuar. Me fjalë të tjera, ata u ranë aq shumë daulleve, saqë arritën, deri në njëfarë shkalle, të krijonin përshtypjen në botë se ky udhëtim «do të ndryshojë kursin e historisë», se Niksoni, antikomunisti i tërbuar, do të realizojë atë afrim me Kinën që asnjë president tjetër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk kishte mundur të realizonte. Niksonin borgjezia e futi në histori si «njeriun e paqes», dhe fakt është se, gjatë gjithë kësaj kohe, propaganda e saj u bë aq shurdhuese në këtë drejtim, sa u mbulua vepra e tij e tmerrshme prej kriminelit lufte që po vret popujt e Indokinës etj.

Kina ka përgjegjësi të madhe në çështjen e pranimit të Niksonit në Pekin, pa i vënë as më të voglin kusht. Por nuk është vetëm ajo përgjegjëse për këtë fitore propagandistike të Niksonit. Vetë vietnamezët, të cilët gjoja janë të zemëruar me kinezët për vajtjen e Niksonit në Pekin, kanë hyrë me kohë në bisedime të fshehta me xhelatët e popullit të tyre. Të mos flasim për revizionistët sovjetikë, të cilët janë të përllyer deri në grykë nëpërmjet lidhjeve e bashkëpunimit me amerikanët.

Ne, nga ana jonë, nuk e pushuam për asnjë çast luftën kundër imperializmit amerikan e kundër Niksonit dhe aq na bënte. Kjo u vu re edhe nga agjencitë e huaja të lajmeve, të cilat vinin në dukje se propaganda jonë ndryshonte nga ajo e kinezëve.

Pra, pavarësisht se Kina nuk foli derisa Niksoni vuri këmbën në territorin e saj, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës zbriti në Kinë me bujë të madhe, me një ekip të madh bashkëpunëtorësh, me një numër të madh gazetarësh dhe me të gjitha aparaturat e duhura të televizionit, radios, kinemasë, ndërlidhjes etj. Për këtë foli tërë bota. Një gazetar amerikan e cilësoi zbritjen e Niksonit në Kinë si «një zbritje në hënë».

Pritja e Niksonit në aerodrom nga ana e kinezëve u bë pa popull, pa fjalime, pa praninë e trupit diplomatik. Ndryshe do të ishte skandal i hapët dhe një sfidë në çdo situatë. Atë e priti grupi i zakonshëm dhe i përhershëm i përbërë nga Çu En Lai, Li Hsien Nieni, përfaqësuesi i ushtrisë në KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe nga gjithë vargu i zyrtarëve. Çu En Lai dukej si «i ngrirë», natyrisht, sepse e dinte që po e shikonte gjithë bota, kurse Niksoni i hapte dhëmbët si të kalit, ishte i gëzuar, i qeshur, pavarësisht se rrugët nga kalonin ishin boshatisur, sigurisht me urdhër e me direktivë. Mirëpo këtë situatë e kishin merak «ta ngrohnin propaganda dhe televizioni amerikan».

«Korrektesa e ftohtë e jashtme kineze» që u duk në aerodrom dhe në rrugët nëpër të cilat kaloi kortezhi, nuk ishte veçse një *trompe-l'œil*¹. Në vend që të vazhdohej kështu me një «mysafir të padëshiruar», që u pranua të vinte «për të shkëmbyer mendime për problemet që interesonin të dy vendet» pa i vënë asnjë kusht, me një

1 Frëngjisht — një paraqitje e jashtme gënjeshtre.

mysafir që deri dje ishte cilësuar nga vetë kinezët «kriminel fashist më i poshtër», «vrasës» etj., etj., protokollet dhe qëndrimet ndaj Niksonit bënë një kthesë prej 180 gradësh.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk ishte çlodhur akoma nga udhëtimi, kur u prit nga Mao Ce Duni, dhe në zyrën e tij të punës. Kjo, me sa dimë ne, nuk kishte ngjarë kurrë. Miqtë dhe mysafirët e tjerë, qofshin edhe ata më të ngushtit e Kinës, Mao Ce Duni i pret dhe i ka pritur kurdoherë në fund të vizitës së tyre. Edhe delegacionet tona ai i ka pritur kurdoherë në fund. Gazetarët amerikanë nuk e dinin se Maoja do ta priste Niksonin, pa arritur mirë, as delegacioni i tyre, siç duket, nuk e dinte këtë gjë, prandaj e cilësuan si «bombë». Dhe, në fakt, kjo pritje ishte një bombë. Maoja me këtë donte t'i tregonte Niksonit ngrohtësinë dhe dashamirësinë e tij të veçantë për këto kontakte dhe bisedime, donte t'i tregonte intimitet, pse e priti në studio, dhe, mbi tryezën ku kishte mbështetur bërrylat presidenti, dukej një vandak me libra, për t'i thënë Niksonit se ke të bësh me një «mendimtar të madh». Mao Ce Duni donte, gjithashtu, t'i tregonte Niksonit se është ai, Maoja, që hapi këtë «epokë të re në botë», e cila është «çështja e relatave kino-amerikane», dhe, nga ana tjetër, t'i thoshte popullit kinez që kjo «politikë miqësore» me imperializmin amerikan «është politika ime dhe jo e Çu En Lait». Në qoftë se nuk del mirë kjo politikë, «kemi eksperiencë dhe ia hedhim fajin Çusë».

Komunikata e lëshuar pas takimit Mao-Nikson nuk thoshte gjë tjetër veçse «bisedimet ishin të sigjerta dhe të hapëta», pra as mish, as peshk, kurse televizioni kinez fliste një gjuhë tjetër. Në ekranin e vogël dukeshin Maoja dhe Niksoni të gëzuar dhe të qeshur, që shtrëngoheshin jo me një, por me të dy duart. Kisingeri ishte shtrirë i qeshur dhe i gëzuar në kolltuk, si në shtëpinë e

tij. Çu En Lai ishte *aux anges*¹, qeshte, kakarisej aq fort, sa që vinte edhe dorën në gojë se e tepronte. Pra atmosfera ishte më shumë se miqësore dhe këtë atmosferë e kishte marrë vetëm televizioni kinez, domethënë ishte gjë e kontrolluar, pasi ishte lëshuar në ekranin e vogël, dhe kjo ishte bërë jo pa qëllim nga Çuja, por që ta fiksonte historia «këtë moment historik», ta shihnin amerikanët dhe të orientoheshin edhe populli kinez nga kjo «strategji dhe taktikë gjeniale proletare» e Mao Ce Dunit.

Pas këtij akti «plot kuptim» të Maos, atmosfera, që gjoja në dukje ishte e rezervuar, u çel, u thye akulli, filluan «të lulëzojnë 100 lulet» dhe «të ecet në marshimin e gjatë».

Banketi i kinezëve ishte madhështor. Çfarë tha Çu En Lai në këtë banket? Të gjitha të mirat, sikur kishte përpara jo një mik të ri, por të vjetër, pse «populli kinez dhe populli amerikan janë miq» etj. Pra Çuja tha: Ne duhet të kërkojmë normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve dhe të shkëmbejmë mendime mbi çështje që u interesojnë të dyja palëve. Më në fund, — tha Çuja, — u hapën dyert e kontakteve miqësore.

Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, se Niksoni është një mik i Kinës dhe i popujve, sepse është ai që i hapi këto porta të miqësisë. Për Çunë dhe për ata që mendojnë si ai, Niksoni pushoi së qeni një imperialist, një fashist, një xhelat i popujve. Kësaj i thonë të kalosh në rrugën e lakenjve të imperializmit.

Mosmarrëveshje kemi, — thotë Çuja në fjalim, — po këto nuk duhet të bëhen pengesë që të merremi vesh dhe të rrojmë në bashkekzistencë etj. Mosmarrëveshje të vogla ekzistojnë!!!

Kështu ka folur dikur edhe Hrushovi, por ai nuk

¹ Frëngjisht — ishte në kulmin e kënaqësisë, të lumturisë, po kapte qiellin me dorë.

ishte kaq «xhentil» me mysafirët amerikanë, siç po tregohet Çuja, i cili bën kujdesin më të madh se mos lëshojë ndonjë fjalë jo pa vend që po e po, por që të mos interpretohet as për keq.

Për Çunë, i cili përpiqet të mbulojë qëllimet e tij, populli amerikan është «aq i mirë» sa nuk bëhet, «populli amerikan është mik i popullit kinez», e kështu vazhdon kënga e Çusë, derisa edhe orkestra e banketit luante këngën «Moj e bukura Amerikë!»! Moj e bukura Amerikë e milionerëve dhe e miliarderëve! Moj Amerikë, qendër e fashizmit dhe e imperializmit barbar! Moj Amerikë, vrasësja e vietnamezëve dhe e arabëve, shtypësja e lirisë së popujve! Moj Amerikë «e bukur» e gangsterëve! Moj Amerikë «e bukur», ku shtypen dhe vriten zezakët, të papunët, komunistët!!!

Dhe kësaj Amerike i këndohet në Pekin, saqë Niksoni, në përgjigjen që i bëri Çu En Lait në banket, tha: «Kurrë nuk kam dëgjuar që muzika amerikane të luhet më mirë se kaq në një vend të huaj». Është e qartë, edhe Niksoni habitet dhe bile, në njëfarë mënyre, do të thotë se «paskam qenë i gabuar, ju kujtoja se ishit me të vërtetë komunistë».

Edhe Niksoni në fjalimin e tij mburr Kinën dhe mikpritjen e madhe, mburr fjalën dashamirëse dhe elokuente të Çusë. Ai thotë pa një, pa dy se «ajo që bëjmë ne këtu, mund të ndryshojë botën»; «...shanset e paqes shtohen pa mbarim»; «ajo që na bashkon është se ne kemi interesa të përbashkët, të cilët i kapërcejnë këto mosmarrëveshje».

Dhe Niksoni vazhdon:

«Le të fillojmë së bashku një marshim të gjatë jo në një rrugë pa krye, por në rrugë të ndryshme që shpjen në të njëjtin qëllim, në qëllimin e ndërtimit të një strukture botërore të paqes e të drejtësisë, në të cilën që të gjithë të mund të qëndrojmë së bashku me të njëjtin

dinjitet dhe çdo komb, i madh apo i vogël, të ketë të drejtë për të vendosur vetë formën e tij të qeverisjes, pa ndërhyrje apo dominim nga jashtë...».

Dhe më tej:

«Nuk ka asnjë arsye që ne të jemi armiq, sepse asnjëri prej nesh nuk kërkon territorin e tjetrit, asnjëri prej nesh nuk kërkon sundimin përmbi tjetrin ose të zgjatë duart dhe të sundojë botën. Ne së bashku mund të ndërtojmë një botë të re edhe më të mirë».

Po Çu En Lai si i përgjigjet këtij gjirizi fashist? Edhe ai i përgjigjet pikërisht kështu dhe thjesht: «...Bota shkon drejt përparimit, drejt dritës dhe jo drejt errësirës». Çu En Lai zhduku edhe shprehjen se bota shkon drejt revolucionit. Mirë thonë gazetat: «Çuja e la mënjanë revolucionin botëror». E tillë, e poshtër dhe skandaloze, është propaganda dhe demagogjia që bën Pekini për fashistin e tërbuar, gjakatarin e popujve të botës, kreun e imperializmit botëror, Niksonin! Dhe kush? Pekini, i cili pretendon të jetë qendra botërore e marksizëm-leninizmit!

Demagogjia e imperialistit është e atillë që edhe ai, përkrah Çu En Lait, thotë se «Bota shkon drejt dritës dhe jo drejt errësirës». E gjithë propaganda amerikane synon të vërë në dukje se Niksoni dhe imperializmi amerikan janë bërë miq të Kinës dhe të kinezëve, miq të popullit dhe të udhëheqjes. Akulli u ça pas takimit të Niksonit me Maon. Gazetat kineze u mbushën me fotografitë e Niksonit, të Maos, të Çusë, të Çian Çinit etj. Takimi protokollar që u bë në aerodrom, u kthye më vonë në takime të nxehta, në bankete, në teatro, në stadiume të mbyllura, ku 20 mijë veta ngrihen në këmbë duke duartrokatur Niksonin dhe Çu En Lain, «arkitektët» e këtij «takimi historik». Çian Çini, gruaja e Maos, ka ndërruar rrobat dhe *kuafyrë*¹. Leshrat i ka prerë krejt

¹ Frëngjisht — mënyrë e rregullimit të flokëve.

à la garson, kapelën me yll të kuq e ka hedhur në shportë dhe rrobat ushtarake të revolucionit i ka zëvendësuar me rroba kazmir, ose me cohë të zezë. Ajo, në çdo shfaqje, rri në krah të Niksonit, dhe, kur nuk janë tok, Niksoni dhe gruaja e tij plotësojnë programet e tyre, vizitojnë kuzhinat kineze, «habiten, janë të mahnitur» gjoja, «hanë me shkopinj», «ç'mrekulli!». Ata vizitojnë komuna, puthin kalamanë kinezë, vizitojnë edhe Murin e Madh Kinez. «Të prishim çfarëdo muri», thotë Niksoni. **Këto janë «7 ditë që ndryshuan botën».** «Ne, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina, mbajmë në duart tona fatet e botës». Dhe propaganda elektorale e Niksonit për t'u zgjedhur përsëri president i Shteteve të Bashkuara vazhdon nga territori kinez! Kurse Çu En Lai, nga ana e tij, është i kënaqur dhe i buzëqeshur. Reaksioni këtë e lavdëron, e ngre në qiell, por atij aq i bën, se gjoja, me këtë politikë që ndjek, «zbaton vijën e kryetarit Mao me shkathtësinë më të madhe».

Pra, gjatë ditëve të vizitës, çdo dëshirë e Niksonit, e Maos dhe e Çusë u plotësua. Asnjë kundërshtim nuk u duk midis dy palëve, veç disa formulave të zakonshme. Më në fund doli edhe komunikata e përbashkët kino-amerikane, e cila vërteton unitetin e tyre në shumë pikëpamje bazë. Le t'i shohim këto.

Vajtja e Niksonit në Pekin, pritja që iu bë atij dhe komunikata e përbashkët kino-amerikane përbën një fitore për imperializmin amerikan dhe personalisht për Niksonin. Ndërsa Kina nuk fitoi dhe nuk mund të fitonte gjë në këtë mes; përkundrazi, ajo humbi para opinionit të popujve revolucionarë të botës, humbi para lëvizjes komuniste ndërkombëtare. **Kina «financoi» imperializmin amerikan me besim në sytë e popujve.** Ajo u tha popujve dhe komunistëve se me imperializmin amerikan, edhe në momentet kur ky po vret dhe po pret, edhe kur ka pushtuar territoret e tyre, edhe kur nuk ka dhe nuk

do të lidhë marrëdhënie diplomatike me ta, edhe kur sistemi i tij është në krizë, prapë mund të bisedosh me të miqësisht, të rrish gju më gju me të dhe t'i njohësh atij të drejtën të gënjejë popujt. Ja, këtë bëri Kina. Kjo është e palejueshme dhe e dënueshme, kjo nuk është në vijën tonë marksiste-leniniste.

Komunikata kino-amerikane është dokumenti më i poshtër që mund të bëhej. Në këtë komunikatë parashtrohen krah për krah pikëpamjet «e bukura» të të dyja palëve, sa të njëjës edhe të tjetrës. Kinezët na «ngopin» me fraza të përgjithshme: «Popujt duan lirinë; ku ka shtypje, ka rezistencë; kombet, të mëdha e të vogla, duhet të jenë të barabarta; të gjitha trupat ushtarake duhet të largohen nga vendet e huaja» etj. Kështu, pala kineze vazhdon një tiradë mjaft të gjatë pa asnjë aluzion, pa adresë. Vetëm Japonia dhe Bangladeshi zihen në gojë prej tyre, kurse çdo gjë tjetër është zhdukur. E do xhentileca e famshme kineze(?!), meqë «mikun e ke në shtëpi»?! Pse e ftove? Por më mirë duhet thënë se këtë qëndrim ta dashka vija e re që po ndjek, e jo mirësjellja për «mikun» që ke ftuar.

Edhe pala amerikane, në komunikatën në fjalë, bën një tiradë akoma më të gjatë. Ajo nuk merr asgjë përsipër, përkundrazi, sipas atyre që thuhet në komunikatë, «Amerika e bukur» na qenka «vendi më paqësor dhe më demokrat», amerikanët janë kundër agresionit, janë që vendet e Indokinës të vetëvendosin(!). Shtetet e Bashkuara janë gati të bëjnë këtë e atë, çfarë të doni e çfarë të mendoni (faza të bukura plot), por, me fjalë të tjera, ata do të ruajnë miqësinë me Çan Kai Shinë, me klika të vendeve të Indokinës dhe me Republikën e Koresë së Jugut, thuhet se trupat do t'i heqin nga rajonet e ndryshme (me fjalë, natyrisht) «kur të ulët tensioni» etj., etj. Kështu vazhdon «kënga» amerikane në komunikatën e përbashkët.

Ku ishe? Asgjëkundi! Gati asnjë kundërshtim, megjithëse theksojnë se «ekzistojnë kontradikta të mëdha» ndërmjet tyre. As grima e polemikës nuk duket; përkundrazi, pasi bën këtë «tablo idilike», para publikut që priste, ata dolën me çka kishin në zemër. Dhe konkluzioni është ky: **bashkekzistenca paqësore tipike e Hrushovit, bile më e përsosur se e atij, sepse, sipas komunikatës kino-amerikane, çdo gjë do të zgjidhet, bile pa konflikte, me fjalë të tjera «pa armë, pa luftë», do të zgjidhet me trëndafila! Me të vërtetë tigrin qenkësh «tigrin prej letre». Por nuk po merret vesh se kush është tigrin prej letre.**

Ç'del nga kjo komunikatë? Kina i thotë botës se unë bisedova me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në mënyrë miqësore, se si rezultat i këtyre bisedimeve do të evitohet lufta ndërmjet ne të dyve, se rajoni Azi-Pacifik nuk do të lejohet të bëhet zonë influence e ndonjë fuqie të madhe (përralla), se asnjëra palë nuk duhet të hyjë në marrëveshje me një të tretë kundër palës tjetër (përralla), dhe se bota nuk duhet të ndahet në sfera influence (përsëri përralla).

Të gjitha këto përralla të shkruara në komunikatë, aprovohen nga kinezët, të cilët i thonë botës: «Ja, ne i detyruam amerikanët të pranojnë tërë këto gjëra. Kjo është një fitore e madhe për socializmin». Kinezët u thonë naivëve: «Shihni, amerikanët nuk janë edhe aq të këqij» dhe, megjithëse as për Tajvanin nuk përfunduar gjë, as marrëdhënie diplomatike nuk vendosëm, «ne me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të bëjmë tregti, do të shkëmbejmë dijetarë, artistë, gazetarë» etj. Me fjalë të tjera «i hapëm dyert për invadimin e Kinës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Është ca e çuditshme kjo, po kështu do të ngjasë në fakt.

Çu En Lai, kur u kthye në Pekin nga Shangai, ku kishte vajtur për të përcjellë Niksonin, u prit me triumf,

me gongë, me lule e me Çian Çinë. Çuja ishte «heroi i ditës!». Ky «hero i ditës» do të punojë me të gjitha forcat brenda vendit për të forcuar pozitën e grupit të tij, duke pasur edhe mbështetjen e Maos. Ai do t'i zhvillojë me tempo marrëdhëniet e shumanshme me amerikanët, do të mbështetë kandidaturën e Niksonit, pse tash këtë e ka mik dhe me të do të bëjë shumë kombinime, por edhe do të përpiqet që të mos demaskohet keqas në sytë e popujve. Hëpërhë «heroi i ditës» do t'i kundërshtojë sovjetikët deri në atë pikë sa do të ketë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por më në fund, edhe ai, do ta hedhë maskën, siç e hodhi Hrushovi. **Sa për revolucionin botëror, për komunizmin dhe për socializmin, ai këtyre do t'u vërë gurin e rëndë, siç bënë revisionistët në Bashkimin Sovjetik dhe gjatë. Kjo rrugë që kanë zënë, atje të çon. Qofshim ne të gabuar, por faktet nuk na lejojnë të gjykojmë ndryshe! Marksizëm-leninizmi që na frymëzon dhe na udhëheq, nuk na lejon t'i gjykojmë ndryshe shokët kinezë dhe veprimet e tyre.**

E MËRKURË
22 MARS 1972*

KINA DHE BASHKIMI SOVJETIK

Siç e kam shkruar disa herë të tjera, akoma pa vajtur Niksoni në Kinë, gjatë mbërritjes dhe qëndrimit të tij në Pekin, si dhe ditë me radhë pasi u largua, revizionistët sovjetikë bënë një propagandë shurdhuese antikineze, që e kapërcente në potencial atë të herëve të tjera. Ndaj kësaj propagande antikineze të sovjetikëve, kinezët hesh-tën, hala edhe tash vazhdojnë të heshtin.

Propaganda antikineze e sovjetikëve, me demaskimin e Kinës dhe të Maos në sytë e popujve dhe të komunizmit ndërkombëtar, synonte të tregonte se:

a) Maoistët ranë në ujdin me imperializmin amerikan për të ndarë sferat e influencës në botë dhe për të dominuar botën si dy fuqi imperialiste.

b) Ujdia kino-amerikane po bëhet në bazë të antisovjetizmit, të përçarjes dhe të dobësimit të kampit socialist dhe të komunizmit ndërkombëtar.

c) Ujdia kino-amerikane është kundër luftërave nacionalçlirimtare të popujve. Kina tradhtoi veçanërisht interesat dhe luftën e popullit vietnamez dhe të të gjithë popujve të Indokinës.

Këto ishin, në vija të përgjithshme, objektivat demagogjikë të revizionistëve sovjetikë kundër Kinës gjatë gjithë kësaj periudhe. Sovjetikët u ranë daulleve të mëdha. Me këtë donin të mbulonin tradhtitë e tyre dhe aleancat reale që kanë bërë me amerikanët kundër mark-

sizëm-leninizmit, kundër popujve, për të dalë kështu si mbrojtës të popujve të Vietnamit, si anti-amerikanë «të tërbuar» dhe «parimorë». Galeria nuk u gënjye, por nuk mund të themi se këto shpifje nuk bënë efekt fare. Do të jetë gabim të mendohet kështu.

Pasi u largua Niksoni, Kina nuk reagoi kundër sovjetikëve, të cilët e vazhduan punën e tyre, por me më pak intensitet, këtë herë me daulle të vogla, sepse Niksonit i vjen radha të vejë në Moskë, e cila duhet të bëjë që të harrohen ca zërat e daulleve të forta që ranë. Derisa «armiku», që është miku yt, ishte në shtëpinë e tjetrit, ti s'le gjë pa thënë kundër tij; mirëpo tash ky «armik», që është miku yt i vërtetë, të vjen në Moskë! Duhet ndërruar muzika.

Dhe kapedan Leonidha (Brezhnjevi) foli nga tribuna e kongresit të sindikatave sovjetike. Këtu na intereson çfarë tha kryerevizionisti në drejtim të kinezëve. Këtë herë ai kishte vënë «dorashka kadifeje», e kishte zbutur tonin. Në substancë ai tha: «Sovjetikët kanë qenë, kanë bërë thirrje e kanë punuar që Kina dhe Bashkimi Sovjetik të bashkëpunonin ngushtë si dy vende socialiste që ishin; por, për fajin e saj, Kina nuk ka dashur dhe i ka hedhur poshtë këto propozime. Bashkimit Sovjetik i vjen keq për këtë». Më poshtë kapedan Leonidha vazhdon në substancë: «Kinezët, me vajtjen e Niksonit, deklaruan se janë gati të bashkëpunojnë me këdo në bazë të politikës së bashkekzistencës paqësore. Atëherë fare mirë; meqenëse është kështu, meqenëse doni kështu, meqenëse me Shtetet e Bashkuara të Amerikës imperialiste bëtë kështu, ne, sovjetikët, ju propozojmë që të bashkëpunojmë në këto baza; fundi i fundit jemi gati që në këto baza të nënshkruajmë edhe një marrëveshje miqësie dhe mos-sulmimi» etj.

I mbetet tash Kinës t'i përgjigjet. Iliçovi, pas fjali-

mit të Brezhnjevitet, arriti përnjëherë në Pekin. Sigurisht, propozimet miku i ka në xhep.

Ç'do të bëjë Kina? Ajo do të notojë patjetër në këto ujëra, por do të shohim me çfarë lloji noti dhe me sa kilometra në orë!

E SHTUNË
25 MARS 1972

TË PENGOHET FUTJA E SËMUNDJES SË LISË NË VENDIN TONË

Në lidhje me shfaqjen e lisë në Jugosllavi u dha urdhër që të bllokohen kufijtë tanë për të gjithë ata që vijnë nga jashtë, që nuk janë të vaksinuar ose që nuk e vërtetojnë këtë me raport mjekësor. Të vaksinohet edhe popullata e vendit tonë dhe asnjë të mos lejohet të dalë jashtë pa qenë i vaksinuar. Këtu, te ne, nuk ka asnjë rast lije. Populli të mos alarmohet, por duhet të lajmërohet me një komunikatë të shkurtër nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

TË DENONCOJMË SYNIMET EKSPANSIONISTE SOVJETO-AMERIKANE NË BALLKAN

Sot shkrova disa ide e teza si dhe skemën e një artikulli kundër vajtjes së mareshalit Greçko në Jugosllavi. Le të denoncojmë synimet ekspansioniste sovjetike në Ballkan, grumbullimin e divizioneve të ndryshme në kufijtë hungaro-jugosllavë, politikën nxitëse antijugosllave të bullgarëve të shtyrë nga sovjetikët dhe të dënojmë vajtje-ardhjet e njësisve të flotave ushtarake sovjetike dhe amerikane në portet jugosllave.

LARG DUART NGA BALLKANI!

Pashë përsëri artikullin kundër vajtjes së mareshalit Greçko në Jugosllavi. Ia dërguam atë redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» që ta botojë nesër. I vumë titullin: «Larg duart nga Ballkani!»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 240.

E MARTE
4 PRILL 1972

OFENSIVË E MADHE NË TRI FRONTET E VIETNAMIT

Vietnamezët kanë filluar një ofensivë të madhe në tri fronte, nga veriu drejt Kuan Trisë dhe Huesë, nga kufiri i Laosit në perëndim dhe drejt Sajgonit. Ofensiva po zhvillohet me sukses të madh. Kukullat e Sajgonit detyrohen të lënë shumë pozicione të fortifikuara. Qeveria e Sajgonit dhe vetë presidenti Van Thieu, deklaroi se trupat e tij janë në rrezik dhe kërkoi ndihmën e amerikanëve. Këta, në pamundësi të angazhojnë trupa të mëdha të tyre, përdorin bombardime në shkallë të gjerë me aeroplanë B-52. Po hëpërhë koha është e keqe për ta. Propaganda e tyre vërtitet drejt asaj se ata që kanë zbarkuar në paralelin e 17-të janë divizione verivietnameze, domethënë gjoja kanë shkelur marrëveshjen e Gjenevës, kështu që Pentagoni ka filluar dhe do të vazhdojë bombardimet mbi Vietnamin e Veriut. Po luhen, gjithashtu, edhe manovra politike: një delegacion ushtarak sovjetik, me një ndihmëministër të Mbrojtjes në krye, është në Hanoi, shkon andej e këndej nëpër pritje dhe është bërë objekt i propagandës amerikane, e cila s'mungon të vërë në dukje se «armët, topat, tanket, raketat e verivietnamezëve që sulmojnë janë sovjetike».

Sovjetikëve, siç duket, u vjen mirë një propagandë e tillë në prag të vajtjes së Niksonit në Moskë, për të bërë presion mbi të në bisedimet për Vietnamin, për të

ulur prestigjin e Kinës që gjoja nuk e ndihmon Vietnamin etj.

Por kulmi i demagogjisë sovjetike kundër Kinës do të jetë ajo që kam thënë edhe një herë tjetër, që kundër bombardimeve të Niksonit t'i vënë veton e vajtjes së tij në Moskë, siç bëri Hrushovi me Ajzenhauerin me rastin e rrëzimit të aeroplanit spiun U-2.

ME KOREANËT KA VETËM RECIPROCITET

Më lajmëruan se ambasadori i Koresë na bën ftesë për të dërguar në Kore një delegacion të nivelit të lartë dhe një telegram urimi për 60-vjetorin e «udhëheqësit të madh», Kim Ir Senit, si dhe një delegacion ushtarak për të marrë pjesë në përvjetorin e ushtrisë së tyre.

U thashë shokëve se asnjë delegacion nuk do të dërgojmë. As telegram të mos dërgohet. Telegram urimi nga shokët e Ministrisë së Mbrojtjes për ushtrinë duhet t'u bëjmë po qe se na kanë bërë edhe ata, po për «40-vjetorin e luftës kundër Japonisë» nuk është nevoja.

PRITJE ZYRTARE NË PEKIN PËR DELEGACIONIN TONË TË BUJQËSISË

Delegacionit qeveritar të bujqësisë që shkoi në Kinë, iu bë një pritje zyrtare nga tri mijë veta në aeroportin e Pekinit me flamure, portrete, parulla, muzikë, lule e gongë.

Shokët kinezë, me këtë duan t'i tregojnë botës se miqësia kino-shqiptare është e pathyeshme dhe e madhe. Edhe ne për këtë arsye në krye të delegacionit dërguam ministrin e Bujqësisë. Edhe ne, edhe ata, shfrytëzuam rastin për të njëjtin qëllim.

MANOVRA POLITIKE RRETH VIZITËS SË NIKSONIT NË BASHKIMIN SOVJETIK

Agjencitë e huaja njoftojnë se Shtëpia e Bardhë ka pasë «parashikuar» shtyrjen e udhëtimit të Niksonit për në Moskë, për arsye të gjoja ndihmës që Bashkimi Sovjetik i jep Vietnamit në ofensivën që po zhvillon kundër Sajgonit. Por, shtojnë agjencitë, kjo u la më një anë dhe Niksoni po i del punës përpara, për të fituar pikë dhe për të penguar ndonjë «shaka» që mund t'i bënte Moska nga ana e saj.

AMBASADORI GREK VIZITON KRAHINAT TONA TË JUGUT

Shokët e Ministrisë së Jashtme më vunë në dijeni se ambasadori grek shkoi në Gjirokastrë, në Sarandë dhe në Vlorë (nëpërmjet bregdetit). Çdo gjë shkoi në rregull, siç e kishin parashikuar. Ai i bëri vizitë zyrtare kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Gjirokastrës, vizitoi muzetë, shkroi në librat e tyre të përshtypjeve «përshtypjet e tij të mira». Vizitoi kooperativën bujqësore të Sofratikës, ku e vunë në dijeni për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës në minoritet.

I dhanë pako me libra shkollorë në gjuhën greke. Qëllimi i tij i dukshëm, në pamjen e parë, ishte të konstatonte se a flitej gjuha greke, apo e kishim ndaluar. Natyra, fushat, fshatrat (shkuan natën në rrugën e luginës së Dropullit për të parë dritat e fshatrave të minoritetit), ishin të bukura si në pranverë. I kanë bërë shumë përshtypje, sido që në këto ka qenë i rezervuar.

E HËNË
17 PRILL 1972*

NJË BISEDË E ÇU EN LAIT PA PROBLEME POLITIKE

Nga fillimi i muajit prill shkoi në Pekin një delegacion yni qeveritar për të nënshkruar marrëveshjen e kreditë që Republika Popullore e Kinës i jep Republikës Popullore të Shqipërisë për bujqësinë.

Për këtë, në krye të delegacionit ne mund të dërgonim në Kinë edhe ndonjë zëvendësministër, por çuam ministrin e Bujqësisë për t'i gjallëruar ca marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kinës, se kishim përshtypjen që nga ana kineze sikur kishte ftohtësi, që nga koha e vajtjes së Niksonit në Pekin. Për këtë vizitë ne nuk bëmë fjalë fare në shtyp, duke e injoruar plotësisht, por edhe duke vazhduar në të gjitha frontet e tjera vijën tonë miqësore me Kinën e Mao Ce Dunit. (Përveç dërgimit të ministrit të Bujqësisë në Kinë, ne ndërmorëm edhe një sërë aktivitete të tjera miqësore, që kinezët nga ana e tyre i pritën me entuziazëm dhe iu përgjigjën reciprokisht.) Delegacionin tonë ata e pritën shumë mirë në Pekin. Në aerodrom kishin dalë tri mijë veta me muzikë, me flamuj dhe me portrete.

Dërgimi i ministrit në Kinë kishte si qëllim jo vetëm t'i jepte rëndësi marrëveshjes që do të nënshkruante ai dhe t'u shprehte shokëve kinezë falënderimet për ndihmën që na jepnin, por, meqenëse ai është edhe kandidat i Byrosë Politike, në takimet dhe në fjalimet që

do të kishte rastin të mbante me ta, do të afirmonte para tyre politikën tonë të pandryshueshme të miqësisë së madhe dhe të unitetit me Republikën Popullore të Kinës dhe me Partinë Komuniste të Kinës. Natyrisht, çështja e Niksonit do të lihej në heshtje, për arsye se nuk na takonte neve ta ngrinin këtë problem. U takonte kinezëve të na thoshin diçka, si përgjigje të letrës së Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe të na vinin në korent, qoftë edhe shkurt, sa për të kapërcyer radhën, për rezultatet e bisedimeve Mao-Çu En Lai-Nikson. Pra, duke dërguar nga ana jonë në Kinë një kandidat të Byrosë Politike, Çu En Lai i jepej mundësia të shprehej për këtë problem, në rast se ai e shihte të arsyeshme. Në qoftë se Çu En Lai do t'ia shtronte këtë, kryetari i delegacionit ishte porositur që ta falënderonte për informimin dhe do t'i thoshte se këtë informim do t'ia transmetonte udhëheqjes. Ai nuk do të jepte ndonjë mendim, por do të afirmonte, në përgjithësi, besimin e Partisë sonë se Republika Popullore e Kinës dhe Partia Komuniste e Kinës kurdoherë «zhvillojnë» luftë në të dy frontet, si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër revizionizmit sovjetik, dhe se ato «qëndrojnë fort» në parimet e marksizëm-leninizmit. Në rast se Çu En Lai nuk e hapte këtë muhabet, le t'u mbetej atyre përgjegjësia. Ne e bëmë detyrën tonë, bile edhe duke u kujtuar, me personalitetin që dërguam në krye të delegacionit, që këtë detyrë duhej ta kryenin ata ndaj nesh, qoftë edhe formalisht, pavarësisht se ne nuk ishim dakord me ta.

Ne mendonim se Çu En Lai, si «politikan» i zgjuar që është, nuk do ta humbiste këtë rast, por u gabuam. Çu En Lai e priti delegacionin (dhe këtu bazohemi në radiogramin që na erdhi nga Pekini, me të cilin informohemi për bisedimin). Bisedën e hapi dhe e mbylli Çu En Lai, kurse kryetari i delegacionit tonë bëri vetëm disa

ndërhyrje të parëndësishme. Çuja nuk i ka folur atij asgjë për çështje politike (megjithëse ai e ka zakon të flasë gjatë për këto çështje), nuk i ka folur asgjë për Shqipërinë (vetëm ka pyetur për shëndetin e shokëve...).

Biseda e Çusë ishte një autokritikë ndaj nesh në drejtime të tjera. Ai tha se «traktorët që ju kemi dërguar, janë me defekte në kolodokë, edhe avionët Mig-19 janë me defekte; prandaj mos i përdorni, derisa t'ju dërgojmë ekipe t'i kontrollojnë dhe t'i riparojnë. Po me defekte, tha Çuja, na kanë dalë edhe kamionët e gazet që kemi dërguar në Vietnam, edhe makinat korreze të kallamsheqerit që kemi dërguar në Kubë» etj.

Në fund të bisedës, Çuja i lidhi të metat dhe gabimet në industrinë e tyre të makinave dhe në industrinë ushtarake «me aktivitetin sabotues të elementëve që i përkasin rrymës ultra të majtë». Ai tha se «rryma ultra e majtë» në Kinë kishte për qëllim të sabotonte sukseset e arritura gjatë Revolucionit Kulturor dhe të restauronte atje kapitalizmin. Gjatë 2-3 vjetëve, vazhdoi ai, industria ushtarake është dëmtuar, bile është prishur. Vetëm për motorët e avionëve gjuajtës Nr. 6, shoku Jeh Çen Jin bëri një mbledhje që zgjati 10 ditë për të biseduar me specialistët dhe për të gjetur shkaqet e defekteve të këtyre avionëve. U tha se defekte të tilla ndodhnin në fillim në këta lloj avionësh dhe u përmend që edhe motorët e avionëve të sovjetikëve u venë vetëm 100 orë. Mirëpo ne më parë, shtoi më tej Çuja, i kemi pasur motorët që punonin 200 orë. Atëherë si ndodhi që ra aftësia e këtyre motorëve nga 200 në 100 orë? Ka disa motorë që punojnë vetëm 25 orë. Neve, përfundoi Çuja, «elementët e kësaj rryme na kanë sjellë dëme shumë të mëdha në ushtri. Këtë po jua themi vetëm juve, shokëve shqiptarë». Ky ishte i vetmi aluzion politik i bisedës dhe asgjë tjetër nuk tha. Çuja kërkoi që ne të bëjmë «kritika» për

makineritë që marrim prej tyre dhe tha se do të marrin masa t'i ndreqin në vend të gjitha të metat që janë vërtetuar.

Duke u ndarë me kryetarin e delegacionit tonë, në mes të tjerash, shoku Çu En Lai i tha atij: Shoku Kan Shen vazhdon të jetë akoma i sëmurë, sepse vuan nga një bronkit. Kur erdhi këtu Çausheku, shoku Kan Shen doli një herë për ta pritur, por pastaj mjekët e këshilluan të mos dalë më dhe në fakt shoku Kan Shen nuk e ndien veten mirë e nuk mund të dalë në punë. Besojmë se me këtë donte të na thoshte se «nuk e kanë spastruar si Lin Biao».

Ky ishte bisedimi i Çu En Lait sipas radiogramit që na erdhi nga Pekini. Këto janë idetë kryesore të kësaj bisede. Pra, është e qartë: Çu En Lai nuk deshi të futet në çështje politike, megjithëse i ka shumë qejf. «Ne (kinëzët) qëndrojmë në pozitë tona, ju në tuajat. Kurse për çështjet e marrëdhënieve ekonomike ne mbajmë angazhimet dhe do të jemi kurdoherë korrektë», lë të kuptojë Çuja. Mirë, ne mbajmë vijën tonë, ne kemi qenë e jemi në rregull, korrektë në marrëdhëniet me Kinën. Çuja as letrës së Komitetit tonë Qendror nuk iu përgjigj, as këtë herë nuk foli, se atij i binte të fliste. Ne regjistrujmë.

Ç'mund të nxjerrim si përfundim?

Nuk është një gjë e zakonshme që Çu En Lai në bisedë me një shokun tonë të mos trajtojë probleme politike. A ka pasur probleme politike të dorës së parë që ai duhej t'i prekte? Po!

a) **Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë marrëdhënie të reja.** Ne mendojmë se ai duhet të thoshte se deri ku, ose në cilat drejtime do të zhvillohen këto marrëdhënie. Çu En Lai mund të fshihet prapa pretekstit se «meqë ju ishit kundër ardhjes së Niksonit në Kinë dhe e injoruat këtë vizitë, atëherë ç'është nevoja që ne t'ju vëmë në korent për të?». Mirë, ne kemi

qenë kundër vizitës në fjalë, por tash që vizita u bë, neve na intereson të dimë çfarë u arrit nga ajo dhe si mendojnë kinezët ta zhvillojnë politikën e tyre në të ardhmen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne kemi të drejtë ta kërkojmë një gjë të tillë, sepse jemi aleatët e Kinës. Shokët kinezë mund të thonë se: «Ju u vutë në dijeni me anën e komunikatës kino-amerikane dhe pas kësaj, politika jonë përballë Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk ka ndryshuar». Megjithëse nuk është kë-shtu (se vazhdojnë vajtja dhe ardhja e personaliteteve të të dy vendeve, për të mos folur çfarë po bisedohet dhe po arrihet në mes tyre, sepse janë bisedime sekrete), përsëri u mbetet atyre të na thonë pse **zyrtarisht më parë na është thënë se «kjo që po bëjmë me Niksonin është një taktikë dhe një strategji e re, e madhe»**. Pra Çu En Lai heshti plotësisht në këtë problem të madh, mbasi pozitat i ka të dobëta dhe duhet të bënte disa mohime ose afirmime për të cilat nuk është i sigurt, prandaj qëndroi prudent. Por prudenca tregon lëkundje dhe pasiguri në politikën që po ndjek Kina me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Objektivat kryesorë, taktikë dhe strategjikë, që do të arrinin, nuk po duken as brenda në Kinë, as në arenën ndërkombëtare. Ne mendojmë se në arenën ndërkombëtare ky veprim politik i Kinës në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk i solli fitime asaj, por dëme.

b) **Problemi i Vietnamit.** Atje ka filluar ofensiva e madhe ushtarake nga ana e vietnamezëve. Amerikanët dhe kukullat e tyre po hanë grushte të rënda. Kjo është një fitore e madhe jo vetëm për popullin vietnamez, por edhe për të gjithë ne. Politika jonë ka qenë dhe është që të shporren amerikanët nga Vietnam. Ne e mbështetim Vietnamin në këtë drejtim.

Kurse Çu En Lai heshti për fitoret e popullit vietnamez në këtë luftë. Pse? Sepse kinezët nuk i kanë punët

mirë me vietnamezët dhe kjo, s'ka dyshim, për shkak të kursit që ndjekin ata ndaj Niksonit, të cilin vietnamezët me të drejtë e quajnë kriminelin më të madh të luftës. Kinezët, të cilët e pritën Niksonin në shtëpi, u takuan dhe biseduan me të; lufta e vietnamezëve i ka vënë kinezët në pozita të vështira. Kjo do të thotë: «Unë derdh gjak, ti pranon si mik vrasësin tim dhe bisedon me të». Kina bëri deklarata zyrtare dhe komunikata që nënshkruan të dyja palët e afirmoi se ajo «me Niksonin nuk do të bisedonte për luftën e Vietnamit». Ky ishte një gabim i madh politik dhe strategjik nga ana e saj. Kinezët mund të thonë se «s'deshën vietnamezët» të bisedojnë për ta me amerikanët. Pavarësisht nga kjo, Kina nuk mund ta linte në heshtje këtë çështje, sikundër e la. Nga kjo përfituan revizionistët sovjetikë, që hiqen tash si «frymëzuesit dhe ndihmësit kryesorë të ofensivës vietnameze».

Pra Çuja heshti edhe për Vietnamin, pse i ka zënë gojën politika me Niksonin. Kina, edhe në këto pozita që është, vazhdon t'ia japë Vietnamit si më parë ndihmën materiale, por ndihma e saj politike është e zbehtë.

c) **Politika kineze ndaj Pakistanit dhe Bangladeshit pësoi një fiasko!** Çfarë të thoshte Çuja? Për Lindjen e Mesme dhe për Evropën ai heshti krejtësisht, si në komunikatën kino-amerikane.

d) **As revizionistët sovjetikë nuk i zuri një grimë në gojë. Pse?**

Problemi që preku Çuja në mënyrë të zbehtë ishte ai i «rrymës ultra të majtë», e cila i ka sjellë «dëme të mëdha Kinës e që donte të vendoste atje kapitalizmin». Sigurisht, Çuja e kishte fjalën për grupin e Lin Biaos, pa ia vënë emrin. Kjo është taktika e tyre e vjetër. Këtë gjë që s'të flet shumë, na e tha gjoja në konfidencë neve, shqiptarëve. Çfarë ka bërë kjo rrymë? Deshi të vendoste kapitalizmin!! Po në ç'mënyrë? Vetëm duke sabotuar

avionët? Pse, me kaq mund të kënaqet një parti motër? O vëre siç është për t'u vënë, o mos e vër fare në ko-rent!!

Sa për sabotimin e avionëve dhe të helikopterëve, kjo nuk është një çështje e re. Shokëve tanë që kanë qenë në Kinë që në vitin 1968-1969, këtë ua kanë thënë shokët kryesorë ushtarakë kinezë, bile nga më kryesorët, nga ata që u spastruan me «grupin ultra të majtë». Domethënë puna sabotuese në avionë u zbulua kur Lin Biaoja ishte «i plotfuqishëm». Por sidoqoftë, nga ana e tyre, ky mund të konsiderohet «një veprim i komplotistëve» dhe bile veprimi kryesor i tyre. Asgjë tjetër nuk na u tha nga Çu En Lai. Ai tash, me kaq sa na tha, e konsideron se e ka bërë detyrën «e solidaritetit ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë». Ne s'jemi të një mendjeje me të dhe mendojmë se, derisa iu fut këtij problemi, ai duhej ta shpjegonte.

Për çështjen e Kan Shenit, që na e përsëritin shumë herë, duan të thonë se «ai është i sëmurë dhe nuk është spastruar me grupin ultra të majtë». Mirëpo ky «grip» ose «bronkit» si shumë po zgjat. Ka më tepër se një vit që Kan Shenit nuk del në publik. Kjo është punë e tyre, po, me ne, duket që edhe në këtë çështje nuk janë seriozë.

E ENJTE
20 PRILL 1972*

KINA PO FUTET MË THELLË NË NJË RRUGË PA KRYE

Kina lajmëron se dje arritën në Pekin dy nga senatorët amerikanë më të rëndësishëm, Mensfild dhe Skot, përfaqësues kryesorë të të dy partive amerikane. Ata vënë në Kinë si «miq» dhe do të bisedojnë me Çu En Lain. S'dihet, mund të takohen edhe me Maon. Do të shohim.

Vajtja e këtyre dy emisarëve kryesorë imperialistë e dëmton shumë emrin e Kinës dhe e fut këtë akoma më thellë në një rrugë shumë të gabuar dhe pa krye, rrugë që u fillua me praninë e Niksonit në Pekin. Ata vajtën në një kohë kur lufta në Vietnam po zhvillohet e furishme, kur vietnamezët po përparojnë, kur amerikanët dhe kukullat e tyre po hanë grushte, kur Niksoni jep urdhra dhe bombardon barbarisht Hanoin, Hajfongun dhe trupat e vietnamezëve në jug.

Kjo situatë është e tmerrshme për Kinën, kurse Çuja vazhdon rrugën që filloi. Sovjetikët protestojnë që anijet e tyre u goditën në Hajfong, kërcënojnë se mund të mos e pranojnë Niksonin në Moskë, dhe, duke përfituar nga kjo situatë, hiqen sikur janë ata (sovjetikët) që po e ndihmojnë Vietnamin në fitoren e tij. Niksoni kërcënon të bllokojë Hajfongun. Atëherë sovjetikët mund të kërkojnë nga Kina që të dërgojnë materiale lufte nëpërmjet territorit të saj. Në qoftë se Kina nuk e pranon, dhe nuk do ta pranojë këtë, atëherë situata për të do të vesh-tirësohet.

E SHTUNË
22 PRILL 1972*

OFENSIVA VIETNAMEZE DHE KINA

Dje delegacioni ynë qeveritar u kthye nga Kina dhe sot na raportuan për punën e bërë atje. Për anët ekonomike çdo gjë shkoi mirë, kurse për çështjet politike nuk ka asgjë veç heshtjes së plotë.

Po bëhen më shumë se tri javë që vietnamezët po sulmojnë nga të katër anët forcat amerikane dhe kukullat e Sajgonit. Katër fronte të rëndësishme kanë hapur: një në drejtim të Huesë, të cilën e kanë lënë pas; një front nga Laosi në qendër, me qëllim, siç duket, që të ndajnë Vietnamin e Jugut në dy, duke izoluar forcat armike të zonës veriore të Vietnamit të Jugut nga ato të frontit të Sajgonit; frontin e tretë e kanë hapur në veri të Sajgonit, ku kanë marrë qytetin An Lok, kyç i rëndësishëm i Sajgonit, të cilin e rrezikojnë nga veriu (kanë arritur sipas lajmeve 60 km larg Sajgonit); fronti i katërt është hapur në jug të Sajgonit nga Kamboxhia (kanë arritur rreth 40 km afër Sajgonit). Qëllimi kryesor është rrethimi dhe marrja e Sajgonit. Një Dien Bien Fu i dytë shumë më i bujshëm. Kjo do të jetë fitorja vendimtare, në qoftë se do t'ia arrijnë qëllimit. Disfata e imperializmit amerikan do të jetë tërësore dhe e turpshme në Vietnam.

Aktualisht imperializmi amerikan dhe Niksoni janë vënë me shpatulla në mur. Atyre nuk u ka mbetur veçse

të përdorin aviacionin taktik dhe strategjik, por pa efekt të dukshëm dhe të mundshëm. Vietnamizimi i konfliktit nga ana e tyre përfundoi në një fiasko: kukullave të Sajgonit nuk u mbahen këmbët gjëkund. Taktika e vietnamezeve është të vazhdojnë ofensivën dhe njëkohësisht të kërkojnë nga amerikanët që të ulen në tryezën e bisedimeve në Paris. Amerikanët, deri tash, refuzojnë dhe vijonë në bisedime me kusht që vietnamezët të pushojnë ofensivën.

Kjo gjendje i ka vënë Niksonin dhe administratën e tij në situata të vështira politike, dhe pikërisht në prapësi të zgjedhjeve presidenciale. Kundërshtarët e tij po e luftojnë keq. Brenda vendit ka greva dhe demonstrata. Niksoni u detyrua dje të mbyllte një sërë universitetesh të rëndësishme, pse studentë e profesorë kanë ngritur krye. Flitet se Niksoni do të mbajë një fjalim «të rëndësishëm» javën që vjen.

Taktika e luftës e vietnamezeve do të dalë me sukses, me kusht që ata të vazhdojnë të mos tërhiqen nga kjo taktikë e drejtë, pse vetëm kjo do t'u sjellë fitoren.

Marrëdhëniet e kinezëve me vietnamezët janë të ftohta. Mjaft fakte, që i kam përmendur në shënimet e mëparshme, e vërtetojnë këtë gjendje, por po mësojmë rastësisht edhe të tjera, që forcojnë bindjen tonë.

Ambasadori ynë në Hanoi këto ditët e fundit pati një bisedë me atasheun ushtarak kinez në Vietnam. Ky i tha: «**Ne (kinezët) nuk dimë gjë për këto ofensiva, sepse vietnamezët nuk na vënë në korent. Nuk dimë nëse ky është një veprim serioz dhe do t'i shkohet deri në fund, apo është një aventurë që do t'u kushtojë shtrenjtë. Sovjetikët kanë gisht në këtë ofensivë**». Vetëm këto pohime të këtij personi me shumë përgjegjësi dhe brenda në Hanoi, tregojnë qartë situatën që ekziston midis kinezëve dhe vietnamezeve. Kjo thënie, përveç çështjes së madhe që kinezët mbahen krejt si të huaj nga qëlli-

met e vietnamezëve krijon edhe dyshim në çështjen: **kinezët a janë pro, apo kundër ofensivës aktuale?** Në qoftë se janë pro, atasheu ushtarak kinez duhej ta aprovonte dhe ta mbështeste ofensivën e vietnamezëve, pavarësisht se këta nuk i kanë vënë në korent. Por mund të jetë edhe ana tjetër, që kinezët këtë sulm të vietnamezëve e konsiderojnë si aventurë, duke bërë analogji me luftën në Kore, kur ushtria koreane shkoi deri në Pusan dhe, kur amerikanët kundërsulmuan dhe erdhën deri te lumi Jalu, në kufi me Kinën.

Janë këto arsye që i bëjnë kinezët ta quajnë ofensivën e vietnamezëve «një aventurë»? Tok me këtë, mos mendojnë ata se, meqë sovjetikët kanë gisht në një ofensivë të tillë, i kanë futur vietnamezët në këtë aventurë për ta sjellë luftën në kufijtë e Kinës, duke provokuar një sulm të ri ala Mak Artur në Vietnam dhe kjo t'u japë shkak sovjetikëve jo vetëm të propagandojnë kundër Kinës, por edhe ta implikojnë atë në luftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose të futin edhe vetë këmbët në Vietnam dhe ta rrethojnë Kinën nga jugu? Të gjitha këto janë variante të mundshme.

Por është dhe varianti tjetër. Ndryshimi i strategjisë dhe i taktikës së Kinës, dhe veçanërisht ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka bërë që Kina të ndryshojë qëndrimet kryesore.

Në lidhje me Vietnamin Kina ishte kundër bisedimeve të vietnamezëve në Paris me amerikanët dhe i konsideronte këto të kota. Kur ajo vetë u fut në bisedime të fshehta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ndërroi qëndrimin në këtë çështje. Vietnamezët në Paris propozuan 7 pikat, amerikanët propozuan të tyret. Ishte koha kur u deklarua akordi për vajtjen e Niksonit në Kinë. Pikërisht pas kësaj, amerikanët nuk ia varën më Konfencës së Parisit. Pse? Nuk ka dyshim, mund të mendohet se për Vietnamin do të bisedonte Niksoni në Pekin.

Dhe ka arsye të ishte kështu. Verivietnamezët u hodhën përpjetë dhe me siguri u grindën me kinezët, saqë Çu En Lai u detyrua të deklarojë botërisht se «me Niksonin nuk do të preket çështja e Vietnamit». Këtu qëndron burimi i konfliktit.

Por ky konflikt duhet të jetë zhvilluar edhe brenda në udhëheqjen kineze, domethënë në mes të Mao — Çu En Lai nga një anë dhe Lin Biaos dhe ushtarakëve, nga ana tjetër, ose «të majtëve ekstremë», siç i kanë cilësuar. Duhet të supozojmë se Maoja dhe Çuja ishin për vajtjen e Niksonit në Pekin dhe për zbutjen e politikës ndaj Shteteve të Bashkuara, si edhe për zgjidhjen, deri në njëfarë shkalle me bisedime, të problemit të Vietnamit, kurse Lin Biaoja dhe shokët e tjerë ishin kundër vajtjes së Niksonit, kundër zbutjes së politikës me të dhe për zhvillimin e mëtejshëm të luftimeve nga ana e Vietnamit. Për këtë ata duhet të jenë akuzuar «ultra të majtë».

Këtë çështje kryesore kinezët e fshehin dhe neve na thonë gjëra që nuk qëndrojnë në këmbë dhe që janë kontradiktore, si për shembull, «ultra të majtët ishin prosovjetikë» dhe këtë e lidhin me faktin që sovjetikët mundet të kenë gisht në ofensivën vietnameze. Sipas kinezëve, ultra të majtët thonë se «politika duhet të jetë në plan të parë», kurse «në plan të parë, sipas tyre, duhet të jetë industria». Kjo është tezë krejt revizioniste. «Ultra të majtët janë kundër industrisë dhe industrisë moderne, ata janë kundër artizanatit». Ç'kontradikta!

E kështu me radhë, një sërë budallallëqesh të tilla. Shumë të meta dhe gabime të natyrshme në punë kinezët i ngrenë në parime dhe ua veshin «të majtëve ekstremë». Këto nuk hahen!

Kinezët gjenden në vështirësi të bëjnë kthesa, pra ndaj «të majtët ekstremë» nuk i akuzojnë botërisht për gabime politike, por me këto gjëra të dorës së dytë dhe

kontradiktore që, edhe kur të jenë të detyruar të ndërrojnë faqe, të lëvrijnë si peshq.

Tash shokët kinezë na thonë neve se «vietnamezët janë njerëz me dy faqe».

Ambasadori ynë në Pekin na lajmëron sot se këto ditët e fundit jepej një pritje për një personalitet afrikan. Në darkë ishte edhe Çu En Lai, i cili, në sy të të ftuarve, u përpoq të jepte përshtypjen se marrëdhëniet me Vietnamin ata i kanë «shumë të mira». Por i doli e kundërta. Ai u ngrit nga tryeza dhe shkoi drejt diplomatëve dhe ua bëri me shenjë dy ambasadorëve vietnamezë, të Veriut dhe të Jugut, që të afroheshin, por këta as që lëvizën nga vendi. Vajti Çuja tek ata dhe filloi t'u fliste. Ata e dëgjonin me një indiferencë të theksuar, që u binte në sy të gjithë atyre që i shikonin. Më në fund të dy ambasadorët vietnamezë, duke mbajtur po atë qëndrim indiferent, i dhanë të kuptojë Çusë se nuk e merrnin vesh çfarë thoshte, saqë Çuja u detyrua të thërresë përkthyesit. Kjo skenë e rëndë u ra në sy të pranishmëve dhe bëri përshtypje të madhe.

Sidoqoftë, situata ndërmjet Kinës dhe Vietnamit paraqitet jo e shëndoshë. Nga kjo situatë përfitojnë revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë, në dëm të popullit vietnamez, i cili lufton heroikisht, dhe ne duhet ta mbështetim me të gjitha forcat tona në luftën e tij të drejtë.

E MËRKURE

26 PRILL 1972

SHËNIM

Mora librin «Face au révisionnisme»¹ me shkrime të mia që është botuar në Paris nga shtëpia botuese «Maspero». Myri ka bërë një parathënie të mirë dhe të drejtë, marksiste-leniniste, që vë në dukje luftën e drejtë dhe konsekuente të Partisë sonë. Libri është shtypur dhe lidhur shumë mirë.

1 Frëngjisht — «Përballë revizionizmit».

LUFTA HEROIKE E POPULLIT TË VIETNAMIT DHE INTRIGAT E SOCIALIMPERIALIZMIT SOVJETIK

Sot punova me tekstin përfundimtar të artikullit lidhur me luftën heroike të popullit vietnamez. I bëra disa korigjime të nevojshme dhe ia dërguam gazetës «Zëri i popullit» që ta botojë nesër me titullin: «Lufta heroike e popullit të Vietnamit dhe intrigat e social-imperializmit sovjetik»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 244.

SHËNIM

U thashë shokëve të Ministrisë së Jashtme «t'i tërheqin vëmendjen» ambasadorit tonë në Rumani, që nuk jep asnjë mendim të tij dhe të shokëve të tjerë të ambasadës për ndryshimet e rëndësishme që u bënë në udhëheqjen kryesore të Rumanisë. Nuk mjafton të na informojë ç'thonë ambasadori grek, jugosllav, bullgar e të tjerë. Ne në Rumani kemi shumë miq tanët. Ç'bën me ta ambasadori shqiptar? Përse e kemi dërguar atje?

PASOJA TË RËNDA PËR SHKAK TË NJË AVENTURE TË NXITUR NGA ANA E KORESË DHE E BS NË CEJLON

Shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia më raportuan për bisedën që patën me shokun Sanmugathasan, Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Komuniste të Cejlonit, i cili ka ardhur këto ditë në Shqipëri.

Sanmugathasani, ka thënë se për afro katër muaj ishte burgosur për arsye të «aventurës guevariste» që ngjau në Cejlon, organizuar nga ambasada e Koresë dhe ajo sovjetike, me pjesëmarrjen aktive të një numri «të madh» të rinjsh të udhëhequr nga një revizionist i maskuar, «i dëbuar» me qëllim nga «Universiteti Lumumba» i Moskës. Ky provokator përfitoi nga mungesa e vigjilencës së Partisë Komuniste të Cejlonit dhe, duke u hequr si «prokinez i flaktë», u fut në parti, u ngarkua me punën e rinisë, por pas një kohe u demaskua. Por punën e keqe ai e bëri dhe me mijëra të rinj të armatosur sulmuan. Janë vrarë me mijëra veta dhe aktualisht në kampe përqendrimi ka deri në 15 000 njerëz. Qeveria goditi ashpër, vazhdon shtetrrëthimi dhe u shtrenjtua jetesa. Natyrisht, Partia Komuniste e Cejlonit nuk mori pjesë në këtë aventurë. Sanmugathasani bëri një analizë kritike të gjendjes së partisë dhe të vendit. Këto e kanë bërë që problemet e ideologjisë e të politikës kombëtare dhe ndërkombëtare t'i shohë më realisht se herët e tjera. Do të takohem edhe vetë me të.

BISEDË ME KRYETARIN E FEDERATËS SË SINDIKATAVE PËR ÇLIRIMIN E VIETNAMIT TË JUGUT

Asistova në parakalimin e punonjësve të Tiranës. Parakalim i bukur, koha ishte me diell.

Në krah të tribunës qendrore ishin shumë miq të huaj, që kanë ardhur për të marrë pjesë në punimet e Kongresit tonë të 7-të të Bashkimeve Profesionale, kurse në tribunën qendrore kishim ftuar anëtarët e delegacionit të Kinës, ato të të dy Vietnameve dhe të Cejlonit. Në krah kisha kryetarin e delegacionit të Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut¹. S'kish-te dalë ndonjëherë nga vendi, ai ka lindur dhe është rritur në luftë të pandërprerë. Njerëz heroikë vietnamezët! Më falënderoi për ndihmën «e madhe» që i japim ne luftës së tyre. I thashë se nuk duhet të na falënderojë, se ndihma jonë është shumë e vogël, përpara ndihmës kolosale që lufta heroike e popullit të Vietnamit u jep popujve të të gjithë botës.

1 Nguyen Van Sin.

PASOJA TË RËNDA PËR SHKAK TË NJË AVENTURE TË NXITUR NGA ANA E KORESË DHE E BS NË CEJLON

Shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia më raportuan për bisedën që patën me shokun Sanmugathasan, Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë Komuniste të Cejlonit, i cili ka ardhur këto ditë në Shqipëri.

Sanmugathasani, ka thënë se për afro katër muaj ishte burgosur për arsye të «aventurës guevariste» që ngjau në Cejlon, organizuar nga ambasada e Koresë dhe ajo sovjetike, me pjesëmarrjen aktive të një numri «të madh» të rinjsh të udhëhequr nga një revizionist i maskuar, «i dëbuar» me qëllim nga «Universiteti Lumumba» i Moskës. Ky provokator përfitoi nga mungesa e vigjilencës së Partisë Komuniste të Cejlonit dhe, duke u hequr si «prokinez i flaktë», u fut në parti, u ngarkua me punën e rinisë, por pas një kohe u demaskua. Por punën e keqe ai e bëri dhe me mijëra të rinj të armatosur sulmuan. Janë vrarë me mijëra veta dhe aktualisht në kampe përqendrimi ka deri në 15 000 njerëz. Qeveria goditi ashpër, vazhdon shtetrrëthimi dhe u shtrenjtua jetesa. Natyrisht, Partia Komuniste e Cejlonit nuk mori pjesë në këtë aventurë. Sanmugathasani bëri një analizë kritike të gjendjes së partisë dhe të vendit. Këto e kanë bërë që problemet e ideologjisë e të politikës kombëtare dhe ndërkombëtare t'i shohë më realisht se herët e tjera. Do të takohem edhe vetë me të.

BISEDË ME KRYETARIN E FEDERATËS SË SINDIKATAVE PËR ÇLIRIMIN E VIETNAMIT TË JUGUT

Asistova në parakalimin e punonjësve të Tiranës. Parakalim i bukur, koha ishte me diell.

Në krah të tribunës qendrore ishin shumë miq të huaj, që kanë ardhur për të marrë pjesë në punimet e Kongresit tonë të 7-të të Bashkimeve Profesionale, kurse në tribunën qendrore kishim ftuar anëtarët e delegacionit të Kinës, ato të të dy Vietnameve dhe të Cejlonit. Në krah kisha kryetarin e delegacionit të Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut¹. S'kish-te dalë ndonjëherë nga vendi, ai ka lindur dhe është rritur në luftë të pandërprerë. Njerëz heroikë vietnamezët! Më falënderoi për ndihmën «e madhe» që i japim ne luftës së tyre. I thashë se nuk duhet të na falënderojë, se ndihma jonë është shumë e vogël, përpara ndihmës kolosale që lufta heroike e popullit të Vietnamit u jep popujve të të gjithë botës.

1 Nguyen Van Sin.

FITORE TË SHKËLQYERA TË VIETNAMEZËVE

Këto ditë vietnamezët po korrin fitore të shkëlqyera të njëpasnjëshme kundër imperialistëve amerikanë dhe kukullave të Sajgonit. Ata po përparojnë në të katër frontet. Në frontin e veriut drejt Huesë, e cila është rrethuar, armiqtë po prapsen në panik drejt Da Nangut. Kuan Tria u çlirua, po kështu edhe An Loku. Sulmi mbi Hanoi dhe Da Nang po përgatitet. Niksoni kërcënon të bombardojë Hanoin dhe Hajfongun. Por më kot e ka, s'ka ç'bën. Këto janë raprezalje hitleriane para disfatës së turpshme. Aviacioni amerikan është i pafuqishëm të fitojë luftën. Një popull i vogël heroik e përballoi dhe e mundi kuçedrën fashiste kriminale amerikane. E para disfatë serioze që po pësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushat e betejës. U erdhi fundi.

TAKIM ME DELEGACIONE NGA KINA DHE VIETNAMI

Sot paradite prita delegacionin e punëtorëve kinezë, që ka ardhur për të marrë pjesë në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale¹.

Po sot pasdite prita dy delegacionet e Vietnamit që do të marrin pjesë në Kongresin e 7-të të Bashkimeve Profesionale: delegacionin e Federatës së Sindikatave të Vietnamit² dhe delegacionin e Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut³.

1 Delegacioni kryesohej nga anëtarja e KQ të PKK, sekretare e komitetit të partisë të qytetit të Shangait dhe përgjegjëse e konferencës së përfaqësuesve të punëtorëve revolucionarë të qytetit të Shangait, Van Hsiu Çen.

2 Delegacioni kryesohej nga anëtari i presidiumit të Federatës së Sindikatave të Vietnamit, Hoang Mau.

3 Delegacioni kryesohej nga anëtari i KQ të Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut, Nguyen Van Sin.

TAKIM ME SHOKUN SANMUGATHASAN

Prita sot shokun cejlonez Sanmugathasan. Më bisedoi për goditjen që pësoi partia nga reaksioni me rastin e aventurës së Çe Guevaristëve cejlonezë të shtyrë nga koreanët e sovjetikët. Ai më foli, gjithashtu, për kongresin e ardhshëm të partisë së tyre, që do të mbaj në ilegalitet. Shokët cejlonezë duhet të ndërrojnë metodën e punës, pse reaksioni qeveritar nuk i lejon më të veprojnë «legalisht». Shkëmbyem po ashtu mendime për politikën e jashtme dhe për gjendjen e Partisë Komuniste Indiane (m-l).

NË KONGRESIN E BPSH PËRSHËNDETIN MIQTË E HUAJ

Në Kongresin e Bashkimeve Profesionale, që u hap dje, vazhdojnë diskutimet.

Sot përshëndetën delegacionet e Kinës dhe të dy Vietnameve. Diskutuan edhe një pjesë tjetër e delegatëve të huaj.

SHËNIM

Sot paradite në një rën nga sallat e Pallatit të Kulturës ku zhvillohen punimet e Kongresit të 7-të të BPSH, u takova me delegatët e huaj.

SHËNIME

Dhashë udhëzime që të përgatitet një deklaratë nga Qeveria jonë në mbrojtje të Vietnamit dhe kundër bllokadës fashiste të Niksonit.

Bisedova me Ramizin për artikullin që do të botojmë nesër në mbrojtje të Vietnamit dhe në bërjen apel popujve që të bashkohen për të thyer bllokadën fashiste dhe agresive të imperializmit amerikan kundër këtij vendi¹.

Porosita, gjithashtu, që ambasadori ynë në Ankara të protestojë për shpifjet që po bëhen në një gjyq në Stamboll, se gjoja dy nënshtetas turq me origjinë shqiptare po bënin «spiunazh» në favorin tonë. Ç'të poshtë janë. Të gjitha të kurdisura.

1 «Popuj dhe shtete përparimtare, të shkatërrojme bllokadën agresive fashiste të imperializmit amerikan në Vietnam! Social-imperialistët sovjetikë pranojnë në fakt bllokadën amerikane ndaj Vietnamit».

E SHTUNË
13 MAJ 1972

**OFENSIVA FITIMTARE E VIETNAMEZËVE DHE
BLLOKADA AGRESIVE FASHISTE E PORTEVE
TË VIETNAMIT TË VERIUT NGA ANA
E IMPERIALISTËVE TË SHTETEVE
TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

Sulmi i vietnamezëve mbi ushtritë agresive amerikane dhe kukullat e tyre të Sajgonit po ecën me sukses përpara. Po çlirohen rajone të gjera dhe qytete. Forcat çlirimtare janë 10 km larg Huesë, An Loku është i rrethuar dhe kërcënohet, Sajgoni, gjithashtu, po kërcënohet ashtu si dhe gjithë mbrojtja dhe strategjia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e kukullave të tyre. Këta janë përpara një disfate të turpshme.

«Vietnamizimi» i luftës i Niksonit pësoi disfatën më të turpshme. Kjo luftë vërteton edhe një herë, në mënyrë të shkëlqyer, se luftës çlirimtare popullore nuk mund t'i qëndrojë përballë asnjë forcë. Përpara shpirtit luftarak, guximit dhe zotësisë së një populli, që lufton për kauzën e tij të drejtë, do të thyhen armët e armikut, qoftë ky i madh dhe i armatosur me armët më moderne, siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. As demagogjia e tyre, duke e paraqitur çështjen sikur luftën e bëjnë kukullat e Sajgonit, nuk pi ujë. Ballistët vietnamezë u shpartalluan si ballistët tanë, të përkrahur nga okupatorët italo-gjermanë. Fati i tyre është dhe do të jetë kurdoherë i njëjlojtë kudo e në çdo kohë. Kush bash-

kohet dhe i shërben armikut të popullit të vet, ai është i dënuar me vdekje.

Lufta kundër popullit të Vietnamit është lufta e amerikanëve. Këta janë në hall të madh, se po e humbasin atë dhe «nderin», që nuk kanë pasur kurrë. Disfata e tyre në Vietnam ua heq frikën popujve nga kjo egërsirë që do plumb, pse plumbi e rrëzon përdhe dhe e ngordh. Tash bisha amerikane po përpëlitet në agoninë vietnameze, por do që të shpëtojë «e gjallë» nga kurthi, ajo mundohet t'i tregojë botës se gjoja u tërhoq pa plagë dhe jo me bisht në shalë.

Tash qëndrimi i amerikanëve në Vietnam është bërë i pamundur, jo se ata nuk duan, por se nuk qëndrojnë dot. Atje atyre u digjet toka nën këmbë. I përdorën të gjitha mjetet që dispononin deri edhe aleatët e tyre, revizionistët e Moskës, por nuk mundën dot. Tash u mbetet e vetmja rrugëdalje, të kapitullojnë, por të mund të lënë pas në Vietnam «njëfarë shprese» për të ardhmen, «të ruajnë» të paktën në «pushtetin e ardhshëm» një kontingjent njerëzish nga të tyret për t'i pasur si ura, si agjentura, si sabotatorë dhe diversantë. Dhe këtë tërheqje strategjike Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë ta bëjnë duke u përpjekur t'u imponojnë luftëtarëve heroikë të Vietnamit kushtet e tyre të forcës. Këtu synojnë të gjitha masat aktuale luftarake që ndërmerr Niksoni, që nga bombardimet e Hanoit, Hajfongut etj. dhe minimin e porteve të Vietnamit të Veriut e deri te bisedimet e fshehta dhe të hapëta që u mbajtën e do të mbahen në Moskë në mes Brezhnjev-it e Kosiginit dhe Niksonit.

Bllokada e porteve të Vietnamit tregon se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e humbën luftën tokësore. Bombardimet ajrore janë pa efekt, pse vietnamezët u mësuan dhe kanë marrë masa për t'i përballuar, kështu që Shtetet e Bashkuara, duke bombarduar si në shkretëtirë, nuk

mund të arrijnë asnjë objektiv taktik ose strategjik në luftë. Ndalimi i furnizimeve nga Kina, mund të pengohet ca, por kurrë nuk do të ndalohet dot krejtësisht nga ana e Shteteve të Bashkuara. Ushtritë amerikane të mundura nuk mund të rikthehen dot prapë në Vietnam; ato ishin atje, luftuan dhe u thyen dhe, po të kthehen prapë, edhe një herë do të thyhen. Kukullat e Sajgonit s'janë për gjë, ato shkrihen si kripa në ujë. Jo vetëm ushtarakisht humbën Shtetet e Bashkuara dhe Niksoni, por ata po humbasin rëndë edhe politikisht. Veprimet ajrore dhe bllokada detare, që janë edhe këto veprime ushtarakë, bëhen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të fitojnë diçka politikisht. Por, kjo është një fitore si ajo e Pirros. Bota përparimtare i dënon këto veprime agresive të imperialistëve amerikanë.

Blokada agresive detare e porteve vietnameze nga ana e Niksonit demaskoi jo vetëm atë, por edhe revizionistët sovjetikë. Këta kanë qenë dhe janë kundër luftës çlirimtare të popullit vietnamez. Këta kanë luftuar për kompromise dhe për kapitullimin e Vietnamit përpara Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Revizionistët sovjetikë donin që të shuhej lufta në Vietnam, të triumfoje «bashkekzistenca e tyre paqësore», «bota pa luftëra dhe pa armë». Revizionistët sovjetikë përpiqen që në «shpartallimin» e vietnamezëve të dilnin si «shpëtimtarë» dhe të vendosnin hegjemoninë e tyre.

Dhënia nga ana e tyre e disa ndihmave vietnamezëve ishte e domosdoshme, ndryshe nuk mund të maskohej djallëzia që kanë kurdisur në sy të popujve dhe të vetë vietnamezëve. Qëllimi kryesor i revizionistëve sovjetikë qëndronte i njëjtë dhe i pandryshueshëm: luftë për kapitullim dhe njëkohësisht të dukej sikur ishin ata që e vërtitnin këtë luftë, «fitoret e vietnamezëve ishin fitoret e tyre». Edhe sulmi aktual po trumbetohet si i tyre dhe pikërisht kjo i demaskoi. Edhe Niksoni ndihmoi

në demaskimin e tyre. «I mbyturi kërkon të mbahet nga kashta për të shpëtuar», thotë populli. Dhe Niksoni, për të shpëtuar «nderin e vet», luftën e popullit vietnamez e paraqit sikur janë sovjetikët që po e bëjnë, domethënë Shtetet e Bashkuara luftojnë në Vietnam kundër Bashkimit Sovjetik. Si vazhdim «duhet të merremi vesh ne», Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik për t'i vënë këmbët në një këpucë Vietnamit, ku «edhe ju, sovjetikë, edhe ne, amerikanë, tha Niksoni, kemi interesa të mëdhenj». Të dy kusarët imperialistë zbuluan fytyrat e tyre të përlyera me gjak.

Del qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kishin lajmëruar që më parë Bashkimin Sovjetik për bllokadën e porteve vietnameze, ata e kishin tatuar pulsën e sovjetikëve dhe ishin të bindur se këta nuk do të lëviznin, siç nuk lëvizën. Bashkimi Sovjetik lëshoi një komunikatë «proteste» fendë, me erë të qelbur, që i kënaqi Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjithë aleatët e tyre. «Shpëtuam nga ballafaqimi i armatosur midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik» — bërtitën të gjithë ata që duan t'i mbajnë popujt nën frikën e luftës, prandaj sipas Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara dhe duaxhinjve të tjerë të tyre kjo do të thotë: «Popuj, mos luftoni për çlirimin tuaj, mos i zemëroni fuqitë e mëdha, pranoni diktatin e tyre, bëni si thonë ata, lëri ata të zgjidhin mosmarrëveshjet etj!». Kjo është strategjia dhe taktika më e poshtër e imperializmit dhe e socialimperializmit për të vendosur hegjemoninë e tyre, për të siguruar zona influence, për të trembur popujt, për t'i shtypur ata me armë kur u piqet situata dhe për t'i mbajtur nën kërcënim luftarak, kur e shohin se s'mund të ndërhyjnë dot drejtpërdrejt.

Shantazhin e luftës e krijojnë dhe e ushqejnë ata, luftën kundër popujve e shpallin ata, intrigat në mes të popujve i kurdisin ata dhe u thonë atyre: «Mos

lëvizni, se ju mbrojmë ne!». Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik revizionist, nuk mbrojnë asnjë popull, ata mbrojnë interesat e tyre imperialistë dhe për këta sakrifikojnë çështjet jetike të popujve të tjerë.

Natyrisht, në këtë valë të ndyrë nuk duhet të hyjë Kina Popullore. Ajo i futi këmbët në këtë batak në takimet me Niksonin, por akoma sa s'është vonë, është koha të tërhiqet sa më parë, se armikut po i dhe gishtin, të rrëmben dorën, krahun dhe kokën. Imperializmi amerikan, jo vetëm që është armiku më i egër, por edhe nga më dinakët. Kinezët menduan se, duke u pjekur me Niksonin, do të përfitonin në të dyja tablotë, mirëpo ata humbën në të dyja këto tablo dhe tash janë në pozita shumë të vështira. Ja, pra, ç'është Niksoni. Njëlloj ashtu si ka qenë. Atëherë Kina do ta luftojë atë, siç e luftonte më parë, apo do t'i matë fjalët dhe veprat kundër tij? Në litar nuk mund të hedhësh valë. Kjo nuk i ka hije as Kinës, as Mao Ce Dunit. «marksist-leninistit të madh». Le t'ua lëmë këtë rol Titos dhe Çausheikut, këtyre dy armiqve të marksizëm-leninizmit dhe shërbëtorëve të njëqind imperialistëve.

Ne besojmë se Kina do të ecë e vendosur në rrugën e drejtë, do të ecë krah për krah me ne për të mbrojtur si kurdoherë çështjet e mëdha që na preokupojnë. Ne nuk tundemi nga rruga jonë, sikur malet dhe qiejt të na bien mbi kokë, pse kjo jona është rruga e drejtë, marksiste-leniniste.

E MËRKURË

17 MAJ 1972

SHKALLËZIM I RI I LUFTËS AMERIKANE KUNDËR VIETNAMIT

Fashisti Nikson, me anën e ajrit minoi edhe lumenjtë e Vietnamit të Veriut për të penguar transportin e brendshëm. Ky është një shkallëzim i ri i luftës në Vietnam. Niksoni po lufton me Vietnamin e Veriut pa i deklaruar luftë atij. Vetëm ushtri nuk ka zbarkuar atje se të gjitha mjetet po i përdor. Kur fashisti Nikson po vepron si xhelat dhe vrasës i popujve, ai përgatit dhe deklaroi se të hënën që vjen do të vejë në Moskë, ku do të pritet me nderime nga tradhtarët e marksizëm-leninizmit, nga shokët e tij Brezhnjev, Kosigin e kompania e tyre. Këta as që marrin mundimin të paktën ta fshehin këtë tradhti! Edhe krerët kapitalistë të vendeve të botës druhen nga opinioni i vendeve të tyre dhe nga ai botëror që të afishohen publikisht e në mënyrë solemne me një kriminel të tillë lufte, siç është Niksoni.

Revizionistët sovjetikë janë atë etur për aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë atë të interesuar për miqësinë e tyre, saqë asgjë nuk i përmban. Për ta s'kanë vlerë as opinionin e popullit sovjetik dhe ndjenjat e tij, as ai botëror dhe as zemërimi i ligjshëm i popullit heroik të Vietnamit që vritet e digjet. Ja ç'janë revizionizmi dhe revizionistët: shërbëtorë të përlulur dhe servilë të kapitalit botëror, oportunistë, gënjeshtarë të frikshëm përpara kërcënimeve e shantazheve të më të

fortit të llojit të tyre. Ata janë të frikshëm përpara kryengritjeve popullore që, për t'i shtypur, bëjnë çdo gjë, çdo barbarizëm, thyejnë çdo normë, qoftë dhe atë më të voglën të moralit të tyre borgjez.

Revizionistët sovjetikë edhe një herë po e ndihmojnë imperializmin amerikan në Vietnam, me gjithë poshtërimin që pëson, pse jo pa qëllim e zhvilloi Niksoni këtë shkallëzim të luftës atje. Derisa ai nuk mundi t'u impononte vietnamezëve politikën e tij të forcës në bisedimet e Parisit ai ua imponoi këtë plotësisht sovjetikëve në Moskë. Dhe këta të poshtë e pranuan gjuhëzimin para kriminelit fashist Nikson.

Rëndësi ka çështja që vietnamezët deri tashti nuk kanë pranuar të bëhen lodra e dallavereve të kapitalistëve të Moskës, nuk i kanë lejuar këta, që nën maskën e furnizimit me disa armë, t'u impononin edhe politikën e tyre të kompromiseve dhe të kapitullimit.

Kinezët, gjithashtu, nuk tregohen aspak në lartësinë e duhur në propagandën e tyre për demaskimin e fortë të kësaj politike të luftës barbare amerikane dhe tradhtare e kapitulluese të revizionistëve sovjetikë. Propaganda e tyre është reduktuar në disa formula bajate. Vetë ata u vunë gurë «rrotave» të tyre. Ky është një sukses për politikën e Niksonit dhe të sovjetikëve, derisa arritën ta neutralizojnë deri në njëfarë shkalle Kinën që të marrë pjesë aktive dhe të luftojë si duhet në këto momente kaq kritike për armiqtë e popujve të botës dhe të socializmit. Është e vërtetë se Kina po vazhdon ta ndihmojë Vietnamin me të gjitha forcat e saj, por kjo nuk është e tëra, sepse duhet të zhvillohet e ashpër edhe lufta politike dhe ideologjike kundër armikut. Kjo e fundit mungon, bëhet e zbehtë, për arsyet që dihen.

Të vazhdojmë deri në fund ta ndihmojmë Vietnamin me të gjitha forcat dhe mjetet që kemi deri në fitoren e tij të plotë, të vazhdojmë të luftojmë dhe të demaskoj-

më deri në fund imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik. Këto janë detyrat tona të mëdha, detyrat tona të shenjta, siç janë edhe mbrojtja e atdheut tonë socialist dhe e marksizëm-leninizmit. Vietnami do të fitojë! Marksizëm-leninizmi do të triumfojë!

TE NDIHMOJME VIETNAMIN ME TË GJITHA FORCAT E SAJ

1970

Shoku Ham Xuan, sekretari për bashkëpunimin me shtetet e jashtme të Kompartizimit të Vietnamit, ka shkruar në revistën "Koha e re" të Hanoi, në të cilën është diskutuar për bashkëpunimin me shtetet e jashtme të Vietnamit. Në artikullin e tij, Shoku Ham Xuan thotë: "Vietnami është një shtet i ri i pavarur dhe i bashkuar me shtetet e jashtme të botës. Kjo është një fitore e madhe për popullin vietnamez dhe për bashkëpunimin me shtetet e jashtme të Vietnamit. Këto janë detyrat tona të mëdha, detyrat tona të shenjta, siç janë edhe mbrojtja e atdheut tonë socialist dhe e marksizëm-leninizmit. Vietnami do të fitojë! Marksizëm-leninizmi do të triumfojë!"

TË NDIHMOJMË MARKSISTË-LENINISTËT NË AFRIKË

Shoku Ramiz më raportoi për bisedën që kishte pasur me njërin nga udhëheqësit e sindikatave të Afrikës, i cili e kishte parashtruar gjendjen e lëvizjes marksiste-leniniste në Afrikë gati njësoj siç jemi të informuar edhe ne. Ai tha se të gjithë i kanë sytë te Shqipëria dhe te Partia e Punës e Shqipërisë, prandaj është lutur të ftojme prej tyre në vendin tonë, sepse kështu i ndihmojmë. Kërkoj pastaj nga ne që t'i ndihmojmë për të botuar një revistë në Afrikë dy herë në vit në gjuhët anglisht dhe frëngjisht.

SHËNIM

U propozova shokëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme që të shpejtojnë gjetjen dhe caktimin e ambasadorit tonë të ri në Itali, pse shkoi shumë kohë që ambasada jonë në Romë është pa titullar.

QËNDRIM JO I MIRË I KINEZËVE

Shokët kinezë nuk i botojnë më në shtypin e tyre qendror artikujt themelorë të «Zërit të popullit» që demaskojnë imperialistët amerikanë dhe Niksonin si dhe socialimperialistët sovjetikë, por herë pas here i botojnë në një gazetë të veçantë që nxjerrin vetëm për kuadrot. Është e qartë, ata nuk duan që këto materiale t'i lexojë opinioni i gjerë, për arsye që dimë dhe nuk duan që të mbajnë qëndrim të ashpër kundër amerikano-sovjetikëve. Kjo s'është e mirë.

NIKSONI NË MOSKË — KINA HESHT

Moska pret banditin fashist amerikan, Niksonin, dhe e arsyeton këtë tragjedi të turpit me gjoja politikën e bashkekzistencës leniniste.

Lenini, gjoja, i paska mësuar këta imperialistë të rinj të miqësohen, të lidhin aleanca, të ndajnë e të sundojnë botën me imperialistët, kolonialistët dhe xhelatët e përhershëm të popujve, shtypësit e lirive të tyre, grabitësit e pasurive dhe të pavarësisë së vendeve të tjera. Ç'poshtërsi! Ç'trockizëm cinik!

Para se të nisej për në Moskë, Niksoni i mori plotësisht masat «për të njollosur» Leninin: ai po bombardon egërsisht Vietnamin, minoi portet dhe bregdetin vietnamez, vazhdon luftën më barbare që mund të bëhet. Në kulmin e kësaj veprimtarie të egër ky bandit fashist mori avionin dhe mbërriti në Moskën e Leninit dhe të Stalinit, ku e pritnin në aerodrom tradhtarët sovjetikë. U luajt për të himni i sovjetëve, ai himn që udhëhiqte luftën çlirimtare. Topat që shkatërruan bishën naziste, shtinë përsëri, por këtë herë për të nderuar një Hitler të dytë, i cili qëllon me top, me bomba, me napalm, me mitralozë e me të gjitha armët 24 orë mbi 24 orë dhe për vite me radhë popullin heroik të Vietnamit. Deri këtu ka arritur cinizmi i tradhtarëve revizionistë, saqë i shtrëngojnë dorën dhe i buzëqeshin xhelatit, që hanë e pinë me të, që komplojnë me të në kurriz të popujve të tjerë për të ndarë botën midis tyre.

Vrasësi i fëmijëve vietnamezë do të vizitojë, me siguri, shkolla e çerdhe të fëmijëve sovjetikë, do t'u zgërdhijë atyre qeshjen e tij cinike, do t'u shtrëngojë duart dhe do t'u gëzojë faqet nipërve të atyre heronjve të cilët u hodhën në betejat më të zjarrta që ka njohur historia, kundër kapitalizmit dhe imperializmit botëror. Tash Kornilovi, Denikini i ri, me fytyrën e Niksonit, sillet në Moskë e në Kremlin, i rrethuar me nderime nga Trockët e Buharinët e rinj.

Në banketin madhështor në Kremlin, fashisti i egër dhe i ndyrë Nikson foli «për paqen, për lirinë, për bashkëzistencën, për miqësinë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik». Ai tha se «po hapim një faqe të re për njerëzimin» dhe nuk mungoi të theksonte se «ne, shtetet më të mëdha të botës, duhet të bëjmë që shtetet e vogla të moderojnë ndjenjat e tyre». S'ka ku të vejë më qartë: «Të shuajmë revolucionet në botë, të mbajmë në fre popujt, të bëjnë këta ashtu si duam dhe si urdhërojmë ne». Dhe Niksoni i thotë këto fjalë në Kremlin, ku punoi dhe luftoi Lenini i madh në krye të bolshevikëve, në Kremlin ku ziente revolucioni proletar.

Tash në këtë Kremlin mbretëron kundërrevolucioni dhe, të puqur dorë më dorë, Niksoni me Kerenskët e rinj vizitojnë varrin e Ivanit të Tmerrshëm, vjetërsirat e carëve, bodrumet e thesareve. Mauzoleu i Leninit rri i heshur. Por Lenini nuk ka vdekur. Leninizmi është i gjallë. Ai, sot ose nesër, do t'i përpijë edhe këto qelbësira, të cilat do të shpartallohen dhe do të dërrmohen nga revolucioni proletar. Tradhtia do të shembet.

Me paturpësinë më të madhe Podgorni, në fjalimin e tij, tha shprehimisht se «dëshirojmë që në botë të ulet tensioni», domethënë të ulet revolucioni, popujt të mos ngrenë krye për të drejtat e tyre. Podgorni kërkoi hap-tazi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës: «Të evitojmë luftën në mes ne të dyve, pa gjërat e tjera i rregullojmë,

merremi vesh dhe ujdise mi në mes nesh». Aq, kjo do të thotë ndarje e zonave të influencës në botë, në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Podgorni pohoi hapur se «bashkëpunimi sovjeto-amerikan deri tash ka qenë në favorin e paqes». Pra, lufta kundër popujve të veçantë nga ana e këtyre dy superfuqive nuk ka rëndësi, sepse për ta ajo është një gjë e zakonshme dhe e nevojshme.

Kurse miku i revizionistëve sovjetikë, Niksoni, i kërcënoi hapur popujt me bombën atomike, duke thënë se «ne, fuqitë e mëdha, duhet të jemi të përmbajtura në përdorimin e armëve bërthamore, pse mund të arrijmë në goditje të drejtpërdrejtë». Kjo do të thotë: «Ju, popujt të tjerë, frenohuni në kërkesa, dëgjonani ne, fuqitë e mëdha, na merrni si arbitra, na bëni kadilerë për të zgjidhur çështjet tuaja dhe mos na nxirrni pengesa të na digjni mjekrën, se atëherë ne jemi të atillë, që djegim gjithë botën». I tillë është kërcënimi që u bëjnë popujve të botës Niksoni dhe kundërrevolucionarët sovjetikë.

«Po hapet shekulli i ri», tha Niksoni, për takimin aktual të Moskës. Kjo është sfida që kapitalizmi botëror me imperializmin amerikan dhe sovjetik në krye, po u bëjnë proletariatit, popujve, revolucionit. Popujt, marksistë-leninistët, revolucionarët do të luftojnë deri në fitoren e plotë mbi armiqtë.

Në kohën që Niksoni dhe Brezhnjevi po komplotojnë kokë më kokë në Moskë, Kina nuk flet fare fare për këto probleme, por mban politikën e heshtjes së plotë, kurse vietnamezët vazhdojnë me sukses ofensivën. U lumtë heronjve vietnamezë!

TË DEMASKOJMË VAJTJEN E NIKSONIT NË MOSKË

Dhashë disa teza e ide të zgjeruara për një artikull bazë në «Zërin e popullit» për të demaskuar vajtjen e Niksonit në Moskë dhe për bisedimet që zhvillohen atje midis Brezhnjev-Niksonit. Më vonë, pasi të dalë komunikata sovjeto-amerikane, duhet të mendojmë për disa artikuj të tjerë.

SHËNIM

Me Ramiz Alinë lexova artikullin që «Zëri i popullit» do të botojë nesër kundër bisedimeve të Moskës¹.

¹ «Një etapë e re e strategjisë globale sovjeto-amerikane kundër lirisë e pavarësisë së popujve».

BISEDIMET SOVJETO-AMERIKANE TË MOSKËS DHE QËNDRIMI I KINËS

Nuk është një çështje e vogël dhe e parëndësishme vajtja në Moskë e Niksonit, President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nuk janë pa rëndësi, bile kanë rëndësi të madhe, bisedimet që zhvillohen atje midis Brezhnjev-it dhe Niksonit, midis imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik. Gjithë bota, të gjithë popujt, të gjitha qeveritë interesohen dhe shfaqin mendimet e tyre mbi çka po ngjet në Moskë, mbi planet dhe komplotet e hapëta dhe të fshehta që kurdisen atje në kurriz të popujve të botës, të fateve të tyre dhe të paqes, nga ana e të dyja superfuqive imperialiste. **Vetëm Kina e Mao Ce Dunit hesht! As vajtjen e Niksonit në Moskë nuk ka sinjalizuar Kina në shtypin dhe në radion e vet, pale të tjerat.**

Kina ia fsheh popullit të vet që mysafiri i saj i para tre muajve, i cili u prit atje me përzemërsi, sot ndodhet në Moskë. Pse ia mban këtë fshehur popullit? Kjo është një nga «çuditë» kineze! **Të injorosh një eveniment të tillë, për të cilin flet dhe mban qëndrim gjithë bota, e pakta gjë që mund të thuash, është një absurditet politik. Të mbash një qëndrim të tillë, duke e arsyetuar se «unë jam Kina» dhe «ju injoroj ju», kjo gjithashtu, është një megalomani politike e shfrenuar që nuk njeh asnjë kufi.** Përsëri ky është një absurditet politik i shtetit të madh,

që sot shfaqet në këto forma dhe për këto probleme, por nesër vazhdon edhe për probleme të tjera. Popujt vënë pyetjen logjike: «Ky shtet i madh socialist, që përhap në të gjithë botën citatet dhe idetë e Mao Ce Dunit, ç'mendim ka për këto evenimente botërore që zhvillojnë imperialistët?». Kina hesht, ose, më drejt të themi, shtypi dhe radioja kineze përkujtojnë me bujë e me tamtame tri-dhjetë a dyzetvjetorin e një artikulli të Maos mbi letërsinë dhe artin. Pas këtij «evenimenti letrar», sikur kanë dëshirë t'u përgjigjen traktateve dhe marrëveshjeve që u nënshkruan në seri në Kremlin nga Niksoni dhe Brezhnjevi, «Zhenminzhibaoja» boton një kryeartikull foshnjor, ku i thuhet opinionit botëror të mësojë historinë botërore!

A mos vallë kinezët kanë marrë angazhime ndaj Niksonit të mos kritikojnë imperializmin amerikan? A mos vallë kanë midis tyre marrëveshje të atilla që e shuajnë polemikën për hir të realizimit të këtyre marrëveshjeve? Këto të bëjnë të dyshosh. Mirëpo faktet janë fakte, Kina nuk është më në ato pozita luftarake dhe revolucionare kundër imperializmit dhe veçanërisht kundër imperializmit amerikan.

Kur do të vente dhe kur vaiti Niksoni në Kinë, sovjetikët nuk lanë gjë pa thënë, pa sharë dhe pa shpifur kundër Kinës. Skandal i neveritshëm! **Kinezët heshtën, nuk thanë asnjë fjalë, por shënojmë se, në «konfidencë», neve na thanë: «Kur të ikë Niksoni, ne do t'u përgjigjemi si duhet sovjetikëve, bile ashpër».** Iku Niksoni, kaluan shumë muaj para se ai të vente në Moskë, bëri të gjitha ato që bëri në Vietnam, kurse kinezët as shkruan, as folën kundër sovjetikëve. Përsëri heshtje. Dhe kjo heshtje vazhdon e rëndë, e turbullt, e dvshimtë. Kësaj i thonë shuarie e polemikës, shuarje e luftës politiko-ideologjike.

Pse ngjet kjo vallë? Kinezët mos janë në tratativa të fshehta me sovjetikët për një politikë të bashkekzsis-

tencës paqësore, siç e kuptojnë revizionistët? Apo mos janë dakord me çfarë është nënshkruar në Moskë në mes Brezhnjev it dhe Niksonit, dhe Kina, në kushte të barabarta, aspiron të hyjë në të njëjtën valle? Edhe kjo të bën të dyshosh. Asnjë shpjegim tjetër nuk mund t'i gjesh kësaj heshtjeje kineze.

Gjithë shtetet kapitaliste të botës, aleate ose jo me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë shumë të shqetësuar nga aleanca sovjetiko-amerikane, nga hegjemonizmi i tyre në botë, nga ndarja e zonave të influencës ndërmjet tyre. Dhe të gjithë, në një mënyrë ose në një tjetër, haptazi ose gjysmë të maskuar, e shprehin këtë shqetësim.

Sovjeto-amerikanët folën dhe vulosën haptazi në Moskë. «Ne, — thanë ata me fjalë të tjera, — jemi dy superfuqi atomike, ne bëjmë luftën, ne sigurojmë paqen, ne ruajmë potencialin e tmerrshëm atomik që kemi krijuar, dhe ne të dy vendosim çfarë duhet të shtojmë dhe çfarë duhet të pakësojmë». Kjo do të thotë: «Gjithë bota të dridhet nga ne dhe të na bindet, se ne bëjmë shiun dhe dieillin». Ata vazhdojnë: «Popujve të tjerë nuk duhet t'u shiten armë, pse natyrisht na ngatërrojnë, ngrenë krye, bëjnë revolucion kundër nesh; prandaj, edhe po të ngjasin gjëra të tilla, ne, të dyja superfuqitë, të moderojmë ndjenjat e tyre, sido që të dy jemi kundër ndërhyrjes në punët e brendshme të popujve të tjerë, ne jemi garantë të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të tyre». Më tej ata përsëri vazhdojnë: «Të zhvillojmë tregtinë e madhe midis nesh; në zona të veçanta të bëjmë tregtinë e vogël me shtete të tjera dhe të mos i vëmë gurë në rrota njëri-tjetrit; të krijojmë në shtetet e këtyre zonave klikat tona, t'i sjellim ato në fuqi dhe të kemi kujdes t'i forcojmë ose t'i rrëzojmë nga brenda, kur nuk na binden, natyrisht të mos duket aq hapur ndërhyrja jonë; ta akaparojmë ne shkencën, mjekësinë, tërë kozmosin».

Me fjalë të tjera ata thonë: «Të bëhemi zotër të faqeve të popujve, të shteteve, të blejmë mendimet dhe ndjenjat e tyre; toka, qielli e çdo gjë të na përkasin neve, kurse thërrimet që mbeten nga sofrat jonë t'ua japim të tjerëve». «Kështu realizojmë, vazhdojnë ata, ëndrrën e vjetër të kapitalizmit, krijojmë baronët dhe skllëvërit e, ndërmjet tyre, qëndrojnë lakenjtë dhe lansquenets¹».

Këto, e të tjera si këto, u thanë, u vendosën dhe u vulosën haptazi, pa dorashka, pa pikën e turpit, në Kremlin ku jetuan, punuan dhe luftuan Lenini dhe Stalini, djemtë e proletariatit dhe udhëheqësit e tij, nxënësit më besnikë të Marksit dhe të Engelsit.

Por sa gjëra të tjera, akoma më të rrezikshme për popujt, u vendosën në fshehtësinë më të madhe nga cari Brezhnjev dhe fashisti Nikson? Këto koha do t'i zbulojë dhe jeta do të na japë të drejtë, pse Partia e Punës e Shqipërisë është ajo parti në botë që ngre zërin me forcën e duhur dhe demaskon tradhtinë e revizionistëve dhe komplotet sovjetiko-amerikane.

Kinezët kurdoherë ngrenë çështjen se çdo veprim i tyre politik (që bie erë oportunistik) bëhet për të shfrytëzuar e për të thelluar kontradiktat. Kështu thanë ata kur filluan muajin e mjalitit me revizionistët rumunë; këtë thanë kur i buzëqeshën Titos; këtë deklaruan kur biseduan me spanjollin Karriljo; këtë, më në fund thanë kur u takuan me Niksonin. Po sa i thelluan këto kontradikta? Fituan kinezët, apo të tjerët? Natyrisht, kinezët humbën. Kontradikta në mes sovjetikëve dhe revizionistëve të tjerë ekzistonin dhe ekzistojnë, por ne shohim se qoftë Titoja, qoftë Çausheku, Giereku ose Husaku, më shumë i zbutin sesa i acarojnë kontradiktat me Bashkimin Sovjetik (për arsye se kanë frikë prej tij). Kjo është e vërtetë, por këtej kinezët duhet të nxjerrin edhe konkluzione.

¹ Frëngjisht — mercenarë.

zionin që e ashtuquajtura ndihmë e tyre nuk acaroi asgjë dhe prej saj nuk përfitoi asgjë as revolucionari, as socializmi.

Po kontradiktat ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vallë u thelluan me politikën e kinezëve? Këta të fundit mund të thonë ç'të duan, kontradikta ka dhe do të ketë ndërmjet të dyja superfuqive imperialiste, por me vizitën e Niksonit në Moskë dhe me çfarë u vendos atje, kontradiktat shënojnë një zbutje relative, qoftë edhe demagogjike, edhe propagandistike, sikur ta pranojmë.

Ç'fituan Kina dhe socializmi nga zbutja e luftës revolucionare nga ana e kinezëve? Asgjë! Mendoj se humbën ajo dhe revolucionari. Në Vietnam Kina krijoi një ftohje dhe i vuri vietnamezët në pozitë sa t'i thonë asaj haptazi të mos bisedonte me Niksonin për çështjen e Vietnamit. Vietnamezët nga ana e tyre filluan ofensivën dhe po e vazhdojnë me sukses, edhe tash që Niksoni mbaroi punë në Moskë. Ç'do të thotë kjo? Açik, kjo do të thotë se dy rrugë ka: nga një anë është rruga revolucionare dhe, nga ana tjetër, është rruga e «bashkekzistencës paqësore hrushoviane». Rruga e fundit nuk është e denjë për Kinën socialiste.

Por e gjithë kjo politikë jorealiste, jokonsekuente marksiste-leniniste e shokëve kinezë ka krijuar edhe një ftohje e mosbesim të dukshëm në forcat revolucionare dhe në partitë komuniste dhe punëtore (marksiste-leniniste) në botë. Këto përpara flitnin për Kinën, mburreshin me të, mbështeteshin tek ajo dhe e mbështetnin, bile në mënyrë të ekzagjeruar ato hiqeshin si maoiste etj. Tash në kontaktet që kanë me ne, ato as që flasin fare dhe detyrohemi ne «ta nxitim» ca zjarrin që është fikur. Hope të çuditshme janë bërë në Kinë dhe momente të çuditshme po kalon ajo. Kur ne luftonim me propagandën tonë revizionizmin dhe imperializmin, kinezët qën-

dronin në surdinë. Pastaj filluan të botonin artikujt tanë, po vetë nuk flitnin. Më vonë, krahas botimit të artikujve tanë, ata filluan të flitnin edhe vetë. Pas kësaj përsëri vetë pushuan dhe vazhdonin me artikujt tanë. Ndërsa tash as vetë nuk flasin, edhe materialet tona nuk i botojnë. Kjo tregon jo thjesht lëkundje, por bile lëkundje nga e djathta.

Me gjithë këto gjëra, ne nuk i kemi humbur shpresat që Kina do t'i ndreqë këto qëndrime, pse kjo do të jetë në interesin e madh të revolucionit dhe të socializmit. Ne do të luftojmë me këmbëngulje në këtë drejtim duke mbajtur qëndrime të vendosura marksiste-leniniste në politikë dhe në ideologji dhe duke forcuar miqësinë me Kinën në rrugën marksiste-leniniste. Duke vepruar kështu, ne mendojmë se nuk bëjmë lëshime oportuniste në këtë çështje, por përpiqemi të influencojmë për të mirë.

Por një gjë është e qartë: «Strategjia dhe taktika e re» e Çusë dhe e Maos në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u bë me dhimbje brenda në Kinë. Ajo shkaktoi reaksion dhe u morën masat që dihen, por që nuk u shpallën kurrë. Këto masa mund të jenë në rrugën e tyre shkëmbinjtë të cilët pengojnë që të bëhet kthesa në ndreqjen e gabimeve. Nga ana e tyre thuhet se «gabimet duhen ndrequr me kurajë», por, kur vjen koha që të ndreqen, mungon kuraja, pse këto gabime u bënë me dhimbje dhe, po të ndreqen, do të bëhen përsëri me dhimbje. Qoftë kështu ose ndryshe, marksizëm-leninizmi na mëson se duhen evituar gabimet, por, kur bëhen, duhet detyrimisht dhe absolutisht të ndreqen.

**E MARTË
30 MAJ 1972**

SHËNIM

Me shokun Ramiz Alia diskutuam për dokumentet e ndryshme që u nënshkruan në Moskë nga sovjeta-amerikanët dhe nxorëm konkluzione e teza për propagandën dhe shtypin tonë.

**E PREMTE
2 QERSHOR 1972**

QËNDRIMI YNË I DREJTË KA NDIKIM TE POPUJT ARABË

Më raportuan për punën që ka bërë delegacioni ynë i rinisë në kongresin e rinisë siriane. Fjalimi i këtij delegacioni, që fliste edhe kundër revizionistëve sovjetikë (e që edhe këta kishin delegacionin e tyre në sallë), u prit me entuziazëm të madh dhe u brohorit në këmbë. Shqipëria jonë, me qëndrimet e saj të drejta dhe heroike, ka ndikim të madh në popujt arabë. Ta kalitim më tej këtë miqësi!

TË PËRHAPIM JASHTË MENDIMIN SHKENCOR SHQIPTAR

U parashtrova shokëve që duhet të bëjmë përpjekje të çajmë në opinionin e jashtëm me mendimin shkencor shqiptar, pse nuk është aspak e mjaftueshme dërgimi i ndonjë reviste shkencore me ndonjë përmbledhje njëfaqëshe në gjuhën frëngjisht për çdo studim. Kjo është një- lloj sikur të mos bëhet gjë fare. Kurse shkencëtarët ta- në, në të gjitha disiplinat, kanë shkruar gjëra të mira, origjinale e të thella, që vënë mirë në dukje mendimin shkencor shqiptar. Kjo do të pritët jashtë, nga shkencë- tarët e ndryshëm, jo vetëm me kuriozitet, po me inte- resim të madh. Për këtë gjë institutet tona dhe univer- siteti duhet të interesohen veçanërisht dhe të krijojnë lidhje të gjalla me institutet, me universitetet, me shkencëtarët dhe me revistat e tyre të veçanta respek- tive. Nga studimet tona të zgjidhen më të mirat dhe t'u dërgohen atyre të përkthyer në gjuhët e tyre, të kër- kohet të merret pjesë në simpoziume, në konferenca, në debate, të kërkohet, gjithashtu, që edhe diskutimet e pjesëmarrësve tanë të botohen. Kjo është e domosdosh- me të bëhet dhe mendoj se do të gjejmë fushë më të lehtë për të depërtuar në këtë drejtim, për arsye se shumica e këtij lloji nuk do të ketë karakter posaçërisht të thek- suar politik. Ne me këtë do të fuqizojmë njohjen e vendit tonë socialist dhe do të zhdukim atë mjegull që

ekziston jashtë, se vendi ynë është i prapambetur, pa kulturë, pa mendime shkencore të vetat dhe origjinale. Mendoj se kështu do të ngjallim interesim në shumë shkencëtarë të huaj.

TE DEMOKRACIË DHE TE KUNDËRSHTOJES
MËN TE QYTHA FORCËT
ALBANIA E KOPËRREVOLUCIONARË
SOVJETO-SHËRËTË

Diskutova me Ruzhica për artikullin që do të boto-
het në revistën "Nëntori" për demokracinë e mater-
ve dhe për marrëdhëniet e saj me demokracinë
amerikane dhe socializmin sovjetik.
Diskutova gjithashtu edhe me Ruzhica me propaga-
ndën për botën e jashtme. E kërkova artikullin për
të mirat dhe dërgohen atyre të përkthyer në gjuhët e tyre
këtë propagandë të diskutimit dhe të përkthimit
shumë aktivitet.

**TË DEMASKOJMË DHE TË KUNDËRSHTOJMË
ME TË GJITHA FORCAT
ALEANCËN KUNDËRREVOLUCIONARE
SOVJETO-AMERIKANE**

Diskutova me Ramizin për artikullin që do të botohet nesër në «Zërin e popullit» për demaskimin e marrëveshjeve, që u arritën në Moskë në mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik¹.

Bisedova, gjithashtu, edhe në lidhje me propagandën tonë për botën e jashtme. Situatat, aktualisht, janë më të mira dhe duhet ta zhvillojmë, ta bëjmë më me mend këtë propagandë, të diferencuar dhe që të përmbledhë shumë aktivitete.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 251.

**BAZA NË KINË — SHTATË VJET PA UDHËHEQJE
PARTIE**

Ambasadori ynë në Pekin, vizitoi një provincë të madhe në veriperëndim të Kinës, qendër e rëndësishme e industrisë së naftës etj. Atje ai u prit shumë mirë, shumë ngrohtë dhe njerëzit flitnin me dashuri të madhe për Partinë tonë dhe për Shqipërinë.

Atje i folën për «të gjitha të këqijat e rrymës ekstreme të majtë». Ç'nuk i thanë: «Ata ishin kundër dhe sabotonin industrinë, teknikën, arsimin, kulturën, kërkimin të likuidonin kuadrot e vjetër deri në 40 vjeç, të cilët duhej t'i dërgonin të ruanin majmunët dhe t'i zëvendësonin me 20-vjeçarë». Dhe kjo është tekstualisht. Por ç'mendonin për politikën e jashtme, për Niksonin që vete në Pekin, ata nuk thanë asnjë fjalë, të majtët ekstremë sikur nuk kanë qenë fare të interesuar për këto probleme!

Ambasadori ynë konstatoi, dhe ata vetë i thanë, se komitete partie në vend, në fabrika, në miniera nuk ka, nuk janë formuar. Po bëhen 7 vjet pa udhëheqje partie. Po parti vallë ka?!!

TITOJA NË MOSKË

Titoja, renegati i marksizëm-leninizmit shkoi sot në Moskë. Në televizor pamë se ky «njeri i madh», siç e quan tash Moska, u puth e u përqaftua shumë herë me renegatët e tjerë të Moskosit. Duhet t'i demaskojmë si renegatë të marksizëm-leninizmit e të socializmit.

SHËNIM

Bisedova me shokët që ambasadori ynë në Pekin të marrë kontakt me Fan Jinë dhe t'i parashtrojë edhe një herë çështjen e kërkesave tona qeveritare që i janë bërë qeverisë kineze, të cilat ai mori përsipër t'i studionte dhe t'u gjente rrugëzgjdhje pozitive.

**PËRSËRI NDRYSHIME NË QËNDRIMIN
E AMBASADORËVE VIETNAMEZË**

Pas vizitës së Niksonit në Moskë tek ambasadorët e Vietnamit të Veriut dhe të Vietkongut shikohen qëndrime të ndryshme kundër sovjetikëve. Ata flasin më hapur me ambasadorët tanë, kritikojnë hapur revizionistët sovjetikë dhe i bëjnë fajtorë, pse ndihmojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po u hapen sytë. Më mirë vonë se kurrë!

**VIGJILENCË NDAJ ZHVILLIMIT TË NGJARJEVE
NË ITALI**

Italia fqinje vazhdon të jetë në krizë të madhe. Ajo ecën pa qeveri, në vend mbretërojnë anarkia, kriza ekonomike, banditizmi. Po përgatitet rruga e neofashizmit dhe e diktaturës fashiste. Duhet të jemi vigjilentë!

Revizionistët bëjnë përpjekje të mëdha për të shpërndarë në Evropë ideologjinë e tyre të dështuar. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për të shpërndarë ideologjinë e tyre të dështuar në Evropë. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për të shpërndarë ideologjinë e tyre të dështuar në Evropë. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për të shpërndarë ideologjinë e tyre të dështuar në Evropë.

I. T. ...

DIPLOMACI SEKRETE NË MES «KOMUNISTËVE» DHE IMPERIALISTËVE

Sovjetikët dhe amerikanët me siguri kanë biseduar gjerë e gjatë midis tyre në Moskë për Vietnamin dhe në dëm të tij. Të dy këta imperialistë të egër duan të dalin «me nder e me timi» nga kjo luftë, të përfitojnë të dy nga gjaku i derdhur prej popullit vietnamez. Çështja qëndron në presionet e ndryshme që do të përdorin të dy njëkohësisht mbi vietnamezët, për t'i gjunjëzuar ata. Amerikanët do të vazhdojnë të përdorin armën e luftës dhe të terrorit, kurse sovjetikët demagogjinë, presionet dhe shantazhet e prerjes ose të «vështirësive» në furnizimin e të ashtuquajturave ndihma për Vietnamin.

Sigurisht, çdo gjë varet nga qëndrimet e vietnamezëve. Deri tash vietnamezët po luftojnë kundër amerikanëve dhe u rezistojnë sovjetikëve. Tash në Hanoi, si edhe ambasadorët vietnamezë jashtë, flasin hapur për pakënaqësinë e tyre ndaj sovjetikëve, i dënojnë këta, gjë që nuk e bënin më parë. Siç duhet të rezultojë, përpara kësaj situatë që u krijua, krahu oportunist në Hanoi është në gjendje të vështirë dhe në minoritet. Ky minoritet aktual është i detyruar t'i nënshtrohet pikëpamjes së drejtë të shumicës që është për luftë deri në fitore, në bazë të 7 pikave. Për Kinën nuk flasin asgjë, por i kanë zbutur qëndrimet e ngurta që shkaktoi vajtja e Niksonit në Pekin.

Në datën 15 të këtij muaji vetë Podgorni do të shkojë në Hanoi për bisedime. Sigurisht, ai vete gjoja t'u flasë vietnamezëve për «qëndrimet heroike të sovjetikëve» ndaj Niksonit, për «kritikat e ashpra» që ata i bënë presidentit amerikan dhe që «asnjë lëshim» parimor nuk i lejuan vetes, jo vetëm për luftën e Vietnamit, por për të gjitha çështjet botërore që u diskutuan. E tillë do të jetë brendia e valixhes së kalit ukrainas, të tilla do të jenë bajgat që do t'u lëshojë ai në derë vietnamezëve. Sa do t'i hanë këto vietnamezët, është një çështje tjetër. Por prapa këtyre «beve e rrufeve» do të bëhen presionet dhe shantazhet në forma «këshillimesh të urta», gjoja «në pamundësitat që kanë krijuar situatat për të mos u ardhur ndihmat», «për mungesën e gatishmërisë së Kinës që këto ndihma sovjetike të kalojnë përmes tokës së saj» etj. Podgorni nuk do të mungojë t'u thotë vietnamezëve se gjoja Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në pozita të vështira dhe Niksoni dha shenja të dukshme se «po të lëshoni ju pak (sa për të shpëtuar nderin e tij), ai do të cedojë» dhe profka të tjera të tilla.

Ukrainasi Podgorni nuk do të mungojë të denigrojë Kinën në sy të vietnamezëve. Sigurisht, Podgorni do t'u thotë atyre se «Niksoni ka simpati dhe respekt për udhëheqësit kinezë, se këta janë marrë vesh me amerikanët për shumë probleme jetike të Azisë, se në Kinë u deklarua zyrtarisht se më 19 qershor do të vejë në Pekin Kisingeri për të vazhduar bisedimet që lanë Niksoni me Çu En Lain». Të gjitha këto bisedime të ardhshme kino-amerikane «Nënmali, — Podgorni» do t'ua bëjë vietnamezëve një mal shpifjesh. Sa do t'i hanë vietnamezët këto, është problem tjetër, siç është, natyrisht, problem tjetër i rëndësishëm vajtja e tretë e Kisingerit në Pekin.

Bisedat e përzemërta kino-amerikane vazhdojnë në Pekin në errësirën e madhe. Asgjë nuk pipëtin as për miqtë, as për kurrkënd. Diplomacia sekrete është në fuqi

në mes «komunistëve» dhe imperialistëve. «Bota, bile as miqtë, nuk duhet të dinë gjë ç'bisedojmë dhe ç'vendosim në, pse na prishin punë». Kësaj i thonë: «Bashkëpunojmë ngushtë nën rrogëz dhe jashtë hedhim disa fishekzjarrë ngjyra-ngjyra, mundësisht me disa ngjyra sa më të kuqe për të zbavitur galerinë».

E MARTË
13 QERSHOR 1972

SHPREHJE E POLITIKËS SË AFRIMIT ME AMERIKANËT

Kim Ir Seni i Koresë, ky oportunist me damkë, por që hiqet si «një marksist-leninist i madh», i dha një intervistë një gazete të madhe të Nju-Jorkut. Në këtë intervistë ai tregon fytyrën e tij të vërtetë të një pacifisti revizionist të kohëve aktuale. Kim Ir Seni pati paturpësinë që të pohonte se Koreja e Jugut nuk është një shtet kapitalist. Këtë e bëri për t'u bërë tërthorazi qejfin amerikanëve, për të rënë me ta në ujdi që të lejojnë bashkimin e Koresë në «rrugën paqësore». Thuhet se fshehurazi një kapitalist korean në Shtetet e Bashkuara, mik i Kim Ir Senit, po bisedon me Kisingerin.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet me Japoninë e Satos, Koreja e Veriut po i trash, natyrisht me ndërmjetësinë e të ashtuquajturave shoqëri të miqësisë në mes Koresë dhe Japonisë.

Këto qëndrime revizioniste as që na çuditin. Ne e dimë se kush është Kim Ir Seni, po mjerë shokët kinezë që nuk i kuptojnë ose nuk duan t'i kuptojnë.

**FASHISTËT MUND TË PROVOKOJNË SELINË
E AMBASADËS SONË NË ROMË**

Disa miq italianë njoftuan ambasadën tonë në Romë se fashistët kanë në mend të bëjnë një provokacion kundër selisë së saj. I lajmëruam shokët të jenë vigilentë dhe të marrin masa. Të venë, gjithashtu, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, ta denoncojnë këtë gjë, pa zbuluar burimin, dhe të bëjnë përgjegjëse qeverinë italiane në rast se ngjet gjëkafshë.

**PSE GJITHË KËTO FALËNDERIME
TË PËRSËRITURA?**

Shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme më vunë në korent se zyrtarisht, në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës, ambasada kineze na solli (kushedi për të satën herë) falënderimet e zjarrta për ndihmën e madhe që ne i kemi dhënë Kinës për pranimin e saj në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare, për eksperiencën e madhe që ne kemi, për ndihmën dhe bashkëpunimin e ngushtë që duhet të kemi etj., etj.

Vë pyetjen: Pse gjithë këto falënderime e lavdërime të përsëritura? Të shohim ku fle lepuri!

UJDI «E BUKUR» KINO-AMERIKANE

Gjermano-amerikani Henri Kissinger, këshilltari kryesor i fashistit Nikson, ka tri ditë që ndodhet në Pekin. Vajtja e tij në Kinë u njoftua me një lajm të shkurtër nga Pekini dhe nga Uashingtoni. Ky lajm thoshte se «do të bisedohet për probleme që interesojnë të dy vendet». Formulë e bukur, që do të thotë, me fjalë të tjera, «s'ka pse të interesohen të tjerët dhe të bëhen merak se çfarë do të bisedojmë ne; këto që bisedojmë ne, janë punë krejt të brendshme dhe të tjerët nuk duhet të interesohen për punët e brendshme tonat». Ujdi «e bukur» kino-amerikane! Dhe bisedimet vazhdojnë në fshehtësinë më të madhe, midis «engjëllit» Kissinger dhe Çu En Lait, mundet, kushedi edhe Maos, derisa punët janë sekrete.

Me «miqtë» pse të mbahen protokolle. Mund të zbatohen shumë lloj protokollesh: me shqiptarët, që kinezët thonë se i kanë «miq me kokë», zbatojnë protokollin e injorimit të plotë. Neve nuk na u tha gjë që do të vente Kissingeri në Pekin, pale se çfarë do të bisedohet. Ne e morëm vesh këtë nga shtypi. Diplomacia sekrete po vepron, si nga ana sovjetike, si nga kinezët, si nga amerikanët. Solidaritet i plotë në këtë çështje nga të tre. Pse t'i ngatërrojnë të tjerët, të shkretët, kanë nevojë të punojnë të qetë! Apo nuk punojnë «për të mirën» e botës e të popujve!!

Deri te gazetarët e Perëndimit, që janë aq kuriozë e

të sëmurë, s'pipëtin asgjë. Atyre u kanë vulosur gojën. Edhe këtë, sigurisht, e bëjnë «për interesat e paqes hyjnore botërore».

Sa keq për Kinën që po futet në këto kurthe të ndyrra! Amerika kapitaliste është bërë gjeli i diplomacisë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Ajo u dikton politikën dhe rrugën! Sa keq, sa keq! Deri kur popujt do të durojnë këto allishverishe mbi kurriz të tyre?!

SHËNIM

Bisedova me shokët për programin që është përgatitur lidhur me vizitën e Norodom Sihanukut, i cili vjen nesër dhe se si duhet të zhvillohen bisedimet zyrtare me të.

RRETH VIZITËS SË SIHANUKUT

Sot vjen për vizitë zyrtare delegacioni qeveritar i Kamboxhias, i kryesuar nga princi Norodom Sihanuk. Ai vjen nga Rumania, ku bëri vizitën e parë. Do ta presim edhe me popull në Tiranë. Princi vjen me një suitë të madhe, po jo më të madhe se ajo e Çausheekut kur shkoi në Pekin.

BISEDË ME SIHANUKUN

Sot prita në selinë e Komitetit Qendror Norodom Sihanukun, Kryetarin e Shtetit të Kamboxhias dhe pjesën kryesore të delegacionit të tij. Biseda kaloi e përzemërt. Sihanuku është personalitet i zgjuar, politikan realist dhe i vendosur në luftën për çlirimin e atdheut të tij. Foli me urrejtje të madhe dhe me vendosmëri kundër agresorëve amerikanë dhe klikës së Lon Nolit. Ai kishte besim të madh në fitoren e popullit të tij. Duke biseduar për Frontin e Bashkuar Kombëtar të Kamboxhias, Sihanuku foli shumë mirë dhe hapur për rolin e madh dhe vendimtar në luftë të komunistëve kamboxhianë. Pa dyshim ai duhet të ketë influencë në Kamboxhia dhe, pavarësisht se është princ, po i shërben çlirimit kombëtar fuqimisht. Shokët komunistë të Kamboxhias, për çështjen e madhe të çlirimit, kanë shumë interes të sillen drejt, korrektë dhe sinqerisht me të. Varet shumë edhe nga qëndrimi i tyre që Sihanuku të mos lëvizë nga rruga e miqësisë që ka zënë me ta.

TAKIM ME JENG SARIN

Sot në selinë e Komitetit Qendror, tok me Hysniun dhe me Ramizin, pritëm Jeng Sarin, i cili është pjesëtar i delegacionit që kryeson Sihanuku. Ky është anëtar i Byrosë Politike të KQ të Partisë Komuniste të Kamboxhias. Sipas tij, Sihanuku nuk e di që është komunist, por më duket se është e zorshme që ai të mos e dijë këtë. Sidoqoftë, shoku Sari kërkoi të na vinte në dijeni për luftën e partisë së tyre dhe ne, natyrisht, e vumë atë në dijeni për tonën. Shoku Sari fliste frëngjisht. Ai na informoi pjesërisht për formimin e partisë pse nuk i arriti koha. Shokët kamboxhianë nuk kanë qenë dakord me Partinë e Punonjësve të Vietnamit si për datën e formimit të partisë kamboxhiane ashtu edhe për prejardhjen e saj (nga ish-Partia Komuniste Indoneziane). Na foli, gjithashtu, për organizimin e ushtrisë dhe të Frontit. Unë ndërhyra dhe i fola për eksperiencën e Frontit tonë, i tregova të përfitojnë, sa të jetë e mundur më shumë, nga genia e Sihanukut në Front. Jeng Sari do ta vazhdojë bisedën me Hysniun, me Ramizin dhe me shokët e tjerë.

SHËNIM

Mbrëmë shtruan një darkë për nder të Sihanukut. Ai foli shumë mirë edhe për Shqipërinë, por edhe për qëndrimet e tij politike dhe luftarake kundër agresorëve amerikanë. Duke ngrënë vazhduam me të bisedimet politike mbi problemet aktuale ndërkombëtare, për Kinën, Vietnamin dhe Laosin. Biseduam, gjithashtu, rreth kulturës dhe artit në Kamboxhia e në Shqipëri. Sihanuku i pëlqeu këngët dhe vallet shqiptare që ekzekutuan artistët tanë në këtë darkë.

PODGORNI NË HANOI DHE KISINGERI NË PEKIN.

Udhëtim i sinkronizuar nga diplomacia amerikane. Çështja e Vietnamit është problemi kyç për t'u zgjidhur, natyrisht, në favorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në dëm të Vietnamit.

Të dy kalanderët, që u nisën njëri nga Moska, tjetri nga Uashingtoni, kanë harmonizuar rolet: sovjetikët mbajnë tezën se «vietnamezët i nxit në luftë Kina», amerikanët avazin tjetër «vietnamezët i nxit në luftë Bashkimi Sovjetik». Këto dy teza puqen në një dhe kanë për qëllim të tregojnë se «vietnamezët luftojnë për mustaqet e Çelos». Pra, sipas këtyre banditëve, vietnamezët vriten dhe digjen kot, nuk kanë fituar dhe nuk do të fitojnë gjë dhe se rruga e tyre e vetme është: «Të bien në ujdi me amerikanët, sipas kushteve amerikane».

Për hir të kësaj gënjeshtre dhe për të bërë presione e shantazhe mbi vietnamezët, nga Moska për në Hanoi u nis Podgorni pa bujë, si cub. Asgjë s'u dha në shtypin sovjetik për nisjen e Presidentit të Sovjetit Suprem të Bashkimit Sovjetik, kurse Hanoi e priti dhe njëkohësisht e injoroi krejtësisht.

Gënjeshtarët revizionistë sovjetikë, para vajtjes së Niksonit në Moskë, u kishin premtuar vietnamezëve se do t'u dërgonin raketa moderne me qitje të gjatë. Mirëpo, kur mbërriti Niksoni, natyrisht pasi u morën vesh me të, jo vetëm dërgimi i raketave u pezullua, por edhe i mate-

rialeve të tjera luftarake që u kishin premtuar. Për këtë arsyeja u gjet: bllokada e porteve vietnameze nga minat amerikane. «**Si mund të përpiquej sovjeti të çante bllokadën? Kjo do të thoshte të goditeshin nga amerikanët, kjo do të ishte flaka e luftës bërthamore!**», «**Tavarishi, u marrrosët?! Mos doni të djegim jorganin për një plesht? Po revolucioni botëror, po socializmi, po komunizmi që po ndërtojmë ne në Bashkimin Sovjetik?!**». Të gjitha këto, natyrisht, duhen kuptuar drejt. Revizionistët gjykojnë kështu: «**Miqësinë me imperializmin amerikan ne nuk e sakrifikojmë, ne kemi rënë në ujdi të rrojmë në paqe dhe në miqësi me të, kemi ndarë sferat e influencës, të cilat i mbrojmë me bombat tona, që i kemi në numër kolosal dhe që mund t'i lëshojmë lehtë mbi të tretët që do të ngrenë krye dhe nuk do të na binden. Sot bombat amerikane i hanë vietnamezët dhe mirë t'u bëhet, ne heshtim. Nesër bombat tona, sovjetike, do t'i hajë dikush tjetër në kurriz dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të heshtin. Në mes miqve ky qëndrim është diçka e natyrshme**».

Kështu që, pas vajtjes së Niksonit në Kremlin, raketat u hoqën nga listat dhe pas kthimit të Podgornit nga Hanoi, raketat u kthyen në 5 topa dhe pesë kamionë për t'i tërhequr! Por edhe këto kur të mbërrijnë!

Vietnamezët nuk i pranuan propozimet e Podgornit, se ato qenë propozime amerikane të shoqëruara me shantazhet dhe me kërcënimet sovjetike. Ata qëndruan në 7 pikat e tyre. O luftë deri në fund, deri në fitore, o pranimi nga amerikanët i të 7 pikave vietnameze. Kjo ishte një shuplakë e rëndë për Podgornin, i cili u largua nga Hanoi «me bisht në shalë». Derisa kalanderi sovjetik, «i dërguar i posaçëm i amerikanëve në Hanoi», ishte në bisedime me vietnamezët, Niksoni ndaloi bombardimet mbi Hanoin, kurse, me t'u larguar miku i tij, ai i rifilloi bombardimet akoma më barbarisht.

Kisingeri nga ana e tij këndoi po atë këngë në Pekin, por «me avaz të përshtatshëm kinez». Ne e marrim me mend këtë «avaz», por kinezët, për të kaluar radhën, gjoja na vunë në korent «në vija të përgjithshme» nëpërmjet ambasadorit tonë në Pekin nga njëfarë Y Xhani, zëvendësministër i Jashtëm, i cili i tha se «nuk jam në dijeni me hollësi për bisedimet që u zhvilluan me Kisingerin». Natyrisht, kjo nuk është e vërtetë, por, edhe në qoftë se është ashtu, shko e vihu në dijeni të plotë, pastaj hajde na thuaj, në rast se ke vendosur të na informosh.

Por çfarë tha Y Xhani? Tha se nëpërmjet Kisingerit Niksoni siguroi kinezët që asgjë nuk u vendos kundër Kinës në Moskë, se Niksoni hodhi poshtë të gjitha insinuatat armiqësore të sovjetikëve kundër kinezëve. Me fjaltë të tjera, del se **amerikani paska mbrojtur Kinën kundër sovjetikëve! Pra, sovjetikët janë të këqij, ndërsa amerikanët qenkan miq të Kinës! Hajde ç'kohë kanë ardhur!** Prandaj, sipas Y Xhanit, Kisingeri kërkoi që të venë sa më shumë amerikanë në Kinë dhe të zhvillojnë tregti. Kinezët u përgjigjën: «Do të lejojmë të vijnë amerikanë në Kinë, por do t'i zgjedhim vetë, kë duam ne (kinezët)»!

Për Vietnamin Y Xhani tha se Kisingeri në të kaluarën gjoja u kishte folur se amerikanët duan ta mbarojnë luftën sa më parë, por vietnamezët janë «kokëfortë». Dhe kinezët i bënë të ditur Kisingerit tezën «e njohur» të tyre, sipas së cilës çështja e Vietnamit duhet të zgjidhet në Konferencën e Parisit.

E tërë kjo ishte biseda e Y Xhanit! Mizerje!!

DO TË PËRKRAHIM REZOLUTËN E RDP TË KORESË NË OKB

Këshillova shokët e Ministrisë së Jashtme që zëvendësministrit korean, që ka ardhur apostafat nga RDP e Koresë, t'i thonë se do ta mbrojmë rezolutën e tyre që do të paraqitin sivjet në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Ne nuk do të bëhemi bashkautorë të saj, për arsye se do të jenë edhe revizionistët sovjetikë, por do t'u rekomandojmë miqve tanë që të bëhen, duke ua shpjeguar arsyen përse ne nuk bëhemi vetë. U rekomandova që fjalimi që do të mbahet për këtë problem nga ana jonë në OKB të argumentohet mirë.

SË SHPEJTI VJEN MINISTRI I BUJQËSISË I RP TË KINËS

Më lajmëruan se ambasadori kinez u ka thënë shokëve të Ministrisë sonë të Bujqësisë se ministri kinez i Bujqësisë që vjen këto ditë në Tiranë, do të bisedojë me ta për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizimit të bujqësisë sonë. Kjo është një ndihmë e madhe që mund të na jepet. U thashë shokëve që ta studiojnë mirë këtë problem me specialistët e bujqësisë dhe jo vetëm nga zyra.

RRETH PERSONALITETIT TË SIHANUKUT

Kinezët kanë frikë se mos Sihanukut i bëjnë ndonjë atentat në të gjitha ato vende që do të vejë. Çdo gjë mund të ngjasë, por unë mendoj se amerikanët kanë më shumë interes ta bëjnë me vete atë sesa ta vrasin. Në këtë drejtim Jeng Sari «kishte frikë se Titoja, i cili e ka ftuar të çlodhet nja pesë ditë në Brioni, do ta përpunojë». Po ashtu kinezët kanë informata se princi ka ftuar dy oficerë të sigurimit francez gjoja ta ruajnë në Jugosllavi. Punë e qelbur prej princi! Ta merr mendja, çdo gjë mund të kurdiset e të pritët prej tij.

Sihanuku i ka thënë Jeng Sarit se «këto bisedime që bëjnë këta tre të mëdhenjtë¹, mos bëhen gjë edhe në kurriz të Kamboxhias?». Jeng Sari e ka siguruar që Kina kurrë nuk mund ta bëjë këtë, ajo është armike e imperializmit amerikan dhe e sovjetikëve. Sa i bindur është mbreti i Kamboxhias për këtë, është tjetër punë. Sigurisht edhe ai do të përpiqet të manovrojë në mes fuqive. Mbretërit këtë punë e kanë në gjak, ata shiten e bashkohen me klasën e tyre, por mendimi im, nga bisedimet e pakta që bëra me Sihanukun, është se ai paraqitej i vendosur për luftë, miqësor dhe i hapët me ne.

Unë i fola veçanërisht se ai për çlirimin dhe për rindërtimin e atdheut duhet të mbështetet, në radhë të

¹ Është fjala për bisedimet Kinë-SHBA-BRSS.

parë, në forcat e brendshme. Asnjë besim dhe asnjë iluzion ai nuk duhet të ketë as te socialimperialistët sovjetikë. Po ashtu asnjë besim nuk duhet të ketë në kapitalizmin botëror, duke i përmendur Francën dhe Japoninë. Të gjithë këta, i thashë, janë ujë që ju kanë pirë gjakun, ju kanë luftuar dhe prapë këtë punë do të bëjnë kundër jush. Ata nuk pyesin se ju jeni mbret, princ o kryetar shteti. Kurse ne shohim te ju një patriot të shquar e të vendosur, që ju preokupon çështja e popullit, jeni një princ liberal dhe demokrat, prandaj jemi me ju, ju përkrahim dhe do të përkrahim deri në fund popullin tuaj, Frontin e Çlirimit etj.

Nga përshtypja e jashtme mua m'u duk se ai mbeti shumë i kënaqur, i entuziazmuar dhe plotësisht dakord.

DURRËS, E SHTUNË
1 KORRIK 1972

ARRITI DELEGACIONI I BUJQËSISË SË RP TË KINËS

Sot arriti në Tiranë delegacioni i bujqësisë së RP të Kinës i kryesuar nga ministri i Bujqësisë Shan Fe. Në delegacion bën pjesë një grup specialistësh i përbërë prej 19 vetash. Te ne ndodhet edhe një grup tjetër mekanikësh kinezë për bujqësinë. Këta paraqiten të disponuar të na ndihmojnë.

Ministri vetë nuk është specialist i bujqësisë, por oficer tankist. Kështu i kanë kinezët ministrat e tyre. Do të rrinë deri nga 20 korriku. Do t'i pres edhe unë ndonjë ditë.

DURRËS, E MARTË
4 KORRIK 1972

POPULLI KOSOVAR NUK DO TË JETË KURRE MIK I TITISTËVE

Udhëheqja e Kosovës, duke ndjekur vijën e «Borbës» e të Tanjugut, nuk mungoi t'i përgjigjej, nëpërmjet gazetës «Rilindja», artikullit të «Zërit të popullit»¹, që demaskonte vajtjen e Titos në Moskë. Nga ana jonë ky ishte një demaskim ideologjik, kurse nga ana shtetërore ne nuk e ngitnim Jugosllavinë, veçse i tërhiqim vëmendjen në rrezikun që paraqit Bashkimi Sovjetik ndaj Jugosllavisë, në drejtim të cenimit të pavarësisë dhe të sovranitetit të saj.

Ne i kuptojmë pozitat delikate të gazetës «Rilindja», deri diku edhe të udhëheqjes shqiptare kosovare, në përgjithësi. Por për sa i përket kësaj udhëheqjeje, realiteti nuk është se ata s'kanë si bëjnë ndryshe. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës janë titistë, kanë bindje titiste dhe e mbrojnë atë që thonë se «çdo gjë që kemi fituar, e kemi fituar në sajë të Titos». Natyrisht, në sajë të Titos populli i Kosovës u vra, u shtyp, u persekutua, u dëbua në Turqi dhe po dëbohet edhe sot e kësaj dite nga vendi i tij në emigracion. Udhëheqja shqiptare kosovare nuk kupton ose nuk dëshiron të kuptojë se gjendja e sotme

¹ Është fjala për artikullin me titull: «Frazeologjia «leniniste» nuk mund ta maskojë antileninizmin», «Zëri i popullit», 15 qershor 1972.

në Kosovë nuk u detyrohet «dëshirave e qëllimeve të mira» të Titos, po rrethanave katastrofike që krijoi ai, krizës së madhe nga e cila vuan Jugosllavia. Në këto kushte të vështira për të, Tito kapitalisti preferon hëpër-hë t'i ketë shqiptarët e Kosovës më mirë «miq», sesa armiq. Por Titoja popullin shqiptar të Kosovës nuk do ta ketë kurrë mik. Miq ai do të ketë në Kosovë disa individë shqiptarë, të cilët i ka duaxhinjtë e tij dhe servilë njëkohësisht. Me anën e tyre mendon Titoja të gënjejë kosovarët.

Është pra për këtë arsye, dhe kjo shpreh pikëpamjen servile të udhëheqjes kosovare, kur na thonë në «Rilindje» se «kur atakohet Titoja, atakohen shqiptarët e Kosovës». Na marrshin të keqen e shqiptarëve të Kosovës dhe tonën. As ne, as kosovarët, nuk kemi dert dhe s'duam t'ia dimë nga të pëlliturit e titistëve shqiptarë. Këta kujtojnë se do të na frikësojnë dhe do të na imponojnë pikëpamjet e tyre revizioniste dhe antishqiptare. Edhe në Kosovë, me siguri, artikulli i «Rilindjes» ka bërë efektin e kundërt të asaj që priste udhëheqja kosovare.

Këta udhëheqës titistë kosovarë mendojnë se, edhe pas zhdukjes së Titos, gjendja e tyre, pale e Kosovës dhe e popullit të saj, do të vazhdojë të jetë «e favorshme». Ata mendojnë se kjo udhëheqje e stisur nga Titoja, në momente krize, do të vazhdojë të dominojë dhe të udhëheqë Jugosllavinë jashtë dhe në kundërshtim me rivalitetet e klaneve të ndryshme kapitaliste, jashtë rivaliteteve nacionaliste, aq shumë të acaruar qysh tash, pse ato janë pjella e regjimit kapitalist titist. Pas Titos këto rivalitete nacionaliste do të bëhen politika dominuese në Jugosllavinë posttitiste. Nacionalizmi serb është më i fuqishmi dhe, kur themi nacionalizmi serb, do të thotë serbomëdhenjtë. Këta, qoftë me emrin Rankoviç, qoftë me emrin Nikeziç, merret fare lehtë me mend ç'duan

të thonë për Kosovën dhe për kosovarët. Serbët do të dominojnë, por dhe ustashët kroatë nuk do t'i hedhin armët. Titoja këta i goditi, ai goditi, gjithashtu, edhe Rankoviçin, por që të dyja palët janë gjallë, organizojnë, bile luftojnë edhe me armë. Pardje Tanjugu njoftoi se banda ustashësh të armatosura në male të Hercegovinës, ranë në përpjekje dhe «u asgjësuan» nga forcat e sigurimit dhe të ushtrisë. Domethënë hyri edhe ushtria në veprim! Kurse për rankoviçistët prapë Tanjugu thotë se ministri i Punëve të Brendshme i Jugosllavisë denoncoi veprimtarinë e tyre antishtetërore.

Këto situata udhëheqësit shqiptarë të Kosovës nuk i kuptojnë, ose nuk duan që t'i kuptojnë. Unë mendoj se më shumë nuk duan t'i kuptojnë, pse tash fare lehtë, në një mënyrë ose në një tjetër, mund të na thoshin se «këto situata i kuptojmë fare mirë, fare drejt, por jemi të detyruar të bëjmë politikë dhe të përfitojmë nga kjo koniunkturë e krijuar për të konsoliduar pozitat e shqiptarëve të Kosovës në vendin e tyre». Një gjë të tillë ata s'po e bëjnë dhe si zor ta bëjnë. Ne nga ana jonë do të ndjekim vijën tonë të drejtë edhe ndaj Jugosllavisë, edhe ndaj Kosovës, edhe ndaj renegatit Tito.

Ne do ta ndihmojmë Kosovën me të gjitha forcat tona dhe brenda mundësive që na lejojnë rrethanat politike.

DURRËS, E MËRKURË

5 KORRIK 1972

IMPERIALIZMI AMERIKAN DHE REVIZIONIZMI SOVJETIK — PËRGJEGJËS PËR GJENOCIDIN NË VIETNAM

Njerëzimi duhet të dënojë si kriminelë lufte si imperialistët amerikanë, ashtu edhe revizionistët sovjetikë për gjenocidin në Vietnam.

Lufta barbare e hitlerianëve amerikanë kundër popullit heroik vietnamez vazhdon me furinë më të tërbuar. Barbarët amerikanë kanë ndarë rolet me kukullat e Sajgonit. Këta të fundit dhe populli i Vietnamit të Jugut me vite të tëra janë kthyer në mish për top në kasaphanën amerikane. Ata u grinë në fushat e betejave tokësore. Teoria nixoniane e vietnamizimit të luftës është në veprim me kohë, pavarësisht se kukullat e Sajgonit nuk kanë asnjë fitore në shportën e tyre. Fashistët amerikanë nga ana e tyre luftojnë me armën e aviacionit. Qëllimi i amerikanëve është të vrasin sa më shumë vietnamezë, nga të dyja palët dhe të djegin e të shkatërrojnë plotësisht Vietnamin e Veriut dhe të Jugut. Hitleri nuk kishte qëllime të ndryshme dhe nuk vepronte ndryshe. Fashistët, racistët, s'janë veçse barbarë imperialistë. Të tillë janë dhe amerikanët.

I tërë aviacioni amerikan, me gjithë forcën e tij goditëse, po bombardon ditë e natë Vietnamin e Veriut dhe të Jugut. Me vite të tëra bombarduesit më modernë bëjnë nga dyqind e nga treqind ekskursione në ditë dhe

lëshojnë bomba mbi çdo gjë, mbi objekte civile, mbi qytete, mbi fabrika e spitale, mbi diga e mbi pyje, mbi shkolla e mbi lagje të populluara. Numri i bombave të hedhura deri tash mbi Vietnam, ia ka kaluar shumë numrit të bombave që janë harxhuar gjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore nga të gjithë ndërluftuesit. Fuqia më e madhe agresive e botës është hedhur kundër një shteti dhe një populli të vogël! Por ky popull i vogël reziston, lufton heroikisht dhe e ka vënë në pozita të vështira, në pozitat e disfatës, këtë shtet agresor imperialist.

Përpara kësaj tragjedie të tmerrshme bota bën sehir. Imperializmi amerikan intrigon kudo, bën demagogji, bën shantazhe, kërcënon, blen e shet plaçka nga të gjithë, blen ndërgegjegen e gjithë atyre që shiten në tregjet e tradhtisë. Ka shumë e shumë të tillë që lëshojnë lotë krokodili për krimet që kryhen në Vietnam. Ata gjoja qajnë ditën, kurse natën bisedojnë e puthen me fashistët amerikanë. Dhe të gjithë këta tradhtarë të popujve thonë se këto i bëjnë për të shpëtuar botën nga lufta. Kur lufta zien, këta thonë se shpëtojnë njerëzimin nga vdekja, kurse njerëzit grihen nga bombat. Këta tradhtarë dhe xhelatë popujsh po mbushin atmosferën me mjetet e tyre që nga bombat, dollarët e rublat e deri te parullat false për paqen. Kush e kush përpiqet të bëjë propozime për mbledhje e takime të fshehta dhe të hapëta, të bëjë propozime konferencash e traktatesh për «Sigurimin evropian», për «Sigurimin aziatik», për «Sigurimin afrikan», për «sigurim» kudo! Por asgjëkundi s'ka dhe s'do të ketë siguri. Në botë është përhapur mania e lëvizjeve të mëdha të udhëheqësve të ndryshëm të shteteve të çdo ngjyre e të çdo kallëpi. Të gjitha këto lëvizje kryhen për të dhënë përshtypjen se diçka po bëhet, diçka do të dalë kënde! «Pritni, popuj, mos lëvizni, mos u revolttoni, se çdo gjë do të ndreqet! Kini besim te ky e tek ai, kini besim tek ajo konferencë që po përgatitet,

tek ai takim i të mëdhenjve!» Po malet pjellin nga një mi! Zinxhirët për popujt po farkëtohen dhe vidhat shtrëngohen.

Tok me fashistët amerikanë janë në ujdi edhe fashistët sovjetikë. Një ndryshim ekziston në mes tyre, fashistët amerikanë janë më të guximshëm, kurse fashistët sovjetikë më dinakë, për arsye të maskimit. Ata veprojnë njësoj me maska të ndryshme. Fashistët amerikanë bombardojnë Vietnamin, fashistët sovjetikë kërkojnë ta gjunjëzojnë. Të parët janë armiq të hapët, të dytët armiq të maskuar. Gabimi i madh i Ho Shi Minit dhe i vietnamezëve ishte dhe është se u besonin e u besojnë renegatëve sovjetikë, se kanë besuar e besojnë në «miqësinë» e tyre false, se kanë kujtuar e kujtojnë se ia kishin nevojën ndihmës së tyre materiale dhe ushtarake. Por historia tregoi se çfarë miqsh janë revizionistët sovjetikë. Ku janë bombardierët sovjetikë për Vietnamin? Ku janë kaçabombardierët sovjetikë modernë për Vietnamin? Ku janë raketat moderne sovjetike për Vietnamin? Jo, s'ka të tilla për Vietnamin! Qielli i Vietnamit duket, do të minohet nga amerikanët! Qielli sovjetik duhet të ruhet, toka, pasuria dhe njerëzit sovjetikë duhet të ruhen! Përse të ruhen!? Për luftën e fundit, për «mbrojtjen e paqes»!

«Kemi përgjegjësi të madhe përpara njerëzimit», — tha tradhtari Podgorni në Hanoi, kur shkoi tash së fundi si i dërguar i Niksonit. «Kemi përgjegjësi që të mos shpërthejë lufta bërthamore. Amerikanët janë të përgatitur shumë mirë ushtarakisht dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kontradiktat me aleatët e tyre. Në rast se ne i acarojmë punët me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë këta dhe aleatët e tyre do të shtrëngojnë radhët kundër nesh etj.», — tha Podgorni.

Tradhtarët s'kanë as dinjitet, as turp. Me fjalë të tiera, revizionistët sovjetikë u thanë vietnamezëve: «Dorëzohuni, ne nuk mund t'ju ndihmojmë, amerikanët janë

të fortë. Mirë t'ju bëhet, në rast se vazhdoni luftën!». Poshtërsia s'ka fund.

Vietnamezët kanë filluar të flasin ca kundër sovjetikëve, por këtë e bëjnë me gjuhë të vogël dhe vesh më vesh, kurse sovjetikët përfitojnë nga heshtja e tyre publike dhe, me gjithë këtë tradhti të madhe, në shtyp, në radio, me «gramafonat» e tyre si Kastroja me shokë, bëjnë zhurmë shurdhuese se po e ndihmojnë luftën e Vietnamit. Edhe këta janë kriminelë lufte. As më të vogël orvatje nuk ndërmarrin për të çarë bllokadën e porteve vietnameze. Vetëm të akuzojnë Kinën dinë të bëjnë. Por edhe Kinës mirë t'i bëhet, se u dha armë armiqve. Ishte e dënueshme prania e Niksonit në Pekin në ato kushte që ekzistonin marrëdhëniet në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sidomos të pranosh kriminelin e luftës, Niksonin, në një kohë kur ky vret e pret vietnamezët, djeg e përvëlon Vietnamin, këtë e dënon dhe do ta dënojë rëndë historia e njerëzimit, pavarësisht se Kina pa kursyer e ndihmon nga ana tjetër Vietnamin. Por Kina mund të thotë se «e priti Niksonin për interesa të mëdhenj botërorë, për të thelluar kontradiktat e dy superfuqive, për të evituar goditjen e saj nga Bashkimi Sovjetik, për të bërë tregti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës» etj., etj. Të gjitha këto i thonë edhe sovjetikët me forma të tjera. Por Vietnamit është ndërgjegjja e botës që lufton për liri e për pavarësi kundër imperializmit, kundër fashizmit, kundër barbarisë. A je për këtë luftë dhe me këtë luftë apo nuk je? Kjo është çështja e madhe dhe kësaj çështjeje nuk mund t'i bëhet dredhi.

NJË AMBASADOR QË HIQET SI KOMUNIST

Më raportuan për bisedën e ambasadorit të Kongo-Brazavilit, me rastin e paraqitjes së letërkredencialeve. Ky ambasador është i akredituar edhe në Beograd. Hiqet komunist, ka mbaruar universitetin në Francë, pastaj shkoi e dubloi studimet edhe në Moskë 4 vjet, në universitetin «Lumumba». Merret me mend çfarë komunisti mund të jetë ky. Është ambasador i «një shteti që ndërton socializmin», siç thonë, por gjysma e Komitetit Qendror të «partisë komuniste» me udhëheqësin kryesor janë burgosur nga pjesa tjetër që është në fuqi. Gjoja kjo është një çështje e brendshme, nuk ka gisht i huaji. Ata që janë brenda, duan të heqin qafe influencën franceze dhe të orientohen nga «Kina e nga Bashkimi Sovjetik», kurse pala tjetër që është në fuqi thotë «dakord, por jo përnjëherë, javash-javash». Me një fjalë të hamë në shumë grazhde dhe të kemi shumë flamurë.

GJETËN JUGOSLLAVËT TITISTË TE NE KISHË KU TË FALEN

Ambasadori ynë në Beograd na njofton se, përveç artikujve në shtypin e Beogradit e të Kosovës që i përgjigjeshin artikullit të «Zërit të popullit» për Titon që vajti në Moskë, e thirrën në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në mes muhabetëve të tjera «për miqësinë e për tregtinë», i protestuan butë edhe ata për atë artikull. Ai u dha përgjigjen e duhur se «polemikën ideologjike ne nuk e pushojmë, kurse për ngjarjet ndërkombëtare do të themi kurdoherë mendimin tonë, siç e thoni edhe ju, pavarësisht se kjo ju pëlqen ose jo. Ne nuk sulmojmë as Federatën Jugosllave dhe as marrëdhëniet tona shtetërore, të cilat nga ana jonë bëjmë përpjekje t'i zgjerojmë». Gjetën jugosllavët titistë te ne kishë të falen!

SHQIPËRIA NUK ËSHTË HAN ME DY PORTA

Ministri i Punëve të Jashtme i Sihanukut lajmëron, si pa gjë të keqe, nga Algjeri që, kur të kthehet Sihanuku nga Jugosllavia në Shqipëri para se të vejë në Kinë, do të bëjnë një aktiv me studentë kamboxhianë që duhet të vijë te ne nga Franca, Çekosllovakia, Hungaria dhe Rumania. Kush janë këta studentë? Kush i zgjedh dhe kush i nis? As na thuhet gjë, as edhe emrat e tyre bile s'na jepen, që të mund t'u japim vizën. Ministri i Jashtëm i Sihanukut e merr Shqipërinë si han me dy porta, ku mund të hyjë kushdo. Por, vetë Sihanuku dhe shokët kinezë na kanë rekomanduar që gjatë vizitës së Sihanukut te ne asnjë kamboxhian të mos lejohet nga jashtë. Si bëhet kjo? Prandaj i thashë ministrit tonë të Jashtëm të lajmërojë ambasadorin e Kinës në Tiranë që të vërë sa më parë në dijeni Pekinin dhe nëpërmjet këtij të njoftohet për këtë Sihanuku, i cili është në Mauritani, ku ne nuk kemi ambasador. T'i thuhet që ne për çështje sigurimi për të, nuk jemi për një «aktiv» të tillë sa kohë që Sihanuku do të jetë te ne. Ndryshe vetë Sihanuku dhe shokët kinezë duhet të marrin përgjegjësinë. Në këtë rast kamboxhianët duhet të na i kërkojnë zyrtarisht me letër, ku të specifikohen edhe emrat e të gjithë atyre që do të vijë. Përndryshe kërkesën nuk e pranojmë.

NJË «IDE GJENIALE» PËR BASHKIMIN E KORESË QË U LEVERDIS IMPERIALISTO-REVIZIONISTËVE

«Bashkimi i të dy Koreve»¹, i trumbetuar me aq bujë nga «udhëheqësi i madh i 40 milionë koreanëve», «ka marrë aprovimin dhe bekimin» e udhëheqjes reaksionare të Seulit, të imperialistëve amerikanë që kanë pushtuar Korenë e Jugut, të militaristëve japonezë të Tokios dhe të gjithë reaksionit aziatik dhe evropian.

Kinezët, zyrtarisht, nëpërmjet gojës së vetë Çu En Lait, e aprovuan këtë «vendim gjenial» të Kim Ir Senit, që sipas disa ambasadorëve të Kinës, kjo çështje «i zuri në befasi», kurse sipas zërave të agjencive të huaja, kjo u bë në marrëveshje me kinezët, ndërsa sovjetikët, po sipas këtyre zërave, nuk u pyetën fare. Natyrisht, kjo tezë e fundit, duke marrë parasysh megalomaninë e Kim Ir Senit, mund të jetë e vërtetë, por mund edhe të mos jetë e vërtetë, po e përhapur apostafat për t'i dhënë më shumë kredi gjestit «të udhëheqësit të madh të 40 milionëve». Në fakt, ai është «udhëheqësi i madh» i vetëm 10 milionëve, kurse të 30 milionët e tjerë janë në letër, se komandohen prej të tjerëve.

Që ideja e bashkimit është një gjë pozitive dhe që duhet luftuar për të, kjo nuk ka asnjë dyshim. Por si do të arrihet ky bashkim në këto situata, të brendshme dhe

¹ Plani i Kim Ir Senit për bashkimin e Koreve nuk u realizua.

ndërkombëtare, në lidhje sidomos me Korenë e Jugut? Sipas «udhëheqësit të madh», bashkimi duhet të arrihet pa marrë parasysh ekzistencën e dy rendeve të ndryshme, «socialiste» dhe kapitaliste, pa marrë parasysh ideologjitë e ndryshme dhe çdo gjë që ka rezultuar prej tyre. «Të bashkëjetojmë, të marrim për bazë gjakun, vëllazërimin, trungun», të krijojmë me një fjalë një hibrid të ri korean origjinal.

Amerikanët e duartrokitën këtë «ide gjeniale», natyrisht duke shtuar se ata kanë interesat e tyre në Korenë e Jugut dhe nuk janë të dispozuar të heqin që andej forcat ushtarake. Kim Ir Seni vuri si kusht të «bashkimit» mosndërhyrjen e të huajve në këtë problem korean. Kjo natyrisht është dëshira e Kimit dhe jo e amerikanëve dhe e reaksionit botëror. Në këto koniunktura «udhëheqësi i madh i 40 milionë koreanëve» nuk bëri veçse të vërë në zbatim vijën amerikane dhe të kapitalizmit botëror, që përpiqen të infiltrojnë në vendet revizioniste nën maskën e tregtisë, të bashkëpunimit, të shkëmbimit të ideve e të tjera. Me fjalë të tjera, «prishja e murit të Berlinit» korean u bë me dëshirën dhe gjenialitetin e «udhëheqësit të madh». S'kanë përse të mos e duartrokasim amerikanët dhe reaksioni botëror këtë «shembull të shkëlqyer» për gjermanët e Lindjes, për bullgarët, çekët, polakët e të tjerë që lëpijnë buzët për një kockë amerikane. Rumunët janë në kulm të gëzuar! «Bashkimi i popujve të ndarë, do të bëhet pa çak, pa bamb, pa dallim feje dhe ideje, jemi vëllezër, asgjë s'na ndan»!

«Udhëheqësi i madh i 40 milionëve» me këtë «veprim gjenial» u thotë kështu vietnamezëve: «Pse luftoni kot, pse po derdhni gjak e digjeni! Ndiqni mësimet e mia! Puthuni me Sajgonin, pavarësisht pse ata janë vrasës, kapitalistë dhe së toku u thoni amerikanëve, siç u thashë unë, mos u përzieni në punët tona të brendshme!

Nuk e shikoni si ecin punët? Të gjithë janë miq me amerikanët, piqen, puqen, puthen, venë e vijnë, marrin kredi, atëherë ne pse duhet të bëjmë ndryshe? Luftërat revolucionare, luftërat çlirimtare, luftërat parimore marksiste-leniniste tash janë të demoduara!».

Të gjitha këto «mësime» i kanë brenda «veprimet gjeniale të Kim Ir Senit», i cili është një antimarksist i urryer, një renegat, një oportunist dhe një megaloman i tillë — një Sin Man Ri i dytë. Natyrisht, këtu shprejnë të arrijnë edhe amerikanët, edhe japonezët, në mos me këtë, me një tjetër si ky. Kim Ir Seni mendon që nëpërmjet osmozës të gëlltitë Jugun, por edhe Jugu me amerikano-japonezët po këtë strategji do të ndjekin. Kush do të fitojë? Sigurisht Kim Ir Seni do të humbasë në këtë lodër të rrezikshme, pse ai nuk është marksist, nuk është parimor, pse ai është megaloman dhe pse nuk e ka atë fuqi ekonomike që kanë Jugu dhe imperializmi amerikan. Do ta ndihmojnë Bashkimi Sovjetik dhe Kina? Kjo varet, do të shohim qysh dhe sa. Në qoftë se ndjekim «logjikën» e Kimit cilido nga këta do të shikojë interesat e tij dhe në fakt që tani po i shikojnë fare mirë.

Kimi po hyn nga një rrugë gjoja e paangazhuar në një rrugë të angazhuar ose, për të qenë më ekzakt, në vend të dy partnerëve që kishte deri sot (Bashkimit Sovjetik dhe Kinës), me të cilët luante në litar dhe në mes të dyve herë pizmoset me njërin, herë me tjetrin, po që të dy i zhvat, tash po hyn në marrëdhënie me një dashnor të tretë, të modës e të pasur! Kështu Kimi, me «ide në e tij gjeniale», e vuri veten si «veshka në mes të dhjavit». Situatat po komplikohen në Lindjen e Llargme. Revizionizmi modern po zhvillohet dhe po forcohet, imperializmi amerikan po kthen mbeturinat armiqësore të tij, në miqësore. Po flitet gjoja kundër imperializmit amerikan, por po lidhen me të, po merren vesh; po flitet

kundër revizionizmit sovjetik, por po ecet në gjurmët e tij ideologjike, politike, ekonomike dhe ushtarake.

Në këto kushte asgjë e mirë nuk do të dalë, kontraktat duken sikur mëlcohen, dhe në fakt po mëlcohen, po kjo është e përkohshme, ato do të thellohen, ato do të pëlcasin, asgjë s'do të qëndrojë e qetë, revolucioni do të çajë, me gjithë armiqtë e egër dhe dinakë të tij.

DURRËS, E ENJTE

13 KORRIK 1972

VIETNAMEZI DHE «MIQTË E MËDHENJ» TË TIJ

Vietnamezët vazhdojnë të luftojnë heroikisht dhe me luftën e tyre kanë fituar dashurinë dhe admirimin e gjithë popujve të botës. Ata po bëjnë sakrifica të mëdha në njerëz dhe në materiale. Atdheu i tyre është djegur e përvëlur nga bombardimet amerikane, që nuk bëjnë dallim për asgjë. Është një ndeshje për jetë a për vdekje. Kjo e bën luftën e popullit heroik vietnamez jo të zakonshme, por një luftë me karakter ndërkombëtar, pavarësisht se ajo duket si e izoluar në gadishullin indokinez. Fakt i madh historik është se një popull i vogël po i reziston me sukses dhe i shkakton disfata të pandreqshme të njëpasnjëshme, politike dhe ushtarake, fuqisë më të madhe agresive të kohës sonë, imperializmit amerikan. Luftën kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës vietnamezët e filluan, pasi mbaruan atë kundër japonezëve dhe më vonë kundër francezëve. Ata e filluan me armë e pa armë, me armët e tyre të pakta, me trofetë, por armiku i huaj duhej dëbuar nga vatrat e tyre.

Në ato kohë të fillimit flirti i Hrushovit me amerikanët kishte nisur të dukej dhe ne e kuptonim ku do t'i dilte tymi. Ne nuk na gënjenin rodomontadat hrushoviane kundër amerikanëve, ato ishin «grindje të fejuarish» rishtas, që përgatitnin «muajin e mjaltit», siç e përgatitën. Shumë shokë të huaj nuk i kuptuan kundërshtimet tona me Hrushovin e kompani, i morën ato «si

zemërimi kalamanësh» që dalin nga «mbikëqyrja dashamirëse dhe e drejtë e baba Hrushovit». Dhe një nga këta shokë ishte edhe Ho Shi Mini, i cili vrapoi «të na vinte në ndihmë», pa na pyetur, «të na merrte nga krahu dhe të na çonte t'i puthnim dorën gjysh Hrushovit». I ziu xhaxhi Ho, me shpirtin e tij të butë, nuk kuptonte asgjë se ç'po luhej për fatin e Bashkimit Sovjetik dhe të komunizmit, as nuk parashikonte se ç'fat e priste vendin dhe popullin e tij nga kjo tradhti e Hrushovit.

Por, shokët vietnamezë, sido që të ishte, sido që e kuptonin (dhe e kuptonin gabim) konfliktin e madh në mes marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë, e filluan luftën çlirimtare kundër amerikanëve dhe kuku llave të Sajgonit.

Lufta e Vietnamit ishte konflikt i hapur me armë kundër imperializmit amerikan, ishte lufta e hapur në mes socializmit dhe imperializmit, ishte fillimi i një lufte të re nacionalçlirimtare, kundër kolonializmit të ri dhe më të egër që ka njohur njerëzimi. Pikërisht këtu vërtetë konflikti ynë i madh ideologjik dhe politik me hrushovianët. Ata ishin për kapitullim përpara kapitalizmit, ne jo; ata ishin për miqësi dhe aleancë me amerikanët, ne jo; ata ishin për çarmatosjen e popujve, ne jo; ata, në fakt dhe në teori ishin për shuarjen e luftërave nacionalçlirimtare të popujve, ne jo; ata ishin për bashkekzistencën revizioniste hrushoviane, ne jo; ne ishim për bashkekzistencën leniniste, e kështu për të gjitha problemet kyç të teorisë dhe të praktikës revolucionare.

Është e qartë se revizionistët sovjetikë nuk ishin për luftën çlirimtare vietnameze, ne ishim dhe jemi deri në fitoren e plotë, flas për ne, sepse për kinezët këta do t'i shohim dhe do t'i gjykojmë hap pas hapi.

Por hrushovianët dhe shokët e tyre, në pamundësi ta pengonin luftën, do të përpiqeshin ta sabotonin, ta përdornin atë si një gur shahu në lojërat e tyre ndër-

kombëtare, ta përdornin kundër Kinës si një zjarr të ndezur dhe të rrezikshëm në portat e saj, i cili mund t'u shërbente në planet e tyre të ardhshme djallëzore kundër Kinës.

Rëndësi për hrushovianët kishte çështja që lodra e tyre të mos demaskohej, duhej që ata të ruanin aparenecat se gjoja po e ndihmonin luftën e Vietnamit, se gjoja ishin kundër imperializmit amerikan. Ne ishim të vetmit që i demaskuam haptazi e deri në fund hrushovianët edhe në këtë drejtim. Po për Hrushovin kishte rëndësi të madhe që udhëheqja e Vietnamit të Veriut të mos i demaskonte, por, duke bërë luftë, «të bënte lodrën e tij», domethënë të vazhdonte ta quante Bashkimin Sovjetik revizionist «mikun e tij të madh, që e ndihmon me armë, me municione etj.». Kësaj gjëje Hrushovi ia arriti, se xhaxhi Hoja ishte në këtë vijë, ai nuk e shihte dot perspektivën e fitores së luftës së popullit të tij pa Bashkimin Sovjetik, ai nuk shihte se hrushovianët kishin tradhtuar kauzën e madhe të socializmit e të popujve. Kështu, në udhëheqjen vietnameze u krijuan, me siguri, dy mendime për luftën dhe për miqtë e vërtetë e të rremë, por kjo udhëheqje, e angazhuar në një luftë të pamëshirshme, «e konsideroi si taktikë të drejtë, që të gjithë ata që e ndihmojnë Vietnamin janë të tërë miq». Bile ata mendonin, siç mendonin dhe mendojnë sovjetikët, që, për hir të luftës së Vietnamit, të pushojnë polemikën, që për hir të luftës kundër amerikanëve të pushojnë polemikën (polemikë të cilën sovjetikët e kanë pushuar). Por ne nuk ramë në këto kurthe, vazhduam ta ndihmojmë pa rezerva Vietnamin dhe të demaskojmë revizionistët sovjetikë.

Por është e drejtë të thuhet, dhe kjo është një meritë e Ho Shi Minit, e udhëheqjes vietnameze dhe sidomos e popullit vietnamez, që deri tash nuk kanë rënë në kompromis me imperializmin amerikan. Ata, me gj-

thë presionet e mëdha nga «miqtë e mëdhenj» sovjetikë, nuk e pushuan kurrë luftën. Dhe këto presione kanë qenë të vazhdueshme. Edhe bisedimet e Parisit me siguri kanë qenë rezultat i këtyre presioneve, megjithëse vietnamezët thonë se është një taktikë e tyre. Sidoqoftë vietnamezët kishin shpresa te kjo «taktikë», sovjetikët ca më shumë. Tash kinezëve, pa e thënë, por ne e nuhatim se edhe atyre u pëlqen arritja e një kompromisi. Vietnamezët, aktualisht, kur shikojnë se Niksoni pritet me përzemërsi në Pekin e në Moskë, janë më pak entuziastë për këto «zgjidhje politike» dhe thonë, siç kemi thënë ne kurdoherë, se vetëm lufta vendos fitoren.

Në situatat aktuale, kur mizoritë e Niksonit kundër Vietnamit kanë arritur kulmin dhe nga ana tjetër tratativat e hapëta dhe sekrete në mes Niksonit, Brezhnjevrit dhe Çu En Lait janë «bukë e grunjtë», vietnamezët kanë filluar të zemërohen nga «miqtë e mëdhenj» dhe po flasin më shumë se ç'flitnin më parë kundër tyre. Por këto «të folura», natyrisht nuk janë qëndrime politike të hapëta publike. Ata na flasin neve, aprovojnë me entuziazëm qëndrimet tona, na quajnë miq të vërtetë etj.

Kanë të drejtë vietnamezët të jenë të pakënaqur nga «miqtë e mëdhenj»? Durim të madh kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë. Ata u zemëruan me kinezët kur shkoi Kisingeri dhe më vonë Niksoni në Pekin. Ata kishin plotësisht të drejtë të zemëroheshin dhe, sa dimë ne, protestuan. Kinezët, siç duket, u thanë se «qështjen vietnameze nuk do ta bisedojmë dhe ne do të vazhdojmë t'ju japim ndihmë si më parë, pavarësisht se ç'do të mendoni ju dhe ç'do të thoni për ne». Ky qëndrim i kinezëve s'ka qenë dhe nuk është një qëndrim i drejtë parimor. Në një kohë kur vëllezërve dhe shokëve u bëhet një luftë kaq barbare, ti pret dhe bën politikë me kryexhelatin e tyre. Nga ana tjetër, vëllezërve dhe shokëve u thua «materialisht do t'ju ndihmoj, por politikisht dhe ideologji-

kisht nuk ju ndihmoj dot». Dhe në fakt ndihma në këtë drejtim po bëhet e zbehtë, sa për të shkuar radhën. S'mund të qëndrohet dot në dy karrige dhe ta quash veten marksist-leninist. Këtë rol e luajnë plotësisht revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye.

Vietnamezët u zemëruan edhe ca më shumë me sovjetikët, kur vajti Niksoni në Moskë, pse ky i fundit u bëri edhe sfidën e bllokimit të porteve vietnameze, domethënë u preu sovjetikëve edhe atë rrugë që e përdorin sa për të pasur këmbët në Vietnam. Sovjetikët iu përgjigjën sfidës amerikane me marrëveshje të plota të shumanshme, si dy miq të mirë që janë. Në drej të vejë Vietnamit për ta! Niksoni dërgoi në Hanoi agjentin e tij, Podgornin, t'u vinte vietnamezëve këmbët në një këpucë. Por nuk ua vuri dot. Vietnamezët vazhduan luftën. Por mendimi im është se kjo që bënë vietnamezët nuk ishte e mjaftueshme, ata duhej t'u vinin sovjetikëve këmbët në një këpucë. Si ta bënin? Ultimatum! O sovjetikët duhej të vazhdonin të plotësonin me të madhe kërkesat e vietnamezëve me armë, si në sasi, si në cilësi dhe në kohë, nëpërmjet detit dhe, pra të çanin bllokadën amerikane, ose të demaskoheshin prej tyre si miq të rremë për vietnamezët dhe miq të vërtetë për imperialistët amerikanë. Le të zgjidhnin sovjetikët cilën rrugë të donin. Kështu vietnamezët lajmëronin në të njëjtën kohë edhe miqtë e tjerë.

Përveç këtij ultimatumit, «miqve të mëdhenj» duhej t'u viheshin këmbët në një këpucë edhe në luftën politiko-ideologjike efektive që duhej të bënin kundër imperializmit amerikan, pse t'i japësh disa armë Vietnamit, pa e ndihmuar politikisht, nuk shkon. Këtë gjë bënte edhe tregtari i armëve Zaharov në Luftën e Parë Botërore.

«Miq të mëdhenj» japin plot arsye demagogjike pse veprojnë ashtu dhe nuk veprojnë kështu. Në majën e

gjuhës e kanë «luftojmë për lirinë e popujve, luftojmë për paqen, luftojmë imperializmin, jemi leninistë» e plot slogane të tilla. Komunistët e vërtetë kurrë nuk duhet t'i lejojnë renegatët të gënjejnë komunistët dhe popujt. Renegatëve, tradhtarëve duhet t'u çirren maskat sa më parë, pse sa t'i lësh, aq më të rrezikshëm bëhen, forcohen dhe godasin më me forcë. Armikut as mos iu përul, as mos i trego shpinën, po tregoji gjoksin dhe pushkën!

DURRËS, E PREMTE

14 KORRIK 1972

TE MENDOJMË MË MIRË PËR MARRËDHËNIET TONA ME KINEZËT

Nga Ministria e Jashtme më njoftuan se nga muaji tetor vjen një delegacion kinez i shëndetësisë, me ministrin në krye. Por ky vjen pa ftuar, vjen se shkon në Rumani, ku është ftuar. Vizita e delegacionit të shëndetësisë nuk është pa qëllim politik nga kinezët. I qortova shokët e kësaj ministrie që nuk mendojnë t'i ftojnë. Kjo nuk është aspak e drejtë. Prandaj duhet të aktivizohet bashkëpunimi, se, pavarësisht nga mosmarrëveshjet që kemi për çështje parimore, vetëm me Kinën kemi lidhje të ngushta dhe këto lidhje ia lëmë spontaneitetit. Të mendohet të bashkëpunojmë tash në sesionin e OKB-së. Gjithashtu me krijimin e Akademisë sonë të Shkencave dhe për shumë fusha të tjera të vemi dhe të kërkojmë që edhe kinezët të vijnë te ne.

BISEDË ME DELEGACIONIN E BUJQËSISË TË RP TË KINËS

Sot prita këtu delegacionin e bujqësisë të Republikës Popullore të Kinës, i cili vizitoi vendin tonë gjatë njëzet ditëve. Siç më kanë thënë shokët, ai ka pasur përshtypje të mira dhe ka thënë fjalë të mira për zhvillimin e bujqësisë te ne. Ndenjën pak pse kishin pritje në Tiranë. Gjatë bisedës u thashë anëtarëve të këtij delegacioni se është e vërtetë që kemi bërë përparime në bujqësi, duke marrë parasysh gjendjen e prapambetur nga e cila jemi nisur, por ne jemi akoma prapa dhe duhet akoma më shumë ta zhvillojmë bujqësinë, ta mekanizojmë atë dhe të marrim masa të tjera të shumta për të ngritur më tej nivelin e jetesës së popullit, i cili është akoma shumë më i ulët në krahasim me vendet evropiane armiq që na rrethojnë. Duke ecur në këtë rrugë në çështjen e bujqësisë, ne në të njëjtën kohë duhet të vazhdojmë industrializimin e vendit dhe mbrojtjen e atdheut. E tërë kjo është e domosdoshme, imperative, në këto situata kur vendi ynë është i rrethuar me shtete armiq. Në këtë vepër të madhe ndërtuese, që duhet të kryejmë, faktori i brendshëm është vendimtar, por faktori i jashtëm, për ne ky faktor është vetëm Kina mike dhe aleate, është gjithashtu i rëndësishëm. Ndhima e Kinës është e domosdoshme. Kina këtë çështje e ka shikuar drejt nga ana politike, në radhë të parë, dhe ne jemi të bindur se

kështu do ta shikojë vazhdimisht. Me fjalë të tjera, i lashë të kuptojë qartë delegacionit kinez se ndihma për Shqipërinë nuk duhet të shikohet me «frymë tregtare», siç bëjnë disa shokë kinezë, por, në radhë të parë, «me frymën politike».

DURRËS, E MËRKURË

19 KORRIK 1972

NJË SHUPLAKË E RËNDË PËR SOCIALIMPERIALIZMIN SOVJETIK

Mbrëmë presidenti egjiptian Sadat mbajti një fjalim «të rëndësishëm», ku vuri në dukje konfliktin në mes Moskës dhe Kajros. Ai u ka kërkuar sovjetikëve armë ofensive «për t'i shpallur luftë Izraelit» dhe sovjetikët, për ta mbajtur Egjiptin në zap dhe në shfrytëzim të plotë nga çdo pikëpamje, natyrisht, kanë refuzuar. Atëherë Sadati po u bën atyre një shantazh politik, kërkon largimin e këshilltarëve sovjetikë nga Egjipti (dhe nuk janë pak, 20 000 veta) brenda 27 korrikut. Kjo është një shu-plakë e rëndë për socialimperializmin sovjetik, që shka-tërron planet e tyre, është një ngjarje me rëndësi të madhe. Të shohim ç'do të bëjnë sovjetikët, ç'manovra do të luajnë për të mos nxjerrë këmbët nga Egjipti, pse po iu dhanë dudat, do të jetë e zorshme që të kthehen shpejt. Pastaj me dëbimin e tyre, mbarojnë edhe rrenat e demagogjia «e mbrojtjes së popujve arabë», dhe flota e tyre në Mesdhe mbetet si peshku pa ujë. Do të shohim nga ana tjetër sa i vendosur është Sadati të qëndrojë në vendimin që mori.

Fakt është se dëbimi i sovjetikëve është një fitore për egjiptianët, pavarësisht se u duhet një kohë e gjatë që të çlirojnë tokat e pushtuara nga Izraeli. Por me sovjetikët brenda, këto toka nuk do t'i çlirojnë kurrë, jo vetëm kaq, por do të humbitnin dhe pavarësinë e vendit.

Politika jonë e drejtë dhe e vendosur i ka ndihmuar popujt arabë për të ruajtur lirinë, të cilën duhet ta ruajnë edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

DURRËS, E PREMTE
21 KORRIK 1972

GJENDJA NË LINDJEN E MESME KA QENË DHE MBETET E TURBULLT

Fjalimi i presidentit egjiptian Sadat, vazhdon të bëjë jehonë në botë. Pritej reagimi i sovjetikëve, i cili nuk mungoi të jepej me anë të një komunikate të agjencisë TASS. Natyrisht reagimi ishte sikur nuk kishte ngjarë asgjë alarmuese për ta, se kjo ndodhi «ishte një gjë e zakonshme, e rregullt», një marrëveshje «e përzemërt» që më parë në mes të dy shteteve. Kishin shkuar specialistë sovjetikë në Egjipt për të instruktuar egjiptianët, tash ata e kryen me sukses detyrën dhe kthehen në atdhe urtë e butë. Asgjë nuk ka ndryshuar në miqësinë aq të thellë e aq të sigurtë në mes Egjiptit dhe Bashkimit Sovjetik. Ky i fundit do të vazhdojë ta ndihmojë Egjiptin në mënyrë vëllazërore kundër Izraelit, për çlirimin e tokave të pushtuara prej tij etj., etj.

Me këtë gjuhë flet TASS-i përpara shuplakës që Bashkimi Sovjetik hëngri botërisht nga Egjipti. Këtë disfatë revizionistëve sovjetikë u duhet ta zbutin dhe arsye të qarta, që nuk lënë aspak të kuptohet se kanë qenë dakord për largimin e specialistëve, misioni i të cilëve, sipas deklaratave të Sadatit, s'ka qenë vetëm «të mësojnë ushtarët egjiptianë me armët e reja», por edhe të komandonin e të drejtonin shtetin egjiptian.

Pas komunikatës së TASS-it duhet të kenë arritur

dhe rublat e shumta sovjetike për Egjiptin», pse filloi «zbutja egjiptiane», qoftë nga komunikata e ambasadës egjiptiane në Moskë, qoftë nga kryeartikulli i «Al Ahramit», që «ekzaltojnë miqësinë sovjetike, ndihmën sovjetike etj.», që duan të thonë «rreshtohemi me tonin e TASS-it».

Siç duket, udhëheqësit egjiptianë pritnin një reaktion të fortë nga sovjetikët, por u qetësuan dhe tash që shantazhet kaluan, ata po veprojnë duke biseduar edhe me sovjetikët, edhe me amerikanët, edhe me francezët, por edhe me izraelitët prapa skenës. Sadati në këto situata po noton «dirisht», popullit e opinionit me fjalimin e tij i tha se «sulmi mbi Izraelin nuk u bë, se rusët s'na dhanë armë, kështu që duhet të gjejmë gjetkë, prandaj pritni sa të rregullohen burimet e tjera».

Specialistët sovjetikë thuhet se kanë filluar të ikin, por sa do të ikin, kush do të ikë dhe kur, nuk dihet, të shohim. Gjendja në Lindjen e Mesme ka qenë dhe mbetet e turbullt. Atje ka futur këmbët imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. Ata zor të largohen që andej me p... e Sadatit. Sado të zhurmshme që të jenë, ato janë dhe mbeten prapë p...

DURRËS, E SHTUNË

22 KORRIK 1972*

«KOMPLOTI I LIN BIAOS»

Më në fund, pas gati 11 muajsh, shokët kinezë, nëpërmjet ambasadorit tonë në Pekin, si dhe atij kinez në Tiranë, na vunë disi në korent zyrtarisht për «ultra të majtë» ose për «komplotin e Lin Biaos».

Shokët kinezë na thanë afërsisht këto gjëra:

Tani ne (kinezët) themi se ultramajtistët u demaskuan plotësisht dhe kryesori, rrënja e tyre ishte Lin Biaoja. Ky ngrinte flamurin e kryetarit Mao kundër kryetarit Mao. Gjatë Revolucionit Kulturor ai krijoi një vijë në formë të majtë, por në esencë të djathtë, duke dashur të përmbyste diktaturën e proletariatit dhe të restauronte kapitalizmin në Kinë. Po të njëjtin qëllim kishte dhe Liu, por ky, siç duket, hodhi në dorë partinë dhe po restauronte kapitalizmin (këtë mënyrë veprimi shokët kinezë e quajnë të djathtë!), kurse Lin Biaoja, nëpërmjet Revolucionit Kulturor, donte të merrte fuqinë dhe të vendoste kapitalizmin (këtë mënyrë veprimi shokët kinezë e quajnë ultra të majtë).

Lin Biaoja, thanë shokët kinezë, ishte element tipik me dy faqe. Ai që më parë, në kohën e Van Minit e përkrahu këtë, por ishte i ri. Atëherë ky veprim i tij u quajt një gabim nga papjekuria. Pastaj ai u bashkua me Maon, mori pjesë në marshimin e gjatë, bëri edhe gjëra të mira, por bëri edhe gabime gjatë punës, të cilat i korrigjoi. Lin Biaoja ka qenë kundër luftës së Koresë dhe

dërgimit të vullnetarëve kinezë atje. Në dukje ai i ka pranuar gabimet e tij, por, nga ana tjetër, ka minuar gjithçka që ishte në interes të partisë. Kur kryetari Mao shpërtheu Revolucionin Kulturor, ai mbajti flamurin e kryetarit Mao, por në fakt punonte për vete.

Gjithashtu ata na thanë: Kryetari Mao nuk ishte dakord me vlerësimet dhe me lëvdatat e Linit për idetë e Maos dhe për veprën e tij. Gjithë ato lëvdata që e ngri- nin Maon në qiell, ishin antimarksiste, se e vinin atë mbi marksizëm-leninizmin, se ushtarët dhe oficerët kinezë var- nin në qafë portretet e Maos, se përulëshin çdo mëngjes përpara portretit të Maos dhe përpara po këtij portreti bënin autokritikë (si përpara ikonave të Krishtit).

Të gjitha këto ne, shqiptarët, i dënonim si marrëzira idealiste dhe antimarksiste kur i merrnim vesh, kurse udhëheqja kineze i toleronte, saqë kërkonte t'i impononte edhe jashtë. Ne jo vetëm nuk i pranuan kurrë këto ve- prime, por që në shfaqjet e para të Revolucionit Kultu- ror i dënuam me neveritje.

Vlerësimi se «idetë e Maos janë maja më e lartë e marksizëm-leninizmit» ose se «ai është marksist-leninist më i madh i ditëve tona» etj., që thoshte Lin Biaoja (dhe e hanin të tjerët), ishte idealist. Kinezët thanë se gjoja Maoja e ka kritikuar me kohë për këtë dhe Lin Biaoja e ka pranuar kritikën, por në fakt ka vazhduar punën për t'u paraqitur si më përkrahësi dhe më besniku i Maos.

Në fakt ai ka komplotuar tri herë për të vrarë Maon, thonë kinezët, por neve na folën vetëm për njërin, për atë që djali i Lin Biaos, zëvendëskomandant i aviacionit, kishte formuar një grup prej 100 vetash, me të cilët do të vriste Maon dhe Çu En Lain, do të zaptonte selinë e Komitetit Qendror dhe do të rrëzonte pushtetin e dikta- turës së proletariatit.

Lin Biaoja akuzohet se gjatë Revolucionit Kulturor nxiti elementët armiq për të bërë sabotime kundër par-

tisë dhe për të ndezur luftën brenda ushtrisë. Ai kishte krijuar një grup besnik rreth vetes, pjesëtarët e të cilit i bënë lajka për ta ngritur atë.

Shokët kinezë thanë se që në fillim Maoja i diktoi thëniet e Linit, por jo veprimet intrigante të tij. Këto veprime komplotuese dolën në shesh dalngadalë, sidomos pas Kongresit të 9-të të Partisë Komuniste të Kinës. Siç dihet, në këtë kongres u aprovua vendimi që Lin Biaoja të ishte pasardhësi i kryetarit Mao. (Edhe këtë gjë, si të gjitha të tjerat, ne, shqiptarët, e kemi dënuar me kohë.) Lin Biaoja, duke parë se Mao Ce Duni ishte mirë me shëndet, kishte frikë se nuk do ta merrte dot stafetën, prandaj kurdisi «komplotin për ta marrë sa më shpejt pushtetin».

Lin Biaoja, na thanë kinezët, e ndiente se Maoja do t'i kuptonte këto, prandaj në Plenumin e 2-të të KQ të vitit 1970 grumbulloi grupin e tij për të bërë grusht shteti. Në këtë kohë sovjetikët bënë provokacionin në Usuri dhe sollën 300 000 ushtarë në Mongoli në kufi me Kinën. Domethënë këto ishin veprime të koordinuara. Në këtë grup bënte pjesë edhe Çen Po Taja, por Maoja e zbuloi këtë dhe e frenoi komplotin. Çen Po Taja u demaskua (këtë na e kanë thënë vetë shokët kinezë). Kundër Lin Biaos nuk u bë gjë. Maoja thonë se punoi për ta shpëtuar Linin. Mirëpo nga të dhënat del se ai nuk u diktua, por u kritikua për disa gabime dhe vazhdoi të grumbullonte njerëzit e tij për të bërë kryengritje të armatosur.

Kur komploti u zbulua, më 13 shtator 1971, në mëngjes, ai u arratis me aeroplan në drejtim të Bashkimit Sovjetik, por aeroplani u rrëzua në Mongoli dhe u dogj. Vajza e Lin Biaos, 5 orë para se të ngrihej avioni, lajmëroi Çu En Lain se po arratiset i ati. Maoja paska thënë: «Lëreni të arratiset». Komplotisti Huan Jun Shen, për të fshehur gjurmët, propozoi që ta rrëzonin aeropla-

nin me raketa, por i ndaloi Maoja, pse do të akuzoheshin që e vranë dhe fakte që ta akuzonin nuk kishin. Brenda në avion ishte Lin Biaoja, gruaja e tij dhe djali, piloti, pa shturman dhe pa radist, dhe disa persona të tjerë pa rëndësi, gjithsej nja tetë a nëntë veta.

Pra, sipas shokëve kinezë, me t'u zbuluar komploti, Lin Biaoja donte të shkonte në Bashkimin Sovjetik dhe demaskoi kështu vetveten. Avioni u dogj në tokë, se i mungoi karburanti. «U vërtetua se rryma ultra e majtë ishte kurdisur dhe nxitur nga Lin Biaoja dhe parullat për të përmbysur Çu En Lain, Çen Jinë, Jeh Çen Jinë ishin lëshuar nga ai».

«Domethënë, me demaskimin e Liu Shao Çisë, të Lin Biaos e të komplotistëve të tjerë nga Revolucioni Kulturor, thanë shokët kinezë, partia u spastrua, ajo doli më e fortë dhe me ndërgjegje më të lartë në luftën midis dy vijave dhe në luftën klasore».

Në grupin e besuar të Lin Biaos bënë pjesë Huan Jun Shen, Li Huo Feni, U Fa Hsieni, Cin Hui To, të cilët janë arrestuar. Kinezët na thanë se «për këtë çështje ne nuk kemi thënë asgjë publikisht; për të tjerat, presim ç'do të thonë sovjetikët». (Sovjetikët, ta merr mendja, se nuk do të thonë asgjë, sepse nuk duan as vetë të komprometohen, por as Lin Biaon s'duan ta komprometojnë. Kinezët mund të presin gjatë po të duan.) «Kurse në vendin tonë thanë shokët kinezë, këtë e dinë të gjithë dhe të gjithë janë sqaruar. Jashtë nuk kemi thënë asgjë. Në partinë tonë kanë ndodhur 10 herë situata të rrezikshme të luftës midis dy vijave, por kjo këtë herë ishte më e rrezikshmeja e më seriozja. Rryma ultra e majtë tash është demaskuar definitivisht. Revolucioni Kulturor u zgjat për arsye e sabotimit të Lin Biaos». Ata shtojnë se «Organizata numër 516 u quajt kundërrevolucionare, sepse Komiteti Qendror më 16 maj 1966 nxori një dokument të përpunuar nga Maoja për Revolucionin Kulturor që ishte

një thirrje për përmbysjen e Liu Shao Çisë. Lin Biaoja, përveç përmbysjes së Liut, shigjetat i drejtoi edhe kundër Komiteti Qendror, për ta përmbysur atë dhe pastaj të merrte fuqinë». Gjatë Revolucionit Kulturor, thanë shokët kinezë, kishte gjëra që nuk i kuptonin as ata. Mësimet e Maos nuk zbatoheshin, sepse Organizata 516 ishte kundërrevolucionare. Dokumenti i 16 majit të vitit 1966 u punua brenda në parti, kurse më 16 maj 1967 u botua publikisht, që masat ta studionin mirë (pas një viti?!).

Shokët kinezë thanë se Lin Biaoja u demaskua pak nga pak, se ai punonte në prapaskenë. «Kemi pasur shumë sabotime në marrëdhëniet me jashtë, edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme kishte grupe që udhëhiqeshin nga idetë e Organizatës numër 516. Edhe ne, po edhe Mao Ce Duni, — thanë shokët kinezë, — i kishim kuptuar qëllimet e Lin Biaos, por nuk mendonim që ai do të bënte komplot të hapët. Lini nuk ka folur shumë, po ka punuar fshehur».

«Raporti në Kongresin e 9-të vetëm sa u lexua nga Lin Biaoja». (Çudira! Nënkryetari i partisë qënkej pllakë gramafoni!)

Kjo na ishte tërë historia e komplotit të Lin Biaos, që shokët kinezë mezi na e thanë, pas gati një viti. E ç'gjë të fshehtë dhe misterioze kishte këtu, që Partisë sonë, që e konsiderojnë shumë të afërt, të mos i thoshin të paktën faktet kryesore të ndodhisë dhe të tjerat të na i thoshin më vonë, pasi t'i analizonin? Por ne, kaloi dhe kjo si të tjerat. Ne s'kemi pse të mos i besojmë këtij versioni që na japin shokët kinezë. Ne e gjejmë të mundshme të ngjasë një gjë e tillë, bile të kurdisen edhe komplete më të rrezikshme që mund të konkludohen me katastrofa për diktaturën e proletariatit dhe për socializmin. Kjo mund të ndodhë në rast se humbet vigjilenca revolucionare, nëse partia nuk është në binarët e marksizëm-leninizmit, në qoftë se ajo edukohet në frymën idealiste

të kultit të personit dhe jo në bazë të dialektikës materialiste dhe të materializmit historik.

«Komploti i Lin Biaos» ka qenë me të vërtetë i rrezikshëm dhe ca më i tmerrshëm, sepse ky, siç del, nga ato që na thonë shokët kinezë, «ka qenë i lidhur ngushtë me sovjetikët». Lini pra «kishte qenë një agjent i tyre, tok me gruan dhe me bashkëpunëtorët e tij».

Po prapë shtrohen pyetjet: Si u la dhe bëri gjithë këto gjëra Lin Biaoja?! Si ky njeri, që kishte bërë gabime, të vijë në krye të Partisë, të pompohej kaq shumë?! Si lejohej Çen Po Taja, njeri që na u tha se ç'ishte, të vihej në krye të Revolucionit Kulturor?! Si nuk u ndaluan me kohë «të gjitha ato gabime të mëdha» që u bënë gjatë Revolucionit Kulturor?! Thonë se nuk i kuptuan! Por këto bënin «mu...u», i kuptonim ne këtej nga larg, që nuk dinim shumë gjëra dhe që nuk ishim në dijeni të direktivave që lëshoheshin e jo më ata!

Fakt është se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte në «këmbë», ajo, në mos e likuiduar, ishte e paralizuar dhe direktivat e Maos, thonë shokët kinezë, nuk zbatoheshin. Kush t'i zbatonte? Komplotistët? Kuptohet që këta nuk do t'i zbatonin, përkundrazi do t'i sabotonin. Në qoftë se shokët kinezë nuk u venë deri në fund këtyre analizave që të zbulojnë shkaqet e vërteta dhe të gjejnë ilaçon e vërtetë marksist-leninist, asgjë nuk do të shkojë drejt në Kinë, atje do t'u ngjasin gjëra të tjera edhe më të rënda. Ata thonë se u kanë ndodhur 10 herë të tilla ngjarje. Kjo do të thotë se këto atje janë bërë traditë, vijë. Mund të ngjasin, vend i madh, parti e madhe! Mirëpo nga të gjitha këto të këqija shokët kinezë nuk kanë nxjerrë mësimet e vërteta. Njëri pas tjetrit grupet në udhëheqje po grinden, po goditen, po rrëzohen. Sa rrëzohet njëri, ngrihet i dyti, bie edhe ky, ngrihet tjetri. Bëhen shpjegime në parti, vetëm Maoja qëndron bajrak. Të gjithë luftojnë me bajrakun e Maos, po bajraku i tij

nuk shkrihet me atë të partisë që ky të valojë. Mund të luftohet idealizmi me fjalë, por kulti i Maos nuk është tjetër veçse idealizëm. Ai, në vend që ta forcojë partinë, ta bëjë vetëvepruese, drejtuese, e mpin, e bën automate. Zgjdhjet bëhen vetëm kur pyetet Maoja të thotë fjalën, por se si do ta thotë ai këtë fjalë, kjo varet nga ata që ia diktojnë.

Siç duket, aq sa kemi mundësi të gjykojmë nga të dhënat, Maoja dhe shokët kinezë mendonin se Revolucioni i Madh Kulturor Proletar duhet të mbaronte brenda vitit pa çak, pa bam. Klika e Liu Shao Çisë, që kishte marrë mirë frenat në dorë (vetë Maoja u tha shokëve tanë se «nuk e dimë kush do të fitojë»), do të dorëzohej përnjëherë pa rezistencë. Koncept i çuditshëm për revolucionin dhe për luftën e klasave!!

Armiku të merr fuqinë dhe po vendos kapitalizmin dhe ti mendon se, duke përjashtuar çdo metodë dhune, do ta zhdukësh armikun. **Atëherë, kur ngjasin këto dhe janë fare të mundshme, ti i quan «ultra të majtë», pavarësisht se kush ishte Lin Biaoja. Por revolucionin drejtohej nga Maoja dhe në shtabin e revolucionit ishin edhe Çu En Lai, Kan Shen, Çian Çini e të tjerë. Këta ç'bënë? Ishin dakord me këto që bëheshin apo nuk ishin? Në qoftë se nuk ishin, pse nuk i ndalonin? Në qoftë se nuk i ndalonin dot, se Lini ishte i plotfuqishëm, atëherë nuk mund të thuhet që «nuk e kuptuam dot hilenë e Lin Biaos». Ta kuptosh hilenë e Lin Biaos në fund, kur vajza e tij vjen e të thotë se i ati do të arratiset, kjo tregon qorrllëk të madh, ideologjik dhe politik.**

Pastaj të mos e ndalosh Lin Biaon të arratiset do të thotë të kesh ide të çuditshme mbi armikun e klasës, mbi luftën e klasave. Kjo flet për idenë megalomane të shtetit të madh, që thotë: «Le të ikë ky armik, qoftë edhe Lin Biaoja; ai do të demaskohet». Kjo është e vërtetë, por që të mendosh se nuk ka ç'na bën, nuk është e drejtë.

Shumë «dinak» na paraqitet Lin Biaoja nga shokët kinezë, por ai nuk u tregua aspak dinak në komplotin dhe në tradhtinë e tij. Planet e tij për vrasjen e Maos dhe të Çu En Lait nuk duken të jenë aq të rafinuara; përkundrazi janë të trasha: grusht shteti me 100 veta, si në Amerikën Latine.

Lin Biaoja, sipas të dhënave kineze, na del si një agjent i thjeshtë i sovjetikëve të cilit ata i kanë vënë dy këmbët në një këpucë dhe i thonë: Vepro me çdo kusht, vrit Maon, merr fuqinë, se «Kina u bashkua me Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Mirëpo incidenti i Usurit ndodhi më parë se vizita e Niksonit në Pekin, për të cilën shokët kinezë nuk na thonë asnjë fjalë. **Ishte dakord Lin Biaoja për bisedimet me Kisingerin dhe për vendimet që u morën? Këtu ata heshtin, asnjë fjalë nuk thonë. Pse?! Mos vallë pse edhe ne ishim kundër vajtjes së Niksonit në Pekin, prandaj nuk na i thonë? Po, ne ishim dhe jemi kundër vajtjes së Niksonit në Pekin, për arsye krejt të ndryshme. Ne e mbështetim qëndrimin tonë në qëllime dhe në parime të drejta. Në qoftë se ata nuk na thonë gjë lidhur me këtë problem se mos ofendohemi ne, duke menduar se gjoja në këtë pikë ne qenkemi dakord me sovjetikët dhe me Lin Biaon, na marrshin të keqen! Në këtë rast ata, sovjetikët dhe Lin Biaoja, janë në pozita revizioniste, ultra të djathta, në pajtim me imperializmin amerikan dhe në grindje me njëri-tjetrin për të fituar një partner të fuqishëm imperialist. Pra, kjo pikë kaq e rëndësishme mbeti e pasqaruar për ne nga ana e shokëve kinezë. Po kjo nuk na çudit, se nuk është as e para dhe as e fundit.**

Politika drejt hapjes së dyerve për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në këto forma dhe mënyra që u bë nga kinezët, shënoi një kthesë të madhe. Nuk është e mundur që Lin Biaoja të mos ketë pasur dhe shfaqur mendimin e tij për këtë politikë. Ai e ka shprehur men-

dimin e tij. Deri në fund, të paktën me sa dimë ne zyrtarisht, Lin Biaoja ishte edhe kundër sovjetikëve, edhe kundër amerikanëve. Në këto pozita ishte edhe Kan She-ni. Vallë edhe ky ishte komplotist? Apo ishte ultra i majtë dhe qorr që nuk pa gjë se ç'po luhej rreth tij? E gjithë kjo është një pikë e errët për ne në shpjegimet që na dhanë shokët kinezë.

Çështja tjetër, përsëri ca e errët për ne, është orvatja e Lin Biaos për t'u arratisur me avion. Fluturim si shumë kuturu, fare i paorganizuar. Si ka qenë e mundur që Lin Biaoja, ministri i Mbrojtjes së Kinës, nënkryetar i partisë, ndaj të cilit «nuk kanë fakte», të mos e dijë se vajza e tij e ka denoncuar 5 orë më parë se ai të arratiset?! Si është e mundur që «njeriu sekret i sovjetikëve», sikurse është cilësuar, i cili ia besoi fluturimin të birit komplotist, por nënkomandant i gjithë aviacionit të Kinës, të zgjedhë një avion pa ekuipazh, pa karburantin e mjaftueshëm, pa radio dhe të bjerë në Mongoli e të digjet si një lodër fëmijësh?! **Veprime të tilla nuk bien erë të paktën si të atyre komplotistëve puçistë, si na thanë, që do të vritnin Maon, Çu En Lain, dhe do të merrnin çdo gjë në dorë me 100 veta. Si e çuditshme duket kjo ikje e nxituar e Lin Biaos, kurse bashkëpunëtorët e tij kryesorë dhe pezzo grosso qëndruan në vend, as lëvizën fare. Çudira!! Por të tilla çudira ngjasin në Kinë, ndaj s'kanë pse na çuditin edhe këto këtë herë. Te mija dhe qindi!**

• • Megjithatë, ka disa gjëra të çuditshme që të bëjnë të mendosh dhe të habitësh. Tash, ç'nuk thuhet për Lin Biaon edhe nga vetë kinezët. Siç duket, në Kinë të gjithë janë vënë në korent për këtë gjë. Edhe specialistët tanë të ndryshëm, që venë në Kinë, vihen në korent nga organizatat që i presin. Fondi është njësoj, por *fioriturat* ndryshojnë. Ç'nuk po thonë tash për të kaluarën e Lin Biaos!! Atëherë më tepër e më me forcë shtrohet çështja: Si qe e mundur të arrinte ky njeri deri në postet

që mbante? Mirëpo thuhet se Maoja i njihte gabimet e tij, e kishte kritikuar atë dhe donte ta ndreqte!! Atëherë duhej bërë nënkryetar i partisë dhe ministër i Mbrojtjes që të ndreqej ky njeri?! **Kjo nuk hahet!**

Kinezët tash thonë se «ai iku me aq shpejtësi, sa që harroi të merrte kapelën, dhe në avion nuk arriti të hipte dot me shkallë, por u kacavar, i ndihmuar nga brenda»!! Natyrisht, fakti që Lin Biaoja iku me aq shpejtësi «nga frika se mos e zinin», sillet si argument që të gjendet i arsyeshëm vazhdimi i versionit se avioni nuk kishte benzinë të mjaftueshme. Ngutja ishte, gjithashtu, arsyeja që avioni nuk kishte radist dhe shturman!! Këto gjëra nuk para gëlltiten dot! «Lin Biaoja u arratis, thonë, sepse e kuptoi që u zbulua komploti, që kur u demaskua Çen Po Taja». Mirëpo «ikja» e tij ndodhi muaj e muaj pas demaskimit të Çen Po Tasë dhe Lin Biaoja kishte aq mundësi «të ikte» jo një herë, por njëzet herë.

Nga ana tjetër, nënkryetarit të partisë e ministrit të Mbrojtjes të një Kine kaq të madhe dhe një «komplotisti kaq të rrezikshëm», si është e mundur t'i mungojë gjakftohtësia, sa të harrojë kapelën, t'i mungojë shkalla për t'u ngjitur në avion e ky të mos ketë lëndën djegëse të mjaftueshme për fluturim? Pastaj ky «komplotist i rrezikshëm» si iku dhe i la komplotistët e tjerë, shokët e tij në baltë? Nuk kishin ata mundësi të merrnin avionë nga pika të tjera dhe të çanin ferrën? Sigurisht, kishin. Pse s'e bënë edhe ata këtë gjë, po e bëri vetëm Lin Biaoja?

Po versioni tjetër: Mos e detyruan Lin Biaon të arratisëj dhe rrugës e likuiduan? Kamikaze!

Të supozojmë versionin sipas të cilit Lin Biaoja kishte shfaqur kundërshtime në vijën që po ndiqej, nuk e dimë në cilat drejtime, por ta zëmë në politikën që filloi të bëhej ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kundërshtarët e tij e cilësuan prosovjetik dhe të rrezikshëm.

Atëherë u vendos ta likuidonin. Fakte për komplot nuk kishin, por fakte krijuan dhe në këtë mënyrë u kurdis një komplot kundër tij. Ai u thirr me urgjencë në Pekin, hipi në avion dhe, kur pa se nuk po zbriste në Pekin, pyeti: Ku po shkojmë? Dhe, kur më vonë pa se ishin në Mongoli, ai dhe njerëzit e tij nxorën koburet dhe vranë veten. Ç'u bë brenda? «Avioni ra, u dogj». Asgjë nuk u mor vesh.

Një gazetë kanadeze informonte se «Kisingeri i kishte thënë kryeministrit kanadez që ekspertiza kishte vërtetuar se në karkasën e avionit janë gjetur shenja pre-dhash». Sa është e vërtetë kjo? Sovjetikët thonë të vërtetën apo gënjejnë? Mund të jetë e vërtetë, mund të jetë edhe gënjeshtër. Sovjetikët e kanë çelësin e këtij misteri! Por edhe u leverdis atyre të thonë një version të tillë, i cili e bën më të mundshëm çka ne supozuam më lart. Pse? — bëhet pyetja. Pse të kenë qëlluar brenda në avion?! Kush ka qëlluar dhe pse?! Vetëm Lin Biaoja ka qëlluar?! Edhe po të pranojmë këtë version, ai ka qëlluar sepse pa se po e çonin jashtë Kinës, në Mongoli (dhe jo në Bashkimin Sovjetik, siç thonë kinezët), kundër vullnetit të tij.

Të gjitha këto janë versione të supozuara, që i dikton paqartësia e fakteve që japin vetë kinezët. Zyrtarisht ne pranojmë të gjitha ç'thonë kinezët, por koha do të sqarojë çdo gjë.

DURRËS, E HËNË

24 KORRIK 1972

SIHANUKU NA NJOFTON PËR PRESIONET QË I KANË BËRË TITISTËT

Sot, në vilën e Durrësit, bëra një takim me princin e Kamboxhias, Norodom Sihanukun, i cili, pasi vizitoi Algjerinë, Mauritaninë dhe Jugosllavinë, u kthye për të pushuar disa ditë te ne dhe që këndej do të niset pastaj për në Kinë. Në takim ishin edhe disa nga shokët kryesorë të Partisë e të shtetit. Princi shfaqti dëshirën që me këtë rast të na vinte në korent për rezultatet e bisedimeve që zhvilloi me udhëheqësit e shteteve ku shkoi.

«E kam për detyrë miqësore, — tha ai, — që Çu En Lain dhe ju t'ju vë në dijeni për të gjitha mendimet dhe pikëpamjet që shkëmbeva me udhëheqësit e vendeve që vizitova, pse ju jeni miqtë më të afërt e më besnikë të popullit kamboxhian».

Ky ishte një gjest dhe një veprim shumë dashamirës nga ana e tij. Ne e falënderuam dhe biseda me të, që zgjati plot dy orë, si dhe dreka që u shtrua për nderin e tij pas bisedimeve dhe që zgjati edhe ajo plot dy orë, kaluan në një atmosferë shumë të ngrohtë miqësore, si të gjitha takimet e tjera, kur filloi vizitën zyrtare.

Sihanuku na foli pa rezerva për çdo gjë dhe përcaktimet e tij për problemet, për njerëzit me të cilët bisedoi, për propozimet që iu bënë, deri edhe në provokacionet e hapëta në drejtim të tij, na bindin edhe një herë për pikëpamjet e drejta politike të tij, për zgjuarsinë e tij në

politikë, si dhe për qëndrueshmërinë në pozitat që mban ndaj problemit të vendit të tij dhe problemeve ndërkombëtare.

Ai e filloi bisedën mbi Jugosllavinë, me takimin që pati me Titon. Ai i di fare mirë pikëpamjet tona për atë renegat, pse ia zhvilluam në takimet e mëparshme, nuk munguam t'ia përsëritnim edhe gjatë shkëmbimit të mendimeve që bëmë edhe sot me të. Ai nuk u zgjat për Titon, por u duk që ishte i pakënaqur, bile shumë i irrituar, jo nga Titoja, por nga bashkëpunëtorët e afërm të tij. Kjo, pa na e thënë, ishte pakënaqësi edhe ndaj Titos, pse Sihanuku duket *fin politique*¹ dhe e kupton mirë taktikën e Titos.

«Bëra, — tha Sihanuku, — një luftë homerike me bashkëpunëtorët e Titos, më mbanin me orë të tëra sa s'më linin as të flisja dhe as të veja në filmin që më organizoi Titoja. Bisedat dhe pikëpamjet e tyre, — tha Sihanuku, — ishin diametralisht në kundërshtim me të miat. Ato ishin provokacione të hapëta, bile më në fund e pohuan edhe vetë, kur u munguan argumentet.

Përpjekjet, kuptohej, qëndronin që unë të tregohejsha i pavarur nga Kina. Unë u thashë atyre, — theksoi Sihanuku, — se jam krejt i pavarur dhe ç'nevojë kam të deklaroj se jam i pavarur, kur në fakt jam i lirë dhe vete ku të dua, them hapur mendimet e mia dhe Kinën, Shqipërinë etj., i kam mike besnike? A mos ju, — u thashë jugosllavëve, — dëshironi të flas e të bërtas se «nuk jam me zgjebe, nuk jam me zgjebe» për t'i thënë opinionit se «me të vërtetë kam zgjebe», kurse në realitet jam i pastër? Apo mos dëshironi të bëj si Lon Noli që, për të vërtetuar se nuk është i marrë, tregon edhe raportin e firmosur nga tre doktorë amerikanë për këtë qëllim.

Jugosllavët më sugjeruan, — tha në bisedë me ne

¹ I Frëngjisht — politikan i shkathët, i zgjuar.

Sihanuku, — që ta vendos vendqëndrimin tim në Paris. Unë e hodha poshtë këtë sugjerim, — vuri në dukje ai. Në asnjë mënyrë unë nuk ngulem në Paris, — tha ai, — pse kësaj i thonë të ngulesh në mes të intrigave, të largohem nga populli im që lufton, të largohem nga miqtë dhe aleatët kinezë dhe të lejoj intrigantët imperialistë të luajnë me fatet e vendit tim. Jo, këtë nuk e bëj!

Më folën, gjithashtu, për mundësitë dhe përpjekjet që duhet të bëj për një marrëveshje paqësore me Lon Nolin dhe me amerikanët, të shkoj në një tryezë bisedimesh me ta. Ua hodha të gjitha poshtë me argumente, na informoi ai. U thashë se unë nuk luaj poker me fatet e luftës e të popullit, në tryeza, që të humbas 50 për qind të fitimeve. Më prunë shembullin e Vietnamit dhe iu përgjigja: Vietnamit në fushën e betejës fitoi qind për qind mbi imperializmin francez, shkoi më vonë në tryezën e Gjenevës dhe atje humbi 50 për qind të fitimeve. Konsekuenca e kësaj është lufta aktuale. Kurse bisedimet amerikano-vietnameze në Paris janë të kota, nuk japin gjë, janë para e humbur dhe unë nuk kam para për të humbur.

I atakova jugosllavët, — tha Sihanuku, — për çështjen e shteteve të paangazhuara. Çfarë është kjo që thoni ju në konferencat e këtyre shteteve që keni organizuar, u thashë, — tha ai, — ku keni ftuar ato shtete që manovrohen nga amerikanët dhe sovjetikët, ndërsa Sihanukun e disa të tjerë si ai që kanë qenë krijuesit e saj, por që luftojnë, ju nuk i ftoni në këto mbledhje? Ç'tregon kjo? Kjo është e qartë se dikush që nuk na do të mirën i luan fijen. Titoja, — tha Sihanuku, — në të ikur më foli se «do të rregullohet edhe çështja e njohjes suaj nga sovjetikët». Iu përgjigja Titos që as që më preokupon më një gjë e tillë. Kështu iu përgjigja edhe Çaushekut. I cili më këshilloi që t'i bëja një kërkesë të tretë Moskës për njohje. «I thashë Çaushekut se më unë nuk u lutem atyre», — përfundoi Sihanuku.

Nga të gjitha këto e të tjera si këto Sihanuku na e bëri të qartë se jugosllavët i bënë të gjitha presionet, po ky u rezistoi me sukses. Ato që ne i parashtruam për Titon dhe për titizmin ai i vërtetoi vetë me sytë e tij dhe Titoja doli kallp përpara tij, pavarësisht se nuk e zuri shumë në gojë në bisedime. Hapur qëllimi dhe përpjekjet e titistëve ishin që Sihanukun ta shkulin nga këto pozita, po dështuan.

Për algjerianët Sihanuku e shprehu hapur pakënaqësinë. Ai tha se «më fshehën nga populli, as e pashë atë dhe as më pa». Algjerianët më paralajmëruan se do të më bënin një pritje më madhështore se Kastros, por më fshehën dhe, kur e panë që edhe gazetate franceze dolën për këtë qëndrim, më dërguan në fund të shkretëtirës, në qytetin e Oranit, ku organizuan «një fantazi» arabe. Unë mendoj se Algjeria, me gjithë deklaratat, është nën influencën e Moskës, — vazhdoi Sihanuku. — Në paradë nuk pashë veçse armë sovjetike.

Kurse udhëheqja e Mauritanisë, — na tregoi ai, — është e mirë, mauritanezët më folën hapur, më thanë se '95 për qind e pasurisë së vendit të tyre është në dorën e kolonialistëve.

Edhe unë i fola atij për shumë probleme, për të cilat nuk është nevoja të zgjatem këtu se i morën sekretarët me stenogram, i përforcova atij mendimet e tij të drejta që puqeshin me tonat. E inkurajova, e mbështeta. I thashë, gjithashtu, mendimin tonë të disfavorshëm për deklaratën e Kim Ir Senit në lidhje me bashkimin e dy Koreve. Sihanuku ishte plotësisht dakord me ne.

Si konkluzion, mund të themi se Sihanuku mban qëndrime të drejta, është pozitiv dhe përparimtar dhe duhet ndihmuar e inkurajuar. Ne këtë bëmë dhe mund të themi se ia arritëm këtij qëllimi. Ai largohet i gëzuar dhe shumë mik me ne, ikën i përforcuar në mendimet e tij për vazhdimin e luftës së çlirimit të popullit kamboxhian.

DURRËS, E ENJTE
27 KORRIK 1972

SIHANUKU U LARGUA

I thashë Ramizit që të thërresë ambasadorin kinez dhe ta vërë në dijeni për t'ia bërë të ditur Çu En Lait rezultatet pozitive që patëm ne në bisedimet me Sihanukun. T'i vërë në dukje qëndrimet realiste dhe pozitive të Sihanukut në të gjitha problemet politike.

Sot u largua nga Shqipëria princi Sihanuk. Mendoj më se ai u largua me përshtypje shumë të mira nga vendi ynë. Shokët që e përcollën më thanë se këto ndjenja i shprehu shumë herë para se të hipte në avion, që e çon drejtpërdrejt në Kinë.

DY TË DHËNA PËR LIN BIAON

Të gjithë ambasadorët e Kinës, kudo që janë, marrin kontakt me ambasadorët tanë dhe po i vënë në korent për tradhtinë e Lin Biaos. Është i njëjti version që na është dhënë edhe zyrtarisht. Ka një nuancë të vetme nga ana e të ngarkuarit me punë të ambasadës kineze në Kili, i cili i tha ambasadorit tonë atje, se «miqtë e Maos e vranë Lin Biaon dhe avioni u rrëzua në Mongoli». Kjo gjë na thuhet për herë të parë nga ana e kinezëve dhe përkon me lajmin e një gazete kanadeze, e cila shkruan se Kisingeri, kur ishte në Kanada këtë vit, i paskësh thënë gjoja kryeministrit kanadez se në avionin e djegur kinez që ra në Mongoli, janë gjetur shenja predhash të shtira brenda në avion. Kjo do të thotë, sipas këtyre, se në avion duhet të ketë pasur përleshje me armë.

I ngarkuari me punë i ambasadës kineze në Kili bazohet në këtë të dhënë dhe nxjerr konkluzionin, apo e ka nga qendra e tij? Kjo nuk dihet. Ambasadorët e tjerë kinezë nuk flasin për një gjë të tillë.

VIZITA E NJË ZËVENDËSMINISTRI TË JASHTËM TË KINËS NË TIRANË

Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Çiao Kuan Hua, erdhi në Shqipëri për një vizitë pune, i ftuar nga Ministria jonë e Punëve të Jashtme për të diskutuar së toku, si aleatë që jemi, për problemet e sesionit të sivjetëm në OKB. Ai kaloi nga Rumania më parë se të vinte këtu. Atje pati bisedime me Maneskun. Në bisedimet me shokët tanë tha se «nuk u kënaq nga ato bisedime» dhe e shau Maneskun si maskara; se «Rumania ndjek një politikë si të një shteti kapitalist», se atje shokët e tij i lanë pa bukë dhe se do t'i thotë Çu En Lait se «avioni që fluturon në linjën ajrore nga Pekini, të vijë drejt nga Athina në Tiranë pa kaluar nga Bukureshti» etj.

Çiao Kuan Huaja qëndroi dy ditë në Tiranë, jo më shumë dhe kërkoi që asgjë të mos shkruhej në shtyp. Pse? Nuk dha arsye. Por, në të vërtetë, sipas thënieve të shokëve tanë, atij ia kishte shumë qejfi të mburrej. Megjithatë kjo s'ka rëndësi, gjëra të vogla. Ai pati bisedime me shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme, pastaj u prit edhe në Kryeministri.

Çiao Kuan Huaja erdhi te ne me pretekstin e ftesës sonë për të diskutuar për problemet e OKB-së dhe për një shkëmbim mendimesh mbi «horizontin ndërkombëtar». Mirëpo, në fakt, qëllimi i vërtetë i vizitës së tij ishte të «na vinte në korent» në mënyrë sibylline për

çështjen e Lin Biaos dhe «mbi taktikat e drejta» të politikës aktuale kineze në lëmin ndërkombëtar. Si me shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme, por veçanërisht me ata të Qeverisë, Çiao Kuan Huaja u paraqit si «i porositur në mënyrë të veçantë nga Çu En Lai që të bisedonte shoqërisht dhe hapur me shokët udhëheqës shqiptarë për problemet që na preokupojnë». Siç duket, ai mendonte se do ta prisja edhe unë, gjë që nuk u realizua, për arsye se isha në Korçë dhe ai do të qëndronte vetëm dy ditë, jo më shumë.

Sipas bisedimeve që bëri me shokët e Qeverisë (lexova në Korçë protokollet që ishin mbajtur), **Çiao Kuan Huaja tha dy-tri fjalë për Lin Biaon që «ishte një mas-kara, një komplotist, i cili u arratis me avion për në Bashkimin Sovjetik, avion që ra dhe u dogj në afërsitë e Ulan-Batorit. Lin Biaoja donte të arratisë një herë për në Hong-Kong, pastaj mori rrugën e Mongolisë»**. Kaq tha për Lin Biaon, asgjë më shumë, asgjë më pak! Si për t'u tallur me ne. Dhe kjo, sipas tyre, është quajtur me siguri si «vënie zyrtarisht në dijeni të Partisë së Punës të Shqipërisë»!

Qëllimi tjetër i tij, siç duket nga biseda që bëri, ishte të na bindte që taktikat e përdorura nga Kina, qoftë në çështjen e bisedimeve me amerikanët, qoftë në qëndrimet e tjera ndaj revizionistëve dhe reaksionit, janë të drejta, parimore, leniniste. Pra, parimet nuk shkelen, kontradiktat e armiqve shfrytëzohen dhe pikërisht këtu synojnë edhe kompromiset që eventualisht mund të bëhen.

Të gjitha këto shoku kinez u përpoq t'i vinte në opozicion me vijën tonë, duke lënë të kuptohej, se për këto çështje (në qoftë se ka) mund të ketë dy pikëpamje në mes nesh, ndërsa për të gjitha të tjerat ne jemi dakord. Me fjalë të tjera, ai donte të thoshte se «ju (shqiptarët), në çështje taktike, jeni kundër kompromiseve që këshillojnë Lenini dhe Stalini, se nuk kuptoni dhe nuk

veproni për të thelluar kontradiktat që kanë armiqtë në mes tyre. Pra ju jeni sektarë dhe të majtë, në mos ultra të majtë»!

Natyrisht, këto insinuata të Çiao Kuan Huasë janë pa asnjë bazë dhe provokuese. Shoku kinez, pa e përmendur fare letrën tonë drejtuar Komitetit Qendror të tyre me rastin e vajtjes së Niksonit në Pekin, me ato që tha konsideronte se i përgjigjej zyrtarisht kësaj letre dhe, natyrisht, e hidhte atë poshtë...

Tezat tona vërtetojnë se ne, si kurdoherë, nuk jemi sektarë, as djathtistë, as majtistë, por jemi parimorë, luftojmë në të dy krahët, edhe imperializmin, edhe revizionizmin, luftojmë për thellimin e kontradiktave dhe bëjmë kompromise me ato shtete dhe në ato kohë dhe koniunktura që i gjykojmë të favorshme për ne, por asnjëherë për çështje parimore e ideologjike.

Ne nuk ishim kundër mendimit që Kina të bisedonte me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por këto bisedime duhej të bëheshin në kushte të barabarta: së pari, të njëjhej Republika Popullore e Kinës si i vetmi shtet i ligjshëm, të vendoseshin marrëdhënie diplomatike dhe të zgjidhej problemi i Tajvanit.

Së dyti, koniunktura nuk ishte e përshtatshme për pritjen e Niksonit, sepse ky dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë agresorë në Vietnam e gjetkë dhe se kjo vizitë do të forconte pozitat e Niksonit para zgjedhjeve. Niksoni, nga ana e tij, nuk kishte ndër mend të bënte ndonjë lëshim dhe në fakt nuk bëri asnjë ndaj Kinës.

Afrimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës çorientoi opinionin botëror për Kinën, e vuri Kinën në një pozitë gati me Bashkimin Sovjetik për rregullimin paqësor të problemeve botërore e të revolucionit dhe në të njëjtën kohë egërsoi Bashkimin Sovjetik kundër Kinës si një rival që afrohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kinezët mbrojnë tezën se Bashkimi Sovjetik do t'i sulmojë, sepse ka grumbulluar një milion ushtarë në kufi me Kinën. Çdo gjë mund të ngjasë, por ne mbrojmë tezën se aktualisht Bashkimi Sovjetik i trembet luftës botërore dhe nuk e bën këtë. Kinës ai i bën presion për shumë çështje dhe për arsyen që ajo kërkon rektifikimin e kufijve. Shembulli që sjellin kinezët, se Bashkimi Sovjetik sulmoi Çekosllovakinë, nuk shërben për të vërtetuar aktualisht një sulm kundër Kinës. Tjetër gjë ishte rasti i sulmit mbi Çekosllovakinë, ku nuk u hodh asnjë pushkë kundër invazionit socialimperialist, kurse, me një sulm kundër Kinës, Bashkimi Sovjetik ka parasysh faktin se do t'i duhet të përballojë një luftë në shkallë botërore.

Që revizionistët modernë sovjetikë janë armiq, është e qartë dhe që duhet përgatitur kundër tyre për çdo eventualitet, edhe kjo është e domosdoshme; por një eventualitet të tillë koniunktural, joreal, ta përdorësh për t'u afruar dhe për t'u mbështetur te një agresor tjetër i egër, kjo është e gabuar.

Shembulli i paktit të mossulmimit, që nënshkroi Bashkimi Sovjetik me Gjermaninë hitleriane, që zëvendësministri i Jashtëm kinez e pruri si argument «varë» për ne, që na thonë stalinistë, që gjoja nuk bëjmë dhe s'dimë të bëjmë kompromise, i duhet hedhur poshtë definitivisht këtij revizionisti. Pakti i Bashkimit Sovjetik me Gjermaninë hitleriane në ato kohë dhe në ato rrethana, ishte i drejtë. Por sot koha dhe rrethanat midis Kinës, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës s'janë të atilla. Me atë që deri tash ka bërë agresione të hapëta me armë, që edhe nesër do të bëjë të tjera, ti, Kinë, po miqësohesh; edhe me Bashkimin Sovjetik do të miqësohesh nesër; me këto dy superfuqi shpejt do të bëhesh mike, në qoftë se i gjykon situatat ashtu si t'i do qejfi dhe jo në bazë të një analize marksiste-leniniste, në qoftë se bën kompromise joparimore,

duke i veshur ato me petka false leniniste. Këto, e të tjera çështje të kësaj natyre, duheshin prekur, sigurisht në formë miqësore dhe teorike me shokun kinez. Sidoqoftë, atij iu thanë disa gjëra dhe do të gjejmë kohë që t'ua themi edhe të tjerat kinezëve.

1954

THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA

THE PEOPLE'S REPUBLIC OF CHINA

NJË VAPOR GREK MBYTET NË UJËRAT TONA TERRITORIALE

Nga Ministria e Mbrojtjes më njoftuan për mbytjen në ujërat tona territoriale të një vapori grek. Mbytja mund të jetë aksidentale, por ndodh që pronarët e tyre i mbytin edhe vetë sepse janë anije të vjetra dhe janë të siguruara. Shokët tanë u shkuan menjëherë në ndihmë marinarëve grekë.

NJË DELEGACION USHTARAK KINEZ DO TË VIJË PËR VIZITË

Shokët e Ministrisë së Mbrojtjes më njoftuan se do të vijë një delegacion ushtarak kinez prej 40 vetash për shkëmbim eksperience. Me këtë rast kinezët ftojnë një delegacion ushtarak tonin të vejë për vizitë miqësore. U thashë shokëve ta përgatitin delegacionin, ta çojmë, tok edhe me kërkesa për armatime etj. për të cilat ka nevojë ushtria jonë.

PLATFORMË PUNE ME PARTITË KOMUNISTE
(M-L) MOTRA

Bisedova gjatë me shokun Ramiz për aktivizimin më të mirë dhe për një drejtim më të përcaktuar, me objektiva më të thellë, për të cilat duhet të ngarkojmë Drejtorinë e Jashtme të Komitetit Qendror që mban e zhvillon lidhjet me partitë komuniste e punëtore motra, marksiste-leniniste.

Ne kemi marrëdhënie të mira vëllazërore me shumë parti (marksiste-leniniste) të afirmuara ose jo, me grupe marksiste-leniniste dhe me grupe revolucionare. Me to kemi pak a shumë lidhje të rregullta. Delegacione nga ato vijnë te ne, kurdoherë që ato e ndiejnë të nevojshme. Edhe ne i ftojmë shpeshherë nga ana jonë për të këmbyer eksperiencë, i ftojmë në kongrese, në festa kombëtare dhe për pushime. Ambasadat tona, në ato shtete ku kemi, mbajnë kontakte, bisedojnë dhe transmetojnë mesazhet ose literaturën e njëri-tjetrit.

Në këtë platformë lidhjet tona janë shumë të mira, zhvillohen drejt, në rrugën marksiste-leniniste. Nuk ka asnjë fërkim në mes partisë sonë dhe atyre. Ne nga ana jonë mundet që kemi qenë në gjendje të bënim më shumë për to. Ndihma që u jep atyre Partia e Punës e Shqipërisë është e vogël përpara ndihmës së madhe që i japin dhe do t'u japin ato veç e veç dhe të gjitha së toku lë-

vizjes komuniste botërore, revolucionit proletar dhe luftërave nacionalçlirimtare, në përgjithësi dhe në veçanti.

Dokumentet dhe eksperiencën e Partisë dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë ato i kanë marrë dhe kanë konsideratë të mirë. Ne, pa u krekosur, duhet të punojmë më mirë në këtë drejtim, pse ato nuk e dinë gjuhën tonë, nuk kanë mjetet dhe nuk janë në gjendje të zgjedhin në të gjitha ato materiale ato çka mund t'u shërbejnë. Pra këto lidhje duhen thelluar dhe duhen zgjeruar. Zgjerimi i lidhjeve të Partisë sonë me grupe të tjera revolucionare, të vetëquajtura marksiste-leniniste revolucionare, të majta, e të tjera etiketa të tilla, është delikate të bëhet nga ana jonë, ose të influencojmë drejtpërdrejt në to, kur këto grupe, që arrijnë të vetëquhen parti marksiste-leniniste, janë në konflikt politik dhe ideologjik me partitë komuniste e punëtore (marksiste-leniniste), me të cilat ne kemi lidhje. Një gjë të tillë ne nuk mund ta bëjmë pa biseduar me këto të fundit dhe, që të bisedojmë e të biem dakord, duhet t'i njohim mirë divergjencat parimore që i ndajnë dhe çdo ndërhyrje dhe influencim, në qoftë se bëhet nga Partia jonë, duhet t'i shërbejë revolucionit. Kjo duhet kurdoherë të bëhet në rrugën e marksizëm-leninizmit dhe t'i shërbejë unitetit marksist-leninist të komunistëve në një parti të vetme, në partinë marksiste-leniniste të klasës punëtore, që të jetë në gjendje të udhëheqë klasën dhe masën në revolucion, në luftë me borgjezinë, me kapitalin, me imperializmin, me socialimperializmin dhe me ideologjinë e tyre.

Aktualisht, në të gjitha vendet e botës revolucionari po zien, po shtohen dhe po acarohen kontradiktat në mes imperializmit dhe socialimperializmit nga njëra anë dhe popujve nga ana tjetër, borgjezisë kapitaliste ndërkombëtare dhe kombëtare nga njëra anë dhe popujve në anën e kundërt, në përgjithësi dhe në veçanti.

Imperializmi, me atë amerikan në krye, është në stadin e tij të fundit, në stadin e kalbëzimit. Ai u reziston goditjeve të popujve me anën e armëve, me terror, me luftëra dhe me demagogji, që në bazë ka terrorin dhe kërcënimet. Imperializmi amerikan nga Lufta e Dytë Botërore doli si një superfuqi me një potencial të madh ekonomik, ushtarak dhe teknik. Ai i thuri vetes «kurorën e çlirimtarit nga nazizmi gjerman» dhe që në pragun e fitores mbi Gjermaninë hitleriane dhe militarizmin japonez u paraqit njëkohësisht si e vetmja fuqi ekonomike botërore që ishte në gjendje të ndihmonte vendet e tjera të mëkëmbeshin ekonomikisht dhe i vetmi vend që mund t'i mbronte ato ushtarakisht «nga një sulm i mundshëm i sovjetikëve».

Gjithë këtë psikozë, të bazuar në mjerimin e të tjerëve dhe në frikën nga komunizmi, e krijoi imperializmi amerikan dhe zbatoi hap pas hapi programin e sundimit të botës nga ana e tij. Ai financoi kapitalin evropian brenda dhe atë të Gjermanisë Perëndimore, financoi kapitalët e vendeve të tjera në të gjitha anët e botës, me qëllim shfrytëzimi nga ana e tij, u përpoq që t'u hiqte shfrytëzimin e kolonive shteteve të vjetra koloniale për t'i shfrytëzuar këto vetë edhe më egërsisht dhe me forma e metoda të reja për interesin e madh të tij. Të gjithë «duaxhinjtë» i financonte që të mëkëmbeshin dhe të forcoheshin me qëllim dominimi mbi popujt e ndryshëm dhe për t'i lidhur ngushtë pas qerres së tij, jo vetëm me traktate skllavëruese ekonomike, por edhe me pakte ushtarake. Kështu që baza ushtarake amerikane u vendosën kudo në botë për të mbrojtur perandorinë e pafund të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

E gjithë kjo, natyrisht, kaloi në disa faza dhe jo pa fërkime e përpjekje në çdo fazë. Por mund të themi se kjo politikë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës pati fazën e fillimit me «euforitë» dhe me deziluzionet e ve-

ta, pati fazën e stabilizimit, e cila u ndoq më pas nga faza e kontradiktave të thella në mes tyre dhe partnerëve të tij. Këto kontradikta tash shkojnë duke u thelluar, duke u acaruar, duke shkaktuar kriza të rënda ekonomike, që kanë degjeneruar në konflikte dhe që do të degjenerojnë edhe në konflikte me armë në mes tyre.

Ishin popujt që bënë Luftën e Dytë Botërore, ishin ata që e fituan këtë luftë me sakrificat e tyre të mëdha dhe jo imperializmi amerikan dhe imperialistët e tjerë. Bashkimi Sovjetik i Leninit dhe Stalinit luajti rolin vendimtar në këtë luftë. Pa luftën heroike të popujve sovjetikë dhe të popujve të tjerë të Evropës lufta kundër shteteve fashiste nuk mund të fitohej.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën nga lufta të maskuara me ar, si Harpagoni, por fituesi i madh moral e me kredi të pafund politike, fitues në të gjitha betejat, për arsye se udhëhiqej nga marksizëm-leninizmi, ishte Bashkimi Sovjetik, atdheu i socializmit. Prestigji i komunizmit, i socializmit, i revolucionit në mbarim të Luftës së Dytë Botërore ishte në zenit, popujt u gjallëruan, u freskuan, forcuan besimin në kauzën e tyre të drejtë.

Po zhvillohej, pra, një luftë e ashpër në mes kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye dhe botës kapitaliste, që udhëhiqej nga imperializmi amerikan. Fitorja ishte nga ana jonë, nga ana e socializmit dhe e marksizëm-leninizmit derisa jetoi Stalini. Tradhtia e revizionistëve sovjetikë e ktheu Bashkimin Sovjetik në një fuqi imperialiste dhe socialimperializmi sovjetik doli si një superfuqi kapitaliste botërore me një ideologji false marksiste-leniniste, me satelitët e saj të bindur dhe jo të bindur, po të detyruar ta ndiqnin si në rrugën e politikës dhe të ideologjisë, ashtu edhe në drejtim të aventurave ushtarake.

Socialimperializmi sovjetik ka potencialin e tij ekonomik dhe ushtarak, ka satelitët e tij dhe planet e tij do-

minuese, ashtu siç ka edhe imperializmi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës të tijtë. Dy superfuqitë imperia-
liste duan të sundojnë botën, të caktojnë sferat e in-
fluencave të tyre, të luftojnë komunizmin dhe të shtypin
me armë çdo revolucion dhe luftërat nacionalçlirimtare
të popujve. Këtij qëllimi i shërbejnë teoricienët e ndry-
shëm të socialdemokracisë, po këtë qëllim kanë dhe ndje-
kin teoricienët e revizionizmit modern.

Armaturës së shtypjes dhe të shfrytëzimit i ngjitin
dhe anën politiko-teorike të përshtatshme me atë që po-
pujt, klasa punëtore dhe revolucionarët, të mos mundin
dot të gjejnë rrugën e unitetit për një luftë revolucionare
në mbrojtje të të drejtave të tyre të marra nëpër këmbë
dhe të uzurpuara nga klikat kapitaliste që janë në fuqi.

E gjithë lufta politiko-ideologjike e rrymave anti-
marksiste, që zhvillohen në botë, ka për qëllim përçarjen
e unitetit revolucionar të masave. Revizionizmi modern
aktual sovjetik është një diversion i madh ideologjik
antimarksist në shkallë botërore, që iu shtua rrymave
trockiste, anarkiste, anarkosindikaliste dhe një sërë ma-
fiave të tjera politike, puçiste, gangsteriste.

Më e rënda në këtë mes është se qendra e kësaj
rryme u bë Bashkimi Sovjetik, ish-partia e bolshevikëve
të Lenin-Stalinit. I gjithë prestigji revolucionar i tyre u
përdor dhe vazhdon të përdoret me demagogji nga rene-
gatët në interes të antikomunizmit. Pra, lufta e mark-
sistë-leninistëve të vërtetë, e partive marksiste-leniniste
që qëndrojnë në pozita të shëndosha, është e rreptë dhe
jo e lehtë. Janë shtuar armiqtë tanë në potencial ekono-
mik, ushtarak dhe ideologjik.

Prandaj marksistë-leninistët duhet ta forcojnë luftën
për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të forcojnë uni-
tetin e marksistë-leninistëve të përçarë në planin kombë-
tar dhe të kalohet pastaj edhe në atë ndërkombëtar, du-
het lidhur me masat e popullit dhe duhet punuar me

këmbëngulje për t'i bindur ato për drejtësinë e objekti-
vave dhe duke u organizuar në luftë me klikat sunduese
dhe ideologjitë e tyre të specifikës kombëtare dhe ndër-
kombëtare. Në të dyja këto platforma ne hasim dhe do
të hasim në vështirësi të panumërta dhe të shumëlloj-
shme, pse korrupsioni politik dhe ideologjik është stër-
holluar e zgjeruar dhe është një plagë e thellë.

Eksperienca e madhe e fituar për kauzën e revolu-
cionit, të socializmit dhe të komunizmit, është errësuar
dhe njollosur në sytë e masave nga revizionistët modernë
hrushovianë, të cilët, bashkë me reaksionin botëror, këtë
eksperiencë të ndërtimit të socializmit dhe të revolucio-
nit në përgjithësi e paraqitin si një dështim të plotë. Na
bie për detyrë urgjente dhe e dorës së parë neve, mark-
sistë-leninistëve të ngjitim bregun e vështirë dhe të ka-
përcejmë hendekun që na kanë hapur renegatët. Ne du-
het të mbrojmë ideologjinë tonë, marksizëm-leninizmin,
eksperiencën e fituar në revolucion e në ndërtimin e
socializmit, duke demaskuar renegatët dhe teoritë e tyre
dhe, në bazë të kësaj lufte, të krijojmë unitetin dhe
internacionalizmin proletar. Duhet të shtrëngojmë radhët
tona më fort se kurrë. Fizikisht sot ne nuk kemi më as
Marksin, as Engelsin, as Leninin dhe as Stalinin, por ke-
mi veprat e tyre të pavdekshme që na frymëzojnë dhe
na udhëheqin. Neve na bie detyra e madhe që, duke u
mbështetur në rrethanat aktuale në këtë vepër të madhe
të tyre, t'i interpretojmë në mënyrë korrekte mësimet e
klasikëve tanë. Armiqve dhe renegatëve të marksizëm-
leninizmit nuk u mungon eksperienca djallëzore për in-
terpretime false dhe për falsifikimin krejtësisht të teorisë
sonë. Kjo eksperiencë ka në vetvete një rrezikshmëri të
madhe, pse pikërisht hedh turbullira në mendjen e nje-
rëzve, nxit në natyrën e tyre zakonet, mbeturinat e ideo-
logjive të vjetra, nxit veset e këqija të egoizmit, të me-
galomanisë, të egocentrizmit, të nacionalizmit, ajo nxit

instinktët e dobëta të njerëzimit dhe atje ku arrihet uniteti, fut diversionin, përçarjen, i ushqen ato me arsye-time false antimarksiste, punon për një qëllim të vetëm, të thyejë frontin unitar marksist-leninist, goftë në platformën kombëtare, goftë në atë ndërkombëtare.

Prandaj duhet luftuar pandërprerë kundër të gjitha këtyre që thashë më lart, duhet punuar me konsekuencë për arritjen e unitetit kombëtar dhe ndërkombëtar të marksistë-leninistëve dhe të partive marksiste-leniniste komuniste dhe punëtore. Për këtë qëllim të madh jetik e të domosdoshëm duhet të kontribuojmë të gjithë, pa përjashtim.

Udhëheqja e sigurt dhe e vetme e pagabueshme në këtë drejtim duhet të jetë teoria jonë, marksizëm-leninizmi, e interpretuar dhe e zbatuar drejt e në mënyrë korrekte në çdo etapë, në çdo rrethanë dhe në kushtet e çdo vendi e të çdo zone. Kjo lyp njohuri të teorisë dhe të praktikës revolucionare, kjo lyp të bëhen analiza të herëpashershme të situatave që paraqiten, kjo lyp ndërtimin e një strategjie korrekte për të gjithë dhe ndërtim taktikash që t'i shërbejnë kësaj strategjie. Këto nga një vend në tjetrin, për një parti dhe tjetrën, mund dhe do të jenë të ndryshme, por boshti i tyre duhet t'u shërbejë të gjithëve dhe jo të dëmtojë veprimet e të tjerëve. Këtu qëndron zotësia jonë e formimit dhe e kalitjes së unitetit marksist-leninist revolucionar në një front unik kundër imperializmit, socialimperializmit, forcës së tyre ekonomiko-ushtarake, pushtetit dhe ideologjive të tyre.

Dhe këtë gjë ne do ta bëjmë dhe duhet ta bëjmë pa pasur një Komintern, pa pasur një Parti Bolshevike, pa pasur të gjallë, që të na udhëheqin, një Lenin dhe një Stalin, këtë duhet ta bëjnë partitë marksiste-leniniste, me një bashkëpunim të sinqertë korrekt midis tyre, me metodën e bindjes politiko-ideologjike, pa imponim, pa diskriminim dhe me durim.

Për këtë qëllim duhet të krijojmë, në radhë të parë, mundësinë e kontakteve të ngushta në mes partive tona dhe të zhvillojmë më tej e më thellë njohjen e nevojave, të pikëpamjeve e të mundësive të njëri-tjetrit dhe, në diskutime të hapëta e shoqërore, të përcaktojmë një sërë veprimesh të përbashkëta o të veçanta, që t'i shërbejnë këtij uniteti që do të fuqizojë partitë tona dhe lidhjet e tyre me masat, për të ngritur luftën kundër armikut të klasës në një stad kurdoherë më të lartë.

Partia Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë janë dy parti në fuqi, që udhëheqin ndërtimin e socializmit në vendet e tyre respektive. Në këtë drejtim ne kemi detyrime më shumë ndaj partive të tjera motra, por gjithnjë në rrugë të drejtë. Këtë duhet ta kemi të qartë dhe të mos gabojmë. Ne, por si ne edhe Kina, jemi më shumë në gjendje t'i ndihmojmë partitë e tjera në vështirësitë e shumëllojta që kanë. Atdheu ynë socialist duhet të bëhet mbështetje dhe t'u japë atyre një ndihmë reale e frymëzuese. Pra, neve na bie barra kryesore që të organizojmë më mirë se çdo herë tjetër rregullimin e lëvizjeve, të takimeve, kuptohet, në bashkëpunim dhe me aprovimin e plotë të çdo partie. Neve na bie barra që të ndihmojmë partitë motra për anën materiale të shtypit dhe të propagandës së tyre, kur ndonjë nga këto parti e kërkon, ne duhet të lehtësojmë dhe të ndihmojmë në shpërndarjen e kësaj propagande dhe literature, kur ato parti nuk kanë asnjë mundësi ta bëjnë këtë. Ne duhet t'u sigurojmë të dërguarve të këtyre partive motra që të njihen me çdo gjë në vendin tonë, të marrin atë eksperiencë dhe në atë sektor që u nevojitet. Ne duhet t'ua lehtësojmë me çdo mënyrë dhe në të gjitha format marrjen e kësaj eksperience.

Të gjitha këto Partia jonë i bën deri në njëfarë shkalle, por jemi akoma larg asaj që duhet të bëjmë. Këto marrëdhënie me partitë motra duhet t'i perfeksio-

nojmë dhe t'i bëjmë më të frytshme për lëvizjen tonë revolucionare.

Në radhë të parë, këto kontakte nuk duhet të jenë të rastit dhe vetëm me raste kongresesh, festash o pushimesh. Të tilla takime duhet të vazhdoen si deri tash, pse në këto raste zhvillohen edhe biseda pune, shkëmbehet eksperiencë reciproke. Por është e nevojshme që të planifikohen edhe takime të tjera me objektiva të caktuar dy e shumëpalësh.

Natyrisht takimet e rastit marrin më tepër karakter demonstrativ, festiv dhe informativ, nuk ndihmojnë sa duhet që të diskutohen thellë një ose dy probleme që preokupojnë një ose disa parti, ose lëvizjen në përgjithësi. Kjo bën që problemit të mos i bëhet një analizë kritike dhe të dilet me disa konkluzione dhe detyra parimore. Në të tilla takime preferohet një «unitet mendimesh» në përgjithësi, kur mund të ketë mendime të ndryshme për disa aspekte ose veprime për ndonjë çështje.

Kjo është një hallkë e dobët që ne duhet ta kalitim. Pse është e dobët kjo hallkë dhe ç'duhet bërë që ta forcojmë? Është e dobët se ne nuk e njohim si duhet (flas relativisht) gjendjen në partitë e tjera, reciprokisht, nuk njohim si duhet forcën organizative dhe qëndrimet e tyre politike për problemet kryesore, nuk njohim përbërjen klasore dhe ngritjen ideologjike të tyre. Kjo është një.

E dyta, ne nuk bëjmë analiza dhe të pasurojmë dijenitë tona për gjendjen e vendit, për forcat e armikut dhe për forcat e progresit e të revolucionit ku ai evoluon dhe si luftojnë këto parti për të njohur më mirë raportin e forcave.

E treta, ne nuk njohim si duhet prirjet, forcën dhe politikën që ndjekin partitë e ndryshme politike në vendet dhe në grupet e ndryshme revolucionare, që hiqen të majta, që quhen «parti marksiste» etj., dhe qëndrimet e partive komuniste marksiste-leniniste ndaj tyre, strategjinë dhe taktikën e tyre.

Si këto ka dhe çështje të tjera shumë të rëndësishme për partinë e një vendi të caktuar, por edhe për gjithë lëvizjen. Asnjë parti marksiste-leniniste nuk përjashtohet nga gabimet, secila ca i sheh dhe i ndreq, por ca nuk i sheh dhe ngul këmbë në gabimin, dëmton kështu jo vetëm çështjen e partisë në vendin e saj, por dhe luftën në përgjithësi. Ndihma që i jep partia partisë është shpëtimtare, me kusht që të njohësh problemin dhe ta analizosh atë në bazë të marksizëm-leninizmit.

Natyrisht, për të zgjidhur probleme të tilla, lyphen kontakte pune, debate, diskutime. Nuk mund të jetë e pranueshme që një mëngjes Partia Komuniste e Kinës të deklarojë se ka marrë kontakt dhe ka zhvilluar bisedime me përfaqësues të iks partie revizioniste pa u konsultuar fare për këtë gjë as me partinë komuniste marksiste-leniniste të po atij vendi, as me ne, dhe as me ndonjë parti tjetër. Kjo është një çështje e madhe parimore, që na intereson të gjithëve. Duhet apo s'duhet mbajtur lidhje partie me partitë revizioniste, trockiste etj.? Duhet takuar dhe biseduar në rrugë partie me grupe të tilla renegatësh, vetëm se ndonjëri prej tyre ka disa kontradikta me revizionistët sovjetikë? Natyrisht, ne mendojmë se jo dhe kështu bëjmë e do të bëjmë. Por, para se të ndërmerrnin një hap të tillë, të gabuar, shokët kinezë këtë çështje duhej ta kishin pleqëruar edhe me të tjerët. Ata nuk e bënë një gjë të tillë, por e bënë *fait accompli* në shtyp. Atëherë Partia jonë mbajti dhe ajo qëndrim publik për këtë problem të rëndësishëm. Të tilla qëndrime nuk shërbejnë aspak për forcimin e unitetit, nuk shërbejnë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe zhvillimin e luftës kundër deviatorëve.

Shokët kinezë kanë deklaruar se do të mbajnë ose do të marrin kontakt me të gjitha partitë dhe me të gjitha grupet «e majta», çfarëdo tendence që të kenë dhe kështu bëjnë. Kjo bëhet gjoja për t'i njohur këto, por në

realitet nuk veprohet për t'i njohur, për të diskutuar dhe për t'i sqaruar ato për bashkimin dhe unifikimin në rru-
gën marksiste-leniniste të partisë a grupit të tyre me atë
parti ose grup që ka një vijë të drejtë dhe që është afir-
muar në këtë drejtim. Partia Komuniste e Kinës krijon
më tepër në to një «kredi» për vete, mjaft që këto gru-
pime «të flasin mirë» për Kinën, për Maon, pa le të grin-
den në mes tyre dhe mos e arrifshin kurrë unitetin. Në
këtë nuk mund ta pranojmë dhe nuk e kemi pranuar
dhe këtë ua kemi thënë shokëve kinezë.

Ne mendojmë se këtyre grupeve të majta duhet t'u
studiojmë vijën dhe pikëpamjet, të studiojmë objektivist
ku qëndrojnë kundërshtimet në mes tyre, të marrim
kontakt dhe të diskutojmë me partitë komuniste mark-
siste-leniniste ose me grupin kryesor dhe, në bashkëpu-
nim me to dhe me lejen e tyre, mund të marrim kontakt
me grupet e tjera, në qoftë se pranojnë, kurdoherë me
qëllim që kjo punë t'i shërbejë unitetit në rrugën mark-
siste-leniniste. Këtë punë të thellë ne nuk e kemi bërë
si duhet, e kemi bërë në përgjithësi. Aparati ynë në Ko-
mitetin Qendror duhet ta organizojë punën seriozisht në
drejtim të lidhjeve me partitë motra.

Por çështjen e ndihmës reciproke në forma të tilla,
sado që Partia jonë të përpiqet të punojë, nuk mund ta
kryejë dot vetëm dhe nuk mund ta marrë dot mbi vete
këtë detyrë me kaq përgjegjësi. Do të ishte një preten-
dim i gabuar, në qoftë se ajo do t'i futej vetëm kësaj
pune. Për këtë duhet të kontribuojnë të gjitha partitë.

Sipas mendimit tim, lufta për forcimin e unitetit do
të kalojë në disa faza bisedimesh pune, diskutimesh ideo-
logjike, politike dhe organizative në forma bilaterale. Por
mund të kalohet edhe në forma më të gjera, në takime
shumëpalëshe për të diskutuar për probleme me interes
të përbashkët, që i shërbejnë forcimit të unitetit. Rëndësi
ka që në takime të tilla të respektohen me rreptësi nor-

mat internacionaliste të marrëdhënieve midis partive mo-
tra, barazia dhe pavarësia e plotë e secilës parti, fryma
shoqërore etj.

Në këtë platformë dhe me këto qëllime i thashë
Ramizit na bie neve detyra që të punojmë më mirë, të
forcojmë dhe të zgjerojmë më shumë se ç'i kemi tash
lidhjet me partitë motra dhe shkëmbimet e ndihmën
reciproke.

Idenë e unitetit, idenë e shkëmbimit të mendimeve
dhe të veprimeve revolucionare të përbashkëta me par-
titë motra, na i kanë vënë detyrë kongreset e Partisë
sonë dhe këto detyra ne duhet t'i kryejmë.

E PREMTE
8 SHTATOR 1972

SHENIM

Porosita Ramizin që shtypi dhe radioja të demaskojnë fort raprezaljet e izraelitëve kundër palestinezëve në Liban dhe në Siri, si dhe veprimet e «Gestapos» gjermane që provokuan gjakderdhje në lojërat olimpike.

E SHTUNË
9 SHTATOR 1972

TAKIM ME SHOKUN ADIL ÇARÇANI

Adil Çarçani erdhi dhe më vuri në dijeni për një sërë vështirësish që nxjerrin kinezët në lidhje me ngritjen e metalurgjisë së Elbasanit, siç janë: koksi që mund të fabrikojmë në Ballsh nuk është i përshtatshëm dhe ndërtimi i uzinës për ndarjen e nikelit dhe të kromit nga minerali hekur duhet të shtyhet edhe për 9 muaj etj.

Vendosëm që protokollet me këto ndryshime të firmosen në Tiranë, kur të vijë ministri kinez i Metalurgjisë.

TAKIM ME POL MILIEZIN

Prita sot në selinë e Komitetit Qendror profesor Pol Miliezin me gjithë të shoqën. Profesor Miliezi kuron shoqët tanë që venë në Paris dhe është kryetar i Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri. Pata me të një bisedë të përzemërt. Asistonin Hysniu, Nexhmija e të tjerë.

**TË NJË GJAKU, TË NJË KOMBI, TË NJË GJENEZE,
TË NJË GJUHE E TË NJË FLAMURI**

Sot asistuaam në Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire, ku marrin pjesë shkencëtarë nga vendi ynë dhe nga vende të huaja të Evropës. Studimet bazë janë përgatitur mirë dhe janë të pasura me dokumente të shumta, sidomos arkeologjike, të zbuluara në vendin tonë, veçanërisht brenda këtyre 25 vjetëve. Në pushimin e seancës së parë shkova dhe përshëndeta të ftuarit e huaj dhe tanët. Urova Aleks Budën, që mbajti referatin kryesor në këtë kuvend dhe që është një historian me autoritet të madh. Të huajt shprehën gëzim, kënaqësi dhe na bënë urime. Në mes tyre ishin dhe një numër i konsiderueshëm shkencëtarësh shqiptarë kosovarë. U ndala veçanërisht tek ata, i falënderova që kanë ardhur shumë dhe u thashë se edhe më shumë duhet të vijnë herët e tjera për të tilla probleme, pse i kemi të përbashkëta, duhet të vendosim së toku, se jemi nga një gjak, jemi një popull e një komb, kemi një gjenezë, kemi një gjuhë e një flamur. Asnjë ligj i njerëzve o i kancelarive nuk është i fuqishëm t'u kundërvihet këtyre problemeve bazale e parimore. (Me këtë doja që t'i jepja një shuplakë indirekte Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, i cili kishte thirrur përfaqësuesin tonë të ambasadës në Beograd dhe kishte protestuar zyrtarisht për arsye se «Zëri i popullit» kishte shkruar se «në këtë Kuvend të Studi-

meve Ilire do të vijnë edhe shkencëtarë nga Kosova», kurse sipas atyre duhej të thoshte: «... nga Kosova — Jugosllavi.») Titistët janë titistë, siç i kemi cilësuar, por ne duhet të evitojmë provokimet e tyre, pse ata do të bëjnë çmos që t'i pengojnë këto kontakte me shqiptarët e Kosovës.

Unë me këtë rast të gjithë kosovarëve të pranishëm u urova suksese në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës dhe u sigurova ndihmën tonë.

E MARTË
19 SHTATOR 1972

SHËNIM

Shokët tanë, që janë në Kinë për problemet e metalurgjisë, i kishte takuar Fan Jia, i cili, në emër të qeverisë kineze, u kishte thënë se është e mira që protokollet të nënshkruhen në Pekin, pse qeveria kineze ka vendosur për këtë, dhe ministri kinez i Metalurgjisë, që vjen në Tiranë, s'mund të ndryshojë asgjë. Shokët, në vend që të lajmëronin këtu, u treguan të ngurtë dhe u thanë që ne nuk i nënshkruajmë. I lajmëruam që t'i nënshkruajnë ato, pse as që kishim ndonjë qëllim për të avancuar datat.

NJË KUVEND QË E VURI SHKENCËN TONË NË NIVELIN BOTËROR

Më raportuan për mbylljen e Kuvendit të Parë të Studimeve Ilire. Ky kuvend pati një sukses të madh dhe e vuri shkencën tonë në nivelin botëror. Shkencëtarët tanë: Çabej, Buda, Kostallari, Ceka, Pollo e një plejadë e tërë, të vjetër e të rinj, u treguan njerëz me kulturë të gjerë dhe me nivel të lartë shkencor, sa që shkencëtarët e huaj i vlerësuan me të drejtë si shkencëtarë me autoritet botëror. Këta mbetën të habitur dhe të entuziazmuar për punimet e kuvendit dhe me siguri do t'i bëjnë jehonë shumë pozitive kësaj ndërmarrjeje të lavdërueshme të studiuesve tanë.

SHËNIM

Siç po duket nga hezitimet që shfaqin nën gjuhë shokët kinezë, kamboxhianët do të heqin dorë nga paraqitja e problemit të tyre në OKB. Sigurisht kjo çështje nuk do të kishte sukses menjëherë, se situatat nuk janë pjekur, por ata na u lutën neve që ta paraqitnim këtë problem dhe ne e pranuan. Po presim ç'vendim do të marrin.

SHTYPI TË SHPREHË MIRË NUANCAT E POLITIKËS SONË NDAJ VEPRIMEVE POLITIKE TË KINËS

I thashë Ramizit që shtypi ynë të vërë mirë në dukje bisedimet kino-japoneze dhe të duket kështu aprovimi ynë për to dhe dizaprovimi i bisedimeve Kinë-Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilat gati nuk folëm fare.

BISEDË ME SHOKËT E TREGTISË QË SHKOJNË NË KINË

Shokëve që shkojnë në Pekin për të nënshkruar marrëveshjen tregtare të vitit 1973 me RP të Kinës, u rekomandova që të ngulin këmbë për sigurimin e mallrave që kërkojmë. Po kështu të veprojnë edhe për një sërë lëndësh të para që vijnë nga Kina, kjo të na i sigurojë nga Evropa nëpërmjet tregtisë së saj. Në këtë mënyrë fitohet nga ne humbja e madhe e kohës (rruga) dhe ngritja e çmimeve të udhëtimit. Bisedova edhe për disa probleme të tjera që kanë të bëjnë me mallrat e konsumit të gjerë.

KINA PO I FORCON POZITAT NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Tash pas hapjes së Kinës drejt Japonisë (dhe kjo u realizua me vajtjen e Tanakes¹ dhe në kushte dinjitoze e të drejta për Kinën, sepse Tanaka kërkoi botërisht ndjesë për gjërat e këqija që Japonia i kishte bërë Kinës, njo-hu qeverinë kineze dhe Tajvanin si pjesë të Kinës) mbetet të përmirësohen marrëdhëniet e Kinës edhe me Indinë.

Të dyja këto veprime të mëdha politike janë të tilla që i forcojnë pozitat e Kinës në arenën ndërkombëtare, thellojnë me të vërtetë kontradiktat në mes Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga njëra anë, Japonisë dhe Bashkimit Sovjetik nga ana tjetër, dhe e gjithë kjo është në favor të Kinës. E njëjta gjë do të ngjasë dhe me Indinë, në rast se Kina vepron. Lidhjet e Kinës me Pakistanin nuk duhet të jenë pengesë për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kanët e Pakistanit, qofshin këta Aga Kanë ose Buto, do të vijë koha që të puqen me indianët. Por veprime të tilla nga ana e Kinës prishin planet e imperializmit amerikan dhe të revizionistëve sovjetikë në Lindjen e Largme dhe në të gjithë botën.

Këto pikëpamje tonat ua kam shprehur shokëve kinezë shumë kohë përpara, ashtu siç u kemi shprehur edhe pikëpamjen tonë se në ç'kushte duhej të bëhej takimi kino-amerikan.

1 Në atë kohë kryeministër i Japonisë.

TAKIMI ME JAPONEZËT ISHTE NË FAVOR TË KINËS

Shokëve kinezë duhet t'u japim të kuptojnë se qëndrimet e Republikës Popullore të Kinës në lidhje me hapjen politike ndaj disa shteteve kapitaliste, ne i vlerësojmë drejt. Ne mendojmë se takimi me Niksonin nuk ishte oportun në ato kushte që u bë, kurse takimi me japonezët ishte oportun, në favor të Kinës dhe në disfavor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik.

ETAPË E RE NË MARRËDHËNIET KINO-JAPONEZE

Sot u shpall Deklarata e përbashkët kino-japoneze. Kjo shënon një etapë të re të frytshme në marrëdhëniet në mes të dy vendeve dhe është një sukses i merituar për Kinën, pse Japonia njohu fajet e saj, njohu qeverinë kinëze, preu marrëdhëniet me Tajvanin, të cilën e konsideron pjesë të pandarë të Republikës Popullore të Kinës, dhe anuloi Traktatin Japoni-Tajvan. Sa larg qëndron ky takim dhe sa të pakrahasueshme janë rezultatet e tij në krahasim me vajtjen e Niksonit në Pekin dhe me çfarë u arrit nga ai.

Rezultatet e bisedimeve me Japoninë do të shënojnë një datë historike në Azi dhe në botë. Situata që u krijua pas këtyre bisedimeve përgjithësisht është në disfavor të imperializmit amerikan dhe atij sovjetik. Le të shpresojmë se një situatë e tillë do të krijohet edhe në marrëdhëniet kino-indiane.

LUFTE DHE BISEDIME MIDIS VIETNAMEZËVE E AMERIKANËVE

Lufta në Vietnam, sido që ofensiva e forcave të Vietkongut është ngadalësuar, vazhdon e rreptë. Të dyja palët, edhe vietnamezët, edhe amerikanët, kërkojnë të arrijnë një sukses të dukshëm për të imponuar pikëpamjet e tyre në bisedime. Këto vazhdojnë dhe, si me thënë, kanë kaluar nga personalitetet e Konferencës së Parisit në biseda të drejtpërdrejta dhe sekrete në mes Le Duk Thosë dhe Kisingerit. Ky vete e vjen në Paris, kurse Le Duk Thoja bën edhe ai këtë punë, por, edhe pret më shumë në Paris «kolegun» e tij amerikan.

Asgjë nuk pipëtin nga këto bisedime. Vietnamezët nuk na thonë shumë gjëra, përveç formulave të përherëshme «do të vazhdojmë luftën deri në fitore, bisedimet janë anësore» etj. Veçse këto kohët e fundit ata kanë filluar të flasin ca më hapur kundër sovjetikëve që, siç thonë, po u bëjnë presione që të merren vesh me amerikanët.

Sipas lajmeve që përhapen, çështja kryesore qëndron te Van Thieu, që vietnamezët kërkojnë ta eliminojnë në formimin e një qeverie koalicioni. Amerikanët fare lehtë e eliminojnë Van Thieun, por si duket këta duan të ruajnë avantazhe substanciale, pasi «të pushohet» lufta. Të shohim si do të zhvillohen ngjarjet.

KINEZËT AKOMA NUK KANË VENDOSUR NGA DO TA MARRIN TEKNOLOGJINË E KOMBINATIT TONË METALURGJIK

Mbrëmë asistova në darkën që dha ambasadori kinez me rastin e 23-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Përveç të tjerave, ambasadorit i shfaqja pikëpamjen mbi rëndësinë e marrëveshjes kino-japoneze dhe nuk mungova t'i thosha se ç'mendojmë ne edhe për marrëdhëniet kino-indiane. Ndërsa ambasadori kinez tha se së shpejti ata do të lidhin marrëdhënie me Republikën Federale të Gjermanisë dhe shtoi se nga Japonia dhe Republika Federale e Gjermanisë do të përpiqen të marrin të rejtat e fundit të teknikës, për arsye se «industria kineze është shumë prapa». Se si do t'i marrin këto, me kredi, me klering apo do t'i blejnë me devizë të lirë, ai nuk tha gjë, por me gjysmë goje përmendi se kështu do të veprojnë edhe me kapitalistët amerikanë.

Unë, pa ia shtruar si probleme, sepse këtë gjë do ta realizojë delegacioni ynë ekonomik, kur të shkojë në Pekin, i fola për vështirësitë tona në sigurimin e shumë lëndëve të para, për transportimin e kushtueshëm dhe kohën e gjatë që duhet për transportimin e mallrave që vijnë nga Kina në Shqipëri. Me këtë i lashë atij të kuptonte se shumë prej tyre Kina duhet të na i sigurojë nga vendet e Evropës, me të cilat ka marrëdhënie tregtare.

Ambasadori tha, gjithashtu, se ata do të përpiqen që

teknologjinë e kombinatit tonë metalurgjik ta marrin nga Kanadaja. Me fjalë të tjera, ata akoma nuk e kanë zgjidhur problemin kyç për këtë vepër të madhe e shumë të rëndësishme! Kjo paraqit shumë rreziqe për ne. Të shohim më tej.

SHËNIM

Sot delegati ynë do të flasë në sesionin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Do të shohim jehonën që do të shkaktojë fjalimi i tij, por sigurisht miqtë e vendit tonë në këtë sesion, që janë të shumtë, do ta aprovojnë.

SHËNIM

Shoku Haki [Toska] më njoftoi mendimin e shfaqur nga profesori biolog italian, Maliani, për krijimin e një stacioni për rritjen e farërave të zgjedhura të grurit. I thashë ta studiojnë me shokët e Ministrisë së Bujqësisë.

NË BISEDIMET ME GREKËT PËR PROBLEMET E KUFIRIT TË MBËSHTETEMI NË PROTOKOLLET NDËRKOMBËTARE

U theksova sot shokëve të Qeverisë se delegacioni ynë për problemet e kufirit me Greqinë, që do të bisedojë me delegacionin grek, i cili vjen më 16 tetor në Tiranë, duhet të mbështetet në protokollet e Konferencës së Firences. Grekët me siguri do të kenë tendencë t'i injorojnë këto. Ne, në bazë të kësaj, duhet të diskutojmë dhe të vendosim për riparimin e piramidave, rektifikimin e tyre dhe regjimin e masave të tjera që duhet të përcaktojmë për incidentet, për kontrabandën etj.

PËRGJIGJE E TËRTHORTË E ÇU EN LAIT

Çu En Lai, në bisedën që ka bërë me shokët e delegacionit të universitetit tonë, i cili po viziton RP të Kinës, përveç të tjerave, u tha se «Niksoni hapi rrugën e ardhjes së Tanakes në Kinë». Në fakt kur kreu i tyre vajti në Pekin, atëherë edhe Tanaka me siguri ka thënë pse të mos vemi edhe ne? Kjo ishte një përgjigje e tërthortë e asaj që i thashë ambasadorit kinez këtu në darkën e festës së tyre «...se do të ketë njerëz që do të thonë që është Niksoni që e hapi rrugën e ardhjes së Tanakës (kjo është një arsye), por në fakt është politika dhe shteti i madh socialist kinez që bëri të dështojë politika e rrethimit të Kinës». Kjo punë filloi me OKB-në, kur Kina u pranua si anëtare e saj, kundër vullnetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, (kinezët vetë na kanë thënë se Kisingeri, derisa hipi në aeroplan, nuk e dinte këtë disfatë të tyre dhe u tha kinezëve se Kina mund të pranohet në OKB në vitin 1973).

Çu En Lai u tha shokëve tanë edhe se «Maoja i kishte folur se nuk duhet t'u rritet mendja nga këto fitore diplomatike, se borgjezia e kthen fjalën», dhe u pruri shembullin e Kosiginit. Ai ka thënë se «me Kosiginin u takova tre vjet më parë në aeroport, me të biseduam dhe ramë dakord për disa gjëra. Kanë kaluar tre vjet që atëherë dhe asnjë gjë nuk është zgjidhur. Ata kanë sjellë në kufijtë tanë një milion ushtarë. U hëngrën gjithë bagëtinë mongolëve. Po nuk ua kemi frikën».

**E PREMTE
6 TETOR 1972**

ZHURMË RRETH MARRËVESHJEVE MIDIS DY VIETNAMEVE

Përfaqësues diplomatikë të Vietnamit të Jugut (Vietkong) dhe ambasadorë rumunë u kanë lënë të kuptojnë disa ambasadorëve tanë se ka kontradikta në mes Hanoit dhe Vietkongut. Sipas një ambasadori rumun, udhëheqja e Hanoit, me Le Zuanin në krye (por jo të gjithë), anojnë nga pikëpamjet e sovjetikëve, të cilët u bëjnë presione «të lexojnë me kujdes propozimet amerikane dhe të bëjnë disa lëshime». Le Zuanin e disa të tjerë janë për këto dhe i bëjnë nga ana e tyre presion Vietkongut. Këta shprehen «më kategorikë dhe thonë do të vazhdojmë luftën deri në fitore etj».

Sidoqoftë këto ditët e fundit gazeta «Tajms» e Londrës e ngriti zërin se gjoja u arrit një «marrëveshje për paqe në mes Uashingtonit dhe Hanoit», të cilët «e përgënjeshtroan». «Tajmsi» vazhdon në të tijën, po nuk ka tym pa zjarr. Fakt është se bisedimet e fshehta vazhdojnë në Paris në mes Le Duk Thosë dhe Kisingerit. Ky i fundit vete e vjen në Uashington. Këto ditë ai ka shkuar në Paris tok me gjeneralin Heig, këshilltar tjetër i Niksonit, i cili para një jave ishte në Sajgon për bisedime me Van Thieun.

Gjatë kohës së bisedimeve të fshehta, që do të vazhdojnë deri në datën 10 tetor, thuhet, Leirdi, sekretar i Departamentit të Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, deklaroi, në thelb, se «negociatat janë në rrujë të mirë, por momentet janë delikate etj».

Siç po duket, Van Thieu po «sakrifikohet» nga amerikanët dhe i lihet «drita jeshile» krijimit të «qeverisë së përkohshme me tre komponentë». Do të shohim «fitimet konkrete» të vietnamezëve në këtë «betejë politike».

E PREMTE
13 TETOR 1972

POHIME TË HIDHURA TË TITOS PËR GJENDJEN E BRENDSHME NË JUGOSLLAVI

Këto ditë Titoja i dha një intervistë «lumë» një gazetareje jugosllave¹. Me të vërtetë intervista ishte, si të thuash, një gjirizlumë. Të gjitha ato që dilnin nga goja e Titos, flasin për falimentimin e «socializmit» në Jugosllavi. Ai ripohoi se Lidhja e Komunistëve është ka-tandisur në një fole «oportunistësh, karrieristësh, pasanikësh, kusarësh».

— Ç'duhet të bëjmë? — e pyet gazetarja.

— E kam thënë, — përgjigjet Titoja, — të spastrojmë partinë.

— Po si ta spastrojmë? — e pyet përsëri gazetarja.

— E kam thënë, po s'më dëgjon njeri, — përgjigjet Titoja.

— Është e vërtetë, — thotë gazetarja, — bota thonë se këto që thotë Titoja janë fjalë të kota.

— Po kusarët si do t'i spastrojmë? — e pyet ajo.

— E kam theksuar, — vazhdon Titoja, — që të bëhen hetime mbi pasuritë, si janë vënë, ato që janë vënë me djersë, t'u lihen, pse ne jemi për pronën private, ato që shikohet se janë bërë me spekulime, të gjykohen etj.

¹ Dara Janekoviç — redaktore e gazetës «Vjesnik» të Zagrebit. Titulli i intervistës: «Mbi gjendjen në Jugosllavi dhe në LKJ».

— Duhet të forcojmë unitetin në parti, — predikon Titoja.

— Po si ta forcojmë, — i thotë gazetarja, — kur ju vetë thoni se në parti ka lloj-lloj shtresash me mendime të ndryshme?

Titoja vë në dukje haptazi gjithë kalbësirën e regjimit të vet, kalbësirën e partisë, ai kërkon të lajë veten, po futet deri në grykë në gjiriz. Titoja duket se është shkukur edhe nga trutë e kokës, se asnjë udhëheqës, sidomos një «kokë» si Titoja, nuk është parë kurrë të lukurisë të tilla gjëra. Duket që situata brenda në Jugosllavi është si jo më keq. Gazetarja e pyet sa më shumë, që Titoja të lukurisë dhe të komprometohet sa më keq! Këtë intervistë «lumë» e jep për «plotësimin» e një letre që i kanë dërguar Lidhjes, që kjo «të reagojë».

E bukura është ajo që, në kohën kur Titoja nxjerr këto bajga, Zhorzh Marsheja, udhëheqësi kryesor i Partisë Komuniste revizioniste të Francës, shkon në Beograd «të bisedojë me shokun Tito dhe të shkëmbejnë eksperiencë». Ç'gjë për të qeshur! Marsheja është agjent i sovjetikëve, ai me siguri vete ta nxjerrë Titon nga gjirizi në emër të sovjetikëve, të përforcojë tezat «e miqësisë së sovjetikëve ndaj Jugosllavisë».

Nga të dhënat e diplomatëve të ndryshëm, dhe veçanërisht nga ata të Bullgarisë në Beograd, marrim vesh se «Titoja nuk i ka mirë punët me serbët, se ai është në mosmarrëveshje të thellë me udhëheqjen serbe deri në atë shkallë sa Nikeziçi, udhëheqësi kryesor i partisë së Republikës Serbe, nuk i cakton takim Titos, i cili e kërkon një gjë të tillë». Kjo duket si një sfidë që i bëhet Titos nga grupi serb. Por diçka serioze duhet të ketë jo vetëm se bullgarët janë të informuar nga sovjetikët dhe nuk dinë t'i fshehin si duhet planet e këtyre të fundit, por fakt është se Titoja në këtë intervistë që i dha kësaj gazetareje, përmendi për të mirë «dhe që janë dakord me

pikëpamjet e tij» Kardelin, Bakariçin dhe Dolanskin. Asnjë udhëheqës serb, malazez ose maqedonas nuk u përmend.

Siç duket, klani serbomadh prosovjetik po i bën rezistencë Titos, ai i arriti goditjet e bëra kundër klanit kroat dhe po ndihmohet fshehur nga rusët, që janë pro hegjemonisë serbe për ta detyruar Titon sa është gjallë t'u bëjë lëshime sovjetikëve. Një politikë djallëzore nga më reaksionaret po bëhet nga të gjitha palët në arenë!

Kosovarët dhe Kosova ç'bëjnë në këtë situatë? Nuk dimë gjë konkrete dhe evitojmë çdo gjë e çdo hap që mund të kuptohet keq nga jugosllavët dhe t'u prishim punë shqiptarëve të Kosovës. Politika jonë ndaj Kosovës, marrëdhëniet kulturore e tregtare me të, janë nga më të hapëtat, më miqësoret, më të drejtat. Në këtë rrugë ne do t'i ndihmojmë kosovarët me të gjitha forcat. Ata vetë duhet të gjykojnë situatat reale që zhvillohen në Jugosllavi, ata vetë duhet të mendojnë dhe të veprojnë si për situatat aktuale, ashtu edhe për të ardhmen e Kosovës dhe të banorëve të kësaj krahine. Se ç'fat e pret Jugosllavinë pas vdekjes së Titos, ne kemi mendimin tonë. Situata aktuale është shumë keq dhe e turbullt, por akoma më keq dhe më e turbullt do të jetë ajo pas vdekjes së Titos, pse duhet njohur ashtu siç është, që ky qen kapitalist arrin të mbajë njëfarë ekuilibri mbi paterica të kalbura. Për kosovarët dominimi serbomadh do të jetë i tmerrshëm, ashtu si edhe ai ustash. Një gjendje e tillë, natyrisht, sjell rreziqe shumë të mëdha edhe për vendin tonë. Gjendja aktuale jugosllave është një e keqe për ne, por ka rrezik të bëhet edhe më keq. Prandaj ne jemi vigjilentë dhe do të jemi akoma më shumë vigjilentë për mbrojtjen e atdheut tonë socialist. Këtë çështje duhet ta ketë parasysh edhe populli shqiptar i Kosovës, pse është njëkohësisht në interesin e madh jetik të tij.

E PREMTE
13 TETOR 1972

TAKIM ME DELEGACIONIN E USHTRISË POPULLORE ÇLIRIMTARE KINEZE

Sot paradite bashkë me Hysniun e shokë të tjerë pritëm në selinë e Komitetit Qendror të Partisë delegacionin e Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze që ka ardhur te ne për shkëmbim eksperience. Takimi kaloi shumë ngrohtë. Duke u folur për situatën strategjiko-ushtarake të vendit tonë, u vura në dukje dhe u thashë që t'ua parashitrojmë shokëve të Shtatmadhorisë së tyre nevojën për një shtesë armatimesh dhe nevoja të tjera të ushtrisë sonë, që do t'ua paraqitë delegacioni ynë kur të shkojë në Kinë.

**QEVERIA KINEZE NUK E SHEH TË MUNDSHËM
PLOTËSIMIN E KËRKESAVE TONA EKONOMIKE**

Ambasadori ynë në Pekin na transmetoi tekstin e bisedës që kishte pasur me një zyrtar kinez, i cili i kishte komunikuar mendimin e qeverisë së tij për sa më poshtë:

Shokët tanë i kishin paraqitur disa kërkesa Fan Jisë kur ky ishte në Tiranë, për problemet tona të planit perspektiv 1975-1980, dhe konkretisht për rritjen e kapacitetit të shkrirjes së hekur-nikelit, për ndërtimin e hidrocentralit të Komanit dhe për zgjerimin e TEC-it të Ballshit. Por qeveria kineze hëpërhë plotësimin e këtyre kërkesave nuk e sheh të mundshëm. Ajo nxjerr si arsye «vështirësitë» duke thënë: «Ne nuk kemi rezerva të mëdha», «Të shohim, të ndërtojmë një herë këto që kemi marrë përsipër» etj.

Këto arsyetime të tyre nuk qëndrojnë. Ne do t'i kthehemi përsëri këtij problemi të madh. Kina i ka dhe do t'i shtohen akoma më shumë mundësitë në të ardhmen.

TITOJA NË KONFLIKT ME UDHËHEQËSIT E SERBISË

Titoja u fut publikisht në konflikt me udhëheqësit e Serbisë, duke i akuzuar ata për fraksionistë, grupashë, që nuk zbatojnë vendimet e marra nga Lidhja, nacionalistë, shovinistë etj. Ai sulmoi rankoviçistët, gjilasistët, mjetet e propagandës etj. Tregoi me një fjalë edhe një herë tjetër kalbësirën e madhe, kaosin që ekziston në Jugosllavi, frikën që ka nga katastrofa që e pret dhe mundësinë për ta frenuar atë. Kjo është esenca e fjali- mit të tij në aktivin e Lidhjes Komuniste për Serbinë.

**PËRSËRI MBI ÇËSHTJEN E BISEDIMEVE PËR
PROBLEMET KUFITARE ME GREKËT**

Sot biseduam përsëri se si të veprojnë shokët, që janë caktuar në komision, për të biseduar me komisionin grek për çështjen e rregullimit të piramidave kufitare dhe evitimin e incidenteve. Në rast se grekët nuk pranojnë në marrëveshje Protokollin e Konferencës së Firences, nga ana jonë të bëjmë një deklaratë për këtë, duke përmendur se, në bazë të këtij protokoll mund të bëhen rindërtimet eventuale të piramidave dhe ia bashkëngjitem marrëveshjes.

**VIETNAMEZËT NA NJOFTOJNË PËR
MARRËVESHJEN E TYRE ME IMPERIALISTËT
AMERIKANË**

Ambasadorët e të dy Vietnameve u paraqitën dje në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme dhe zyrtarisht komunikuan sa vijon: «Në bisedimet me amerikanët është arritur në marrëveshjen për largimin e amerikanëve (me çdo gjë) nga Vietnam i Jugut, pas 60 ditësh si të nënshkruhet «armëpushimi». Gjatë kësaj kohe vietnamezët duhet të kenë liruar robërit amerikanë. Në Vietnamin e Jugut do të ketë dy qeveri, dy zona (gjithsecili do të sundojë në zonat që ka), dy ushtri dhe do të krijohet një këshill i lartë që do të punojë për zbatimin e marrëveshjes, për realizimin e votimeve etj. Ky këshill do të përbëhet prej tri forcave: vietkongut, sajgonezë dhe forca e tretë. E gjitha kjo do të mbikëqyret nga një komision ndërkombëtar (?). Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të kontribuojnë në ndërtimin e Vietnamit të Jugut dhe të Veriut, do të paguajnë edhe «dëmshpërblime të luftës». Amerikanët nuk kanë pranuar dy-tri kushte të tjera (që janë jo shumë të rëndësishme).

Ambasadorët e të dy Vietnameve dukeshin të gëzuar për këto rezultate. Po ç'fituan në këtë mes?

Largimin e amerikanëve nga Vietnam (me «të gjitha armatimet», natyrisht jo me ato, dhe këto do të jenë shumë, që do t'u lënë kukullave të Sajgonit). Ky është

një plus. Një plus është (po ky i vogël përpara sakrificave), që shokët vietnamezë kanë një territor të çliruar të tyrin, një pushtet të tyrin dhe një ushtri në këmbë. Mirëpo përballë kanë një pushtet tjetër armik dhe një ushtri armike. Vietnam i Jugut u nda më dysh dhe lufta do të vazhdojë në mos me armë, si në Kore. U krijua një Panmunzhon i ri, me një ndryshim, që në Korenë e Jugut (Vietnam i Jugut) nuk ka ushtri amerikane, por do të vazhdohet të ketë amerikanë me rroba të tjera, civile, qoftë në anën e Sajgonit, qoftë në anën e Vietkongut. Natyrisht «Varkizë» plotësisht kjo nuk është, armët nuk i dorëzuan, por në rast se ndiqet një politikë revizioniste, oportuniste, në qoftë se mbështeten te «miku i madh e i sinqertë», revizionizmi sovjetik e të tjerë, mund të arrihet fare mirë në një Varkizë. Për ta kthyer Vietnamin në një shtet me të vërtetë demokratik, për të mos thënë socialist, do të duhet punë dhe luftë e madhe. Do të shohim se si do të luftojnë, si do të zhvillohet situata dhe si «do të përfundojë» kjo luftë.

Të gjithë, nga janë e nga nuk janë, do të ngrenë zërin e do të bërtasin se «u arrit një fitore e madhe», se «në këtë fitore kemi kontribuar fuqimisht etj.», dhe të gjithë do të vërsulen në Vietnam, gjoja «për të vazhduar ndihmën» por në fakt për t'u nxjerrë sytë vietnamezëve. Ashtu si i shpëtuan nderin Niksonit, ashtu do ta ndihmojnë këtë edhe në këtë fazë të qëndrimit në Vietnamin e Jugut me mjete të tjera. Niksoni e arriti në njëfarë mënyre vietnamizimin e luftës. Tash Frontit i duhet të përballojë dhe të likuadojë ushtrinë e Sajgonit, e cila është e fortë dhe e armatosur mirë. Në rast se Fronti mendon se këtë forcë reaksionare, që do të vazhdohet të ndihmohet nga imperializmi, do ta likuadojë me propagandë, ai gabohet. Lufta do të vazhdojë brenda, mundet edhe luftë civile, ndryshe çdo gjë do të bëhet «Ball». Kjo situatë do të jetë katastrofike dhe e paguar shtrenjtë.

E MARTE

24 TETOR 1972.

Ç'MUND TË NGJASË NË JUGOSLLAVI PAS VDEKJES SË TITOS

Sipas mendimit tim, pas vdekjes së Titos, në Jugosllavi, do të thellohen në kulm kaosi dhe anarkia; Jugosllavia kapitaliste, fryt i tradhtisë titiste, do të kredhet në kontradikta të mëdha e të shumta, do të bëhet preja e rivaliteteve nacionaliste të brendshme dhe fushë intrigash e fuqive të mëdha imperialiste, e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik, që kanë zënë pozita ekonomiko-politike në këtë vend dhe që përpiqen t'i konsolidojnë këto pozita reciproke në dëm të intereseve të popujve të Jugosllavisë. Por, për pozita influence e në mos edhe më shumë, deri në copëtimin e Jugosllavisë aktuale, janë të interesuar dhe lëvrijnë intensivisht edhe shtete të tjera kapitalisto-revizioniste, që bëjnë pjesë në grupimet e NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës ose jashtë tyre.

Por brenda në Jugosllavi klanet serbomëdha dhe ustasho-kroate do të përplasen fort njëri kundër tjetrit. Rreth tyre do të lëvizin interesat e maqedonasve, malazezve, sllovenëve, të Bosnjë-Hercegovinës etj. Në këto klane do të mbështeten edhe fuqitë e huaja për dominim të influencës së tyre, në mos për më shumë. Të gjithë përgatiten për këtë eventualitet, për këto goditje. Rol do të luajë ushtria jugosllave në vendosjen e hegjemonisë së njërës ose të tjetrës palë. Në qoftë se vendoset he-

gjemonia serbe, pavarësisht nga kamuflazhet demagogjike, Jugosllavia do të kthehet edhe më keq se ç'është sot në një vend me një diktaturë të hapët fashiste, e cila do të shtypë egërsisht popujt e ndryshëm që e përbëjnë, do të zhdukë edhe format më të zbehta aktuale të «demokracisë e të vetëvendosjes» dhe do të vendoset terrori i zi. Në këtë rast klani serbomadhi do të luftojë të ruajë formën federative për t'i mbajtur në zgjedhë popujt e tjerë. Kjo i intereson këtij klani dhe asaj fuqie të jashtme që e mbështet, po nuk i intereson klanit tjetër, atij kroato-slloven dhe fuqisë tjetër imperialiste që e mbështet këtë të dytin. Vetë regjimi titist, revizionisto-kapitalist i krijoj këto situata dhe këto konflikte. Për sa i përket nocionit të Federatës, nuk është i vjetër, ai është krijuar nga antanta fituese pas Luftës së Parë Botërore, pas vitit 1919, dhe nga krali serbomadh, diktatori Aleksandër Karagjorgjeviçi. Dihet konfliktet e egra me Radekun, Pashiçin, Paveliçin e me ustashët. Dihet mizoritë mbi kosovarët dhe mbi popujt e tjerë, por Federata u vendos dhe ajo u rivendos edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Do të vazhdojë edhe paskëtaj? Ky është problemi. Ngjarjet e ardhshme do t'i japin përgjigjen e saktë kësaj pyetjeje të rëndësishme.

Ç'mund të ngjasë? Ka shumë variante.

Të vazhdojë Federata? Klani serb, më i forti, më me tradita në sundim dhe i përkrahur nga rusët dhe nga bullgarët (të cilët tash kanë heshtur për rivendikimin e Maqedonisë, pse kanë kurdisur orët me sovjetikët), është për Federatën. Po morën fuqinë, ata do të ruajnë këtë formë. Kroatët dhe sllovenët janë kundër Federatës, jo vetëm siç është sot, por edhe ca më shumë siç mund të jetë nesër nën hegjemoninë serbe. Ata, duke mbështetur vetadministrimin, janë shprehur për njëfarë «konfederate» dhe ekstremistët për shtet më vete. Në këtë rast s'ka Federatë ose mund të ketë një «Federatë» pa

kroatët dhe sllovenët. Imperialistët amerikanë janë për Federatën por nën hegjemoninë e klanit kroato-slloven. Por mund të ngjasë edhe e kundërta: Serbia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina më vete, të bashkuar; Maqedonia të dalë më vete, me perspektivë që të bashkohet me Bullgarinë, e cila do të ngrrejë boritë e rivendikimeve.

Mbetet Kosova. Ç'do të bëhet ajo? Tendencia dhe lufta e klanit serb është dhe do të jetë ta gllabërojë në Serbi, ta skllavërojë. Varet shumë ç'do të bëjnë kosovarët. Do të luftojnë në këtë rast ata që të qëndrojnë jashtë Serbisë, të pavarur, në krahinë autonome që nuk ka më asnjë kuptim ose që ka një kuptim formal nën Serbinë, apo do të shpallin Republikën e pavarur të Kosovës? Pra populli i Kosovës vetëvendos dhe reziston deri në fund.

Probleme shumë të koklavitura do të krijojë situata e ardhshme në Jugosllavinë titiste. Prandaj vigjilenca jonë duhet të jetë e madhe dhe përgatitja ushtarako-ekonomiko-politike e vazhdueshme. Në këtë rrëmujë armiq-të që na rrethojnë, mund të orvaten të cenojnë kufijtë tanë, mund të na provokojnë, mund të afrohen edhe ushtritë e NATO-s dhe të vendeve të Traktatit të Varshavës në kufijtë tanë tokësorë të Veriut dhe të Lindjes. Prandaj ne do të përgatitemi për variantin më të zi, pse në përgatitjen e gjithanshme qëndron sigurimi i jetës së popullit tonë, i lirisë dhe i pavarësisë së atdheut tonë socialist.

BISEDE ME SHOKËT E DELEGACIONIT USHTARAK QË DO TË SHKOJNË NË RP TË KINËS

Bisedova me shokët e delegacionit tonë ushtarak që do të shkojnë në Kinë, për kërkesat që do t'i paraqitin Shtatmadhorisë kineze. U rekomandova që kur të flasim për gjendjen politiko-ushtarake të fqinjëve tanë, në mënyrë të veçantë, theksin ta vënë mbi gjendjen që mund të krijohet në Jugosllavi pas vdekjes së Titos. U zhvillova disa variante të asaj që mund të ngjasë atje, në një rast të tillë, si dhe për detyrat që na dalin neve që çdo gjë të na gjejë plotësisht të përgatitur, veçanërisht nga ana ushtarake.

TITOJA PËRPIQET TË LAJË HESAPET ME KUNDËRSHTARËT E TIJ

Dje mbrëmë agjencia Jugosllave e lajmeve, Tanjug, lajmëroi se udhëheqësit kryesorë të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë për Serbinë, Nikezić dhe Latinka Perović, u përjashtuan nga radhët e udhëheqjes për veprimtari grupazhi dhe si nacionalistë serbë etj. Tash kujt po i vjen radha? Flitet për maqedonasin Çërvenkovski. Po më tej?

Siç po duket, Titoja do që «t'i lajë hesapet me kundërshtarët e tij». Ai do dhe, para vdekjes, bën përpjekjet e fundit që të forcojë pozitat e partizanëve të tij, në portat që i ka vendosur për të ruajtur «unitetin» federativ të Jugosllavisë që kërcënohet seriozisht, të ruajë regjimin kapitalist nën maskën e vetadministrimit. Iu kujtua shumë vonë për të mballosur varkën që ka marrë ujë nga të katër anët. Goditja që u bën serbomëdhenjve është diçka pozitive, po kjo është si një gjilpërë që i futet «një elefanti».

Serbomëdhenjtë janë një forcë e rrezikshme që vetë Tito tradhtari e ripërtëriu me gjak të ri, e mahu dhe e forcoi. Të gjithë Rankoviçët janë gjallë e në aktivitet, ata organizohen për sulmin e ri që nuk do të mungojë të vijë. Një tradhtar i marksizëm-leninizmit që doli hapur kundër socializmit dhe lëshoi forcat e errëta në arenën e Jugosllavisë nuk mund t'i bëjë dot zap këto forca. Ma-

sat, që llomotit të marrë Titoja, nuk do të kenë efekt, pse ato përmbajnë në vetvete zhvillimin kapitalist. Masat e sipërfaqshme, që po merren ose që thuhet se do të merren, janë masa të një klike kapitaliste kundër një klike tjetër kapitaliste. Të gjithë termat që përdoren si: «socializëm», «proletariat», «diktatura e proletariatit» janë blofe dhe demagogji.

Titoja përpiqet të tregohet se po bën «një politikë ekuilibri» të brendshme dhe gjoja të pavarur përballë dy superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Në krizën e madhe që ka mbuluar Jugosllavinë Titoja ka nevojë për kredi dhe, për t'i siguruar ato ai lyp dhe merr nga mund dhe nga kushdo që i jep. Ai ka pasur paturpësinë të thotë se «nuk i ka borxh kurrkujt», në një kohë kur është deri në grykë në borxhe. Mund të merret edhe si e drejtë thënia e Titos, në qoftë se shikohet realiteti: gjysma e pasurisë së paluajtshme e Jugosllavisë është në duart e kapitalit të huaj, 50 për qind e aksioneve janë të tijat dhe të gjitha investimet janë të siguruar nga vetë kushtetuta jugosllave. Kështu Jugosllavia «mund të mos i ketë borxh njeriu», por gjysma e pasurisë së saj është pronë e kapitalistëve të huaj. Por nuk është vetëm kjo pronë e kapitalit të huaj, ky kapital shtohet çdo ditë, pse ekonomia jugosllave nuk është në gjendje t'u paguajë kuotat dhe përqindjet. Pra kusarë nga jashtë e kusarë nga brenda po e bëjnë helaq Jugosllavinë.

Përpara kësaj katastrofe Titoja dhe regjimi i tij gjoja bën presione jashtë. Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës shtrëngojnë qesen për të kërkuar koncesione më shumë, Titoja godet kroatët dhe siguron një kredi prej 1 miliard e 300 milionë dollarë nga Bashkimi Sovjetik. Bashkimi Sovjetik nuk i jep këto për sytë e bukur të Titos, por pse merr koncesionet që kërkon. Në qoftë se nuk merr porte me qira në Adriatik për flotën e tij, ai

merr të drejtën të dërgojë që «të riparohen» anijet e tij të luftës në portet jugosllave. Bashkimi Sovjetik i mbush portet jugosllave me «marinarë spiunë civilë». I ka këta atje për kohën e duhur dhe në kohën e duhur. Si, pa qëllim ndodhen në portet jugosllave një numër i madh anijesh luftime sovjetike... për riparim(!?). Sovjetikët punojnë me valë të gjata. Titoja godet udhëheqjen serbe, për sovjetikët ky qëndrim është thikë me dy presa, edhe nuk u pëlqen, edhe u pëlqen. Nuk u pëlqen, se i largohen miqtë nga postet komanduese, por edhe u pëlqen se i shtohen radhët e miqve të pakënaqur që i mban fshehurazi në pekule dhe në rezervë për momentin që pret të vijë.

Titoja, kur godet serbët, u thotë amerikanëve: zgjidheni më shumë qesen, se «ja, po e tregoj veten anti-serb, pra antisovjetik».

Ç'njeri cinik, ç'politikan «makëro», putanë e përsosur, që shet atdheun ashtu siç shet trupin dhe shpirtin e tij të fëlliqur. Mjerë populli jugosllav, mjerë klasa punëtore dhe rinia jugosllave!

UDHËZIME PËR DELEGACIONIN TONË TREGTAR QEVERITAR QË NDODHET NË PEKIN

Bisedova sot me shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave që t'u shkruajnë shokëve të delegacionit tonë tregtar qeveritar që ndodhen në Kinë të këmbëngulin në kërkesat tona dhe t'i rrëzojnë argumentimet e kundërta të Li Hsien Nienit. Të ngulin këmbë që Çu En Lai t'i presë para vajtjes në Pekin të delegacionit tonë ushtarak, i cili do të niset pas pak ditësh dhe, në rast se nuk i pret, atëherë të presin, por çështjet e tregtisë të mos lidhen me problemet e kërkesat që do të ngrejë delegacioni ushtarak.

Çuja këtë e ka taktikë që të mos na i plotësojë nevojat tona. Qëndrimi i shokëve kinezë nuk është i drejtë, pse kërkesat tona në ekonominë e madhe të Kinës nuk ngrenë peshë.

SHOKËT GJERMANË KËRKOJNË MENDIM PËR STATUTIN E PARTISË SË TYRE

Me Ramizin bisedova për problemet që ka ngritur Kryetari¹ i Partisë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste), i cili ndodhet te ne. Problemet kanë të bëjnë me statutin e partisë së tyre. Ne mendojmë që ky është i pastudiuar mirë dhe i parakohshëm. Shumë probleme të tjera të mëdha u dalin përpara shokëve gjermanë, zgjidhja me sukses e me etapa e të cilave do t'u tregojë edhe rrugën e një programi më real. Pikërisht mbi këto probleme biseduam me Ramizin për t'i diskutuar me të në frymë shoqërore.

¹ Ernst Aust.

**MBËSHTETIM POLITIKËN E SIHANUKUT KUNDËR
KOMPROMISIT ME IMPERIALISTËT
AMERIKANË**

Udhëzova shokët që të mbështetet deklarata që bëri këto ditë Sihanuku në Pekin, se kamboxhianët nuk do të bëjnë asnjë kompromis me amerikanët dhe me klikën e Lon Nolit, por do të vazhdojnë luftën e çlirimit deri në fitoren e plotë. Këtë deklaratë Sihanuku e bëri pas kthimit të tij nga Hanoi, ku ndenji një ose dy ditë.

**TË TREGOHEMI SHUMË MIQËSORË E DASHAMIRË
NË BISEDIMET ME SHOKËT KINEZË**

Shokëve të delegacionit ushtarak, të cilët do të nisen pasnesër për në RP të Kinës u fola përsëri dhe i porosita që bisedimet që do të zhvillojnë me shokët kinezë të jenë shumë miqësore, me dashamirësinë që karakterizon marrëdhëniet tona marksiste-leniniste. Kërkesat t'i paraqitin, t'i arsyetojnë mirë me qëllim që nevojat tona ata t'i kuptojnë në situatat e tyre. Prandaj, të bëhen kurdoherë diskutime të hapëta shoqërore, jo me nervozizëm, në rast se nuk plotësohen, por me suplesë.

MARRËVESHJA AMERIKANO-VIETNAMEZE PËR PAQE

Që kur filluan bisedimet në Paris, para katër vjetëve, në mes vietnamezëve dhe amerikanëve, ne gjykojmë se ato nuk do të sillnin asgjë të mirë, përkundrazi ishin shprehje e një vije të gabuar oportuniste, ishin një lëshim parimor dhe me pasoja të rënda për fitoren mbi imperialistët amerikanë dhe kukullat e Sajgonit.

Ne thoshim se kjo është me siguri vepra e elementëve të atij krahu revizionist të udhëheqjes së Vietnamit të Veriut, që janë miq dhe aleatë ideologjikë të revizionistëve të paturpshëm sovjetikë që, në miqësi me amerikanët, përpiqeshin t'i nxirrnin këta «të papërlyer» nga bataku. E vërteta është se edhe shokët kinezë ishin të një mendimi me ne, domethënë «Me luftë deri në fitore, të hidhen amerikanët në det dhe të merret pushteti në duart e popullit». Këto mendime ne nuk i mbajtëm për vete, por me qindra herë ua thamë haptazi shokëve vietnamezë, duke i siguruar, njëkohësisht, ata se populli shqiptar do ta ndihmonte pa kursyer luftën heroike të popullit vietnamez.

Vietnamezët na përgjigjeshin: «Ne do ta vazhdojmë luftën deri në fund; vetëm me luftë do të çlirohet atdheu nga amerikanët i fundit. Bisedimet e Parisit janë një luftë politike për demaskimin e armikut dhe asgjë më tepër». Po çështja nuk qe kështu dhe frika jonë ishte

e arsytuar: Parisi u bë «Mukja» e vietnamezëve, por më keq akoma ajo do të kthehet në «Varkizë», pse «Mukja» u likuidua që në vezë.

Ç'po ngjet që nga dita që ambasadorët e të dy Vietnameve në Tiranë na komunikuan zyrtarisht rezultatet e bisedimeve vietnamezo-amerikane? Asgjë nuk u përfundua. Verivietnamezët, përpara dredhive dhe pabesive (mjerë ata që këto veti të imperialistëve i marrin si një politikë realiste, paqësore, të amerikanëve), i publikuan ato çka na thanë neve në konfidencë dhe si «një përfundim të kënaqshëm». Pse i publikuan para kohe dhe në mënyrë të njëanshme? Pse amerikanët nuk mbajtën ato çka kishin thënë dhe çka kishin rënë dakord? Amerikanët nxorën probleme të tjera dhe jo të vogla, të cilat duhej të diskutoheshin dhe të rivendoseshin, nxorën se gjoja Van Thieu kundërshtoi «disa pika», «nuk do të firmosë» e të tjera avaze. Amerikanët lanë të kuptohet se nuk do të venë të firmosin «në datën e caktuar». Atëherë vietnamezët e botuan dokumentin gjoja për të demaskuar Niksonin para zgjedhjeve. Por Niksoni e përdori këtë deklaratë në favorin e tij, duke i thënë popullit para zgjedhjeve se «marrëveshja e paqes u arrit, ka vetëm disa gjëra të vogla që duhet të bisedohen dhe të përcaktohen më mirë etj».

Taktika vietnameze dështoi, por, po të studiohet deklarata e tyre mbi marrëveshjen e arritur me amerikanët duket që dhe strategjia e tyre ka dështuar. Vietnamezët nuk e arritën qëllimin përfundimtar të luftës së madhe që bënë. Politika e tyre oportuniste revizioniste bëri të dështojnë. Largimi i amerikanëve është një hipotezë e dyshimtë, por edhe në qoftë se ikin, ata mund të kthehen prapë, në rast se nuk u përmbushen kushtet: pushteti nuk u mor, po u nda me reaksionin më të zi.

Këto janë rezultatet e bisedimeve sekrete Kisinger-Le Duk Tho, Nikson-Brezhnjev dhe sovjetikë e vietna-

mezë. Këto janë «çorba», që gatuan të gjithë këta së toku. Populli vietnamez u tradhtua, lufta nuk mbaroi dhe atë po e mashtrojnë.

«Zgjidhjet e arritura» janë tipike sipas qejfit dhe interesit të të dyja superfuqive:

a) Lufta gjoja pushoi, por ajo nuk ka pushuar.

b) Lufta vazhdon dhe do të vazhdojë në mes dy qeverive dhe në mes dy ushtrive. Kush do të fitojë? Kjo mbetet një pikëpyetje e madhe.

c) Vietnamezët njohin qeverinë kukull të Sajgonit. Amerikanët njohin qeverinë e përkohshme të Vietnamit të Jugut. Qeveria kukull e Sajgonit njeh qeverinë e Republikës Demokratike të Vietnamit dhe jo atë të Jugut. Atëherë ç'fitore e madhe u arrit! Pse, për të arritur këtu u bë gjithë kjo luftë e u derdh kaq gjak?!!

ç) Në marrëveshje thuhet se do të ngrihet një komitet pajtimi. Ç'do të bëjë ky komitet? Do të bëjë zgjedhjet? Zgjedhjet parlamentare, apo ato të presidentit? Ky komitet do të jetë një qeveri mbi qeveritë? Asgjë nuk merret vesh! Po pse, për të krijuar këtë komitet u luftua dhe u derdh kaq gjak? Kështu do të çlirohej vendi me luftë deri në fund siç thuhej, apo me «politikë dhe me komitete»? Siç po duket me komitete.

Mirëpo ne, natyrisht, vëmë pyetjen: ja, u nënshkrua marrëveshja dhe të supozojmë se amerikanët ikën, atëherë kush do të fitojë dhe me ç'mjete do të fitojë ai që do të fitojë? Të marrim versionin se asnjë qeveri nuk çarmatoset, atëherë ose Vietnamit do të bëhet dy e tri pjesë (dhe në këtë rast përse luftuan), ose do të rifillojë prapë lufta civile. Ose versioni tjetër, do të shkrihet dhe vietnamezët do të vazhdojnë të bëjnë lëshime pas lëshimesh për të rishkarë në një «Varkizë», me shpresë që të marrin kalanë nga brenda. Kur të ketë bërë ballë puna, dhe ka mundësi të ngjasë kështu, pse oportunistët do të manovrojnë shumë, sovjetikët do të ndihmojnë dhe do

të inkurajojnë në këtë rrugë, amerikanët me politikë dhe me dollarë do të bëjnë ç'të duan, ata do të jenë kuzhinierët kryesorë të kësaj «turlie vietnameze».

Më në fund e më në bisht, kur të shohin se kalaja jo vetëm nuk u mor nga brenda, por armikut i përgatitën shilletë dhe postiqet të rrijë këmbëkryq brenda në kala, ata më të mirët do të mendojnë si partizanët grekë pas «Varkizës» se «duhen marrë përsëri armët dhe të dilet e të luftohet në mal». Në qoftë se fillon lufta, do të ndërhyjnë përsëri Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Naivët mendojnë se jo. Rezistencën e popullit grek e shtypi Van Fliti.

Verivietnamezët mendojnë se kryesorja është të ikin amerikanët, pa reaksionit ia dredhim kokën. Është e vërtetë se Thieu ka nevojë për amerikanët dhe ky dobësohet pa ta, por ka 1 milionë ushtarë në këmbë, që nuk janë pak. Vetëm naivët mund të mendojnë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do t'i ndihmojnë aleatët e tyre edhe në këtë «paqe të lëkundshme».

Pse e vonojnë nënshkrimin? Pse duan koncesione të tjera, të cilat, në rast se nuk jepen, vazhdohet lufta? Shtetet e Bashkuara të Amerikës luftojnë me ushtrinë e Thieut, e ndihmojnë këtë me bombardimet e tyre. Niksoni zgjidhet president, dhe i gjen fare lehtë arsyet të thotë se «marrëveshjen e shkelën vietnamezët».

Hrushovi i tha Kenedit: «Të zgjedha unë president». Tash Brezhnjevi, verivietnamezët dhe Çu En Lai mund t'i thonë Niksonit se «të zgjedhëm ne president». Sido që mendoj se kinezët nuk kanë ndërhyrë në këto punë të ndyra, është fakt se vajtja e Niksonit në Pekin, në ato kushte dhe në ato momente, pati rrjedhime shumë negative edhe në këtë çështje.

Siç duket, verivietnamezët kishin ndërtuar një taktikë e një strategji të tillë: «Të vazhdojmë luftën dhe të bëjmë bisedime, me të cilat të detyrojmë Niksonin, para

zgjedhjeve, që të tërhiqet. Afër zgjedhjeve lëshojmë një ofensivë të madhe dhe mundësisht pushtojmë qytetet e mëdha, duke përfshirë Sajgonin dhe Niksoni atëherë «kaput», kapitullon. Po ky rezultat nuk u arrit dhe, deshën s'deshën, vanë në kompromisin që po analizojmë.

Me bisedime Thieu nuk rrëzohet, vetëm me luftë rrëzohet. Ai i rezistoi ofensivës së vietnamezëve. Verivietnamezët dhe vietkongët në Jug pësuan një disfatë me këto rezultate që arritën, megjithatë u janë qepur këtyre dhe nuk u shqiten. Duke shpresuar të bënin presione te Niksoni, para zgjedhjeve, në të cilat ky do të fitojë, bënin zhurmë, ndërsa Niksoni u kërkonte koncesione dhe do t'u kërkojë akoma të tjera, më të rrezikshme. Do të lëshojnë më tej vietnamezët? Kjo rrugë këtë tregon. Jeta do të na informojë më mirë dhe do të na mësojë.

E PREMTE
3 NËNTOR 1972

TRAGJEDIA VIETNAMEZE VAZHDON

Amerikanët jo vetëm nuk pranuan të nënshkruanin me vietnamezët «marrëveshjen e arritur», por në fjali- met e tij të fundit në televizion, Niksoni deklaroi se nuk do të nënshkruajë kurrë një marrëveshje që të bjerë erë tërheqje. Ai do të nënshkruajë «një marrëveshje dinjitoze për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një marrëveshje që do të sigurojë një paqe të sigurt dhe të gjatë», e përralla të tjera të këtij lloji. Vietnamezët na thanë neve, kur na komunikuan projektin «e arritur», se kanë mbetur disa gjëra të vogla e të parëndësishme. Mirëpo Niksoni dje mbrëmë tha se «kanë ngelur pa vendosur gjëra të rëndësishme parimore» dhe la të kuptohet se nga Vietnami i Jugut duhet të tërhiqen forcat e Vietnamit të Veriut dhe se duhet të sqarohen dhe të vendosen shumë çështje, që qeveria e ardhshme e Vietnamit të Jugut të mos bjerë në dorën e «komunistëve». Pra, «luga është larg nga buzët».

Vietnamezët e Veriut ranë vetë kokë e këmbë në kurthin ku mendonin të futnin Niksonin. Ky kërkon koncesione të shumta që «fitoren e pretenduar nga verivietnamezët» ta kthejë plotësisht në një fitore të tij. Do të bëjnë koncesione të mëtejshme vietnamezët? Pse jo? Ata kanë hyrë në rrugën e kompromiseve dhe të koncesioneve. Sovjetikët po i shtyjnë në rrugën e kompromiseve dhe të koncesioneve. Sovjetikët po i shtyjnë me të

dyja duart përpara në prehrin e amerikanëve. Shokët tanë vietnamezë bënë gjithë këto koncesione tragjike dhe, në rast se pranojnë të tërheqin edhe ushtrinë e Vietnamit të Veriut nga Jugu, atëherë nënshkruan kapitullimin e plotë. Edhe këtë tradhti mund ta bëjnë, në rast se dëgjojnë sovjetikët, të cilët me siguri do t'u thonë: «Mos e humbisni rastin, ne jemi të fortë, ju na keni ne, tërhiqni ushtarët, i mbani mbi paralelin e 20-të të çlodhen, t'i riorganizojmë, t'i riarmatosim me armët më moderne dhe, në momentin e duhur, ia bëjmë bam. Tash Vietkongu është shumë i fortë për të luftuar brenda në frymën e marrëveshjes së arritur, ata e marrin kalanë nga brenda dhe ne do t'i ndihmojmë nga jashtë. Gjatë kësaj kohe ne i përvishemi ndërtimit të Vietnamit të Veriut, të cilit jemi gati t'i japim miliarda». Kjo duhet të jetë kënga e vdekjes që revizionistët sovjetikë po u këndojnë në vesh verivietnamezëve. Mjerë këta dhe i gjithë populli, në rast se nuk ndalen para disfatës totale!

E SHTUNË

4 NËNTOR 1972

JUGOSLLAVIA ËSHTË E KRIMBUR PËRGJITHMONË

Titoja vazhdon të qërojë hesapet në njëfarë mënyre me kundërshtarët e tij. Siç po duket, me serbët e ka të rëndë. Ai po përdor taktikën e detyrimit «të japin dorëheqjen» që nga Nikeziçi, Peroviçi, Tepavaci dhe deri te Koça Popoviçi. Mundet, nesër, edhe kryeministri i Serbisë. Titoja në fjalimet e tij i akuzon udhëheqësit serbë si «liberalë anarkistë». Flitet gjoja andej-këndeje se këta udhëheqës serbë nuk ishin pro afrimit me sovjetikët. Si zor të jetë vetëm kjo. Sidoqoftë Titoja nuk sjell më në fuqi njerëz nga të vjetrit, por të rinj të besuar të tij, duke dhënë përshtypjen se gjoja këta janë «njerëz të klasës punëtore». Kjo nuk është e vërtetë, është vetëm një bluf. «Goditjet», gjoja për vjedhje dhe grabitje, po bëhen në mënyrë sporadike deri tani, për të thënë se bëhen, kurse për edukimin marksist-leninist as që bëhet fjalë. Natyrisht, kjo është «vrma e fundit e kavallit».

Objektivi i Titos është të forcojë pozitat e tij për aq kohë sa do të rrojë dhe do të sundojë. Jugosllavinë e mori lumi dhe as ujët e Danubit nuk e lan dot këtë ndotësi të madhe e të pafund.

E gjithë kjo situatë është krijuar nga kriza e madhe e regjimit politik dhe ekonomik që krijoi Titoja, me idetë e tij antimarksiste. Siç e kemi parashikuar me kohë ashtu ngjau, filloi me çorganizimin e partisë, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë degjeneroi që kur filloi, asaj

iu hoqën rolet e saj kryesore, gjoja iu ruajt roli «edukues», por që nuk edukoi asgjë e as kërkënd. Titoja decentralizoi pushtetin dhe nuk kishte si të mos shfaqeshin dhe të konkretizoheshin tendencat centrifugale, të zhvillohej tok me ta nacionalizmi republikan, shovinizmi dhe tendencat hegjemone në republikat kryesore si ato të Serbisë e të Kroacisë që çojnë në prishjen e Federatës.

Vetadministrimi titist e ndihmoi këtë situatë të kalbur dhe krijoi luftën kapitaliste ndërmjet republikave, ndërmarrjeve, vuri në rendin e ditës interesat e ngushtë të ndërmarrjeve, të individëve dhe të pasurimit personal në kurriz të të tjerëve dhe të shoqërisë.

Në një shoqëri të tillë që u përtëri në Jugosllavi në këto baza kapitaliste, s'ka se si të mos krijoheshin klasat e vjetra antagoniste, të mos krijoheshin nga njëra anë shtresa e të pasurve, që grabitnin dhe, nga ana tjetër, shtresa e të varfërve, pra shfrytëzimi klasor, i cili do të sillte me vete, siç solli, pakënaqësinë e madhe të masave punonjëse, varfërimin e klasës punëtore, futjen e saj në borxhe ndaj një shteti, që nuk ishte më i tij, por i një klase të re spekulantësh politikë dhe hajdutësh ekonomikë që kishin në duart e tyre pasuritë e vendit, ndërmarrjet që i drejtonin dhe bankat që i financonin. Kulakët morën frenat në dhëmbë dhe në fshat, gjithashtu, u polarizuan forcat në kulakë dhe në fshatarë të varfër, që braktisnin fshatin dhe emigronin jashtë. Pra, në arenën e fshatit ngelën dy forca kryesore në ujdi e në aleancë, kulakët dhe fermat shtetërore në duart e teknokratëve sundues titistë në çdo republikë.

Ç'kërkon të bëjë Titoja në këto situata? Të forcojë diktaturën e tij fashiste, të cilën po e trumbeton, duke pretenduar se po kthehet në «kohët heroike». S'mjafton me ç'bëri, por do akoma më tej të hedhë baltë mbi marksizëm-leninizmin.

Ai thotë «të kthehemi në centralizmin demokratik»

në Lidhje, «të forcojmë disiplinën e kontrollin e shtetit», kuptohet diktaturën e tij, prandaj, sa është gjallë, ai spastron ata që nuk janë të tijtë. Këtë përqendrim të pushtetit në duart e «besnikëve të fundit të tij» e mbulon gjoja me marrje masash kundër «spekulantëve». Por këta spekulantë milionerë janë udhëheqësit kryesorë të regjimit. Atëherë për sy e për faqe do të godasë disa të vegjël që i njeh masa, por në thelb goditjet drejtohen kundër kundërshtarëve politikë të vetadministrimit. Udhëheqësit serbë, që Titoja i goditi dhe i akuzoi si liberalë, si anarkistë, po të pranojmë versionin e Titos, nuk janë veçse aleatët e ngushtë të rankoviçianëve, që gjoja minojnë vetadministrimin nga e majta dhe e Nikeziçit e të tjerëve nga e djathta. Të dy këta janë në një rrugë, në rrugën e shovinizmit dhe të hegjemonizmit serbomad. Të gjithë këta luftojnë për epërsinë në Federatë të Lidhjes Komuniste të Serbisë dhe hegjemoninë e Republikës së Serbisë. Pra këta të kenë vendet dominuese në politikë, në ekonomi, në çështjet financiare e bankare.

Goditja e «kroatëve» kishte ngjyrën e «separatistëve», kurse goditja kundër serbëve po bëhet me ngjyra më të përgjithshme, më të avancuara teoriko-organizative. U goditën po ashtu edhe sllovenët. Edhe këta luftonin për dobësimin e lidhjeve me Federatën e me Beogradin dhe për forcimin sa më shumë të lidhjeve me shtetet kapitaliste perëndimore.

Do të godasë Titoja në Maqedoni e në Kosovë? Nuk e besoj, pse këto dy vende janë sensibil në politikën e përgjithshme të tij. Në Maqedoni qëndrojnë rivendikimet bullgare dhe çdo goditje atje do të çojë ujë në mullirin e shovinistëve bullgarë. Kurse shqiptarët janë një problem tjetër shumë i ndërlikuar dhe i rrezikshëm për të po t'i ngacmojë. Shqiptarët janë goditur vazhdimisht dhe, në rast se pas kësaj gjoja paqe, vjen goditja, atëherë acarimi do të jetë i madh. Populli shqiptar është një popull

i ndershëm, ai nuk vjedh, nuk grabit, prandaj nga kjo anë nuk kanë përse ta akuzojnë. Udhëheqësit kosovarë ndjekin Titon, kështu që edhe nga kjo anë janë nën «ombrellë». Në qoftë se ndokush nga këta ka bërë disa shtëpi të paligjshme, Titoja do të mbyllë sytë se, përpara kusarëve të tjerë me çizme, këta janë «novisë».

Nga masat që trumbeton Titoja, disa do të mbeten kërcënime, shantazhe, disa do të frenojnë diçka, por asgjë nuk do të zgjidhin. Jugosllavia është e krimbur përgjithmonë.

E HËNË
6 NENTOR 1972

DELEGACIONI YNË ARRITI NË PEKIN

Delegacioni ynë ushtarak arriti në Pekin dhe u prit ngrohtësisht nga Jeh Çen Ji dhe nga një numër i madh oficerësh të lartë. Kishte dalë dhe Li Hsien Nieni.

**MËSIMET E PAVDEKSHME TË REVOLUCIONIT TË
TETORIT JANË E DO TË JENË RRUGËRRËFYESE
PËR REVOLUCIONARËT**

Sot është 55-vjetori i Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, që tronditi botën dhe çliroi një të gjashtën e saj nga skllavëria e kapitalit. Mësimet e tij të pavdekshme janë dhe do të jenë rrugërrëfyese dhe ndriçuese për revolucionarët. Ne na udhëhoqi dhe na udhëheq revolucioni që drejtuan dhe bënë Lenini dhe Stalini. Ai është yni dhe jo i revizionistëve sovjetikë, që tradhtuan revolucionin dhe i bënë varrin socializmit në Bashkimin Sovjetik. Po ky varr do t'i përpijë ata dhe revolucionin do të fitojë kudo.

TAKIM ME DELEGACIONIN E RINISË KINEZE

Sot paradite prita delegacionin e rinisë kineze¹ dhe pata me të një bisedë të ngrohtë.

Delegacioni kinez ka ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në Kongresin e 6-të të Rinisë.

¹ Delegacioni kryesohej nga anëtarja e KQ të PK të Kinës dhe zëvendëssekretare e komitetit të partisë të provincës së Ho-peit, Lu Ju Lan.

SHËNIM

Bisedova me Ramizin se si të trajtojë me Zhyrkenë, Sekretar i Partisë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste), çështjen e Shoqatës Francë-Shqipëri, pse ai, siç na raporton ambasadori ynë në Paris, nuk ka pikëpamje të drejta. Pikëpamjet e tij janë sektare. Sidoqoftë Ramizi ta dëgjojë atë me vëmendje kur të vijë dhe t'ia shtrojë hapur pikëpamjet tona, në rast se nuk puqen me të tijat.

ÇU EN LAI PRITI DY DELEGACIONET TONA QË NDODHEN NË PEKIN

Shoku Çu En Lai priti shokët e delegacionit tonë ushtarak dhe të delegacionit tregtar qeveritar dhe pati me ta një bisedë prej 4 orësh. Me shokët e delegacionit ushtarak ai do të bisedojë përsëri para se ky të kthehet.

Shokëve të delegacionit tregtar u akordoi sasinë e grurit që i kërkuan, por «me të qeshur» Çuja u tha se «më dërguat një ultimatum që të takohesha me ju dhe më quajtët burokrat». Shokëve tanë u mungon takti në kërkesa dhe kujtojnë se duhet t'u dalë e tyrja, si të duan dhe kur të duan ata. Këto janë qëndrime jo të hijshme për ne, që na vënë në pozita të vështira me miqtë dhe për disa gjëra që ne nuk kemi të drejtë të ngulim këmbë me një qëndrim prej mushke. Duhet të kemi parasysh se Çu En Lai nuk ka vetëm çështjet tona për të zgjidhur. Nganjëherë harrohet kjo gjë.

SHËNIM

Shokët e delegacionit tonë ushtarak që ndodhen në Pekin na njoftuan për mendimin zyrtar të shokëve kinezë mbi tratativat që po zhvillohen nga Vietnami i Jugut me amerikanët. Këto mendime puçen me tonat. Mendimet e mia për këtë çështje, që ia shfaqta delegatës së rinisë kineze, bënë që edhe ata të na i thonë neve mendimet e tyre.

SHËNIM

Dje u kthye nga Kina delegacioni ynë tregtar. Më raportuan për rezultatet e bisedimeve.

NUK DO TË MARRIM PJESE NË «KONFERENCËN E PËRGJITHSHME EVROPIANE MBI SIGURIMIN DHE BASHKËPUNIMIN»

Diskutuar dhe vendosëm për përgjigjen që Qeveria jonë do t'i dërgojë «promemories» së qeverisë finlandeze, e cila na fton të marrim pjesë në mbledhjen përgatitore, që do të mbahet në Helsinki, për «Konferencën e përgjithshme evropiane mbi sigurimin dhe bashkëpunimin». Ne e refuzojmë ftesën dhe arsyetojmë mospjesëmarrjen.

GJUHA SHQIPE PO LULËZON E DO TË LULËZOJË

Në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe

Mora pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Referatin kryesor e mbajti profesor Androkli Kostallari. U mbajtën kumtesa nga profesor Eqrem Çabej, Idriz Ajeti (kosovar), Mahir Domi, Dhimitër Shuteriqi e të tjerë. Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është një ngjarje me rëndësi historike për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare. Janë bërë përgjithësime shumë të rëndësishme, që do ta zbukurojnë dhe do ta çojnë më tej drejt përparimit gjuhën tonë, këtë thesar të madh, të pashtershëm dhe gjithnjë në rritje e në zhvillim të popullit tonë.

Referati i Androkli Kostallarit ishte një studim shumë serioz dhe kompetent. Po ashtu edhe kumtesa e Çabejt, dijetar i shquar i gjuhës sonë. Profesori kosovar, Idriz Ajeti, luftëtar i shquar i mbrojtjes dhe i përhapjes dhe më në fund i vendosjes së gjuhës letrare shqipe edhe në Kosovë, foli shumë mirë. Kumtesa e tij ishte e dokumentuar.

Gjuha Shqipe po lulëzon dhe do të lulëzojë.

I thashë Androkli Kostallarit që dokumenti bazë, origjinal i Kongresit, i cili do të nënshkruhet nga anëtarët e tij, të bëhet në disa kopje, me qëllim që të kemi në këtu, dhe të ketë edhe për Prishtinën, për Shkupin dhe për Malin e Zi.

**DIJETARËT KOSOVARË JANË ENTUZIASTË PËR
PUNIMET E KONGRESIT TË DREJTSHKRIMIT
TË GJUHËS SHQIPE**

Ramizi më njoftoi për bisedat shumë miqësore që kishte pasur sot me dijetarët kosovarë, në mes dy seancave, në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Këta ishin entuziastë për punimet që po zhvillohen në Kongres. Njëri nga këta i kishte thënë një shokut tonë se Fadil Hoxha i paska treguar se Nikeziçi, kishte sulmuar marrëdhëniet aktuale në mes Kosovës dhe Shqipërisë, me qëllim që t'i shkatërronte dhe njëkohësisht të godiste Fadilin. Ai, i kishte thënë Fadili, dështoi, por sidoqoftë ne duhet të jemi të kujdesshëm.

**SERBËT NUK DUAN QË KOSOVARËT TË VIJNË
NË FESTAT TONA TË NËNTORIT**

I pyetëm dijetarët shqiptarë që kanë ardhur nga Jugosllavia, që marrin pjesë në punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, nëse mund të vinin në festat e nëntorit që do të zhvillohen në Vlorë. Ata u përgjigjën se u qan zemra për një gjë të tillë, por «na kuptoni, situatat janë të tilla që nuk mund të vijmë dot. Mund të marrin masa kundër nesh». Ne i kuptojmë këta shokë.

NJË SHQIPTAR ME KURAJË TRADICIONALE

Jugosllavët penguan prof. Mark Krasniqin të merrte pjesë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Ai dha atëherë dorëheqjen si dekan i Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Prishtinës dhe i dërgoi Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe një telegram përshëndetjeje, ku i thotë, në mes të tjerash, «Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i uroj sukses në punën e tij me rëndësi historike për kulturën kombëtare. Organizatorët dhe pjesëmarrësit e Kongresit i përshëndes për zemërsisht», që do të thotë: «Unë me zemër jam me ju. atje...». Shqiptar me kurajë tradicionale!

TAKIM ME DELEGACIONIN E MINISTRISË SË INDUSTRIË METALURGJIKE TË RP TË KINËS

Sot pasdite prita delegacionin e Ministrisë së Industrisë Metalurgjike të RP të Kinës, që ka ardhur në vendin tonë. Delegacionin e kryesonte vetë titullari i kësaj ministrie Çen Shao Kuen.

SHËNIM

Sot, në orën 18⁰⁰/pasdite u bë këtu në kinoteatrin «7 Nëntori» mbledhja solemne me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe 29 Nëntorit, përvjetorit të Çlirimit të Atdheut. Foli shoku Hysni Kapo. Fjalimi që i mirë dhe u duartrokoi. Kur zbritëm nga tribuna, u takova me ministrin kinez të Metalurgjisë, polakun Mijal, francezin Zhyrke, brazilianin dhe dy shokë nga Ekuadori. U shtrëngova duart edhe shumë patriotëve të njohur që kanë ardhur nga vende të ndryshme të botës. Koncerti që u dha pas mbledhjes ishte i mirë.

Vlora ka bërë përparime në fushën e artit.

BISEDE ME VAJZËN E ISA BOLETINIT

Mora pjesë në darkën zyrtare që u shtrua në hotel «Adriatik»¹. Ishin ftuar vendës e të huaj. Në sallat ndihej një gëzim dhe entuziazëm i madh. Darkën e hapi me një fjalim të shkurtër shoku Petro Dode. Pas tij e mora fjalën unë². Fjalimi u dëgjua me vëmendje. U ngritën shumë doli, u kënduan këngë kombëtare patriotike etj. Veterani Xhebro Gjika u ngrit dy herë, ai improvizoi vjersha për ditët e shënuara dhe demaskoi me humor, në mes të të qeshurave, Hrushovin.

Me Hysniun e shokët e tjerë kaluam në sallat e tjera dhe në mes të një entuziazmi të madh u shtrënguam duart shumë të ftuarve. Kur do të largoheshim, u lamë lamtumirën dhe u përqaftuam me mallëngjim me të gjithë, duke lënë takim vitin e ardhshëm.

Në njërin nga sallat takova dhe bisedova me Ajete Boletinin, bijën e Isait, dhe me të mbesën. U fola për përpjekjet që kemi bërë për të sjellë nga Mali i Zi, ku është vrarë, në Shqipëri, eshtrat e Isa Boletinit. Malazetë, duke mos dashur të na i japin, na thonë se nuk e dinë ku është varrosur. Por ne, i thashë bijës së heroit,

1 Darka është dhënë nga Këshilli i Ministrave i RPSH dhe Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit të Vlorës me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë dhe të ditës së 29 Nëntorit.

2 Shih: «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 173.

nuk do t'i hedhim armët derisa t'i gjejmë ato, do t'i kërkojmë dhe do të ngulim këmbë për t'i sjellë në Shqipëri.

Në këtë darkë takova edhe dy profesorë të rinj shqiptarë nga Mali i Zi, që ishin delegatë në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Njëra ishte vajzë, me origjinë nga Manastiri. Ata ishin shumë të gëzuar, shumë të emocionuar. I tregova vajzës se edhe gruaja ime, Nexhmija, ka lindur në Manastir. I ftova të vijmë përherë në Shqipëri, që është atdheu i tyre dhe besoj, u thashë, se nuk do t'ju qesin pengesë. Ju vazhdoni punën e lavdishme të mësuesit, lidhuni ngushtë me popullin shqiptar të atyre vendeve, dojeni atë, mbronj gjuhën shqipe, se mbrojtja e gjuhës është mbrojtja e kombit.

VLORE, E DIEL
10 DHJETOR 1972

MUNGESË SENSI POLITIK

Beqir Balluku, që ka ardhur nga Pekini në Paris, siç më thonë shokët, nuk do të kthehet me avionin e së martës nga Roma, por ka kërkuar që avioni ynë të ndodhet në Bari të shtunën më 16 dhjetor. Siç duket, ai do që të qëndrojë në Paris e në Romë tok me të gjithë shokët që e shoqërojnë. Nga ana politike kjo që po bën Beqiri nuk është aspak e drejtë. Deri të shtunën i thonë 10 ditë që ai ka lënë Kinën, kështu që pas 10 ditëve do të lajmërojmë se u kthye në atdhe, gjë që nuk shkon fare. Ministri i Mbrojtjes na bredh rrugëve vetëm për të shëtitur, dhe në vende jo miq. Përveç kësaj, shokët i varrosën nënën kur ai s'ndodhej këtu, por edhe për këtë çështje këtij nuk i bëhet vonë që të kthehet sa më parë në Shqipëri. Fëmijët, gjithashtu, e presin. Nuk ka si të kuptohet një gjë e tillë, veçse mendjelehtësi dhe mungesë e sensit politik nga ana e tij. Ia kemi bërë këtë kritikë edhe një herë tjetër, kur donte të bënte po këtë gjë.

MANOVRAT E IMPERIALIZMIT AMERIKAN DHE PLEKSJA NË TO E VERIVIETNAMEZËVE

Po e ndjek me kujdes zhvillimin e «tratativave për paqe», që po zhvillohen në mes Hanoit dhe Uashingtonit, në Paris. Ato kanë ngecur në vend. Për këtë ne nuk kishim asnjë dyshim, vetëm udhëheqja e Hanoit kishte besim se «paqja» do të nënshkruhej. Verivietnamezët kishin besim se i shikonin ngjarjet në një prizëm oportunist dhe lëshimesh, mendonin se Niksoni, i gjendur përpara zgjedhjeve dhe opinionit «demokratik» amerikan, «do të përkulej përpara kërkesave të Hanoit», megjithëse këto ishin plot lëshime të rrezikshme.

Njerëzit që udhëheqin në Hanoi kishin një opinion të madh për veten e tyre, për politikën e tyre dhe kishin arritur në atë mendjemadhësi, sa që edhe opinionet e miqve të tyre të sinqertë nuk i merrnin parasysh. Dhe jo vetëm kaq, po ata arritën deri atje sa të deklararin me arrogancë se «kjo është çështja jonë e brendshme dhe të gjithë miqtë duhet të mbështetin veprimet tona». Por, nuk ishte kështu për të gjithë «miqtë» e tyre. Me miqtë revizionistë sovjetikë ata vepronin ndryshe dhe këta ishin miq të vërtetë për ta.

Mirëpo ndodhi që imperializmi amerikan dhe Niksoni nuk janë vetëm «kokëfortë», siç llo motitin verivietnamezët, por ata janë edhe dhelpër të rrezikshme. Këta manovruan dhe dredhuan aq bukur, sa i futën dhe i pleksën

në rrjetat e tyre «politikanët e mëdhenj» të Hanoit. «Imperializmi amerikan është i pabesë, ai s'e mban fjalën», «qajnë» njerëzit e Hanoit. Pse tash e kuptuat ju këtë realitet? Ku ishit deri tash? Apo kishit shpresa? Por këtë është e zorshme ta pohosh. Vetëm faktet tregojnë se udhëheqësit e Vietnamit kishin shpresa, bile arritën deri atje sa që të «zbutnin» fjalët dhe epitetet kundër imperializmit amerikan «për të mos i ofenduar», për të mos prekur «superndjeshmërinë e tyre». Këto janë fjalët e tyre, të zyrtarëve verivietnamezë, thënë njerëzve tanë zyrtarë.

Po le të vijmë në disa fakte. Në tetor, ambasadorët e Vietnamit në Tiranë i dorëzuan Qeverisë sonë projekt-marrëveshjen e arritur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për «paqe»! Ata ishin entuziastë, ishte çështje dite nënshkrimi i saj. «Disa gjëra të vogla e të parëndësishme kanë ngelur akoma por ato nuk pengojnë», thanë ata.

Kaluan gjithë këta muaj dhe asgjë nuk është nënshkruar, gjërat «e vogla e të parëndësishme» u bënë të mëdha dhe është arritur deri atje, sa amerikanët deklaruan se «verivietnamezët pengojnë në arritjen e marrëveshjes dhe se që të arrihet paqja, verivietnamezët duhet të ndryshojnë konceptet mbi paqen».

Pra bisedimet dhe «përfundimi» u bllokuan. Fol sa të duash ti, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dredhuan, s'mbajnë fjalën! Të gjitha këto ata i kishin dhe i kanë në plan, ti, pse re brenda? Ç'kishte në plan, Niksoni i tha, si të thuash hapur:

- 1) Të tërhiqet ndershmërisht nga lufta vietnameze.
- 2) Nuk do të sakrifikoje miqtë dhe aleatët e tij.
- 3) Do të tërhiqte gradualisht trupat amerikane nga Vietnam dhe lufta atje, në rast se nuk nënshkruhej paqja, do të vietnamizohej.
- 4) Ai kërkonte me të gjitha këto të krijonte për-shtypjen, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në

botë, para dhe në pragun e zgjedhjeve, se paqja ishte «te pragu i derës» dhe vetë Niksoni ishte ai president amerikan që «mund ta ndërtonte këtë paqe» etj.

Këto ishin qëllimet djallëzore të Niksonit. Verivietnamezët këto i hëngrën për djathë, kurse ato ishin sapun. Lufta dhe bombardimet vazhdonin çdo ditë e më të egra dhe bisedimet e buzëqeshjet vazhdonin në Paris, edhe në «Aveny Kleber», edhe në vilat private të revizionistëve francezë dhe të pasanikëve francezë të tjerë në mes Le Duk Thosë dhe Kisingerit. Bënë çdo gjë që nga verivietnamezët dhe deri te kinezët e te sovjetikët që ta ndihmonin fushatën elektorale të Niksonit dhe e ndihmuan: «Njeriu realist i paqes» quhej prej tyre kriminel i egër i luftës, i cili u rizgjodh president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe për 4 vjet të tjerë.

Niksoni, pasi u zgjodh, me shumicë votash, president, tha: «Tash që kapërceva lumin, ju dhjefsha kalin», «Dallëndyshe ktheje ndryshe». Dhe Niksoni ia ktheu këngës tjetër. Ai pa se me kë kishte të bënte dhe tash do t'u punonte qindin.

E para e punës, që të nënshkruhej marrëveshja gjoja e arritur, duhej të zgjidheshin më parë ato «gjërat e vogla» që kishin ngelur pezull, siç thoshin verivietnamezët. Këto «gjëra të vogla» u bëne gjëra të mëdha. Verivietnamezët duhej të bënin lëshime të mëtejshme, se «pak» lëshime bëne. S'flitej më që Van Thieu të hiqej nga mesi në këtë gjë. Verivietnamezët, që bënin aq zhurmë, lëshuan. Por nuk mjafton me kaq. Van Thieu tash është bërë personi nr. 1, «pa Van Thieun s'ka paqe në Vietnam».

Amerikanët manovruan bukur nën hundën e verivietnamezëve dhe për të gënjyer opinionin botëror. Një sërë pjekjesh të Kisingerit, të gjeneralit Heig me Van Thieun, deklarata të shumta dhe gjoja arrogante të Thieut, krijuan përshtypjen që Van Thieu «kundërshton

çka është arritur në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Hanoi», Van Thieu «kundërshton Amerikën»!!

Manovra amerikane u arrit: «verivietnamezët duhet të merren vesh me Sajgonin» dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Niksonin, nga kriminelët nr. 1 të luftës së Vietnamit u bëne «arbitër të çështjes vietnameze», u bëne rregullues, kurse Kisingeri me ecejaket e tij në Paris, në Uashington dhe në Sajgon, me takimet e tij me Le Duk Thonë, me Thieun e me Niksonin, është kthyer në arbitër ose në dirigjent të valles makabre. Dhe bota pret ç'do të dalë!

Niksoni, si arbitër, kohët e fundit, me anën e nazistit Kisinger, ka paraqitur kërkesën që të ndryshohet përmbajtja e pikave për të cilat gjoja kanë rënë dakord. Amerikanët kërkojnë të bëhen ndryshime.

Duhet të bëhen ndryshime në lidhje me komisionin ndërkombëtar. Verivietnamezët thonë që këta të jenë 150 ushtarë, kurse amerikanët duan të jenë me mijëra dhe të kontrollojnë çdo gjë lidhur me «armëpushimin». Pala amerikane kërkon që ushtria e Veriut ta lërë Jugun ose e shumta për një kohë të shkurtër të përqendrohet në dy-tri pika. Amerikanët nuk pranojnë që në marrëveshje të përmendet qeveria e përkohshme e Vietnamit të Jugut, por të përdoret vetëm termi «palët pjesëmarrëse». Amerikanët kërkojnë zhdukjen e «tri forcave», që përbëjnë «komitetin e pajtimit kombëtar» dhe sa për zgjedhje kërkojnë që të zgjidhet vetëm «presidenti». Amerikanët, natyrisht, duan të mbajnë zonën e çmilitarizuar, domethënë dy e tri Vietname. Amerikanët kërkojnë që armëpushimi të shtrihet edhe në Laos e në Kamboxhia. Kjo do të thotë që me këtë rast të mbrojnë edhe Lon Nolin e tradhtarë të tjerë. Përveç këtyre që dalin nga bisedimet, kush e di ç'kërkesa e ç'lëshime të tjera duan amerikanët. Do t'i arrijnë? Të shohim ç'do të lëshojnë vietnamezët.

Por Shtetet e Bashkuara të Amerikës tash «janë ca

kaluar». Ata, gjatë kësaj kohe, krijuan një situatë politike të re për veten e tyre për problemin vietnamez. Ata po e vazhdojnë vietnamizimin e luftës, po e armatosin me çdo gjë qeverinë e Thieut, i tërheqin javash-javash kontingjentet amerikane dhe vazhdojnë bombardimet. Bombardimet nuk pushojnë dhe nuk do të pushojnë, derisa verivietnamezët të kenë pranuar «paks amerikana»¹, me fjalë të tjera, «Varkizën». Ç'do të ngjasë? Do të shohim. Aktualisht revizionistët vietnamezë janë në rrugëkryq, këta kanë hyrë thellë në rrugën e kompromiseve dhe të tradhtisë. Dy rrugë ka: o t'i presin me shpatë nyjet gordiane, o të dorëzohen. Turp dhe katastrofë po të dorëzohen!

Populli heroik i Vietnamit nuk e meriton këtë turp që i bëhet dhe këtë disfatë që i kurdiset.

Le të shpresojmë se populli do ta vazhdojë luftën deri në fitoren e plotë dhe ne do të jemi me të dhe do ta ndihmojmë si kurdoherë.

1 Paqja amerikane.

VLORË, E DIEL
17 DHJETOR 1972*

DUKE LEXUAR PROCESVERBALIN E NJË BISEDE TË ÇU EN LAIT

Duke lexuar procesverbalin e mbajtur nga shokët tanë të delegacionit ushtarak, në bisedën e tyre me Çu En Lain në Pekin, mund të nxjerrim disa konkluzione:

Më gjatë dhe kryesisht në këtë bisedë Çu En Lai trajtoi problemet e politikës së jashtme të Kinës, disa aspekte kryesore të saj, probleme të brendshme dhe, në radhë të parë, «komplotin e Lin Biaos». Për sa u përket marrëdhënieve të Kinës me vendin tonë, ai foli në fund.

Në lidhje me marrëdhëniet me ne, Çu En Lai foli «me dashamirësi» dhe u përqendrua kryesisht në ndihmat që na japin. Ai theksoi se për sa i përket dhënies së ndihmave pas Vietnamit vijmë ne, pastaj me radhë vendet e tjera si Koreja etj. Ky është një gjykim që vetëm ata mund ta bëjnë, por ne nga ana jonë mund të themi se mund të na japin më shumë. Zaten vetë ata theksojnë se «ne nuk ju ndihmojmë sa duhet, se jemi akoma në vështirësi dhe, me t'i kapërcyer këto, do t'ju ndihmojmë më shumë».

Në përgjithësi, nga procesverbali, nga bisedimet e mëparshme të Çu En Lait me delegacionet tona vihet në dukje «preokupacioni» i shokëve kinezë për realizimin «me sukses dhe në kohë» të ndihmave për ne, si në sektorin civil, edhe në atë ushtarak, por vonesat në dërgesat

ose në realizimet ata ia vënë në kurriz sabotimit të bërë nga Lin Biaoja. Kjo është tema, si të thuash, kryesore e bisedës që bëri Çu En Lai dhe për të cilën, në thelb, do të flas më poshtë.

Tabloja që bëri Çu En Lai për problemet e politikës së jashtme nuk ishte ndonjë diçka «e shkëlqyeshme», si do që e tjerre mjaft gjatë. Në fillim, kur lexova proces-verbalin, pata përshtypjen se ai fliste për shokët tanë, por në fakt ai fliste edhe për galerinë, për shokët kinezë që kishte ftuar në atë takim. Problemet që ngriti ai ishin të njohura për ne, por brendia nuk kishte as ndonjë origjinalitet dhe as dukej perspektiva e ardhshme e politikës ndërkombëtare të Kinës, në të gjithë gjerësinë e saj. Ishin qëndrimet e zakonshme e të njohura nga ne në OKB për një varg problemesh, që ngrenë të tjerët, dhe për të cilat Kina duhet të mbajë qëndrim.

Objektivi i këtij qëndrimi është: «Të kundërshtojë dhe të demaskojë» qëndrimet sovjetike që «mashtrojnë dhe gënjejnë të tjerët». Kjo mirë, por ama asnjë veprim politik aktiv nuk bëhet nga ana e Kinës që të tërheqë vëmendjen në OKB, të tërheqë realisht «neutralët» nga ndikimi sovjetik dhe t'i bëjë këta «neutralë» ta ndiejnë veten të ngrohtë, duke ndier te Kina një përkrahëse të fortë dhe të vërtetë. Jo vetëm kaq, por në fjalën e Çu En Lait nuk shihet që të jetë menduar një plan pune e problemesh, që t'ua turbullojë armiqve statukuonë e rehatshme të krijuar në OKB dhe jo të detyrohesh të pranosh ligjin e tyre. Mendoj se nuk mjafton vetëm të thuash, si Çu En Lai, që «ne do të luftojmë edhe sikur vetëm të mbetemi në OKB, sepse luftojmë për drejtësinë». Kjo është drejt, por derisa luftojmë për drejtësinë, duhet të na mbështetin edhe shumë të tjerë, dhe këta shumë të tjerë nuk do të na mbështetin, në qoftë se edhe ne nuk i përkrahim, e jo vetëm «duke u dhënë kredi», sepse kështu bëjnë edhe

imperialistët dhe socialimperialistët, por duke i demaskuar pa mëshirë këto dy superfuqi, gjë që aktualisht Kina nuk po e bën si duhet dhe sa duhet.

Popujt e vegjël duan që superfuqitë të demaskohen dhe të pengohen në veprimtarinë e tyre. Po u bëre lëshime superfuqive, po tregove nuanca dhe preferime në marrëdhëniet me to, gjoja për të balancuar ose për të kundërbalancuar, atëherë humbi interesi dhe besimi i popujve ndaj teje, se ata shohin që të tilla akrobacira bëjnë çdo ditë qeveritë e vendeve të tyre për t'u shpëtuar thonjve të të mëdhenjve. Ata vërejnë me kujdes sidomos qëndrimet e Kinës, sepse e konsiderojnë shtet socialist të fuqishëm.

Kina tregon publikisht se ka nuanca në politikën e saj të jashtme, të paktën në propagandën kundër Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Edhe Çu En Lai tha se «ne u mësojmë më shumë sovjetikëve, sepse ata mashtrojnë më shumë, se hiqen si socialistë, kurse imperialistët amerikanë janë demaskuar si të tillë». Një gjë e tillë edhe është, edhe nuk është e vërtetë, por ta shpallësh këtë dhe të bësh dallime në praktikë, nuk është e drejtë, sepse në këtë mënyrë që të dyja superfuqitë do të luftojnë me armën që u jep vetë. Revizionistët sovjetikë, me këtë rast, thonë se «Kina është kundër socializmit», «bashkohet me politikën amerikane». Dhe në fakt, vetë diferencimi që ajo bën sot botërisht, duke thënë se armiku numër një është Bashkimi Sovjetik e pastaj vijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e çon në anën e këtyre të dytëve. Të tjerët kanë arsye të mendojnë kështu, pavarësisht se Çu En Lai s'mungon të thotë se Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë njësoj të dy.

Për sa i përket politikës që ndjek Kina ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Çu En Lai gati nuk tha asgjë; mundet apostafat ai e la në heshtje këtë çështje, duke

ditur pikëpamjet tona ose se nuk donte të zbuloheshin «marrëdhëniet përgatitore afruese», të cilat mund të shpërthejnë pas «nënshkrimit të paqes në Vietnam». Mendoj se të dyja këto arsye e bënë Çu En Lain të mos flasë për këtë pikë.

Këtë mendim ma përforcon edhe pikëpamja e Çu En Lait lidhur me perspektivën e luftës në Vietnam. Ai tha se Bashkimi Sovjetik e ndihmon pak Vietnamin. Kjo është e vërtetë. Por të ndihmohet pak Vietnamin do të thotë ta dobësosh mbrojtjen e tij. Çu En Lai ishte i mendimit se Bashkimi Sovjetik dëshiron që lufta në Vietnam të vazhdojë. Këtu ka një kontradiktë, e cila qëndron në atë që «nga njëra anë të mos i ndihmohet vietnamezët, dhe, nga ana tjetër, të kërkosh që lufta të vazhdojë». Sovjetikët mund të duan që lufta në Vietnam të vazhdojë, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbahen të lidhura me këtë luftë, që të pengohet Kina për të mos forcuar «miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës», që ajo të vazhdojë të mos ketë marrëdhënie diplomatike me të dhe të mos «zgjidhet» çështja e Tajvanit e «qëndrimi» i Flotës së 7-të Amerikane në ujërat kineze.

Të gjitha këto plane i bëjnë sovjetikët, atyre u interesojnë këto, por një gjë e tillë nuk përputhet shumë me atë që po bëjnë, duke mos e ndihmuar me armë Vietnamin. Sigurisht, sovjetikët, në aleancë me amerikanët, kanë shumë variante planesh në çantë, të cilat i azhurnojnë, i lidhin dhe i bashkërendojnë me të gjitha problemet botërore ku kanë futur hundët.

Çu En Lai nuk foli gati fare për çështjet e Evropës dhe të Lindjes së Mesme, dhe kjo ndodhi jo se ai nuk ka mendimet e tij mbi problemet e mëdha që po ziejnë atje. Vazhdon një politikë jo shumë e interesuar nga ana e Kinës për këto zona dhe, sipas mendimit tim, ky është një gabim, sepse zgjidhja e problemeve politiko-ushtarake në këto vende është me rrjedhime të mëdha për ven-

det e Azisë. Pikërisht këtu, në Evropë dhe në Lindjen e Afërt e të Mesme, të dyja superfuqitë përpiqen të gjejnë fjalën, të konsolidojnë aleancën dhe të kenë duar të lira për gjetkë, të paktën për një periudhë kohe. Të bësh një politikë pasive, siç po bën Kina, në këto momente dhe për këto rajone, nuk është një politikë tej pamëse, pse, duke vepruar në këtë mënyrë, e pret «kundërshtarin aleat» të të vijë në «marrëveshjet» imagjinare që ke rregulluar në një kohë me të. Kështu do të thotë «të presësh hijen», e cila është hipotetike me imperialistët, pse pikërisht edhe ata kanë punuar që «ti, Kinë, të presësh hijen» derisa «ata të rregullojnë punët e tyre» dhe, kur t'i kenë rregulluar këto pa kokëçarje, — sepse «ti, Kinë nuk i pengon në rrugën e tyre», — atëherë ata do të vijin «por me thikë në dhembë».

Çështja tjetër që Çu En Lai shtroi gjatë bisedës, ishte gjendja e brendshme në Kinë, çështja e grupit të Lin Biaos. Këtë problem ai e tori gjatë, megjithëse në vija të përgjithshme janë po ato gjëra që na tha zyrtarisht ambasadori i tyre.

Çu En Lai e karakterizoi veprimtarinë e Lin Biaos nga më të rrezikshmet që ka pësuar Kina. «Lin Biaoja dhe shokët e tij, tha ai, ishin komplotistë nga më të rrezikshmit, por ishin një grup i vogël prej 9 vetash». Këtu është kontradikta e parë. Sigurisht, pranohet versioni i Çusë që ata ishin komplotistë, por që këta 9 apo 10 veta përbënin rrezikun më të madh për Kinën, kjo të çudit, siç të çudit edhe kontradikta tjetër. Lin Biaoja dhe grupi i tij paskan sabotuar çdo gjë gjatë Revolucionit Kulturor! Këta si armiq që ishin, nuk ka dyshim që dëmtuan, frenuan, por që çdo dëm, çdo mosrealizim, çdo defekt të vogël, t'ua ngarkosh këtyre, do të thotë të forcosh dozën. Thuhet se ky grup i vogël, po shumë i rrezikshëm, sabotoi industrinë, bujqësinë dhe mekanizimet e saj, sabotoi armatimet e ushtrisë etj., etj.

Bëhet pyetja: Po të tjerët, të mirët, ku ishin?

Sipas Çu En Lait, çdo gabim në rrugën e diplomaci-së, në politikë, në ideologji, e ka bërë grupi i Lin Biaos.

**Shtrohet pyetja: Po të mirët ku ishin? Pse nuk reagu-
guan?**

Lin Biaoja ngriti lart kultin e Maos dhe ishte ai që e quajti Maon «marksist-leninist të madh», «udhëheqës të madh», «timonier të madh».

Përsëri bëhet pyetja: Po të tjerët, të mirët, ku ishin? Pse nuk i pengonin këto?

Sipas Çu En Lait, Lin Biaoja ishte njeri i sovjetikëve, por prapë sipas Çu En Lait, ai kishte frikë nga një sulm i afërt i tyre kundër Kinës, derisa, pa dijeninë e Byrosë e të Maos, kishte dhënë urdhër të mbusheshin aerodromet me hekurishte që të pengonin avionët sovjetikë të uleshin, dhe të hapeshin digat e të përmyteshin qytete që të pengoheshin desantët sovjetikë.

Dhe kështu, në procesverbalin e ekspozesë së Çu En Lait, gjen një sërë ngjarjesh, të lidhura e të shkëputura, të gjitha për të vërtetuar se grupi i Lin Biaos ishte një grup i rrezikshëm, tradhtar, sabotator etj. Deri atje shkon Çu En Lai sa të thotë që «Lin Biaoja hiqej si i sëmurë, po ai ishte një simulant».

Shumë gjëra të çuditshme për një person që «kishte arritur një post shumë të lartë».

Përse të mos i pranojmë ne të gjitha këto ç'po na rrokullisin tash për Lin Biaon, për një njeri që për ne ishte krejt i panjohur? Ai as që dilte në skenë, nuk kishte asnjë aktivitet dhe ishte për çka ishte ne s'dimë gjë, vetëm se atë e përkrahnin Maoja, Çuja dhe të tjerët, e përkrahte gjithë Partia. Dje të gjithë këta flitnin në mënyrë të shkëlqyeshme për të, sot ia veshin të gjitha të këqijat.

S'jemi dot në gjendje, thonë kinezët, të përcaktojmë deri ku kanë arritur të veprojnë këta armiq! Po ata

kanë vepruar, sipas Çusë, deri edhe në organizimin e kompleteve (dhe jo një herë) për të vrrarë Maon.

Vërejtjet tona për këtë çështje të brendshme të Kinës janë të shumta, sepse në këtë trajtim të problemeve, siç e bëri Çu En Lai, — dhe ky është versioni zyrtar i shtruar edhe në gjithë partinë e tyre, — ka kontradikta të mëdha e të shumta.

Së pari, në këtë shtruarje të problemeve harrohet krejt puna armiqësore e Liu Shao Çisë dhe e grupit të tij të madh, i cili kishte hedhur çdo gjë në duart e tij, kishte eliminuar Maon dhe partinë e kishte katandisur në atë gjendje, sa, për ta likuiduar këtë situatë, u desh të shpërthehej Revolucioni Kulturor. Vetë Maoja u ka pasë thënë disa herë shokëve tanë «akoma nuk dihet kush do të fitojë, ne apo ata».

Shokët kinezë, me sa dimë ne, nuk i kanë bërë një analizë të thellë marksiste-leniniste veprimtarisë armiqësore të grupit të Liu Shao Çisë për të zbuluar rrënjët dhe burimet e kësaj veprimtarie. Është shkruar dhe bërë propagandë kundër tij, po kjo ka ngelur vetëm propagandë. Faktet tregojnë se gjatë Revolucionit Kulturor lindi në udhëheqje një grup tjetër armiqësor më i rrezikshëm, i cili ishte në krye të Revolucionit Kulturor. Ky grup, që ishte në krye e që kishte për detyrë të spastronte armiqtë prosovjetikë, Liun e grupin e tij, na del edhe vetë prosovjetik!

Revolucioni Kulturor ishte i nevojshëm të bëhej, po a ishin të qarta direktivat që e udhëhiqnin? Edhe po, edhe jo. Duket sikur direktivat lindin nga një spontaneitet i çuditshëm, gjë që shkaktoi shtrembërime nga e djathta dhe nga e majta. Grupi i Lin Biaos ishte «ultra-majtist».

Për Revolucionin Kulturor është folur dhe shkruar shumë, por asnjë analizë e thellë për të nuk është bërë nga shokët kinezë. Revolucioni Kulturor i bëri mirë Ki-

nës, apo keq? Kinezët thonë se i bëri mirë, por si shpjegohet atëherë që Lin Biaoja dhe nëntë bashkëpunëtorët e tij sabotuan çdo gjë?

Të tilla analiza nuk janë shumë serioze. Lin Biaoja dhe C⁰ kanë sabotuar, por gjithë ajo veprimtari armiqësore e Liu Shao Çisë ç'u bë?! Po gjithë ata të tjerët që la prapa ky grup në parti e në pushtet, nuk e vazhduan sabotazhin?! Këto nënvleftësohen. U harruan lëkundjet e mëdha të klasës punëtore, bile edhe sabotimet, edhe goditjet me njerëzit e Revolucionit Kulturor, u harrua që partia pushoi çdo veprimtari, bile u shpartallua aq keq, sa akoma nuk është organizuar. Po organizatat e masave që u likuiduan fare? Pse? Sepse «nuk ishin në rregull». Ky çrregullim i madh nuk ka dëmtuar, nuk ka frenuar, nuk ka sabotuar? Këto gjëra duhen analizuar, por nuk analizohen vetëm duke thënë se të gjitha të këqijat i ka bërë Lin Biaoja.

Është thënë, dhe Çu En Lai përsëri vazhdon të thotë, se «ushtria ka qenë dhe është kolona». E çuditshme!! Në krye të ushtrisë ka qenë Lin Biaoja dhe «ai nuk mundi ta përdorte ushtrinë për qëllimet e tij», kurse mundi të sabotonte çdo gjë, kur në krye qëndronte Maoja dhe Çuja!! Kjo është e pakuptueshme, ose bëhet e kuptueshme vetëm duke menduar se Partia Komuniste e Kinës nuk ishte në rrugë të drejtë, nuk mendonte dhe nuk vepronte në bazë të marksizëm-leninizmit dhe në bazë të normave leniniste të një partie me të vërtetë revolucionare.

Në fakt, në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës kanë drejtuar grupe të ndryshme e me tendencë të ndryshme. Maoja ishte filozof, por, siç duket, filozofinë nuk e lidhte shumë me praktikën, ishte liberal, dhe në këtë drejtim linte të tjerët të organizonin, të drejtonin, të shtrembëronin. Ai i vinte pak rëndësi metodës kolegjinale të udhëheqjes dhe linte, si pa gjë të keq, të vepronin gru-

pet. Dhe grupet goditnin njëri-tjetrin. Maoja nuk ishte i huaj dhe reagonte në goditjen e këtyre grupeve, por ishin grupet që vepronin nën flamurin e Maos dhe me këtë flamur përpiqeshin të eliminonin edhe vetë Maon. Kështu bëri Liu Shao Çia e C⁰, kështu bëri edhe Lin Biaoja e C⁰.

Po Çu En Lai ç'bëri? Ky vazhdimisht dhe në çdo rrethanë është treguar shumë elastik, shumë pragmatist, njeri i shkuar me të gjithë, me më të fortët sa janë në fuqi dhe kundër tyre kur këta rrëzoheshin. Çdo qëndrim të tij, pro dhe kundër, Çuja e lidhte kurdoherë me «idetë e Maos». Pra, në çdo kohë, të mirë ose të keqe për të, ai në fillim e në fund të çdo ngjarjeje valëviste «flamurin e Maos».

Kjo tregoi se Çu En Lai, duke ndjekur si të gjithë idetë e Maos, vepronte në vijën e Liu Shao Çisë dhe e zbatonte atë në politikë, në ideologji dhe në ekonomi veçanërisht. Kështu ngjau edhe me grupin e Lin Biaos, ai mbajti po këto qëndrime.

Kur këto dy grupe thyen qafën, qafa e Çu En Lait qëndroi përsëri lart. Ai është më shumë diplomat sesa marksist, ai manovron në çdo rrethanë.

Çu En Lai u duhej të gjithëve, që nga Maoja e deri te Lin Biaoja, për arsye se është një njeri i zoti, organizator i madh, ekonomist i shquar, diplomat me talent dhe, në të njëjtën kohë, një oportunist i përsosur. Në të gjitha këto drejtime ai është një nga personalitetet më të shquara të Kinës pas Maos, bile mund të them edhe më i kualifikuar se Mao Ce Duni.

Këto zotësi, jo prej marksisti të vendosur, e drejta është të thuhet se i ka vënë në shërbim të Kinës, ashtu siç mendon ai, në një platformë të gjerë liberale. Karakteristike është se ky udhëheqës i lartë i Kinës tregon se ka një zotësi të madhe organizative për çdo gjë, por këtë talent nuk e vë edhe në shërbim të partisë. Jo, partia vuan nga organizimi. Pse? Shumë supozime mund të bë-

hen, por tash, në këtë shkrim të shkurtër, nuk mund të hyj e të bëj supozime, sepse edhe fakte e dokumente të mjaftueshme për këtë qëllim nuk kemi. Shokët kinezë janë shumë kurnacë në dhënie të fakteve e të dokumenteve.

Sidoqoftë, do të shohim se si dhe sa Partia Komuniste e Kinës dhe udhëheqja e saj do të nxjerrin mësim nga këto pësime, sa të vlefshme do të jenë këto dhe si do të zbatohen për të forcuar situatën në parti, në shtet dhe për të mirën e socializmit në Kinë dhe në botë.

Ne urojmë që çdo gjë atje të ndreqet drejt, të shkojë mirë. Mund që edhe të gabohemi në këto analiza, por nuk është marksiste-leniniste të mos i bëjmë, të mos mendohemi dhe të nxjerrim edhe ne mësim për veten tonë. Kemi qenë dhe jemi të detyruar që analizat tona t'i bëjmë mbi çka na thonë shokët kinezë, të cilat i besojmë, por me frymë kritike, marksiste-leniniste.

VLORE, E PREMTE

22 DHJETOR 1972

PO LUHET ME GJAKUN E POPULLIT HEROIK

VIETNAMEZ

Hanoi ka hyrë në rrugën e bisedimeve dhe të lëshimeve dhe s'del dot. Ai kërkon edhe paqe, vazhdon edhe luftën. As që bën të paktën orvatje t'i presë bisedimet me amerikanët, pse momenti është i favorshëm.

Uashingtoni nuk pranoi më çka kishte pranuar në tetor, ai kërkon lëshime të mëtejshme nga verivietnamezët dhe për këtë është në ujdi të plotë me Sajgonin. Uashingtoni e ktheu Kisingerin nga tryeza e bisedimeve dhe e vuri të deklarojë publikisht se verivietnamezët nuk duan të nënshkruajnë paqen dhe, për të bërë presion, amerikanët kanë filluar përsëri me forcë bombardimet. Me qindra avionë shkojnë këto ditë mbi Hanoi e Hajfong dhe sasia e bombave që kanë lëshuar arrin në 20 000 tonelata brenda dy-tri ditëve.

Natyrisht, kjo ka bërë përshtypje të rëndë edhe në miqtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët pritnin diçka të nënshkruhej. Atëherë Niksoni, për ta ulur këtë «deziluzion» i dërgoi një mesazh Thieut se gjoja është ai dhe Hanoi që nuk duan të nënshkruajnë paqen, prandaj o Thieu do të vijë në «rrugën e amerikanëve, o këta do t'i presin ndihmën ekonomike». Me gjithë këto profka Shtetet e Bashkuara të Amerikës vetëm dëshirojnë t'i thonë opinionit botëror: «S'kemi ç'bëjmë, nuk

jemi ne që nuk e duam paqen në Vietnam, janë vetë vietnamezët, të dy Vietnamet. Ne, amerikanët, jemi arbitri në mes tyre dhe bëjmë çdo gjë, që t'ia arrijmë pajtimit të tyre deri edhe me bombardimet e egra të Vietnamit të Veriut».

Sajgoni po bën të tijën, vazhdon luftën, është dakord me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, merr ndihma prej tyre, forcohet dhe kërkon lëshime të mëtejshme, domethënë të mbarohet lufta në favorin e tij, të mos ketë veçse dy Vietnam dhe Fronti të likuidohet.

Kina në dukje është që lufta në Vietnam të vazhdojë deri në thyerjen e plotë të amerikanëve dhe të sajgonezëve dhe për këtë ajo ka ndihmuar dhe ndihmon sinqerisht dhe më shumë nga kushdo tjetër. Por në vetvete ajo do që lufta të marrë fund, domethënë nuk ka shumë besim në një fitore të plotë, por llogarit edhe përfitimet e saj, në rast se lufta ndalohet. Kina thotë se Bashkimi Sovjetik do që lufta në Vietnam të vazhdojë, pse kështu ai mendon që të dobësohen Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të ndërpritet «miqësia kino-amerikane» etj.

Nga ana e tij s'ka asnjë dyshim se Bashkimi Sovjetik, në vija të përgjithshme, është në marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bashkimi Sovjetik lëshon be e rrufe për besnikërinë e tij. Betohet se do ta ndihmojë Vietnamin me çdo mjet në luftën që po bën, por, në fakt e ndihmon shumë pak. Bashkimi Sovjetik grin kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lëshon nota njëren pas tjetrës dhe njëkohësisht në fjalimin për 50-vjetorin e Bashkimit Sovjetik, Brezhnjevi e akuzoi Kinën për lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kuptohet edhe në çështjen vietnameze, pa e thënë haptazi, po kjo kuptohet qartë.

Të tilla janë manovrat që po luhen në kurriz të po-

pullit vëlla vietnamez, që ka kaq kohë që po lufton. Edhe ky vit u mbyll në turbullirë. Flitet se deri nga 20 janari nuk do të ketë «paqe».

Ne mendojmë se vetëm lufta e vërtetë dhe pa kompromise do të sjellë atje paqen e vërtetë. Edhe sikur diçka të nënshkruhet, në këto turbullira, kjo do të jetë një paqe e gënjeshtërt, e mbarsur me një luftë tjetër akoma edhe më të egër. Çdo pozë në këto situata të turbullta dhe të gënjeshtërta është në favor të imperializmit dhe të kukullave të tij të Sajgonit. Në këto situata dhe me këto mënyra do të thotë ta shkriësh luftën, ta demoralizosh dhe ta largosh popullin nga lufta për arritjen e fitores së vërtetë.

«DEMOKRACI SOCIALISTE» ALA KIM IR SEN

Kim Ir Seni, «udhëheqësi i lavdishëm i 40 milionë koreanëve», u zgjodh president i republikës, kryeministër i republikës dhe kryetar i partisë. I mbloodhi të gjitha pushtetet në një dorë: partinë, legjislativin, ekzekutivin, me një fjalë një «fashio e Liktorit» e vërtetë. Mao Ce Duni me një telegram plot lëvdata e dha «bekimin». Edhe Niksoni nuk ka grumbulluar kaq fuqi, ai nuk është kryetar i partisë. Megjithatë presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës zgjidhet çdo katër vjet, kurse Kimi është zgjedhur përjetë. «Demokraci socialiste» ala Kim Ir Sen.

1973

**PENGESA NGA PALA KINEZE PËR
METALURGJIKUN**

Ministri i Metalurgjisë i RP të Kinës dhe shokët e tij si «nëpër dhëmbë», pa e shtruar si problem me palë tonë, ngritën çështjen se në Kinë akoma nuk është zgjidhur problemi kryesor, domethënë nëse kombinati metalurgjik do të jetë elektrometalurgji apo koksmetalurgji, siç është vendosur. Metoda elektrometalurgjike ka qenë varianti i parë. Ajo u la. Tash është hedhur përsëri mbi tryezë dhe megjithatë nuk na shtrohet zyrtarisht që të bisedojmë e të vendosim. Procesi elektrometalurgjik është më i leverdishmi, por, si duket, kinezët janë prapa nga kjo anë, shumë probleme i kanë të errëta dhe, sipas zakonit të tyre, diskutimet mund të vazhdojnë pa fund dhe atëherë nuk do të respektohen afatet e ndërtimit të kombinatit. Prandaj, u thashë shokëve që pala jonë nuk duhet të rrijë në pritje dhe inaktive, por të kërkojë që të dërgojmë në Pekin shokët tanë specialistë për t'u përgatitur dhe për të diskutuar e vendosur një herë e mirë për këtë problem kyç.

E SHTUNE
13 JANAR 1973

NE INAUGURIMIN E AKADEMISE SE SHKENCAVE NUK DO TE FTOJME TE HUAJ

Shokët e Qeverisë më pyetën nëse mund të thërresim dijetarë shqiptarë nga Kosova me rastin e inaugurimit të së parës Akademi të Shkencave të vendit tonë. Një gjë të tillë ata, kosovarët, ia kishin ngritur shokut Aleks Buda. Unë isha i mendimit, dhe shokët e Qeverisë e gjetën të drejtë mendimin tim, se nuk duhet të ftojmë, për arsye se kjo ftesë politikisht nuk shkon. Akademia nuk është si Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Në këtë çështje shqiptarët e Jugosllavisë ishin drejtpërdrejt të interesuar dhe politikisht nuk mund të shkaktonte, siç nuk shkaktoi, asnjë fërkim me shtetin jugosllav. Ne bëmë ftesa edhe për në Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire, por ftesa iu bë Beogradit dhe andej erdhën dijetarë jo vetëm kosovarë, por edhe nga kombësitë e tjera të këtij shteti, siç erdhën edhe dijetarë nga vende të tjera. Për çeljen e Akademisë ne nuk ftojmë njeri nga asnjë vend, prandaj nuk është e drejtë që t'i drejtohemi Beogradit për të lejuar që të vijnë këtu vetëm kosovarë.

Nuk është as e rrugës t'i japim bujë ndërkombëtare vetëm faktit se formuam dhe inauguruam Akademinë. Ajo më vonë do të afirmohet, do të krijojë lidhje me akademitë e vendeve të tjera, mund të ketë më vonë edhe korrespondentë të huaj dhe për probleme të veçanta;

vetëm atëherë mund të bëhen ftesa. Dëshirën që kanë shfaqur dijetarët shqiptarë kosovarë për të asistuar në inaugurimin e Akademisë, me keqardhje, nuk ua plotësojmë dot.

E HËNE

15 JANAR 1973*

DISA DEKLARATA ANTIMARKSISTE TË ÇU EN LAIT

Këto dy javët e para të janarit kanë shkuar në Kinë për vizitë zyrtare, përveç të tjerëve, edhe një delegacion i qeverisë italiane, i kryesuar nga ministri i Jashtëm, Mediçi, dhe një delegacion kongolez (i Zaires), i kryesuar nga presidenti i kësaj republike afrikane, gjenerali Mobutu.

Të dy delegacionet i ka pritur Çu En Lai, i cili, natyrisht, ka biseduar me to për çështje politike dhe për të tjera, ka bërë deklaratat dhe ka afirmuar disa pikëpamje politike dhe ideologjike të tij, të cilat mendoj se kanë një rëndësi të veçantë për karakterin «specifik» të tyre. Është kjo që më shtyn të hedh në letër këto shënime.

Me italianin Mediçi, Çu En Lai pati një takim, në të cilin të dy shkëmbyen pikëpamjet. Por asgjë nuk u njoftua në shtypin kinez, përveç lajmit të takimit «të përzier», kurse shtypi, radioja dhe televizioni italian jo vetëm u bënë një jehonë të gjerë udhëtimit dhe bashkëbisedimeve Mediçi-Çu En Lai, por vunë sidomos në dukje këtë deklaratë të Çu En Lait:

Kina miraton Tregun e Përbashkët Evropian. aprovon dhe e gjen të drejtë krijimin e një «Evrope të Bashkuar», që kanë filluar të ndërtojnë shtetet perëndimore të Evropës.

Në banketin zyrtar që Çu En Lai dha për Mobutun,

në mes të tjerave, ai pohoi me plot gojë se «**Kina, me gjithë ndryshimet e formës së regjimit nga ai i Zaires, bën pjesë, natyrisht si dhe Zaireja, në botën e tretë. . .**». Kjo është një deklaratë zyrtare e botuar në shtypin kinez.

Për deklaratat e Çu En Lait drejtuar Mediçit, mund të supozohet se shtypi italian ka interes edhe të trillojë, duke i shtrembëruar ato. Një gjë e tillë edhe mund të ngjasë, por derisa nuk ka një përgënjeshttrim zyrtar nga vetë Kina, këto deklaratat duhet të konsiderohen se janë bërë. Ne kemi parasysh se pikëpamje të tilla mbi Tregun e Përbashkët dhe mbi «Evropën e Bashkuar» ambasadorët e Kinës në vendet e Evropës u kanë shfaqur shokëve tanë ambasadorë. **Pra, kemi të bëjmë me një orientim politik të dalë nga qendra, nga Pekini, me një vijë e një direktivë të lëshuar nga KQ i Partisë Komuniste të Kinës dhe nga qeveria kineze. Kjo vijë, pra, po vihet në zbatim pa ngurrim. Me këtë vijë, me këto orientime, ne jo vetëm nuk jemi në asnjë mënyrë dakord, por jemi në kundërshtim, për arsye se janë të gabuara parimisht dhe në praktikë, sepse nuk janë në vijën marksiste-leniniste, por në kundërshtim me të. Këto janë pikëpamje revizioniste-oportuniste, nuk ndihmojnë revolucionin, zgjimin dhe luftën revolucionare të popujve kundër imperializmit, kapitalizmit dhe borgjezisë reaksionare.**

Të shpjegohemi. Si i arsyetojnë shokët kinezë, dhe veçanërisht shoku Çu En Lai, protagonist i kësaj vije, këto qëndrime politike kyç në vijë? Vetëm me «shfrytëzimin e kontradiktave që ekzistojnë në mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik»? «Të luftojmë që t'i thellojmë këto kontradikta», — thotë Çu En Lai. Mirë deri këtu. Por në favor të kujt t'i thellojmë dhe a janë vetëm këto? S'ka të tjera kontradikta, të njohura dhe të panjohura, që duhet t'i zbulojmë dhe të luftojmë t'i thellojmë në interes të lirisë politike, ekonomike, të

sovrانيتit, të vetëvendosjes së popujve, në interes të revolucionit?

Këto kontradikta që ekzistojnë dhe që po acarohen çdo ditë e më tepër, kush i shkakton? Ku e kanë burimin, dhe a janë të thjeshta apo komplekse? A janë ato vetëm në mes të dyja superfuqive, apo shtrihen edhe më tej, më thellë? A duhet që ne, marksistë-leninistët, të kufizohemi duke u interesuar të thellojmë vetëm kontradiktat që ekzistojnë në mes Amerikës imperialiste e Bashkimit Sovjetik revizionist dhe të harrojmë kontradiktat që ekzistojnë dhe që duhen thelluar në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe «aleatëve» të tyre, në mes Bashkimit Sovjetik revizionist dhe «aleatëve» të tij, në mes të dyja këtyre superfuqive dhe shteteve të «botës së tretë», që janë në sferën e influencës së tyre? **A duhet të harrojmë ne çështjen e madhe klasore, luftën e proletariatit, domethënë zgjidhjen e kontradiktës së madhe në mes proletariatit dhe borgjezisë kapitaliste, në mes kapitalit dhe proletariatit, në mes proletariatit dhe popullit, nga njëra anë, dhe oligarkisë kapitaliste e pushtetit të saj, nga ana tjetër? A duhet të harrojmë ne që do shkaktohen me luftë pushteti i borgjezisë dhe në vend të tij të vendoset diktatura e proletariatit, që rendi borgjez kapitalist të zëvendësohet me rendin socialist?**

Në qoftë se i neglizhojmë e i harrojmë këto, ose përdorim formula për tymosje dhe në realitet veprojmë ndryshe, atëherë nuk i shohim, nuk i gjejkojmë dhe nuk i zbatojmë gjërat si marksistë.

T'i marrim çështjet një nga një. Është e vërtetë që ekzistojnë kontradikta në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, të cilat ne duhet t'i thellojmë. Ku e kanë burimin dhe bazën këto kontradikta? Burimi i tyre qëndron në vetë karakterin dhe në qëllimet e përhershme të kapitalizmit, në shfrytëzimin e pamëshirshëm të proletariatit, në skllavërimin e po-

pujve. Imperializmi, faza e fundit e kapitalizmit, është në kalbëzim e sipër. Ai lufton me gjak, me hekur, me politikë, me ideologji që t'i mbajë popujt të skllavëruar, të shtypë revolucionet, të godasë rivalët që i paraqiten në arenën ndërkombëtare. Armiqtë vendimtarë të tij, të cilët, më në fund, do ta zhdukjin atë, janë popujt, është proletariati botëror, është revolucioni.

Historia vërteton se rivaliteti midis grupimeve kapitaliste të një vendi dhe grupimeve kapitaliste të një vendi tjetër ose midis grupeve kapitalistësh të disa vendeve kundër grupeve kapitalistësh të disa vendeve të tjera për të sunduar botën, për të krijuar dhe për të zgjeruar perandoritë e tyre koloniale, për të ndarë zonat e influencës dhe tregjet, ky rivalitet, pra, ka krijuar konflikte dhe e ka hedhur botën në luftëra të përgjakshme. Këto kanë qenë kriza të mëdha për njerëzimin, ato kanë pasur si qëllim shfrytëzimin dhe shtypjen e njerëzve, të popujve, të shteteve më të dobëta nga më të fuqishmet. Demagogjia e luftënxitësve dhe e skllavëruesve gënjente njerëz dhe popuj, duke shfrytëzuar aspiratat e shëndosha të tyre, por megjithëkëtë asgjë nuk mund t'i shuante ndjenjat e lirisë, të pavarësisë, të çlirimit e të revolucionit. Forca e këtyre ndjenjave dhe aspiratave ka ardhur duke u shtuar. Masat punonjëse të shtypura e të shfrytëzuara u bënë forca vendimtare lëvizëse drejt përparimit, forca kundërshtarë më e rreptë kundër kapitalizmit skllavërues, kundër imperializmit. As shndërrimi i Bashkimit Sovjetik në një vend kapitalist, as shndërrimi, gjithashtu, i një vargu shtetesh të demokracisë popullore në shtete borgjeze kapitaliste, nuk e ndryshuan dot këtë tendencë të zhvillimit. Revolucioni marshon përpara, socializmi vërteton pareshtur vitalitetin e tij; imperializmi amerikan, lidhësi i një sërë shtetesh kapitaliste, dhe social-imperializmi sovjetik, lidhësi i një sërë vendesh revii-

zioniste, janë në një krizë të thellë politike, ideologjike, ekonomik-financiare, kulturore dhe ushtarake.

Këto kriza të mëdha vdekjeprurëse ia shkaktojnë kësaj bote të kalbur, që po perëndon, grevat, protestat etj., revolucionin që zien kudo, si dhe lufta çlirimtare e popujve me të gjitha format dhe stadet që po zhvillohet në gjithë botën. **Këtu qëndron baza e luftës sonë kundër imperializmit dhe socialimperializmit; këto janë armët vendimtare që duhet të përdorim ne për t'i mposhtur ata. Rreth këtij qëllimi të madh duhet të ndërtohen në mënyrë të drejtë strategjia dhe taktikat tona të luftës dhe, për t'i thelluar kontradiktat midis armiqve, në këto parime duhet të bazohemi dhe jo në fantazi, në aventura apo në qëndrime oportuniste.**

Siç dihet, pas Luftës së Dytë Botërore imperializmi amerikan doli i fuqishëm e me një potencial ushtarak dhe ekonomik agresiv. Ai mori në dorë dhe mbi vete rolin e xhandarit ndërkombëtar dhe punoi për mëkëmbjen e të gjitha forcave reaksionare kapitaliste në Evropë, në Amerikën Latine e gjetkë. Imperializmi amerikan kishte përballë kampin e madh të socializmit dhe gjithë popujt e botës, që aspironin dhe luftonin për çlirim.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës brenda disa vjetësh mëkëmbën Gjermaninë e Bonit, Italinë, ekonominë kapitaliste franceze dhe angleze etj., por nuk munguan të kujdeseshin që për çdo ndryshim që bëhej në këto vende, të ruanin «racionin» për vete, domethënë që pjesa e luanit t'u takonte atyre. Shtetet e Bashkuara të Amerikës «i lehtësuan» këto vende nga kolonitë e tyre, të cilat i bënë të vetat me metoda të reja. Imperialistët amerikanë, gjoja duke i mëkëmbur këto shtete, forcuan hegjemoninë e tyre në botë, i lidhën «aleatët» pas qerres së tyre me lloj-lloj traktatesh ushtarake dhe ekonomike. Të gjitha këto shërbenin për të forcuar, në radhë të parë,

hegjemoninë amerikane, për të forcuar borgjezinë reaksionare në çdo vend, për të shtypur çdo lëvizje dhe aspiratë popullore në këto vende e në botë dhe për të krijuar një bllok të hekurt kundër Bashkimit Sovjetik socialist, kundër komunizmit. Lufta e ftohtë, luftërat agresive të veçuara dhe kërcënimi nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me bombën atomike nuk i trembën asnjëherë as vendet socialiste, as popujt e botës.

Tradhtia e madhe e revizionistëve sovjetikë e dobësoi kampin e socializmit, por as revolucionin botëror nuk mund ta pengonte të ecte përpara, as socializmin nuk mund ta zhdukte si rend ekonomik-shoqëror dhe si ideologji marksiste-leniniste; gjithashtu as që mund të shuante dëshirat dhe aspiratat e popujve për të luftuar për socializmin. Marksizëm-leninizmi është i pavdekshëm dhe kurdoherë triumfues.

Por ç'ndodhi? Me tradhtinë e revizionistëve sovjetikë, u shuan vallë kontradiktat e kohës sonë në gjithë kompleksin e tyre? Aspak. Ato u shtuan, si për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si për Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe për aleatët e tyre, pavarësisht nga traktatet, nga marrëveshjet, nga ujdite diplomatike etj., etj. **Kontradiktat që kanë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë me njëri-tjetrin kurrë nuk mund të shuhen e as të zvogëlohen, përkundrazi, ato shtohen, zmadhohen. Burimi dhe baza e tyre qëndrojnë kurdoherë në ato çka ekspozova më lart. Aktualisht të dyja superfuqitë, me gjithë kontradiktat që kanë, janë në aleancë për të luftuar vendet me të vërtetë socialiste, për të luftuar partitë komuniste marksiste-leniniste, për të luftuar aspiratat e popujve për liri, për vetëvendosje dhe për sovranitet, për të luftuar dhe për të shuar luftërat e drejta të popujve. Në të gjitha këto drejtime ato janë dakord. Janë dakord, pra, që të luftojnë socializmin dhe komunizmin.**

Shtetet e Bashkuara të Amerikës luftojnë që të ruaj-

në hegjemoninë në botë; Bashkimi Sovjetik lufton që të vendosë hegjemoninë e tij. Pra ekzistojnë rivalitete për ndarjen e zonave të influencës dhe për minimin e aleancave që kanë këto dy superfuqi me të tjerët. Kjo gjë hyn në lodrën e zonave të influencës dhe ka krijuar e do të krijojë, natyrisht, kontradikta të reja, fërkime serioze, mundet edhe fërkime me armë. Bomba atomike shërben deri tash si faktor frikësimi për të frenuar shpërthimin e konflikteve midis dy superfuqive.

Imperializmi amerikan dhe aleatët e tij evropianë dëshirojnë, dhe luftojnë ta çojnë deri në fund, dobësimin e fuqisë imperialiste sovjetike, që ajo të mos bëhet më e rrezikshme, jo vetëm ideologjikisht, por mundësisht të varet edhe ekonomikisht prej tyre dhe që forca e saj agresive ushtarake, së cilës ia kanë frikën Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të dobësohet e në këtë drejtim janë dakord edhe aleatët e tyre të tjerë. Prandaj ata synojnë drejt likuidimit të varësisë së vendeve të Traktatit të Varshavës prej Bashkimit Sovjetik. Këtu ata kanë korrur mjaft suksese dhe me siguri që do të korrin të tjera, se satelitët e Bashkimit Sovjetik në Evropë, duke filluar që nga Rumania e deri te Polonia, sytë i kanë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Republika Federale e Gjermanisë, nga Franca e nga Anglia. Pazarllëqet nëpër kulisat e diplomacisë së fshehtë janë në rend të ditës; frika e imperialistëve nga popujt është e tmerrshme.

Vendet kapitaliste të Evropës, me gjithë rimëkëmbjen e tyre ekonomike, janë në krizë të madhe dhe popujt që jetojnë në to shtypen nga oligarkitë vendëse. Kudo bëhen greva, demonstrata, goditje me armë deri në luftë, si në Irlandën e Veriut. Ç'tregon kjo? Kalbëzim të kapitalizmit dhe ngritje të forcave revolucionare. Por, përveç shtypjes dhe shfrytëzimit nga oligarkia vendëse, në këto shtete sundon edhe thundra e egër e imperializmit amerikan. Në këto situata edhe ato duan t'i shpëtojnë

thundrës së amerikanëve. Po si? Shkëputja e Dë Golit nga NATO-ja, krijimi i forcës goditëse atomike të pavarur nga ana e Francës, krijimi i Tregut të Përbashkët Evropian dhe ideja e hedhur e lufta e vazhdueshme që po bëhet për krijimin e «Shteteve të Bashkuara të Evropës» nuk kanë për qëllim vetëm t'i shpëtojnë diktatit amerikan. Kjo është njëra anë. Ana tjetër tregon se borgezia mendon që bashkimi i monopoleve të mëdha të këtyre vendeve do të krijojë një fuqi kompakte ekonomike, politike dhe ushtarake që do të jetë më mirë në gjendje të shtypë revoltat dhe revolucionet popullore, të cilat, që tash, kanë shkaktuar telashe të pakapërcyeshme e që më vonë, për arsye të krizave kronike, do të jenë akoma më të zymta për të. Por të gjitha këto plane reaksionare nuk do të zgjidhin asgjë për të. Oligarkitë e këtyre shteteve dëshirojnë që, derisa të sigurohen nga rreziku që u vjen nga Bashkimi Sovjetik, ta ruajnë NATO-n, domethënë të ruajnë ndihmën ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këtu ka një varg kontradiktash: Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta mbajnë NATO-n, por nuk duan që Tregu i Përbashkët Evropian të bëhet një barriera për to dhe, ca më keq, që «Shtetet e Bashkuara të Evropës» të bëhen një fuqi e madhe. Kush do të mbizotërojë ndër shtetet që do të bashkohen në këtë organizatë? Franca, Gjermania Perëndimore apo Anglia? Po ngjallen kështu rivalitete të tjera, «aleanca» të reja, grindje të vazhdueshme, që ne, marksistë-leninistët, duhet t'i analizojmë drejt, t'i parashikojmë drejt dhe të mbajmë qëndrime të drejta.

Le të vijmë tash te deklaratat e Çu En Lait, që, për t'i bërë më të qarta, u detyrova të shkruaj këto shënime, mundet ca si të gjata, por megjithëkëtë jo të plota.

Shtypi dhe radioja italiane shkruajnë dhe flasin me entuziazëm për qëndrimin e kinezëve, të cilët, me gojën e Çu En Lait i bëjnë thirrje Evropës «të gjejë unitetin e

saj në të gjitha drejtimet». Sipas thënieve të Çu En Lait (kurdoherë në bazë të shtypit italian) «procesi i integritimit evropian përbën një element esencial për të arritur një ulje të vërtetë të tensionit». Çu En Lai, sipas po këtij shtypi, vuri theksin «mbi nevojën që ky proces të mos kufizohet në sektorin ekonomik, por të prekë edhe fushat e politikës dhe të mbrojtjes». Nuk ka ku shkon më qartë. Derisa këto nuk u përgënjeshtroan, Çu En Lai i ka thënë.

Këto mendime të Çu En Lait janë antileniniste e reaksionare, në kundërshtim me tezat e njohura të Leninist mbi problemin e «Shteteve të Bashkuara të Evropës». Këto pikëpamje të Çu En Lait radhiten kështu në një vijë me ato të reaksionit evropian.

Çu En Lai është për integrimin evropian në interes të kapitalit të madh kozmopolit, domethënë për sundimin e tij politik, ekonomik dhe ushtarak mbi popujt e Evropës, për atë që ligji i hekurt i kapitalit të sundojë mbi popujt e Evropës. Me tezat e tij, Çu En Lai (që na hiqet si teoricieni i shfrytëzimit të kontradiktave), i injoron krejtësisht kontradiktat e mëdha dhe të pakapërcyeshme në mes proletariatit e popujve të Evropës, nga njëra anë, dhe regjimeve borgjeze reaksionare të vendeve të tyre e oligarkive kapitaliste, nga ana tjetër, ai harron, gjithashtu, edhe kontradiktat në mes vetë këtyre oligarkive. Pra, Çu En Lai bën thirrje të shuhet lufta klasore, bën thirrje të bëhet integrimi evropian, bën thirrje të mos thellohen kontradiktat e kapitalizmit evropian në favor të proletariatit. Me të drejtë, pra, shtypi reaksionar ekzalton Çu En Lain dhe ka arsye të mëdha që e bën këtë.

Proletariati italian gati çdo ditë është në grevë. Borgjezia italiane kërkon t'i shpëtojë kësaj dare. Italia është kthyer në një bazë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër proletariatit, por pa dobi. Reaksioni italian përdor kërbacin e policisë, por hovin e grevave nuk e ndal dot. Borgjezia lufton për integrimin evropian, për krijimi-

min e «Shteteve të Bashkuara të Evropës» dhe kuptohet ç'pret ajo nga kjo dhe ç'të këqija i presin punëtorët dhe popujt e Evropës. Dhe këtu borgjezinë e ndihmon Çu En Lai, i cili u rekomandon popujve dhe proletariatit të Evropës të ndjekin me besim udhëheqësit e tyre, në vend që t'u thotë: «Ngrihuni kundër armiqve të klasës dhe bëjuni varrin dhe i futni brenda, në vend që t'ju futin ata».

Por ç'e shtyn Çu En Lain që të dalë kaq hapur në opozicion me marksizëm-leninizmin? Ai nisët nga një ide tjetër dhe mendon: «Të inkurajojmë këtë bllok reaksionar evropian, se paraqitet edhe kundër bllokut amerikan, por sidomos kundër bllokut sovjetik. Kështu thellojmë kontradiktat në mes blloqeve imperialiste në favor të socializmit». Por bëhet pyetja: në favor të cilit socializëm u thellokan këto kontradikta, kur punëtorëve dhe popujve u bëhet thirrje të mos lëvizin, të integrohen si dhentë në vathën e çobanit kapitalist? Socializmi reduktohet në këtë rast vetëm te Kina, që frymëzohet nga ide të tilla të Çu En Lait.

Çu En Lai duhet të jetë konsekuent në mendimet e tij. Gjersa ai u bën thirrje shteteve evropiane të integrohen nën oligarkitë e tyre kapitaliste, atëherë duhet të pranohet edhe Traktatin e Varshavës, edhe pushtimin e Çekoslovakisë.

Çu En Lai shpall se është kundër hegjemonisë sovjetike mbi këto shtete, bile në këtë rast ai shfaqet për «dezintegrim». Këtu s'ka konsekuencë nga ana e tij, ose ka konsekuencë në drejtimin që satelitët e Bashkimit Sovjetik në Evropë të shkëputen nga ky dhe të integrohen në Evropën tjetër «të bashkuar», për krijimin e së cilës bën thirrje jo vetëm borgjezia monopoliste e Evropës, por edhe Çu En Lai.

Çu En Lai nuk punon për ngritjen e popujve në revolucion, për dobësimin e hallkave të ndryshme të zin-

xhirit kapitalist, nuk ndihmon që të shpërthejnë hallkat më të dobëta të këtij zinxhiri të egër për popujt, por predikon në favor të Kinës, pa e shprehur haptazi, krijimin e blloqeve të ndryshme për balancimin e forcave jo në rrugën marksiste-leniniste, jo në rrugën revolucionare. Në favor të Kinës socialiste të gjithë duhet të luftojmë, por këtë duhet ta bëjmë vetëm për një Kinë socialiste, dhe në rrugën marksiste-leniniste.

Çu En Lai dhe udhëheqja kineze thonë se luftojnë në të dy krahët: edhe kundër imperializmit amerikan, edhe kundër socialimperializmit sovjetik. Mirëpo prej tyre lufta kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës është zbutur. Dhe kur? Pikërisht kur këto luftojnë barbarisht kundër Vietnamit dhe vazhdojnë luftën e tyre agresive kudo. Në një kohë të tillë Çu En Lai pretendon se «Shteteve të Bashkuara të Amerikës revolucionari po u troket në derë». Në këto momente krize për imperializmin amerikan, t'i japësh këtij dorën, siç bëri dhe siç po bën Kina, jo vetëm nuk është e drejtë, por do të thotë ta ndihmosh atë. Kështu vallë vërtetohen tezat e Çusë se «këto gjëra bëhen për të thelluar kontradiktat në mes dy superfuqive në favor të socializmit»? A përfitoi ndonjë gjë Vietnamit apo Lindja e Mesme prej tyre; a u dobësuam lidhjet e imperialistëve amerikanë dhe të socialimperialistëve sovjetikë, që Kina pranoi për vizitë Niksonin? Asgjë nuk u vërtetua nga këto. Siç duket politika kineze është për krijimin e blloqeve të mbyllura, që, natyrisht, do të jenë në rivalitet me njëra-tjetrën dhe që do të brehen nga kontradikta të mëdha.

Disa muaj më parë Çi Pen Fei, ministri i Jashtëm i Kinës, deklaroi afërsisht kështu: «Kina, Koreja, Vietnamit, Kamboxhia, Laosi dhe vendet e tjera të Indokinës, janë një familje e madhe...» etj. Këtu natyrisht s'ka fjalë «bllok», «kamp», «vende socialiste», por bie erë «familje e verdhë», «grupim aziatik», bie erë jomarksiste-

-leniniste. Pra sot bëjnë thirrje për «Evropë të Bashkuar», për «familje të madhe», për «botë të tretë», nesër mund të bëjnë thirrje për integrim të vendeve të Amerikës Latine apo «të popujve të zinj të Afrikës». Ja tendenca që duket në politikën kineze dhe kjo nuk është marksiste-leniniste, nuk është revolucionare. Kjo do të thotë t'u largosh vëmendjen popujve nga lufta e vërtetë revolucionare.

Flagrante, antimarksiste është deklarata e Çusë në banketin me Mobutun. Ai e rreshtoi Kinën në «botën e tretë». Kësaj i thonë të mohosh socializmin, të fshehësh në sytë e botës personalitetin e vërtetë të Kinës dhe karakterin e rendit të saj ekonomiko-shoqëror. Kjo është një pikëpamje oportuniste dhe antimarksiste. Dihet se janë Titoja dhe shokët e tij, Sukarno, Nehru e Naser, që e hodhën idenë mbi «botën» e vendeve gjoja të pangazhuara, por ata ishin borgjezë kapitalistë, ata vetë, shtetet dhe partitë e tyre ishin dhe janë të lidhura me imperialistët dhe me socialimperialistët. Me shumë prej këtyre shteteve borgjeze, që kinezët i futin në të ashtuquajturën botë e tretë, vendet socialiste, sigurisht, duhet të krijojnë lidhje, t'i ndihmojnë në luftën e tyre kundër imperializmit, pse ato kanë kontradikta të thella me të, por jo të shkrijnë personalitetin e politikës së rendit tonë socialist, të mbulojnë faktin që ne jemi vende socialiste dhe që partitë tona janë parti marksiste-leniniste etj.

Të deklaroj se je në «botën e tretë», kësaj i thonë: ose të bësh demagogji e të përpiqesh të gënjeshtë të tjerët, ose në realitet nuk je vend socialist, ashtu si nuk është Jugosllavia titiste, por je plotësisht një vend borgjez kapitalist.

Me një deklaratë të tillë i thuhet botës: «Le ta mbajnë revizionistët flamurin e «vendeve socialiste», «të kampit socialist», «të bashkësisë socialiste», ne jemi të «botës së tretë». Jo, kjo tezë është antimarksiste. Ne

shqiptarët s'jemi dakord. Shqipëria socialiste është dhe do të jetë socialiste edhe sikur të mbetet vetëm. Ne do të vazhdojmë të jemi një vend socialist, qoftë edhe sikur të mbetemi si një ishull i vogël në hartën botërore; ne do të luftojmë me besim sipas ideologjisë sonë marksiste-leniniste, me besim në revolucionin, në proletariatin botëror e në popujt, derisa të triumfojë socializmi e komunizmi në të gjithë botën.

Ne, marksistë-leninistët, duhet të dallojmë kur bëhen në një vend ndryshime thelbësore politike me karakter me të vërtetë demokratik dhe kur bëhen ndryshime që nuk e kanë këtë karakter. Ne duhet të mbështetim të parat dhe jo të dytat, bile ndryshimet politike reaksionare duhet t'i luftojmë.

Ndryshimet politike me karakter demokratik e përparimtar ndihmojnë revolucionin socialist. Kështu që ne, vendet socialiste, as që mund dhe as që duhet të izohemi e të mos i ndihmojmë ato vende dhe ato shtete të së ashtuquajturës botë e tretë, kur këto bëjnë ndryshime dhe reforma politike demokratike, kur janë në konflikt e në luftë me imperialistët, me socialimperialistët dhe me armiq të tjerë të popujve. Por neve, vendeve socialiste, nuk na lejohet të konfondohe mi me ta.

Ne, vendet socialiste, si Shqipëria dhe Kina, duhet të jemi kurdoherë të ngritur në luftë kundër botës kapitaliste dhe socialimperialiste. Detyra jonë është që me shembullin dhe me luftën tonë militante, të tërheqim në rrugën e drejtë klasat e shtypura të vendeve të tjera, duke bërë përpjekje të përbashkëta që ato të hidhen në revolucion kundër regjimeve shtypëse dhe skllavëruese kapitaliste.

Gjithnjë e më tepër po bindem se Kina nuk vepron kështu. Kjo del qartë edhe në të dy rastet që përmenda këtu, por ka edhe shumë raste të tjera. Gjenerali Mobutu dhe klika e tij janë reaksionarë, vrasës të Lumumbës dhe

të njerëzve të tjerë përparimtarë të vendit të tyre. Kina e pret përfaqësuesin e kësaj klike antidemokratike afrikane me nderime të mëdha dhe, për t'i bërë qejfin, Çu En Lai deklaroi se «Kina bën pjesë në botën e tretë». Me një fjalë i thotë popullit kongolez që «unë, Kina, jam mike me Mobutun, përkrah Mobutun, se ai është demokrat, përparimtar» etj., pa le ta shtypë popullin dhe proletariatin Mobutu, pa le të deklarojë ky mu në mes të banketit në Pekin, përpara Çusë: «Ne, kongolezët, jemi këta që jemi, do të qëndrojmë këta që jemi dhe nuk duam ideologji të tjera» etj., etj. Perspektivë të bukur ka socializmi në Kongo, në rast se mbështetim zotin Mobutu!

Po kjo perspektivë e zyrtë për revolucionin dhe për socializmin do të jetë në rast se marksistët dhe vendet socialiste mbështetin Tregun e Përbashkët Evropian, «Shtetet e Bashkuara të Evropës», siç po bën Kina, ose KNER-in e grupimin revizionist të Bashkimit Sovjetik me vendet satelite të tij në Evropë. Jo, Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë nuk do të ecin kurrë në këtë rrugë të gabuar antileniniste të kinezëve. Këta ose duhet të tërhiqen sa më parë nga kjo rrugë e gabuar, ose kjo do t'i çojë shumë më larg.

As nuk mund të merret me mend që shokët kinezë kanë rënë në këtë gabim padashur dhe pa e kuptuar. «Luftën kundër revizionistëve sovjetikë», pavarësisht se është e qartë që e zhvillojnë jo nga platforma e vërtetë marksiste-leniniste, por nga një platformë shoviniste, që bie erë politike e shtetit të madh, ata sot për sot e bëjnë si e bëjnë, kurse nesër edhe mund ta pushojnë dhe kjo duhet pritur nga njerëz që, ose nuk i kanë të qarta parimet marksiste-leniniste, ose i kanë të qarta, por duan të zbatojnë të kundërtën e tyre.

Shokët kinezë e dinë, siç e dimë edhe ne, se «kapitalizmi është ndërkombëtar dhe monopolist». Fuqitë e

mëdha kapitaliste, qofshin këto të djeshmet ose të sotmet, qofshin këto imperialiste ose socialimperialiste, nuk kanë ndryshuar, ato kanë grabitur, kanë shtypur dhe vazhdojnë të grabitin e të shtypin popujt dhe kombet e tjera. Këtë po bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këtë po bën Bashkimi Sovjetik revizionist, këtë po bën Japonia, këtë kanë bërë dhe përpiqen të bëjnë kapitalistët francezë, gjermanoperëndimorë, anglezë dhe italianë. Kapitalistët evropianë për ta bërë më mirë këtë, kanë krijuar Tregun e Përbashkët Evropian dhe janë duke punuar për krijimin e «Evropës së Bashkuar». Në këtë rrujë ata i mbështet Kina socialiste, e cila u kundërvihet detyrës së vërtetë të një shteti socialist dhe pikëpamjeve të Leninit, që tingëllojnë aq aktuale, kur thotë:

«Nga pikëpamja e kushteve ekonomike të imperializmit, domethënë nga pikëpamja e eksportimit të kapitalit dhe e ndarjes së botës midis fuqive «të përparuara» dhe «të qytetëruara» koloniale, Shtetet e Bashkuara të Evropës në kushtet e kapitalizmit ose janë të pamundshme, ose janë reaksionare»¹.

Kjo është e qartë si uji i burimit malor.

Ç'po bën ky grup kapitalistësh modernë? Po eksporton kapitalet dhe investon në vende të tjera për të shfrytëzuar dhe për të skllavëruar popujt e këtyre vendeve. Ata janë neokolonialistët e periudhës së pasluftës së Dytë Botërore. Këtu hyjnë edhe revizionistët sovjetikë. Ne po konstatojmë një organizim grabitjeje kolosale të re, me forma të reja, nga banditët imperialistë dhe social-imperialistë.

Me krijimin e «Shteteve të Bashkuara të Evropës», që e mbështet edhe Çu En Lai, aktualisht kapitalistët e

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 370.

Evropës Perëndimore s'kanë qëllim tjetër veçse të ndajnë në qetësi djersën dhe gjakun e proletariatit evropian, të popujve evropianë. Kësaj ndarjeje të djersës e të gjakut të këtyre popujve kapitalistët duan t'i japin një ngjyrë «paqësore», «duke e zbukuruar» edhe me parulla të tilla, si, «revolucion tekniko-shkencor», «shoqëria e konsumit» e të tjera parulla të fabrikuar. Por kjo ndarje, siç thotë Lenini, nuk mund të bëhet mbi bazë tjetër përveçse me anë të forcës. Ndaj edhe ky bllok shtetesh për ndarjen e plaçkës së huaj të grabitur është burim luftërash agresive imperialiste.

Lenini thotë:

«Në kushtet e kapitalizmit është e pamundur që zhvillimi ekonomik i ekonomive dhe i shteteve të ndryshme të jetë i barabartë. Në kushtet e kapitalizmit, për të rivendosur, kohë pas kohe, ekuilibrin e prishur, nuk mund të ketë mjete të tjera përveç krizave në industri dhe luftërave në politikë.

Sigurisht, ka mundësi të lidhen marrëveshje të përkohshme midis kapitalistëve dhe midis shteteve. Nga kjo anë, ka mundësi të krijohen edhe Shtetet e Bashkuara të Evropës, si një marrëveshje e kapitalistëve evropianë... po për çfarë? Vetëm e vetëm për të shtypur së bashku socializmin në Evropë, për t'i mbrojtur së bashku kolonitë e grabitura kundër Japonisë dhe Amerikës, të cilat janë shumë të pakënaqura nga ndarja e tanishme e kolonive dhe të cilat gjatë këtyre pesëdhjetë vjetëve të fundit janë forcuar me një shpejtësi shumë më të madhe se Evropa e prapambetur dhe monarkiste, që ka filluar të kalbet nga pleqëria»¹.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 21, f. 372.

Kjo është e qartë si drita e diellit; kjo ishte aktuale
djenkur e tha Lenini i madh, është e vërtetë e aktuale
edhe sot, do të jetë po kështu edhe nesër dhe derisa bota
kapitaliste të shkatërrohet dhe të zëvendësohet me botën
socialiste.

E ENJTE
18 JANAR 1973*

NË KINË PROPAGANDOHET FEJA

Propaganda kineze lë të kuptohet haptazi se në
Kinë nuk luftohen fetë, prandaj flet për festat fetare,
për pashkë e për bajram, për meshat e vazet në kishat
e në xhamitë e Pekinit. HSINHUA-ja bënte të ditur se në
xhaminë e Pekinit u festua me pompozitet bajrami dhe
se në këtë festë merrnin pjesë gjithë ambasadorët e ven-
deve myslimane të akredituara në Kinë. Vazhdon vija
për t'i treguar botës se Kina është e «botës së tretë», se
ajo përkrah arabët e myslimanët dhe fenë e tyre! Pari-
morë të mëdhenj!!!

E MARTË
23 JANAR 1973

SI DUHET TA KUPTOJNË DIPLOMACINË E SHTETIT TONË PUNONJËSIT E MINISTRISË SË PUNËVE

TË JASHTME

Udhëzime

Thirra ministrin e Jashtëm dhe e pyeta se si zhvillohen marrëdhëniet me Greqinë, ecin përpara apo kanë ngelur në vend? A e kanë marrë në studim këtë problem pas fjalimit që mbajta në Vlorë me rastin e 60-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, ku jo pa qëllim fola për çështjen e Greqisë? Me sa më raporto, në Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk kanë bërë shumë gjëra, qëndrojnë pasivë përpara problemit, regjistrojnë dhe tregohen pasivë edhe përpara avancave të grekëve, qëndrojnë vetëm receptues, deri sot mbajnë shënim ftesat që ata u bëjnë për të shkuar ndonjë doktor o ndonjë shkencëtar në ndonjë konferencë shkencore. Për sa i përket thellimit mbi fjalimin tim, kolegji i ministrisë këtë as që e ka bërë çështje.

Natyrisht e këshillova se duhet të jenë më të gjallë, më me iniciativë dhe të ndjekin ngjarjet dhe problemet, të studiojnë dhe të analizojnë situatat e favorshme që u krijuan me Greqinë, pas fjalimit tim të 29 Nëntorit 1972 në Vlorë, të vendosin me kujdes masat që duhen marrë dhe të veprojnë për zbatimin e mëtejshëm të tyre, në bazë të vijës që kemi caktuar.

Shtypi grek, në përgjithësi, i ka bërë jehonë të madhe dhe pozitive atyre që kam thënë unë për Greqinë, në fjalimin e Vlorës. Ai ka reaguar drejt për ndjenjat e vërteta të popullit dhe të pushtetit tonë ndaj popullit grek dhe i ka quajtur deklaratat tona, ashtu siç janë, si një siguri nga ana jonë që asgjë e keqe nuk do t'i vijë popullit grek nga ne. Një gjë e tillë ka forcuar ndjenjat e miqësisë së këtij populli fqinj ndaj Shqipërisë dhe ato gazeta që përpara na shanin tash flasin ndryshe, shkruajnë për gjendjen ekonomike, politike dhe turistike të vendit tonë herë mirë, herë çka. Sidoqoftë, opinionin grek ka filluar të dëgjojë kështu një kampion tjetër për ne dhe kjo është pozitive. Ambasadori dhe njerëzit tanë, kur venë nëpër Greqi, priten me ngrohtësi nga masat, u flitet me simpati për Shqipërinë, gëzohen që u lidhën marrëdhëniet diplomatike dhe urojnë që miqësia në mes dy vendeve të shtohet, të forcohet bashkëpunimi, sidomos në drejtimin ekonomik dhe kulturor.

Për çështjen e «Vorio-Epirit», në popull e në gazeta, nuk flitet më në Greqi, vetëm nganjëherë dhe në ndonjë gazetë thellësisht ultrashoviniste. Shumë njerëz i janë shprehur ambasadorit tonë duke i thënë se ky problem është absurd, reaksionar. Bile nga ana greke u shkua edhe më tej. Ambasadori ynë këto javët e fundit u takua në një pritje me dhëndrin e kryeministrit Papadhopollos. Ky na qenka shqiptar, nga Labova e Gjirokastrës, quhet Vasili Zhapa, nga familja e famshme pasanike e Zhapajve. Vasili paskësh qenë nxënësi im në Liceun e Korçës dhe ka ikur në Greqi më 1945 me pasaportë të rregullt. Natyrisht, ai i foli ambasadorit tonë me shumë dashuri dhe simpati për Shqipërinë. Në mes të tjerash ai i deklaroi ambasadorit tonë se ato që thuhet për «Vorio-Epirin» janë një absurditet i madh, janë gjeputura të reaksionit grek. S'ka «Vorio-Epir», por Shqipëri, grekët atje janë një minoritet shumë i vogël dhe trajtohen në më-

nyrë të kënaqshme saqë s'ka ku vete më mirë. Në qoftë se shtrohet çështja për rivendikime është Shqipëria ajo që, me të drejtë, mund të bëjë, si për Kosovën etj. Për këto konsiderata të dhëndrit të Papadhopollosit, pavarësisht se është shqiptar, ne nuk mund të mendojmë se nuk është ngarkuar të na i thotë si përgjigje me gojë të fjalimit tim të Vlorës, ose mund të jenë edhe mendime që shkëmbehen me Papadhopollosin dhe rrethin e tij familjar.

E gjithë kjo që u krijua në Greqi dhe që duhet ta shfrytëzojmë për të forcuar pozitat e Shqipërisë në opinionin publik dhe politik grek, është një situatë interesante për ne.

I ritheksova prapë ministrit, si duhet ta zbatojë politikën tonë me fqinjët, si t'i kuptojë koniunkturat aktuale dhe çdo koniunkturë tjetër që mund të krijohet në të ardhmen.

Të tre fqinjët tanë kanë interes që asnjëri prej tyre të mos orvatet të godasë Shqipërinë, jo se ata e duan rendin tonë socialist, përkundrazi janë kundër tij, por këtë pozitë atyre ua imponon Republika Popullore e Shqipërisë me qëndrimet e saj të vendosura, me politikën e saj të drejtë të bashkekzistencës leniniste me ta. Fqinjët e dinë mirë se kush prek kufijtë e atdheut tonë, nuk mund të ndahet pa luftë. Përpara këtij realiteti ekzistojnë edhe rivalitetet në mes të fqinjëve tanë, ekzistojnë kontradikta të thella, pse janë vende dhe shtete kapitaliste dhe çdo përpjekje, nga cilido prej tyre, për prishjen e statukuosë në lidhje me Shqipërinë, i kalon përnjëherë në plan të parë rivalitetet dhe shkakton reaksion zinxhir, pavarësisht nga marrëveshjet dhe aleancat që kanë në mes tyre. Çdo qeveritar «i arsyeshëm» i këtyre shteteve fqinje kapitaliste nuk ka si të mos i peshojë këto çështje në këtë prizëm.

Në situatat aktuale qeveria e Papadhopollosit, një

qeveri e djathtë, braktisi politikën e shovinistëve grekë dhe atë po aq shoviniste të ashtuquajtur të majtë të Papandreut me shokë dhe zuri përballë vendit tonë pozita më realiste. Kolonelët grekë u treguan më realistë, pse gjykuan drejt se Shqipëria socialiste, por edhe ajo e paraqirimit, asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë një rrezik për Greqinë, e cila në asnjë rast nuk është sulmuar nga ne, asnjë rivendikim tokësor nuk kemi shprehur ne (dhe që mund ta shprehnim, po të mendonim si ata që rivendikojnë tokat tona), kurdoherë kemi dashur të rrojmë në paqe me njëri-tjetrin.

Nga i ka ardhur dhe nga i vjen rreziku Greqisë? Duke gjykuar për një moment si kolonelët e Athinës, ky rrezik mund t'i vijë nga Italia, nga Jugosllavia, nga Bullgaria, nga Turqia dhe nga Bashkimi Sovjetik revizionist. Ne shtojmë edhe nga imperializmi amerikan, si dhe nga reaksioni fashist i brendshëm etj., por kjo është një çështje tjetër.

Italia, fuqi e madhe kapitaliste-fashiste, neofashiste, e ka sulmuar Greqinë dhe kërkon të dominojë mbi të. Aktualisht qeveria italiane mbështet hapur armiq të regjimit të sotëm grek. Jugosllavia dëshiron të dalë në Egje, ajo do për vete Maqedoninë e Egjeut, që haptazi s'e reklamonte, por herë pas here i bie atij teli. «Ç'do të bëhet pas vdekjes së Titos Jugosllavia?», vënë pyetjen grekët. Këta kanë frikën e rusit dhe të bullgarit, satelitit të tij.

Në këto rrethana reale, sigurisht, kolonelët grekë dalin me konkluzionin, siç dolën, se Shqipëria socialiste, pavarësisht nga rendi i saj ekonomik-shoqëror, është një vend më i afërt e më i sigurtë në miqësi me popullin grek se gjithë të tjerët. Nga ana tjetër, grekët i dinë synimet grabitqare të italianëve kundër vendit tonë, ata e dinë mirë se çdo rrezik për Shqipërinë nga ana e italianëve është rrezik edhe për Greqinë. Prandaj,

duke mos e dashur këtë eventualitet, ata dolën me këtë politikë realiste ndaj nesh. Kolonelët grekë e konsiderojnë Shqipërinë socialiste si një mburojë të vendosur edhe për ta kundër një rreziku italian. Kjo është e vërtetë dhe ne, duke mbrojtur atdheun tonë nga ndonjë sulm fashist italian, mbrojmë njëkohësisht edhe pavarësinë e Greqisë. Ne e kemi për nder ta ndihmojmë popullin vëlla grek në kohë rreziku.

Po ta mendojnë kështu këtë çështje edhe udhëheqësit aktualë të Greqisë, atëherë është diçka me rëndësi të madhe. Por ministrin tonë të Punëve të Jashtme e këshillova që, edhe në rast se ata nuk e konceptojnë kështu, diplomacia jonë, në mënyrë të zgjuar dhe jo duke lidhur duart, të punojë që ta kuptojnë kështu. Natyrisht, diplomacia jonë duhet të ketë takt, të ketë parasysh kurdoherë kush janë qeveritarët grekë, të jetë një diplomaci e balancuar dhe të mos shkojë sa andej-kënde, domethënë, duke dashur të bëjë diplomaci me qeverinë e Athinës, të egërsohen qëndrimet tona me Italinë, me Jugosllavinë ose me Turqinë. Edhe këta e të gjithë të tjerët duhet të shohin politikën tonë realiste, marksiste-leniniste, që nuk i përngjet aspak politikës së tyre, ajo nuk bazohet në intriga, por në parime. Këtu ka rëndësi, i thashë atij, si do të bëjmë që grekët të kuptojnë në praktikë parimet e drejta të politikës sonë. Natyrisht asgjë s'del po të lidhen duart.

Që kur janë lidhur marrëdhëniet me Greqinë asnjë artikull nuk është botuar në gazetat tona, në mënyrë që të flasë me fjalë të matura, po të ngrrohta, për miqësinë në mes dy popujve, asnjë lajm pozitiv nuk është dhënë për Greqinë, asnjë kronikë. Asgjë, pra, nuk ka ndryshuar nga qëndrimet tona të para. As që nuk gërmohen faktet pozitive historike të marrëdhënieve të të dy popujve tanë në të kaluarën dhe të shkruhet herë pas here për to, as nuk flitet ndonjëherë të paktën për

përkthimet e veprave të filozofëve të mëdhenj të Greqisë së vjetër! Kjo e plot gjëra të tilla bëjnë përshtypje në Greqi. Atëherë ne do të mbyllim gojën? Tregtia jonë me Greqinë duhet të zgjerohet në bazë të leverdisë reciproke, të shkëmbehen studiues dhe jo të presim të na thërresin vetëm ata. Ambasadori ynë dhe funksionarët e tjerë të ambasadës sonë në Athinë të kenë kurajë të flasin hapur e drejt për miqësinë me popullin grek, të shprehin mendime të mira për gjërat e mira që shohin atje dhe të mos e shohin çdo gjë të zezë dhe për çdo gjë të druhen të shfaqin një mendim të balancuar diplomatik, se mos bëjnë gabim.

Për të gjitha këto probleme e porosita ministrin të thërresë ambasadorin tonë në Greqi, Lik Seitit, të konsultohet e të bisedojë më gjerë me të. Ta këshillojë që të mbajë lidhje miqësore të hapëta, por jo vetëm e në mënyrë komprometuese me V. Zhapën. Ky është një person me anën e të cilit ne indirekt mund të çojmë pikëpamjen e politikës sonë në veshin e Papadhopollosit. Duhet t'u çelen horizonte shokëve, të jenë më të shkathtët dhe, duke qenë parimorë, të mos tregohen të ngurtë.

Përveç këtyre gjërave i përmenda ministrin edhe atë çka u rekomandova shokëve të Ministrisë së Brendshme, që të marrin në shqyrtim kërkesat e shqiptarëve minoritarë grekë, qoftë këta në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Australi o në Greqi, të cilët kërkojnë të vijnë të takohen dhe të vizitojnë familjet e tyre dhe atdheun. Nuk duhet të bëjmë dallim nga kosovarët dhe nga shqiptarët e tjerë që vijnë. Të tërë ata që kërkojnë të vijnë nuk janë njerëz të Silogut «Vorio-Epirot». Të zgjedhim midis tyre më të mirët, më të ndershmit, më të pakomprometuarit. Por bashkë me ta mund të na hyjnë edhe njerëz të ligj. Kjo ka mundësi të ndodhë, siç ka mundësi edhe nga të tjerët, por ne duhet të jemi, si kurdoherë, vigjilentë. Kjo ka rëndësi edhe për njerëzit e mi-

noritetit, por edhe për gjithë ata që do të vijnë, të cilët do të spastrohen nga turbullirat që kanë në kokë, do të lidhen më shumë me familjen dhe me vendin, do të luftojnë propagandën që bëhet kundër vendit tonë jashtë dhe kështu do të demaskohet shovinizmi grek, në favor të miqësisë në mes popullit tonë dhe popullit grek.

**E MËRKURË
24 JANAR 1973**

U SIGLUAN DOKUMENTET E PËRFUNDIMIT TË LUFTËS NË VIETNAM

RD e Vietnamit dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës deklaruan se dje përfaqësuesit e tyre në Paris sigluan dokumentin «e mbarimit të luftës në Vietnam». Të shtunën, më 27 janar, firmoset zyrtarisht në Paris marrëveshja nga pjesëtarët e konferencës që u bë në këtë qytet.

E ENJTE
25 JANAR 1973

NJË PAQE E MJERUESHME PAS NJË LUFTE TË LAVDISHME

Të shtunën më 27 janar në Paris nënshkruhet e ashtuquajtura paqe në Vietnam në mes katër palëve: verivietnamezëve, amerikanëve, qeverisë revolucionare të përkohshme të republikës së Vietnamit të Jugut dhe qeverisë kukull të Sajgonit.

Udhëheqja e RD të Vietnamit pas afro katër vjet «përpjekjesh politike», siç i quante ajo bisedimet e fshehta dhe të hapura me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Paris, arriti në një kompromis me amerikanët. Të dyja palët po e trumbetojnë këtë ngjarje si «një eveniment historik». Si vietnamezët ashtu edhe amerikanët e quajnë këtë «një fitore të madhe» për njëri-tjetrin.

Çka u përfundua, nuk mund të quhet kurrsesi «paqe në Vietnam». Për pikëpamjen tonë ajo mund të quhet, e shumta, një armëpushim edhe ky i përkohshëm, në qoftë se vietnamezët nuk shkojnë më tej në lëshime përpara imperializmit dhe reaksionit.

Kjo marrëveshje e mjerueshme, në favor të reaksionit, është pjella e një politike revizioniste, e një udhëheqjeje të lodhur nga lufta revolucionare, të cilën, pa e thënë hapur, ajo e konsideron të panevojshme, anakronike, e një udhëheqjeje që dëshiron t'u adaptohet situatave oportuniste liberale që janë përhapur në Evropë dhe në botë, që kur morën fuqinë në Bashkimin Sovjetik

revizionistët hrushovianë. Udhëheqja verivietnameze ka-
loi në këtë rrugë dhe këtë e vërtetoi me dokumentet që
do të nënshkruhen të shtunën në Paris.

Populli vietnamez ka bërë një luftë heroike të lavdishme, që s'ka shembull në histori nga egërsia që kanë përdorur armiqtë e tij dhe nga rezistenca e papërkulur dhe me dekada, që ai ka bërë. Me miliona vietnamezë janë vrarë e plagosur në këtë luftë kundër imperializmit amerikan dhe satelitëve të tij. I tërë vendi u dogj e u rrënuar, 7 milionë e gjysmë tonelata bomba të çdo lloji e të çdo kalibri hodhën Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbi Vietnam dhe mbi vietnamezët, por këta nuk u përkulën për asnjë moment, luftuan me trimëri të pashoqe, korrën fitore pas fitoresh kundër armiqtë. Dy presidentë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës thyen kokën në këtë luftë. Edhe presidenti i tretë do të pëson-
te fatin e dy të parëve, por rrethanat e bënë atë të tërhiqej i mundur e i plagosur rëndë. Këtë disfatë të madhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që duhej të arrihej deri në fund, pse fundi nuk mund të ishte larg, fashisti Nikson e trumbeton si një fitore të madhe të tij, si arritjen e paqes, «për të cilën ai luftoi dhe ia arriti».

Populli vietnamez me sakrificat kolosale, me heroizmin e madh, me zotësinë në luftime dhe fitoret e arritura nuk e meritonte mbarimin e luftës në këtë mënyrë, siç ia rregulluan dhe siç u arrit. Populli vietnamez meritonte njëqind herë, një mijë herë fitoren e plotë për të cilën rroku armët, derdhi gjak dhe luftoi si ai. Atij ia rrëmbyen fitoren nga dora, atë nuk e lanë ta kapte, pse me siguri do ta kapte. Dhe këtë dështim udhëheqësit verivietnamezë e quajnë «fitore të madhe të popullit të tyre».

Po përse u ngrit në luftë populli vietnamez? Ai ka luftuar gjithë kohën për çlirimin e tij nga zgjedha e

pushtuesve kolonialistë imperialistë. Ai luftoi me heroizëm kundër imperialistëve kolonizatorë francezë, që na hiqeshin si «demokratë», si «civilizues», që gjoja kishin luftuar kundër hitlerianëve. Vietnamezët i thyen francezët në beteja dhe fituan luftën. Dien Bien Fuja shënoi disfatën e plotë të francezëve dhe kjo ishte një fitore e plotë për popullin vietnamez në Veri, ku u vendos pushteti popullor dhe ku filloi ndërtimi me sukses i socializmit.

Populli në Vietnamin e Jugut vazhdoi të jetonte i robëruar. Marrëveshja e Gjenevës do t'i jepte gjoja fund një gjendjeje të mjeruar. Në këtë marrëveshje u shkruan fraza pompoze, të bukura, u hartuan nene të shumta, u hodhën firma nga fuqi të mëdha, që do të siguronin gjoja zbatimin «me rreptësi» të këtyre neneve. Kjo ishte një gënjeshtër. Imperializmi amerikan e shkeli marrëveshjen. «Presidenti i paqes dhe i progresit» amerikan, Kenedi, dërgoi me shumicë këshilltarë ushtarakë, ushtarë, krijoi baza, aerodrome dhe filloi luftën kundër popullit vietnamez. Pasardhësi i tij Xhonsoni e ngriti numrin e forcave amerikane në Vietnam deri mbi 700 000 veta të armatosur deri në dhëmbë me armët më moderne. Vietnamit u bë poligoni i tyre, i një lufte nga më barbare që ka njohur historia e njerëzimit. Xhonsoni nuk i mjaftoi Vietnamit e Jugut, por filloi bombardimet më barbare edhe kundër Vietnamit të Veriut. Kjo ishte luftë totale, më e keqe dhe më e egër se e hitlerianëve. «Presidenti i tretë i paqes dhe i progresit», fashisti Nikson, u tregua vazhdues i denjë i Xhonsoni.

Kush e shkaktoi këtë luftë agresive dhe barbare? Është imperializmi amerikan, i cili shkeli marrëveshjen e Gjenevës dhe sulmoi Vietnamin e Jugut. Ishte e natyreshme dhe e ligjshme që populli i Vietnamit të Jugut të revoltonte dhe të ngrinte krye kundër shtypësve të tij, bandave, kukullave të Ngo Din Diemit, të Van Thieut,

Kao Kisë e të tjerëve, të shitura tek imperializmi amerikan. Ishte e natyreshme që Vietnamit i Veriut të ndodhej krah për krah në këtë luftë çlirimtare me Vietnamin e Jugut. Ishte, gjithashtu, e natyreshme që gjithë popujt përparimtarë të botës, e, në radhë të parë, vendet socialiste, të ishin plotësisht solidare me luftën heroike të popullit vëlla vietnamez. Kjo ishte një detyrë internacionaliste, që na e diktojnë ligjet e revolucionit, që na e dikton lufta e pamëshirshme që duhet t'u bëjmë armiqve të popujve dhe, në radhë të parë, imperializmit agresiv amerikan.

Lufta heroike e popullit të Vietnamit ishte për ne pjesë e lavdishme e revolucionit të madh botëror, ishte flamuri i shkëlqyer i luftërave çlirimtare të popujve nga kolonizatorët, ishte shembulli i madh se si duhet pritur agresori, si duhet qëndruar kundër tij, si duhet luftuar dhe fituar kundër tij. Vietnamit u tregoi popujve se vetëm me luftë, me revolucion, mund të fitohet liria dhe pavarësia, vetëm me luftë mposhten dhe gjunjëzohen agresorët. Lufta e Vietnamit i tregoi mbarë njerëzimit se edhe një popull i vogël mund t'i rezistojë me sukses një fuqie të madhe, siç është imperializmi amerikan. Lufta e Vietnamit e shkatërroi mitin fals «të pathyeshmërisë së imperializmit amerikan».

Prandaj lufta e Vietnamit ishte edhe lufta jonë, lufta e gjithë popujve të shtypur. Këtë duhej ta dinim ne, por duhej ta dinin edhe udhëheqësit e Vietnamit. Kush e harronte ose e tradhtonte këtë çështje të madhe, ai kishte dëmtuar dhe tradhtuar jo vetëm kauzën e popullit heroik të Vietnamit që bëri kaq sakrificë, por edhe kauzën e drejtë të të gjithë popujve, të revolucionit. Në këto çështje duhet parë më larg nga shtëpia jote, pse kjo shtëpi nuk mund të ketë jetë brenda, e izoluar në një shkretëtirë ose në një humnerë shoqërore. Vietnamit luftoi që të mos rikthehej në humnerën e më-

parshme, ai luftoi që të mos përsëritej më Gjeneva dhe rrjedhimet e përgjakshme që rrodhën pas marrëveshjes së nënshkruar atje.

Është një lëshim i tmerrshëm dhe një padrejtësi flagrante që i bëhet popullit heroik vietnamez me çka u konkludua në Paris. Ne kemi qenë kundër bisedimeve të tilla. Këto mendime tonat, ne nuk i kishim bërë publike, se nuk dëshironim, në asnjë mënyrë, që të dëmtonim luftën nacionalçlirimtare të popullit vëlla vietnamez, por, në mënyrë shoqërore, me të gjithë shokët vietnamezë që jemi takuar, ato ne ua kemi shfaqur hapur. Ne u thoshim atyre: «Ruhuni nga kompromiset e dëmshme dhe të rrezikshme, vetëm me luftë do të arrihet fitorja e plotë». Ne u thoshim atyre gjithashtu: «Ruhuni nga influencat, mos u thyeni nga presionet dhe nga shantazhet e revizionistëve sovjetikë, se ata janë miq dhe bashkëpunojnë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ata duan ta dobësojnë dhe ta shuajnë luftën tuaj, duan t'u grabitin fitoret dhe t'i shpëtojnë nderin Niksonit për të nxjerrë përfitime të ndyra për veten e tyre». Kur ne ua thoshim këto shokëve vietnamezë, ata heshtnin, as nuk reagonin, gjoja bënë politikë, gjoja nuk donin të polemizonin, se kishin interesat e «ndihmës në armatime» etj.

Por ne e kuptonim se s'ka qenë vetëm kjo arsye. Arsyet ekzistojnë te pikëpamjet ideologjike të udhëheqësve kryesorë të Vietnamit, pikëpamje këto revizioniste, oportuniste. Këta nuk ndoqën vrullin e madh revolucionar të popullit, por manovruan për të mbaruar gjoja me nder luftën, siç manovroi edhe Niksoni «të realizonte një paqe me nder» për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qëllimet puqeshin dhe, pas shumë peripecive u arrit rezultati hibrid. Të dyja palët janë tash të kënaqura, të dyja palët bërtasin «fitore e madhe» për njërin dhe për tjetrin.

Çka u arrit në Paris është «një armëpushim» për të dyja palët, mendoj unë, në rast se Vietkongu nuk e lë revolucionin në mes të rrugës, në rast se nuk përqa-fon gjoja metodat demokratike dhe «me rigorozitet» nuk zbaton klauzolat e marrëveshjes. Në rast se ngjet kështu, atëherë do të goditen patjetër me reaksionin e brendshëm. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ndërhyjnë. Parisi do t'i ngjasë Gjenevës e kështu me radhë dhe lufta që u la në mes të rrugës e që kishte mundësi të mëdha të fitohej, do të rifillojë. Në qoftë se ndodh ndryshe, atëherë ne do të asistojmë në një «Varkizë vietnameze». Por edhe «Varkiza vietnameze» është e mbarsur me luftë popullore si «Varkiza greke», por asaj nuk i dihet fundi. Është e vërtetë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës me marrëveshjen e Parisit zotohen se «pas 60 ditëve do të tërheqin krejtësisht çdo forcë ushtarake nga Vietnam». Kjo mund të konsiderohet si diçka e arritur, por jo e sigurt, pse në rrethana të tjera, që imperializmi amerikan i krijon, ata mund të rikthehen. Sidoqoftë, duhet kuptuar se «tërheqja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës» është një disfatë e madhe për të dhe e shkaktuar nga lufta heroike e popullit vietnamez. Ata nuk ikën nga malli, por nga halli.

Por kjo tërheqje e amerikanëve nga halli (dhe këtu qëndron manovrimi i Niksonit), u trumbetua prej tij si një gjest «pajtimi e rregullimi për çështjen e paqes në Vietnam dhe në botë» etj., etj. Këto ishin maskat për të fshehur disfatën jo shumë të largët të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ishin njëkohësisht edhe një degë kompromisi për udhëheqjen oportuniste vietnameze, e cila me shkathtësi revizioniste e kapi dhe e tori nën maskën e parullës «edhe do të luftojmë, edhe do të bëjmë politikë». Politika për të dy donte të thoshte «të pushohej lufta». Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të tërhiqeshin me nder nga Vietnam dhe jo të mundur si

Franca pas Dien Bien Fusë dhe vietnamezët të flasin «se arritën një fitore të madhe». Ç'u bë në këtë mes? Lufta e Vietnamit u «vietnamizua», siç donte Niksoni, i cili qëndron në Vietnam me qeverinë e Thieut, me armatime, me këshilltarë të veshur ushtarakë e civilë dhe me dollarë. Bile u shkua deri atje sa Shtetet e Bashkuara të Amerikës u zotuan «të ndihmojnë» në rindërtimin e Vietnamit të Veriut, me fjalë të tjera «ndërtimin e socializmit në Vietnam!». Kjo është «fitorja e madhe» që pretendon Fam Van Dongu, i cili merr guximin dhe thotë se kjo aprovohet nga të gjitha vendet socialiste. Jo, nga ne nuk mund të aprovohet një thënie e tillë.

Nuk mohohet fakti se aktualisht në Vietnamin e Jugut ekzistojnë zona të çliruara, ekziston Qeveria e Përkohshme Demokratike Revolucionare dhe ushtria popullore. Këto nuk ekzistojnë më parë. Por në Vietnamin e Jugut ekzistojnë dy pushtete, dy qeveri, dy ushtri. Çështja e përcaktimit të kufijve të territoreve është shumë e ndërlikuar. Si do të bëhet ky i famshëm bashkim në mes zjarrit dhe ujit? Si do të vepohet pa goditje e pa ndërlikime në këtë «osmozë»? Kush do të lëshojë? Do të vazhdojë lufta civile apo do të bëhet Varkiza? Do të ketë luftë klase, apo do të shuhet ajo? Atëherë, ku është «kjo fitore e madhe» që trumbeton udhëheqja e Vietnamit? Nuk është serioze, por është tragjike! O do të bëhet Ball, e do të rifillojë përsëri lufta e ndërprerë, e dobësuar dhe me krijime të shumta iluzionesh dhe deziluzionesh.

Udhëheqja revizioniste verivietnameze, sigurisht në mënyrë sekrete, me propozimet e saj u doli përpara propozimeve të Niksonit. Ky fliste për «tërheqje me nder» të trupave amerikane nga Vietnami dhe pa tradhtuar e pa lënë pas dore miqtë e tij sajgonezë. Udhëheqja e Vietnamit fliste për ndarjen e pushtetit me Sajgonin pa Van Thieun dhe me një forcë hipotetike të tretë, gjoja

kundër Thieut dhe pro frontit nacionalçlirimtar. Mbi këtë platformë u tor Parisi, u pleks kompromisi, u arrit sprapsja e verivietnamezëve, domethënë qeveria e Sajgonit, me Thieun në krye, qëndron në fuqi. Kjo qeveri e reaksionit ka nën thundrën e vet tri të katërtat e territorit (sipas agjencive të lajmeve), ka përqindjen më të madhe të popullsisë, pse ka në dorë qytetet, ka një ushtri të madhe në këmbë, të armatosur shumë fort nga amerikanët. Qeveria revolucionare e përkohshme ka malet. Pra luftën populli vietnamez vallë e bëri «që të qëndronte në mal» dhe bandat e reaksionit të mbajnë fushat dhe qytetet? Dhe këtë udhëheqja e Vietnamit të Veriut e quan «fitore të madhe».

Vihet pyetja: duhet apo jo të zbresin luftëtarët vietnamezë nga mali e të dalin nga pyjet?

Vihet pyetja tjetër: duhet të luftohet për të marrë pushtetin apo jo? Marrja e pushtetit nga ana e popullit a nuk është vallë objektivi nga më kryesorët të revolucionit dhe të luftës nacionalçlirimtare? Si do të zgjidhen këto çështje? Në rast se «do të zbatohen me rreptësi» klauzolat e të famshmes marrëveshje të Parisit, atëherë do të shkohet drejt forcimit të pozitave të qeverisë së Sajgonit. Atëherë udhëheqësit vietnamezë i bënë varrin vetes, pse kjo është rruga më tipike kundërrevolucionare, rruga më tipike revizioniste e «marrjes së pushtetit», që domethënë në fakt e mosmarrjes së pushtetit. Tendenca është e theksuar që të ecet në këtë drejtim derisa pranohet dhe ajo që amerikanët «zemërmirë» do të ndihmojnë me kredi që të rindërtohet edhe Vietnami i Veriut, që u bë shkrumb e hi. Po të ishte e mundur, udhëheqja verivietnameze do t'u kërkonte me lutje amerikaneve që të «ringjallnin edhe milionat vietnamezë që vranë».

Por, në rast se nuk do të ecet në këtë rrugë revizioniste, dhe kjo do t'i detyrohet krahut revolucionar,

atëherë marrëveshjet e Parisit nuk do ta kenë jetën të gjatë, ato do të shkelen dhe të dyja palët do të goditen. Atëherë ku ishim e ku do të vemi! Vihet pyetja: Pse e bëmë këtë gjë? Mund të përgjigjen: «Po këtë herë përlëshja bëhet pa amerikanët, pse ata ikën». Dialogu vazhdon:

— Ikën, po vijnë prapë.

— S'mund të vijnë, se është marrëveshja e Parisit!.

— Por edhe më parë ishte marrëveshja e Gjenevës, po ata megjithatë erdhën.

— Po marrëveshjen e Gjenevës e kishin firmosur të pesë fuqitë.

— Edhe atë të Parisit, sipas deklaratave që bëhen, do ta firmosin të pesë fuqitë e mëdha, në mes të të cilave edhe Kina.

Pra Kina, sipas këtyre lajmeve, hyri në valle. Çu En Lai botërisht ka deklaruar:

«Kina Popullore në asnjë mënyrë nuk do të pranojë të marrë pjesë në një konferencë tjetër për Vietnamin si ajo e Gjenevës». Atëherë do të shohim që ajo të marrë pjesë në këtë konferencë të ardhshme, e cila pavarësisht emrit të qytetit që do të marrë, i përngjet si dy pika uji konferencës së Gjenevës?

Çu En Lai ka thënë gjithashtu: «Kina Popullore nuk do të marrë pjesë në asnjë mbledhje të fuqive të mëdha, ku të diskutohet dhe të vendoset për fatet e popujve të tjerë». Idetë e Çu En Lait këto janë, se fjalët mund të mos jenë plotësisht kështu. Por çështja qëndron në atë që do t'i mbajë Çu En Lai këto parime që i trumbeton si «të drejta» apo do t'i shkelë? Që t'i shkelë, gjenden plotarsye dhe e para se «na u lut Vietnamit dhe ne nuk mund ta refuzojmë». Atëherë pse i flet këto «parime» dhe nuk jep mendimin zyrtar të Kinës për rezultatet që u arritën në bisedimet e Parisit? Deri tash Kina nuk ka thënë asgjë. Po do të presim.

Ky është një problem i madh e shumë i koklavitur. Do të ketë rrjedhime të mëtejshme dhe ngjarje të rëndësishme jo vetëm në Vietnam, por edhe në botë. Për shumë, Vietnamit ishte një gur i madh që u kishte zënë rrugën për t'i çuar tek amerikanët. Ky gur tash u hoq dhe do të fillojë maratona drejt Uashingtonit. Të gjitha këto do të bëhen në emër të «konsolidimit të paqes e të socializmit». Paqja në Vietnam bëri që revizionistët të çlirohen nga ajo maskë që u kishte zënë frymën, që u kishte mbuluar fytyrën dhe s'i linte të ecnin dhe aq revan drejt bankave amerikane.

Unë nesër do të bisedoj me ambasadorët e të dy Vietnameve, të cilët kanë kërkuar takim me mua, sigurisht të më komunikojnë, gjoja zyrtarisht, këto çështje. Unë do t'u them atyre hapur dhe shoqërisht mendimet tona për këto çështje kryesore, do t'u them të vërtetën, siç mendojmë, ashtu siç na mëson Lenini.

E ENJTE
25 JANAR 1973

PANORAMË E ZHVILLIMIT POLITIK AKTUAL NË EVROPË

Me ministrin e Punëve të Jashtme bisedova për ngjarjet që po zhvillohen në Evropën tonë plakë dhe për intrigat e dallaveret e shumta që kurdisen nga imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë dhe shtetet e tjera kapitaliste të këtij kontinenti.

Dy ngjarje dominojnë në arenën politike të këtyre kohëve në këtë pjesë të botës, ngjarje shurdhuese dhe mashtruese nën tingujt e xhazit amerikan dhe të balalajkës ruse. Këto muzika bien në Helsinki dhe në Vjenë. Në kryeqytetin e parë llogotitet për «sigurimin evropian» dhe në të dytin bëhen pallavra për «pakësimin e ekuilibruar të ushtrive» në Evropën Qendrore. Në këto dy qytete luhen estrada, por në Uashington dhe në Moskë përgatiten numrat dhe përpunohen e stërviten artistët dhe figurantët. Siç dihet në këtë llum ne nuk morëm dhe nuk mund të merrnim pjesë, jo pse i trembemi luftës, por se duam të luftojmë me shpatë hapur jashtë rretheve vicioze. Ne e themi dhe do ta themi vazhdimisht mendimin tonë hapur, pa frikë dhe pa asnjë rrezik se mos «rrobat tona» grisen ose njolloosen në ferrat dhe në baltën e Vjenës dhe të Helsinkit. Të gjithë pjesëtarët e këtyre konferencave dëshironin shumë që ne të venim për të na komprometuar në zhironet e tyre. Por këto dëshira s'u plotësuan. Në këto mbledhje diskutohen

interesat hegjemonistë të të dy të mëdhenjve dhe ato të klikave kapitaliste dhe jo interesat e popujve të Evropës dhe të botës. Prandaj ne nuk shkojmë në to, po i demaskojmë dhe i luftojmë më me efikasitet nga jashtë. Kur mbledhjet të jenë me të vërtetë të popujve, kundër sundesve të tyre, atëherë Shqipëria do të jetë kurdoherë pjesëmarrëse.

Rumunët në këto mbledhje hiqen sikur luftojnë në të dy frontet. Çfarë blufi i turpshëm! Ata u përngjasin atyre kurvave që tërë natën flenë dhe marrin pare e kredi nga revizionistët e imperialistët dhe ditën na venë në mbledhje si virgjëresha!

E këshillova ministrin që duhet t'i ndjekin këmba-këmbës punimet në këto konferenca, të nxjerrin konkluzione dhe të shkruhen artikuj. Duhet të kenë parasysh këto probleme:

Imperializmi amerikan, përpara krizës së madhe që ka mbuluar botën kapitaliste dhe atë vetë, edhe do që të çlirohet nga shpenzimet e mëdha ushtarake, por edhe nuk do që forcat e armatosura t'i heqë nga Evropa. Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan ta mbajnë në këmbë NATO-n jo vetëm përkundrejt Traktatit të Varshavës, por edhe për të mbajtur nën presion aleatët e vet. Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpiqen që këto shtete aleate të paguajnë më shumë, qoftë për ushtritë e tyre që mbajnë, qoftë për të financuar dollarin në rrugë të tjera, domethënë të eksportojnë më shumë dhe të importojnë më pak dhe të mbyllin kështu deficitin e madh të buxhetit amerikan.

NATO-ja i kërkoi Rosisë që të mblidheshin dhe të bisedonin «për pakësimin e balancuar të forcave në Evropë». Vendet e Traktatit të Varshavës u dhanë një përgjigje pozitive «që pakësimi të prekte vetëm forcat e huaja të vendosura në Evropë». Kjo bëhej që t'i hapej rrugë mbledhjes së «Sigurimit evropian». Hapin vendim-

tar për këtë pazarllëk e bënë Niksoni me Brezhnjevin në Moskë, domethënë të dyja këto mbledhje të bëheshin paralele.

Në Helsinki filluan bisedimet proceduriale pa mbarim kur sovjetikëve nuk u leverdiste, pse jo vetëm Rumania lëvizte vithet, por filloi të lëvizte edhe Polonia. Atëherë mbledhje pas mbledhjesh, presione pas presionesh, rumunët venin përpiqnin kokën te Franca dhe kjo, që kishte planet e saj, i këshillonte të mos u bënin shumë «skerco» sovjetikëve. Rumunët ulnin ca pendët e gjelave. Sovjetikët dëshironin që ta mbronin këtë konferencë, që e kërkuan vetë, shpejt e shpejt, me një deklaratë të përgjithshme dhe të kalonin radhën. Sovjetikët parashikojnë shumë vështirësi.

Amerikanët dhe perëndimorët duan t'i venë çështjes së dobësimit të Bashkimit Sovjetik deri në fund dhe jo vetëm ta dobësojnë ekonomikisht, duke investuar atje dhe në vendet satelite të tij kapitalet e tyre, jo vetëm ta dobësojnë edhe ushtarakisht, duke kërkuar tërheqjen e forcave sovjetike nga Evropa, por duke kërkuar që të hapen edhe kufijtë për idetë, për shtypin, për propagandën, për turizmin etj. Është e qartë tabloja. Ata duan t'i shkëputin Bashkimit Sovjetik, nga influenca e tij, satelitët (këta vetë janë të gatshëm për këtë) dhe t'i lidhin pas qerres së tyre.

Kështu zgjerohet hinterlandi i perëndimorëve dhe shtyhen tej kufijtë e Bashkimit Sovjetik duke arritur në ato pozita, siç ishin para Luftës së Dytë Botërore. Kjo nuk i intereson socialimperializmit sovjetik, i cili dëshiron t'i mbajë nën thundrën e vet satelitët. Prandaj në vijim Bashkimi Sovjetik propozoi që në Vjenë të bisedohej për pakësimin e forcave dhe të armatimeve kombëtare, ndërsa pakësimi i forcave të huaja lihej në plan të dytë. Sigurisht sovjetikët e bënë këtë propozim, me qëllim që muhabetet të zgjatëshin e të mos mbaronin

kurrë dhe gjoja, për të dhënë përshtypje «demokratike», domethënë jo bisedime bllok me bllok dhe as vetëm midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, si në SALT, po të atilla ku të merrnin pjesë edhe shtete të tjera nga çdo bllok. Kjo, natyrisht, do të nxjerrë çështjen tjetër, kërkesën për të marrë pjesë edhe shtete «asnjanëse», domethënë Vjena, të bëhet si Helsinki, në mos më e gjerë dhe çdo gjë të lihet në kalendat greke. Të bëhen pallavra dhe punët të ecin ashtu si vendosin në kulisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik.

Është pra e qartë se të gjitha këto probleme manipulohen nga këto dy superfuqi për të balancuar potencialet e tyre ekonomike dhe ushtarake në Evropë, për të ruajtur dhe për të konsoliduar pozitat e tyre në sferat e influencës dhe njëkohësisht për të dhënë përshtypjen se po luftojnë për «Sigurimin evropian».

Në çështjen e gjoja pakësimit të forcave është e qartë se kërkohet të arrihet në çarmatimin e popujve, në dobësimin e aftësive të tyre mbrojtëse dhe për t'u imponuar lehtë vendeve të Evropës diktatin e superfuqive, për t'i mbajtur nën shantazhin dhe kërcënimin raketo-bërthamor. Këto dy superfuqi nuk do të bëjnë asgjë për të dobësuar forcat e tyre, potencialin e tyre, përkundrazi në çdo gjë synohet që të fshihet kjo dhe çarmatimi të bëhet në kurriz të të tjerëve.

Por edhe në qoftë se këto dy superfuqi bëjnë, në këtë drejtim, ndonjë lëshim të vogël simbolik, dihet se mjetet e mekanizuara, aerodesante, forcat raketo-ushtarako-detare etj., kanë një sferë të gjerë e të shpejtë veprimi nga një vend në tjetrin. Kështu që ky gjest i vogël simbolik nuk prek aspak aftësinë goditëse amerikano-sovjetike në të gjitha rajonet e Evropës.

Rreth këtyre qëllimeve kardinale vërtitet çdo gjë në këto konferenca. Sigurisht, në evoluim do të ketë pro-

bleme, do të ketë çështje, do të ketë taktika si të njërës palë, edhe të tjetrës. Dhe çdonjëra nga këto do të ketë arsye dhe qëllimin e saj pse bëhet. Prandaj, pa humbur fillin, ne duhet t'i ndjekim ngjarjet, t'i analizojmë dhe t'ia shpjegojmë popullit tonë, në radhë të parë, dhe, aq sa mundim, edhe atyre që na dëgjojnë ose që interesohen të dinë mendimin tonë. Dhe ky interesim nuk është i vogël në botë. Gjithashtu, qëndrimet tona politike aprovohen dhe vërtetohen nga koha.

TRUPA
DHE MARRËS

E PREMTE
26 JANAR 1973

TAKIM ME AMBASADORËT VIETNAMEZË

Prita sot ambasadorët e RD të Vietnamit dhe të Republikës së Vietnamit të Jugut. Ata vetë e kërkuan këtë takim me mua.

Në takim më komunikuan zyrtarisht ato që lexuam në komunikatën e tyre të botuar nga shtypi, për «paqen në Vietnam». Ua thashë mendimin, i cili u mbajt me stenogram nga shokët tanë.

Përshtypja ime, pas fjalëve që më thanë në fund, është se i pritën mirë çka unë u thashë hapur e sinqerisht. Më premtuan se mendimet e mia do t'ua komunikojnë partive të tyre.

SHËNIM

Bisedova me Ramizin për të udhëzuar shtypin që, pasi të nënshkruhet «Marrëveshja mbi mbarimin e luftës dhe rivendosjen e paqes në Vietnam», të botohen pikat e saj kryesore dhe pastaj të përgatiten artikuj në frymën e bisedës që u bëra ambasadorëve të Vietnamit, natyrisht, pa thënë çështjet e brendshme.

...

U NËNSHKRUA MARRËVESHJA MBI MBARIMIN E LUFTËS NË VIETNAM. INDOKINA — PRE E NDARJES SË ZONAVE TË INFLUENCËS

Dje, më 27 janar, në orën 10⁰⁰ të mëngjesit u nënshkrua në Paris «Marrëveshja mbi mbarimin e luftës dhe rivendosjen e paqes në Vietnam». Ky është një kompromis i turpshëm për vietnamezët.

Çorba e Vietnamit u gatua nga imperializmi amerikan dhe nga revizionistët modernë në kurriz të popullit heroik të Vietnamit. Por ç'u bë me popujt e tjerë të Indokinës dhe veçanërisht me Kamboxhian dhe me Laosin, që luftojnë për çlirim, për të mos folur për Tajlandën, e cila është një koloni, një bazë ushtarake e amerikanëve dhe që do të presë si strehuese edhe bombardierët që largohen nga Vietnamit?

Në Paris gjoja u vendos dhe u vu në marrëveshje se nga këto dy vende do të tërhiqen trupat e huaja që ekzistojnë në to dhe kaq. Princi Sihanuk, në një intervistë që i dha shtypit në Pekin në lidhje me lajmin e përhapur se gjoja janë trupat vietnameze që luftojnë në Kamboxhia, u përgjigj me zgjuarsiri se «këto të ashtuquajtura trupa verivietnameze janë të tilla aq sa është amerikan edhe gjermani Kisinger». Por këto janë llafe për të fshehur të vërtetën dhe e vërteta është se këto që kurdisen në prapaskena dhe në tryezën e gjelbër të ndërtesës në «Aveny Kleber» jo vetëm kanë folur e

kanë diskutuar, por kanë vendosur edhe marshrutin që duhet të ndjekin për likuidimin e luftës nacionalçlirimtare në këto dy vende. Indokina po bëhet preja e ndarjes së zonave të influencës.

Revizionistët sovjetikë nuk e njohën qeverinë e princit Sihanuk dhe mbajtën lidhje me qeverinë e puçistit reaksionar dhe agjentin e amerikanëve Lon Nolin. Sovjetikët dhe shtetet e tjera revizioniste, aleate të tyre, ishin pra kundër luftës nacionalçlirimtare të popullit të Kamboxhias. Ata u vunë haptazi në anën e reaksionit dhe kundër popullit, duke u radhitur kështu në një vijë me imperializmin amerikan, i cili mori pjesë drejtpërdrejt në luftime në mbrojtje të klikës së Lon Nolit. Kjo është e qartë dhe s'ka nevojë të supozohet. Por ky qëndrim ultrareaksionar i revizionistëve sovjetikë është, përveç të tjerave, rezultat i ujdive të fshehta të tyre me amerikanët, është rregullimi i së ardhmes së Kamboxhias.

Nga ana tjetër, gjatë gjithë kësaj kohe, revizionistët sovjetikë ishin në tratativa të fshehta me amerikanët për të shuar luftën nacionalçlirimtare në Vietnam, për të shpëtuar nderin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Niksonit dhe për të përgatitur tok edhe me udhëheqjen revizioniste vietnameze atë që u arrit në Konferencën e Parisit. Për të dy këta ortakë në krime kundër popujve, shuarja dhe disfata e luftës në Vietnam do të sillte edhe shuarjen e luftës në Kamboxhia dhe në Laos. Tash këta dy ortakë do të punojnë që luftëtarët e lirisë në Vietnamin e Jugut të integrohen, siç duan ata, në regjimin reaksionar të Thieut, të dobësohen sa të jetë e mundur më shumë e më shpejt dhe Vietnami i Veriut të futet në vallen e të gjitha shteteve të tjera pseudosocialiste.

Nga ana tjetër do të punojnë, dhe këtë ata mendojnë se e kanë më të lehtë, të shuajnë luftën në Kamboxhia e në Laos ose me presione të shumanshme, ose me ujdi

dhe me dallavere. E gjykuar kjo çështje në këtë prizëm «trupat e huaja vietnameze», të Veriut ose të Jugut, që marrëveshja e Parisit cakton se do të tërhiqen, mund ta bëjnë këtë për fasadë, por mund edhe të futen ilegalisht ose në marrëveshje me njëra-tjetrën për të shuar luftën e popullit nga brenda ose veç e veç për të ndihmuar njëra palë Sihanukun, me qëllim që ta futin nën ndikimin e tyre dhe tjetra palë Lon Nolin. Kjo do të shkojë në harmoni me atë se si do të zhvillohen çështjet në Vietnam. Po lufta në Kamboxhia ka rrezik të dobësohet, pse mund t'i pritët ndihma nën shumë pretekste dhe Kina s'do të jetë dot në gjendje t'i ndihmojë sa duhet, për shumë arsye.

Cili është qëndrimi i Frontit të Çlirimit të Kamboxhias dhe i Sihanukut përpara këtyre ngjarjeve?

Mendojmë se është një qëndrim i drejtë. Sihanuku, pasi u shpallën klauzolat e marrëveshjes, mbajti një konferencë shtypi në Pekin dhe foli hapur e me guxim politik. Ai në substancë tha se populli kamboxhian do të vazhdojë luftën deri në fund, deri në fitoren e plotë mbi klikën tradhtare të Lon Nolit dhe gjithë atyre që e ndihmojnë. Unë, — tha ai, — nuk pranoj të bëj asnjë bisedim dhe asnjë kompromis me kurrkënd për këtë çështje. Lufta vazhdon dhe do të vazhdojë deri në çlirimin e plotë të Kamboxhias, nënvizoi ai. Rregullimi aktual i çështjes së Vietnamit nuk mund të ndikojë në vendimet tona.

Sihanuku foli edhe për marrëveshjen që u arrit në mes vietnamezëve dhe amerikanëve.

Ç'del nga gjykimi i tij? Ai nuk e aprovon këtë ujdi, sido që, për të mos dalë hapur kundër, thotë se «kjo mund të jetë mirë për vietnamezët», por shprehet çiltazi se çka thuhet në marrëveshje, nuk do të mbahet, do të shkelet dhe lufta do të vazhdojë, se lufta s'ka pushuar. Këto janë, me pak fjalë, mendimet që shprehu Sihanuku dhe nuk janë të gabuara, por janë pikëpamjet e një patrioti kamboxhian.

A do të qëndrojë në këto mendime Sihanuku? Varet nga vendosmëria e tij, nga vendosmëria e komunistëve kamboxhianë, varet nga populli që lufton, varet dhe nga miqtë e popullit kamboxhian, Kina etj.

Ne folëm haptazi, me dashamirësi dhe miqësisht me Sihanukun dhe me shokët komunistë që ishin me të, kur erdhën te ne. Miqtë mbetën shumë të kënaqur dhe ne ishim solidarë me ta. Edhe paskëtaj ne do ta ndihmojmë me të gjitha forcat luftën e drejtë nacionalçlirimtare të popullit kamboxhian, vietnamez e laosian. Por njohim se fitorja e tyre nuk varet vetëm nga ana jonë. Problemi është shumë i koklavitur, me rreziqe e me të papritura, prandaj nga Partia dhe udhëheqja e saj duhet ndjekur me kujdes e me vigjilencë, pse çdo gjë do të ketë reperkusione të thella në botë.

E HËNE
29 JANAR 1973

SHENIME

Me shokun Ramiz diskutuam për artikullin mbi marrëveshjen për «paqen» në Vietnam, që duhet të botohet nesër në «Zërin e popullit»¹.

Shoku Haki Toska më vuri në dijeni për propozimet që pala rumune i bëri Ministrisë së Tregtisë sonë për zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë në mes të dy vendeve, si edhe për çeljen në Tiranë, nga ana e tyre dhe me shpenzimet e tyre, të dy ekspozitave të vogla, njëra për barëra mjekësore dhe tjetra për makineri. I dhashë mendimin që ekspozitat le të pranohen, të tjerat t'i studiojë Ministria e Tregtisë dhe Qeveria, në kemi leverdi.

1 «Disfatë e rëndë për imperializmin amerikan».

E MARTE
30 JANAR 1973

VIETNAMEZËT VETËM DUKE QËNDRUAR JASHTË KOMBINACIONEVE IMPERIALISTO- -REVIZIONISTE

Pjesëmarrja e Kinës në Konferencën Ndërkombëtare për Vietnamin më duket se do të jetë një gabim i madh politik nga ana e saj. Kjo konferencë do të vulosë dhe do të mbrojë marrëveshjen e Parisit për Vietnamin, dhe do t'i ngjasë si dy pika uji Konferencës së Gjenevës, e cila u shkel nga amerikanët dhe rezultoi me luftën e tyre agresive barbare kundër Vietnamit. Të angazhohesh në këtë krijesë imperialisto-revizioniste, gjoja pse t'u lut Vietnamit ose gjoja se mbrohet e ardhmja e Vietnamit, kjo nuk mund të qëndrojë në këmbë. Po more pjesë në këtë konferencë dhe bëhesh garant për zbatimin e marrëveshjes, do të thotë të marrësh pjesë në këtë hibrid revizionist, ta mbrosh dhe të lidhësh duart për veprime revolucionare në të ardhmen. Kjo do të thotë, gjithashtu, «të mbrosh me rreptësi rrugën paqësore të marrjes së pushtetit» nga duart e reaksionit më të egër sajgonez prej popullit vietnamez, do të thotë që luftëtarëve të çlirimit t'u thuash dhe t'i këshillosh, që kështu siç ka ardhur dhe siç u bë puna, të pushojnë luftën, të tregohen të durueshëm përpara masave dhe shqetësimeve të Thieut. Kësaj i thonë të qëndrojnë kontrolli ushtarak përjetë mbi Vietnamin, të shtohet dhe të ndërlikohet çështja me OKB-në etj.

Vetëm po të kesh qëllime të tjera që nuk pohohen dhe që një situatë e tillë ekuivoqe të pëlqen, mund të marrësh pjesë. Ndryshe, po je revolucionar, Vietnamit ndihmohet dhe bile fuqimisht, duke qëndruar jashtë këtyre kombinacioneve të ndyra imperialisto-revizioniste.

VËREJTJE PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME

Ministrit të Punëve të Jashtme ia ktheva tekstin e përshëndetjes që kishin përgatitur për vietnamezët, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes mbi mbarimin e luftës: së pari, për arsye se ishte shumë sektar dhe shumë i thatë dhe së dyti, pse ishte një telegram për Jugun dhe për Veriun, kurse duhet të jenë dy të veçantë, pra, jo me një përmbajtje.

Çështja e dytë për të cilën e kritikova ministrin e Punëve të Jashtme është se janë kënaqur dhe i ka zënë gjumi në lidhje me mbledhjet që mbahen në Helsinki dhe në vendet e tjera ku dy superfuqitë projektojnë të bëjnë zhurmë për «pakësimin e forcave të armatosura». Ministria jonë e Punëve të Jashtme mendon se ka qenë i mjaftueshëm për ne qëndrimi që mbajtëm për mbledhjen e Helsinkit dhe që u gjend shumë interesant nga gjithë bota. Por ne duhet të shkruajmë dhe të flasim, se ato që thamë për atë mbledhje, u vërtetuan, të vëmë në dukje kontradiktat dhe të vazhdojmë demaskimin e tyre. Ministria e Punëve të Jashtme është dhe e ka për detyrë të ndjekë ngjarjet, t'i studiojë, të nxjerrë konkluzione dhe të dalë me propozime.

KISINGERI NË HANOI

Shtetet e Bashkuara të Amerikës njoftuan se për së shpejti Kisingeri, këshilltari misterioz i Niksonit, do të vejë në Hanoi të bisedojë me udhëheqjen e RD të Vietnamit për marrëdhëniet në mes të dy vendeve dhe për «ndihmat» që do t'i japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës Vietnamit të Veriut «për të rindërtuar» vendin. Vrasësit dhe djegësit po bëhen miq! Ç'mjerim, ç'stomak revizionist! Akoma nuk është tharë firma në «traktat». Po më e madhja, gjaku i miliona vietnamezëve ku vajti? Po shkelet me këmbë! Turp!!

ÇI PEN FEI SHTYN VIZITËN NË VENDIN TONË

Nga Pekini na lajmëruan se ministri i tyre i Jashtëm Çi Pen Fei e shtyu vizitën e tij zyrtare, që do të bënte te ne në datën 13 të këtij muaji. Shtyrja bëhet se «ai po përgatitet për Konferencën Ndërkombëtare për Vietnamin», për të cilën kinezët nuk kanë as ftesë, as nuk dinë ku dhe kur do të mbledhet.

PËRPJËKJE E PATURPSHME E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Një miku ynë vjenez shkoi në ambasadën tonë në Austri dhe në emër të përfaqësuesit sovjetik në Organizatën e Energjisë Atomike propozoi që «të zhvillohen bisedime të fshehta në mes nesh dhe sovjetikëve, në Vjenë, për të përmirësuar marrëdhëniet etj.» Ambasadori ynë i dha në mënyrë të merituar përgjigjen, noproçë, ashtu siç i do mushka drutë. Ç'të poshtër që janë! Diplomacia sekrete e amerikanëve po vihet gjerësisht në zbatim nga revizionistët modernë.

NJË PROPOZIM I RI I QEVERISË KOREANE

Qeveria koreane propozon të dërgojë te ne një delegacion të arsimit, me ministrin e Arsimit në krye, për të shkëmbyer eksperiencë. Ne ta pranojmë. Më parë dërguan një zëvendësministër të Jashtëm, i cili ftoi dhe një zëvendësministrin tonë. Po tanët janë të ngathët, sikur kanë frikë të dalin. Koreanët, siç duket, duan «të gjallërojnë» lidhjet, që vetë me vijën e tyre revizioniste i ftohën.

KISINGERI NË PEKIN

Në historinë e mbretërve të Francës dhe pikërisht kur mbretëronte Luigji i 13-të, kardinali i famshëm Armand Dy Plesis Rishëlië përdorte sivëllanë e tij «*le père Joseph*», për të zhvilluar bisedimet sekrete diplomatike me shtetet e tjera. Është për këtë arsye që «*le père Joseph*» njihet në histori me nofkën «*éminence grise*» ose «kardinali i murrmë», i errësirës. Ai personifikon intrigat në prapaskenë, diplomacinë e fshehtë.

Aktualisht, në fund të shekullit të 20-të, Kisingeri luan po këtë rol diplomatik djallëzor. Ai është bërë «*éminence grise*» i presidentit amerikan Nikson. Ky diplomat gjerman (pavarësisht që është çifut dhe ka ikur nga Gjermania naziste, se ishte në rrezik) i shërben me besnikëri hitlerianit më të egër që ka ardhur në fuqi pas Luftës së Dytë Botërore, presidentit Nikson, kreut të imperializmit amerikan.

Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, si dy superfuqi imperialiste, në praktikën e tyre të lidhjeve dhe të marrëveshjeve, kanë vënë në shërbim diplomacinë e fshehtë. Kjo është e kuptueshme, është e nevojshme për ta, se politika dhe veprimet e tyre janë kundër interesave të popujve të botës, janë komplete banditësh që duhet të kurdisen në errësirë. Këta nuk duan t'u zbulohen planet dhe ujdite në mes tyre në ndarjen e botës dhe në shfrytëzimin e popujve, ata duan

t'u mënjanohen telasheve, kokëçarjeve dhe rezistencës nga ana e popujve. Sa të jetë e mundur, ata duan të she-shojnë, në mënyrë të fshehtë dhe në kurrizin e të tje-rëve, kontradiktat që kanë dhe që dalin në mes tyre. Vetëm kur kanë rënë në ujdi ose kur kontradiktat në mes tyre janë të pakapërcyeshme, ata lënë të duket diçka nga manovrat që zhvillojnë në errësirë. Këtë diplomaci të ndyrë sekrete, të dyja superfuqitë bëjnë përpjekje t'ua imponojnë edhe të tjerëve, të cilët, kur me dashje, kur pa dashje, po ndjekin këtë rrugë.

Diplomacinë e fshehtë ka filluar ta praktikojë me dashje edhe Kina socialiste, veçanërisht me amerikanët, dhe këtu qëndron rrezikshmëria. Kjo është një praktikë e padrejtë dhe e dënueshme. Asnjëri, qoftë mik, qoftë armik i Kinës, nuk di, nuk merr vesh ç'po ngjet në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës. Miqtë e Kinës, sidomos, nuk dinë asgjë. Kisingeri vete e kthehet nga Kina fshehtazi dhe haptazi, po ç'thuhet, ç'bisedohet, ç'vendoset? Asgjë nuk pipëtin. Edhe për ne, çdo gjë mba-het sekret. Vete dhe ikën Niksoni në Kinë, po ç'u tha, ç'u bë, ç'u vendos? Çdo gjë për ne mbetet në errësirë. Kurse gjithë bota le të lexojë vetëm sloganet e komunikatave kashtë. Natyrisht, ne kashtë nuk hamë dhe kemi plotë-sisht të drejtë të mendojmë, dhe të mendojmë drejt e pa u gabuar, se kinezët bisedojnë me agjentët e impe-rializmit amerikan dhe marrin vendime që neve dhe të tjerëve nuk na i thonë, se nuk u intereson, mbasi nuk janë gjëra për të thënë, se janë të dënueshme dhe të papranueshme nga popujt. Nuk mund t'u gjesh arsye tje-rër këtyre veprimeve.

Le të pretendojnë kinezët se ato çka bisedojnë dhe çka vendosin me amerikanët shërbejnë për të thelluar kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Kjo nuk hahet. Mund të jetë edhe e kundërta, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i

bëjnë këto për të thelluar kontradiktat në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Atëherë thuaji haptazi veprimet e tua, Kinë e Mao Ce Dunit, që t'i gjykojë opinioni botë-ror, nëse i shfrytëzon drejt apo gabim kontradiktat dhe çfarë çmimi paguan për këto veprime!

Udhëheqja kineze mund të thotë se po t'i zbulojë këto tratativa me amerikanët, i marrin vesh sovjetikët. Atëherë, pse nuk e thua hapur se me amerikanët e ke grurë dhe ke aq besim tek ata, sa t'u besosh atyre dhe jo neve, miqve të tu? Apo miqtë tash janë vetëm miq në thonjëza dhe janë bërë «të mërzitshëm»? Por, të bësh një punë të tillë të fshehtë, do të thotë të futesh në rrethet e intrigave e të intrigantëve dhe të ndryshosh krejt mentalitetin, gjykimin dhe vlerësimin për popujt e tjerë, për problemet dhe për hallet e tyre.

Udhëheqësit kinezë mund të thonë: «Ne jemi me popujt, nuk ndërrojmë vijë, çdo gjë e bëjmë për inte-resin e socializmit». Është kollaj të thuash parulla, po di-plomacia e fshehtë vazhdon. Kinezët sulmojnë sovjetikët që merren vesh fshehtazi me amerikanët. Po vetë udhë-heqësit kinezë ç'bëjnë? Të njëjtën gjë kanë filluar dhe këtë po e vazhdojnë me galop. Janë në garë me sovje-tikët kush të hyjë më mirë në «*bonnes grâces*» të fashistit Nikson. «Ribentropi» Kisinger i Niksonit pritet në Moskë, në Pekin e gjetkë, si Mesia i çifutëve, pritet t'u sjellë «*manën*»¹ shpëtimtare, pritet t'u sjellë fjalën e mirë nga «perëndia» e Shtëpisë së Bardhë. Kjo është skandaloze!

Ç'mendojnë dhe ç'thonë popujt e tjerë që luftojnë kundër imperializmit amerikan dhe lakenjve të tij, kur shohin sidomos udhëheqësit kinezë të bëjnë të tilla gjëra? Mos vallë këto marrëveshje të ndyra e ndihmojnë

¹ Ushqim i mrekullueshëm që, sipas legjendës biblike, iu dër-gua nga zoti ebrejve në shkretëtirë; këtu është në kuptimin ale-gorik: dhuratë e mirë, e pashpresuar.

luftën e tyre? Ç'thonë vietnamezët, laosianët, kamboxhi-anët, arabët e popujt e kontinenteve të tëra, revolucionarët, marksistë-leninistët e vërtetë? Ata thonë: Turp! Tradhti! Kompromis revizionist! Shkelje e parimeve që mbrojnë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e popujve!

Ishte e kuptueshme, deri diku, që gjatë Luftës së Dytë Botërore, presidenti Rusvelt, që ishte sakat, dhe duke marrë, gjithashtu, parasysh rreziqet e luftës, dërgonte në Londër e në Moskë këshilltarin e tij privat, Hopkins. Por aktualisht Niksoni, që po e përdor këtë taktikë me «Ribentropin» Kisinger, ka qëllime të caktuara. Ai nuk do që në pazarllëqet e tij të komprometojë Departamentin e Shtetit, domethënë shtetin e tij, por përdor një mashë, të cilën e dërgon andej-këtej për sondazhe politike, për mundësi agjenturore, «për të tatuar» xhepat e të tjerëve, kokat e tyre dhe, në rast se ky emisar bën ndonjë gabim, e hedh tej si një limon të shtrydhur, duke dalë vetë «i larë» e «i pastër». Dhe të gjithë atyre që e presin këtë kasnec të presidentit, u duket sikur kanë zënë qiejt me dorë.

Kisingeri shkoi te sateliti i SHBA-së në Tajlandë. Atje siguroi klikën e këtij vendi për çdo gjë dhe «për perspektivën e shkëlqyer që e pret Indokinën». Që andej kaloi në Laos, bisedoi, intrigoi, rregulloi, premtoi dhe deklaroi se shpejt edhe atje do të pushojë lufta.

Sot, përfaqësuesi i Niksonit dhe i imperializmit amerikan, që për vite me radhë vrau, dogji e shkatërroi Vietnamin heroik, hyn në Hanoi me degën e ullirit në dorë... As është parë dhe as është dëgjuar që kriminelët dhe të mundurit në luftime të priten nga fituesit si burra të mirë dhe si njerëz që luftojnë «për paqen dhe për të mirën e njerëzimit»...

Nga Hanoi, Mesia amerikane do të vejë në Pekin. Katër-pesë ditë do të zgjatin bisedimet, drekat e darkat me Çu En Lain, me Çi Pen Fein, mundet edhe me

Maon. Çdo gjë do të bëhet në fshehtësinë më të madhe, sikur çështjet për të cilat do të bisedojnë, u interesojnë vetëm këtyre.

Megjithëkëtë, sekretet do të zbulohen një ditë dhe «le pot aux roses» do të kundërmojë.

Por qëndrimi i kinezëve ndaj nesh, me tërë kuptimin e fjalës, është joshoqëror, i poshtër, antimarksist. Para vajtjes së Kisingerit në Vietnam, ambasadori ynë në Pekin kërkoi një takim zyrtar me Y Xhanin për të biseduar për ngjarjet e Vietnamit. Mundësia për takim nuk iu dha, por një nëpunës i vogël i tha: «Edhe ne nuk dimë gjë ç'po ngjet në Vietnam, ne jemi duke studiuar traktatet, por nuk kemi nxjerrë akoma konkluzione, nuk dimë pse vete Kisingeri në Hanoi; Kisingeri do të vijë edhe në Pekin, por nuk dimë se çfarë do të na shtrojë. Ne do të bisedojmë për çështjet tona e asgjë për të tjerët. Na kanë ftuar të marrim pjesë në Konferencën e Parisit për Vietnamin dhe jemi përgjigjur se do të marrim pjesë në të, por nuk dimë se kur do të mblidhet dhe ç'do të diskutohet atje» etj.

Edhe një shtet kundërshtar të kishim pyetur, kështu nuk do të na përgjigjej. Faktet tregojnë se rreth këtyre problemeve ne jemi vënë në dijeni nga të tjerët, që s'janë miqtë tanë. Megjithatë, edhe sikur të mos informohemi, ne kokën e kemi në vend dhe i gzykojmë situatat nga çdo gjë që ngjet. Por kjo që bënë kinezët ndaj nesh, vërteton ato që thashë më lart. Ata nuk janë në rregull. Ne do të ndjekim rrugën tonë pa lëkundje. Koha do të vërtetojë drejtësinë e gjykimeve tona. Aleanca kino-amerikane po ecën. Do të shohim deri ku do të shkojë.

**E SHTUNË
10 SHKURT 1973**

MEGALOMANIA E UDHËHEQËSVE VIETNAMEZË

Një nga zëvendëskryeministrat e Vietnamit të Veriut i tha të ngarkuarit tonë me punë në Hanoi se «tash luftën e fituam dhe testamentin e Ho Shi Minit e plotësuam. Amerikanët i dëbuam nga Vietnami, Thieuun e mundëm, po nuk e kemi shkatërruar akoma, edhe këtë do ta realizojmë, Vietnamin po fillojmë ta rindërtojmë (me ndihmën amerikane) dhe do të luftojmë që të realizojmë unitetin e vendeve socialiste». As më shumë, as më pak! Këto i tha miku i zgjuar!

Përveç kësaj nuk mungoi t'i thoshte përsëri se «populli vietnamez ka luftuar (në të kaluarën), kundër kinezëve, japonezëve, francezëve dhe amerikanëve». Me fjalë të tjera: «Ne jemi marksistë të kulluar, jemi vigjilentë kundër kinezëve, japonezëve, francezëve dhe amerikanëve, këtyre imperialistëve, prandaj kini besim te ne dhe te sovjetikët, miqtë tanë besnikë, që s'na kanë sulmuar kurrë!» Ky na qenka si duket testamenti i Ho Shi Minit.

Nga ana tjetër, marrim vesh zyrtarisht nga kinezët se këta dhe vietnamezët qenkan të zemëruar me Sihanukun, se «ky hodhi predha bosh, duke deklaruar se është gati të bisedojë me amerikanët, po jo me Lon Nolin dhe se kështu i është këshilluar edhe nga Çu En Lai dhe udhëheqja vietnameze». Tash këta, gjoja nuk i gjejnë «me vend këto bisedime për paqe», kurse vetë këtë punë

kanë bërë me vite, hapur dhe në mënyrë sekrete. Nga njëra anë e shtynë Sihanukun, nga ana tjetër na thonë ne «se nuk janë dakord dhe se duhet të vazhdohet lufta në Kamboxhia, që të mund të lëshojnë amerikanët».

Intriga po luhet. Dhe Sihanuku vepron sipas interesave të tij, siç duket edhe ky nuk do që të luajë kartën e të tjerëve. Laosin e shtynë të nënshkruajë paqen, vetë e nënshkruan, kartën Sihanuk nuk duan ta përdorin për shantazhe politiko-ekonomike për interesat e tyre. Po do t'u bindet Norodom Sihanuku? Këtë do ta shohim!

SHËNIM

Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të vërejtjeve që u bëra në lidhje me aktivizimin e marrëdhënieve me Greqinë, më dërgoi një plan propozimesh. Unë isha dakord me sa propozohet, me kusht që ato të mos bëhen menjëherë, por të jenë për një periudhë të gjatë dhe të studiohet prioriteti i shtimit të tyre.

KORRUPSIONI NË JUGOSLLAVI KA ARRITUR KULMIN

Gazetat jugosllave njoftojnë se në një ishull të vogël që ka formuar Buna në anën e tyre, jo më larg se 100-150 metra nga bregu ynë, jugosllavët do të hapin kampe turistësh nudistë. Këtë e bëjnë apostafat ndaj nesh. Ministria jonë e Jashtme do të protestojë rreptësisht që të ndalohet një gjë e tillë, ndryshe ne do të fillojmë një fushatë propagandistike kundër Jugosllavisë për këto gjëra të turpshme.

ME PARIMET NE NUK LUAJMË ME ASNJERI

Ministri i Jashtëm më tha se ministri i Arsimit i Koresë, që ka ardhur për vizitë zyrtare te ne, për të kërkuar ndihmën tonë në Kombet e Bashkuara, dhe për të demaskuar me anën e shtypit klikën e Koresë së Jugut, që hodhi poshtë «të famshmin» plan të Kim Ir Senit për bashkimin e të dy Koreve në rrugë paqësore, ka kërkuar që të piqet edhe me mua. Këtë gjë, natyrisht, e kërkon për të bërë reklamë dhe për të treguar se edhe nga ana e partisë, domethënë në vijën ideologjike, ne jemi dakord me ta. Këtë gjë zotërinjtë koreanë e bëjnë se ua duan koniunkturat aktuale, po ne me parimet nuk luajmë dhe këtë avantazh nuk ua japim, jo për çështje foddullëku në asnjë mënyrë, por për çështje parimore.

Që nga viti 1961 e deri tash, kur Partia jonë mbronte me heroizëm parimet e marksizëm-leninizmit dhe luftonte pa mëshirë revizionistët, kur Partia jonë sulmohej dhe sulmohet nga të katër anët, Koreja as nuk e ngriti një herë zërin, qoftë edhe një zë të mbytur, në mbrojtje të Partisë sonë. Përkundrazi, ajo nuk ua prishi kurrë qejfin sovjetikëve, e kishte grurë me ta, merrte ndihma me shumicë dhe për ne e për kinezët ç'nuk thoshte me hrushovianët.

Por edhe tash që duan të luajnë në të dyja tablotë, koreanët as që «gabojnë» të thonë diçka pozitive për Partinë e Punës të Shqipërisë. Për këtë arsye i thashë

ministrit tonë që nuk e pres, prandaj të gjejë një arsye diplomatike dhe t'i japë përgjigjen. Nga ana shtetërore ministrit korean të Arsimit iu bënë të gjitha nderimet e përshtatshme, të gjitha pritjet në rrugë qeveritare. Kështu që e ka edhe më tepër se ç'duhej.

E HËNË
19 SHKURT 1973*

**KINA E KA KTHYER KURSIN DREJT SHTETEVE
TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

Nga Hanoi Kisingeri shkoi në Pekin, ku qëndroi pesë ditë. Sot që po shkruaj këtë shënim, duhet të jetë larguar.

Bisedime të gjata «të përzemërta e të çiltra» janë zhvilluar me Çu En Lain dhe me Maon. Të dyja palët janë të kënaqura dhe agjencitë e huaja të lajmeve rezultatat e këtyre bisedimeve i paraqesin «shumë optimiste dhe me perspektiva të mira për botën».

Por çdo gjë mbahet në fshehtësi absolute, sidomos nga ana e Kinës, dhe kjo është skandaloze. Të bisedosh me armikun më të egër të popujve, të socializmit e të komunizmit dhe t'i mbash të fshehta këto bisedime e vendime, është antileniniste. Të mbash të fshehta nga komunistët, nga miqtë e tu, nga popujt, ato gjëra që i di të gjitha armiku i komunistëve e i popujve, teorikisht dhe praktikisht do të thotë të biesh në ujdi me armikun e t'i mbash të fshehta këto ujdi, se s'mund të thuhet, se janë të dënueshme nga opinioni. Lenini nuk lejonte qëndrime të tilla armiçësore dhe të errëta. Ai i çirrte maskën çdo veprimi të tillë.

Kina e ka kthyer kursin drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Armik kryesor ajo quan Bashkimin Sovjetik, kurse me Amerikën po e zbut. Pse? Cilat janë planet strategjike dhe taktikat e saj? Ajo asgjë nuk zbu-

lon, asgjë nuk thotë, vetëm lë të kuptojë se ajo «di ç'bën, se është një vend socialist, se Partia Komuniste e Kinës është një parti marksiste-leniniste». Por bota nuk ngopet me formula, do punë, do të shohë prova, do t'i gjykojë vetë qëndrimet që mban njëri ose tjetri. Këto veprime në errësirë nuk mund të shpjegohen aq lehtë «me shfrytëzimin e kontradiktave», siç mendojnë kinezët.

Pa le të na e thonë konkretisht, si po i shfrytëzojnë këto kontradikta në mes amerikanëve dhe sovjetikëve? Vallë mos na marrin për sylleshë e naivë, që t'u besojmë verbërisht formulave të përgjithshme? Pse i mbajnë të fshehta bisedimet me amerikanët dhe s'na lejojnë që edhe ne të gjykojmë se si e deri ku i shfrytëzojnë këto kontradikta? Vallë këto bisedime janë vetëm në favor të kinezëve? Po amerikanët vallë, nuk nxjerrin fitime prej tyre?

Është bërë zakon të thuhet se «u biseduan probleme që u interesojnë të dy vendeve». Ky është një mashtrim. Është qëndrim antileninist kur bisedon me imperialistët prapa shpinës së popujve. Si është e mundur që këto bisedime të mos u interesojnë popujve, revolucionit? Si është e mundur që armiqtë e popujve e të revolucionit t'i dinë deri në hollësi këto bisedime dhe popujt e revolucionarët të mos dinë asgjë?

Jo, shokë kinezë, këtu ka vetëm një gjë: bisedimet e fshehta, «me dyer të mbyllura», që ju po bëni, janë të dënueshme dhe ju e dini këtë, prandaj nuk i shpallni. Ju keni rënë në ujdi me amerikanët për këtë, ata ju kanë imponuar vullnetin dhe taktikën e tyre dhe ju e keni pranuar, u jeni nënshtruar. Pra keni bërë lëshime për të përfituar diçka që është e dëmshme, efemere dhe shumë e rrezikshme për Kinën, për socializmin dhe për paqen.

SHËNIM

Thirra ministrin e Jashtëm dhe i diktova një telegram për ambasadorin tonë në Pekin, i cili të marrë kontakt me Jeng Sarin, përfaqësuesin e Partisë Komuniste të Kamboxhias dhe t'i komunikojë këtij mendimin tonë për problemet e luftës së tyre, për të cilat kërkon këshillat tona.

SHËNIM

Interesante do të jenë rezultatet e zgjedhjeve parlamentare që do të bëhen të dielën që vjen si në Francë, ashtu edhe në Kili.

TITOJA MENDON SE ËSHTË KËRTHIZA E BOTËS

Lexova pardje një intervistë me të vërtetë lumë të dhënë nga Titoja një gazetareje jugosllave¹.

Ç'thosh ai në këtë intervistë? Më mirë mund të vihet pyetja përse dhe për kë nuk fliste?

Vetëm për Shqipërinë nuk pipëtinte asnjë fjalë. Përkundrazi fliste për gjithë botën, për të gjitha shtetet, të mëdha e të vogla të të gjitha kontinenteve, për të gjithë burrat e shteteve, të mëdhenj e të vegjël (natyrisht të mëdhenjve u vinte rëndësinë më të madhe), fliste, gjykonte, u jepte nota të gjithë njerëzve dhe shteteve me radhë, politikës së tyre, i kritikonte, i mburrte. Cilitdo u dërgonte këshilla se si duhej të vepronin për atë dhe për këtë gjë, jepte dhe bënte prognoza për të ardhmen e botës, të kombeve, të shteteve, të ideve, të njerëzve. Titoja mendon se është kërthiza e botës. Besoj se bota nuk ka njohur deri tash një renegat të tillë, një shitës të atdheut të tij, një aventurier, një sharlatan, një megaloman të çmendur e pa skrupull, një bandit e një hajdut, një gënjeshtar dhe blofër të tillë. Të gjitha epitetet që i përshtaten vagabondit politik dhe atij ordiner, i përshtaten të tëra edhe Titos dhe zor se mjaftojnë, duhet të krijosh të tjera.

Shokët e ambasadës në Beograd na shkruajnë se në

¹ Dara Janekoviç.

qarqet diplomatike intervista e Titos ka bërë përshtypje të keqe, bile shumë ambasadore janë zemëruar dhe kanë kërkuar shpjegime në Ministrinë e Jashtme, e cila i ka përcjellë, se dhe ajo nuk di ç'të thotë. «Njeriu i madh» lëshon «xhevahiret» si lopa bajgat.

E MËRKURË
28 SHKURT 1973

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME TË KINËS MBAN HESHTJE TË PLOTË NDAJ NESH

Në Paris do të zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare për Vietnamin, ku fuqitë e mëdha, në mes të të cilave edhe Kina, «do të garantojnë» zbatimin e neneve të marrëveshjes e të protokolleve anekse «Mbi pushimin e luftës e rivendosjen e paqes në Vietnam». As edhe këtë qëllim kryesor, të njohur botërisht, nuk na e tha Ministria e Punëve të Jashtme të Kinës. Kjo ndaj nesh mban heshtje të plotë: Për Vietnamin nuk di gjëra të sigurt, se vietnamezët nuk e informojnë; Për Laosin dhe Kamboxhian nuk dinë gjë, atje dinë vetëm se luftohet. Ç'bëri Kisingeri në Pekin? Ç'u arrit? As informatën më të vogël nuk na japin. Vetëm dy orë më parë se të publikohej komunikata, ia dorëzuan këtë ambasadës sonë në shenjë «prioriteti dhe ... sidomos miqësie». Asnjë fjalë, asnjë shpjegim nuk e shoqëroi këtë gjest. Është e qartë se kinëzët nuk janë dakord me ne dhe çdo lidhje pune në këtë drejtim e kanë këputur, zaten edhe më parë të gjalla nuk i kishin. Ata mendonin se ne do t'u këndonim himne e do t'u bënim hosana për lidhjet e tyre pa dinjitet dhe me përlulje ndaj amerikanëve, ata mendonin se do të këndonim këngën e tyre, se armiku kryesor është Bashkimi Sovjetik dhe jo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ata mendonin se ne do ta brohoritnim politikën e tyre jo-korrekte të brendshme dhe të jashtme, do t'i kuptonim,

siç i kuptojnë ata, kontradiktat dhe shfrytëzimin e tyre. Me një fjalë ata kanë menduar dhe mendojnë se ne duhet të hedhim çapin sipas çapit të tyre. Por gabohen tmerrësisht. Ata hala s'na kanë njohur ne që jemi miq besnikë vetëm në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e drejtë, të barabartë dhe jo miq në «rrugën e skllëvërve». Shqiptari, komunist dhe jokomunist, s'i ka pranuar kurrë as skllavërinë dhe as ofezat.

Dje në Konferencën e Parisit Roxhersi u ngrit, la mbledhjen dhe me një arrogancë të madhe prej fashisti deklaroi se «nuk do të vinte në mbledhje, derisa verivietnamezët nuk do të lironin robërit amerikanë të luftës në ditën dhe në orën e caktuar». Kjo është një ofezë e madhe për Kinën. Ç'përgjigje iu dha Roxhersit? Asgjë! U ngritën kalanderët dhe dolën në rrugë, shkuan u ngrohën në diell, vanë morën fotografi në Harkun e Triumfit dhe shkuan në pritjen e Shumanit. «Kongresi i Vjenës» vazhdon punimet, pritet të bëhet ndonjë mbledhje, kur t'i vijë qejfi «Meternih» Roxhersit.

E MARTE
6 MARS 1973

BISEDË ME K. MIJALIN

U takova në Komitetin Qendror me shokun polonez K. Mijal dhe bisedova gjatë me të. Ai më bëri një pasqyrë të gjendjes në Poloni dhe të luftës që zhvillon partia e tyre.

Edhe unë i fola për gjendjen te ne, për disa probleme ndërkombëtare që interesojnë të dyja partitë tona dhe për disa çështje që kanë të bëjnë me këto probleme dhe që na qitin vështirësi qëndrimet e shokëve kinezë, siç janë: Tregu i Përbashkët Evropian, «Kombet e Bashkuara Evropiane», lidhjet Amerikë-Kinë etj. Ishim plotësisht dakord në pikëpamje.

E PREMTE
9 MARS 1973*

PËR MOSMARRËVESHJET KUFITARE KINEZËT KANË RËNË NË KURTHIN E SOVJETIKËVE

Revizionisto-imperialistët sovjetikë, në rrugën në të cilën po ecin dhe me frymëzimin socialshovinist që i karakterizon, kanë filluar një veprimtari të bujshme provokuese, duke hequr të gjithë emrat e vjetër kinezë të fshatrave ose të lumenjve të disa zonave siberiane dhe duke u vënë atyre emra të rinj ruso-sovjetikë. S'ka asnjë dyshim se këto veprime hyjnë në fushatën antikineze dhe në mobilizimin e popujve sovjetikë me parulla shoviniste kundër Kinës, kundër rivendikimeve territoriale nga ana e kinezëve në dëm «të atdheut të tyre socialist». Në këtë mënyrë dhe me këto metoda revizionistët sovjetikë nxitin ndjenjat shoviniste te popujt e Bashkimit Sovjetik nën parullën se «kufijtë e Bashkimit Sovjetik janë në rrezik, prandaj duhet t'i mbrojmë». Kështu ata arsyetojnë edhe grumbullimin e një milion ushtarëve sovjetikë në Mongoli dhe në zonat e tjera kufitare me Kinën.

Kina nuk rri pa iu përgjigjur, por mendoj se ajo po përdor të njëjtat metoda shoviniste, duke rënë kështu në provokacionin që kurdisin revizionistët sovjetikë. Kinezët mbrojnë tezën se këto zona, fshatra e lumenj, emrat e të cilëve po ndërrohen tash nga sovjetikët, janë kinezë, pra këto vende i përkasin Kinës, se ato ia kanë grabitur kësaj regjimit cariste, dhe Brezhnjevi me shokë duan t'i përjetësojnë. Në këtë mënyrë konflikti acarohet, por du-

ke u nisur nga motive jo të drejta ideologjike, sepse edhe nga kinezët kalohet në pozita shoviniste, gjë që u shërben revizionistëve.

Pra në vend që udhëheqja kineze të sulmojë nga pozita parimore ideologjike, për të demaskuar revizionistët sovjetikë dhe të punojë për të afruar popujt sovjetikë dhe kinezë kundër armikut të përbashkët, ajo nisat nga pozita shoviniste, prandaj i armiqëson dhe i nxit këta për luftë me njëri-tjetrin. Dhe, çka është akoma më e rëndë, shtypi kinez për të mbrojtur tezat e veta sjell në «mbështetje» citate të gazetarëve amerikanë. Paturpësia s'ka perde fare; s'mbahet gjëkund as preteksti i «shfrytëzimit të kontradiktave»! Me këtë kinezët duan t'u thonë sovjetikëve se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë me ne, e jo me ju».

Mbahuni fort që të dy, se imperialistët amerikanë po ju hipin në zverk!

E MËRTË
13 MARS 1973

E MËRTË
13 MARS 1973

VENDIMI YNË PËR TË NDËRTUAR HIDROCENTRALIN E FIERZËS ËSHTË I PATUNDUR

Në takim me shokët Ramiz Alia, Haki Toska dhe Rita Marko, u rekomandova dhe u dhashë tezat kryesore për një fjalim që Rita duhet të mbajë në hidrocentralin e Fierzës. Në këtë fjalim, të ndërtuar si zakonisht, të vërë pikat mbi pikëpamjet tona të patundura për ndërtimin e hidrocentralit. Pra «à bon entendeur, salut»¹. Të flitet, si kurdoherë, për miqësinë dhe bashkëpunimin me Kinën, të bëhen edhe aluzione për padronët e Koçi Xoxes dhe kundër revizionistëve sovjetikë.

1 Frëngjisht — kuq e ka mizën në kësulë, le të kruhet.

E MARTE
13 MARS 1973*

PROVOKACIONE TË «SPECIALISTËVE» KINEZË SI ATO TË REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Shokët kinezë prej kohësh kanë filluar të ngadalësojnë dërgimin te ne të materialeve, të makinerive, të projekteve etj. Këtë mosrealizim të kontratave nga ana e tyre ata e «arsyetojnë» me lloj-lloj justifikimesh si: «Çdo gjë na e ka sabotuar Lin Biaoja, prandaj po punojmë që t'i riparojmë dhe shumë gjëra që do t'ju dërgojmë juve, do të ribëhen»; «Jemi prapa nga ana teknike, pas tre-katër vjetësh do të jemi mirë dhe atëherë Shqipërinë do ta ndihmojmë më shumë, se deri tash e kemi ndihmuar pak»; «Rruga deri në Shqipëri është shumë e gjatë dhe nuk na mjafton transporti»; «Kina duhet të ndihmojë Vietnamin që të rindërtohet, si dhe shumë vende të tjera» etj., etj.

Gjithashtu, kinezët nuk u japin përgjigje kërkesave për të dërguar në Kinë disa teknikat tanë, që të interesohen atje për këto çështje. Edhe ambasadori i Kinës në Tiranë, lidhur me këtë problem, ose përgjigjet me formulën e zakonshme «s'kam ndonjë lajm», ose përsërit po ato formula të «vështirësive», ose thotë se «shumë punonjës kinezë interesohen në Kinë për problemet e Shqipërisë», gjë që, tërthorazi, do të thotë se «nuk është nevoja që ju të dërgoni specialistët tuaj në Kinë».

Përveç kësaj, ambasadori kinez përdor tash edhe taktika të reja. Ai u thotë punonjësve tanë: «Ju keni kapa-

citete të pashfrytëzuara plotësisht» dhe u jep disa shembuj që s'janë realë, por ai i përdor këta «për të argumentuar» qëndrimet e tyre dhe për të na thënë: «Mos u qani pse të tjerat nuk vijnë në kohë». Ndërsa specialistët kinezë, të nxitur, kanë filluar t'u bëjnë provokacione njerëzve tanë. Njëri nga këta (natyrisht i porositur) i tha një tonit: «Ke ndonjë koment ti për pritjen e Kisingerit nga ana e Maos?». Yni i tha: «Jo». «Po cili është mendimi yt personal?», — vazhdoi kinezi. Yni iu përgjigj: «Imperializmi është armiku ynë i betuar dhe kështu do të mbetet derisa ta zhdukim». Kinezi i tha: «Prandaj Maoja si ai plaku i përrallës e futi ujkun në thes dhe i mbylli grykën që ta vrasë më mirë». Yni nuk iu përgjigj, por ndërroi bisedën. Kinezi vazhdoi duke i thënë: «Pse ju, shqiptarët, nuk keni besim te ndihma jonë?». Yni ia hodhi poshtë kategorikisht këtë gjë. Natyrisht kinezi tërthorazi donte t'i thoshte se «ju nuk keni besim te politika jonë (kineze)».

Kujdes, shokë kinezë, se kështu filluan të vepronin edhe revizionistët sovjetikë kundër nesh dhe kundër marksizëm-leninizmit! Ne sillemi drejt, flasim hapur, shoqërisht me ju, por ne s'na përkulin as presionet, as shantazhet. Ne jemi vigjilentë!

E MARTË
13 MARS 1973

SHËNIM

Prita ambasadorin e RDP të Koresë¹. Ai kërkoi takim për të më komunikuar një mesazh të Kim Ir Senit në lidhje me politikën verikoreane «për bashkimin paqësor të të dy Koreve». Koreanët kërkonin mbështetjen e Partisë, të Qeverisë dhe të popullit tonë në këtë çështje. Unë iu përgjigja pozitivisht.

¹ Song Guan Xho.

E MËRKURË
14 MARS 1973

SI T'I PËRGJIGJEMI NJË PARULLE BAJATE TË KINEZËVE

Bisedova me shokët e Byrosë Politike që të kenë parasysh se në rast se zyrtarët e lartë të ambasadës kineze në Tiranë, në bisedime me ta, u thonë se «Kina ka vështirësi» (në çështje ekonomike kuptohet dhe kuptohet po ashtu pse e përsëritin kaq shpesh këtë parullë), t'u thonë se «ne i kuptojmë vështirësitë e Kinës, por për Shqipërinë socialiste s'duhet të ketë vështirësi».

SHËNIM

Sot u bë mbledhja e përgjithshme e komunistëve të aparatit të KQ të Partisë për dhënie llogari e zgjedhje. Në mbledhje e mora fjalën edhe unë. U përqendrova në një çështje me rëndësi jetike: «Si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi imperialisto-revizionist i vendit tonë dhe efekti i presionit të tij mbi ne»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 266.

MANOVRA E KINEZËVE LIDHUR ME NDËRTIMIN E METALURGJIKUT

Erdhën shokët Adil Çarçani dhe Spiro Koleka e më vunë në dijeni se kinezët (kurdoherë gojarisht dhe asnjëherë me letër), kërkojnë të bëjnë ndryshime në ndërtimin e metalurgjikut. Në mënyrë të njëanshme ata duan të bëjnë spostime objektesh, duke kërkuar dhe 35 hektarë tokë tjetër. Por më e rënda është ajo që thonë se «po të mos aprovohen këto kërkesa, atëherë do të vonohen projektet e metalurgjikut». Nga ana tjetër, ambasadori kinez, jo vetëm që nuk pranoi kërkesën tonë për të dërguar njerëzit tanë të merrnin pjesë në diskutimet që po bëhen në Pekin në lidhje me metodën që do të përdoret për shkrirjen e hekur-nikelit, gjë që na e shtroi vetë ministri i Metalurgjisë kineze, kur ishte te ne, por u përgjigj duke thënë se «në rast se bëhet ashtu si kërkoni ju, neve nuk na leverdis etj.». Në fakt ne s'kërkuam asgjë, kurse ata kërkojnë të sajojnë shkaqe për ta shtyrë ndërtimin e veprës. I thashë Adilit ta thërrisë ambasadorin, të bisedojë me të shoqërisht, t'i vërë pikat mbi «i» dhe të kërkojë që për çështjen e parë të lejojë të venë specialistë nga tanët në Pekin e të diskutojnë, se për këta ka dy muaj që nuk japin vizë.

POHIME TË AMBASADORIT KINEZ

Adil Çarçani mori kontakt me ambasadorin kinez këtu dhe i parashtrio atij çka biseduam dhe vendosëm në disa ditë më parë për vonesat nga ana kineze të livrimëve tona, gjë që pengon seriozisht realizimin e objekteve industriale. Adili më tha se pasi ia parashtrio çështjen gojarisht, i dha atij edhe promemorian, me shkrim, për ndihmë.

Ambasadori e dëgjoi me vëmendje të madhe dhe në mbarim u shpreh kështu: «Këto janë plotësisht të drejta dhe puqen me konstatimet dhe me mendimet e qeverisë sonë. Unë do të lajmëroj menjëherë qendrën dhe duhet të marrim masa. Këto gjëra shkaktohen nga puna armiqësore e Lin Biaos. Në ministritë dhe në ndërmarrjet tona ka njerëz të ligj që nuk punojnë mirë dhe që sabotojnë».

Këto ishin shprehjet e ambasadorit. Të shohim se a do të lëvizin gjërat pas këtij takimi?

LAJM I HIDHUR NGA PK E BRAZILIT

Shoku Ramiz Alia më raportoi për bisedën që kishte pasur me shokun brazilian që erdhi nga Kina dhe që nga java niset për në Amerikën Latine. Ai e vuri në korent veçanërisht për kapjen dhe pushkatimin në Brazil, disa muaj më parë, të disa anëtarëve të KQ të Partisë Komuniste të Brazilit.

DERI KU DO TË SHKOJË FTOHTËSIA E ZYRTARËVE KINEZË NDAJ NESH?

S'ka si të mos i quajmë qëndrime të ftohta ato që mbajnë zyrtarët kryesorë kinezë ndaj vendit tonë, sidomos këto kohët e fundit. Ambasadori ynë në Pekin nuk informohet për asgjë me rëndësi ndërkombëtare ose të brendshme. Vetëm rastësisht, në ndonjë pritje, në këmbë, si për të kaluar radhën, në sallën e pritjes së aeroportit, ndonjë nëpunës i rangut të dytë ose të tretë i thotë diçka rreth atyre ngjarjeve që të gjitha agjencitë e huaja i kanë bërë bujë katër-pesë ditë më parë dhe asgjë nuk i thuhet për Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Korenë, për Bashkimin Sovjetik dhe për marrëdhëniet e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mister dhe heshtje në të gjithë frontin. Nga ambasadorë të huaj në Pekin marrim vesh gjëra që ua kanë thënë kinezët.

Maoja « ishte i sëmurë nga reumatizma » dhe s'e priti dot kryetarin e delegacionit tonë qeveritar, anëtar i Byrosë Politike. Çu En Lai « ishte shumë i lodhur », prandaj nuk e priti Reiz Malilen, kurse, në fakt, që të dy nuk ishin as të sëmurë dhe as të lodhur, se po ato ditë, si njëri, edhe tjetri, pritën përfaqësues të huaj, dhanë bankete e vizituan ekspozita angleze. Edhe Maoja e kishte për detyrë ta priste kryetarin e delegacionit shqiptar për hir të miqësisë midis dy popujve tanë, por veçanërisht

Çu En Lai i takonte në shenjë reciprociteti ta priste zëvendësministrin tonë të Punëve të Jashtme, se Kryeministri ynë e priti zëvendësministrin e Jashtëm të Kinës kur ky erdhi në vendin tonë. Më parë ka ndodhur që Çuja, bile edhe Maoja, të pritnin deri edhe ndonjë nëpunës të thjeshtë nga tanët. Këto sjellje, natyrisht, s'ka si të mos na tërheqin vëmendjen dhe të mos i mbajmë shënim për të parë se deri ku do të shkojnë kinezët me këtë qëndrim që po mbajnë ndaj nesh.

Megjithatë, ne do të ruajmë gjakftohtësinë dhe do të vazhdojmë të jemi miq e shokë të mirë me popullin kinez dhe me shokët kinezë, në qoftë se këta do të sillen ndaj Partisë së Punës dhe vendit tonë si marksistë-leninistë. Një gjë e tillë është në interes të të dyja palëve dhe në rrugë të drejtë internacionaliste.

PROVOKACION FASHIST KUNDËR AMBASADËS SONË NË ROMË

Ambasada jonë në Romë na lajmëron se një grup fashistësh italianë kanë sulmuar një nëpunës të ambasadës sonë dhe e kanë goditur. Në orën 12 të natës Ministria jonë e Punëve të Jashtme thirri ambasadorin italian në Tiranë, i paraqiti atij një protestë të rreptë dhe kërkoi që qeveria italiane të marrë masa kundër atentatorëve, ndryshe është përgjegjëse.

Para dy-tri ditësh ne kemi protestuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë se fashistë italianë kishin thyer natën, me gurë, xhamet e dritareve të ambasadës sonë në Romë.

Këto janë pjesë e fushatës së shpifjeve që ka filluar Vatikani për një ish-prift, kusar e kriminel, të dënuar nga gjyqet tona dhe kjo fushatë vazhdon dhe me siguri do të vazhdojë, por ne armiqve do t'u tregojmë vendin, me vendosmëri.

TAKIM ME MIQ KINEZË

Në Pallatin e Brigadave u takova me pjesëtarët e trupës së cirkut të Shangait dhe me ekipet kombëtare të basketbollistëve kinezë. Ishte edhe ambasadori i Kinës, Fola me ta dhe pritja kaloi në përzemërsi.

MAO CE DUNI REHABILITON TEN HSIAO PININ

Ten Hsiao Pini doli përsëri në skenë me titullin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Shtetit.

«Revolucioni i Madh Kulturor Proletar», i konceptuar dhe i udhëhequr nga «kryetari i madh Mao Ce Dun», jo vetëm që mori fund «me sukses», por tash kanë filluar të rehabilitohen njëri pas tjetrit të gjithë ata kuadro që u dënuan prej tij si «armiq e agjentë numër dy, numër tre» e kështu me radhë, «kundërrevolucionarë, guomindanas» etj. Natyrisht Revolucioni Kulturor, i cili u fillua kundër Liu Shao Çisë, Pen Çenit, Ten Hsiao Pinit e të tjerëve, mbaroi me zbulimin e «komplotit të kurdisur nga Lin Biaoja» dhe me vrasjen e tij. **Si përfundim autorët e Revolucionit Kulturor u futën në hije dhe u bënë «reaktivë» (si avionë reaktivë; ç'kuptim kishte kjo shprehje që përdorën kinezët, ata vetë e dinë!), kurse ata që Revolucioni Kulturor i kishte futur në hije dhe i kishte bërë «reaktivë», dolën në dritë dhe u bënë siç u bë Ten Hsiao Pini zëvendëskryetar i Këshillit të Shtetit!** Liu Shao Çia, Pen Çeni dhe disa krerë të tjerë qëndrojnë akoma në hije. Deri kur? Mundet derisa «të korrighohen», pse kjo është «metoda e pagabuar» e shokëve kinezë. Ten Hsiao Pini doli për herë të parë në pritjen zyrtare që iu bë Sihanukut, kur ky u kthye nga tokat e çliruara të Kamboxhias. Ai figuronte nën Li Hsien Nienin dhe mbi Çi Pen Fein. Vendin qeveritar, pra, tash e zuri. Më vonë

mund të zërë edhe vendin që kishte në udhëheqjen e partisë. «Floriri i vogël», ashtu siç e ka quajtur Maoja para revolucionit, «armiku numër dy i Partisë Komuniste të Kinës», siç u quajt gjatë Revolucionit Kulturor, tani, pas revolucionit «u korrighua» dhe «njohu gabimet».

Versioni zyrtar që iu komunikua ambasadorëve të vendeve socialiste, në mes tyre edhe ambasadorit tonë, është se «Teni në fillim të Revolucionit Kulturor ka bërë gabime të rënda dhe, tok me Liu Shao Çinë, ka zbatuar vijën reaksionare borgjeze». Vetë Maoja e ka gjykuar kështu, por gjoja ka thënë se «duhet t'i dallojmë këto gabime nga ato të Liu Shao Çisë». Dhe kështu më 14 gusht 1972 (pas vajtjes së Kisingerit), «miku» Ten, që është i zgjuar dhe nuhat nga fryn era, «i ka bërë një letër kryetarit, pranon gabimet, bën autokritikë dhe premtori të punojë mirë».

Me këtë rast, si version zyrtar na u tha tekstualisht se «kryetari Mao ka bërë një shënim, i cili është një dokument direktiv, ku thuhet: «Ta lexojnë kryeministri dhe Van Dun Hsini» (kandidat i Byrosë Politike, që bën edhe punën e sekretarit të Byrosë Politike). Gabimet e Ten Hsiao Pinit janë të rënda, por ky duhet dalluar nga Liu Shao Çia për këto arsye:

1) Në zonat e çliruara Teni u dënuar një herë, se mbrojti vijën e Maos, kur ky u sulmua nga KQ, domethënë nga Van Mini.

2) Nuk ka probleme të trashëguara nga historia, nuk ka kapitulluar përpara armiqve, ka meritë në luftë, ka kryesuar delegacionin në Moskë kundër revizionistëve sovjetikë.

Për këtë çështje ju kam folur më se një herë, — u thotë më në fund në shënim kryetari.

Pra kryetari Mao dha urdhër, siç duket, që Ten Hsiao Pini të rehabilitohet dhe Byroja Politike, natyrisht, «pasi diskutoi», e miratoi.

Personi që na i komunikoi këto, vetë Çi Pen Fei, ministri i Jashtëm i Kinës, konkludoi me versionin zyrtar se «kjo është politika e madhe dhe e ndritur e kryetarit Mao me kuadrin. Rehabilitimi i Ten Hsiao Pinit është një mësim i madh për Partinë Komuniste të Kinës, e cila do të mësojë nga marksizëm-leninizmi dhe nga mësimet e urta të kryetarit». Asgjë më shumë, asgjë më pak, vetë e hoqi e vetë e vuri.

Së pari, të tërheq vëmendjen fakti se këto gjëra të rëndësishme kryetari nuk shkoi t'i shtrojë vetë në Byronë Politike, por ua dërgoi anëtarëve të saj me nga një «shënim direktiv».

Çështja e dytë që të bie në sy është se ky shënim specifikohet për kryeministrin, në radhë të parë.

E treta është se në shënim Maoja thotë: «Ju kam folur më se një herë për këtë çështje», gjë që supozon se kryetarin nuk kanë dashur ta dëgjonin.

Kush nuk ka qenë dakord? A mund të mendohet që Çu En Lai të mos ketë qenë dakord me këtë rehabilitim të Ten Hsiao Pinit?! Ndoshta Çu En Lai dëshirona të jetë vetë zot, vetë shkop, kurse Maoja do dy vijat në parti, prandaj duhet t'i krijojë një «konkurrent» Çusë dhe jep ultimatum që «floriri i vogël» të zërë vendin që kishte pasur. **Ten Hsiao Pini vjen, natyrisht, me gjithë taborret e tij dhe të gjithë zënë vendet që kishin. Këto taborre që ishin të Liu Shao Çisë u poshtëruan gjatë Revolucionit Kulturor, pastaj «u ndreqën» dhe tash «janë bërë shqerra».** Vazhdon e shtohet kështu kaosi dhe anarkia nën flamurin e «marksist-leninistit të madh» Mao Ce Dun. **Në Kinë janë në fuqi shumë rryma: rryma e Maos, rrymat e Çusë, të Liut, të Van Minit, të Tenit, të Lin Biaos, të Guomindanit (dhe le të ndalemi këtu, se nuk do të na mjaftojë defteri për t'i numëruar). Pse marksiste janë këto gjëra?!!!**

Ambasadorët kinezë në vendet e ndryshme këndoj-

në tjetër avaz: «S'është Ten Hsiao Pini ai që ka bërë gabime, por janë bërë gabime kundër tij. Ten Hsiao Pini është shok i mirë dhe besnik i kryetarit Mao».

Po përse u bë gjithë kjo zallamahi dhe ç'do të rezultojë që këtej? Mund të gabohej, por kjo nuk është një çështje e thjeshtë. Kjo sigurisht është një «kinezëri» si gjithë të tjerat.

Tash zëdhënasi zyrtar thotë se Ten Hsiao Pini ka qenë «i vendosur kundër revizionistëve sovjetikë»! Ai mund të ishte i tillë aq sa ishte «i vendosur» edhe shoku i tij i ideve, Liu Shao Çia, aq sa ishte «i vendosur», para fillimit të revolucionit, edhe miku i tij, Çu En Lai.

Aktualisht po ndiqet një kurs pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që e udhëheq Çu En Lai. Tash në Uashington Kina ka dy përfaqësues: njëri është ambasadori i Çu En Lait dhe tjetri, i dërguari i agjencisë HSINHUA. Shtetet e Bashkuara të Amerikës manovrojnë si të duan. Kryetari bëri një «politikë të madhe» dhe, në vend që «të thellonte kontradiktat në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës», këta të dy i lidhi më fort në mes tyre, u fut vetë në mes dy topave dhe tash nuk di si të dalë. Atëherë ka mundësi që kryetarit «gjenial» i polli mendja femër: nxori Ten Hsiao Pinin nga sirtari për të filluar me të një politikë buzëqeshjeje në një krah ose në një tjetër. Anglezët e këshilluan kryetarin «gjenial» si duhet ta adoptojë politikën e tyre «*de bascule*» ose politikën e kërcimit mbilitar: «Mirë me të dy dhe jo mirë me njërin dhe keq me tjetrin, e as keq me të dy». Maoja s'mund të rrojë dot me **numrin një**, ai kurdoherë rron me **numrin dy**. Kështu që një mëngjes mund të shohim një zvarritje edhe nga sovjetikët, duke filluar me gjëra të vogla, për të arritur «ekuilibrin». Dhe kjo taktikë s'ka dyshim që do të trumbetohet si «gjeniale».

Atëherë Kina do të vijë në normën e «gjenialitetit të

politikës së saj» të bashkekzistencës paqësore, të «forcës së tretë», që u reklamua nga Çu En Lai në një intervistë apo në një banket, nuk më kujtohet. Domethënë do të ecet nën shembullin e «komunistëve» Tito dhe Çausheku. «Mirë me të dyja superfuqitë, edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe me Bashkimin Sovjetik», merr e jep nga të dyja anët, bëj intriga andej, bëj intriga këtej, gjoja se po shfrytëzohen kontradiktat, mbulohen këto me mendimin se «jam fuqi e madhe dhe se pa mua nuk bëhet dot në botë». «Të vazhdojmë kështu sa të bëhemi tri superfuqi me të gjitha tiparet», bile pa maska fare, sepse një punë e tillë këtu të çon: t'i çjerr maskat njëri-njëri pas tjetrit, siç iu çorën Bashkimit Sovjetik. A

SHKËRTIM I
KRIJËS

E MËRKURË
18 PRILL 1973

TAKIM ME MINISTRIN VIETNAMEZ KSUAN THUI

SHKËRTIM I

Prita ministrin e RD të Vietnamit, që ka ardhur te ne për një vizitë zyrtare, për të na vënë në korent të rezultateve të bisedimeve të Parisit dhe të zbatimit të marrëveshjes me amerikanët.

1 Në atë kohë kryetar i delegacionit të RD të Vietnamit në bisedimet e Parisit për dhënien fund të luftës e rivendosjen e paqes në Vietnam.

SIHANUKU DËSHIRON TË VIJË PËR VIZITË MIQËSORE E PËR PUSHIME

Norodom Sihanuku, i cili shpreh miqësi për Shqipërinë, kërkoi që nga fundi i prillit ose fillimi i majit, datën nuk e përcakton, të vijë për vizitë miqësore dhe të pushojë te ne. Ne e lajmëruam se e presim.

«GRERËZAT» BORGJEZE QËMTOJNË MJALTIN DHE LËSHOJNË HELMIN NË KOPSHTIN E «NJËQIND LULEVE»

Me paturpësinë më të madhe drejtori i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, Gën Biao, u thotë ambasadorit tonë në Pekin dhe një shokut tonë (që ka vajtur atje për kurim), përpara gjithë personelit kryesor të drejtorisë së tij, se:

«Lëvizja marksiste-leniniste në botë po shkon vazhdimisht përpara, por do akoma kohë që grupet dhe partitë marksiste-leniniste të afirmojnë qenien e tyre. Ne nuk botojmë materiale propagandistike të gazetave të partive komuniste marksiste-leniniste për dy arsye:

a) Në qoftë se botojmë në shtypin tonë artikuj të tillë për të bërë të njohur ndonjë sukses që porsa e ka arritur një parti marksiste-leniniste, ne do të tërheqim vëmendjen e armikut, i cili do të marrë masa kundër saj, dhe një gjë e tillë është dhe në disfavorin tonë edhe të vetë kësaj partie.

b) Nga eksperiencia e punës së disa viteve del se nuk është nevoja t'i propagandojmë shumë aksionet e këtyre partive, sepse armiku vepron, kështu, për shembull, shumica e udhëheqësve të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Indisë janë vrarë dhe burgosur».

Sipas Gën Biaos, udhëheqësit e këtyre partive nuk vijnë dot në Kinë, se i përgjon policia, se armiku ka kri-

juar rrjet spiunazhi etj. «Kurse nga Japonia, — tha Gën Biaoja, — është më ndryshe». «Përfaqësuesit e këtyre partive dhe grupeve, — vazhdon ai, — duan të vijnë te ne duke menduar se kjo gjë mund të ndikojë për forcimin e punës së tyre brenda. Ne nuk u themi dot «mos ejani», prandaj i ftojme si miq. Kështu vijnë te ne edhe persona nga parti që na kanë luftuar dhe na kanë sharë. Kur erdhi Niksoni dhe Tanaka, pse të mos vijnë edhe të tjerë? Bile Niksoni erdhi për nevojat e tij elektorale. **Po të dojë të vijë edhe Çan Kai Shia, le të vijë».**

Ky flet hapur dhe me cinizëm si antimarksist, pohon me gojën e tij se Kina ka hequr dorë nga revolucioni, se ajo nuk ndihmon më revolucionin, partitë dhe grupet marksiste-leniniste që luftojnë në botë. Ajo fshihet prapa maskës se gjoja mos i komprometojë këto parti dhe këto grupe përpara armiqve, kurse në realitet është Kina ajo që do t'u tregojë imperializmit dhe borgjezisë se nuk i ndihmon, as i përkrah komunistët, armiqtë e tyre. Ç'poshtërsi! Komunistët në vende të ndryshme të botës kanë shpërthyer luftën revolucionare, legale dhe ilegale, kanë marrë në sy vdekjen, kurse kinezët kanë paturpësinë të thonë se «këta komunistë duan të vijnë në Kinë për të forcuar pozitat e tyre brenda». Këta shokë kërkojnë ndihmën e Kinës, sepse mendojnë se ajo është socialiste, ndërsa Kina e Mao Ce Dunit as flet për ta, as propagandon, as riboton artikujt e tyre, as i ndihmon, por vetëm konstaton se u vranë të gjithë udhëheqësit e njërës ose të tjetrës parti. Ç'paturpësi!!

«Kina socialiste» i pret shokët komunistë njësoj si Niksonin, si Tanaken, si Çan Kai Shinë, si revizionistët. Kësaj i thonë tradhti me xhufkë. Këta veprojnë njësoj si sovjetikët kundër partive komuniste marksiste-leniniste dhe grupeve revolucionare. Kinezët kanë frikë se u del emri «për keq» dhe u prishet «nami i mirë» që krijuan në gjirin e borgjezisë amerikane dhe asaj botërore.

Prandaj kinezët nuk mund të jenë dakord me vijën marksiste-leniniste revolucionare të Partisë sonë. Ata ideologjikisht nuk janë dakord as me tërë politikën tonë të brendshme dhe të jashtme. Dhe këtë e manifestojnë. Çu En Lai, Li Hsien Nieni dhe Maoja i kanë prerë kontaktet me ne; ato që mbahen janë fare formale, diplomatike. Shqipëria nuk është më «mikja besnike e veçantë», ajo për ta ka hyrë në radhën e fundit, pas Rumanisë e Jugosllavisë në Evropë, pas Koresë, Vietnamit dhe Kamboxhias në Azi. Kina nuk merr pjesë në manifestimet tonë politike, pse komprometohet! Ajo na dërgon (meqenëse bëjnë turne në Evropë), ekupe të cirkut, të futbollit, të volejbollit dhe asgjë më tepër. Marrëveshjet ekonomike, me zvarritje, po i ruan, por duket qartë se u shua ai «zjarri i parë».

Si mundet Kina të jetë dakord me politikën tonë të jashtme, kur ajo lidh marrëdhënie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Japoninë, me Gjermaninë Federale, me Spanjën e Frankos, në një kohë që ne jo vetëm nuk lidhim marrëdhënie me to, por vazhdimisht demaskojmë politikën e tyre imperialiste e fashiste? Si mundet Kina të aprovojë revolucionarizimin e vendit tonë, luftën kundër fesë e Vatikanit, kur Y Xhani, funksionar i lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës, i thotë ambasadorit tonë se «këto që bëni ju, nuk mund t'i bëjmë dot ne, pse mbi 50 milionë të popullatës së Kinës përbëhet nga elementë të klasave të përmbysura dhe të familjeve të tyre»? S'ka se si të ndodhë ndryshe, sepse kur te ne luftohen feja, kisha e Vatikani, në Kinë, në Pekin, hapen kisha dhe katedrale katolike e ortodokse dhe nga shtypi kinez propagandohet frekuentimi i tyre.

Shtypi katolik i botës, nga të katër anët, ka ngritur një fushatë me shpifje kundër nesh dhe na vë në kundërshtim me Kinën; shtypi borgjezo-kapitalist na sulmon që nuk lidhim marrëdhënie diplomatike me Shtetet

e Bashkuara të Amerikës dhe na vë në opozicion me Kinën.

Gjithashtu shtypi kapitalist botëror, duke bërë bilancin e qëndrimeve oportuniste të Kinës për shumë probleme ndërkombëtare, nuk mungon të vërë në dukje qëndrimet tona për të njëjtat probleme, dhe natyrisht, del në konkluzionin se në mes Kinës dhe Shqipërisë ekzistojnë kontradikta, se «Shqipëria u izolua plotësisht dhe u braktis nga Kina» etj.

Po atë qëndrim që ka mbajtur Kina kundër partive komuniste marksiste-leniniste dhe grupeve revolucionare, që nuk boton asgjë për to, se mos «komprometohet», këtë qëndrim po mban tash edhe ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Asgjë nuk boton për ne, përveç pritjeve dhe përcjelljeve të futbollistëve, volejbollistëve dhe njerëzve të cirkut kinez. Çdo gjë tjetër për Shqipërinë është zhdukur nga shtypi kinez. Kinezët me këtë qëndrim duan t'i thonë haptazi botës kapitaliste dhe revizioniste se me Shqipërinë socialiste dhe me Partinë e Punës të Shqipërisë nuk kanë marrëdhënie të veçanta. Shqipërinë tash ata e konsiderojnë njësoj si Jugosllavinë dhe Rumaninë. **Por Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës u thonë nga ana e tyre lëvizjes komuniste botërore, kinezëve, dhe botës kapitalisto-revizioniste, se qëndrojnë të patundura si shkëmb graniti në rrugën marksiste-leniniste revolucionare, se nuk kanë lëvizur dhe nuk do të lëvizin asnjë presje nga këto qëndrime dhe do të fitojnë. Kina është identifikuar me Jugosllavinë titiste dhe me Rumaninë revizioniste, dhe jo me ne.**

Politika e hapjes së portave të Kinës vazhdon «me sukses» jo vetëm në marrëdhëniet shtetërore, por edhe «në rrugën e gjerë të internacionalizmit proletar». Tok me hapjen e portave të Kinës si shtet për të huajt e çfarëdo kallëpi, që nga Niksoni e Tanaka dhe Çan Kai Shia,

po të dojë, deri tek ata antimarksistë që e kanë luftuar dhe e kanë sharë, u hapën edhe portat e Partisë Komuniste të Kinës. Po, po u hapën për të huajt.

Specialistëve të huaj, që punojnë në institucionet kineze, u kanë shpërndarë për lexim dhe miratim një projektudhëzim me titull: «Mbi përmirësimin e punës me specialistët e huaj që punojnë në Kinë». Ky projekt mban vulën e fjalimit që mbajti disa ditë më parë Çu En Lai dhe për të cilin u shkrua edhe një artikull në shtypin kinez. Pra nga komentuesi zyrtar kinez u tha: «Specialistët e huaj ta njohin jetën e popullit kinez, të njihen me materialet e partisë me të cilat njihet masa me parti dhe pa parti në Kinë. Ata mund të formojnë organizata partie, bile mund të pranohen edhe anëtarë të Partisë Komuniste të Kinës, mund të marrin pjesë në format e edukimit, ose me kinezët, ose më vete, sipas dëshirës. Duhet t'u kushtohet kujdes familjeve të specialistëve të huaj për të dërguar fëmijët e tyre në çerdhe e në kopshte, që ata të bëjnë pjesë në organizata pionieri dhe të bashkimit të rinisë komuniste, që të shkojnë në shkollë sipas moshave dhe të jetojnë në konvikte tok me kinezët. Të rinjtë e huaj të mos pengohen të miqësohen, të dashurohen, bile edhe të martohen me vajza kineze. Organizatat përkatëse të ndihmojnë që të bëhet punë sqaruese me familjet kineze për të luftuar mbeturinat që ekzistojnë në këtë drejtim. Edhe sigurimi të përmirësojë punën për mbrojtjen e ekspertëve të huaj që punojnë në Kinë. Trajtimi ekonomik i tyre të jetë i mirë» etj., etj. **Me një fjalë ky projektudhëzim ishte një «poemë» e tërë liberalo-revizioniste. Po hapen të gjitha portat e Kinës për llumin e huaj kapitalisto-revizionist.**

Kjo është e qartë. «Nga kush duhet të kemi frikë?» pyesin ata që qeverisin Kinën dhe drejtojnë Partinë Komuniste të Kinës. Dhe përgjigjen: «Nga dogmatikët, nga sektarët dhe jo nga liberalët». Derisa e pohojnë vetë se

«50 milionë të popullatës së Kinës është reaksionare», le të vërshojnë nga jashtë dhe ndonjë milion të tillë! «Ç'do të na bëjnë? Do të mbyten në detin kinez. Në perspektivë ne do ta mbulojmë botën. A s'jemi populli më i madh i botës?»!

Vetë Çu En Lai ka ndërhyrë personalisht në ambasaden tonë që të merreshin masa kundër disa studentëve shqiptarë, që në mënyrë thjesht shoqërore shoqëroheshin me disa vajza kineze. Dhe kjo ndodhte shumë vjet para Revolucionit Kulturor, kështu që këto pikëpamje nuk kanë si t'ia atribuojnë Lin Biaos. **Që në atë kohë e deri tash ç'rrugë «me lule» e «ç'lule» kanë lulëzuar dhe do të lulëzojnë në tokën e Kinës së «bekuar» nga Konfuci!**

Ç'plehra do të futen në Kinë! Sa do të martohen! Sa shoqëri, legale dhe ilegale, do të krijohen! Sa kisha e katedrale do të hapen! Sa plehra do të marrin kombësinë kineze e sa nga këto do të futen në radhët e Partisë Komuniste të Kinës dhe, nën flamurin e Maos, do të luftojnë për CIA-n, për KGB-në sovjetike dhe për kapitalizmin botëror!

Me të vërtetë atje do të krijohet qendra e internacionales trockiste. Të gjitha këto plehra do të vërshojnë në Kinë nën maskën e «të majtëve», «të maoistëve», e të «të persekutuarve» në vendet e tyre. Në Kinë do të gjejnë ndihmë dhe përkrahje dhe, që andej, me krahë të ngrohtë dhe me «vulën e Maos», do të fillojnë e do të vazhdojnë luftën kundër marksistë-leninistëve të vërtetë, si dhe për të bërë me vete partitë revizioniste, që t'i tërheqin këto nga ndikimi i Bashkimit Sovjetik revizionist.

Këtej do të fillojë një veprimtari shumë e rrezikshme e revizionistëve maoistë. Duhet të jemi shumë vigjilentë. **Lufta kundër revizionizmit sovjetik, nga pozitë revizioniste, të çon në rrugë revizioniste; të mbështetesh tek imperializmi amerikan për të luftuar revizionizmin**

sovjetik, kjo të çon në rrugën e ngritjes së flamurit të ndyrë të trockizmit për të luftuar revizionizmin sovjetik dhe për t'i zënë këtij vendin si një fuqi e madhe dhe si «një udhëheqëse e madhe ideologjike».

Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina duket se janë dakord për ta dobësuar rivalin kryesor të tyre, Bashkimin Sovjetik socialimperialist. Vazhdon synimi, si nga imperializmi amerikan, ashtu edhe nga Kina për t'i shkëputur «demokracitë popullore» satelite nga Bashkimi Sovjetik. Li Hsien Nieni, i rrethuar me 4-5 zëvendësministra, e filloi këtë punë duke pritur përfaqësuesit ekonomikë të Çekosllovakisë e të Bullgarisë.

Kina ka lidhje të mira me Titon, me Çaushekun, me Karriljon. Me siguri ajo do t'i zgjerojë këto lidhje me partitë e tjera revizioniste dhe me trockistët maoistë. **Borgjezia do të lëshojë parullën që «grerëzat» e saj të venë të qëmtojnë mjaltin dhe të lëshojnë helmin në kopshtin ku «lulëzojnë njëqind lulet».**

23 PRILL 1973

PËRSE JAPONEZËT NGULIN KËMBË TË LIDHIN MARRËDHËNIE DIPLOMATIKE ME NE

Japonezët ngulin këmbë që të lidhin marrëdhënie diplomatike me ne. Neve kjo as na ndez, as na shuan! Po ç'është gjithë ky mall i madh që u ka hipur japonezëve për ne? Mua më duket se ka një qëllim. E para, që «të vërtetojnë se Shqipëria është e varur nga Kina. Ç'bën Kina, është e detyruar të bëjë edhe Shqipëria». E dyta, «po të lidhim ne marrëdhënie diplomatike me Japoninë, atëherë, mendojnë ata, duhet të lidhim marrëdhënie të tilla edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe me Bonin, mbasi edhe Kina ka lidhur me ta». Prandaj ngul këmbë Japonia e para për të çarë rrugën.

Mendoj se nuk kemi pse shpejtohemi që të lidhim marrëdhënie me Japoninë. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo se jo, por as me Bonin, as me Anglinë. Kjo të na kthejë arin që na ka grabitur, Boni të na paguajë dëmshpërblimet e luftës. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu si nuk deshën ato të lidhnin marrëdhënie 30 vjet me radhë, edhe ne nuk duam as për 100 vjet.

SHËNIM

Këshillova shokët e Ministrisë së Jashtme që seksioni i shtypit i dikasterit të tyre të përpunojë materialet që vijnë nga ambasadat dhe për ato që duhet, të informojë shtypin qendror në mënyrë që ky të godasë edhe në ato drejtime ku nuk është vënë në dijeni nga ana e ATSH-së ose e agjencive të huaja të lajmeve.

U dhashë si shembull kërkesat e veçanta për ndihmë që bëjnë shokët kamboxhianë dhe koreanë.

TË SOLIDARIZOHEMI ME THIRRJEN E ASAMBLESE SË LARTË POPULLORE TË RDP TË KORESË

Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Qeveria jonë duhet të mbështetin thirrjen që Asambleja e Lartë Popullore e RDP të Koresë u ka drejtuar gjithë parlamenteve dhe qeverive të botës, për çështjen e bashkimit paqësor të vendit dhe për ndërprerjen e ndërhyrjes së huaj në punët e brendshme të Koresë.

Presidiumi dhe Qeveria duhet t'u bëjnë koreanëve një mesazh solidariteti dhe t'u premtojnë ndihmën tonë.

KTHESË E KINEZËVE PËR METALURGJIKUN?

Delegacioni i teknikëve tanë që shkoi në Kinë me këmbënguljen e palës sonë, që të interesohej veçanërisht për shpejtimin e projekteve dhe të makinerive të kombinatit metalurgjik, na lajmëron se është pritur mirë. Pala kineze është aktivizuar dhe po merr masa serioze të shpejtojë punët. Kinezët kërkojnë ndjesë. Për elektrometalurgjinë akoma nuk kanë diskutuar.

SHËNIM

Rroftë dita e 1 Majit!

Rroftë Partia!

Parakalimi i popullit sot në bulevardin «Dëshmorët e kombit» ishte i mrekullueshëm.

Kur mbaroi parakalimi i punonjësve, vajta u dhashë dorën dhe përshëndeta delegacionet e huaja mike, që kanë ardhur për festë me ftesë të Bashkimeve Profesionale.

AMBI VIZITËN E ARDHSHE TË SIHANUKUT

Sihanuku do të vijë në Shqipëri tri herë. Natyrisht, ai vjen edhe zyrtarisht edhe miqësisht, pse do ta bëjë dhe si «eskalë» të sigurt gjatë vizitës së tij në vende të ndryshme. Do ta presim, se e kemi mik dhe lufton.

**SI TË PUNOHET PËR DEMASKIMIN E VEPRIMEVE
DHE TË POLITIKËS SË IMPERIALISTO-
-REVIZIONISTËVE**

Bisedova me shokun Ramiz se si duhet të ndiqen ngjarjet ndërkombëtare, se si duhet të shfrytëzohen të dhënat e ambasadave tona jashtë, se si duhet të instruktohen ambasadorët tanë që të na informojnë për probleme të veçanta dhe nga të gjitha këto të dhëna të përpuhuara të nxirren konkluzione, që të shërbejnë për artikuj të rëndësishëm, ku të demaskojnë veprimet dhe politikën e imperialisto-revizionistëve.

**NJË PROMEMORJE E NEVOJSHME PËR QEVERINË
KINEZE**

Me shokë të Qeverisë studiova çështjen e një promemorjeje që duhet t'i paraqitim qeverisë kineze për aktivizimin e ndërtimit të një sërë ndërmarrjesh të rëndësishme të pesëvjeçarit të tanishëm, që po na i vonojnë për arsye të ndryshme. T'u kërkojmë, gjithashtu, të plotësojnë edhe prodhimin që është i nevojshëm për ekonominë tonë, por që nuk do të merret nga këto ndërmarrje për shkak të vonesës së përfundimit të tyre. Këto prodhime që çmohen në mbi 40 milionë rubla, duhet të na jepen me kredi.

TË DEMASKOJMË KARTËN E RE TË ATLANTIKUT

ENJTE

I dhashë Ramizit udhëzime se si shtypi ynë duhet të ndjekë dhe të demaskojë «Kartën e re të Atlantikut», që shpalli Kisingeri, këshilltari i Niksonit. Të studiohen pikat e dobëta të saj, qëllimet skllavëruese dhe kontraktat që ka shkaktuar dhe do të shkaktojë kjo kartë e re amerikane në Evropë dhe në botë, si në lëmin ekonomik dhe politik, edhe në atë të mbrojtjes dhe këtu të godasim e të demaskojmë.

... të demaskojmë.

GIEREKU NË JUGOSLLAVI

Polaku Gierek¹ u prit «me pompë» nga Titoja. Të dy kanë interes të hiqen si shokë të mirë dhe miq të sinqertë. Në koniunkturata aktuale të dy kanë nevojë për njëri-tjetrin. Titoja «për ta afruar» në politikën dhe në pozitat e «të paangazhuarve», duke e ditur që ai është aktualisht «prosovjetik» dhe për t'i lënë Brezhnjev të besojë se «ja, miqtë e tu, janë miqtë e mi».

Giereku nga ana e tij është dakord me këto pikëpamje të Titos dhe i thotë Brezhnjev: «Ja, bëra një punë të mirë, që «miqësinë» e Titos për Bashkimin Sovjetik e çimentova». Nga ana tjetër polaku, me anën e Titos, ndërhyr tek amerikanët që këta ta shtojnë besimin te Polonia e Gierekut dhe t'i shtojnë pa frikë investimet e kapitaleve në Poloni.

E tërë kjo është politika e «njëqind flamurëve» dhe në ankand vihen Polonia dhe Jugosllavia që janë bërë gjahu i dy superfuqive.

1 Në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm i PPB të Polonisë.

NJË VIZITË QË ACARON KONTRADIKTAT MIDIS REVIZIONISTËVE GJERMANË E SOVJETIKË

Vajtja e Brezhnjev-it në Bon në brendi i ka acaruar marrëdhëniet me RD Gjermane. Brezhnjevi me siguri do t'i bëjë Brandit lëshime në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane dhe në interes të politikës imperialiste sovjetike. Në udhëheqjen gjermanolindore grupi i mjek-rosh-Ulbrihtit ka filluar të lëvizë kundër Honekerit, — shërbëtor i Brezhnjev-it.

NJË LETËR E MAO CE DUNIT DREJTUAR GRUAS SË TIJ

Çu En Lai, më 8 mars, në një fjalim «autokritik» që u mbajti specialistëve të huaj, të cilët punojnë në Kinë, u tha se «do t'ju lexojmë disa dokumente partie që kanë lidhje me demaskimin e Lin Biaos».

Dokumenti «i parë», i përkthyer në 7 gjuhë, iu lexua specialistëve të huaj, në mes të të cilëve ishin edhe tanët, ata që punojnë në Radio Pekini. Ky dokument është një letër drejtuar Çian Çinit nga Maoja që mban datën 8 korrik 1966.

Maoja i shkruan gruas: «Pasi u largova nga Han-xhou, banova 10 ditë në shpellë dhe tash jam në Çansha (vendi i reve të bardha dhe i lejlekut të verdhë!). Letra juaj pas këtyre 10 ditëve pa informacion, është shumë interesante dhe me plot gjëra të reja... Organi drejtues i Komitetit Qendror shpejton të më dërgojë materialet e fundit për aprovim dhe unë do t'i aprovoj. Miku im (është fjala për Lin Biaon) ka mbajtur një referat për «grushtin e shtetit» dhe i ka bërë këtij problemi një analizë që askush nuk ia ka bërë deri më sot. Disa ide të tij më bëjnë të mendohem thellë dhe të shqetësohem. Nuk ma merrte mendja që librat e mi të kishin një fuqi kaq çudi-bërëse, prandaj padashur më kujtohen thëniet: «Ajo gjë që zgjatet shumë, thërrmohet lehtë», «Sa më lart ngrihesh, më shumë vritesh kur bie», «Sa më shumë të rri-

tet lavdia e një njeriu, aq më vështirë e ka ai të jetë i denjë për të».

«Rrethanat më detyruan të plotësoj kërkesën e disave... Është e para herë që jam dakord me të tjerët kundër dëshirës sime, që veproj kundër vullnetit. Tani kam edhe tiparet e tigrinjtë edhe të majmunit, por më shumë kam ato të tigrinjtë. Kjo është kryesore dhe e rëndësishme. Të porosis që të mos të të rritet mendja nga kjo famë, të jesh e matur dhe të dëgjosh këshillat e shokëve... dhe Çenin». (Është fjala për Çen Po Tanë, por kur u pyetën shokët kinezë nga të huajt se kush ishin këta shokë që duhej të dëgjonte Çian Çini, ata thanë: nuk i njohim!) «Unë tani jam majmuni që u bë mbret, sepse nuk ka tigrin në mal. Në kohën tonë, kur mungojnë heronjtë, unë, një njeri i vogël, u ngrita kaq lart. Unë jam një hero, sepse s'kishte të tjerë. Të gjitha këto nuk duhet t'ia thuash njeriu, sepse përkojnë me thënie të zeza të të djalhtëve. Për të majtët këto do të jenë një spërkatje me ujë të ftohtë, që u hidhet në kokë, kurse të djalhtët do t'i ndihmojë. Tani kryesore është lufta për të përmbysur pjesërisht të djalhtët. Thëniet e mia të majtëve dhe masave nuk u vijnë sipas oreksit. Pasi të spastrojmë të djalhtët do të na duhet të bëjmë një spastrim tjetër, bile disa spastrime. Një herë në 7-8 vjet në botë ndodhin lëkundje dhe gjatë këtyre lëkundjeve e keqja del sipër. Mundet që, pas vdekjes sime, këto thëniet e mia të bëhen të njohura dhe të djalhtët do t'i përdorin për qëllimet e tyre, por edhe të majtët do të përdorin thënie të tjera të miat, do të organizohen dhe do të shpartallojnë të djalhtët etj. Të djalhtët do të dështojnë si Çan Kai Shia».

Kjo letër e Maos është e çuditshme për shumë arsye, duke marrë parasysh vitin kur është shkruar dhe ngjarjet e zhvilluara në Kinë që prej asaj kohe.

Pikësëpari Maoja i shkruan gruas së tij dhe tregon haptazi se vetëm tek ajo ka besim, sepse i thotë që «men-

dimet e tij nuk duhet t'ia thotë kurrkujt». Çian Çini është e vetmja mbështetje e tij. Kështu del. Për partinë as flet fare, sikur ajo të mos ekzistojë. Ekzistojnë dy rryma për Maon: të djalhtët dhe të majtët, të cilët luftojnë për pushtet, ndërsa Maoja është krejt i izoluar nga partia, nga masat, nga shokët. A është kjo letër kundër «mikut» të tij Lin Biaos, që bën Revolucionin Kulturor? Duket se po, sepse aluzionet e ngritjes së kultit të vet ia atribuon Lin Biaos. Mirëpo, kur munden të djalhtët, Maoja bën që Lin Biaoja të caktohet zëvendëskryetar i partisë me statut, në një kohë kur këtë, Lin Biao, e kishte në listën e spastrimeve të ardhshme të të majtëve. Lojë me dy faqe!? Jo mbështetje në parti, në masa. Bile ai vetë thotë në letër se «masat nuk do të më kuptojnë». Po kush mendon ky se do ta kuptojë? Gjëkund nuk duket. Duket një gjë, se në Kinë edhe në të ardhmen do të ngrihen të djalhtët që t'u bien të majtëve, pastaj këta do të organizohen dhe do të spastrojnë të djalhtët e kështu vazhdimisht një herë në çdo 7 vjet.

Rroftë kaosi dhe anarkia! Kush të jetë më i forti, le të marrë pushtetin. Një herë do të bëhet mbret majmuni, një herë tjetër tigrinjtë! Teori e bukur! Ç'besim mund të kenë kuadrot e shëndoshë në të tilla teorira? Atje luftohet vetëm për pushtet nga të dy krahët, antimarksistët dhe marksistë-leninistët duhet t'u nënshtrohen bindjeve të njërit ose të tjetrit krah!?

Cili duhet të jetë qëllimi i përhapjes së kësaj letre negative? S'ka tjetër qëllim veç që të duket gjoja pozitiv fakti se Maoja diktoi që në fillim se Lin Biaoja ishte i majtë dhe nuk kishte besim tek ai, por e përdori si të keqen më të vogël, pastaj e likuidoi.

Me këtë ai u thotë dhe të tjerëve, se «Kështu do ta pësoni edhe ju nesër, asgjë nuk është e sigurt. Çështja e dy vijave në parti është teoria ime dhe tigrinjtë, mbi të dyja këto vija, që vendos diellin ose shiun, jam unë!»!

Mirëpo çdo deduksion për çështjet kineze, ku nuk njohim ekzaktësisht të dhënat, duhet ta nxjerrim me imagjinatë, prandaj duhen menduar dhe versione të tjera.

Thamë më lart se kjo letër është shkruar në korrik 1966, kur kishte filluar Revolucioni Kulturor, kur komploti i grupit të djathtë të Liut ishte zbuluar dhe po demaskohej, pra nën prizmin e ngjarjeve të asaj kohe duhet të shikojmë edhe brendinë e saj. **Maoja ishte angazhuar në këtë luftë dhe s'ka se pse «të interpretohet» si ironi nga ana e tij referati i Lin Biaos mbi «grushtin e shtetit».** Ishte, pra, e qartë se Revolucioni Kulturor, i udhëhequr nga Maoja, luftonte për likuidimin e grushtit të shtetit të Liu Shao Çisë, dhe Lin Biaoja ishte pro kësaj lufte, ishte, pra, pro Maos.

Maoja në këtë letër i thotë Çian Çinit: «Këshillohu me shokët...». Emri i parë nuk thuhet, por s'ka dyshim se është i Lin Biaos, që është hequr dhe është zëvendësuar me pika-pika. Pse është hequr? Kuptohet, po të marrim parasysh ngjarjet e mëvonshme dhe akuzat kundër Lin Biaos. Emri tjetër është Çen. Kush është ky Çen? Kur u pyetën shokët kinezë për këtë, thanë se nuk e dinin. Kjo nuk është e vërtetë, ata e dinë, por nuk e pohojnë. Mendja ta do se është fjala për Çen Po Tanë. Mund të bëhet pyetja: Pse emrin Çen (pa Po Tanë) e lanë dhe emrin Lin Biao e hoqën? Pse s'i lanë ose pse nuk i hoqën të dy? Pikërisht këtu qëndron «kinezëria» e gjërave: Çen Po Tanë ata e kanë demaskuar me emër, kurse Lin Biao akoma jo. Apo mos vallë çështja e Lin Biaos nuk është sqaruar akoma? Apo, megjithëse demaskohet brenda në Kinë, rrethanat mbeten akoma të errëta? («Si tradhtoi Lin Biaoja?! Si iku në Mongoli?! Si donte të vriste Maon?! Si ishte prosovjetik dhe antiamerikan?» etj., etj.).

Me fjalë të tjera, duke e studiuar letrën me syrin e kohës kur është shkruar, miq të Maos dalin... (një emër

i zëvendësuar me pika-pika) dhe «Çeni». **Çu En Lai nuk del gjëkund, pra nuk figuronte në «të besuarit» e Maos. Atëherë ku qëndronte kjo figurë kaq kryesore pas asaj të Maos dhe të Liu Shao Çisë?**

Po të ndjekim këtë interpretim të letrës, atëherë shtrohen pyetjet: **Pse doli në dritë kjo letër tash?! Kujt i shërben?! I shërben kësaj situatë të krijuar, apo do të krijohet ndonjë situatë e re, «një përmbysje» e re, që predikon Maoja në letër dhe përgatit terrenin?**

Shumë evenimente kanë ngjarë, të gjitha bëheshin me emrin e Maos dhe në kthesa Maoja nxirrte gjilpërën nga mesi. Liu vepronte «me flamurin e Maos», Maoja doli kundër tij; Revolucioni Kulturor u bë «me flamurin e Maos», Maoja doli kundër Lin Biaos; Çu En Lai lufton «me flamurin e Maos», Maoja e aprovon Çunë, këtë do ta shohim. Tash ai më shumë hesht se flet, nxjerr nga një letër dhe nga një Ten Hsiao Pin nga vrima.

PAPA DO TË VIZITOJË KINËN!

Ambasadori ynë në Vjenë na njofton se, ndërsa ishte duke biseduar me atasheun ushtarak kinez kishte ardhur atasheu ushtarak jugosllav, i cili e kishte pyetur kinezin: «A mos vallë papa Piu VI do të vizitojë Kinën?».

Kinezi i ishte përgjigjur: «Po, do të vijë» dhe, duke u kthyer nga ambasadori ynë, i ka thënë: «Ne e kemi ftuar papën të vijë në Pekin, ai e ka pranuar ftesën dhe do të vijë».

Ky është kulmi i çoroditjes antimarksiste të udhëheqjes kineze.

**BREZHNEVI DO T'I BËJË LËSHIME TË MËDHA
MILITARIZMIT GJERMAN**

Vajtja e Brezhnjevitet në Bon do të shërbejë për thurje intrigash të rrezikshme ndërkombëtare: lëshime politike ndaj Republikës Federale të Gjermanisë, dëme të konsiderueshme në kurriz të interesave sovranë të Republikës Demokratike Gjermane, lëshime në favor të Bonit në drejtim të Berlinit Lindor, përgatitja për gëlltitjen e Republikës Demokratike Gjermane nga Republika Federale e Gjermanisë, fuqizimi i RFGJ dhe i revanshizmit, aleanca ruso-gjermane, forcimi i qëndrimit amerikan në Evropë si kundërbalancim dhe nënshtrim të Francës dhe të Anglisë ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës etj.

SHËNIM

Princi Sihanuk i Kamboxhias na lajmëroi se e shtyu për një datë të mëvonshme ardhjen në Shqipëri, për arsye se do të vazhdojë turneun edhe në disa shtete të tjera të Afrikës. Do të na lajmërojë datën ekzakte.

SHËNIM

Shoku Rita Marko erdhi më raportoi për punën dhe për bisedimet që ka pasur delegacioni i Bashkimeve Profesionale në Kinë.

POLITIKË E ÇUDITSHME KINEZE

Zëvendëskryeministri grek, Makarezos, ndodhet në Kinë, ku, sipas lajmeve të agjencisë HSINHUA, po i bëhet një pritje e mirë. Duket që Makarezos të jetë i kënaqur nga kjo gjë. Kuptohet se qeveria greke është e interesuar për rezultatet e kësaj vizite sepse ka jo vetëm interesa tregtie, por edhe për çështje «prestigji» ndërkombëtar. Nga ana tjetër, në vijën e amerikanëve, qeveria e Papadhopulosit luan edhe ajo kartën e «thellimit të kontradiktave në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik». Kina, nga ana e saj luan po këtë kartë për thelimin e kontradiktave midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, krahas kartës së vendosjes së prestigjit të saj botëror si «një fuqi e madhe».

Në këto koniunktura, duke marrë parasysh se grekët «kanë parasysh» marrëdhëniet tona miqësore me Kinën, marrëdhëniet kino-greke janë në favor të gjendjes sonë. Por, brenda këtyre marrëdhënieve, e drejtë do të ishte, dhe çdo gjë e kërkonte, që Kina të paktën të na kishte vënë në dijeni të këtij takimi. Kjo do të ishte minimalja, por ajo as këtë s'e bëri. Në këtë rast Kina duhej të bënte konsultime me ne, për të na thënë, në vija të përgjithshme, se ç'do të bëhej në mes tyre. Mund të jepnim edhe ne ndonjë mendim o ndonjë sugjerim për fqinjin që deri dje ishte sjellë aq keq me ne dhe që i ruan pretendimet e poshtra territoriale. Kinezët nuk morën mundimin të mësonin as historikun e marrëdhënieve tona me Greqinë. Politikë indpendente, e pavarur! Çudi, çudi çfarë miqsh!!

NË KINË PO FRYN ERË E PERËNDIMIT

Përpara Konferencës së Parisit, ku u nënshkrua marrëveshja për «vendosjen e paqes në Vietnam», Kina kishte deklaruar që ministri i Jashtëm i saj Çi Pen Fei do të bënte nëpër botë vizita, bile kishte caktuar edhe datat. Dhe në krye të listës e më parë nga të gjithë shtetet e tjera, që do të vizitonte ministri kinez, figuronte Shqipëria, «aleatja e ngushtë e Kinës». Ky ishte një vendim i drejtë dhe dinjitoz.

Erdhi Konferenca e Parisit, ku do të mernte pjesë edhe Kina me Çi Pen Fein, po plani i udhëtimeve u prish, u shty për më vonë. Mirë!

Tash lajmërohet se do të fillojë udhëtimi i Çi Pen Feit, por radha nuk është më ajo e para. Për Shqipërinë le që nuk flitet më se do të vizitohet e para, por nuk bëhet fjalë se kur do të vizitohet. Është lajmëruar se në qershor Çi Pen Fei do të vejë në Londër dhe që andej në Paris, pastaj thuhet se do të vizitojë Rumaninë.

Duket aqik se në Kinë po fryn erë e Perëndimit dhe jo erë e Lindjes!

PËR UDHËTIMIN E MAKAREZOSIT NË KINË

Ministrin e Punëve të Jashtme duhet ta kujtosh për çdo gjë. Ambasadori ynë në Athinë nuk di ç'qëndrim të mbajë për udhëtimin e Makarezosit, zëvendëskryeministrit grek, në Pekin dhe për rezultatet që u arritën atje. Në vend që ai të udhëzohet që të deklarojë se ne e aprovojmë dhe «jemi të gëzuar» për lidhjet e miqësisë të popullit kinez me popullin grek, se populli kinez është mik dhe aleat i popullit shqiptar etj., nuk i thuhet gjë fare.

Nga ana tjetër, u thashë shokëve të kësaj ministrie të lajmërojnë ambasadorin tonë në Pekin që ky nuk duhet të interesohet për bisedimet me Makarezosin, pse duhet që shokët kinezë të marrin iniciativën për ta vënë atë në korent dhe, në rast se e bëjnë këtë, ambasadori ynë të mos rrijë si hu, por t'u thotë se «u bë mirë, ne e aprovojmë» etj., etj.

AUSTRI SHËNIM

Ambasadori ynë në Pekin gjeti rastin dhe pyeti Y Xhanin nëse do të shkonte papa në Kinë dhe nëse do të lidhnin marrëdhënie diplomatike me Vatikanin. Ai u përgjigj negativisht. Gjene mirë.

MONARKIA GREKE U RRËZUA

Monarkia në Greqi u rrëzua nga kolonelët dhe Jorgos Papadhopullosi shpalli republikën dhe veten e tij president. Do të bëhet referendum popullor.

ERDHI SIHANUKU

Sot erdhi për vizitë miqësore princi Norodom Sihanuk i Kamboxhias. E pritëm me popull. Mbeti i kënaqur.

NATO-JA INTERESOHET PËR VENDIN TONË, PËRSE VALLË?

NATO-ja, në mbledhjen e fundit që mbajti në muajin maj në Bruksel, paska diskutuar edhe për Shqipërinë. Këtë informatë na e dha një ambasador i vendeve skandinave, nëpërmjet një ambasadori tonë në Evropën Perëndimore.

Informata thotë:

«Duke gjykuar pozitën dhe gjendjen e Shqipërisë, anëtarët e NATO-s kanë konkluduar se në Shqipëri situata është stabël, atje ekziston unitet dhe ka përparime në ekonomi. Shqipëria ka një pozitë gjeografike të fortë në Mesdhe, por politika e saj në lidhje me këtë det është në favorin tonë. Ajo na kundërshton ne, por kundërshton edhe sovjetikët. Prandaj ne nuk duhet ta shqetësojmë Shqipërinë dhe t'i acarojmë punët me të, përkundrazi të bëjmë që t'i përmirësojmë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia të përpiqen të lidhin marrëdhënie diplomatike me të, por pa i ngutur dhe pa i nxitur. Të ngarkojmë Italinë të interesohet në këtë drejtim».

Ky është informacioni. Sa i vërtetë është, koha do ta tregojë, por ka shumë mundësi të jetë i vërtetë, jo vetëm nga serioziteti i personit që na e dha, nga dëshira e tij ose i shtyrë të na e thoshte, kjo nuk ka rëndësi, por edhe nga përmbajtja se është e mundshme që të jetë konkluduar kështu në diskutimet e kësaj organizate, në rast

se është folur për Shqipërinë. Dhe për Shqipërinë ka shumë mundësi të jetë folur.

Unë diskutova me shokët e Këshillit të Mbrojtjes dhe me ministrin e Jashtëm për këtë çështje, ua analizova informatën dhe u dhashë udhëzime për veprim.

Politika jonë është e vendosur, socialiste marksiste-leniniste konsekuente. Kjo politikë dhe këto qëndrime jo vetëm nuk u pëlqejnë, por janë në kundërshtim të vendosur si me NATO-n, si me Traktatin e Varshavës. Gjithsecili nga këto dy grupime imperialiste do të dëshironte që Shqipërinë ta kishte nga ana e vet. Në pamundësi t'ia arrijnë kësaj, pa një goditje aventureske të armatosur kundër vendit tonë, ata preferojnë të mos «cenojnë» hëpërhë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e Shqipërisë dhe, në fakt, duan s'duan, pranojnë statukuonë. Të dy këto grupime duan të ruajnë ekuilibrin e armatosur në mes tyre.

NATO-ja dhe Traktati i Varshavës nga të dyja anët përpiqen të afrohen me ne, gjoja të tregohen «të butë e dashamirës»; Moskë u lodh për të rivendosur marrëdhënie diplomatike me ne; Uashingtoni, dhe ky i pari bëri avanca po në këtë drejtim, dhe u ndoq pastaj nga Anglia. Ne bëjmë, me të drejtë, veshin e shurdhër.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk nguten dhe, në këtë drejtim, vërtetohet brendia e informacionit që na jepet për mbledhjen e NATO-s. Sovjetikët nguten nga ana e tyre, pse duan të dalin në Adriatik dhe në Mesdhe, por ne e luftojmë me vendosmëri këtë synim imperialist grabitqar të tyre. Kjo u vjen për hosh shteteve të NATO-s, prandaj, sipas informacionit, thonë se politika e Shqipërisë në Mesdhe është në favorin e tyre. Politika jonë është po aq kundër dhe e vendosur edhe kundër imperialistëve amerikanë në Mesdhe, por NATO-ja mendon se rreziku nuk i vjen nga Shqipëria, po nga sovjetikët.

Interesimi kaq shumë i të dyja palëve për Shqipëri-në tregon, nga ana tjetër, rëndësinë strategjike të vendit tonë, si për njërin anë, edhe për tjetrën, tregon kontradiktat e mëdha në mes tyre, tregon po ashtu se në planet e luftës të të dy grupimeve, është planifikuar prej tyre që Shqipëria të bëhet fushë lufte për t'u goditur dhe për t'u pushtuar sa më parë nga njëri ose nga tjetri.

Kjo vërteton saktësinë e parashikimeve tona për luftë dhe për mbrojtjen e atdheut nga të katër anët, pa lënë pas dore asnjë anë: luftë, mbrojtje dhe sulm në rrethim.

Dihen dhe ne po i ndjekim me vigjilencë të madhe ngjarjet që zhvillohen aktualisht në Evropë, planet e sovjet-amerikanëve, të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës, po i ndjekim me kujdes marrëdhëniet sovjet-amerikane në strategjinë botërore dhe në interesat e veçantë në ndarjen në mes tyre të sferave të influencës në kurriz të popujve të vegjël. E gjithë kjo situatë e koklavitur zhvillohet në mes të një krize të madhe ekonomike, politike dhe ushtarake që përfshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Sovjetik dhe gjithë vendet e tjera aleate të tyre, por edhe të ashtuquajturën botë e tretë, e cila është inkuadruar kokë e këmbë në këtë «valle infernale».

Aktualisht acarimet dhe kontradiktat po shtohen. Dy superfuqitë, «duke harmonizuar veprimet në mes tyre», përpiqen të dominojnë mbi partnerët më të vegjël dhe të sigurojnë hegjemoninë, të shmangin kështu sa të jetë e mundur një luftë në mes tyre. Por kjo do të ketë një kufi, pse kontradiktat jo vetëm do të shtohen, por këto do të bëhen shkak për luftëra lokale, të cilat janë preludi paralajmërues i thyerjes së të ashtuquajturit ekuilibër paqësor.

Jugosllavia, pas vdekjes së Titos, do ta prishë ekuilibrin aktual? Sovjetikët po përpiqen këto kohët e fundit të ndërhyjnë atje «në mënyrë paqësore». Titoja, mik i

amerikanëve dhe gjoja i botës së tretë, po i lë të lirë të veprojnë, bile edhe në portet e Adriatikut. Ai hiqet sikur nuk i lë, mban ekuilibrin. Amerikanët dhe perëndimorët hiqen sikur nuk janë të shqetësuar. Pse? A e ndiejnë veten të fortë në Jugosllavi apo Titoja ka firmosur ndonjë marrëveshje të fshehtë me sovjetikët, që «nuk do të ndërhyjnë asnjëherë me armë në Jugosllavi dhe që Jugosllavia, edhe pas vdekjes së tij, do të jetë mikeshë e sovjetikëve dhe e amerikanëve»? Kjo është «njëfarë zone influence» e përbashkët e amerikanëve dhe e sovjetikëve dhe e bekuar nga Titoja. Ka mundësi që amerikanët dhe sovjetikët të jenë marrë vesh në mes tyre për këtë gjë, sikundër ka mundësi që kjo hipotezë të mos qëndrojë. Në këtë rast të fundit qëndron iminent rreziku i ndërhyrjes së armatosur nga të dy grupimet, i NATO-s dhe i Traktatit të Varshavës kundër Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Mundet, por kjo ka probabilitet më pak, që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja t'u lënë dorë të lirë sovjetikëve në Ballkan, domethënë që Jugosllavia dhe Shqipëria të jenë lënë si zonë influence dhe veprimi për sovjetikët. Kjo ka më pak probabilitet, pse kështu NATO-ja, Italia e Mesdheu kërcënohen seriozisht. Sidoqoftë, për ne rreziku është kurdoherë i afërt dhe çdo gjë mund të pritët nga sovjet-amerikanët. Çështja që ne na tërheq vëmendjen në informacionin që na jepet mbi punimet e NATO-s është ajo që Italia ngarkohet «të kujdeset për Shqipërinë». Kjo është e ditur dhe e parashikuar nga ne. Historikisht është vërtetuar se Italia borgjeze dhe fashiste ka sulmuar dhe ka pushtuar Shqipërinë. Edhe aktualisht NATO-ja këtë rol po i ngarkon asaj. Shqipëria, duhet kuptuar informacioni, është caktuar zonë influence e Italisë si pjesëtare e NATO-s. Në çdo variant kundër nesh Italia do të bëjë rolin e xhandarit dhe të diversionistit në koniunkturata aktuale të një «paqeje relative» dhe agresion kryesor në emër të NATO-s në të

gjitha variantet e tjera që përmenda. Në informacionin që na jepet, nuk përmendet roli që i caktohet Greqisë në një agresion të mundshëm kundër nesh, por, nënkuptohet, Greqia në NATO do të sulmojë për të përmbushur qëllimet e saj ekspansioniste dhe grabitqare kundër vendit tonë, për të mos lejuar njëkohësisht Italinë që t'u afrohet kufijve të saj, në rast se arrin ta pushtojë Shqipërinë.

Prandaj rreziku kryesor për ne qëndron si nga sovjetikët, nëpërmjet Jugosllavisë, si nga Italia dhe nga Greqia. Çdo lloj veprimi i sovjetikëve në Jugosllavi do të vërë në lëvizje veprime të NATO-s (Itali-Greqi) dhe anasjelltas.

Në lidhje me këto detyra jonë ushtarake është të jemi në gatishmëri të plotë ndaj Italisë dhe Greqisë, në gatishmëri të plotë ndaj sovjetikëve dhe luftës së tyre «rrufe», në rast se sulmojnë Jugosllavinë, pse do të na sulmojnë edhe ne, që jemi njëkohësisht të sulmuar edhe nga Italia.

Të ngremë vazhdimisht nivelin e punës politike dhe të forcojmë më shumë ekonominë. Të përgatitemi me rezervë të çdo lloji për kohë rreziku, të ndjekim me kujdes politikën italiane kundër nesh. Jepen sinjale se qeveria italiane kërkon ta «zbutë qëndrimin me ne», kërkon kontakte të reagojë kundër disa fenomeneve dhe veprimeve të Vatikanit dhe të policisë italiane kundër një funksionari të ambasadës sonë në Romë.

Dihet fushata e Vatikanit kundër nesh në mbrojtje të një ish-prihti bandit, që gjyqet tona e kishin dënuar me vdekje dy-tre vjet më parë. Ne iu përgjigjëm ashpër, duke vënë në dukje se Vatikani dhe priftërinjtë e tij kishin marrë pjesë në pushtimin e Shqipërisë nga Italia. Kjo i dogji qeverisë italiane. Gjatë kësaj fushate të Vatikanit policia italiane bëri edhe provokacionin me nëpunësin tonë, të cilin Ministria e Jashtme e Italisë kërkoj

ta tërhiqim si «persona non grata». Pastaj vetë Medici¹ ndërhyri dhe e tërhoqi këtë vendim dhe kërkoj të mos e bënim bujë. Ne nuk e pranuan, e tërhoqëm tonin dhe dëbuam një të tyrin që mbante lidhje agjenturore edhe me këtë prift para arrestimit.

Vatikani e ngatërroi politikën e qeverisë italiane. Korrente demokristiane, socialiste e të tjera nuk e aprovuan këtë fushatë të Vatikanit dhe ky tash e ka vënë në surdinë. Medici thirri ambasadorin tonë dhe i tha «fjalë të mira» për «miqësinë» etj., etj. dhe pas kësaj ambasadori italian në Tiranë largohet dhe në vend të tij vjen një i ri. «Ambasadori i ri, punë e re». Prandaj ne duhet të jemi vigjilentë për veprimet e ambasadës italiane këtu, të jemi vigjilentë ndaj politikës italiane në drejtim të vendit tonë, të vërtetojmë edhe nga burime të tjera këto informacione dhe çdo informacion tjetër dhe të bëjmë lidhjet e të nxjerrim deduksionet e nevojshme për çdo gjë dhe në çdo kohë.

¹ Në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme.

E MARTË
5 QERSHOR 1973

MBI PERSONALITETIN E SIHANUKUT

Sot paradite në selinë e KQ pritëm princin Norodom Sihanuk dhe patëm me të një bisedë të hapët, miqësore dhe të sinqertë. Ai na vuri në korent për situatën e brendshme në Kamboxhia, për vajtjen e tij atje dhe për intrigat që luajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik dhe Franca për të arritur një kompromis me të. Por Sihanuku qëndron shumë mirë, të gjitha propozimet i ka shkelmuar dhe tha se do t'i shkelmojë edhe paskëtaj.

Sihanuku, në bisedën që bëri, tha haptazi se marrëveshja e Parisit mbi Vietnamin, jo vetëm që nuk ishte një fitore, po përgatit një luftë të tretë në Indokinë. Ai la të kuptojë se vietnamezët e Veriut u gabuan dhe sovjetikët i futën ata në thes.

Fola edhe unë.

Në bisedat që bëra në darkën që shtruam për Sihanukun, ky parashtroi përsëri me forcë qëndrimet e tij «të palëkundura dhe të ashpra» kundër amerikanëve. Në fjalimin e tij shumë të mirë, të hapët e të fortë, ai e barazoi Niksonin me Hitlerin. Sihanuku m'u shpreh se është plotësisht i vendosur të mos bëjë asnjë lëshim, të mos bëjë asnjë kompromis për çështjen e çlirimit të plotë të vendit. Ai tha se nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga sovjetikët dhe nga francezët po bëhen orvatje që të arrihet në kontakte dhe në bisedime dhe këto bise-

dime të përfundojnë «me një qeveri kukull me tri kokë». Unë, — tha ai, — kurrë nuk do ta pranoj një gjë të tillë. Në qoftë se vietnamezët pranuan kompromisin, unë nuk e pranoj; në qoftë se ata pranuan që Sajgonin ta dominojnë Thieu dhe amerikanët, unë nuk pranoj një turp të tillë për Kamboxhian. Vietnamezët, — vazhdoi ai, — thonë se arritën fitoren, unë mendoj se në Paris ata nënshkruan luftën e tretë të ardhshme në Indokinë. Sihanuku e tha edhe në fjalim se «do të luftojmë deri në çlirimin e plotë të Kamboxhias dhe fitorja jonë e plotë do të jetë disfata e plotë e Riçard Niksonit, turpi i plotë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës».

Kundër sovjetikëve Sihanuku është po aq i vendosur dhe për ta më fliste me urrejtje të madhe. «Do të veprojmë si ju, — më thosh, — jemi dakord në çdo gjë, asgjëkundi nuk e hap zemrën kështu si me ju». Fliste për Shqipërinë dhe për Partinë tonë me zjarr. Bëri një herë aluzion se «më këshillojnë të jem i matur, të jem pak më i arsyeshëm me gjendjen e krijuar etj. Unë u them jam realist, se mbroj atdheun dhe popullin tim, okupatorët të shporren, populli im nuk ka pushtuar njeri». I lumtë Sihanukut! E inkurajova dhe e urova me gjithë zemër për burrërinë dhe qartësinë politike të tij.

Nuk e dimë ekzaktësisht ç'pikëpamje kanë shokët komunistë të Kamboxhias për Sihanukun, por, sipas mendimit tonë, ata duhet të jenë realistë: Sihanuku, pavarësisht nga origjina dhe pozita e klasës së tij, pavarësisht nga qëndrimet në të kaluarën, pozitën e tij aktuale në kushtet e luftës nacionalçlirimtare janë shumë të mira, pozitive dhe të vendosura. Për këto qëndrime, që janë në favor të luftës çlirimtare, shokët komunistë kamboxhianë duhet ta mbajnë më afër dhe të tregojnë se kanë besim. Ata duhet të mendojnë për sot dhe për nesër, pse me

Dukej qartë se shokët e Kamboxhias nuk janë të kënaqur nga verivietnamezët. Këtë pakënaqësi Sihanuku e shfaqti hapur në bisedimet që bëri me ne.

E ENJTE
7 QERSHOR 1973

DISA QËNDRIME TË KOMUNISTËVE KAMBOXHIANË JANË PA KUPTIM

Shokët Hysni Kapo dhe Ramiz Alia më raportuan për bisedën që patën sot me Jeng Sarin. Çdo gjë shkoi mirë. Ai na solli akordin e plotë të mendimeve të udhëheqjes së partisë së tij me tonën. Foli po ashtu mirë për princin dhe falënderoi për ndikimin e madh që ushtrojmë ne tek ai. Vetëm ne nuk kuptojmë përse Partia Komuniste e Kamboxhias nuk demaskon revizionistët sovjetikë, kurse princi nuk lë gjë pa thënë kundër tyre? Nuk kuptojmë pse nuk bisedojnë me princin për ekzistencën e Partisë Komuniste të Kamboxhias, gjë që ai me siguri e di. Nuk kuptojmë po ashtu, që duke pranuar princin si kryetar të shtetit dhe udhëheqës të rezistencës, përse ky të mos njohë të paktën personalisht udhëheqësin kryesor të Partisë Komuniste të Kamboxhias. Kjo nuk është politikë e zgjuar dhe as e drejtë dhe e sinqertë ndaj princit, me të cilin bashkëpunohet dhe bashkëluftohet. Situata të tilla medoemos do të krijojnë artrite dhe mosmarrëveshje serioze nesër, por mundet edhe tash dhe këto duhet të mënjanohen.

BISEDË ME SIHANUKUN

Mbrëmë Sihanuku dha darkë zyrtare, e cila kaloi shumë ngrohtë. Pata bisedime të mëtejshme me të për forcimin e besimit të tij në fitoren e popullit në luftë dhe në luftën për kalitjen e unitetit me komunistët kamboxhianë dhe me patriotët, pse vetëm atje qëndron fitorja. Besoj se ai do të largohet i kënaqur nga ne. Sot shkon në Jugosllavi, do të kthehet përsëri te ne dhe pastaj do të shkojë në Rumani e prej andej në Kinë.

Në bisedat që bëra mbrëmë në darkë me Sihanukun përfitova nga rastet që më dha ai, për t'i folur hapur në drejtim të forcimit të pozitave të tij politike dhe të bashkëpunimit në front me komunistët kamboxhianë.

Sihanuku në bisedë tha: «Më cilësojnë «Princi i kuq», kurse unë nuk e kam të kuqe taserën, po e kam rozë».

I thashë, sidoqoftë ju jeni një princ i tillë që historia moderne nuk ka njohur. Revolucioni Francez njohu një princ mbretëror Filip «égalité» që «u nda» nga monarkia, por ai nuk shkoi larg, nuk u bë kurrë mik i Dantonit, i Maratit, i Robespierit dhe i Babëfit. Kurse Sihanuku e la atë shumë, shumë larg, u lidh ngushtë me popullin dhe me komunistët kamboxhianë dhe së bashku luftojnë të njëjtët armiq të tyre.

Sihanuku më vonë tha: «Borgjezia kamboxhiane më urren dhe më lufton».

I thashë: «Gëzohu për këtë, pse të duan populli dhe komunistët. S'ka fitore më të madhe se kjo. Karl Marksi na mëson ne, komunistët, të duam dhe të respektojmë të gjithë ata që shkëputen nga klasa e tyre dhe bashkohen me kauzën e madhe të popullit, të punëtorëve e të fshatarëve».

Sihanuku m'u përgjigj se komunistët e Kamboxhias e duan.

I thashë: «Të jesh më se i sigurt për këtë. E pashë vetë në filmin që na tregove. Ju përqafoheshit me ta si vëllezër, si shokë lufte të vërtetë që jeni. Ruajeni dhe thellojeni këtë unitet, këtë dashuri, se këtu qëndron fitorja dhe e ardhmja e lumtur e popullit».

Sihanuku më tha: «Jam plotësisht dakord me ju, Shqipëria është shembull». I thashë: «Jemi dy shembuj, Shqipëria dhe Kamboxhia, jemi në unitet mendimi dhe veprimi, jemi në luftë kundër të njëjtëve armiq të egër. Do të qëndrojmë kështu vazhdimisht në kohë të këqija dhe të mira».

Sihanuku i aprovoi nxehtësisht fjalët e mia.

TAKIM ME DELEGACIONIN E FRONTIT PATRIOTIK TË LAOSIT

Prita sot delegacionin e Frontit Patriotik të Laosit¹.
Më vunë në dijeni për situatën në Laos dhe unë u
fola² për eksperiencën tonë, duke bërë natyrisht aluzion
për situatat e tyre qoftë të brendshme, qoftë të jashtme.

1 Delegacioni kryesohej nga anëtari i përhershëm i KQ të
Frontit Patriotik, Nuhak Fumsavan.

2 Shih: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Për-
mbledhje veprash) 1971-1975», f. 297.

SHËNIM

Sot kthehet Sihanuku nga Jugosllavia. Ai vjen për
vizitë private për 4 ditë, do të pushojë dhe pastaj do të
vejë në Rumani për vizitë zyrtare dhe që andej do të
kthehet në Kinë.

KRYEMINISTRI I MALTËS KËRKON TË VIJË NË SHQIPËRI

Don Mintofi, Kryeministri i Maltës, na propozon ose të vijë ai më parë për vizitë zyrtare në Shqipëri, ose të vejë Kryeministri ynë në Maltë.

Ne do t'ia refuzojmë propozimin, natyrisht me lezet, as të vijë, as t'i vemi, asgjë nuk na lidh me të. Nga na doli ky myteber? Sigurisht i vënë që «të hapë rrugën» dhe të fillojë propaganda perëndimore se ne gjoja filluam lidhjet me Perëndimin. «U ça akulli». S'e hamë ne atë gjellë!

IMPERIALIZMI AMERIKAN PRET ME NDERIME E CEREMONI TË MËDHA KREUN E SOCIALIMPERIALIZMIT SOVJETIK

Të demaskojmë vizitën e kreut të socialimperializmit sovjetik Brezhnjev, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë qëllim i dërguam sot gazetës «Zëri i popullit» artikullin me titull: «Sekretari i përgjithshëm i PK të Bashkimit Sovjetik bisedon me kreun e imperializmit amerikan»¹.

Po sot i dhashë Ramizit teza e mendime për disa artikuj të tjerë kundër kësaj vizite të Brezhnjevit në Uashington. Artikujt të shërbejnë për të demaskuar qëllimet dhe planet sovjeto-amerikane për dominimin e botës nga ana e tyre.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 310.

SIHANUKU LARGOHET NGA VENDI YNË SHUMË I KËNAQUR

Sot pasdreke në orën 7⁰⁰ do të zhvillohen bisedimet e fundit me Sihanukun dhe pas bisedimeve do t'i japim një darkë lamtumire. Ai largohet nesër nga vendi ynë. Në bisedimin që bëmë me të, Sihanuku riafirmoi me forcë besimin në fitoren e popullit kamboxhian mbi imperia-lizmin amerikan dhe klikën e Lon Nolit. Ai demaskoi përsëri me forcë intrigat sovjeta-franko-amerikane për të krijuar një qeveri «me tri koka», të majtët, qendra dhe e djathta dhe shprehu solemnisht vendimin se «kurrë nuk do të pranojë një gjë të tillë», pse «kjo do të thotë të futesh nën sundimin e tre imperialistëve». Ai theksoi se «do të luftojë deri në fitoren e plotë tok me komunistët, të cilët janë patriotët më të flaktë dhe të vendosur». «Unë do të vdes një ditë, — më tha ai, — dhe kam vendosur që të vdes për popullin. Kjo është gjëja më e mirë që mund të bëj».

Sihanuku ishte ca i mërzhitur dhe nervoz pse pardje mori një lajm nga komanda e rezistencës brenda që i thoshte se verivietnamezët u kishin prerë furnizimin e armëve dhe të mjeteve të tjera të luftimit që u jep Kina. Ai nuk e pranonte dhe e gjente të padrejtë këtë vendim të vietnamezëve. Drejt mendonte dhe ne e aprovuam. «Ne nuk kërkojmë, — tha Sihanuku, — që Vietnamit të gjakoset për ne, por nën «shenjën» e mosshkeljes së marrë-

veshjes së Parisit, që po shkelet vazhdimisht nga ameri-kanët, të mos na jepen armët që na janë destinuar, kjo është e papranueshme. Ne këto armë nuk do t'i futim hapur, por ka shumë rrugë që askush nuk i merr vesh. Unë do ta shtroj çështjen me udhëheqjen vietnameze, pse një gjë e tillë është në dëmin tonë dhe të tyren», dhe vazhdoi se megjithëkëtë «ne do ta vazhdojmë luftën dhe armët do t'ia rrëmbejmë armikut».

Ne u treguam plotësisht solidarë me pikëpamjet e tij shumë të drejta, e inkurajua, i siguruam ndihmën tonë, edhe në drejtimin e bisedimeve me shokun Çu En Lai, që të ndikojë mbi verivietnamezët. Sihanuku largohet nga ne shumë i kënaqur.

TAKIM ME AMBASADORIN KINEZ

Takova sot ambasadorin kinez, të cilit i thashë që t'i komunikojë Çu En Lait rezultatet e bisedimeve që bëme ne me Sihanukun. Iu luta, gjithashtu, t'i komunikojë Çu En Lait mendimin tonë për veprimin e padrejtë të verivietnamezëve, që u kanë ndaluar kamboxhianëve furnizimin e armëve që u jep atyre Kina. Shoku Çu En Lai duhet të ndërhyjë pranë vietnamezëve, që të hiqet kjo embargo absurde.

NUK DO TË FUTEMI KURRË NË KOMBINACIONE TË RREZIKSHME

Hyri edhe Athina në kor për të na bindur ne «të japim një shpresë për pjesëmarrje më vonë në manovrimet e Sigurimit Evropian». Ministria e Jashtme e Greqisë kërkon nga ne aprovimin që përfaqësuesi i tyre në mbledhjet e Helsinkit të thotë se «ata i kuptojnë arsyet e mospjesëmarrjes së Shqipërisë, por shpresojnë që në të ardhmen ajo mund ta rishikojë vendimin» etj.

Lajmëruam ambasadorin tonë në Athinë t'u thotë grekëve se qëndrimi i Republikës Popullore të Shqipërisë është i njohur dhe nuk ndryshon as tash, as në të ardhmen dhe se nuk e gjejmë të nevojshme deklaratën e qeverisë greke.

Pse ngulin këmbë kështu të gjithë? Se jemi i vetmi vend dhe shtet që i demaskon këto manovra. A u prish ndonjë punë qëndrimi ynë forcave imperialisto-revizioniste? Shumë, për arsye se Shqipëria përfaqëson atë opinion botëror, që është kundër këtyre intrigave të të mëdhenjve. Prandaj këta duan ta shtypin këtë zë, duke u përpekur ta futin Shqipërinë në thes. Ne nuk futemi kurrë në këto kombinacione.

BANKIERI ROKFELER PRITET ME BANKETE NË KINË

Kinezët, me anën e një komunikate, lajmëruan opinionin botëror se shpërthyen një bombë atomike. Kjo është një gjë e mirë dhe vlen si përgjigje ndaj deklaratës sovjeto-amerikane për «luftën atomike». Por do të shohim më vonë ç'do të bëhet.

Flitet se Kisingeri do të vejë në Pekin në vjeshtë, Çu En Lai do të shkojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në vitin 1974 Niksoni do të vejë përsëri në Kinë. Ndërkohë nga Pekini, HSINHUA-ja njofton: Bankieri amerikan me famë Rokfeler ndodhet në Kinë; ai bisedon dhe pritet me bankete, kurse Çian Çini merret me notarët dhe me sportistët amerikanë, nëpërmjet të cilëve u dërgon të fala Niksonit dhe gruas së tij.

Ku po shkohet?!!

MARRËVESHJET E REJA SOVJETO-AMERIKANE — NJË SFIDË E RËNDË PËR TË GJITHË POPUJT

Gazetës «Zëri i popullit» i dërguam sot artikullin me titull: «Marrëveshjet e reja sovjeto-amerikane — një sfidë e rëndë për të gjithë popujt»¹. Ai bën pjesë në artikujt që do të botohen në shtypin tonë për demaskimin e udhëtimit të Brezhnjevit në SHBA.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 396.

SHËNIM

Ramizi priti ambasadorin e Kinës dhe i dha një ekzemplar të raportit që mbajta në Plenumin e 4-t të Komitetit Qendror, i cili nesër a pasnesër del edhe në shitje. Kështu Partia Komuniste e Kinës mbetet borxhleshë të na japë edhe ajo neve raportet që mbahen në plenumet e saj, në qoftë se mbahen.

POPUJT NUK DO T'IA FALIN KINËS KËTO QËNDRIME TË RREZIKSHME

Brezhnjevi vajti dhe u kthye nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bisedimet e tij me Niksonin ishin shumë të përzemërta dhe spektakulare. U kakaris gjithë bota: Kauboji sovjetik u takua deri edhe me «yjet e Hollivudit», me kaubojtë e Kalifornisë, u puth e u përqaftua me kaubojin artist që luan rolet e «banditit». Shumë kuptimplote! Po aq kuptimplote është edhe dalja e Brezhnjev-it në skenat e televizionit amerikan, veshur me një xhakëtë me shqiponjën amerikane, që ia fali Niksoni! Brezhnjevi ndërroi këmishë, ai ndërroi xhaketën sovjetike me atë amerikane. Një kuptim kanë: u shit tek imperia-lizmi amerikan. Miliarderët amerikanë, me të cilët Brezhnjevi bëri një bisedë të gjatë dhe të përzemërt, u kënaqën shumë dhe e cilësuan Brezhnjevin si «një amerikan të vërtetë» dhe «mbledhjen e drejtoi tamam si një ameri-kan». Ç'të përmendim shakatë e tjera groteske të tij, që bënë sensacion në gjithë botën dhe e ulën deri në llum prestigjin e Bashkimit Sovjetik.

Klouni ndoqi klounin: Hrushovi bëri «fejesën» dhe shkoi për «muajin e mjaltit» në Shtetet e Bashkuara, ndërsa Brezhnjevi shkoi atje, në Kemp Dejvid dhe në Kaliforni, për të bërë «martesën» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të konsumuar martesën në mes tij dhe Niksonit. Brezhnjevi i çoi

në pajë Niksonit pasuritë e Bashkimit Sovjetik, tokat, lirinë politike, sovranitetin, prestigjin e Bashkimit Sovjetik, për një grusht dollarësh.

Në tezat që dhashë për artikujt që dolën në «Zërin e popullit» për këto probleme, janë shprehur pikëpamjet tona, por sa më tepër të thellohesh dhe sa më shumë të shkruash për këto çështje, kurrë nuk është shumë. Këto janë probleme me rëndësi botërore, rreth të cilave thuren intriga të rrezikshme me karakter ndërkombëtar.

Është gabim i madh që marrëveshjet e arritura në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që tash njihen botërisht, të mos vlerësohen hapur, botërisht në shtyp, ashtu siç po bëjnë kinezët, që mjaftohen vetëm duke u shfaqur mendimin e tyre shokëve tanë në Pekin, — sigurisht edhe të tjerëve, — nëpër korridore. Asnjë qëndrim zyrtar dhe hapur nuk po mbajnë kinezët për takimin Brezhnjev-Nikson dhe për çka arritën dhe konkluduan ata. Vetëm shpërthimi i një bombe atomike nga Kina, sido që edhe kjo ka rëndësinë e vet, nuk është aspak e mjaftueshme. Por kinezët mendojnë se kjo është e mjaftë për të shpjeguar çdo gjë dhe për të shkatërruar planet djallëzore sovjeto-amerikane.

Heshtja kineze është jonormale dhe shumë domethënëse. Kjo tregon se Kina nuk do që të flasë. Pse? Sepse po të flasë, duhet medoemos të demaskojë të dy «banditët», siç po shprehen shokët kinezë në korridore. Që të mos demaskojë njërin, me të cilin është në «muajin e mjaltit», nuk demaskon edhe tjetrin dhe merr poza olimpike, duke dashur të thotë: «Unë s'flas, por mendoj dhe punoj në heshtje». «Metodë e shkëlqyeshme!», por që nuk ta ha kush, nuk ta pëlqen, nuk ta aprovon dhe nuk ta beson njeri. Në kokë mund të kesh shumë gjëra të mira, ose lakra, por njerëzit janë mësuar të shikojnë punën dhe jo gunën.

Ti, Kinë, je vend i madh, por fjalën tënde nuk po e

thua as në momentet kruciale, kur të gjitha vendet, të gjithë popujt janë shumë të shqetësuar nga komploti i madh ndërkombëtar që kurdisin të dy fuqitë imperialiste, Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të thuash se Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës «nuk konkluduan gjë në mes tyre» kjo do të thotë ose nuk sheh, dhe kjo është një miopi e madhe politike, ose ke kuptuar, hesht dhe nuk flet sepse ke qëllime.

Të dy banditët e mëdhenj imperialistë u morën vesh «urbi et orbi» për probleme të rëndësishme në mes tyre dhe për probleme ndërkombëtare. Këto marrëveshje u nënshkruan dhe u deklaruan haptazi, por ka edhe marrëveshje sekrete, që nuk u deklaruan, që nuk thuhën, por që mund të nxirren si konkluzion i atyre që janë shkruar për të fshehur diçka. Asgjë nuk mund të mbahet sekret nga ana e të dyve, jo sepse ata do të dalin t'i thonë me zë të lartë në radiotelevizion, por bota do t'i njohë ato kur ata t'i vënë në veprim, sepse ato vendime sekrete janë marrë për të vepruar në kurriz të popujve të tjerë. «Ka kontradikta në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës», thonë kinezët. Sigurisht, ka dhe do të ketë, por këto marrëveshje, që u arritën në mes tyre, kanë për qëllim t'i zbutin kontradiktat. Lidhur me këto marrëveshje sharra do të ngecë një mëngjes në gozhdë, prandaj duhen ngulur gozhdët, që sharra të hasë në to.

Është fakt se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën më të fituara në këtë lodër. Ato siguruan tregje koloniale të reja, të mëdha, dhe atë ku nuk ua priste mendja kurrë, në Bashkimin Sovjetik. Me Bashkimin Sovjetik Shtetet e Bashkuara të Amerikës dikur ishin në pozita armiqësore, gati lufte, sepse Bashkimi Sovjetik ishte një vend socialist, armik i betuar i kapitalizmit dhe i imperializmit. Kurse, me ardhjen në fuqi të revizionistëve sovjetikë, situata ndryshoi dhe çdo gjë do të vinte, pa

dyshim, këtu ku ka ardhur. Shteti i madh e i fuqishëm i proletarëve u shndërrua në një shtet kapitalist, në një shtet socialimperialist, i gatshëm për t'u marrë vesh me një shtet tjetër imperialist. Marrëveshjet, — s'kishte asnjë dyshim, — do të bëheshin në baza jo të barabarta. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin superiore ndaj Bashkimit Sovjetik në ekonomi, në teknikë, në industri, në bujqësi, por edhe nga ana ushtarake. Revizionistët e lanë vendin e tyre prapa. Në kthesën e tij drejt kapitalizmit, Bashkimi Sovjetik pësoi disfata të shumëllojta dhe kjo e bëri të ulë kokën, të ulë flamurin dhe të kërkojë ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të rregulluar shtëpinë, se mund t'i rrezohej.

Pikërisht Brezhnjevi, pavarësisht se ishte përfaqësues i një vendi të madh, vajti në Uashington dhe lypi e lypi në një mënyrë të atillë të ndyrë, sa u përul dhe u dha llogari një për një senatorëve amerikanë për çifutët sovjetikë, për shtetasit e shtetit të tij: sa ka dërguar në Izrael, sa të tjerë janë për t'u nisur, sa ngelen e ç'do të bëhet me ta. Dhe përse u bë ky skandal i ndyrë përlulësie? Për të kërkuar dollarë dhe me këta dollarë, që kullojnë gjak, të blejë teknologji të përparuar amerikane e, në të njëjtën kohë, të gjejë treg për të shitur pasuritë e popullit sovjetik te miliarderët amerikanë. Kjo çështje është e qartë dhe s'do koment. «Të mençurit» do të thonë: «Kjo është një taktikë e Bashkimit Sovjetik për t'i arritur Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Se mos imperializmi amerikan ka dalë në treg që të japë haraç forcën e vet për të dobësuar veten dhe për të fuqizuar kundërshtarët! Ose «politikanët e zgjuar e të heshtur» bëjnë sikur i kuptojnë të gjitha dhe s'mungojnë të thonë hapur e publikisht: «Revizionistët sovjetikë janë më të rrezikshëm nga imperialistët amerikanë».

Përse u dashka të diskutohet se kush është më i rrezikshëm, kur të dy janë armiq po aq të egër të popujve

dhe të lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të tyre?! Ta shtrosh problemin, siç bëjnë këta politikanë të paparim dhe të falimentuar, do të thotë të rreshtohesh në anën e «më të dobët» dhe më i dobëti për ta janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këto do ta shfrytëzojnë Bashkimin Sovjetik, do të nxjerrin nga ai fitime përrallore që do t'u shërbejnë për të fuqizuar perandorinë e tyre botërore. Nga ana tjetër, futja e kapitaleve amerikane në Bashkimin Sovjetik do të bëjë që të zhduken sa më parë edhe mbeturinat më të vogla të fitoreve të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, do të bëjë që të shkatërrohet Bashkimi Sovjetik si bashkim republikash. Ky është qëllimi i imperializmit amerikan: të shpartallojë Bashkimin Sovjetik si fuqi kapitaliste e rrezikshme rivale.

«Të mençurit» do të thonë: «Kjo zor të arrihet». Përkundrazi, kjo është e lehtë të arrihet kur largohesh nga binarët e marksizëm-leninizmit. Revizionizmi përmban në vetvete fryrjen e ndjenjave nacionaliste, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i fryjnë këtij zjarri me të madhe. «Të mençurit» thonë: «Gjë që nuk arrihet». Po faktet ç'thonë? Erdhi Hrushovi në fuqi, po ç'solli me vete dhe ç'u bë në Bashkimin Sovjetik? Ra Hrushovi, erdhën Brezhnjevet, po ku shkuan punët me Bashkimin Sovjetik? Në shitjen e këtij të Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nesër ata që do të vijnë pas këtyre, do ta shpartallojnë edhe si shtet Bashkimin Sovjetik. Duan apo nuk duan revizionistët, rruga e tyre atje të çon, ndihma dhe aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës synojnë këto rezultate: «përca dhe sundo», sepse është absurde të mendosh se mund të të ndihmojë imperializmi që të forcosh e t'i bësh varrin.

Marrëveshjet që u nënshkruan në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, siguruan zhvillimin e këtij procesi, por si njëri, edhe tjetri, ruajnë rezervat e qëllimet që ka secili prej tyre, që as mund t'ia

pohojnë njëri-tjetrit, por në të njëjtën kohë i dinë si njëri, ashtu edhe tjetri, dhe e kuptojnë shoqi-shoqin. Që të zhvillohet ky proces, duhej të nënshkruanin një marrëveshje «të bujshme», «ndalimin e luftës në mes tyre». Këtë marrëveshje, aq sa do të jetë efikase, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik e zgjeruan në formulimin e saj. Ata u bënë xhandarët e botës, thanë dhe vendosën hapur se do të ndërhyjnë kudo kur të cenohen interesat e tyre, kudo dhe kurdoherë që «do të rrezikohet paqja», sipas terminologjisë që ata përdorin.

Zhvillimi i këtij procesi, të kurdisur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, tregon se ky është një proces imperialist i zakonshëm, klasik. Rrjedhimet e këtij procesi nuk kufizohen vetëm në mes dy vendeve, por ato do të ndihen në gjithë botën. Të dyja këto superfuqi duan të dominojnë botën, duan ta shfrytëzojnë atë, duan që ajo të jetë nën këmbët e tyre, nën kërbacin e zotërinjve të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Prandaj ata i kanë ndarë zonat e tyre të influencës. Këto zona edhe janë përcaktuar, edhe nuk janë përcaktuar. Ka për këto gjëra aleanca të shkruara, por ka edhe të pashkruara. Si në të shkruarat, ashtu edhe në të pashkruarat do të përplasen interesat e këtyre dy zotërinjve. Këtu qëndron ujdia e tyre sekrete, që këto përplasje të mos bëhen me buçitje, por ata të merren vesh dhe të ujdisen në mes tyre, dhe sidomos nga të dy të mos lejohet që popujt, në kurrizin e të cilëve po bëhen këto allishverishe, të ngrenë krye. Në këtë rast ata kanë përcaktuar dy rrugë: rruga e parë, të merren vesh të dy banditët mbi grabitjen; rruga e dytë, në rast se i grabituri ngre krye, ata ta godasin dhe t'i thonë: «Sus!», «se po rrezikon paqen!», paqen e banditëve, kuptohet.

Këtu nuk bëhet fjalë për «çarmatim», po për ruajtjen e armatimeve, për ruajtjen e monopolit atomik. Në

këtë mes bëhet fjalë për orvatjet e futjes së të gjithëve në të dyja sferat e veçanta, kuptohet, në ombrellat atomike të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kina dhe Franca, që e kanë bombën atomike, konsiderohen heretike, prandaj edhe njëherë, edhe tjetër, nga njëri ose nga tjetri, u është vënë syri t'i gjuhëzojnë, t'i «futin në klub» për t'ua përdredhur kokën si të pulës.

Paktet dhe të gjitha llojet e marrëveshjeve që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kanë me partnerët e tyre, nën dritën e aleancës sovjeto-amerikane, kanë marrë një kuptim tjetër, një rrugë tjetër. Çdo gjë tash, nga të dy të mëdhenjtë, shihet nën prizmin thjesht të aleancës që nënshkruan, dhe partnerët e aleancave të dyanshme ose të shumanshme nuk janë veçse pionët e kësaj loje shahu.

Çdo gjë do të ushqejë, në radhë të parë, synimet e kësaj aleance famëkeqe. Bashkëpunimi, ndihma reciproke, marrëveshjet tregtare dhe të tjera allishverishe do të ndërrojnë kuptim dhe drejtim. Derisa janë ndarë zonat e influencës, Bashkimi Sovjetik «ka siguruar», siç e mendon ai, sundimin mbi satelitët. Ai edhe para kësaj shtate i sillte rrotull këta me kërbac, u bënte një mijë *restriksione* dhe shantazhe ekonomike, kurse vidhat do të shtrëngohen paskëtaq aq shumë, sa t'i katandisë «aleatët» në qojle të vërtetë. Bashkimi Sovjetik, i cili po shet pasuritë edhe shpirtin tek imperializmi amerikan, nuk është në gjendje të mbajë detyrimet që ka ndaj satelitëve, prandaj do të përpiqet t'i ngordhë më mirë këta, t'i lidhë këmbë e duar pas qerres së tij, që t'i heqë më mirë osh e bran. Kjo është perspektiva e KNER-it, e integritit dhe mbi kokat e tyre Traktati i Varshavës. Frytet e perandorisë së re cariste do të përdoren, do të administrohen dhe do të ndahen me kritere të reja, të frymëzuara nga një ideologji «e re», armike e ideologjisë së Karl Marksit dhe Vladimir Iliç Leninit.

Kurse imperializmi amerikan e ka rrugën e tij të caktuar. Mbi partnerët e tij ai i ka hedhur kthetrat me kohë. Detyra e tij është t'ua ngulë ato edhe më fort në grykë, për t'i pasur të bindur e nën thundër.

Kriza e madhe botërore që ka shpërthyer, i ka zënë për fyti Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik tok me satelitët e tyre. Kjo krizë polli këtë aleancë që synon t'i nxjerrë ata nga situatat e vështira, domethënë nga dara e revolucionit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kanë vendosur së bashku të shtypin revolucionin, kryengritjet, luftërat nacionalçlirimtare, të bashkojnë në qëllimet e tyre dhe të shtypin, po ta dojë rasti dhe nevoja, edhe partnerët e tyre kapitalisto-revizionistë. Për këtë arsye marrëveshjet e Uashingtonit dhe të Kalifornisë kanë ngjallur zemërim, indinjatë, dyshime dhe rezistencë në të gjithë popujt, në të gjitha shtetet e botës, pavarësisht ç'ngjyrë politike kanë. Kush hapur, kush me gjysmë goje, të gjithë thonë se «aleanca SHBA-BS është në dëmin tonë».

Në këtë lëmsh që është krijuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, pavarësisht se janë më të fortët, e ndiejnë veten të izoluar dhe të rrethuar anembanë nga një frymë e fortë zemërimi. Ata kanë planëzuar «ta sqarojnë» këtë situatë me demagogji, me kërcënime, me shantazhe. Ata e dinë se kjo aleancë s'mund të ketë jetë të gjatë, në rast se, secili dhe të dy bashkërisht, nuk vënë rregull në shtëpitë dhe në aleancat e tyre, domethënë të dekurajojnë e të frikësojnë kokëfortët dhe të favorizojnë partnerët e tyre të bindur. Rubla dhe dollari do të jenë në rendin e ditës për të korrptuar, kurse demagogjia, intrigat dhe armët për të mbajtur klikat në fuqi dhe për të sjellë të reja kur rrezikohet fuqia e tyre. «Statukuoja dhe paqja» do të jenë motoja e të dyve.

Me siguri dy superfuqive agresive nuk do t'u ecë

çdo gjë si në gjalpë. Kundër planeve dhe veprimeve të tyre djallëzore do të ketë reaksion dhe rezistencë. Kjo rezistencë po duket që tash në të gjithë botën. Shtetet evropiane, të gjitha shtetet kapitalisto-revizioniste, me përjashtim të vendit tonë socialist, janë të inkuadruara në blloqe. Edhe ato shtete si Jugosllavia, që hiqen si të paangazhuara, janë brenda në këto fole grerëzash. Pra të gjitha këto shtete e këto klika i kanë ngritur veshët, në valle janë, por brendapërbrenda ziejnë kundër dy superfuqive.

Në Helsinki e në Vjenë bëhen mbledhje, mbahen fjalime, por asnjeri nuk u zë besë fjalëve, të gjithë shohin me dyshim shoqi-shoqin, se e dinë që atje luhet mbi lëkurën e tyre, atje mbizotërojnë pikëpamjet dhe interesat e dy të mëdhenjve, të cilët duan «të qetësojnë» Evropën dhe ta qetësojnë sipas oreksit të tyre të mbizotërimit. Këtu ata hasin në kundërshtime pak a shumë të nuancuara.

Bile edhe Gjermania e Bonit, më e favorizuara në këto situata, hegjemoninë e saj në Evropë e shikon të kërcënuar nga dy të mëdhenjtë. Ajo mund të përfitonte më parë, atëherë kur nuk ishin uqdisur punët në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, kurse tash ka dy vjehrra xheloze dhe tinzare, që nusen e egër nuk do ta lënë të majmet si të dojë ajo. Të dy vjehrrat do të përpiqen kush e kush ta bëjë nusen me vete, por që të dyja duan ta kenë edhe kundër Francës së panështruar.

Franca e shikon më shumë rrezikun që e kërcënon nga të dy partnerët e mëdhenj, si edhe nga Boni që përfiton nga situatat. Qeveria franceze po e manifeston hap-tazi qëndrimin opozitar kundër aleancës sovjetiko-amerikane, si dhe kundër Kartës së re të Atlantikut, që i fut më thellë vendet perëndimore të Evropës nën zgjedhën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Franca borgjeze

përpiqet, dhe duket tendenca aktuale e politikës së saj, t'i kanalizojë pakënaqësinë dhe frikën që i ka ngjallur kjo aleancë dhe të konkretizojë brenda aleancave një opozitë kundër planeve amerikano-sovjetike në Evropë, por edhe në botë.

Evropa kapitaliste, sikur edhe vetë Franca, është e zhytur në borxhe të Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë hyrë thellë në ekonominë e saj dhe mbajnë atje forca të armatosura. Vendet kapitaliste të Evropës janë të pakënaqura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por pa to nuk rrojnë dot, pa ndihmën dhe ushtrinë amerikane nuk bëjnë dot. Mund të bëjnë llafe e muhabetë kundër tyre, por prapë luten: «Aman, Amerikë, mos u largo, mos na lërë vetëm përballë rusit!». Rusin, natyrisht, e kanë frikë, por kanë frikë sidomos nga revolucionin, nga kryengritja e popujve të tyre. Prandaj edhe tendencat e revoltës së politikës borgjeze të Francës vërtiten në këtë rreth vicioz. Synimet e mëdha të të dy kryebanditëve janë «të rregullojnë» Evropën dhe t'i kenë duart të lira që të manovrojnë jashtë saj, se ata e dinë që një mungesë qetësie në Evropë ndikon dhe nxit trazira në kontinente të tjera. Roli i Evropës nuk është zhdukur në botë.

Azia, Afrika, Amerika e Jugut dhe Lindja e Mesme janë akoma më shumë të zemëruara dhe të shqetësuara nga kjo gjendje që është krijuar. Është e qartë se në Lindjen e Mesme të dyja superfuqitë imperialiste bëjnë ligjin, kanë caktuar zonat e tyre të influencës dhe merren vesh për çdo gjë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështetin dhe armatosin Izraelin dhe e kanë kthyer këtë në një koburë të tyre kundër Egjiptit, Sirisë, popullit palestinez dhe në përgjithësi kundër popujve arabë. Bashkimi Sovjetik në këto vende që përmendëm, është bërë një furnitor armësh, që nuk lejon në asnjë mënyrë të përdoren dhe u imponon këtyre popujve gjendjen «as

luftë, as paqe», ndërsa në të njëjtën kohë po forcon pozitën e tij dominuese prej pseudoaleati të padëshiruar. Natyrisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këto vende nuk kanë vetëm Izraelin, ato dominojnë edhe në Liban, në Jordani, në Arabinë Saudite, në principatat e Gjirit Persik dhe në vetë Iranin. Këtu është perandoria e tyre e vajgurit. Sovjetikët afrohen me Irakun për ta shfrytëzuar dhe, në ujdi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po nxitin kontradiktat në mes këtij vendi dhe Iranit për t'i pasur mirë në zap që të dy këta, secili nga ana e tij.

Lindja e Largme është më e koklavitur për ta, por edhe atje synojnë të vendosen mirë që të dy, njëri duke kërcënuar, tjetri duke buzëqeshur. Qëllimi i strategjisë së tyre janë Kina dhe Japonia. Dihet lidhjet e Japonisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bashkimi Sovjetik e fton atë të marrë pjesë në «tortën» siberiane. Me siguri Japonia do të marrë pjesë. Qëllimi i sovjetikëve është ta neutralizojnë Japoninë dhe të mos e lënë të afrohet me Kinën, që ta rrethojnë këtë të fundit. Japonia e ka pasur dhe e ka parasysh vazhdimisht këtë perspektivë, por ka dhe rezervat e veta, sepse, e futur në mes të dy ujqve më të mëdhenj, ka frikë se ata mund ta hanë. Prandaj Japonia i ka sytë edhe nga Kina, kështu që te kjo shikojnë të tre.

Bashkimi Sovjetik e kërcënon Kinën, i bën presion që, ose të afrohet me të, ose ta shtyjë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat i buzëqeshin. Dhe për mendimin tonë, Kina adoptoi një strategji të gabuar, në mos më tepër: braktisi në fakt luftën në dy fronte, edhe kundër sovjetikëve, edhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe adoptoi luftën tjetër: armiqësi me sovjetikët dhe miqësi me amerikanët.

Përse e adoptoi Kina këtë politikë? «Që të shfrytëzojë kontradiktat sovjeto-amerikane», — thotë. Po cilat

janë këto kontradikta dhe si i shfrytëzon Kina ato? Zëri i Kinës as nuk është dëgjuar dhe as që dëgjohej në Evropë. Kina, në fakt, edhe botërisht e kishte neglizhuar Evropën. Tash ka filluar të interesohet, po Evropa është e komplikuar, bizantine, makiavelike, ajo nuk i ha kollaj «kinezëritë». Në Lindjen e Mesme ajo qëndron jashtë. Në të gjitha vendet e tjera të botës pesha e Kinës është vetëm një peshë në potencë, por jo reale. Të dyja superfuqitë manovrojnë kudo. Popujt duan t'i shpëtojnë kësaj dare, duan ndihmën e Kinës, ndihmën morale, politike, ekonomike dhe ushtarake të saj, por Kina nuk është në gjendje t'ua japë si duhet dhe sa duhet, sepse pozitat e saj në arenën ndërkombëtare nuk janë të drejta, ato janë të gabuara.

Në këtë krizë të madhe dhe në këtë ujdi midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, në vend që Kina të zërë pozitat për t'i përçarë që të dy, duke luftuar edhe njërin edhe tjetrin, dhe, në këto situata frike dhe zemërimi kundër sovjetikëve dhe amerikanëve, të polarizojë rreth vetes të pakënaqurit, ajo e ka hapur politikën e saj drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Llogaritë e Kinës janë aq të gabuara. Me këtë politikë ajo nuk mund të fitojë besimin e popujve, ajo kështu nuk shton kontradiktat në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, por ndihmon e forcon Shtetet e Bashkuara, këtë imperializëm të egër dhe të fuqishëm.

Kina ndjek një politikë të tillë të gabuar, sepse ka frikë nga ndonjë sulm sovjetik! Mos vallë Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta mbrojnë? Duhet të jesh budalla ose reaksionar që të mendosh një gjë të tillë. Po atëherë? Ke nevojë për ndihmë e për kredi? Po dhe sovjetikët këtë punë po bëjnë. Atëherë do të ndjekësh rrugën e sovjetikëve, duke qenë në luftë me ta. Kjo nuk është një politikë me frymëzim marksist-leninist. Një politikë

të tillë kanë bërë edhe shtetet kapitaliste perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore. Ato u mbështetën te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që i financuan dhe i gllabëruan. Frika nga Bashkimi Sovjetik, në atë kohë kur rronte dhe drejtonte Stalini i madh, i bëri shtetet kapitaliste të botës të lidhen pas qerres amerikane. Tash këto shtete dhe këto vende e ndiejnë peshën e rëndë dhe zinxhirët që u kanë hedhur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe duan t'i këputin këta.

Këtë eksperiencë kërkon të provojë edhe Kina, së cilës i përshtatet shumë një shprehje e popullit tonë: «Për inat të sime vjehre, do të vete të fle me mullixhinë». Pra, Kina, duke pasur frikë nga revizionistët sovjetikë, kërkon të vejë të puqet me amerikanët. A duhet ta bëjë ajo një gjë të tillë? Kjo jo vetëm që nuk është marksiste-leniniste, por është një gabim fatal. Kina duhet t'u qëndrojë kundër deri në fund të dyja superfuqive dhe të grumbullojë rreth vetes popuj e kombe të pakënaqura, të cilat s'janë pak, por janë një forcë kolosale. Forca e popujve të ngritur në revolucion dhe në luftë kundër dy superfuqive është e pathyeshme. Pikërisht këto kontradikta duhet të shfrytëzohen më parë Kina dhe jo të shkojnë në gjueti për kontradikta hipotetike, jo të shkojnë në ato gjurmë që e çojnë në skllavëri politike, por të ecë në rrugë revolucionare, të vështira, por revolucionare.

Të mos shkojmë më tej, por të marrim çështjen e Francës. Franca goliste dhe ajo e Pompidusë i ka pasur e i ka të ftohta marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tash në këto situata, ajo i ka frikë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Bashkimin Sovjetik, edhe Bonin, të cilit i buzëqeshin të dy të mëdhenjtë. Franca e ndien veten në rrezik dhe kërkon t'i rezistojë këtij presioni të madh. Duket qartë se ajo përpiqet t'u vërë gurë në rrota planeve evropiane të të dyja superfuqive hegjemoniste. Ajo orvatet të krijojë një grupim

rezistence me shtetet e tjera evropiane, por zor se ia arrin. Franca kërkon mbështetje edhe jashtë Evropës. I ka hedhur sytë nga Kina. Ne e dimë se Çi Pen Fei, që u takua me Pompidunë, i tha këtij: «Ruajuni dhe jini vigjilentë ndaj Bashkimit Sovjetik!». Duhej të priste Çi Pen Fein kapitalizmi francez që t'i thoshte të ishte vigjilent ndaj Bashkimit Sovjetik!

Francës i intereson miqësia me Kinën, sigurisht për ta drejtuar këtë kundër Bashkimit Sovjetik. Këtu puqen qëllimet e saj me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës; njëkohësisht kjo lehtëson presionin e Bashkimit Sovjetik mbi të. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës Franca ka mosmarrëveshje, por nuk do që t'i këputë fare lidhjet me to, se i do si xhandar kundër revanshizmit teuton dhe sulmit sovjetik. Kurse në Kinë Franca do që të hapet, do tregje për t'u shpëtuar krizës dhe presioneve ekonomike që i bëhen dhe që do t'i shtohen për ta gjunjëzuar.

Ç'do të bëjë Kina? Do të shohim. Buzëqeshja me Francën do t'i shërbejë revolucionit, apo do të shërbejë për të nxjerrë nga pozitat e vështira një shtet kapitalist, që kërkon, gjithashtu hegjemoni në Evropë? Sigurisht Franca e llogarit edhe miqësinë e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por kjo nuk e shqetëson shumë. Ajo e llogarit dhe e pëlqen armiqësinë e Kinës ndaj Bashkimit Sovjetik. Me fjalë të tjera: Kina u nxjerr gështenjat nga zjarri.

Pozitat që ka zënë Kina, kursi që po ndjek ajo në politikën e jashtme, për ne nuk janë të drejta, nuk janë revolucionare. Ajo lë që të kalojnë momente shumë të favorshme për revolucionin, momente të një krize të madhe e të rëndë për imperializmin amerikan dhe për socialimperializmin sovjetik.

Popujt dhe marksistë-leninistët nuk do t'ia falin Kinës këto qëndrime shumë të rrezikshme, shumë negative dhe dëmprurëse,

DURRËS, E PREMTE

13 KORRIK 1973*

DELEGACION FORMAL

Në Durrës prita delegacionin e ushtrisë kineze¹, që kishte ardhur me rastin e 30-vjetorit të Ushtrisë sonë Popullore. Ai largohet nesër.

E pyeta kryetarin e delegacionit² si shkoi në shëtitjen që bëri në Shqipëri, sido që ishte e shkurtër dhe me avion, ç'përshtypje i bënë ushtria jonë dhe njerëzit e populli me të cilët mori kontakt. Natyrisht, nuk më tha gjë, disa formula shumë të njohura dhe të përdorura nga çdo kinez me të cilin jemi takuar. Është e zorshme të bisedosh me të tillë anëtarë delegacionesh, se nuk gjen asnjë jehonë, nuk merr asnjë përgjigje për çka i pyet. Të gjitha mendimet, biseda që përpiqesh të bësh, hasin në një mur të papërshkueshëm (në dukje), se nuk sheh asnjë reagim, asnjë përgjigje të arsyeshme, veçse formula stereotipe pa kripë.

Kështu e pësova edhe me këtë kryetar të delegacionit kinez. Fillova t'i flisja mbi çështje ekonomike për të dalë në probleme të tjera të ushtrisë dhe të politikës. Vura re se, kur flisja unë, kryetari i delegacionit shikonte tavanin, tablotë e muret. Atëherë përdora një taktikë

1 Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 408.

2 Shy Shian Çien, zëvendëskryetar i Komisionit Ushtarak pranë KQ të PKK.

tjetër për ta nxitur: në mes të bisedës ndalesha dhe i bëja pyetje se ç'mendonte ai, si e gjykonte Kina këtë ose atë problem. Disa herë i theksova se «ne jemi të gëzuar kur vijnë delegacione të rangut të lartë, sepse mund të shkëmbejmë mendime për probleme kapitale që na interesojnë të dyja palëve». Por Shy as që lëvizte nga *mytizmi* (heshtja) i tij.

Sidoqoftë, unë ia thashë mendimet e mia për shumë çështje dhe anëtarët e delegacionit kinez mbanin shënime. Të paktën ata që do t'i lexojnë ato shënime, po të duan, le të nxjerrin përfundimin se dërgimi i delegacioneve të tilla formale e pa personalitet (nga heshtja), s'ka asnjë vlerë. Deri edhe gjërat që do të shkruanin në librat e përshtypjeve të muzeve që do të vizitonin të ne, i kishin sjellë nga Pekini të numërtuara. Kjo nuk hahet!

Pasi mbarova unë, kryetari i delegacionit kinez filloi të thoshte formula. Tha se këtë verë do të bëjnë kongresin e partisë dhe kanë vendosur të mos thërresin përfaqësues nga partitë motra. Iu përgjigja që kjo ishte punë e tyre, por neve na vjen keq të mos marrim pjesë në kongresin e partisë së tyre, ku me siguri do të flasë edhe Maoja. Asnjë reagim. Pastaj ai foli për «fitoren e madhe» të popullit vietnamez etj. Në mes të bisedës i thashë se kjo nuk është një fitore e madhe, gjersa Thieu është në Sajgon dhe i fuqishëm etj. Asnjë përshtypje, asnjë reaksion, ose më mirë, me qëndrimin e tij donte të thoshte se «unë kam ardhur të them formulat tona dhe asgjë më tepër». Për Kamboxhian nuk tha asnjë fjalë, por foli unë.

Më në fund lëshoi «parullën varë», që, sipas tyre, «arsyeton» hapjen e tyre drejt SHBA-së, se Bashkimi Sovjetik është më i rrezikshëm e nuk njihet si i tillë nga të tjerët. I thashë se kjo nuk qëndron shumë në këmbë, se tash në botë e njohin të gjithë se ç'është Bashkimi Sovjetik. Me veprimet e tij ai është demaskuar dhe so-

vjetikët janë po aq të rrezikshëm sa edhe amerikanët. Me fjalë të tjera ai donte të na i nxirrte amerikanët më pak të rrezikshëm. Pasi i lëshoi këto formula, kinezi shikonte vazhdimisht orën që të largohej sa më parë, se kishte frikë mos zgjatej muhabeti, por unë e mbajta e me ngrohtësi bisedova «à bâtons rompus» (duke u hedhur nga një temë në tjetrën), derisa më në fund i dhashë lejë dhe e përcolla me fjalë të ngrohta, me gjithë qëndrimin e tij si mumje.

DURRËS, E DIEL

15 KORRIK 1973

TË VEGJLIT DUHET TË NDËRTOJNË NJË POLITIKË TË TYREN

Isha në klubin tonë me Mehmet Shehun dhe me Spiro Kolekën. Duke biseduar për zhvillimin e ngjarjeve në botë, Mehmeti shprehu mendimin «sikur të merrnim kontakte zyrtare për bisedime politike, për të shfaqur pikëpamjet tona, në fillim me Francën, pastaj me Zvicrën e më ndonjë vend skandinav»¹ etj. Kjo të bëhet duke dërguar ministrin tonë të Punëve të Jashtme dhe ata reciprokisht të dërgojnë të tyret. Këtë moment ai e gjen të arsyeshëm për faktin se Franca aktualisht paraqitet e pakënaqur nga marrëveshjet Brezhnjev-Pompidu.

Unë nuk e mbështeta këtë propozim, pse ne nuk fitojmë gjë, vetëm humbasim në arenën ndërkombëtare dhe ua shpjegova përse.

¹ Duke iu referuar këtyre veprimeve të Mehmet Shehut, shoku Enver ka thënë: «Mehmet Shehut i kishin caktuar detyra padronët, që vendi ynë të hapej drejt Perëndimit ekonomikisht, politikisht e diplomatikisht dhe këto çështje ai i shtronte gjoja si rastësisht, bile edhe duke shëtitur në rrugë, i shtronte gjoja për diskutim, si të lidhura me gjendjen, me nevojat. Ne mbronim vijën, mbanim qëndrim të drejtë dhe ai tërhiqej, sipas taktikës së tij të njohur, për të mos u komprometuar. Ai lëvizte me kujdes gurët në drejtimet e tij, tatonte pulsën, po t'ia arrinte qëllimit mirë, përndryshe tërhiqej». (Plenumi i 7-të i KQ të Partisë, 20-21 shtator 1983.)

Është e vërtetë se në këto koniunktura Franca është e pakënaqur dhe bën përpjekje të çajë dhe ne duhet të ndihmojmë në thellimin e këtyre kontradiktave. Por lind pyetja: ne ndihmojmë më shumë duke qëndruar në pozitë tona aktuale ndaj Francës, domethënë duke demaskuar me propagandën tonë aleancën sovjetiko-amerikane dhe me bisedime nëpërmjet ambasadorëve reciprokë, me ministritë e jashtme të të dy vendeve, apo të shkojmë më tej? Unë mendoj se nuk duhet të shkojmë më tej. Ne duhet të vëzhgojmë zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, të shohim më tej a do të acarohen situatat në mes Francës dhe Bashkimit Sovjetik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në ç'drejtim dhe në ç'masë? Ne nuk jemi si Kina, po jemi një vend i vogël, që nuk luan rol në zhvillimin e politikës franceze, në qoftë se do të marrim kontakte zyrtare.

Influenca jonë në arenën ndërkombëtare është aq sa është, por ajo lidhet me qëndrimet tona revolucionare. Ne na mbajnë vesh kundërshtarët e kapitalizmit dhe të qeverive e klikave në shërbim të tij, ata na kuptojnë, na mbështetin, pse shprehim mendimet dhe ndjenjat e tyre dhe luftojmë për të drejtat e tyre. Diplomacia borgjeze ka hyrë në një llum të madh e të ndyrë. Ajo përpiket të na tërheqë edhe ne në këtë llum. Ne duhet të evitojmë këtë kontakt të qelbur. Të gjitha këto shtete kapitaliste, që nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, na bëjnë thirrje për kontakte dhe të tëra janë gati, po t'u japim shenjën më të vogël. Shtetet kapitaliste duan që ne ta ulim flamurin që po mbajmë lart. Është e vetmja arsye pse na «buzëqeshin» për të na futur në kurth dhe t'i thonë botës, nëpërmjet një propagande shurdhuese: «Ja, edhe Shqipëria u fut në vallen tonë», pavarësisht se ne nuk futemi në atë valle. Në këtë karusel politike, ku me mijëra e me mijëra politikanë shkëmbejnë vizita në mes tyre, thurin intriga e shesin te njëri-

-tjetri interesat e vendeve dhe të popujve të tyre etj., duan të na futin edhe ne. Ne kurrë nuk duhet të gabohemi, nuk duhet të shpejtohemi. Kjo nuk do të thotë se ne do të lidhim duart. Jo, ne edhe kontakte duhet të marrim, por duke zgjedhur momentet, që të kemi fitime ne dhe jo ata.

Por më parë se të mendojmë të marrim kontakte me Francën, ne duhet të marrim, gjithashtu, kontakte, nëpërmjet ministrit tonë të Jashtëm me kolegët e tij në Kinë, në Kore, në Vietnam, që të vemë dhe të vijmë. Ne duhet t'i ndezim kontaktet më parë këndeje sesa nga Perëndimi.

Me Perëndimin duhet të bëjmë më shumë kujdes. Pikërisht këto pozita tonat e bëjnë Perëndimin dhe Lindjen «të na respektojnë», natyrisht nga zori, po të na respektojnë! Me qëndrimet tona të drejta ne luftojmë lirisht dhe dorën kurrkujt s'ia nderim, por edhe rreth e rrotull nesh kanë gjetur karar nga qëndrimet tona. Në qoftë se ne veprojmë të nxituar, armiqtë do t'i fryjnë «kontaktet» tona, do të intrigojnë, do të na ngacmojnë.

Interesi ynë është të mos lëvizim nga pozitat që kemi zënë, qoftë edhe në anën formale. Ne nuk dimë akoma mirë ç'rrugë do të marrë Kina. Ajo lëkundet, ka hapur rrugën drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Të mëdhenjtë s'kanë konsiderata për të vegjlit, prandaj të vegjlit duhet të ndërtojnë një politikë të tyre dhe kjo jona mendoj se është e drejtë, mbasi bazohet kurdoherë në analiza marksiste-leniniste.

DURRËS, E MARTË

17 KORRIK 1973

PËRÇAPJET JUGOSLLAVE NUK JANË VEÇSE INTRIGA QË KANË PËR QËLLIM MASHTRIMIN

Kosovari Fadil Hoxha, njeri i besuar dhe besnik i Titos, u kujtua të piqet e të bisedojë me ambasadorin tonë në Beograd. Këtu nuk është çështje kujtese, por i është vënë detyrë të marrë kontakt dhe të na thotë çka e kanë porositur.

Në fakt, para disa javësh, ai u takua me ambasadorin tonë dhe i tha afërsisht këto: Jepu të fala shokëve në Tiranë nga unë dhe nga Titoja dhe u thuaj se Jugosllavia dëshiron sinqerisht të zhvillojë dhe të përmirësojë më tej marrëdhëniet me Shqipërinë. Tash marrëdhëniet «janë të mira», por ne dëshirojmë që këto të kalojnë në një stad më të avancuar. Ne ju sigurojmë se duke bërë këto propozime, na besoni, nuk kemi asnjë qëllim të keq. E kaluara nuk përsëritet më dhe duhet ta harrojmë. Ne dëshirojmë «sinqerisht» që të kemi kontakte me ju, të shkëmbejmë mendime për një sërë problemesh. Këto kontakte reciproke le t'i fillojmë nga zëvendësministrat e Jashtëm, pastaj nga ministrat, pastaj mund të vijë edhe Mehmet Shehu, të vijmë edhe nga ne personalitete në Shqipëri. Kështu, në këtë mënyrë, ngrohet situata, pse e kërkojnë kohët. Duhet të mendohet edhe për shqiptarët e Kosovës, nuk dihet se ç'do të ngjasë më vonë pas vdekjes së Titos, ose pas 20-50 vjetësh etj.

Këto ishin në vija të trasha propozimet e Fadil Ho-

xhës dhe, në fund «të grepit» «për të zënë peshkun», ky titist kishte vënë Kosovën.

Natyrisht, biseda e Fadil Hoxhës dhe mendimet që shfaqti ai, nuk janë të tijat, por të Titos dhe të udhëheqjes Jugosllave, pse Fadili edhe ndonjëherë që është takuar me ambasadorin tonë, këtë e ka bërë me druajtje dhe në prezencë të të tretëve, se mos komprometohej, kurse këtë herë, ai «hap dhe perspektivën e Kosovës», me të cilën indirekt do të na lërë të kuptojmë «se varavara në mos sot, nesër, Kosova do të vetëvendosë dhe e dimë si do të vendosë, prandaj duhet që tash ta përgatitim këtë vetëvendosje dhe rrugë tjetër s'ka, përveçse të përmirësojmë marrëdhëniet Jugosllavi-Shqipëri», që do të thotë, «t'i hapim portat nga të dyja anët, të bëhemi bythë e brekë dhe brenda 20 vjetëve shohim e bëjmë». Ky është «xhevahiri» i fundit që polli «koka gjeniale» e tradhtarit, e renegatit dhe e aventurierit ndërkombëtar Tito.

Mendon Titoja se ne i harrojmë qëllimet e tij djallëzore! Ai mendon se kjo kohë e gjatë, që nga lufta që i kemi hapur revizionizmit jugosllav, është e mjaftë dhe ka ardhur koha për ta zbutur këtë luftë. Mirëpo e gjithë kjo kohë ka vërtetuar drejtësinë e luftës sonë dhe ka demaskuar fytyrën e këtij aventurieri, që s'ka as besë, as fjalë, as parim, që shiti Jugosllavinë dhe është gati të shesë, siç po bën, edhe të gjithë ata që bien në kthetrat e tij. Por ne s'na fut dot në kthetrat e tij as tash që përpiqet «të na ndjellë me ëndrrën e Kosovës».

Çështja e Kosovës është më parë çështje e kosovarëve dhe Republika Popullore e Shqipërisë do ta ndihmojë zgjidhjen e drejtë të saj, vetëm duke qëndruar e fortë dhe në këto pozita, duke pasur kurdoherë këto pikëpamje të drejta kundër titizmit. Me popujt e Jugosllavisë ne jemi dhe do të jemi miq, por jo në rrugën titiste. Në këtë rrugë të fundit ne do të kemi këto marrëdhënie

që kemi sot dhe propozimet për t'i zhvilluar disi më tej janë titistët që i pengojnë, janë po këta titistë për të cilët Fadil Hoxha bën be e rrufe se duan «sinqerisht» t'i zhvillojnë marrëdhëniet me ne. Ka disa vjet që marrëveshja kulturore në mes të dy vendeve nuk po nënshkruhet, pse ata qitin pengesa; artistëve tanë që venë në Maqedoni, të ftuar në festivalet e tyre dhe ndërkombëtare, u nxjerrin një mijë e një pengesa e vështirësi, i kontrollojnë në kufi, u prishin dritat dhe mikrofonat në shfaqje etj., etj.

Po ku e kanë qëllimin jugosllavët, që i bëjnë këto avanca? Unë mendoj se kanë dy qëllime, një të jashtëm dhe një të brendshëm.

a) Qëllimi i jashtëm: orvatja e Titos bën pjesë në korin e përgjithshëm: «Shqipërinë ta thyejmë, ta futim në vallen infernale dhe ta mbytim e ta likuidojmë këtë zë dhe këtë çerdhe të rezistencës». Edhe aventurierët ndërkombëtarë i kanë ngarkuar të orvaten në këtë drejtim, megjithëse me ne u janë djegur letrat. Mirëpo Titoja mendon se «ne jemi të izoluar», ai ka dalë në konkluzionin, si të gjithë armiqtë e tjerë të vendit tonë, se «Kina politikisht dhe ideologjikisht po na lë», se duke mbajtur ne qëndrime antisovjetike, Jugosllavia është një «aleat i vetëm» yni kundër një rreziku nga Lindja. Titoja di me siguri edhe mendimin e vjetër të Çu En Lait, i cili dikur na predikoi «lidhjet me Jugosllavinë» për t'i bërë ballë sulmit eventual sovjetik. Titoja di, gjithashtu, qëndrimin tonë ndaj NATO-s dhe fqinjëve tanë dhe ka ardhur në konkluzionin se Jugosllavia është e vetmja mbështetje e Shqipërisë «në këto situata». Është e vërtetë, mendon Titoja, se «në mes shqiptarëve dhe jugosllavëve ekzistojnë mosmarrëveshje të mëdha, por këto mund të jenë zbutur, e para, nga masat që po marrim tash brenda, duke dhënë përshtypjen se po vijmë në «kohët heroike», duke ndrequr gabimet dhe shqiptarët

duhet të jenë sensibël, por edhe në mos u mbushet shumë mendja për këto masa, ne, ka menduar Titoja, «u lëshojmë çështjen e Kosovës si një hije, nga e cila mund të kapen»». Tito reaksionari mendon se prishja me ta nga ana jonë ka qenë vetëm çështja e Kosovës, kurse në të vërtetë nuk ka qenë vetëm ajo. Kosova hynte në të gjithë vijën antimarksiste jugosllave, në atë vijë që e çoi Jugosllavinë në këtë ditë.

Titoja mendon se duke u bërë shqiptarëve këto propozime me anën e shqiptarit kosovar Fadil Hoxhës, «ne u themi atyre të Tiranës: besonani, mos kini asnjë frikë nga ne, pastaj ju keni një «garanci» të madhe brenda në Jugosllavi: Kosovën. Nuk dihet ç'do të ngjasë pas 20 vjetëve. Me fjalë të tjera përgatiteni këtë «bashkim». Mendim «gjenial i Titos», po që ne nuk e hamë.

b) Qëllimi i brendshëm: për të qetësuar kosovarët, të cilët i kanë sytë te ne, e duan Shqipërinë, entuziazmohen nga sukseset tona, marrin shembull nga ne në shumë gjëra. Kosovarët e shohin çdo ditë ç'ndodh tek ata dhe ç'ndodh te ne dhe u krijojnë titistëve një mijë telashe. Këtë ata duan ta evitojnë dhe kanë menduar këtë variant, domethënë asgjë të mos bëjnë më shumë se ç'bëjnë sot dhe këtë e bëjnë nga zori në lidhje me marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri dhe nga ana tjetër t'u thonë kosovarëve se Shqipëria është mike e Beogradit, prandaj prijin shpresat nga Shqipëria: «Shqipëria u lidh me serbin».

Jo, ne s'e hamë këtë! Prandaj e kanë kot Titoja dhe Fadil Hoxha të na vënë në gjumë! Ne do të vazhdojmë rrugën tonë ndaj Jugosllavisë dhe, në rast se ndonjëherë do të dërgojmë ndonjë zëvendësministër, do ta dërgojmë kur të na leverdisë neve dhe jo atyre.

Titistët kalojnë edhe më tej me këtë manovër. Na vijjnë informata se në Beograd dhe në qarqet kosovare flitet se Mahmut Bakallin e transferojnë nga udhëheqja e Kosovës si ambasador në Pekin. Sa është e vërtetë kjo

nuk dihet, por në rast se bëhet ka një qëllim, dhe ky qëllim është kundër nesh. Titoja ka interesa të mëdhenj politikë dhe ekonomikë në Kinë, prandaj nuk ka mbetur Jugosllavia pa kuadro që të dërgojë në këtë vend të rëndësishëm një shqiptar, sado të besuar që ta ketë. Prapëseprapë ai shqiptar është. Mund të thuhet se ai do të jetë i rrethuar me serbë etj., dhe s'ka ç'bën. Kjo është evidente, dhe kështu do të jetë, në qoftë se do të dërgohet Bakalli si ambasador. Po atëherë pse dërgohet? Dërgohet që Titoja t'u japë të kuptojnë kinezëve se ai «ka besim të madh te shqiptarët» derisa i dërgon ambasadorë në Kinë, se Titoja do pajtimin me Republikën Popullore të Shqipërisë dhe me këtë i thotë asaj që të vazhdojë ndikimin ndaj nesh në këtë drejtim. Titoja do t'i tregojë Çu En Lait se ai është dakord me «çka ky u ka këshilluar shqiptarëve», por janë këta që nuk e dëgjojnë. Në këtë mënyrë Titoja do të përpiqet të futë pyka në mes nesh dhe Kinës.

Nga ana tjetër, Titoja mendon se meqë Bakalli është shqiptar, do të ketë më shumë kredi në Kinë, atij do t'i hapen dyert dhe zemrat dhe kështu Titoja do të mund të shumëfishojë informacionin, të zhvillojë intriga dhe spiunazhe dhe, kur të kapet me presh në dorë, kur të qelbet peshku, fajet bien mbi «shqiptarin» që është «i pabesë», «nacionalist», «agjent i sovjetikëve, agjent i shqiptarëve» e një mijë gjëra të tilla, për t'u lënë të kuptojnë kinezëve: «Ja, të tillë janë shqiptarët, ju dhe ne u japim besim dhe këta të tilla gjëra bëjnë». Por do të shohim, do të jetë vallë e vërtetë kjo fjalë që është hapur për Bakallin?

Dhe më në fund avanca e Fadil Hoxhës mund të ketë edhe një shpjegim tjetër. Titistët mësuan për drunë që u dhamë Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës. Ku dihet, ata mund të jenë të tyret, jo vetëm ideologjikisht që po e po, por edhe në rrjet agjenturor. Atëherë, në qoftë se është kështu, jugosllavët janë trembur prej një de-

maskimi të tmerrshëm nga ana jonë. Për t'i dalë përpara një eventualiteti të tillë, ata na nderën degën e ullirit, «dorën e miqësisë». Fadil Paçrami në kohën e Nakos e të Liri Belishovës mund të ketë rënë brenda me jugosllavët e më vonë me sovjetikët dhe tash ata vepronin në lidhje me ta kundër Partisë dhe shtetit tonë. Por këto lidhje koha do t'i vërtetojë.

DURRËS, E SHTUNË
21 KORRIK 1973

AMBASADORËT TANË DUHET TË JENË AKTIVË SIDOMOS ME KOLEGËT E TYRE KINEZË

Ministrin e Jashtëm e këshillova që ambasadorët tanë në vendet e ndryshme të jenë më aktivë jo vetëm me diplomatët e tjerë të vendeve të ndryshme, por sidomos me ambasadorët kinezë. Me këta të fundit ambasadorët tanë mbajnë marrëdhënie shumë të mira dhe miqësore, por deri diku qëndrojnë, si të thuash, pasivë në komentimin e ngjarjeve politike në dritën e politikës së Partisë sonë. Nga raportet që na bëjnë, po konstatoj se veçanërisht në shfaqjen hapur dhe gjerë të politikës sonë kundër imperializmit amerikan dhe politikës së tij agresive ata qëndrojnë pasivë, duke menduar se mos i lëndojnë kinezët në politikën e hapjes së tyre ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo është një e metë nga ana e tyre. Gjithashtu, pasivë qëndrojnë ata edhe ndaj politikës revizioniste jugosllave dhe rumune. Ambasadori kinez, kudo ku ndodhet, përpunohet qoftë nga jugosllavët, qoftë nga rumunët, kurse tanët as që marrin guximin si duhet t'ua sqarojnë çfarë fshihet prapa dokrrave të rumunëve dhe të jugosllavëve. Prapë edhe këtu ambasadorët tanë druhen, se mos lëndojnë preferencat e politikës kineze në drejtim të këtyre dy shteteve revizioniste. Kjo nuk është mirë. Ne duhet të bëjmë çmos dhe me çdo mënyrë që të ndikojmë te shokët kinezë me drejtësinë e pikëpamjeve tona për çështjet ndërkombëtare.

Këtë punë duhet ta bëjnë dhe të mësohen ta bëjnë mirë, me guxim, në mënyrë shoqërore dhe me diplomaci të gjithë ambasadorët tanë, por veçanërisht dhe sidomos ambasadori ynë në Pekin. Ai është një shok i mirë, po është vetëm receptiv. Ç'i thonë, kur i thonë dhe sa i thonë, i merr dhe na i çon. Kjo nuk është aspak e mjaftueshme. Ne dëshirojmë që ambasadori ynë në Kinë të jetë nga më aktivët, nga më të gjallët dhe më në kontakt dhe jo vetëm të mësojë, por edhe të shfaqë mendimin e Partisë sonë për të gjitha problemet. Ai dhe gjithë personeli i ambasadës sonë atje duhet të jenë një levë e rëndësishme e forcimit të lidhjeve miqësore midis dy vendeve tona.

DURRËS, E DIEL
29 KORRIK 1973*

PËRSE E SHTYNË KINEZËT THIRRJEN E KONGRESIT TË PARTISË?

Nga Pekini ambasadori ynë na bën të ditur se shokët kinezë, me mënyrat e tyre, siç e kanë zakon, nëpërmjet përkthyesve, na komunikojnë vendime të rëndësishme që merr udhëheqja.

Para 6-7 ditëve përkthyesi kinez i të dërguarit tonë të shtypit i thotë këtij të fundit se në «Zhenminzhibao» s'ka ndonjë gjë të rëndësishme për të përkthyer, pse «udhëheqësit nuk po bëjnë takime, pasi kanë shumë punë». Të ketë shumë punë dhe për këtë arsye të mos bëhen takime, nuk do të thotë se jeta ka ngecur në vend, por, siç duket, kinezi donte të thoshte se «udhëheqësit janë në mbledhje».

Dje përkthyesi kinez ia përsëriti prapë këtë këngë shokut tonë. Atëherë ky i tha: «Sigurisht udhëheqësit kanë shumë punë, sepse ata përgatiten për kongresin e partisë». Përkthyesi iu përgjigj: «Jo, kongresi nuk do të mbahet, se u shty për më vonë». Pra, siç po del nga kjo manovër të komunikuari, kongresi, që do të mbahej, nuk do të bëhet tash afër. Për kur u la dhe pse u shty, natyrisht, zor është të dihet. Por edhe pse u la për më vonë, as kjo nuk dihet me siguri; pse a mund t'i zihet besë thënies së një përkthyesi, sido që përkthyesit nuk thonë gjë tjetër veçse ato që i porositin?!

Në rast se kongresi u shty, cilat janë arsyet? Kjo çështje ka rëndësi. Nuk përjashtohet të jenë arsye teknike, por s'ma merr mendja të jenë këto. Në qoftë se shty-

het kongresi i partisë, kjo, sigurisht, ndodh për arsye politiko-ideologjike. Siç duket, udhëheqësit kinezë nuk janë marrë vesh për probleme të mëdha politiko-organizative dhe të tilla, sipas mendimit tonë, ka jo një, por shumë. Politika që ndjek Partia Komuniste e Kinës, për shumë probleme të mëdha, sipas nesh, qëndron varur dhe lëkundet sa andej-kënde, si lavjerrësi i sahatit. Të shohim, të presim.

Për sa u përket problemeve të brendshme, këto, natyrisht, janë shumë dhe ne nuk dimë tjetër, përveç atyre që ka lënë prapa për t'u zgjidhur **Revolucioni Kulturor dhe sidomos «çështja Lin Biao»**. Ky problem, siç e kam shprehur në shumë shënime të mëparshme, është i koklavitur dhe misterioz, po me të lidhen shumë probleme partie: problemi i riorganizimit të partisë dhe i organizatave të masave, zhvillimi i ekonomisë në rrugë të drejtë, që, sipas thënieve të kinezëve, e kishte sabotuar Lin Biaoja, si dhe çështja e kuadrit.

Çështja e kuadrit duhet të jetë një problem i koklavitur, se në këtë drejtim ndikojnë edhe botëkuptimet e tyre ideologjike, dhe sepse në gjithë atë rrëmujë vijnë vërdallë marksistë-leninistë, njerëz të Liu Shao Çisë, njerëz me pikëpamje të njëjta me Lin Biaon e më në fund mbështetës të vijës së Çu En Lait etj. Të gjithë këta reklamohen si të vijës së Mao Ce Dunit, ca janë «rindërgur», ca janë «rehabilituar» e disa të tjerë janë «duke u edukuar». Hajde merre vesh këtu se ç'po bëhet, dhe në një kohë që partia «ishte duke u riorganizuar».

Po kush e riorganizonte partinë? Mbi ç'parime e mbi ç'kritere bëhej ky riorganizim? Dhe ata që e organizonin, a ishin në lartësinë e kësaj detyre të madhe dhe a udhëhiqeshin në këtë punë nga një rigorozitet parimor marksist-leninist? Të gjitha këto probleme të brendshme nuk ka si të mos përplasen tash në punën për përgatitjen e kongresit të partisë. Këto probleme duhet

të gjejnë zgjidhje të drejtë, në rast se nuk është vendosur që çdo kongres të pjellë turbullira dhe paqartësi të tilla. Por mundet që udhëheqja kineze të ketë vendosur edhe kështu, pse Maoja, në letrën që i kishte shkruar Çian Çinit, duke bërë fjalë për grupin e Liu Shao Çisë, i thoshte asaj se do të spastrojnë këta, pastaj do të spastrojnë të tjerët, më vonë edhe të tjerët, e kështu me radhë. Natyrisht, varet si e kuptojnë spastrimin atje në Kinë dhe si bëhet spastrimi, kush spastrohet dhe kush mbetet, dhe, pasi ndodh ky proces, kush rifutet në parti nga «të spastruarit».

Për ne në politikën e jashtme të Kinës ka shumë probleme që janë të errëta dhe që, sigurisht, duhet të analizohen e të përcaktohen në raportin e kongresit të tyre të partisë. Por mundet që këto probleme, të cilat për ne janë të errëta dhe qëndrimet e shokëve kinezë ndaj tyre të gabuara, për shokët kinezë mund të jenë krejt të zgjidhura dhe bile «të zgjidhura drejt». Sipas nesh, marrëdhëniet kino-amerikane filluan në rrugë të gabuar dhe vazhdojnë të zhvillohen në rrugë të gabuar. Ç'po ngjet dhe ç'po bëhet me amerikanët? Ka dy vjet të tërë që asgjë nuk pipëtin. Kisingeri, misterioz, vete e vjen në Kinë, merr kontakt me Çu En Lain, bisedojnë vesh më vesh me njëri-tjetrin. Vajti dhe iku Niksoni, venë e vijnë në Kinë delegacione të shumta senatorësh amerikanë, bankierë, shkencëtarë, turistë, futbollistë, artistë e spiunë gjithfarësh. Ç'bëjnë të gjithë këta?! Ç'thonë?! Ç'del nga ky allishverish?! Asgjë nuk pipëtin! Për gjithçka dinë vetëm Çu En Lai dhe të afërmit e tij. Natyrisht, edhe Niksoni. Bota di vetëm që këta venë në Kinë. priten në bankete dhe ikin. Mister i madh, i ndyrë, i dyshimtë, i dënueshëm për kinezët. Të gjithë kanë të drejtë të pyesin: «Ç'po kurdiset prapa krahëve të njerëzimit?». Kur Brezhnjevi takohet me Niksonin, ata me siguri marrin edhe vendime të fshehta, por të paktën disa prej tyre

edhe botohen. Kinezët asgjë. E gjithë kjo politikë e misterit, ç'u solli kinezëve? Botërisht asgjë të mirë, veçse dëm të madh. Bota mendon: Çfarë është kjo Kinë?! Çfarë po bën?! Ç'vijë ndjek, ç'synime ka?!

Vallë do t'ia shpjegojnë shokët kinezë këtë vijë dhe këto rezultate kongresit të partisë së tyre? Ne mund që vrasim mendjen kot, në një kohë që kinezët e kanë shumë lehtë «ta zgjidhin» këtë çështje: ose t'ia bëjnë kongresit shesh me lule, ose nuk i thonë asgjë. Mund të duket e çuditshme një zgjidhje e tillë, por s'ka asgjë për t'u çuditur me shokët kinezë, sepse ata mund të thonë si për kongresin e tyre, ashtu edhe për botën: «Nuk është e domosdoshme të deklarojmë gjë sot, nesër do të shihni ç'do të shihni. Kini besim te ne, se ne s'gabojmë kurrë, nuk devijojmë kurrë, lërnani rehat të punojmë në fshehtësi, se nga errësira do të dalë diçka aq e ndritshme, sa do të verbojë botën!»

Para kongresit kinezët do të presin Kisingerin. Ky ka deklaruar se do të bisedojë me kinezët shumë gjëra (natyrisht misterioze), edhe për çështjen e Kamboxhias. Në këtë kohë kur amerikanë Kisinger deklaroi kështu, Sihanuku ngrihet dhe shkon në Kore, me siguri në shenjë proteste. Dhe ai bën shumë mirë. Nga njëra anë Kamboxhia bombardohet nga amerikanët, nga ana tjetër Kina bisedon në mënyrë të fshehtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Si do t'ia thonë kongresit këto? Si do t'ia shpjegojnë kongresit «paqen e madhe në Vietnam», kur thonë nga ana tjetër se Le Zuani është një revizionist, një aleat besnik i Bashkimit Sovjetik dhe bashkëpunëtor tash i fshehtë, nesër aleat i hapët i amerikanëve e i përrëndimorëve, që do t'i japin kredi?

Të gjitha këto, vallë, do t'ia thonë kongresit?! Mos janë bërë këto probleme e shumë të tjera si këto pengesë që u shty kongresi? Mundet po, mundet edhe jo! Le të presim, le të shohim!

DURRËS, E HËNË
30 KORRIK 1973

NJË SHPREHJE REALISTE E MIQËSORE PËR VENDIN TONË

Kryetari i Senatit të Turqisë, në një bisedim që ka pasur këto ditë me ambasadorin tonë në Ankara, i ka thënë: «Admiroj politikën e Republikës Popullore të Shqipërisë, pse ajo është e drejtë, e hapët, e guximshme dhe konsekuente. Demaskimi që ju u bëni të dyja superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, ka një rëndësi të madhe. Ai ka ndikuar shumë në politikën botërore dhe historia do të flasë për ju. Këtë jua them sinqerisht dhe jo për t'ju bërë qejfin».

Kjo ka rëndësi për ne, pse thuhet nga një udhëheqës i lartë i një shteti borgjez, që gjykon realisht dhe që natyrisht është në kundërshtim me rendin tonë socialist. Shprehje të tilla realiste na vijnë edhe nga shumë përfaqësues të tjerë të shteteve borgjeze, veçanërisht nga diplomatë francezë, të cilët haptazi manifestojnë kundërshtimin e tyre kundër marrëveshjeve të fundit midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik.

KINEZËT I KANË FTOHUR KONTAKTET POLITIKE ME NE. TË PËRPIQEMI TË ÇAJMË AKULLIN

Shokëve u shfaq mendimin se ka ardhur koha, mundet edhe nga marsi ose nga prilli i vitit të ardhshëm (këtë e shohim dhe e vendosim), që një delegacion yni të vejë për vizitë miqësore në Kinë. Në Kinë ndodhën gjithë këto ngjarje, «mbaroi Revolucioni Kulturor», «u likuidua Lin Biaoja», me politikën e saj Kina ua hapi dyert Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Që nga kjo kohë kinezët i kanë ftohur kontaktet politike me ne. Ata asgjë, as orvatjen më të vogël nuk bëjnë për të shkëmbyer me ne mendime për problemet e shumta dhe të rëndësishme ndërkombëtare, sido që nga ana jonë, që nga unë dhe deri te kuadro të tjerë, nuk kemi ndenjur pa ua shfaqur atyre mendimet tona. Kinezët rrinë të heshtur, bile kanë shkuar deri atje sa shtypi i tyre jo vetëm nuk i bën jehonë asnjëherë ndonjë shkrimi tonë, por nuk flet as edhe për sukseset e vendit tonë. Te ne ata kanë përfaqësues të agjencisë së lajmeve, të cilët transmetojnë vetëm lajme të shkurtra kronikale.

Natyrisht, kjo pasqyron predispozicionin që kanë për të vazhduar politikën e tyre; ata nuk mbetën të kënaqur dhe me siguri nuk u pëlqeu mendimi që u shfaqëm ne në lidhje me vajtien e Niksonit në Kinë. Por më në fund ç'doli nga ky takim me amerikanët? Asgjë nuk po shohim dhe as ata vetë nuk po thonë gjë. Gjithçka e mbajnë

të fshehtë. Kritika jonë ishte e brendshme. Në këtë mes u bë e qartë dhe e dallueshme se ne nuk ndryshuam asgjë në qëndrimin tonë ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vazhduam dhe do të vazhdojmë luftën kundër tyre, kurse kinezët e zbutën. Mbase donin që ne të bënim si ata, por këtë ne nuk e bëmë e nuk e bëjmë dhe jemi në rrugë të drejtë. Sidoqoftë, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë në mes nesh për këto probleme, ne duhet të përpiqemi të çajmë akullin e krijuar jo për fajin tonë. Kjo është në interes të vendit tonë, të Kinës dhe të revolucionit.

Pastaj ne kemi nevojë që, duke marrë kontakt me shokët kryesorë kinezë, të mësojmë realitetin e gjendjes së brendshme në Kinë, realitetin për partinë, për politikën, për ekonominë; kemi nevojë të marrim vesh më qartë për politikën e Kinës ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës etj. Kemi nevojë, gjithashtu, të dimë se ç'mendojnë kinezët për zhvillimin e ardhshëm të gjendjes e të ngjarjeve në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore në botë.

Natyrisht, delegacioni ynë do të vejë pasi të jetë mbajtur kongresi i Partisë Komuniste të Kinës dhe mbledhja e Asamblesë. Atëherë shumë gjëra do të kenë ngjarë, shumë çështje do të jenë vendosur dhe kontaktet tona me ta mund të jenë më të frytshme.

Me këtë rast, delegacioni ynë të shkojë edhe në Kore, në Vietnam dhe në Pakistan. Marrim kështu kontakt me miqtë, na bëhet mirë edhe për brenda, edhe për jashtë.

DREKË PËR EDUARD HILLIN

Sot kishim për drekë shokun Eduard Hill, Kryetar i Partisë Komuniste (m-l) të Australisë me bashkëshorten e tij. Biseduam për një sërë problemesh¹. Ishim dakord. Kaluam shumë mirë dhe miqtë mbetën shumë të kënaqur. Me ta ishte dhe Ramiz Alia.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 417.

TAKTIKA E SHUMË VIJAVE NË KINË — NJË PRAKTIKË E NGRITUR NË PARIM

Në arenën ndërkombëtare zëri i Kinës vazhdon të mos ndihet. Ekzistojnë periudha pushimesh për cilindo shtet, por pushimet e kinezëve në politikën ndërkombëtare vazhdojnë prej shumë kohësh, kurse fuqitë e tjera të mëdha botërore vazhdojnë përpjekjet dhe intrigat. Revizionistët sovjetikë dhe satelitët e tyre sulmojnë Kinën çdo ditë, duke e akuzuar atë për bashkëpunim me imperializmin amerikan, për antimarksizëm dhe për përçarje të të ashtuquajturit kamp të socializmit. Kina nuk u përgjigjet këtyre sulmeve. Propaganda antikineze e sovjetikëve po merr dhe parashikohet të marrë forma më konkrete. Në konferencën e «të paangazhuarve» në Algjer, sovjetikët po përgatiten të veprojnë me anën e Fidel Kastros, të cilit i japin, të paktën, një milion e gjysmë dollarë në ditë. Këta muajt e fundit mjekroshi Kastro sulmoi, pa vënë emrat, Kinën dhe Shqipërinë. Sipas tij, Bashkimi Sovjetik është një vend i vërtetë socialist dhe bën pjesë në «botën e tretë». Këto teza, ky gramafon i sovjetikëve, do të shtrojnë edhe në Algjeri.

«Sovjetikët, pjesëtarë të botës së tretë»!!! Pse jo! Edhe Çu En Lai e ka pasë deklaruar këtë tezë për Kinën. Atëherë, oburra, kush të hyjë më parë në këtë «botë të tretë»? Po në «botën e dytë» kush mbetet të hyjë? Në të parën kush bën pjesë? Mund të krijojnë dhe të katërtën

dhe të pestën, që të mos e marrë vesh i pari të dytin! Qëllimi është si e si të maskohen.

Përballë kësaj veprimtarie politike intensive antikinaze, Kina hesht. Një ambasador kinez i thotë një ambasadorit tonë që «edhe ne jemi duke përgatitur një ofensivë politike kundër sovjetikëve për çështjen e kufijve kino-sovjetikë». Sa e vërtetë është kjo? Sidoqoftë, është e mjerueshme.

Niksoni dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë zhytur në një skandal të ndyrë, në një krizë të rëndë. Sovjetikët ndihmojnë Niksonin të dalë nga ky batak. **Po kinezët ç'bëjnë? Heshtin! Asgjë s'thonë gazetat kineze se ç'ngjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje ecet me «një delikatesë» tipike kineze, që të mos thyhen vezët e kllockave Çu-Kisinger-Nikson.** Gazetat kineze propagandojnë për vajtje-ardhje, dreka e darka që shtrohen për nder të delegacioneve amerikane në Kinë.

Kisingeri kishte lajmëruar se më 15 gusht do të vinte në Pekin që «të rregullonte» Kamboxhian, po ai s'vajti, sepse Sihanuku «çau ferrën», iku në Kore për të mos biseduar mbi këtë problem me të. U prishën planet.

Kinezët na patën thënë zyrtarisht se në gusht ose nga fillimi i shtatorit do të bënin kongresin e partisë dhe do të thërritnin Asamblenë Kombëtare. Mundet që do ta bëjnë! Por asnjë shenjë nuk duket, gushti iku dhe po vjen vjeshta. Flitet, por këto janë fjalë diplomatësh, se u bë plenumi i KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe nuk ranë dakord që të bëhej kongresi; «Çian Çini dhe Jao Ven Juan janë në opozitë me Çu En Lain. Kongresi është shtyrë». Ambasadori i Kinës në Paris i tha ambasadorit tonë se më 11 shtator Pompiduja do të shkojë në Pekin. Në qoftë se është kështu, atëherë vështirë të mblidhet kongresi para festës së 1 Tetorit.

AFP-ja njoftonte mbrëmë se këto ditë Çu En Lai ka pasur një takim me parlamentarë holandezë dhe linte të

kuptohej se ai «ka vënë në një plan Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sa i përket rrezikshmërisë së tyre». Kujt t'i besosh? Le të mbështetem te dëshira jonë që të ngjasë kështu, por, në qoftë se ka një fije të vërtetë në këtë thënie, atëherë diçka duhet të ketë ngjarë në mbledhjet misterioze të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës! Njëra vijë, përko-hësisht, duhet t'ia ketë hipur vijës tjetër! Taktika e dy vijave ose e shumë vijave në Partinë Komuniste të Kinës, siç po duket, është një praktikë e zakonshme e ngritur në parim. Këto vija të ndryshme kanë pa dyshim edhe udhëheqësit, edhe pasuesit e tyre, të cilët mbrohen me flamurin e Mao Ce Dunit. **Mao Ce Duni «prononcohet me gjysmë goje» për njërën dhe e lë që drejtësinë e saj «ta vërtetojë koha». Në rast se koha nuk e vërteton, kthehet te vija tjetër, por edhe këtë e lë «ta vërtetojë koha». Dhe kështu me radhë! Në çdo kthesë Maoja thotë nga «një frazë», nga «një citat» dhe mbi këto rrëtohet bota kineze, reflektojnë njerëzit dhe marrin rrugën: disa atë të pushtetit, të tjerët për njëfarë kohe «shkollën e riedukimit». Vetëm Lin Biaoja «u vetëvra», sepse komploti. Të tjerët rehabilitohen, më vonë vijnë në parti dhe në pushtet dhe prapë ua lënë vendin të tjerëve.**

Po a janë të drejta këto konkluzione?! Nga faktet që disponojmë është e zorshme të nxjerrësh përfundime të tjera.

Shokët kinezë mbajnë heshtje të madhe, as thonë, as shkruajnë gjë. As analiza problemesh e situatash nuk shikon të bëhen e as veprime politike të dukshme, që të mund të dalësh në konkluzione të tjera. Të gjitha faktet dhe të dhënat që ne mbledhim me kujdes dhe që i analizojmë me shumë dashamirësi e objektivitet, nuk të lënë të dalësh në rrugë të tjera më të qarta. Le t'ia lëmë kohës t'i vërtetojë, siç bën Mao Ce Duni.

KINA NUK DUHET TA NEGLIZHOJË EVROPËN

Ne kemi qenë kurdoherë të mendimit, dhe këtë ia kemi shprehur edhe Li Hsien Nienit, që Kina duhet të dalë në arenën ndërkombëtare me një politikë aktive për të forcuar në botë pozitat e saj revolucionare, për të inkurajuar proletariatin botëror në luftë kundër kapitalit, për të ndihmuar popujt përparimtarë që luftojnë për të fituar dhe për të mbrojtur lirinë, pavarësinë e sovranitetin, për t'u çliruar nga thonjtë e imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Këtyre dy superfuqive, i kemi thënë Li Hsien Nienit, duhet t'u bëhet një luftë e pamëshirshme, pa bërë lëshime parimore. Kontradiktat në mes këtyre të dyjave duhet t'i thellojmë, pa mbajtur anën e njëjës ose të tjetrës. Kurdoherë situatat duhen analizuar të lidhura me koniunkturat që krijohen në botë, dhe të përdoren taktika të atilla që të mos vijnë as në kundërshtim me strategjinë tonë, as ta luftojnë atë. Parulla jonë e madhe «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!» të mos mbetet një frazë e vdekur.

Li Hsien Nienit i kemi lënë të kuptojë, gjithashtu, se Kina po e neglizhon Evropën, dhe se ky është një problem me rëndësi të madhe. Në Evropë përplasen interesat e mëdhenj të imperialistëve dhe të socialimperialistëve; këtu ata kanë strofkën e tyre kryesore; që këtej janë hedhur në kolonizimin e botës, në shtypjen e popujve; këtu ata zhvillojnë teoritë e tyre dhe i rajonizojnë ato në

të gjithë botën. Me këtë, i thamë Li Hsien Nienit, ne nuk mendojmë se duhet harruar lufta jonë intensive në të katër anët e botës. Kina duhet të luajë kudo një rol vendimtar për revolucionin, në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine, por Evropën kurrsesi nuk duhet ta neglizhojë.

Tash Kina ka filluar të interesohet për Evropën, por jo kurdoherë duke ndjekur taktika të drejta. Këtë gjë, të mos e përsëris tash, e kam shprehur edhe në shkrime të mëparshme. Vajtja e Pompidusë në vjeshtë të parë në Kinë tregon se kinezët po përdorin një taktikë të mirë. Edhe Franca kërkon të nxjerrë fitime, por edhe Kina fiton, në rast se këto koniunktura shfrytëzohen drejt.

Pse shkon Pompiduja në Pekin? Sipas mendimit tim, në mes Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë krijuar kontradikta serioze, që janë trashëguar që nga koha e Dë Golit. Ato u dukën sikur u zbutën me ardhjen e Pompidusë në fuqi, po prapë u ashpërsuan, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë ta gjunjëzojnë ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht Francën. Partneri kryesor i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është Republika Federale e Gjermanisë. Boni po bëhet i rrezikshëm edhe për Francën, së cilës jo vetëm i rrezikon autoritetin dhe ekonominë, por e kërcënon edhe ushtarakisht. Pra, Francës, përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i shtohet një rival i përhershëm, imperializmi revanshist gjerman, kurse Bashkimi Sovjetik është bërë për të një rrezik i tretë i madh.

Franca shikon se të dyja superfuqitë po merren vesh veçanërisht në dëm të saj, kurse Boni qëndron në mes tyre dhe fiton terren. Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Republika Federale e Gjermanisë dhe Bashkimi Sovjetik po bëhen një kërcënim për Francën. Franca nga ana e saj kërkon të çajë dhe ta përçajë këtë bllok të fuqishëm, dhe tash ka zgjedhur Kinën për mbështetje.

Prandaj shkon Pompiduja në Pekin. Natyrisht, Pompiduja do të tjerë çështjet ku Franca ka pikëpamje të përbashkëta me Kinën dhe këto mund të jenë: Qëndrimi kundër bashkëpunimit dypalësh të dy superfuqive për të vendosur për problemet ndërkombëtare dhe sferat e influencës në botë; kundërshtimi i pazarllëqeve të dy superfuqive për të ashtuquajturin pakësim të armatimeve që ka për qëllim monopolin dhe balancimin e armatimeve të dy superfuqive dhe çarmatosjen e vendeve të tjera; kundërshtimi i ndërhyrjeve të dy superfuqive në punët e brendshme të vendeve të tjera; kundërshtimi i ekspansionit të tyre në dete dhe në oqeanë, e kështu me radhë.

Kina me siguri do të jetë dakord për këto çështje, por do të shohim si do të manovrojë për të nxjerrë më shumë përfitime, sepse ajo shikon vetëm «me një sy», Bashkimin Sovjetik e shikon me dylbi të madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bonin me dylbi të vogël. Por në këtë mes ajo nuk duhet të harrojë as proletariatin, as revolucionin dhe as popujt e Evropës që luftojnë kundër kapitalit.

SHKRUAR
DITË 2 SHTATOR 1973

E DIEL
2 SHTATOR 1973*

TELEGRAM URIMI PËR KONGRESIN E 10-të TË PARTISË KOMUNISTE TË KINËS

Shokët kinezë njoftuan me shtyp e me radio se zhvilluan Kongresin e 10-të të Partisë së tyre. Raportin politik e ka mbajtur Çu En Lai. Është mbajtur edhe një raport i dytë mbi statutin e ri të partisë e është aprovuar edhe statuti.

Sot, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe në emrin tim, i bëra Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunit një telegram urimi me rastin e Kongresit të 10-të.

SHËNIM

Thirra ministrin e Jashtëm dhe i dhashë mendime të shkruara për të korrigjuar dhe për të plotësuar mesazhin përgjigje që duhet t'i dërgojë Kim Ir Senit për propozimet për bashkimin e të dy Koreve dhe kërkesën për përkrahjen tonë.

SHËNIM

Pirro Kondin e udhëzova se si duhet të trajtojë propaganda jonë konferencën e «të paangazhuarve», që mbahet këto ditë në Algjer, pse konstatova se ajo po nënvleftësohej.

KONGRESI I 10-TË I PARTISË KOMUNISTE TË KINËS

Nga data 24 deri më 28 gusht 1973 u zhvillua Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste të Kinës.

U mbajtën dy raporte kryesore: njëri, që ishte më kryesori, u mbajt prej Çu En Lait, dhe i dyti, mbi statutin e partisë, nga Van Hun Veni. Kongresi i zhvilloi punimet në mënyrë krejt të mbyllur dhe në një fshehtësi të madhe, «shembullore» si të thuash. Shokët kinezë e arsyetojnë këtë fshehtësi me atë që të mos e sabotonin revizionistët sovjetikë(!). Mirë, kjo është puna e tyre, por konspiracioni vazhdoi edhe pasi kishte mbaruar kongresi. Kjo qëllon pikërisht në atë kohë që ambasadori ynë në Pekin, Xhorxhi Robo, kandidat i KQ të PPSH, bënte vizitat e lamtumirës, se largohej nga kjo detyrë. Megjithëse ai pyeste, shokët kinezë as që i thanë se kongresi që mbledhur dhe do të shpallej. Sidoqoftë, prapë s'ka rëndësi.

Kongresi i 10-të miratoi vijën dhe veprimtarinë e përgjithshme të Revolucionit Kulturor dhe vijën e Kongresit të 9-të. Revolucionin Kulturor e përcaktuan tash më drejt, si një revolucion me karakter politiko-ideologjik. Të tillë përcaktim i kemi dhënë në këtë revolucion, kur në Kinë jepeshin përcaktime të paqarta dhe shumë herë jo të drejta.

Kongresi lë të kuptohet se gjatë Revolucionit Kul-

turor janë bërë gabime. Të tilla gabime ne i kemi parë, i kemi diskutuar me njëri-tjetrin, i kemi kritikuar në rrethin e ngushtë të udhëheqjes sonë dhe jemi habitur me të drejtë se si lejoheshin të tilla gabime antimarksiste. Me aq sa na lejonin njoftimet e shtypit, sepse kinezët nuk na informonin, mbasi këto probleme i konsideronin të brendshme, besoj se ne nuk kemi gabuar në thelb në vlerësimin e çështjeve. Natyrisht ne akoma nuk mund të gjykojmë me thellësinë e duhur për këto probleme, sepse deri tash asnjë analizë e thellë nga ana e vetë kinezëve nuk i është bërë Revolucionit Kulturor, ideve, rrymave dhe tendencave që u shfaqën e u ballafaquan, derisa u arrit edhe në goditje me armë gjatë zhvillimit të këtij revolucion. Kinezët, brendapërbrenda, mund ta kenë bërë një analizë të tillë, por një analizë publike s'ka dhe veç dënimeve dhe arsyeve të dënimeve të grupeve të Liu Shao Çisë dhe të Lin Biaos e Çen Po Tasë ne nuk dimë gjë tjetër.

Kongresi i 9-të aprovohet në bllok dhe thuhet se Lin Biaoja në këtë kongres nuk kishte kontribuar «veçse në leximin pa dashje» të raportit politik, sepse ky raport ishte bërë nga shokë të tjerë, nën udhëheqjen e Maos, ndërsa raporti i përgatitur nga Lin Biaoja dhe Çen Po Taja u hodh poshtë (!).

Kongresi i 10-të dënon veprimtarinë «kriminale, antiparti» etj., të Lin Biaos dhe të grupit të tij. Ai cilësohet si agjent i revizionistëve sovjetikë dhe si komplotist për të vrarë Maon. Ky grup dhe veprimtaria armiqësore e tij «u likuiduan plotësisht, me sukses dhe kudo. Ky grup kishte sabotuar shumë». Kongresi «aprovoi plotësisht dhe njëzëri vijën e drejtë marksiste-leniniste të kryetarit Mao» dhe thekson: «Duhet të vazhdohet lufta për demaskimin e figurës tradhtare të Lin Biaos» dhe «të nxjerrim mësim nga shembulli negativ».

Për politikën e jashtme dhe për detyrat e Partisë

Komuniste të Kinës Kongresi i 10-të flet qartë, na duket neve, dhe përcakton drejt rrezikshmërinë e madhe të të dyja superfuqive imperialiste, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, «luftën kundër të dyjave», që «duan të kafshojnë Kinën e të dominojnë botën dhe popujt»; flitet «të forcohet dhe të mbrohet internacionalizmi proletar, të forcohet uniteti me proletariatin, me popujt, me kombet e shtypura» etj. Çka është mirë dhe në kundërshtim me disa shfaqje të mëparshme, Kongresi i 10-të thekson se «ne duhet të bashkohemi me të gjitha partitë dhe organizatat e vërteta marksiste-leniniste në të gjithë botën dhe të çojmë deri në fund luftën kundër revizionizmit modern».

Partia jonë ka qenë përkrah Partisë Komuniste të Kinës e në mbrojtje të saj, si në kohë të mirë, ashtu edhe në furtunë. Por Partia jonë ka kritikuar, gjithashtu në rrugë marksiste-leniniste, kurdoherë kur ka gjykuar se disa çështje nuk ishin drejt. Këto kritika dhe vërejtje i ka bërë në kohën e duhur dhe brenda normave.

E ENJTE
13 SHTATOR 1973

TË DEMASKOHET GRUSHTI USHTARAK FASHIST NË KILI

Porosita të shkruhet një artikull redaksional kundër grushtit të shtetit ushtarako-fashist në Kili, të demaskohen fashistët komplotistë në bashkëpunim me imperializmin amerikan. Të mbrohet figura e presidentit Alende, që u rrëzua dhe u vra prej tyre, si një demokrat i shquar dhe përparimtar etj.

SHËNIM

Fjalimi i Çu En Lait, mbajtur me rastin e vizitës në Pekin të presidentit të Francës, Zhorzh Pompidu, ishte një fjalim i mirë, dinjitoz, i vendosur dhe luftarak. Në këtë fjalim politika e jashtme e Kinës shprehej drejt, në mënyrë radikale.

UDHËZIME AMBASADORIT TONË TË RI NË KINË

E udhëzova dje ambasadorin tonë të ri në Kinë se si të punojë dhe si ta kryejë detyrën më së miri. Qëllimi kryesor dhe vendimtar është kalitja e mëtejshme e miqësisë dhe e aleancës në mes dy partive dhe shteteve tona, në unitet dhe në përputhje me parimet e marksizëm-leninizmit.

Udhëzimet që i dhashë, me pak fjalë, konsistojnë në këto gjëra:

Duhet të kuptojë se detyra që iu ngarkua është me rëndësi shumë të madhe. Qëllimi kryesor i vajtjes së tij në Kinë është forcimi i mëtejshëm i lidhjeve të ngushta miqësore marksiste-leniniste, internacionaliste në mes dy partive dhe dy republikave tona popullore.

Marrëdhëniet tona me Kinën, si ato politike, ideologjike, ekonomike e kulturore, ashtu edhe ushtarake deri tani kanë shkuar mirë. Ne duhet të bëjmë që këto të shkojnë akoma edhe më mirë. Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë në Kinë kanë fituar admirimin dhe respektin e popullit kinez. Kjo është një fitore e madhe që duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë. Ambasadorit, tok me shokët atje, u bie të kontribuojnë në këtë çështje. Ne, nga ana jonë, Kinën socialiste dhe Partinë Komuniste të Kinës i kemi mbrojtur në çdo kohë dhe këtë e dinë dhe e çmojnë kinezët.

Kinezëve ne u kemi bërë dy letra shoqërore, një për çështjen e kufijve me Bashkimin Sovjetik dhe një për

vajtjen e Niksonit në Pekin. Për këto letra nuk kemi marrë përgjigje. Sigurisht, mendojmë se mundet që shokët kinezë të mos kenë qenë dakord me pikëpamjet tona dhe mund të kenë thënë: «Le të ruajnë shqiptarët mendimet e tyre dhe ne tonat, të mos hyjmë në diskutime dhe të mos bëhen këto objekte fërkimesh». Edhe ne ashtu kishim menduar.

Po mundet që me letrën për vajtjen e Niksonit u ndërlikua çështja. Ka mundësi që Lin Biaoja të ketë mbrojtur tezën «e mospranimi të Niksonit në Pekin». Ky është një supozim që bëjmë ne, se asgjë për këtë nuk figuron në dokumentet e kinezëve kundër Lin Biaos. Në rast se është kështu siç supozojmë ne, shokët kinezë mund të kenë thënë me veten e tyre që, «meqë dënojmë Linë», shqiptarët mund të mos jenë të qartë për çështjen e tij.

Kur ne e dënuam Linë pa hezitim, duke uruar kongresin dhe Maon, shokët kinezë «u shkrifëruan» dhe e pritën telegramin tonë për kongresin me aq entuziazëm. Ky është një supozim që bëjmë, pse për ne, edhe sikur Lini të ishte kundër vajtjes së Niksonit në Pekin, këtë ai e bënte nga pozita krejt të kundërta nga tonat, nga pozitat prosovjetike, kurse ne nga pozitat antisovjetike dhe antiamerikane.

Kështu vajtja e ambasadorit tonë të ri në Pekin ndodh pas Kongresit të 10-të dhe në një kohë që udhëheqja kineze po tregohet dashamirëse ndaj Partisë dhe vendit tonë. Prandaj ai duhet të përfitojë. Punë ka shumë dhe duhet të punojë. Atje ka edhe punë konkrete, edhe punë politike e diplomatike. Të bëjë që të forcohet dashuria për popullin dhe për vendin tonë e për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Të mbajë kontakte të gjalla, të bëjë pyetje me takt, por edhe pa pyetur mos të rrijë dhe të informojë për gjendjen ashtu siç e mendon. Duhet të ketë parasysh që kritikën nga jashtë edhe s'para u pëlqejnë kinezëve.

TË MBROJMË POPULLIN PËRPARIMTAR KILIAN

Ritheksova përsëri që propaganda jonë duhet të tregohet më shumë aktive në mbrojtjen e popullit demokrat përparimtar kilian, që vritet e torturohet nga junta fashiste ushtarake. Të bëhen mitingje në fabrika e gjetkë, të bëhen protesta, të mbrohen dhe të inkurajohen shokët tanë revolucionarë kilianë, të vihet në dukje figura e Alendes, që u vra prej fashistëve, në mbrojtje të demokracisë dhe të përparimit.

TE ARBRORETE TË PARSITETAR KILIAN
SHËNIM

I dhamë dorën e fundit fjalimit që ministri ynë i Jashtëm do të mbajë në mbledhjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.



**GJERMANËVE T'UA KUJTOJMË SE DUHET TË NA
PAGUAJNË DËMSPËRBLIMET E LUFTËS**

I thashë ministrit të Jashtëm që në fjalimin e tij në Kombet e Bashkuara, me rastin e pranimit të të dy shteteve gjermane, të deklarojë se të dyja këto Shqipërisë i kanë borxh dëmshpërblimet e luftës (t'i specifikojë këto në bazë të dokumenteve), të cilat duhet të na i paguajnë pa humbur kohë. Ato s'kanë për të na i paguar, po ne shtrojmë një të drejtë të ligjshme.

SHËNIM

Duhet shkruar një artikull, ku të demaskohet grushti ushtarak fashist në Kili, si dhe të demaskohet me argumente teza e revizionistëve sovjetikë, italianë, francezë e të tjerë, për marrjen e pushtetit në rrugën paqësore.

ERDHI REXH BËRÇI

Erdhi në Tiranë për vizitë dhe për bisedime Kryetari i KQ të Partisë Komuniste (m-l) të Anglisë, Rexh Bërç. Nesër ai do të bëjë bisedimet e para me Ramizin.

PROTESTË ENERGJIKE QEVERISË ITALIANE PËR NDOTJEN E UJËRAVE TONA BREGDETARE

Protestuam energjikisht pranë qeverisë italiane kundër faktit se midhjet e tyre të infektuara me bacilin e kolerës po na infektojnë ujërat territoriale dhe bregdetin tonë. Këto midhje italianët i kanë hedhur në det dhe ato kanë ardhur në plazhet tona. Po merren masa të rrepta dhe urgjente dezinfektimi. Lajmëruam popullatën e bregdetit për kujdes e vigjilencë.

SHËNIM

Siç u tha shokëve tanë të ushtrisë zëvendësatashe ushtarak i ambasadës kineze te ne, Asambleja e Madhe Kombëtare Kineze është mbledhur, por në mënyrë sekrete. Kurse ambasadorit tonë, Çi Pen Fei dhe Dun Bi Uja, që e pritën kur paraqiti letrat kredenciale, nuk i thanë asgjë.

AKT KRIMINAL I QEVERISË ITALIANE

Midhjet e infektuara me kolerë, të ardhura nga Italia, vazhdojnë të dalin në bregdetin tonë. T'i bëjmë edhe një protestë tjetër të rreptë nga ana jonë qeverisë italiane. T'i demaskojmë italianët me artikuj për këtë akt kriminal. Të vazhdojmë të vaksinojmë gjithë popullatën bregdetare dhe të dezinfektojmë kudo. Deri tash nuk kemi asnjë rast kolere.

SHENIM

Shoku Ramiz Alia më raportoi për bisedën që bëri me Kryetarin e KQ të Partisë Komuniste (m-l) të Anglisë, shokun Rexh Bërç. Ishin dakord për të gjitha problemet që u diskutuan. Të martën që vjen do ta pres edhe unë.

Sot kalon nga shteti ynë për në Paris—Nju-Jork Çiao Kuan Hua. Vërejtja: Në bisedën e jashtme të shokut për të marrë pjesë në sesionin e zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

SHËNIME

Sonte do të shkojmë në pritjen që jep ambasada kineze me rastin e 24-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës.

Sot kalon nga aerodromi ynë për në Paris—Nju-Jork Çiao Kuan Huaja, zëvendësministri i Jashtëm i Kinës që shkon për të marrë pjesë në sesionin e zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

TË PËRPIQEMI PËR TË KTHYER QYMYRET TONA TË DOBËTA NË KOKS

Nëpërmjet rumunëve që kanë uzinë dhe nëpërmjet kinezëve të japonezët duhet të përpiqemi për të marrë teknologjinë e kthimit të qymyreve të dobëta, siç janë këto tonat, në koks. Kjo do të jetë shumë e nevojshme, e dobishme dhe me leverdi ekonomike për ne.

FJALIMI I DELEGACIONIT TONË NË OKB PRITET MIRË

Na lajmërojnë nga Nju-Jorku se fjalimi i delegacionit tonë ka pasur jehonë të mirë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Shumë delegatë të vendeve miq u ngritën nga vendet e tyre dhe shkuan për të përgëzuar në vend delegacionin tonë në sallë, shumë të tjerë përgëzuan në korridore, veçanërisht arabët, përfaqësuesit e vendeve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Francezi po ashtu përgëzoi dhe shfaqi kënaqësinë e tij për sa flitej për Francën.

NË PRITJEN QË DHA AMBASADORI KINEZ NË TIRANË

Mbrëmë në pritjen që u dha në ambasadën kineze, pasi e urova ngrohtësisht ambasadorin për kongresin dhe për rizgjedhjen e tij si kandidat i Komitetit Qendror, ai na vuri në korent për përgatitjen dhe zhvillimin e punimeve të kongresit, si dhe për entuziazmin që ka krijuar kjo ngjarje në Kinë. Të gjitha ç'na tha, njiheshin nga ne, sepse shtypi dhe radioja e Kinës i kanë transmetuar. Ambasadori na perfrazoi raportin e Çu En Lait.

Në pyetjet që i bëra, në lidhje me vizitën e Pompidusë, ai nuk më tha ndonjë gjë konkrete, por, duke marrë shkas nga kjo, pasi fola unë se si i gjykojmë ne aktualisht pozitat e politikës franceze, ai i aprovoi plotësisht pikëpamjet tona.

E pyetëm për të ardhmen e Kamboxhias. Ambasadori kinez u tregua disi i rezervuar duke thënë se kamboxhianët duhet të luftojnë akoma, ata kanë nevojë të kaliten, të forcohen, të clirojnë shumë qendra të tjera, para se të marrin Pnom-Penin; se Lon Noli ka akoma një ushtri shumë më të madhe nga ajo e Frontit; se të tjerë infiltrohen nga Tajlanda dhe se Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë ta ndihmojnë Lon Nolin etj.

Ai, pasi e pyeta, tha se «armët që u japim ne (kinezët), vietnamezët e Jugut i lejojnë të kalojnë për në Kamboxhia».

SHËNIM

Më treguan disa çelique të para të markës shqiptare që janë prodhuar nga hekur-nikeli ynë në uzinën eksperimentale të ngritur në Kinë.

NGJARJET TRAGJIKE TË KILIT — MËSIM PËR
REVOLUCIONARËT E GJITHË BOTËS

I dërguam sot gazetës «Zëri i popullit», që ta botojë nesër, artikullin me titull: «Ngjarjet tragjike të Kilit — mësim për revolucionarët e gjithë botës»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 437.

TAKIM ME REXH BËRÇIN

Prita sot Kryetarin e KQ të Partisë Komuniste (m-l) të Anglisë shokun Bërç¹, që ka ardhur në vendin tonë për vizitë dhe për bisedime me ne.

Biseda që e ngrohtë dhe miqësore. Ai shoqërohet nga gruaja e tij, militante edhe ajo. Merrte pjesë edhe Nexhmija.

Shoku Bërç më tha se djali i tij, kirurg dhe alpinist, në një majë mali të pazbuluar në Groenlandë, u ngjiti pari, nguli aty flamurin shqiptar dhe depozitoi të mbështjellë me celofan Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë. Majës i vunë emrin «Maja e Shqiponjës». E falënderova dhe e ftova djalin e tij të vizitojë vendin tonë dhe Alpet e Veriut.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 452.

LUFTË E RE MIDIS EGJIPTIANËVE, SIRIANËVE
DHE IZRAELITËVE

Që dje filloi lufta e egjiptianëve dhe e sirianëve kundër Izraelit. Siç po duket, sido që kjo nuk ka rëndësi pse arabët janë në të drejtën e tyre, janë këta që kanë sulmuar të parët dhe Izraeli sikur u gjend në befasi. Egjiptianët kaluan kanalin e Suezit dhe, sipas tyre, u vendosën në bregun e djathtë të tij, duke pushtuar fortifikatat izraelite të vijës Barlev. Sirianët po ashtu sulmuan lartësitë e Golanit e të Hebronit dhe pushtuan pozitat izraelite. Dueli i aviacionit është i madh. Komunikatave nuk mund t'u zësh shumë besë.

Çështja deri tash qëndron kështu: arabët kanë avantazhe. A do t'i ruajnë dhe a do t'i zhvillojnë ato dhe si? Lufta prej 6 ditësh e 1967-s u është bërë vallë mësim? Deri tash Izraeli nuk i ka zënë në befasi si më parë. Ç'do të ngjasë më vonë, do të shohim. Do të shohim po ashtu shkallën e përgatitjes së arabëve, taktikën dhe strategjinë e tyre, si dhe atë të Izraelit. Arabët duken si pak të alarmuar, izraelitët më shumë. Mos vallë luhet këtu ndonjë manovër e madhe e përbashkët dhe e koordinuar? Arabët bënë një ofensivë për të fituar disa pozita nga të cilat të rikthehen pastaj në «vallen e OKB-së» dhe të bien në kurthet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të sovjetikëve. Të tërë fitojnë nga një çikë; për të mos humbur gjithçka, të gjithë të humbasin nga një çikë

dhe të vazhdojnë përsëri gjendjen «as luftë, as paqe», të vazhdojnë diskutimet! Këtë do ta shikojmë, po e ndjekim me vigjilencë. Ne do t'i mbrojmë arabët me të gjitha mjetet tona propagandistike dhe do të demaskojmë Izraelin, sovjetikët dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dhashë urdhër që forcat e bregdetit, të marinës dhe të aviacionit të jenë në gatishmëri të plotë, pse këto situata janë të mbarsura me rreziqe.

LUFTA NË LINDJEN E MESME VAZHDON

Egjiptianët po përparojnë duke luftuar në Sinai dhe deri tash nuk duket ndonjë lëkundje në ta. Sirianët po luftojnë edhe ata mirë me sulme, me zbrapsje dhe kundërsulme. Thuhet nga të dyja palët se luftohet në Golan (nga sirianët), në afërsi të Damaskut (45 km larg nga ana e Izraelit). Por e vërteta duhet të jetë se sirianët kanë zënë vijën e parë të tyre të mbrojtjes dhe nuk e lëshojnë. Izraeli po mburret se «do ta marrë Damaskun, se shkatërroi ushtrinë siriane etj.», po asnjë nga këta objektiva nuk ka arritur dhe po pëson humbje të rënda në tanke dhe në avionë. Miti i «luftës rrufe», «i pathyeshmërisë» së tij dështoi. Izraeli gjendet në vështirësi dhe këtë e tregon ndihma e hapët që kanë filluar t'i japin Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Uniteti i vendeve arabe duket më i mirë, aq sa mund të jetë një unitet mbretërisht, feudalësh dhe borgjezësh-kapitalistë. Këtu qëndron rreziku. Agjenturat e imperializmit amerikan dhe të atij sovjetik punojnë brenda radhëve të tyre. Këta përpiqen të shuajnë zjarrin që nuk u leverdis, se cenon interesat e tyre dominues dhe shfrytëzues. Të dyja superfuqitë ndodhen keq dhe kanë frikë mos ndërlikohet gjendja, se mos fitorja e arabëve ose e izraelitëve vë në rrezik dominimin e amerikanëve ose të sovjetikëve. Prandaj që të dyja bëjnë sikur ndihmojnë, por përgatitin «pompat e mëdha të shuarjes së zjarrit»,

pse kështu ruajnë statukuonë «as paqe, as luftë» dhe forcojnë dominimin.

Çka po bëjnë arabët tash është pozitive, revolucionare. Të tërë, Brezhnev e Tito dhe të gjithë llojet e tyre, gjithë bota kapitaliste, janë kundër popujve arabë. Prandaj Kina, në dhe gjithë revolucionarët në botë, duhet ta ndihmojnë luftën e këtyre popujve.

LITTA NE LINDEN E MISSIR VASHIDON

... (mirrored text from the reverse side of the page)

... (mirrored text from the reverse side of the page)

ARMIQTË MË TË MËDHENJ TË POPUJVE ARABË

Gazeta «Zëri i popullit» do të botojë nesër artikullin tonë demaskues për dy superfuqitë, me titull: «Imperializmi amerikan e socialimperializmi sovjetik — armiqtë më të mëdhenj të popujve arabë»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 466.

VJEN NË VENDIN TONË NJË DELEGACION VIETNAMEZ

Sot do të vijë në vendin tonë për vizitë miqësore zyrtare një delegacion i Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe i qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit. Delegacionin e kryeson anëtari i Byrosë Politike të Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe Kryeministër i Republikës Demokratike të Vietnamit, Fam Van Dong.

TAKIM ME FAM VAN DONGUN

Prita¹ kryetarin e delegacionit të Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe të qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit, Fam Van Dong, si dhe anëtarin e këtij delegacioni, Nguyen Zui Çin².

1 Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 474.

2 Ministër i Punëve të Jashtme.

U NËNSHKRUA DEKLARATA E PËRBASHKËT SHQIPTARO-VIETNAMEZE

Në përfundim të bisedimeve që u zhvilluan midis delegacionit vietnamez dhe delegacionit tonë, sot u nënshkrua deklarata e përbashkët shqiptaro-vietnameze.

Po sot, në sallën e Teatrit të Operës dhe të Baletit u organizua një miting i miqësisë shqiptaro-vietnameze.

DELEGACIONI VIETNAMEZ LARGOHET SOT NGA VENDI YNË

Sot delegacioni i Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe i qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit, i kryesuar nga Fam Van Dongu, largohet nga vendi ynë.

Delegacionit, në shenjë respekti për luftën heroike të popullit vietnamez, ne i bëmë një pritje shumë të ngrohtë e vëllazërore dhe me nderimet që i përkitnin. U prit e u përcoll me popull. U prit në vizita protokollare, u zhvilluan bisedime zyrtare. Delegacioni bëri homazhe dhe vendosi kurora në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut dhe vizitoi Shtëpinë-Muze të Themelimit të Partisë dhe Muzeun e Luftës Nacionalçlirimtare. Vizitoi Tiranën dhe Durrësin.

Për nder të delegacionit Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave dhanë një pritje në Pallatin e Brigadave. Foli edhe Fam Van Dongu. Pas bisedimeve u nënshkrua edhe deklarata e përbashkët. U organizua edhe një miting i miqësisë në Tiranë.

Unë nuk mora pjesë në këto ceremoni e aktivitete.

MBI DIPLOMACINË E FSHEHTË

Teza për artikull

— Tehu i artikullit të drejtohet kundër amerikanëve, sovjetikëve, por edhe kundër fuqive të tjera imperialiste. Amerikanët dhe sovjetikët të goditen e të trajtohen një-lloj, jo një më shumë e një më pak.

— Të dilet nga kuadri i Lindjes së Mesme. Mbështetja duhet të jetë citati i Leninit, domethënë çështjen ta trajtojmë në një kuadër më të gjerë, parimor.

— Të gjenden e të përdoren episode të tmerrshme që popujt i kanë pësuar mbi kurriz.

— Të gjitha komunikatat dhe deklaratat e gjithë shteteve imperialiste, borgjeze, socialimperialiste janë false, gënjejnë popujt.

— Të gjithë mbarojnë me formula mirëdashëse, kurse në brendi ata janë ujë që kurdisin komplete dhe grinden në kurriz të popujve.

— Në qoftë se popujt e botës, dhe, në radhë të parë, proletariati botëror, do të gënjehej nga të tilla deklaratat, nga të tilla takime, nga të tilla diskutime të fshehta, do të gjendemi përpara katastrofës bërthamore dhe këtë katastrofë nuk e ndalon asnjë nga krerët e imperializmit dhe të socialimperializmit, por vetëm popujt dhe proletariati botëror.

— Populli shqiptar mendon se ka ardhur dhe po ka-

lon koha që të gjithë të ngrenë krye kundër këtij komploti e shantazhi të tmerrshëm, që shkaktoi në të kaluarën luftëra botërore, që shkaktoi më vonë luftën në Kore, në Vietnam dhe tani në Lindjen e Mesme dhe që nesër do t'i vërë zjarrin gjithë botës.

— Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët mbajnë armët atomike dhe me këto kërcënojnë botën. Atë e kanë edhe Anglia, Franca dhe Kina. Ne dhe popujt e tjerë duhet të jemi plotësisht me propozimin kinez për çarmatimin (të shënohet konkretisht cili dokument është ky, është deklarata e Kinës), çdo propozim tjetër për çarmatimin është bluf, është gënjeshtër.

— Do të ketë njerëz që do të na akuzojnë si satelitë të Kinës, sepse mbrojmë tezën kineze. Neve nuk na pri-shet puna, aq na bën, pse ne jemi revolucionarë, luftojmë për çështjen e drejtë të popujve dhe jemi miq me të gjithë ata që luftojnë për këtë çështje të drejtë.

Satelitë janë ata që shiten për ca grosh, që venë në Uashington dhe shesin atdheun e tyre, që kanë paturpësinë të bëjnë deklaratat, me të cilat tregojnë haptazi se e kanë vënë atdheun e tyre në ankand, nën thundrën e imperializmit amerikan. Dhe këta e gënjejnë botën dhe vetëquhen komunistë. Këta janë tradhtarë të komunizmit dhe të popujve të tyre.

— Ka të tjerë që hiqen si komunistë, por që me kohë u ka dalë boja. Por imperializmi dhe socialimperializmi i kanë pompuar e zgjedhur ata me sitë të turpshme si dallaveraxhinj që vetë, me emisarë të tyre, lidhin e zgjidhin intriga në kurriz të popujve dhe këtë e bëjnë sepse e kanë ndërgjegjen të korrumpuar. Për këta ideal janë dollari dhe rubla.

— Popujt nuk u besojnë të tillë njerëzve dhe as diplomatëve e kancelarive të tjera që përplasen tek ata për të rregulluar gjoja punën e njerit ose të tjetrit.

— Sidoqoftë në këtë mjegull të tmerrshme, të gjithë

këta diplomatë janë disa ermite krimbash të rrezikshëm që mbulohen me parulla e formula false dhe gërryejnë jetën e popujve.

— Popujt e botës dhe proletariati botëror do ta pranojnë këtë situatë? Në qoftë se do ta pranojnë, ata kanë pranuar vdekjen. Por popujt dhe proletariati botëror nuk e pranojnë vdekjen pa luftë, ata e dinë se vetëm me luftë shtypen këta krimba.

— Populli shqiptar, që kur lindi Partia dhe shteti i tij socialist (popullor), është futur në polemikë me shtete dhe me njerëz të tillë dhe këtë luftë ai do ta vazhdojë me ashpërsi, pa pasur frikë as nga shantazhet, as nga ndërhyrjet e armatosura.

— Të gjithë ata që do të guxojnë të bëjnë hapa ose veprime të tilla të jenë të sigurt se do ta kenë vështirë me popullin shqiptar, se ne nuk jemi vetëm dhe për këtë që themi, për këtë që mendojmë e luftojmë ne, mendojnë e luftojnë me qindra milionë njerëz në botë.

E SHTUNË
15 DHJETOR 1973

DIPLOMACIA E FSHEHTË E DY SUPERFUQIVE — RREZIK I MADH PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E POPUJVE

Pashë përfundimisht artikullin «Mbi diplomacinë e fshehtë». Iu dërgua «Zërit të popullit» që ta botojë nesër me titullin: «Diplomacia e fshehtë e të dyja superfuqive — rrezik i madh për lirinë e pavarësinë e popujve»¹. Tezatat e këtij artikulli i kisha shkruar që nga fillimi i këtij muaji.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 490.



— THE UNIVERSITY OF CHICAGO PRESS —

... the ... of ...

1974



TË DEMASKOHEM KOMPLOTET E REVIZIONISTËVE

Teza për artikull

Lexova artikullin që është shkruar për gazetën «Zëri i popullit» lidhur me një mbledhje të re që përgatitin revizionistët për të sulmuar Kinën dhe Shqipërinë. Nuk më pëlqeu. Hartova këto teza për një artikull të ri¹.

— Revizionistët duan të përsëritin Bukureshtin dhe Moskën, pra të bëjnë një mbledhje kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ata duan që në mbledhje të dënojnë Partinë Komuniste të Kinës dhe Partinë e Punës të Shqipërisë sikur këto gjoja kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin. Për këtë do të sjellin «fakte» të rreme, veçanërisht kundër Kinës.

Ne duhet të demaskojmë tezat e tyre teorike anti-marksiste, për të treguar se ata nuk janë marksistë-leninistë, por tradhtarë të komunizmit.

(Vetëm pasi të jetë bërë kjo, mund të vihen pjesët me karakter demaskues politik të artikullit që është përgatitur).

Ç'mund të demaskohet?

— Që kur vdiq Stalini, t'u thuhet revizionistëve sovjetikë, ju filluat luftën kundër marksizëm-leninizmit e

¹ Është fjala për artikullin e botuar në gazetën «Zëri i popullit», 14 shkurt 1974.

komunizmit, hapur dolët në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960. Dëshët ta bënit këtë që në Bukuresht, pra pa vajtur në Moskë, duke goditur e dënuar Partinë Komuniste të Kinës, por s'u eci dhe për këtë ka meritë Partia e Punës e Shqipërisë, që luftoi me vendosmëri e sabotoi planet tuaja.

Që atëherë ju keni pushuar së qeni marksistë-leninistë.

— Partitë revizioniste nuk kanë më asgjë komuniste, marksiste-leniniste. Vetëm emri u ka mbetur i tillë.

— Brenda e tyre është antimarksiste, ashtu siç është edhe ndërtimi i tyre organizativ. Asgjë marksiste-leniniste nuk ka mbetur. Edhe ndërtimi i Partisë, edhe funksionimi i organizatës nuk kanë asgjë leniniste. Rrënjët e tyre janë mbi ujë.

— Por këtë nuk e pohojnë dot. Kanë frikë, por u duhet edhe për të mashtruar. Fshihen nën emrin e Leninit, përfitojnë që Lenini është rus e bolshevik i madh.

— Por Lenini është rus aq sa janë gjermanë Marksi e Engelsi. Pretendimi i revizionistëve të Moskës se janë leninistë, se Rusia është atdheu i leninizmit është fals. Qendra revolucionare botërore s'është më atje, ajo tani ka kaluar në ato vende e parti, ku në realitet mbrohet leninizmi e luftohet për triumfin e ideve të Leninit.

— Pas Kongresit të 20-të të gjitha partitë revizioniste që ndjekin sovjetikët (bashkë me vetë partinë sovjetike) janë futur në rrugën e tradhtisë e janë shndërruar në parti si ato të Internacionales së Dytë, kundër të cilave luftoi Lenini. Ky filloi luftën për krijimin e partive të vërteta komuniste revolucionare, duke gjallëruar kështu revolucionin botëror.

— Të gjitha partitë revizioniste kanë braktisur normat leniniste të partisë.

— PK Italiane prej kohësh nuk u mëson «komunistëve» (anëtarëve të saj) marksizëm-leninizmin.

Ajo, ashtu si vetë sovjetikët, ka adoptuar tezat e borgjezisë monopoliste të vendit, bashkekzistencën paqësore, rrugën paqësore, demokracinë parlamentare etj., që përbëjnë shtrembërimin tipik të mësimëve të Leninit, pavarësisht se revizionistët këto teza i shesin si «leniniste».

— Partia Komuniste Italiane ka deklaruar me kohë se është gati të bashkohet me të gjithë, edhe me demokristianët, gjoja për të arritur socializmin. Ajo kështu zhduk çdo kufi klasor.

Mund të përdoret edhe teza aktuale mbi të ashtuquajturin «kompromis historik».

— PK Franceze menjëherë pas Kongresit të 20-të dha disa shenja sikur nuk ishte dakord as me tezat e Hrushovit, as me pikëpamjet toliatiste. Por më pas u gjunjëzua.

Tani PK Franceze s'ka asgjë komuniste. Anëtarët e saj kanë vetëm taserën «komuniste» dhe detyrën të shesin gazetën «L'Humanité». Por edhe kjo po shitet më shumë në kiosket e borgjezisë, kurse organizatat-bazë nuk mblidhen.

— Leninizëm këto parti quajnë atë çka shkruajnë gazetat e tyre, atë politikë që propagandojnë e ndjekin ato. Këtë gjendje e shkaktoi Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, tradhtia e hrushovianëve.

— Të gjitha partitë revizioniste, me atë sovjetike në krye, janë mbushur me spiunë e agjentë, pa folur se në vendet revizioniste këta kanë depërtuar edhe në organet e pushtetit.

— Ju revizionistët sovjetikë keni ardhur në rrugën e titizmit, që likuidoi PK të Jugosllavisë dhe u hapi dyert spiunëve të të gjitha ngjyrave. U zhduk roli udhëheqës i saj dhe iu caktua tjetër rol. Më kot Titoja përpiqet të kthehet në normat e vjetra. Kjo s'bëhet dot. Edhe ju s'ktheheni dot. Megjithatë një ditë kjo do të ndodhë, ne

kemi bindje, por këtë do ta bëjnë proletarët e revolucionarët sovjetikë, pasi t'ju kenë zhdukur përfundimisht ju.

— Kësaj ju i trembeni, prandaj edhe nxitoni të bëni mbledhje për ta paraqitur veten «si komunistë», «leninistë».

— Rruga e Partisë së Punës të Shqipërisë, në të kundërtën, është marksiste-leniniste, revolucionare.

(Këtu të zhvillohet ideja që Partia e Punës e Shqipërisë zbaton me besnikëri mësimet dhe normat leniniste, të cilat kanë sjellë këtë gjendje revolucionare etj., etj. Pra, të kundërtën e asaj që ka ndodhur në partitë revizioniste).

— Ju doni të na akuzoni ne, sikur veprokemi shtrembër, kurse e vërteta është se ju jeni lidhur me imperializmin, se ju e të gjithë ata që ju vijnë pas, po luani rolin e shërbëtorëve të borgjezisë, pikërisht si dikur partitë socialdemokrate.

— Ju përpiqeni ta paraqitni veten të fortë, por jeni të krimbur, të përçarë. Dhe kjo përçarje nuk duket vetëm në udhëheqje, por edhe poshtë. Dhe s'ka si të jetë ndryshe, duke qenë tradhtarë ju nuk mund të keni unitet. Është absolute ekzistenca e rrymave, e tendencave dhe e grupeve të ndryshme. Kjo shprehet edhe në popull. Pikërisht si në vendet borgjeze.

Vetëm se te ju nuk bëhen ndryshime të bujshme, siç bëhen në vendet klasike borgjeze, ku ndërrohen qeveritë njëra pas tjetrës. Ju keni një atë të vlefshme që e shfrytëzoni: gënjeni popullin akoma me emrin e bolshevizmit. Kjo mungesë stabiliteti është karakteristike edhe për Bullgarinë, Poloninë, Çekoslovakinë etj., të cilat ju i mbani nën fre dhe po i detyroni.

— Ju jepni urdhra që të eliminohen kudo ata njerëz që s'u duhen më, për t'i zëvendësuar me njerëz më besnikë të Moskës.

— Por këto vende qëndrojnë me ju, sepse janë lidhur me shumë zinxhirë në sistemin tuaj drejtpërdrejt. Në të

vërtetë ata e urrejnë komunizmin, por ju urrejnë edhe ju. Ata duan të shkëputen nga ju, jo për të ndjekur rrugën m-l, por për t'u lidhur me imperializmin amerikan.

— Këto vende ju përpiqeni t'i integroni gjithnjë e më fort.

— Ekonomikisht janë të varur nga ju.

— Sigurimi juaj punon si në shtëpi të vet në këto vende.

— Atje ushtritë tuaja janë ulur këmbëkryq, veç agjentëve të shumtë që keni.

(Duhet përdorur të gjitha të dhënat që kemi në këto drejtime).

— Berlingueri i Italisë çdo ditë përsërit thirrjen tashmë të vjetruar për krijimin e «një Evrope Perëndimore demokratike të pavarur e pacifiste, e cila duhet të jetë as antisovjetike, as antiamerikane». Kjo është tradhtia më e madhe.

— Ç'bën Partia e Punës e Shqipërisë? Luftë në të dyja anët. (Këtu të flasim për vijën tonë kundër imperializmit e revizionizmit.) Kjo vijë ka fituar simpati dhe shikohet me respekt nga miliona njerëz në botë.

— Ju kërkoni unitet, por ky nuk mund të arrihet kurrë në gjirin e revizionistëve. As kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, as kundër partive të tjera marksiste-leniniste s'i ngrini dot klikat e ndryshme që do të vijnë në mbledhjen tuaj, sepse po «të bashkohen ato me ju për të na dënuar ne, Kinën e Shqipërinë», me siguri do të gjenden para një kundërshtimi të rreptë të vetë anëtarëve të tyre dhe veçanërisht të punëtorëve e popujve të tyre. Ky do të ishte shkatërrim për ta. Dhe këtë shkatërrim s'e duan revizionistët.

— Por ju mbledhjen e doni edhe për të aprovuar platformën tuaj politike, socialimperialiste.

(Këtu duhet vënë pjesa e artikullit që është përgatitur dhe që demaskon këtë qëllim të revizionistëve).

— Revizionistët e ndryshëm duket se do të jenë prudentë, sepse nuk u leverdis që t'ju ndjekin qorrazi. Në të vërtetë ju (revizionistët sovjetikë) do të izoloheni jo më nga popujt e revolucionarët, prej të cilëve jeni izoluar me kohë, por edhe nga miqtë tuaj. Shenjat po duken. Në shembullin e Bukureshtit, nën pretekstin e bisedimeve të disa problemeve që i dalin një reviste teorike, ju thirrret në Pragë një mbledhje tjetër. Por edhe aty hasët në pengesa.

— Para kësaj situatë e para disfatës që do të pësojë revizionizmi, mund të ndodhin ndryshime në udhëheqjen sovjetike. Por, kushdo që të likuidohet dhe kushdo që të marrë forcat në dorë, prapë kjo nuk ndryshon gjë. Është qërim llogarish midis revizionistëve.

— Ai që do t'i qërojë hesapet me ju, në rrugë të drejtë, do të jetë revolucioni, klasa punëtore, marksizëm-leninizmi, që patjetër do të fitojë.

— Për sa u përket Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste kjo mbledhje e tradhtarëve do t'i ndihmojë që të shtojnë e të forcojnë më tej luftën e tyre revolucionare. Me siguri lëvizja marksiste-leniniste do të marrë një hov të paparë, të madh, sepse kjo mbledhje edhe një herë do t'i demaskojë revizionistët si antimarksistë e armiq të betuar të komunizmit. Me këtë mbledhje ata hedhin një hap drejt likuidimit të vetvetes.

— Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë marksistë-leninistët e revolucionarët do të vazhdojnë luftën e tyre revolucionare marksiste-leniniste.

2. BUKURESTI
18 SHKURT 1974

E ENJTE
31 JANAR 1974

NË VENDIN TONË VJEN NJË DELEGACION I «AL FATAHUT»

Sot në vendin tonë vjen një delegacion i miqësisë i lëvizjes nacionalçlirimtare palestineze «Al Fatah».

**MBLEDHJA E PARTIVE REVIZIONISTE — NJË
MBLEDHJE KUNDËR REVOLUCIONIT
DHE KOMUNIZMIT**

Nesër në gazetën «Zëri i popullit» do të botohet artikulli me titull: «Mbledhja e partive revizioniste — një mbledhje kundër revolucionit dhe komunizmit»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 502.

**PALESTINEZËT DUHET TË VAZHDOJNË LUFTËN
E TYRE**

Sot u vura në dijeni për bisedimet që shokët tanë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore patën me delegacionin palestinez të «Al Fatahut». Bisedimet kanë qenë të përzemërta. Palestinezët bënë disa kërkesa ushtarake, por unë i pata porositur shokët më parë që t'u përgjigjeshin se këto çështje do t'i shikojmë më vonë.

Palestinezët duhet të vazhdojnë të luftojnë pareshur dhe në kushte shumë të vështira, për shumë arsye:

Ata, megjithëse luftojnë për një çështje të përbashkët, janë të përçarë. Natyrisht korrentet e ndryshme që ekzistojnë në gjirin e tyre nuk arrijnë të koordinojnë as programin e tyre minimal të përbashkët për këtë luftë dhe për qëllimet e saj. Programi i tyre, me sa dëgjojmë, se asgjë të botuar nuk kanë, është çlirimi i Palestinës nga çifutët. Po çifutët dhe shteti i Izraelit ç'do të bëhen?

Aktualisht palestinezët luftojnë nga tokat e të tjerëve, derisa këta të tjerë janë në luftë me Izraelin. Megjithëkëtë, edhe tash, ata nuk luftojnë dot si duhet dhe si duan. Duhet t'i nënshtrohen politikës së shtetit arab, nga territori i të cilit veprojnë. Por kur këto shtete arabe do ta pushojnë luftën kundër Izraelit, dhe me siguri që do ta pushojnë si Egjipti, edhe Siria, ç'do të bëjnë palestinezët? Perspektivë e errët dhe luftë e vështirë, që duhet të vazhdohet në kushte të reja.

U NIS PËR NË KINË NJË DELEGACION I MINISTRISË SË NDËRTIMIT

Sot u nis për në Kinë një delegacion i Ministrisë së Ndërtimit, i kryesuar nga Rahman Hanku¹. Do të bisedojë me kinezët çështje që kanë të bëjnë me ndërtimin e hidrocentraleve.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

1 Në atë kohë ministër i Ndërtimit.

SHËNIM I MINISTRI I PËRBAKËRIT E JEGOSLLAVËVE DHE I PËRBAKËRIT E JEGOSLLAVËVE DHE

Bisedova me shokët për vajtjen e delegacionit tonë në Kinë. Të pranohet kohën që kërkojnë kinezët.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

Delegacioni i kryesuar nga Rahman Hanku do të bisedojë me kinezët për ndërtimin e hidrocentraleve në Kinë.

E MARTË
12 MARS 1974

HIDROCENTRALI I FIERZËS DHE POZITA E PËRBASHKËT E JUGOSLLAVËVE DHE E KINEZËVE

U takova me shokët Haki Toska dhe Petro Dode, nga të cilët kërkoja sqarime të mëtejshme për çështjen e hidrocentralit të Fierzës. Interesant është se vërejtjet dhe pengesat që po nxjerr tani pala kineze, i kishte ngritur tamam kështu pala jugosllave në një bisedë që kishte pasur me komisionin mikst shqiptaro-jugosllav për problemin e ujërave. Me siguri jugosllavët duhet t'ua kenë futur ato në vesh kinezëve. Do të luftojmë për t'ua rrëzuar kinezëve pretendimet e tyre pa baza.

E PREMTE
15 MARS 1974

SHËNIM

Me shokët Haki Toska dhe Spiro Koleka bisedova se në ç'mënyrë duhet t'i udhëzojnë shokët tanë të grupit të punës së metalurgjisë, të cilët ndodhen në Pekin, për të trajtuar me kinezët problemet që duhet të zgjidhen në situatat e krijuara.

E HËNE
18 MARS 1974

SHENIM

Pas katër ditësh Spiro Koleka më dërgoi kopjen e telegramit që i duhej drejtuar nga ana e tij, grupit tonë të punës së metalurgjisë, të cilin duhej t'ia kishte dërguar tri ditë më parë. E këshillova të mos e dërgonte më atë tekst, pse ngjarjet precipituan. Telegrami nuk bënte më efektin e kërkuar, pse Li Hsien Nieni ka ndërhyrë në favorin e tezave tona.

E MARTE
19 MARS 1974

SHENIM

Me Adilin hartuam një telegram të ri për shokët e grupit të punës së metalurgjisë në Pekin, duke iu përshatur kushteve të reja.

RRETH PROBLEMEVE GJEOLOGJIKE NË FIERZË NGRITUR NGA KINEZËT

Hakiu më raportoi për bisedën që pati me sekretarin e komitetit të Partisë të kantierit të hidrocentralit të Fierzës. Ai tha se atje po punohet me entuziazëm, se inxhinierët tanë janë të qartë për të gjitha çështjet. Asnjë dyshim nuk kanë ata për problemet gjeologjike dhe për këto probleme dëgjuan për herë të parë, kur një shok kinez ia ngriti shokut Rita, kur shkoi në Fierzë.

BISEDË E AMBASADORIT KINEZ ME SHOKUN RAMIZ ALIA

Ramizi më tha se i kishte vajtur ambasadori kinez dhe nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës i kishte thënë se marrin përsipër të shtypin në katër gjuhë tri vëllime të veprave të zgjedhura nga të miat.

Duke i treguar për sesionin e posaçëm të Asamblesës së Përgjithshme të OKB-së, të propozuar nga Algjeria, i kishte thënë, gjithashtu, se në këtë mbledhje do të shkojë Ten Hsiao Pini, për të cilin Maoja ka thënë se është një nga kundërshtarët më të rreptë të revizionistëve sovjetikë.

PËRSE NUK DUAN KINEZËT QË NE TË NDËRTOJMË HIDROCENTRALIN E FIERZËS?!

Përse udhëheqja kineze e trajton në mënyrë të gabuar, dhe bile mund të themi armiqësore, çështjen e madhe për ne të hidrocentralit të Fierzës? Ashtu siç e kanë shtruar specialistët kinezë problemin, haptazi po na thonë se duhet hequr dorë nga ndërtimi i këtij hidrocentrali. Po pse? Vallë «çështje mungese studimi gjeologjik»?! Nuk është e vërtetë! Këto studime janë bërë dhe janë gjetur të plota edhe nga ata, dhe për to kemi nënshkruar dokumentin e përbashkët. Atëherë?!!

Të jetë kjo një punë armiqësore e disa specialistëve kinezë, që ia kanë raportuar çështjen gabim udhëheqjes së tyre, e cila ka arritur t'u thotë: «Keni të drejtë, duhet të mënjanojmë një katastrofë të mundshme». Kjo tezë ka mundësi të qëndrojë, sepse po kjo zëvendësministre kineze e Energjetikës mbrojti dikur tezën se «Hidrocentrali i Vaut të Dejës do të ishte një katastrofë». Ne ia kundërshtuam, hidrocentrali u ndërtua. Çu En Lai deklaroi se specialistët kinezë e kishin gabim, ndërsa specialistët shqiptarë kishin të drejtë. Hidrocentrali i Vaut të Dejës është shëndoshë e mirë.

Le të shpresojmë që edhe për hidrocentralin e Fierzës të ngjasë kështu. Të shohim si do të pritet ekspozoja që Rahman Hanku do t'i bëjë ministrit kinez të Energjetikës. Në qoftë se edhe këtu do të ngulin këmbë në

pikëpamjen e tyre të gabuar, ne do të trokasim më lart, derisa të realizohet çështja jonë e drejtë.

Rahman Hanku na lajmëron nga Pekini se udhëheqja e specialistëve kinezë për hidrocentralin e Fierzës lajmëroi Petrit Radovickën se «specialistët kinezë nuk tërhiqen nga pozitat e tyre». Me fjalë të tjera kjo do të thotë që hidrocentrali të mos ndërtohet. Radovicka iu përgjigj se edhe specialistët tanë nuk tërhiqen, pse ne kemi të drejtë. Rahmani do të kërkojë takim me ministrin përkatës kinez dhe këtij do t'i paraqitë çështjen sipas udhëzimeve që i kemi dhënë.

UDHËZIME PËR BISEDIMET ME SHOKËT SPANJOLLE

Shoku Ramiz më informoi se do të vijë një delegacion i Partisë Komuniste (m-l) të Spanjës.

I thashë që, në rast se ata shtrojnë çështjen e kontraktave që kanë me Kinën, e cila vendosi marrëdhënie diplomatike me qeverinë e Frankos, t'u thotë se «këto janë marrëdhënie shtetërore», prandaj për kontraktat që kanë, le të bisedojnë shoqërisht me kinezët. Në thënjën «po ju pse nuk vendosni marrëdhënie diplomatike me Spanjën», t'u sqarohet që «ne nuk lidhim marrëdhënie, se Frankoja dhe qeveria e tij janë fashistë».

Mosmarrëveshjet me Zhyrkenë t'u thuhet që t'i zgjidhin në mes tyre.

SHËNIMI

Ministrisë së Punëve të Jashtme i bëra një sërë vërejtjesh për fjalimin që do të mbahet në mbledhjen e OKB-së, që do të bëhet nga data 8 e këtij muaji, sipas kërkesës së Algjerisë. Ne do t'i mbështetim algjerianët dhe do të demaskojmë dy superfuqitë dhe manovrat e tyre.

Ministrisë së Punëve të Jashtme i bëra një sërë vërejtjesh për fjalimin që do të mbahet në mbledhjen e OKB-së, që do të bëhet nga data 8 e këtij muaji, sipas kërkesës së Algjerisë. Ne do t'i mbështetim algjerianët dhe do të demaskojmë dy superfuqitë dhe manovrat e tyre.

PRITJE JO E MIRË NGA KINEZËT

Rahman Hanku, që ndodhet në Pekin në krye të delegacionit të Ministrisë së Ndërtimit, mori takim me ministrin kinez të Ekonomisë Ujore dhe të Energjetikës. Ai ia shtroi çështjen për problemet inxhiniero-gjeologjike që kanë ngritur kohët e fundit specialistët kinezë dhe disa probleme të tjera teknike dhe kinezi për «tri herë rresht» si përgjigje i tha: «Ribisedoni me shoqen zëvendësministre» dhe u ngrit e u largua. Pritje jo e mirë. S'kanë argumente dhe duan ta lënë çështjen në këtë nivel, derisa ne «të humbasim durimin». E lajmëruam Rahmanin që të ribisedojnë specialistët midis tyre dhe, në rast se specialistët kinezë nuk lëvizin nga pozitat e veta, atëherë këndej ne të kërkojmë që specialistët e të dyja palëve të raportojnë përpara dy ministrave, pastaj shohim e bëjmë.

«FURTUNA» PËR FIERZËN PËRFUNDOI ME TURPIN E KINEZËVE

«Furtuna» që ngritën shokët kinezë për hidrocentralin e Fierzës mbaroi në një «gotë ujë». E gjithë çështja ishte që të krijonin një situatë për të na thënë: «Merreni ju përgjegjësinë e projektimit të hidrocentralit dhe ne do t'ju ndihmojmë me çdo gjë si edhe më parë». Kinezët kishin frikë nga përgjegjësia. Ne u thamë se jemi dakord, e marrim ne përgjegjësinë, dhe me këtë çdo gjë u zhblokua. Por mendoj se specialistët kinezë janë influencuar (se si, nuk e dimë) edhe nga jugosllavët, të cilët kanë ngritur para njerëzve tanë po të njëjtat çështje dhe në të njëjtën formë e përmbajtje për hidrocentralin e Fierzës. Natyrisht, titistëve u leverdiste shumë që hidrocentrali të bllokohej, pse një gjë e tillë do të shkaktonte vështirësi politike në mes Kinës dhe nesh dhe ne do të na dëmtonte ekonomikisht. Por çdo gjë u likuidua. Kinezët morën mbi vete turpin që kanë frikë nga përgjegjësia, dhe këtë e nënshkruan në dokumentin zyrtar. Ata qofshin!!

**NJË DELEGACION I FRONTIT TË BASHKUAR
KOMBËTAR TË KAMBOXHIAS VJEN
NË VENDIN TONË**

Sot vjen në vendin tonë, për vizitë zyrtare e miqësore, një delegacion i Frontit të Bashkuar Kombëtar të Kamboxhias dhe i Qeverisë Mbretërore të Bashkimit Kombëtar të Kamboxhias.

TAKIM ME KIEU SAMFANIN

Sot në selinë e KQ të Partisë prita Kieu Samfanin¹, kryetarin e delegacionit zyrtar të Kamboxhias, që ka ardhur për vizitë zyrtare e miqësore te ne, si dhe anëtarët e delegacionit. Shokët kamboxhianë më vunë në dijeni për gjendjen e luftës së tyre dhe për perspektivat e mira për fitore. U fola edhe unë për besimin e madh që kemi në fitoren e tyre, u thashë se mbështetja jonë për luftën e tyre edhe në të ardhmen do të jetë si kurdoherë e plotë dhe e pakursyer. Duke marrë parasysh se në delegacionin e tyre ishte dhe Sarin Çaku, ministër i Jashtëm dhe njeri i besuar i Sihanukut, i përmenda disa gjëra që i kisha thënë Sihanukut në drejtimin që të qëndrojë i bashkuar me shokët kamboxhianë në front dhe të mos hyjë në bisedime me tratativa kompromisi me amerikanët, me sovjetikët dhe me lonolistët. Shokët e Partisë Komuniste të Kamboxhias janë të vendosur për të mos bërë asnjë kompromis dhe deklaruan se do të glirohen duke luftuar. Verivietnamezët kamboxhianëve u vonojnë armët që u jep Kina, kështu që këta kanë vështirësi, po do t'i kalojnë. Ata thanë se do ta sulmojnë

¹ Në atë kohë, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Frontit të Bashkuar Kombëtar të Kamboxhias, zëvendëskryeministër e ministër i Mbrojtjes Kombëtare të Qeverisë Mbretërore të Bashkimit Kombëtar të Kamboxhias dhe kryekomandant i Forcave të Armatosura të Çlirimit Kombëtar të Kamboxhias.

kryeqytetin vitin e ardhshëm, pse tani për tani u mungojnë armët e rënda, me të cilat Lon Noli i rrethuar, është i armatosur mirë dhe i barrikaduar.

Përshtypja ime për Samfanin ishte e mirë. Ai duket i vendosur dhe i mprehtë. I njoftova se kemi vendosur t'i dekorojmë me urdhrat tanë më të lartë. U erdhi mirë dhe e meritojnë.

1 PRILL
1974

E PREMTE
26 PRILL 1974

MIQTË KAMBOXHIANË U LARGUAN NGA VENDI YNË

Dje pasdite, pas përfundimit të bisedimeve zyrtare, u nënshkrua deklarata e përbashkët shqiptaro-kamboxhiane. Po dje pasdite anëtarëve të delegacionit iu dorëzuan urdhrat e lartë të RPSH, me të cilët Presidiumi i Kuvendit Popullor i dekoroi.

Sot delegacioni u largua nga vendi ynë i përcjellë me nderime dhe me popull.

TEN HSIAO PINIT PO I BËHET REKLAMË E MADHE

Agjencitë e huaja të lajmeve flasin vazhdimisht për «largimin» e Çu En Lait nga drejtimi i shtetit dhe thonë se ai po zëvendësohet nga Ten Hsiao Pini. Ato në këto raste bëjnë shumë spekulime, se gjoja ai «dështoi në politikën e tij proamerikane», gjoja «për liberalizmin dhe oportunitetin e tij në vijë» etj. Agjencitë borgjezo-kapitaliste të lajmeve, gjithashtu thonë se janë vënë dacibabo në muret e disa uzinave, ku Çu En Lai cilësohet si «sahanlëpirës i të huajve» etj. Natyrisht, për të tilla gjëra gjithnjë kanë spekuluar armiqtë e Kinës socialiste.

Në realitet ç'po ndodh? Me aq sa dimë ne dhe ç'na kanë thënë shokët kinezë, fakt është se Çuja është shumë i lodhur nga puna e madhe që ka kryer, sidomos për moshën e tij të kaluar. Fakt është po ashtu se ai kishte monopolizuar punën në marrëdhëniet me botën e jashtme, saqë nuk linte njeri të huaj të largohej nga Kina pa e takuar dhe pa biseduar me të, pa pritur dhe pa përcjellë në aerodrom, dhe deri në darka e në dreka, të gjithë vizitorët, që nga kryetarët e shteteve deri te senatorët amerikanë, shkencëtarë, gazetarë e pingpongistë, me një fjalë «derrin dhe dosën». Kjo ishte jo vetëm e tepruar, po edhe e dëmshme për prestigjin e Kinës. Prandaj Li Hsien Nieni, Ten Hsiao Pini etj., na thanë se është marrë vendim që Çuja të çlodhet dhe të heqë dorë nga të gjitha

çështjet protokollare. Këtë po e zbatojnë, dhe në realitet Ten Hsiao Pini po e zëvendëson në këtë drejtim.

Li Hsien Nieni, në një bisedë që pati me ambasadorin tonë, në lidhje me lodhjen e Çusë lëshoi edhe këtë frazë: «Kur plaken kuadrot gabojnë edhe ideologjikisht». Ç'donte të thoshte ai me këtë?

Faktet tregojnë se Ten Hsiao Pini po flet më hapur kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si në OKB ashtu edhe gjetkë. Sipas agjencive të lajmeve, kinezët e mbyllën një klub që amerikanët kishin hapur në Pekin për fëmijët e diplomatëve të ndryshëm; po ashtu kërkuan që rojet ushtarake të marinës, që ruajnë misionin amerikan, të kthehen në civilë. Siç duket, këto gjëra ishin lejuar më parë, në kohën e «muajit të mjaltit» me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tash, pas «eksperiencës», duhet të ketë «deziluzione» në këtë vijë dhe kjo është shtrënguar kundër amerikanëve. Kjo na pëlqen. Mundet të jetë një kthesë e re, të cilën e bëjnë me njerëz të riardhur në fuqi, një nga të cilët është Ten Hsiao Pini. Por, nga sa mund të gjykojmë tash, Çuja nuk është «skartuar», siç thonë agjencitë e Perëndimit. Në fakt, ai është i lodhur, por drejton, veçse me forma dhe me metoda të reja. Mundet që atë ta destinojnë dhe për president të presidiumit, në rast se mbledhin Asamblenë.

Fakt është se Ten Hsiao Pini po i bëjnë reklamë të madhe, po i përgatitin një kolltuk. Dje ambasadori kinez Liu, dorëzoi zyrtarisht në Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme një tog të madh me «fotografi reklamë» të ardhura nga Pekini në të cilat tregohet se po «triumfon» Teni, të cilin e presin dhe e përcjellin me pompë të madhe për në OKB, tregohet kur pret burrat e shtetit etj. Kurse një gjë të tillë në këtë mënyrë nuk e kishin bërë për Çunë, bile as edhe për Maon. Ambasadori kinez këtu, me këdo që takohet, nuk lodhet së foluri për Tenin dhe së mburruri atë. Kjo është direktivë dhe nuk bëhet pa qëllime. Këto do t'i shohim më qartë më vonë.

E DIEL

26 MAJ 1974*

KINEZËT E SHTYNË PËRSËRI VIZITËN E DELEGACIONIT TË PARTISË E TË QEVERISË SONË

Kinezët, me anën e Li Hsien Nienit, nëpërmjet ambasadorit tonë, na lajmëruan se delegacionin e Partisë dhe të Qeverisë sonë nuk e presin dot sivjet në gjashtëmujorin e dytë, po e shtynë vizitën e tij për gjashtëmujorin e parë të vitit 1975. Ne, natyrisht, e pranojmë këtë, por, po të ishim ne, një gjë të tillë nuk do ta bënim. Ne e bëmë këtë kërkesë gati një vit më parë dhe ata na e shtynë për këtë vit. Kërkuam që vizita të bëhej në gjashtëmujorin e parë të 1974-ës, kinezët na thanë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 1974, për arsye se kalendari i tyre i pritjeve ishte i ngarkuar. Kjo kishte mundësi dhe mund të ishte normale, kurse shtyrja e dytë tash nuk është normale. Cilat janë arsyet? S'ka më baza. Kup-toji si të duash! Bëj një mijë supozime!

Ja ç'tha Li Hsien Nieni në thelb: «Të na kuptoni, e kemi marrë në shqyrtim, veçanërisht, kërkesën tuaj, e kemi studiuar seriozisht dhe, vitin e ardhshëm, duke pasur parasysh situatat e brendshme e të jashtme, do të jemi më të përgatitur për të pritur delegacionin tuaj. Do t'ju kënaqim vitin tjetër më mirë. Aktualisht jemi të zënë me fushatën kundër Lin Biaos dhe Konfucit» etj.

Këto «arsye» të çuditin. Arsyet janë këto?! Në qoftë se kanë ndonjë gjë tjetër, qoftë në situatën e brendshme

apo të jashtme, atë edhe mund të na e thonë. Ne mund të bëjmë plot supozime, por më mirë të presim dhe do të shohim.

Ta shtyjnë vallë pritjen e delegacionit tonë, sepse kanë kontradikta me ne?! Kontradikta ne kemi e do të kemi edhe vitin tjetër, por këto kontradikta kanë qenë të brendshme dhe s'ka sepse të pengojnë vajtjen e delegacioneve tona. Këto kontradikta që ekzistojnë midis nesh, nuk janë bërë publike, por publiku ka nxjerrë konkluzionet e veta, si për shembull, nga qëndrimi ynë kundër imperializmit amerikan. Mirëpo jeta tregon se kinezët, me politikën e hapjes së portave ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pësuan deziluzione. Amerikanët, pas këtij qëndrimi të ri kinez ndaj tyre, duhet të kishin shkuar duke i dobësuar lidhjet me Tajvanin, por, në të kundërtën, ata dërguan atje një ambasador të ri, bile një ish-zëvendëssekretar shteti. Prandaj në analizën që kinezët mund t'u bëjnë kontradiktave që kemi pasur ne me ta, duhet të dalin në përfundimin (veç në mos daçin), se ne kemi pasur e kemi të drejtë. Prandaj mendoj se nuk mund të përjashtohet fakti që shokët kinezë vajtjen e delegacionit tonë e shtyjnë për të mos u ballafaquar me ne, se do t'u duhej të bënin autokritikë para nesh.

Ne kemi pasur debate edhe për çështje teknike të realizimit të veprave me kredi, por ato me diskutime shoqërore janë sheshuar. Në fushatat kundër armiqve të partisë dhe të shtetit të Kinës, ne i kemi përkrahur ata. Këtë e pohojnë hapur edhe vetë. Prandaj në këto drejtime nuk gjen asnjë arsye për të shpjeguar këtë qëndrim të shokëve kinezë.

Atëherë duhet të imagjinojmë arsye të brendshme? Cilat mund të jenë këto? Supozime: «Çu En Lai është i lodhur», «Çu En Lai është i sëmurë». Ai është tërhequr. Po sa është tërhequr dhe në se është tërhequr?! Ka, lidhur me të, ndonjë problem politik? A do të jetë më

kryeministër apo do ta zëvendësojnë me Ten Hsiao Pinin, që po e pompojnë? Ç'do të bëhet Çuja? Mund të bëhet dhe president i republikës. Atëherë duhet të mblihdhet Asambleja Kombëtare. Mundet që kjo të jetë arsyeja e vërtetë. Të shohim. Mund të na e thoshin neve këtë? Ashtu duhet të ndodhte, por ka dy-tre vjet me radhë që na thonë se «sivjet-mot» do të mblihdhet Asambleja, por kjo akoma nuk është mbledhur. Mbase s'duan të na e thonë më, se nuk është serioze. Pastaj kushedi se ç'u del? Kështu u ka ngjarë përherë. **Ujërat në udhëheqjen e tyre nuk janë të kulluara. Shihet konfuzion lidhur me njerëzit që presin e përcjellin miqtë! Shumë herë në këto ceremoni pritjesh e përcjelljesh sheh udhëheqës që s'duhet të jenë dhe nuk sheh nga ata që duhet të jenë.**

SHKËRIM
1971. 10. 25. 1971

E MËRKURË
5 QERSHOR 1974

A ËSHTË E VËRTETË KJO QË THONË AGJENCITË E LAJMEVE PËR KINËN?

Agjencitë e lajmeve njoftojnë nga Zaireja se Kina ka dërguar ushtarakë për të stërvitur partizanët e Angolës. Këta ushtarakë, shtojnë lajmet e këtyre agjencive, i ka pritur edhe vetë Çuja para se të niseshin.

Si e çuditshme na duket një gjë e tillë. Vërtet Kina mori pjesë gjerësisht në luftën e Koresë, por ajo ishte tjetër çështje. Tash ata na kanë deklaruar neve se nuk do të ndihmojnë hapur as lëvizjet nacionalçlirimtare, as partitë marksiste-leniniste, pse mund të akuzohen për ndërhyrje në punët e brendshme të të tjerëve. Ndërsa del se kanë dërguar instruktorë ushtarakë në Angolë!

TAKIM ME DELEGACIONIN E PK
TË GJERMANISË (M-L)

Dje u takova me delegacionin e Partisë Komuniste të Gjermanisë (m-l) të kryesuar nga kryetari i partisë, shoku Ernst Aust¹. Biseda kaloi e ngrohtë. Shkëmbyem mendime për politikën aktuale dhe për probleme ideologjike që interesojnë të dyja partitë tona dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 520.

SHËNIM

Ambasadori ynë në Pekin i ka dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme një raport të dytë, fare të kotë dhe pa asnjë vlerë për tërheqjen e Çu En Lait. Spekulimet që bëjnë agjencitë perëndimore për këtë tërheqje, ai i shfaq si ide të tij, që rezultojnë gjoja nga observacionet personale.

TAKIM ME NIPIN E SAMI FRASHËRIT

Prita dhe pata një bisedë shumë të ngrohtë me nipin e patriotit dhe të dijetarit të shquar të vendit tonë, Sami Frashërit, Emin Erer, i cili jeton jashtë. Emini ka ardhur në Shqipëri për të marrë pjesë në inaugurimin e shtëpisë-muze të vëllezërve Frashëri.

ZBARKIMI I FORCAVE USHTARAKE TË TURQISË NË QIPRO

Turqia zbarkoi sot forca ushtarake në Qipro. Kuptohet se për këtë u gjet edhe justifikimi: «Për të mbrojtur marrëveshjen e Gjenevës e të Zurichut» (Turqia është një nga garantët e saj), «për të mbrojtur minoritetin turk» nga puçistët grekë që rrëzuan Makariosin, dhe më në fund, «për të mbrojtur gjithë qipriotët, statukuonë, paqen» etj. Plot fjalë të mira, por në realitet, qëllimi ishte të pushtohet Qiproja, e cila është përballë Anadollit dhe hunda e saj drejtohet drejt gjirit të Iskenderunit dhe portit ushtarak Mersin, nga ku nisën forcat e zbarkimit. Fakt është se popullsia turke e Qipros nuk është trajtuar kurrë mirë nga grekët, ajo vazhdimisht është persekutuar nga qipriotët grekë. Prandaj mund të anojmë nga turqit dhe ne kemi mbajtur anën e tyre, jo pse grekët e megaliidhesë kanë pretendime edhe mbi atdheun tonë, por se e vërteta ashtu qëndron. Kur u stabilizua gjendja në Qipro, edhe pozitat tona ishin për këtë statukuo. Kush e prishi këtë? S'ka asnjë dyshim: Athina e mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Anglia. Athina shoviniste donte me kohë ta aneksonte Qipron, që kur prifti Makarios dhe gjenerali Grivas luftonin për ENOS-in. Edhe Makariosi ishte për ENOS-in, edhe ky prift aventurier, me njëqind flamurë në xhep, ishte kun-

dër turqve, për bashkim me Greqinë, pastaj u bë kundër Athinës, ishte me Anglinë e kundër saj, kjo më në fund e shpëtoi nga thonjtë e ENOS-it, ishte pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pastaj e prishi me to, lejoi bazat e NATO-s në ishull, zuri miqësi me Bashkimin Sovjetik, bëri vizitë në Kinë, u puq me Maon dhe me Çian Çinin, hiqesh «i paangazhuar», por flinte me të tërë. Prift politikani edepsëz. Natyrisht Athina nuk e duronte dot, prandaj futi në Qipro oficerë dhe ushtarë grekë dhe këta bënë puçe dhe ia ngritën këmbët Makariosit. Pra Greqia e filloi agresionin e para, gjoja nga brenda, për të aneksuar ishullin dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të bëheshin zot i saj, nga frika se mos e zinte vendin Rusia që është e uritur për baza në Mesdhe. Mirëpo Turqia nuk fjeti, as nuk pyeti, as nuk dëgjoi, as nuk u tremb, por e kaloi pengesën e ujit. Të tjerët u gjendën me gisht në gojë. Është mirë për ne që megaliidhesë greke t'i thyhet dhe një herë hunda.

Bashkimi Sovjetik flet e bërtet kundër Greqisë se do të aneksojë Qipron. Po kush flet? Hrushovianët, që me Venizellosin (junior) biseduan për t'i dhënë Greqisë Gjirokastrën dhe Korçën. Kush flet për aneksim? Social-imperialistët sovjetikë që pushtuan Çekoslllovakinë, që rrëzuan Dubček-Makariosin dhe vunë Husak-Samsonin! Por kuptohet pse e bëjnë ata këtë, për t'i bërë qejfin Turqisë, së cilës po ia prishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia etj.

Titushka që hiqet si parimor, edhe ai po bërtet, por do ta shohim deri kur do të bërtasë miku dhe aleati i Turqisë dhe i Greqisë. Për udhëheqjen e Turqisë ai do të thotë një fjalë, siç tha «për sy e për faqe» për pushtimin e Çekoslllovakisë.

Të gjitha këto janë lodra të të poshtërve, të të shiturve tek imperialistët amerikanë dhe sovjetikë. Këta që

sot janë «miq» të klikave, nesër bëhen armiq të tyre, sot «mbajnë anën e njerit», nesër gjejnë formula të tjera të diktuar nga dollari, rubla e sterlina.

Në OKB bëhen llogje. Në fakt gjërat vendosen jashtë OKB-së. Ç'paturpësi! Në lloj-lloj mbledhjesh lëshohen deklarata, kurse mbi popujt hidhen bomba dhe topa.

S'mund të mbash asnjë qëndrim zyrtar në këto situata. Qëndrimi ynë është vetëm «liri, pavarësi popullit të Qipros, si atij grek dhe atij turk, demokraci të vërtetë». Por në këto situata asgjë s'mund të arrihet. Që të fitojë revolucioni duhet luftë, luftë akoma e gjatë, e vetë popullit qipriot dhe e të gjithë popujve të tjerë. Luftë kundër dy superfuqive dhe të gjitha agjenturave e klikave të tyre në të gjithë botën. **Ne po forcojmë mbrojtjen tonë, jemi shumë vigjilentë, pse rreziku i një lufte po vjen rrotull në Mesdhe dhe në Ballkan. Në befasi asgjë nuk do të na gjejë dhe, po të vijë rreziku, ne do ta përballojmë me sukses e do të mposhtim çdo agresion.**

E MARTE
23 KORRIK 1974

TË RUAJMË EKUILIBRIN E DASHAMIRËSISË SI NDAJ POPULLIT TURK ASHTU EDHE NDAJ ATIJ GREK

Me shokun Hysni pashë artikullin që kemi përgatitur për ta botuar nesër në gazetën «Zëri i popullit», lidhur me situatën që është krijuar kohët e fundit në Qipro.

Kisha menduar dhe përgatitur disa ide për t'ia shtuar artikullit, pa bërë përsëritje dhe pa krijuar kontradikta, por i lashë. Qëllimi im ishte që të forcojmë opinionin në popullin grek për dashamirësinë tonë në një kohë kur atë të gjithë e sulmojnë. Të forcojmë mendimin, që tashmë është formuar, ndaj politikës sonë të urtë dhe të matur në çështjen e Qipros. Nuk gjeta formulim më të përshtatshëm për këtë problem që ka rëndësi politike, sidomos në lidhje me fqinjën tonë të jugut. Pavarësisht nga veprimet e shovinizmit grek e turk, ne ruajmë ekulibrin e dashamirësisë si ndaj popullit të Turqisë, ashtu edhe ndaj atij të Greqisë. Edhe atje ku unë zë në gojë Dubçek-Makariosin e të tjerë, indirekt lë të nënkuptohet se Greqia është fajtorë për fillimin e konfliktit. Aty demaskoj, gjithashtu, edhe të gjithë lakenjtë e amerikanëve dhe të sovjetikëve, që nga Titoja, Çausheku e të tjerë.

E keqja në artikull, qëndron në atë se nuk përmendim as sulmin grek të përgatitur me kohë nga klika shoviniste fashiste e Athinës për të realizuar ENOS-in, as

sulmin e shovinistëve turq si kundërveprim ndaj sulmit të grekëve. Të dy agresionet në Qipro nuk i përmendim. Prandaj përfundimisht mendova se është më mirë të qëndrojmë në idetë e përgjithshme që përmban artikulli, pse po të shtojmë idetë e reja që po i radhis këtu, mund të merret edhe sikur ne mbrojmë të dyja qeveritë, turke dhe greke, pavarësisht se flas për popujt turk e grek, për bashkëjetesën paqësore dhe me të drejta të barabarta në një vëllazërim të sinqertë dhe të harmonishëm të të dy komuniteteve të ishullit.

Është për të ardhur keq, pse fshihet e vërteta e gjërave dhe kjo bëhet për interesa të veçantë egoistë, për t'i bërë qejfin njërit apo tjetrit shtet të madh, për oportunizëm, për servilizëm dhe nga frika. E, pra, ne shqiptarët s'kemi pasur dhe s'kemi frikë ta themi haptazi atë që mendojmë.

Po sulmohet nga të katër anët populli mik grek. Ne jemi kundër këtyre sulmeve, pse nuk është populli grek fajtor për çka po ndodh, por imperializmi amerikan. Ai, tok me imperializmin anglez dhe me socialimperializmin sovjetik, i kurdisin dhe i nxitin këto intriga. Të tri këto lubi luajnë me fatet e popujve të Mesdheut, të Ballkanit dhe të botës. Që të tria përpiqen kush e kush të hedhë Qipron në dorë, kush e kush t'i hedhë thonjtë Turqisë dhe të pushtojë ngushticat, kush e kush të robërojë popullin grek, për të kaluar më vonë në një konflikt të përgjithshëm. Kjo është e vërteta e madhe. Kundër këtyre imperialistëve dhe socialimperialistëve duhet drejtuar tehu i shpatës dhe jo kundër popujve vëllazër turk dhe grek. Janë Bashkimi Sovjetik revizionist dhe imperialist, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi i egër e gjakpirës që shkelin të drejtat sovraane të popujve, që i nxitin të grinden e të gjakosen në mes tyre, për t'i rrjepur më mirë e për t'u pirë gjakun. Apo nuk janë të qartë Vietnami, Bangladeshi, Lindja e Mesme, tash Qiproja etj.,

etj.? A mund të harrohen tmerret që ka bërë imperializmi amerikan kundër popujve? Revizionistët e Moskës po sulmojnë me propagandë Greqinë. Dhe kush e bën këtë gjë? Ata që sulmuan dhe pushtuan Çekoslovakinë, që rrëzuan Dubček-Makariosin dhe vunë në vend të tij Husak-Samsonin. Sovjetikët revizionistë gjoja mbrojnë Turqinë. Kush mund ta hajë këtë gënjeshtër? Asnjeri, ca më pak ne shqiptarët dhe turqit, me të cilët na lidh një miqësi e sinqertë, ashtu siç na lidh edhe me popullin grek. Ne u themi imperialistëve amerikanë dhe socialimperialistëve sovjetikë: larg duart nga Turqia dhe nga Greqia, i lini të qeta se ato janë në gjendje t'i zgjidhin vetë mosmarrëveshjet që kanë lindur në mes tyre, në mirëkuptim dhe në interesin e të dy popujve të tyre, në interesin e paqes botërore. Jeni, ju, imperialistët amerikanë dhe revizionistët socialimperialistë sovjetikë, që i nxitni gjakrat, që shkaktuat gjakderdhjen në Qipro, dhe tash, me siguri do të dilni si «shpëtimtarë të situatës». Që tash kanë filluar t'i thurin lëvdata njëfarë intriganti, që e ka emrin Kisinger; që tash po përhapet fjala se «forca sovjetike» do ta stabilizojë gjendjen.

Ne nuk gënjehemi. Është vullneti i mirë i popujve turk, grek e qipriot, që e ndaluan zjarrin. Dhe ne kemi besim se është vullneti i këtyre popujve, trima e përpërimtarë, që do të sjellin paqen në Qipro dhe në mirëkuptim e në drejtësi atje do të vendosen përsëri pavarësia dhe sovraniteti i saj, demokracia, liria dhe bashkekzistenca e vëllazërimi në mes banorëve grekë dhe turq të ishullit. Kjo do të jetë një vepër e madhe e lavdishme dhe do t'u sjellë një të mirë të madhe, veçanërisht popujve të Ballkanit. me fatet e të cilëve kanë luajtur fuqitë e mëdha imperialiste, që i kanë vrrarë dhe i kanë pasë armiqësuar me njëri-tjetrin për t'i shtypur më lehtë. Por ato kohë tash kanë perënduar.

31.10.1974
11.11.1974

E MARTË
23 KORRIK 1974

QIPROJA DHE PLANET HEGJEMONISTE TË DY SUPERFUQIVE NË MESDHEUN LINDOR

Artikulli¹ që i dërguam sot gazetës «Zëri i popullit» e që do të botohet në numrin e saj të nesërm, synon demaskimin e planeve të dy superfuqive imperialiste — Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik në Mesdhe. Artikulli mban titullin: «Qiproja dhe planet hegjemoniste të dy superfuqive në Mesdheun Lindor».

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 539.

SHËNIM

U thashë shokëve që, nëpërmjet punonjësve të Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme, t'u bëhet e ditur qeveritarëve grekë se në rastin e gjendjes së krijuar në Greqi këto kohët e fundit, lidhur me krizën e Qipros ajo, Greqia, të jetë e qetë dhe e sigurt nga kufijtë që ka me vendin tonë.

Ky qëndrim yni politikisht është i drejtë dhe do të bëjë efekt në vendin fqinj.

NJË DELEGACION I VIETNAMIT TË JUGUT VJEN NESËR NË VENDIN TONË

Nesër vjen në vendin tonë, për një vizitë zyrtare e miqësore, një delegacion i Republikës së Vietnamit të Jugut. Atë e kryeson Nguyen Huu Tho¹.

Përfaqësuesit të shquar të popullit heroik të Vietnamit të Jugut do t'i bëjmë pritje të përzemërt dhe me popull. Ai do të zhvillojë bisedime dhe do të vizitojë edhe vendin.

¹ Kryetar i Presidiumit të Komitetit Qendror të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut dhe kryetar i Këshillit të të Urtëve të Qeverisë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut.

TAKIM ME DELEGACIONIN E VIETNAMIT TË JUGUT

Në selinë e Komitetit Qendror të Partisë prita sot delegacionin zyrtar të Republikës së Vietnamit të Jugut, të kryesuar nga Nguyen Huu Tho, kryetar i Presidiumit të Komitetit Qendror të Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut dhe kryetar i Këshillit të të Urtëve të Qeverisë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut¹. I fola hapur e miqësisht.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 543.

MITING PËR NDER TË MIQVE TË SHQUAR VIETNAMEZË

Shokët më njoftuan se sot pasdite në selinë e Këshillit të Ministrave u nënshkrua marrëveshja midis Qeverisë së RP të Shqipërisë dhe Qeverisë Revolucionare të Përkohshme të Republikës së Vietnamit të Jugut për ndihmën ekonomike falas që Qeveria jonë i jep Qeverisë Revolucionare të Përkohshme të Vietnamit të Jugut për vitin 1975.

Pas ceremonisë së nënshkrimit, delegacioni mik mori pjesë në një miting që ishte organizuar për nder të tij në Teatrin e Operës dhe të Baletit. Në miting folën shoku Haxhi Lleshi dhe Nguyen Huu Tho.

Nesër delegacioni largohet nga vendi ynë.

Për këtë vizitë zyrtare e miqësore, do të botohet një komunikatë e përbashkët.

NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE

Sot pasdite në orën 19⁰⁰ do të shkoj për të marrë pjesë në pritjen që do të japë ambasadori kinez, Liu Xhen Hua, me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës.

POLITIKA JONË ËSHTË E HAPUR, ËSHTË POLITIKË E PARIMEVE PROLETARE

Sot në sallën e Teatrit të Operës dhe të Baletit u takova me zgjedhësit e zonës elektorale Nr. 209 ku është vënë kandidatura ime.

Takimi ishte një shprehje e zjarrtë e dashurisë dhe e respektit të thellë që masa e punonjësve të kryeqytetit ushqen për Partinë tonë të shtrenjtë. Mbajta me këtë rast një fjalim¹. Një pjesë të madhe të këtij fjalimi ia kushtova politikës sonë të jashtme, politikë e hapur dhe e parimeve proletare.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 552.

ASNJË LËSHIM TITIZMIT

Shokët më informuan se një nga anëtarët e delegacionit të Universitetit të Prishtinës, që ka ardhur këtu, ka kërkuar të takohet me një personalitet, pse ka «diçka të rëndësishme për të komunikuar nga Fadil Hoxha për shokun Enver». Në bisedë ai ka lënë të kuptojë çfarë do të na thotë dhe këto korrespondojnë me ato që vetë Fadili i tha ambasadorit tonë në Beograd. Ky person kishte lënë të kuptonte këto gjëra më tepër:

Sikur Titoja i kishte thënë se «duhet të bëjmë autokritikë të hapët në lidhje me Koçi Xoxen dhe se, po t'i ngjasë gjë Shqipërisë, kosovarët janë të lirë t'i vijnë asaj në ndihmë» etj.

I thashë Hysniut le ta dëgjojë këtë njeri Kahreman Ylli, por të mos i japë asnjë mendim, vetëm t'i thotë se do të raportojë lart.

Na intereson ta dëgjojmë, pastaj këtë problem ta shtrojmë dhe të vendosim për qëndrimet ndaj këtyre avancave. Këtu duhet të jemi të qartë dhe të vendosur: asnjë lëshim titizmit. Revizionistët jugosllavë, me Titon në krye, janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, armiq të socializmit dhe të komunizmit, ata janë dhe mbeten armiq të betuar të Partisë sonë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ne duhet të mbajmë qëndrimet aktuale në rrugën shtetërore, por asnjë çap nuk duhet të bëjmë nga ana politiko-ideologjike. Solidaritetin, në rast

sulmi kundër Jugosllavisë, ne e deklaruar hapur dhe i qëndrojmë. U bie atyre të veprojnë. Me siguri titistët duan që çdo gjë të fshihet dhe kujtojnë se, po dënuan Koçi Xoxen, u bënë marksistë-leninistë. Jo, Koçi Xoxe ishte një armik i Partisë sonë, një agjent i Titos, i cili si antimarksist dhe imperialist kërkonte të na zhdukte si parti dhe si shtet. Por nuk është vetëm kjo. Titistët, me Titon në krye, kanë qenë dhe janë kriminelë, ata kanë qenë dhe janë kundër revolucionit, kundër marksizëm-leninizmit, janë kundërrevolucionarë, borgjezë dhe agjentë të imperializmit. Prandaj lufta kundër tyre vazhdon në platformën politiko-ideologjike dhe ne në asnjë mënyrë nuk duhet të lidhim duart dhe të mbyllim gojën me pseudopremtimet e revizionistëve jugosllavë.

Por neve na intereson të dimë qëndrimin e kosovarëve, deri ku janë të lidhur këta me Shqipërinë dhe, kur them kosovarëve, kuptoj «udhëheqësit», se është e qartë që populli e do me gjithë shpirt Shqipërinë socialiste. Por kurdoherë me kujdes dhe me prurëncë me ta, kurdoherë brenda vijës sonë dhe në disfavor të titizmit.

Fadil Hoxha, në biseda që ka bërë me ambasadorin tonë në Beograd, lë të kuptojë se «ai ka qenë në pozita të vështira në kohën e Rankoviçit». Thotë po ashtu se «ka sidomos serbë, që ndodhen kudo, që nuk janë në favor të marrëdhënieve të drejta midis nesh dhe unë po ju flas këtu edhe si udhëheqës, edhe si shqiptar kosovar».

Fadili thotë: «Konsiderohesha si tradhtar nga Rankoviçi». Po nga Titoja? (këtë nuk e thotë, nuk mund ta thotë) dhe kosovari i delegacionit të Universitetit të Prishtinës tregoi se gjoja ky i sugjeroi Fadilit nga ana e vet, që «unë do t'u ngre shqiptarëve që t'i heqin epitetet që të kanë vënë shqiptarët si tradhtar i popullit shqiptar» etj.

Fadili thotë po ashtu që «është goditur se ai ka qenë

kundër atyre që donin të ngrinin Kosovën kundër Shqipërisë dhe për këtë qëndrim e larguan nga posti». Ai s' thotë se kush, por dihet që e ka fjalën për Rankoviçin, Dushanin, por ndoshta dhe për Titon. Dhe më në fund Fadili shton: «Ne dhe ju kemi interes ta shpëtojmë Kosovën nga çdo ngatërrësë, ne kemi luftuar së bashku dhe gjaku nuk bëhet ujë». Kjo frazë e fundit i përgjigjet çka i thashë unë afërsisht Rexhep Durakut që ta njoftonte Fadilin nga ana ime se «ne jemi vëllezër të një mëme, të një gjaku dhe gjaku nuk bëhet ujë».

Duhet t'u besojmë këtyre çka thotë Fadili? Duhet t'u besojmë deri në një pikë. Ai serb nuk është, por është shqiptar, dhe Shqipërinë e do sipas mënyrës së tij. Cila është mënyra e tij? Që Shqipëria ta ketë mirë me këtë Jugosllavi që mendon se tash nuk është si ajo e Rankoviçit (dhe këtu gabon), kështu që ne ta ndihmojmë Kosovën të forcojë pozitat e saj në Federatë (këtë nuk e ka keq dhe ne e kemi parasysh). Fadili pohon se rankoviçistët ishin kundër Shqipërisë dhe luftonin të ngrinin Kosovën kundër nesh. Por është e qartë se kjo ngjiste jo vetëm në kohën e Rankoviçit, por edhe të Titos. (Fadili s'e përziën Titon në këtë punë, se beson kështu apo për oportunitet, të dyja mund të mendohen, pse Fadili gjykon që pas dënimit të Rankoviçit, Titoja u hapi ca rrugë kosovarëve, por në një vend nuk mungon të na thotë: «T'i përmirësojmë marrëdhëniet tash që është gjallë Titoja, pse pas vdekjes së tij nuk dihet se ç'bëhet». Kjo mund të na lërë të kuptojmë se pas Titos «ne kosovarët asnjë besim s'mund të kemi te serbët».) Fadili na thotë se «këtë qëndrim e ka kundërshtuar, prandaj është goditur». Ai thotë, gjithashtu, se i kishte thënë Titos shumë herë që «të hidhte poshtë Koçi Xoxen dhe vetëm me Enver Hoxhën dhe me Mehmet Shehun duhet të përmirësojmë marrëdhëniet», por Titoja nuk e dëgjonte. Ve-

tëm tash, pas fjalimit të 3 tetorit të Enverit¹, Titoja i paska thënë se «ti Fadil Hoxha ke pasë të drejtë» etj.

Sigurisht, këto gjëra që thotë Fadil Hoxha, i flet më hapur, pse Titoja dhe shokët e tij i kanë ndezur dritën jeshile, duke e porositur të thotë këto se «u vjen mirë shqiptarëve, llafe janë dhe llafet i merr era». T'i afrojmë ata, mymqyn² dhe t'i futim në radhë, t'ia ulim prestigjin Shqipërisë socialiste, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të ngremë kështu prestigjin e Titos dhe të titizmit. Bota atëherë do të thotë: mbaroi edhe Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë, u nënshtruan. Se si e bën këtë Fadil Hoxha, me bindje, me gjysmëbindje ose i urdhëruar, ne duhet të jemi të bindur se qëllimi i Titos dhe i titistëve është ky që thashë.

Ne i kemi të drejta deklaratat tona, mund të zhvillojmë tregtinë me Jugosllavinë, të bisedojmë edhe për rrugët, edhe për hekurudhat, por jo të shkojmë më tej, çdo gjë me ta duhet bërë me shumë prurëncë dhe këto që do të bëjmë, të mos i lëmë titistët t'i interpretojnë sipas qejfit të tyre, ne t'i interpretojmë sipas interesit tonë. Veçanërisht të mos lejojmë në asnjë mënyrë që jugosllavët të propagandojnë sikur ne po «puqemi me titistët». Çështjen e Kosovës dhe të udhëheqësve shqiptarë kosovarë ta kemi kurdoherë parasysh dhe t'i ndihmojmë në rrugën marksiste-leniniste, në rrugën e internacionalizmit proletar. Një Kosovë e fortë, me ndjenja të forta shqiptare, me kulturë patriotike dhe me dashuri të sinqertë për Shqipërinë socialiste, është një ndihmë shumë e madhe për ne, është një ndihmë dhe një gardh kundër shovinizmit serbomadh dhe revizionistëve titistë e sovjetikë.

1 Fjalimi i mbajtur në takimin me zgjedhësit e zonës Nr. 209, 3 tetor 1974 në Tiranë.

2 Nga turqishtja — bile po të ketë mundësi.

TË PËRPUNOHET QËNDRIMI YNË I MËTEJSHËM NË POLITIKËN E JASHTME

Bisedova me ministrin e Punëve të Jashtme se si, duke u bazuar në fjalimin tim të 3 tetorit 1974 para zgjedhësve, të përpunojmë qëndrimin tonë të mëtejshëm në zhvillim të politikës sonë të jashtme.

Po ashtu, duke iu përgjigjur shpresave që shprehën njerëzit jashtë nga jehona e këtij fjalimi, duhen rishikuar më tej masat që duhet të merren nga Ministria e Punëve të Jashtme për propagandimin e vendit tonë në botën e jashtme. Fjalimi është një sintezë e politikës së jashtme të Partisë sonë, prandaj ai duhet të shpjegohet me artikuj e mjete të tjera, të interpretohet nga ne dhe të mos lëmë që një gjë të tillë ta bëjnë të tjerët sipas qejfit të tyre.

SHËNIM

U takova me kryetarin e delegacionit tonë tregtar që shkon në Rumani, ku do të zhvillojë bisedime lidhur me marrëdhëniet tregtare. I thashë se po t'i sugjerojnë takim me Çausheskun, t'u thotë se «nuk jam i autorizuar». Me të tjerët të takohet, me Çaushin jo, pse merr ngjyrë partie.

KISINGERI NË RUMANI E NË JUGOSLLAVI

Agjencia rumune e lajmeve njoftoi se Henri Kisinger, sekretar shteti i SHBA-së dhe ndihmës i presidentit amerikan për çështjet e sigurimit kombëtar, i dha fund vizitës së tij në Rumani, ku zhvilloi bisedime zyrtare dhe u prit edhe nga Çausheku. Po sot, siç njofton agjencia jugosllave Tanjug, ai shkoi për vizitë zyrtare në Jugosllavi, ku pati takime me autoritete të larta jugosllave edhe me vetë Titon.

Çfarë fshihet prapa këtyre vizitave e bisedimeve të antikomunistit të tërbuar Kisinger, koha do të na e tregojë.

KISINGERI NË PEKIN

Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njofton se sot arriti në Pekin për vizitë zyrtare sekretari i shtetit i SHBA-së dhe ndihmës i presidentit për çështjet e sigurimit kombëtar, Henri Kisinger. Në aeroport atë e priti ministri i Jashtëm kinez¹.

Kisingeri vazhdon turneun e tij komplotues. Në fillim të këtij muaji ai ishte për vizitë zyrtare në Rumani e Jugosllavi, ku u takua edhe me Çaushekun dhe me Titon. Të shohim kë do të takojë në Pekin.

¹ Në atë kohë Çiao Kuan Hua.

TAKIM ME DELEGACIONIN E PARTISË DHE TË QEVERISË SË RP TË KINËS

Sot paradite në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, prita delegacionin e partisë e të qeverisë së RP të Kinës, që ka ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor. Delegacionin e kryesonte Jao Ven Juani¹.

¹ Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të KQ të PK të Kinës.

TAKIM ME DELEGACIONET E HUAJA QË KANË ARDHUR PËR FESTËN TONË

Sot paradite në selinë e Komitetit Qendror të Partisë prita të gjitha delegacionet qeveritare, si dhe ato të partive marksiste-leniniste, që kanë ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet e 30-vjetorit të Çlirimit dhe të fitores së revolucionit popullor.

NGA BISEDË ME JAO VEN JUANIN

Në bisedën që bëra dje me Jao Ven Juanin, ky u tregua shumë i afërt dhe i dashur me mua, por ndonjë gjë të veçantë e të rëndësishme nuk më tha. Për Çu En Lain tha se është më mirë dhe se shpresojnë të flasë në mbledhjen e Asamblesë Popullore Kombëtare, që do të mbahet së shpejti. Foli edhe për çështjen e kontradiktave sovjeto-jugosllave e sovjeto-rumune dhe tha se ne duhet të ndihmojmë që këto kontradikta të thellohen. Unë iu përgjigja duke i thënë se të tre janë revizionistë dhe se asnjë iluzion nuk duhet pasur për ta. Çdo qëndrim i tyre është koniunktural. Ne, pa cenuar vijën tonë, do të ndihmojmë në acarimin e kontradiktave midis tyre, por pa harruar kurrë që ata janë armiq.

FORCOHEN E THELLOHEN MARRËDHËNIET KINO-AMERIKANE

Agjencia kineze e lajmeve, HSINHUA, njoftoi dje se Kisingeri u largua nga Kina i përcjellë në Shangai nga Çiao Kuan Huaja.

Siç kanë bërë të ditur agjencitë e lajmeve, sapo mbërriti në Pekin, domethënë më 25 nëntor, Kisingeri u prit nga Çu En Lai në spital, ku është i shtruar. Në darkën e po asaj dite, Çiao Kuan Huaja dha një banket, në të cilin morën pjesë edhe zëvendëskryetari i Këshillit të Shtetit, Ten Hsiao Pini. U shkëmbyen fjalime midis Kisingerit e Çiaos. Në datat 26, 27 e 28 nëntor midis Kisingerit e personave që e shoqërojnë dhe Ten Hsiao Pinit e Çiao Kuan Huasë u zhvilluan bisedime. Në mbrëmjen e kësaj dite, Kisingeri dha një pritje, në të cilën, përveç personave të tjerë, mori pjesë përsëri Ten Hsiao Pini. Përsëri u shkëmbyen fjalime e dolli.

Po forcohen e po thellohen marrëdhëniet kino-amerikane!

KINA NUK ZBATON POLITIKËN E NDIHMËS INTERNACIONALISTE MIDIS VENDEVE SOCIALISTE

Këtu ka ardhur një delegacion ekonomistësh kinezë i dërguar nga qeveria kineze për të studiuar me njerëzit tanë kërkesat që kemi bërë për planin e ardhshëm pesëvjeçar.

Sot më raportuan për fjalën që kishte mbajtur kryetari i delegacionit kinez, pasi tanët u parashtruan gjerësisht atyre kërkesat për objekte. **A. Këllezi m'u duk ca si optimist, po unë nuk jam optimist dhe do ta them pse. Këtë ia thashë edhe shokëve që të instruktojnë njerëzit tanë që merren me këtë punë, të bëjnë kujdes dhe të diskutojnë shoqërisht me kinezët, por të mbrojnë si duhet pikëpamjet tona.**

Çfarë tha kinezi që nuk tingëllon mirë për ne? Duke lënë mënjanë formulat e zakonshme për miqësinë, fillimi i ekspozesë së tij ishte: «Kina është një vend i madh me një popullsi me më tepër se 800 milionë njerëz, me nevoja të mëdha, është një vend në zhvillim. Kina u jep ndihmë 80 shteteve, ka shumë angazhime ndërkombëtare. Ndihma më e madhe u është dhënë dhe u jepet nga ana e saj Koresë, Vietnamit dhe Shqipërisë. Shqipërisë i është dhënë një ndihmë më e madhe se këtyre dy vendeve të tjera mike, për të mos folur për të tjerat». Ky ishte shtrimi i qartë i problemit.

Ai vazhdoi: «Nga plani aktual kemi afro 20 objekte që i keni filluar ose nuk i keni filluar dhe duhet, natyrisht, t'i inkuadroni në planin e ardhshëm». Kjo është vërejtja e dytë. Ai e di që këto 20 objekte nuk kanë filluar nga puna, se janë kinezët ata që nuk mundën të na i jepnin ato çka duheshin për fillimin dhe për vazhdimin e punimeve në to.

Përfaqësuesi kinez më tej vazhdoi: «Duhet të na jepni të dhëna të plota që të mund të gjykojmë ku e si bazohen kërkesat tuaja», dhe nxori pikëpamjet e Çu En Lait: forcat punëtore, fshatin, kapacitetin e ndërtimit etj., etj. hollësi.

Pasi m'u lexua ky fjalim i kinezit, A. Këllezi më tha se «ne do t'ua japim të gjitha të dhënat me hollësi». — Jo, t'u japim të dhëna, por nuk është nevoja me hollësi dhe për të gjitha gjërat, — iu përgjigja unë.

Shokëve u thashë, — dhe këta ishin dakord, — se «siç po e gjykoj unë, kinezët kanë dy tendenca: të marrin të gjitha të dhënat për ekonominë tonë, por të mos na japin ç'kërkojmë; të nxjerrin shumë pengesa dhe të na japin pak. Prandaj shokët tanë në të dy këto drejtime duhet të bëjnë shumë kujdes, t'u japin atyre ato të dhëna që janë të domosdoshme dhe të sigurojnë prej tyre zbatimin e të gjitha detyrimeve që kanë ndaj nesh, dhe jo të japin shumë e të marrin pak».

Është e vërtetë se shokëve kinezë, që do të na japin kreditë, me të cilat neve na duhet të ndërtojmë disa veptra, u duhet t'u japim të dhëna që mbështetin dhe arsyetojnë kërkesat tona. Është, gjithashtu, puna e tyre sa mundësi kanë ata të na ndihmojnë. Por në letrën qeveritare që u dërguam, në mos plotësisht, në pjesën më të madhe, ne ua bënim të qarta kërkesat tona. Ata, nga ana e tyre, mund të na flitnin më ndryshe nga ajo mënyrë me të cilën hapën bisedën. Vazhdimisht, dhe asnjërit nga njerëzit tanë që kanë vajtur në Kinë deri tani, nuk ka

munguar t'u thuhet nga të gjithë udhëheqësit kinezë, bile edhe në emër të Maos, të Çu En Lait e të tjerëve, se «Shqipërinë e kemi ndihmuar shumë pak, do ta ndihmojmë më shumë» etj.

Ne i kuptojmë nevojat e Kinës, shtrirjen e saj në botë, ndihmat që jep ajo, por si marksistë dhe si internacionalistë mendojmë se Kina duhet t'u japë më pak qeverive borgjeze (që ne e dimë se çfarë bëjnë me këto kredi, kush përfiton prej tyre, nga lidhen këto qeveri borgjeze dhe si janë pleksur dhe kredhur në kreditë skllavëruese kapitalisto-revizioniste) dhe neve të mos na i refuzojë kërkesat e arsyeshme. Kinezët të mos harrojnë as pozitativet ideologjike, politike dhe ushtarake të vendit tonë. Prandaj shpresojmë se shokët kinezë do të na i zgjidhin drejt çështjet, duke zbatuar politikën e ndihmës internacionaliste midis vendeve socialiste.

E SHTUNË
14 DHJETOR 1974*

KINEZËT DUAN TË TATOJNË PULSIN TONË

Ambasadori kinez në Stokholm i thotë ambasadorit tonë se kinezët ngurrojnë të marrin pjesë në ceremoninë e dhënies së Çmimit Nobël disidentit sovjetik Solzhenicin. Po këto ishin vetëm llafe, se kinezët morën pjesë që çke me të. Natyrisht, ne nuk morëm pjesë, jo pse Solzhenicini është antihrushovian, por sepse ai sulmon Marks, Engelsin, Leninin, Stalinin dhe komunizmin. Këto ne ua thamë kinezëve, por për këta mjafton të jetë dikush kundër sovjetikëve dhe menjëherë i thonë amin. Kështu, pa marrë parasysh se Solzhenicini sulmon Leninin, Stalinin, ata e respektojnë! Turp!

Ambasadori kinez në Beograd i thotë, gjithashtu, ambasadorit tonë atje, duke e vënë në dijeni për biseditmet e Y Xhanit në Jugosllavi: «Ne, kinezët, u kemi kërkuar sovjetikëve që të bëjnë autokritikë për Bukureshtin dhe që kufijtë me Kinën të kthehen në statukuonë e kohës së Hrushovit!» Pse vetëm Bukureshti i ndan kinezët me sovjetikët?! Të tjerat, siç po duket, nuk kanë rëndësi për ta. Po Bukureshti ishte vetëm maja e veshit që nxori hrushovizmi, gjirizi erdhi pas Bukureshtit. Dome thënë, po të thonë revizionistët sovjetikë se «në Bukuresht nuk u veprua me gjakftohtësi nga ana e Hrushovit», kinezët janë gati të pajtohen me ta. Çudi, pse nuk e bëjnë këtë sovjetikët?!

Janë vallë në vete shokët kinezë, apo këto janë

thënie të ambasadorëve të tyre? Por zor që ambasadorët kinezë të thonë *enormitete* të tilla pa direktiva nga lart. Ata përpiqen të na tatojnë pulsin, por nga përgjigjja që marrin me siguri e shohin se pulsi ynë rreh si kurdoherë komunist, revolucionar, antirevizionist.

E SHTUNË
14 DHJETOR 1974

PRESIDENTËT JANË NË HALL

Presidentët janë në hall dhe, me brekë nëpër këmbë, po vijnë vërdallë se nuk gjejnë karar.

Presidenti Brezhnjev (ky është lënë vetë zot, vetë shkop, pse as Podgorn, as Kosigin peshojnë) shkoi me vrap në Vladivostok të piqte një president tjetër, Fordin e shpëlarë e pa kripë, por që sapo ka dalë nga gjirizet e Uotergejtit. Ç'bënë atje? Asgjë nuk u tha, por një vërë në ujë. Siç duket ata deshën t'i thoshin botës: «Ja, këtu jemi!». Edhe Kina i pa që u poqën afër kufijve të saj. Të dy kalanderët prematuan se do të piqen prapë, të dy kishin nevojë për këtë tamtam për popujt e tyre, pse edhe Fordi, edhe Brezhnjevi s'i kanë këmbët të sigurta.

Atëherë «president» Brezhnjevi, meqë erdhi me duar bosh nga Vladivostoku, e mbajti vrapin në Paris për t'u pjekur me një tjetër president myfliz, Zhiskar d'Estënin. Ky i fundit ishte në hall, pse presidenti Ford i bën presion. «Presidenti» Shmid i bën, gjithashtu, presion. Atëherë edhe Zhiskari priti Brezhnjevin që t'u bëjë presion dy të parëve. Brezhnjevi do medoemos «teknologji të re» dhe një fjalë të mirë për «Sigurimin evropian», që është kthyer në një mossigurim botëror. Zhiskari i dha, dhe Brezhnjevi si i limaksur (këtë gjest e pamë në televizor), pa u tharë mirë boja, i rrëmbeu Zhiskarit dokumentin nga duart duke i thënë: «E mora ç'desha, se kam shumë nevojë».

Dhe Zhiskari, me buzëqeshjen e tij sarkastike, sikur donte t'i thosh kapiten Leonidhës: «Edhe unë të mora gazin dhe naftën, se kjo çështje më ka zënë prej gryke, pa sa për «Sigurimin evropian» kemi kohë të bisedojmë: *verba volant*».

Edhe presidentët qëndrojnë «volant» mbi vullkane.

PRISHTINE, 23 JANAR 1974

E HËNË

23 DHJETOR 1974*

JO, SHOKË KINEZË, NE ME JUGOSLLAVËT NUK JEMI «SI DHËMBËT ME BUZËT»

Y Xhani, zëvendësministër i Jashtëm i Kinës, që ishte te ne për festën e 30-vjetorit të Çlirimit si anëtar i delegacionit, të cilin e kryesonte Jao Ven Juani, prej këtej shkoi për një vizitë «miqësore» në Beograd. Atje ai pati takime e bisedime «të përzemërta», deri edhe me kryeministrin.

Kur u kthye në Pekin, Y Xhani pati një takim me ambasadorin tonë, të cilit i foli për këto bisedime. Ai i tha se «Jugosllavët e shohin situatën në botë të koklavitur. Sovjetikët u bëjnë atyre presione», «sovjetikët jo vetëm organizojnë informbyroistët, po dhe ustashët», «jugosllavët po u rezistojnë atyre» etj. Në këtë drejtim jugosllavët i pompuan mirë kinezët dhe këta u kënaqën me këto «kontradikta të thella» sovjeto-jugosllave. Pastaj folën për «botën e tretë», ku bëjnë pjesë kinezët dhe për «botën e të paangazhuarve», ku bëjnë pjesë jugosllavët. Si përfundim, «jugosllavët mbetën të kënaqur nga shpjegimet dhe tash e kuptuan mirë pozitën kineze në këtë problem»... Se nuk e kishin kuptuar më parë!!!

Pastaj nuk munguan të flitnin në këto bisedime edhe për qëndrimin e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë, duke u përdorur nga kinezi «deklaratat» tona. Dhe titistët nuk munguan t'u hidhnin «thimjamin» e tyre, duke thënë se ata «i duan të mirën Shqipërisë», se duan të rrojnë «në

miqësi», se portet e tyre nuk ua hapin vetëm anijeve sovjetike, por edhe atyre amerikane, se këto janë çështje ekonomike, kurse nga ana ushtarake ata janë vigjilentë etj., etj. Dhe «miku ynë», Y Xhani, tha si konkluzion se jugosllavëve u kishte thënë që kështu duhet të jetë miqësia në mes jugosllavëve dhe shqiptarëve, pse që të dyja palët jeni si «dhëmbët me buzët».

«Papa kinez» i dha bekimin «miqësisë jugosllavo-shqiptare» me një parabolë konfuciane, të poshtër, revizioniste. Të mendosh se e tha këtë gjë nga budallallëku, apo i shtyrë nga «inercia» e vërshimit të formulave stereotipe që përdorin, apo se donte t'u tregonte jugosllavëve që «ne kemi gisht në këtë politikë dhe e aprovojmë, derisa ju quajmë aq të afërt dhe në funksion të njëri-tjetrit, sa ç'janë dhëmbët me buzët», është vështirë të kuptohet.

Ç'gomarllëk! Ç'poshtërsi! Kjo figurë «biblike» e kinezit do të thotë se, sipas tij, ne me titistët jemi një kokë, një zemër, një trup, ndjekim një politikë e kemi një ideologji! Si mund t'i quash këto mendjelehtësi? Si mund të thuash se i shkau goja?! Ky ia tha këtë jo vetëm kryeministrit jugosllav Bijediçit, i cili me gëzim ia aprovoi dhe ia përsëriti edhe ai këtë «xhevahir», por edhe ambasadorit tonë. Natyrisht, ne nuk do të jemi kurrë dakord me atë thënie dhe domethënie, por do të jemi kundër, se titistët janë armiq, renegatë, revizionistë, agjentë të imperialistëve dhe të revizionistëve.

Na marrshin të keqen Y Xhani dhe shokët që mendojnë si ai në Kinë. Siç po duket, revizionizmi i ka rrënjët të thella në Kinë dhe fshesa e madhe atje nuk ka kaluar si duhet e ku duhet. Jo vetëm që kanë ngelur plehra qosheve në Kinë, por ata janë në pozita të larta e të besuara dhe veprojnë sheshit. Ku ta dish ç'gjëra të tjera ka biseduar Y Xhani me jugosllavët, por fakti është se ai doli i kënaqur. Kënaqësinë ta ruajë për vete.

E HËNË
23 DHJETOR 1974

NË KONCERTIN E ANSAMBLIT ARTISTIK SHTETËROR «MANSUDE» TË RDP TË KORESË

Shkuam në Teatrin e Operës dhe të Baletit për të parë koncertin e ansambllit artistik shtetëror «Mansude» të RDP të Koresë, që ndodhet në vendin tonë. Programi ishte i mirë dhe i bukur.

Në fund të pjesës së parë të koncertit u takova dhe bisedova me disa nga pjesëtarët e ansambllit. I përgëzova.

TREGUESI I LËNDËS

A

Afrimi, lidhjet dhe bashkëpunimi kino-amerikan — 39, 48-49, 58, 61-63, 65, 66-67, 71-72, 74, 77-79, 84-86, 88-90, 91-101, 117-119, 121, 142, 154-155, 170, 173-174, 178-179, 185, 187, 199, 227-228, 238-239, 303-304, 333-334, 360, 406-407, 408-409, 416-417, 422, 443, 452-453, 502, 516-517, 520-521, 616-617, 649

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeta-amerikane — 92, 102-103, 112, 139-141, 143-145, 149-151, 154-159, 164, 172, 185-186, 207-208, 211, 342, 351-353, 355-356, 388-389, 394, 405-407, 482-483, 497, 503, 505-512, 516, 655

Aleancat, traktatet politike, ekonomike, ushtarake të imperialistëve dhe të socialimperialistëve — 33-35, 287, 289, 350, 351, 357-358, 363, 364-368, 387-388, 480-484, 511, 513

Ambasadat e huaja në RPSH

— Ambasada e RP të Kinës. Takime me ambasadorin e saj — 45, 85-86, 177, 189, 202, 220, 235, 270-271, 275, 428-429, 431, 433, 434, 441, 500, 504, 569, 605, 617, 636

— Ambasada e RD të Vietnamit. Takime me ambasadorin e saj — 45, 168, 285-286, 299, 327, 385, 391

— Ambasada e Frontit Kombëtar të Çlirimit të Vietnamit të Jugut — 168, 285-286, 299, 327, 385, 391

— Ambasada e RDP të Koresë — 110, 430

— Ambasada e Greqisë — 35-37, 113

— Ambasada e Italisë — 32-34, 438, 485

— Ambasada e Kongo-Brazavilit — 200

Ambasadat e RPSH në shtete të ndryshme — 87, 236, 460, 480, 531-532, 542

— në Kinë — 6-8, 16, 45, 64, 80-81, 85, 87, 126, 165, 167, 170, 220, 282, 409, 418, 436, 447, 452, 470, 477, 532, 550, 555, 556, 563, 617, 618, 623

- në RD të Vietnamit — 123-124, 410
- në Jugosllavi — 50-55, 56, 57, 201, 259-260, 420-421, 525, 639, 653
- në Greqi — 369, 373, 476, 501
- në Itali — 147, 176, 438, 484-485
- në Turqi — 127, 537
- në Austri — 403, 470
- në Francë — 312, 542
- në Rumani — 129
- në Suedi — 653
- në Kili — 236

Anglia, imperializmi anglez. Qëndrimi armiqësor ndaj RPSH — 20-21, 22, 357, 443, 481, 629

Armatimi, çarmatimi, armët bërthamore dhe qëndrimet demagogjike të fuqive imperialisto-revizioniste ndaj këtyre problemeve — 151, 156, 354-355, 356, 388-389, 502, 506, 510-511, 583

B

Ballkani — planet dhe synimet e fuqive imperialisto-revizioniste ndaj tij — 32, 106, 107, 483, 627, 629, 630

Bashkegzistenca paqësore. Kritikë pikëpamjeve borgjezo-revizioniste mbi bashkegzistencën paqësore — 100, 140, 149-151, 155, 398

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik

- revizionistët sovjetikë — tradhtarë të marksizëm-le-

ninizmit. Degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i jetës politikë-shoqërore në BS — 78, 101, 247-250, 355, 507-508, 509, 512

— strategjia globale, politika socialimperialiste në marrëdhëniet me vendet dhe me partitë e tjera. Bashkëpunimi me imperializmin e reaksionin — 24-25, 62-63, 71-73, 140, 141-142, 157, 208-209, 240, 247-248, 356, 364, 388-389, 405-406, 425-426, 471, 481-483, 583, 589-590, 592-594, 626, 629

— bashkëpunimi dhe kontradiktat me RF të Gjermanisë — 471, 513, 545

— marrëdhëniet me RD Gjermane — 464

— marrëdhëniet me Francën — 655-656

— sabotimi i luftërave dhe i lëvizjeve revolucionare e çlirimtare të popujve — 130, 216, 218-219, 394-395

— politika demagogjike e BS mbi gjoja ndihmën për Vietnamin. Përkrahja nga BS e luftës së imperializmit amerikan në Vietnam — 108-109, 121, 140, 143-144, 149, 172-173, 185-187, 196, 198-199, 208-212, 303-304, 334, 342, 394-395

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 71-73, 102-104, 173-174, 342, 425-426, 515, 541, 589-590

— marrëdhëniet me Jugos-

llavinë — 24-25, 106, 107, 292-293

— qëndrimet armiqësore ndaj RPSH — 87, 403, 481-482, 589

— lufta e marksistë-leninistëve dhe e popujve kundër revizionizmit sovjetik — 249-250, 512-513

Shih edhe: Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto-amerikane

Bisedimet dhe marrëveshja amerikano-vietnameze në Paris — 124-125, 210, 233, 269, 276-277, 285-286, 298-302, 326-330, 341-343, 375, 376-377, 380-384, 393-396, 398, 422-423, 475

Borgjezia, karakteri reaksionar i saj — 92, 357, 358-359, 453

D

Diplomacia borgjezo-revizioniste — 20-21, 34, 65, 172-174, 178-179, 185-187, 197-198, 356, 368, 403, 405-409, 416-417, 480-481, 506, 523, 582-584, 585

Diplomacia marksiste-leniniste e RPSH — 53-55, 87, 372-374

E

Egjipti — lufta e popullit egjiptian kundër pushtuesve izraelitë dhe imperializmit — 216, 218-219, 514, 573-574, 575, 597

Engels, Frederik — 157, 249, 590, 653

Evropa — «Sigurimi Evropian», «Evropa e Bashkuar» — 79, 334-335, 351, 356-359, 363, 364-366, 386-390, 513-514, 516, 544-545, 655-656

F

Fashizmi dhe fashistët në kohën e sotme; lufta kundër tyre — 24, 97, 132, 137, 143-144, 149-150, 169, 176, 196-199, 288, 306, 371, 438, 553, 557

Franca, imperializmi francez — politika e jashtme e saj — 357, 419, 513-514, 517-518, 522-523, 545; 655-656

G

Greqia — politika e jashtme dhe gjendja e brendshme e Greqisë — 37-38, 370-372, 474, 478, 484, 501, 625-626, 628-629, 630

— qëndrimet e saj ndaj Shqipërisë — 22, 35-36, 274, 369-370, 371-372, 484, 501

GJ

Gjermania — Republika Demokratike Gjermane. Problemi i demshpërblimeve për Shqipërinë — 464, 559

— Republika Federale e Gjermanisë. Politika e jashtme. Problemi i dëmshpërblimeve për Shqipërinë — 357, 364, 513, 545, 559

I

Idealizmi — 221, 225-226
Imperializmi — *strategjia globale dhe kriza e tij; kontradiktat e aleancat ndërmjet vendeve imperialiste, ndërmjet vendeve imperialiste e revizioniste* — 59-60, 87, 141-142, 156, 245-248, 353-358, 363-366, 387, 388, 523, 583

Internacionalizmi proletar — 58-60, 131, 254-255, 361-362, 379

Italia

— kriza e imperializmit italian dhe politika e jashtme e tij — 32, 37-38, 169, 358-359, 371-372, 438, 483-484

— marrëdhëniet me RPSH — 32-33, 176, 483-485, 564

Izraeli — *vegël e imperializmit amerikan; politika agresive e tij kundër vendeve arabe* — 573, 575, 597

J

Japonia, imperializmi japonez; marrëdhëniet me Kinën — 78, 99, 266, 268, 454, 515

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav

— L K J — degjenerimi dhe shthurja e mëtejshme politike, ideologjike dhe organizative e saj — 23-25, 26, 29, 55, 278-279, 283, 291-293, 305-307, 591-592

— degjenerimi i jetës politike dhe ekonomiko-shoqërore në Jugosllavi. Konfliktet dhe grindjet nacionale. Anarkia dhe kaosi — 24, 28, 193-195, 278-280, 283, 287-289, 291-293, 305-308, 319, 528, 638-639

— bashkëpunimi dhe lidhjet e revizionistëve jugosllavë me vendet imperialiste e revizioniste; politika demagogjike dhe mashtruese e tyre — 23-25, 166, 371, 420-421, 463, 482-483, 513, 626, 657-658

— politika demagogjike dhe qëndrimet armiqësore ndaj PPSH e RPSH — 21, 50-55, 413, 525-526, 527-530, 600, 611, 638-641, 657-658
Shih edhe: Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në Jugosllavi

K

Kambodhia

— lufta e popullit kambodhian për çlirim kombëtar. Presionet sovjetike e jugosllave ndaj kësaj lufte — 184, 190-191, 231-234, 263, 296, 393, 394-396, 410-411, 486-488, 489-490, 536, 569, 613-614

— marrëdhëniet me RPSH — 184, 202, 231-234, 492-493, 498-499, 612, 613

Kili — *grushti ushtarak dhe reaksioni fashist në Kili* — 419, 553, 557, 560, 571

Kina — *Partia Komuniste e Kinës*

— lufta ndërmjet vijave, rrymave e grupeve në Parti. Grindjet politike, konplotet dhe lufta për pushtet në udhëheqjen kineze. Shthurja e PK të Kinës — 6-15, 48-49, 60-62, 125-126, 159, 165, 221, 224-226, 236, 335-340, 451-452, 465-469, 533-536, 542-543, 551

— kongreset dhe plenumet e KQ të PK të Kinës — 8, 11-12, 520, 533-536, 542, 547, 550-552, 556, 569

— qëndrimi antimarksist ndaj partive marksiste-leniniste, lëvizjeve dhe luftërave çlirimtare e revolucionare në botë. Përpjekjet për formimin e blloqeve me partitë revizioniste — 44, 45-47, 48, 61, 70-72, 99, 157, 158-159, 251, 253-254, 447-448, 450, 621

— qëndrimet joparimore të saj ndaj PPSH — 6-8, 9-11, 119-120, 224, 447, 449, 450, 605, 618-620

Kina — *Republika Popullore e Kinës*

— konfuzioni politik, ideologjik e shoqëror në Kinë. Konfliktet e brendshme dhe lufta për pushtet. Re-

volucioni Kulturor — 10, 11-12, 13-14, 116, 119-120, 220-230, 335, 337-338, 367, 422-423, 449, 468-469, 470, 534, 541-543, 616-617

— politika e jashtme oportunisto-revizioniste e saj. Përkrahja forcave imperialiste, revizioniste e reaksionare dhe sabotimi i luftërave çlirimtare e revolucionare të popujve — 47-49, 58, 61, 72-73, 76, 77-79, 85, 119, 142, 148, 154-155, 237-241, 270, 331, 332-335, 350-351, 352-361, 362-364, 406-407, 443-444, 452-453, 505-506, 507-509, 515-518, 535-536, 551, 621, 650

— politika e «botës së tretë» dhe e vendeve «të paangazhuara» — 73, 351, 360-361, 443-444, 449-453, 482, 541, 657

— marrëdhëniet, kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 61, 101, 154-159, 170, 240, 275, 333, 359, 416-417, 422, 425-426, 452-453, 506-507, 516-517, 520-521, 536, 623-624

— marrëdhëniet me Jugosllavinë — 157, 449, 657-658

— marrëdhëniet me Rumani në — 61, 85, 157, 213, 237, 449

— qëndrimi ndaj Kambodhias — 263, 410-411, 536, 569, 613

— qëndrimet demagogjike

ndaj luftës së popullit vietnamez dhe luftës çlirimtare e revolucionare të popujve — 78-79, 91-92, 101, 118-119, 123-126, 144, 158, 187, 210-212, 314, 334, 342, 359-360, 384, 398-399, 449

— marrëdhëniet, kontradiktat me RDP të Koresë — 203, 344

— afrimi, lidhjet me Japoninë — 266, 267, 268, 270, 275

— qëndrimet ndaj RPSH. Zvarritjet dhe sabotimi i furnizimeve, i pajisjeve dhe i kredive për Shqipërinë. Delegacione kineze në RPSH — 45, 79, 80-81, 82, 85-86, 88-90, 111, 114-120, 148, 177, 192, 213, 214-215, 220, 224, 237-241, 243, 257, 261, 270-271, 282, 294, 313, 331-332, 347, 402, 409, 422-423, 431, 433, 434, 436-437, 449, 457, 475, 519-521, 538-539, 606-607, 610, 611, 618-620, 650-652

Klasat dhe lufta e klasave në botën kapitalisto-revizioniste — 54, 226-227, 247-248, 306, 352, 358

KNER-i (Këshilli i Ndihmës Ekonomike Reciproke) — 363, 511

Kolonializmi, neokolonializmi — 208, 354, 364, 377-378, 393

Kompromiset, oportunizmi — 240-241, 298-302, 330, 376-

-377, 380, 381-382, 383, 393, 407-408

Kontradiktat në botën kapitalisto-revizioniste — 37-38, 72-

-73, 157-158, 170, 205-206, 208, 238-239, 245-248, 351-357, 370, 406-407, 417, 482, 513, 544-546, 592-594

Koreja — pozitat oportunisto-revizioniste të udhëheqjes koreane. Marrëdhëniet e saj me PPSH e RPSH — 110, 175, 203-206, 344, 404, 414, 430, 456, 659

Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në Jugosllavi

— traditat patriotike, revolucionare. Kundërshtimet, demonstratat kundër regjimit titist — 27, 28-31, 55, 193-195, 289, 307-308

— gjendja e brendshme në Kosovë. Politika demagogjike, shoviniste, shkombëtarizuese dhe e gjenocidit e revizionistëve jugosllavë ndaj popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi — 26-31, 51, 193-194, 280, 317, 319, 320, 525-526, 528-529, 639-640

— qëndrimet e drejta dhe marrëdhëniet e kosovarëve me RPSH — 29-31, 317, 528

Shih edhe: Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të RPSH — qëndrimet parimore m-l të RPSH ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta

në Jugosllavi. Solidarësia dhe ndihma për Kosovën

L

Lenin, Vladimir Iliç — 149, 150, 157, 238, 247, 248-250, 310, 358, 364, 365-366, 385, 416, 511, 582, 590-591, 653

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare

— strategjia dhe taktika e partive marksiste-leniniste — 47-48, 248-255, 354, 362, 448

— solidarësia dhe përkrahja ndërmjet partive dhe grupeve marksiste-leniniste — 244-245, 248-255

— Partia Komuniste (m-l) e Anglisë. Marrëdhëniet me PPSH — 561

— Partia Komuniste e Brazilit — 435

— Partia Komuniste e Cejlonit. Marrëdhëniet me PPSH — 130

— Partia Komuniste e Francës (marksiste-leniniste). Marrëdhëniet me PPSH — 45-47, 312

— Partia Komuniste e Gjermanisë (marksiste-leniniste). Marrëdhëniet me PPSH — 295, 622

— Partia Komuniste e Kambodhias. Marrëdhëniet me PPSH — 182, 183, 418, 487-488, 491, 613-614

— Partia Komuniste Peruane — 42

— Partia Komuniste e Polonisë. Marrëdhëniet me PPSH — 424

Lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve — 59-60, 208, 248, 379-380, 393-394, 407-408, 582, 584

M

Marksizëm-leninizmi — 30, 59, 101, 249, 250, 355

Marks, Karl — 157, 249, 493, 511, 590, 653

Ministria e Punëve të Jashtme e RPSH — 32, 33, 34, 38, 50, 56, 87, 90, 110, 113, 129, 147, 177, 188, 213, 237, 285, 368, 370, 400, 412, 413, 418, 438, 455, 609, 632, 642

Minoriteti grek në Shqipëri — 113

N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 33-35, 287, 289, 357, 387-388, 480-484

O

Oportunizmi

Shih: Kompromiset, oportunizmi

Organizata e Kombeve të Bashkuara

— qëndrimi parimor e revolucionar i RPSH në të — 188, 263, 559, 568, 609

— pozita dhe qëndrimi i RP të Kinës në OKB — 237, 272, 275, 332, 605, 617

P

Palestina — lufta e saj kundër sionistëve izraelitë. Marrëdhëniet me RPSH — 595, 597

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e saj kundër:

— revizionizmit modern — 44, 58-60, 560

— revizionizmit sovjetik — 207-209, 560

— revizionizmit jugosllav — 47, 193-195, 201, 638-641

Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme; marrëdhëniet e saj me partitë marksiste-leniniste

— vija e drejtë parimore marksiste-leniniste në politikën e jashtme — 363, 592, 593, 594

— ndihma dhe përkrahja internacionaliste partive dhe grupeve marksiste-leniniste e revolucionare — 244-245, 251-255, 450

— marrëdhëniet, kontradiktat me PK të Kinës. Takime, bisedime me delegacione kineze — 12-13, 90, 114-115, 221, 253-254, 340, 504, 547, 552, 555, 619, 646

— qëndrimet parimore m-l ndaj Partisë së Punonjëseve të Vietnamit — 578, 579

— qëndrimet parimore m-l ndaj Partisë Komuniste të

Kamboxhias — 182, 183, 418, 488, 491, 613-614

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Gjermanisë (marksiste-leniniste) — 295, 622

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Francës (marksiste-leniniste) — 45-47, 312

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste (m-l) të Anglisë — 565, 572

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste (m-l) të Spanjës — 608

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste Polake — 322, 424

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Brazilit — 435

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste Peruane — 41, 42

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Cejlonit — 130, 134

— marrëdhëniet me Partinë Komuniste (m-l) të Australisë — 540

— marrëdhëniet me Ligën Komuniste (m-l) të Suedisë — 171

— takime, bisedime me përfaqësues të partive marksiste-leniniste — 130, 182, 183, 647, 648

Partitë komuniste marksiste-leniniste

Shih: Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare

Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të RPSH

— qëndrimet parimore marksiste-leniniste në marrëdhëniet me vendet e tjera; lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit — 33-34, 58-60, 86, 93, 106, 148, 152, 158-159, 164, 212, 239, 240-241, 361-362, 363, 370, 372, 386, 390, 396, 432, 454, 460, 481, 501, 522-524, 538-539, 553, 557, 560, 573, 582-584, 593, 627, 629-630

— forcimi i pozitës dhe i autoritetit të RPSH në botë — 523-524, 537

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën. Delegacione të RPSH në Kinë — 16, 87, 88-90, 111, 114-120, 159, 214-215, 239-241, 243, 265, 270, 290, 294, 297, 313, 347, 437, 461, 473, 476, 519-521, 531-532, 538-539, 544, 555-556, 567, 598, 599, 601, 602, 603, 610, 658

— përkrahja, solidarësia dhe ndihma internacionaliste për Vietnamin — 128, 131, 137, 144-145, 207-208, 298-299, 314, 343, 380, 391, 400, 445, 580, 581, 633, 634, 635

— qëndrimi ndaj luftës së popullit kilian — 557, 560

— qëndrimi parimor m-l ndaj Jugosllavisë — 34, 50-55, 57, 413, 526-528, 638-639, 641, 658

— qëndrimi ndaj Rumanisë — 60, 129, 567, 643

— qëndrimi parimor ndaj Qipros — 627, 628-630

— qëndrimi parimor ndaj Koresë — 110, 188, 404, 414-415, 430, 456, 548

— marrëdhëniet me Kamboxhian — 180, 181, 184, 190-191, 202, 235, 296, 396, 492-493, 613-614

— marrëdhëniet me Greqinë — 34-38, 242, 274, 284, 368-369, 370, 372-374, 412, 476, 628-629, 630, 632

— marrëdhëniet me Italinë — 32, 33-35, 37-38, 438, 484-485, 562, 564

— marrëdhëniet me Francën — 522-523

— marrëdhëniet me Turqinë — 137, 628-629, 630

— përkrahja e luftës së popujve arabë kundër imperializmit, sionizmit e reaksionit — 58-60, 161, 217, 573-574, 597

— përgjigje qeverisë finlandeze — 316

— problemi i marrëdhënieve me Maltën — 496

— problemi i marrëdhënieve diplomatike me Japoninë — 454

— qëndrimi ndaj RF të Gjermanisë dhe RD Gjermane. Problemi i dëmshpërbliemeve gjermane për Shqipërinë — 559

— qëndrimet parimore m-l të RPSH ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare që jeton në trojet e veta

në Jugosllavi. Solidarësia dhe ndihma për Kosovën — 27, 28-31, 51-52, 56, 195, 259-260, 280, 317, 318, 319, 323-324, 348-349, 526, 528, 639, 641

— takime, bisedime, pritje vizitorësh të huaj. Miq dhe dashmirë të Shqipërisë — 40, 83, 129, 131, 133, 136, 146, 258, 281, 458, 459, 486-488, 568, 647, 648

Polonia — revizionistët polakë — 170, 356, 463, 592-593

Propaganda borgjezo-revizioniste — 14, 15, 46, 61-63, 64, 69, 71-72, 84, 91-94, 102, 108-109, 185, 541, 583

Propaganda dhe shtypi të RPSH për botën e jashtme — 53-54, 61-63, 85-86, 137, 160, 162-163, 164, 256, 264, 372-373, 392, 455, 549, 557, 582-583, 589-594, 628, 642

Q

Qiproja — konflikti turko-grek për Qipron — 625, 628-630, 631, 632

R

Revizionistët francezë — 71, 279, 591

Revizionistët italianë — 46, 60, 590-591, 593

Revizionistët spanjollë — 46, 60, 70

Revizionizmi modern

— revizionistët modernë — tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe armiq të popujve — 71-72, 101, 143-144, 248, 249-250, 393, 541, 589

— kontradiktat dhe kriza në gjirin e revizionistëve. Mbledhjet e partive revizioniste — 353-354, 356, 589-594, 596

— qëndrimet armiqësore ndaj PPSH e RPSH — 87, 403, 481-482, 589

Revolucioni socialist; rruga ngadhënjimtare e tij — 206, 245, 247, 249, 353-354, 356, 362, 363, 379, 383

Rumania

— politika e jashtme oportunisto-revizioniste e udhëheqjes rumune. Marrëdhëniet e saj me Kinën — 46-47, 60, 71, 129, 204, 276, 356, 387, 388, 475, 644

— marrëdhëniet me RPSH — 397

RR

Rrethimi imperialisto-revizionist — 289, 379

S

Spiunazhi, spiunë, agentë — 8-9, 11, 20-21, 22, 139, 591

Sta'in, Josif Visarionoviç — 21, 149, 157, 238, 247, 248-250, 310, 517, 653

Strategjia dhe taktika imperialiste e revizioniste — 71-73, 157-159, 238-239, 355-356, 357-361, 406-407, 417, 515-518

Superfuqitë, lufta e njëkohshme e partive m-l dhe e popujve kundër tyre — 141-142, 151, 156-157, 247-248, 333, 335, 355-356, 386-387, 388-390, 405-406, 482, 510-513, 514, 575-576, 631

SH

Shovinizmi — 425-426, 625-626, 628-629

Shqiptarët e mërguar — 373-374

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan

— strategjia globale e imperializmit amerikan, politika e luftës dhe e agresionit në Vietnam e në vende të tjera — 88-89, 91-92, 98-99, 108, 121, 122-123, 132, 138-142, 143-144, 149-150, 172, 196-199, 239, 246-248, 299, 303, 326-330, 341-343, 354-356, 364, 377-379, 381-382, 388-389, 393, 401, 405-406, 408-409, 462, 481-483, 507-508, 514-515, 583, 629, 644

— marrëdhëniet, kontradiktat me shtetet imperialiste e revizioniste; lufta e popujve kundër imperializmit amerikan — 59-60, 78, 204, 246-247, 356-357, 387, 388, 512-513, 542

— vizitat e Niksonit, Kisingerit dhe misionarëve të tjerë amerikanë në Kinë — 10-11, 18, 58, 61-62, 64, 65, 69, 74, 75, 76, 77, 80-81, 88-89, 91-101, 115, 117-119, 121, 124-125, 178-179, 187, 227, 406, 407-409, 535-536, 619, 645

— qëndrimet armiqësore të SHBA-së ndaj RPSH — 20-21, 22, 481-482

Shih edhe: Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeta-amerikane; Afrimi, lidhjet dhe bashkëpunimi kino-amerikan

Shtypi, agjencitë e lajmeve dhe radiotelevizioni i vendeve borgjeze e revizioniste — 14, 15, 46, 58, 65, 88-90, 93, 94, 97, 112, 155, 158-159, 170, 175, 178-179, 199, 201, 230, 278-279, 350, 357-358, 369, 413, 420, 436, 449, 450, 542-543, 616-617, 621

T

Traktati i Varshavës — shndërrimi i tij në një armë presioni dhe agresioni nga socialistët sovjetikë — 33-35, 287, 289, 387-388, 481, 482, 483, 511

Tregu i Përbashkët Evropian — 350, 351, 357-358, 363, 364-366

Turqia — politika e jashtme dhe e brendshme e saj, marrëdhëniet me RPSH — 27, 137, 537, 625-626, 629-630

V

Vendet arabe, popujt arabë — 573-574, 575-576, 597
Vendet e «paangazhuara» — 233, 361, 363, 541
Vietnami i Jugut — lufta e popullit të tij kundër agresorëve amerikanë dhe reaktionit të brendshëm. Kompromiset e udhëheqjes së Frontit Kombëtar të Çlirimit me imperializmin amerikan. Marrëdhëniet me RPSH — 108, 122-126, 132, 138-140, 158, 168, 172, 197, 207-212, 269, 285-286, 298-302, 376-379, 382, 633
Vietnami — Republika Demokratike e Vietnamit
 — lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë. Disfatat e imperia-

lizmit amerikan në Vietnam. Pozitat oportuniste ndaj SHBA-së — 91-92, 121, 131, 144, 168, 186, 198, 207-208, 269, 276-277, 298-302, 326-330, 341-343, 376-378, 379, 380, 382-383, 410-411, 489

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 118-119, 125, 126, 210-211
 — marrëdhëniet me PPSH e RPSH — 207-208, 269, 285-286, 298-299, 578, 581
 Shih edhe: Bisedimet dhe marrëveshja amerikano-vietnameze në Paris.
Vigjilenca revolucionare për mbrojtjen e atdheut — 73, 87, 169, 280, 289, 290, 482, 484, 485, 574, 627

TREGUESI I EMRAVE*

A

Ajeti, Idriz — 317
 Ajzenhauer, Duajt — 109
 Alende, Salvador — 553, 557
 Alia, Ramiz — 41, 43, 130, 137, 146, 153, 160, 164, 183, 235, 244, 255, 256, 264, 295, 312, 318, 392, 397, 427, 435, 460, 462, 491, 497, 504, 540, 561, 565, 605
 Anderson, Nils — 43, 83
 Anderson, Rëne — 83
 Aust, Ernst — 295, 622

B

Babëf, Grak — 492
 Bakalli, Mahmut — 528-529
 Bakariç, Vladimir — 280
 Balluku, Beqir — 325
 Belishova, Liri — 530
 Berlinguer, Enriko — 593
 Bërc, Rexh — 561, 565, 572
 Bijediç, Xhemal — 658
 Boletini, Ajete — 323
 Boletini, Isa — 323

Bonaparti, Napoleon — 5
 Bond, Xheims — 10
 Brand, Vili — 464
 Brezhnjev, Leonid — 25, 103-104, 139, 143, 151, 152, 154, 157, 210, 299, 301, 342, 388, 425, 463, 464, 471, 497, 505-506, 508, 522, 535-536, 576, 655, 656
 Buda, Aleks — 259, 262, 348
 Buto, Ali Zylfikar — 17, 266

C

Cedenbal, Jumzhagin — 7
 Çeka, Neritan — 262
 Çin Hui To — 223
 — **Ç**
 Çabej, Eqrem — 262, 317
 Çan Çun Çiao — 8
 Çan Kai Shi — 99, 448, 450, 466
 Çarçani, Adil — 257, 433, 603
 Çaushešku, Nikolae — 70, 71, 73,

* Emrat e klasikëve të marksizëm-leninizmit janë vendosur në treguesin e lëndës.

117, 142, 157, 181, 233, 444,
453, 628, 643, 645
Çen Ji — 8, 19, 223
Çen Po Ta — 9-11, 222, 225,
229, 466, 468-469, 551
Çen Shao Kuen — 321
Çervenkovski — 291
Çian Çin — 97-98, 101, 226,
465-468, 502, 535, 542, 626
Çiao Kuan Hua — 237-241, 566,
649
Çi Pen Fei — 360, 402, 440,
442, 475, 518, 563
Çu De — 9
Çu En Lai — 8, 10, 13-14, 19,
48, 64, 65, 69, 73, 81, 85, 93-
98, 100-101, 114-120, 125, 173,
178, 203, 210, 226-228, 238,
275, 313, 331-339, 350-351,
357-360, 363-365, 384, 436-437,
449, 450-451, 465-466, 469, 502,
535, 541, 542-543, 547, 550,
554, 606, 616-617, 619-620

D

Dedijer, Vladimir — 21
D'Estën, Zhiskar Valeri — 655-
-656
Dë Gol, Sharl — 357, 545
Dode, Petro — 323, 600
Dolanski, Stane — 280
Domi, Mahir — 317
Dubçek, Aleksandër — 626, 628,
630
Dun Bi U — 563
Duraku, Rexhep — 640
Dyklo, Zhak — 71

E

Emer, Xhulian — 20-21

F

Fam Van Dong — 382, 578, 579,
581
Fan Ji — 167, 261, 282
Filip, Lui — 492
Flit, Van — 21, 301
Ford, Xherald — 655
Franko, Françisko — 608
Frashëri, Emin Erer — 624
Frashëri, Sami — 624

G

Gën Biao — 45, 447-448
Gierek, Eduard — 157, 463
Greçko, Andrei — 106, 107
Grivas, Xhorxh — 625
Guevara, Ernesto Çe — 134

GJ

Gjika, Xhebro — 323
Gjilas, Milovan — 21

H

Hanku, Rahman — 598, 606-
-607, 610
Heig, Aleksandër — 276, 328
Hill, Eduard — 540
Hitler, Adolf — 196, 486
Hoang Mau — 133
Holmberg, Nils — 171
Honeker, Enrik — 464
Hopkins, Harri — 408
Ho Shi Min — 198, 208-210,
410
Hoxha, Nexhmije — 258, 324,
572

Hoxha, Fadil — 50-55, 57, 318,
525-529, 638-641
Hrushov, Nikita — 76, 95-96,
100-101, 109, 207-208, 209, 301,
505, 509, 653
Huan Jun Shen — 222-223
Husak, Gustav — 157, 626, 630

I

Ibarruri, Dolores — 70-71
Iliçov, Leonid — 103

J

Janekoviç, Dara — 278, 420
Jao Ven Juan — 542, 646, 648,
657
Je Çyn — 8
Jeh Çien Jin — 116, 223, 309
Jeng Sari — 183, 190, 418, 468,
489, 491

K

Kan, Aga — 266
Kanellopoulos, Panajot — 21
Kan Shen — 8, 19, 117, 120,
226, 228
Kapo, Hysni — 17, 18, 83, 130,
183, 258, 281, 322, 323, 491,
628, 638
Kapo, Vito — 17, 18
Karagjorgjeviç, Aleksandër —
288
Karajanis, Dionis — 35
Kardel, Eduard — 280
Karriljo, Santiago — 46, 60,
70-73, 453

Kastro, Fidel — 199, 234, 541
Kaza, Raimond — 46
Kazhimiezh, Mijal — 322, 424
Kenedi, Xhon — 301, 378
Këllezi, Abdyl — 650, 651
Kieu Samfan — 613-614
Kim Ir Sen — 110, 175, 203-205,
234, 344, 414, 430, 548
Kisinger, Henri — 94-95, 173,
179, 185-187, 210, 269, 276,
299, 328, 329, 401, 405-409, 416,
422, 462, 502, 536, 542, 644,
645, 649
Koleka, Spiro — 433, 522, 601,
602
Kondi, Pirro — 549
Konfuci — 452, 618, 658
Kosigin, Aleksej — 139, 143, 655
Kostallari, Androkli — 262, 317
Krasniqi, Mark — 320
Ksuan Thui — 445

L

Le Duk Tho — 269, 276, 299, 328
Leird, M. Robert — 276-277
Le Zuan — 276, 536
Li Hsien Nien — 64, 93, 294,
309, 440, 449, 453, 544-545,
602, 616-617, 618
Li Huo Fen — 223
Lin Biao — 6-15, 119-120, 125,
220-230, 236, 238, 332, 335-338,
339, 428, 434, 440, 442, 452,
465, 467-469, 534, 551, 556,
618
Liu Shao Çi — 11, 220, 224, 226,
337-338, 339, 440-441, 468, 534-
-535, 543, 551
Liu Xhen Hua — 617, 636

Lon Nol — 182, 232, 233, 296,
329, 394, 395, 396, 410, 498,
614
Lubonja, Todi — 529
Luigji i 13-të — 405
Lu Ju Lan — 311
Lumumba, Patris — 362

LL

Lleshi, Haxhi — 635

M

Makarezos, Nikolas — 474, 476
Makarios, Elefterios — 625-626,
628, 630
Mak Arthur, Duglas — 124
Maliani, Cirilio — 273
Malile, Reiz — 436
Malro, Andre — 5
Manesku, Manea — 237
Mao Ce Dun — 7, 8, 9-10, 11-
-12, 13, 15, 19, 63, 65, 80-81,
94-95, 97-98, 102, 121, 125,
220-229, 336-339, 344, 407, 436-
-437, 449, 465-469, 534-535,
543, 547, 605, 626
Marat, Zhan Pol — 492
Marko, Rita — 427, 473, 604
Marshe, Zhorzh — 279
Mediçi, Xhuzepe — 350-351, 485
Mensfeld, Majk — 121
Milliez, Pol — 258
Mintof, Dominik — 496
Mobutu, Sese Seko — 350, 361,
362-363
Mugosha, Dushan — 27, 640
Myrdal, Jan — 40
Myri, Zhilber — 127

N

Naser, Gamal Abdel — 361
Nehru, Khavaharlal — 361
Ngo Din Diem — 378
Nguyen Huu Tho — 633, 634,
635
Nguyen Kao Ki — 379
Nguyen Van Sin — 131, 133
Nguyen Van Thieu — 108, 269,
276-277, 299, 301, 302, 328-
-330, 341, 378, 382-383, 394,
398, 410
Nguyen Zui Çin — 579
Nikeziç, Marko — 24, 194-195,
291, 305, 307, 318
Nikson, Pat — 68, 98, 502
Nikson, Riçard — 10-11, 61-62,
64, 65, 68, 69, 77-79, 80-81,
84-86, 87, 112, 119, 125, 138-
-142, 143, 144, 154-158, 199,
227, 299, 301-302, 326-327,
341, 344, 377, 378, 380, 381,
382, 388, 394, 405-406, 448,
450-451, 486, 502, 505-506, 542,
556
Nuhak Fumsavan — 494

P

Paçrami, Fadil — 529-530
Pallamas — 35
Papadhopullos, Jorgos — 369-
-371, 373, 474, 478
Papandreu, Georg — 371
Papa Piu VI — 470
Paredes, Macedos Saturnino —
41, 42
Pashiç, Nikolla — 288
Paveliç, Ante — 288
Pen Çen — 440

Peroviç, Latinka — 291, 305
Pin De Huai — 12
Pirro (mbret i Epirit) — 140
Podgorni, Nikolai — 150-151,
173, 185-187, 198-199, 211, 655
Pollo, Stefanaq — 262
Pompidu, Zhorzh — 517-518,
522, 542, 554
Popoviç, Koça — 305

R

Radek — 288
Radovicka, Petrit — 607
Rankoviç, Aleksandër — 24, 27,
194-195, 291, 639, 640
Rishëlië, Armand Dy Plesis —
405
Robespier, Maksimilian — 5,
492
Robo, Xhorxhi — 80, 550
Roxhers, Uiliam — 423
Rusvelt, Franklin — 408

S

Sadat, Anvar — 216, 218, 219
Samson — 626, 630
Sanmugathasan, Nangaliman —
130, 134
Sarin Çak — 613
Seiti, Lik — 373
Sihanuk, Norodom — 180, 181,
182, 183, 184, 190-191, 202,
231-234, 235, 296, 393, 394-
-396, 410-411, 440, 446, 459,
472, 479, 486-488, 489-490, 491,
492-493, 495, 498-499, 500, 536,
613
Sin Man Ri — 205

Skot, Valter — 121
Solxhenicin, Aleksandër — 653
Song Guan Xho — 430
Spiru, Nako — 530
Strong, Ana Luiza — 68
Sukarno, Ahmed — 361
Sulcberger, C.L. — 20-22

SH

Shabrol, Klod — 46
Shan Fe — 192
Shehu, Mehmet — 522-523, 525,
640
Shmid, Helmut — 655
Shuman, Robert — 423
Shuteriqi, Dhimitër — 317
Shy Shian Çien — 519-521

T

Tanaka, Kakuçi — 266, 275,
448, 450-451
Tejlor, Roland — 43, 83
Ten Hsiao — 80-81
Ten Hsiao Pin — 440-443, 469,
605, 616-617, 620, 649
Tepavac, Marko — 305
Tijo, Sharl — 47
Tito, Josif Broz — 21-22, 23,
24, 142, 157, 166, 190, 193-
-195, 232-234, 278-280, 283,
291-292, 293, 361, 420-421, 444,
463, 482-483, 525-529, 576, 591-
-592, 626, 628, 638, 639, 640-
-641, 645
Toska, Haki — 273, 397, 427,
600, 601, 604
Tripallo, Miha — 24, 25

U Fa Hsien — 223
Ulbricht, Valter — 464

V

Van Dun Hsin — 441
Van Hsin Çen — 133
Van Hun Ven — 550
Van Min — 220, 441, 442
Venizellos, Sofokli — 21, 626
Vllahoviç, Velko — 23-24
Vu Fa Hsien — 8

X

Xoxe, Koçi — 427, 638, 639

XH

Xhonson, Lindon — 378

Ylli, Kahreman — 638
Y Khan — 187, 409, 449, 477,
653, 657-658

Z

Zaharov, Bazil — 211

ZH

Zhapa, Vasil — 369-370, 373
Zhivkov, Teodor — 25
Zhyrke, Zhak — 45-47, 89, 312,
322, 608
Zhyst, Sen — 5

TREGUESI
GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

Adriatik (deti) — 33, 292-293,
481, 483
Afrikë — 146, 361, 514
Akademia e Shkencave e RPSH
— 213, 348-349
«Al Ahram» (gazeta) — 219
«Al Fatah» (lëvizja nacionalçli-
rimitare palestineze) — 595, 597
Algjer — 549
Algjeri — 202, 231, 234, 605
Amerika Latine — 227, 361,
514
Angola — 621
An Lok (Vietnam) — 122, 132,
138
Ansambli artistik shtetëror
«Mansudo» i RDP të Koresë —
659
Arabia Saudite — 515
Associated Press — 66
Athinë — 237
Azi — 78, 268, 334-335, 514

B

Ballsh (Fier) — 257
Bangladesh — 17, 99, 119, 630

Barlev (Egjipt) — 573
Bashkimet Profesionale të Shqipërisë dhe Kongresi i 7-të i tyre — 131, 133, 136, 473
Beograd — 200, 657
Bon — 471
«Borba» (gazeta) — 193
Bosnjë (Jugosllavi) — 287, 289
Brioni (Jugosllavi) — 27, 29,
190
Bruksel — 480
Bukuresht — 237
Bunë (lumi) — 413

C

Cejlon — 130
CIA — 20, 452

Ç

Çansha (Kinë) — 465
Çekoslllovakia — 592-593

D

Damask — 575
Da Nang (Vietnam) — 132

«Dans le turbillon de l'histoire» (libri) — 20-22
Danub (lumi) — 305
Dien Bien Fu (Vietnam) — 122, 378, 382
Dropull (Gjirokastër) — 36, 37, 113
Durrës — 231, 519, 581

E

Egje (deti) — 371
Ekuador — 322
ENOS — 625-626, 629

F

«Face au révisionnisme» (libri) — 127
Federata e Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut — 131, 133
Federata e Sindikatave të Vietnamit — 133

G

«Gestapo» — 256
Golan (Siri) — 573, 575
Groenlandë — 572
Guam (ishulli) — 58

GJ

Gjirokastër — 36, 113

H

Hajfong (Vietnam) — 121, 132,

139, 341
Hanoi — 108, 121, 132, 139, 173, 341, 401, 408-409
Hanxhou (Kinë) — 465
Hebron (Siri) — 573
Helsinki — 316
Hercegovinë (Jugosllavi) — 195, 287, 289
Hidrocentrali i Fierzës — 52, 82, 427, 600, 604, 606, 610, 611
Hidrocentrali i Komanit — 282
Hidrocentrali i Vaut të Dejes — 606
Hong-Kong — 238
HSINHUA — 65, 86, 367, 443, 474, 502, 645, 649
Hue (Vietnam) — 108, 122, 132, 138

I

Indi — 266
Indokinë — 80-81, 92, 393, 394, 408
Irak — 515
Iran — 515
Irlanda e Veriut — 356
Iskenderun (Turqi) — 625

J

Jalu (lumi) — 124
Jordani — 515

K

Kakavije (Gjirokastër) — 36
Kaliforni (SHBA) — 505, 512

Kanada — 236, 271
Kemp Dejvid (SHBA) — 505
Këshilli i Mbrojtjes i RPSH — 481
KGB — 452
Kombinati Metalurgjik (Elbasan) — 257, 270-271, 282, 347, 433, 457, 601, 602
Konferenca e Helsinkit për «sigurimin evropian» — 316, 400, 501
Konferenca e Vjenës për «pakësimin e ekullibruar të ushtrive në Evropë» — 386-390, 513
Konferenca Ndërkombëtare për Vietnamin — 402, 422, 423
Kongo-Brazavil — 200
Kongo-Zaire — 350-351, 362-363
Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe — 317, 318, 319, 320, 324, 348
Kongresi i 6-të i BRPSH — 311
Korçë — 238
Koreja e Jugut — 204
Korfuz (Greqi) — 36
Kroaci — 29, 306
Kuan Tri (Vietnam) — 108, 132
Kuvendi i Parë i Studimeve Ilire — 259-260, 262

L

Labovë (Gjirokastër) — 369
Laos — 122, 329, 393, 394, 395, 408 411 494
«L'Humanité» (gazeta) — 591
Liban — 256, 515
Lindja e Afërme — 335
Lindja e Largme — 119, 205, 266, 515

Lindja e Mesme — 119, 218-219, 334-335, 514, 516, 575-576, 630
Londër — 408, 475
Lufta e Dytë Botërore — 197, 240, 246, 247, 288
Lufta e Parë Botërore — 288

M

Mali i Zi — 26, 27, 55, 289, 317, 323
Maltë — 21, 33, 496
Manastir (Jugosllavi) — 324
Maqedoni — 24, 27, 288, 289, 307, 371, 527
Marrëveshja e Gjenevës dhe e Zurichut — 625
Marrëveshja e Gjenevës për Indokinën — 108, 233, 378, 380, 381, 384, 398-399
Mauritani — 202, 231, 234
Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Bukuresht (qershor 1960) — 589-590, 594
Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore (Moskë 1960) — 589-590
Mersin (Turqi) — 625
Mesdhe (zona) — 32, 33, 216, 481, 483, 627, 629
Ministria e Bujqësisë e RPSH — 189, 273
Ministria e Mbrojtjes Popullore e RPSH — 110, 242, 243, 597
Ministria e Ndërtimit e RPSH — 598
Ministria e Punëve të Brendshme e RPSH — 373
Ministria e Shëndetësisë e

RPSH — 105
Ministria e Tregtisë e RPSH — 397
Mongoli — 7, 222, 228, 230, 236, 238, 425
Moskë — 103, 108-109, 112, 121, 143, 144, 154, 156, 166, 172, 187, 193, 200, 204, 210, 386, 388, 407, 408
Mukje (Krujë) — 299

N

Nankin (Kinë) — 8
Nju Jork — 268, 568

O

Oran (Algjeri) — 234

P

Pakistan — 119, 266
Pakti i Mossulimit Sovjeto-Gjerman — 240
Panmunxhon (Kore) — 286
Paris — 46, 84, 88, 127, 232-234, 422, 475, 655
Pei Da-he (Kinë) — 8
Pekin — 8, 10, 12, 13, 48, 66, 70, 79, 96, 98, 100, 111, 114, 115, 117, 121, 124-126, 173, 178, 187, 210, 237, 239, 309, 367, 407, 417, 476, 556, 601, 603, 617
Pnom-Pen — 569
Pragë — 594
«Pravda» (gazeta~) — 62

Prishtinë (Kosovë — Jugosllavi) — 317
Protokoll i Konferencës së Firreces — 274, 284
Pusan (Kore) — 124

R

Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit — 310, 509
«Rilindja» (gazeta~) — 33, 193-194

S

Sajgon — 108, 122, 138, 286, 302
SALT — 389
Sarandë — 36, 113
Seul — 108
Sërbi — 26-27, 279, 283, 287-289, 291, 305, 306, 307
«Sfida shqiptare» (libri~) — 40
Siberi (BRSS) — 425
Sinai (Egjpt) — 575
Siri — 161, 256, 514, 575, 597
Sofratikë (Gjirokastër) — 113
Stamboll (Turqi) — 137
Suez (kanali~) — 573

SH

Shangai (Kinë) — 8, 79, 100, 649
Shkup (Jugosllavi) — 317
Shoqata e Miqësisë Francë-Shqipëri — 258, 312

T

Tajlandë — 393, 408
«Tajms» (gazeta~) — 276
Tajvan — 18, 80-81, 88, 100, 239, 266, 268, 334, 619
Tanjug — 24, 193, 195, 291, 644
TASS — 218-219
TEC-i (Ballsh-Fier) — 282
Tiranë — 181, 214, 237, 274, 581
«Triëndëshi i zi» (libri~) — 5

U

Uashington — 386, 443, 508, 512, 583
Ulan-Bator — 238
Universiteti i Prishtinës (Kosovë) — 320, 638, 639
Universiteti i Tiranës — 56, 162, 275
Usur — 222, 227

V

Varkizë (Greqi) — 286, 299, 300,

301, 330, 381, 382
Varshavë — 84, 88
Vatikan — 438, 449, 477, 484-485
Vietnami i Jugut — 122, 138-139, 269, 300-302, 342, 376, 378-381
Vjenë — 403
Vladivostok (BRSS) — 655
Vlorë — 113, 319, 322, 368, 369, 370
«Vorio-Epir» — 369-370

Z

«Zëri i popullit» (gazeta~) — 44, 58, 62, 85-86, 107, 128, 148, 152, 153, 164, 193, 201, 259, 397, 497, 503, 506, 571, 577, 585, 589, 596, 628, 631

ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta~) — 155, 533

	Faqe
1. — 2 janar 1972. Paraqitje reaksionare e një revolucionari të madh francez	5
2. — 3 janar 1972. Ç'po ngjet me grupin e Lin Biaos?	6
3. — 4 janar 1972. Në ambasadat tona secili duhet t'i vihet punës energjikisht	16
4. — 5 janar 1972. Shënim	17
5. — 6 janar 1972. Niksoni «mysafir» — armik i Kinës	18
6. — 12 janar 1972. Vdiq Çen Jia	19
7. — 16 janar 1972. Pohime të një agjenti të CIA-s rreth kompleteve antishqiptare të amerikano-anglezëve dhe të greko-jugosllavëve	20
8. — 27 janar 1972. Kriza e regjimit titist vazhdon të thellohet	23
9. — 1 shkurt 1972. Pse ky interesim i titistëve për Kosovën	26
10. — 2 shkurt 1972. Çfarë duhet të kemi parasysh në politikën tonë ndaj Italisë dhe Greqisë	32
11. — 2 shkurt 1972. Amerikanët po i krehin bishtin Çu En Lait	39
12. — 3 shkurt 1972. Një libër i mirë për vendin tonë	40
13. — 5 shkurt 1972. Shënim	41

	Faqe
14. — 7 shkurt 1972. Takimi me shokun Paredes	42
15. — 9 shkurt 1972. Shënim	43
16. — 12 shkurt 1972. Vija e demarkacionit midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë nuk mund të shlyhet	44
17. — 13 shkurt 1972. Partia Komuniste e Kinës është në pozita revizioniste	45
18. — 16 shkurt 1972. Çfarë dhe si duhet biseduar me Fadil Hoxhën	50
19. — 16 shkurt 1972. Kujdes nga provokacionet e titistëve	56
20. — 19 shkurt 1972. Përsëri për takimin e ambasadorit tonë me Fadil Hoxhën	57
21. — 20 shkurt 1972. Vija kineze kundër revizionizmit sovjetik ushqehet nga motive nacionaliste	58
22. — 21 shkurt 1972. Mbi vizitën e Niksonit në Pekin	64
23. — 22 shkurt 1972. Mao Ce Duni priti Niksonin	65
24. — 23 shkurt 1972. Mendime të Niksonit të thëna përpara udhëheqësve kinezë	66
25. — 24 shkurt 1972. Gruaja e Niksonit reklamon Kinën	68
26. — 25 shkurt 1972. Vazhdojnë bisedimet Çu En Lai — Nikson	69
27. — 25 shkurt 1972. Kinezët luftojnë që t'ua rrëmbejnë sovjetikëve hegjemoninë në kampin revizionist	70
28. — 27 shkurt 1972. Amerikanët janë të kënaqur nga Mao-Çuja	74
29. — 28 shkurt 1972. Shënim	75
30. — 3 mars 1972. Kinezët kanë devijuar ashtu si Hrushovi	76

	Faqe
31. — 4 mars 1972. Kinezët nuk na kanë dhënë asnjë informatë zyrtare për vizitën e Niksonit	77
32. — 5 mars 1972. Ne nxjerrim konkluzione në bazë të fakteve	80
33. — 6 mars 1972. Provokatorët marrin përgjigjen e duhur	82
34. — 14 mars 1972. Miq të mirë të vendit tonë	83
35. — 14 mars 1972. Po ndiqet rruga e bojkotimit të heshtur të Shqipërisë	84
36. — 16 mars 1972. Të mos jemi ne shkaktarët e ftohjes së miqësisë me kinezët	87
37. — 18 mars 1972. Asnjë artikull në gazetat kineze për vizitën e Niksonit në Kinë	88
38. — 21 mars 1972. Udhëtimi i Niksonit në Kinë, bisedimet kino-amerikane, komunikata përfundimtare	91
39. — 22 mars 1972. Kina dhe Bashkimi Sovjetik	102
40. — 25 mars 1972. Të pengohet futja e sëmurdjes së lisë në vendin tonë	105
41. — 27 mars 1972. Të denoncojmë synimet ekspansioniste sovjeto-amerikane në Ballkan	106
42. — 28 mars 1972. Larg duart nga Ballkani!	107
43. — 4 prill 1972. Ofensivë e madhe në tri frontet e Vietnamit	108
44. — 6 prill 1972. Me koreanët ka vetëm reciprocitet	110
45. — 8 prill 1972. Pritje zyrtare në Pekin për delegacionin tonë të bujqësisë	111
46. — 12 prill 1972. Manovra politike rreth vizitës së Niksonit në Bashkimin Sovjetik	112
47. — 14 prill 1972. Ambasadori grek viziton krahinat tona të Jugut	113

	Faqe
48. — 17 prill 1972. Një bisedë e Çu En Lait pa probleme politike	114
49. — 20 prill 1972. Kina po futet më thellë në një rrugë pa krye	121
50. — 22 prill 1972. Ofensiva vietnameze dhe Kina	122
51. — 26 prill 1972. Shënim	127
52. — 28 prill 1972. Lufta heroike e popullit të Vietnamit dhe intrigat e socialimperializmit sovjetik	128
53. — 29 prill 1972. Shënim	129
54. — 29 prill 1972. Pasoja të rënda për shkak të një aventure të nxitur nga ana e Koresë dhe e BS në Cejlon	130
55. — 1 maj 1972. Bisedë me kryetarin e Federatës së Sindikatave për Çlirimin e Vietnamit të Jugut	131
56. — 1 maj 1972. Fitore të shkëlqyera të vietnamezëve	132
57. — 4 maj 1972. Takim me delegacione nga Kina dhe Vietnami	133
58. — 6 maj 1972. Takim me shokun Sanmugathasan	134
59. — 9 maj 1972. Në Kongresin e BPSH përshëndetin miqtë e huaj	135
60. — 11 maj 1972. Shënim	136
61. — 12 maj 1972. Shënime	137
62. — 13 maj 1972. Ofensiva fitimtare e vietnamezëve dhe bllokada agresive fashiste e porteve të Vietnamit të Veriut nga ana e imperialistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës	138
63. — 17 maj 1972. Shkallëzim i ri i luftës amerikane kundër Vietnamit	143

	Faqe
64. — 18 maj 1972. Të ndihmojmë marksistë-leninistët në Afrikë	146
65. — 20 maj 1972. Shënim	147
66. — 21 maj 1972. Qëndrim jo i mirë i kinezëve	148
67. — 22 maj 1972. Niksoni në Moskë — Kina hesht	149
68. — 25 maj 1972. Të demaskojmë vajtjen e Niksonit në Moskë	152
69. — 26 maj 1972. Shënim	153
70. — 29 maj 1972. Bisedimet sovjeto-amerikane të Moskës dhe qëndrimi i Kinës	154
71. — 30 maj 1972. Shënim	160
72. — 2 qershor 1972. Qëndrimi ynë i drejtë ka ndikim të popujt arabë	161
73. — 2 qershor 1972. Të përhapim jashtë mendimin shkencor shqiptar	162
74. — 3 qershor 1972. Të demaskojmë dhe të kundërshtojmë me të gjitha forcat aleancën kundërrevolucionare sovjeto-amerikane	164
75. — 5 qershor 1972. Baza në Kinë — shtatë vjet pa udhëheqje partie	165
76. — 5 qershor 1972. Titoja në Moskë	166
77. — 7 qershor 1972. Shënim	167
78. — 8 qershor 1972. Përsëri ndryshime në qëndrimin e ambasadorëve vietnamezë	168
79. — 8 qershor 1972. Vigjilencë ndaj zhvillimit të ngjarjeve në Itali	169
80. — 9 qershor 1972. Kinezët kanë pushuar polemikën kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik	170
81. — 10 qershor 1972. Takim me një udhëheqës komunist suedez	171

	Faqe
82. — 13 qershor 1972. Diplomaci sekrete në mes «komunistëve» dhe imperialistëve	172
83. — 13 qershor 1972. Shprehje e politikës së afrimit me amerikanët	175
84. — 14 qershor 1972. Fashistët mund të provokojnë selinë e ambasadës sonë në Romë	176
85. — 16 qershor 1972. Pse gjithë këto falënderime të përsëritura?	177
86. — 21 qershor 1972. Ujdi «e bukur» kino-amerikane	178
87. — 21 qershor 1972. Shënim	180
88. — 22 qershor 1972. Rreth vizitës së Sihanukut	181
89. — 23 qershor 1972. Bisedë me Sihanukun	182
90. — 24 qershor 1972. Takim me Jeng Sarin	183
91. — 25 qershor 1972. Shënim	184
92. — 25 qershor 1972. Podgorni në Hanoi dhe Kisingeri në Pekin	185
93. — 26 qershor 1972. Do të përkrahim rezolutën e RDP të Koresë në OKB	188
94. — 27 qershor 1972. Së shpejti vjen ministri i Bujqësisë i RP të Kinës	189
95. — 28 qershor 1972. Rreth personalitetit të Sihanukut	190
96. — 1 korrik 1972. Arriti delegacioni i bujqësisë së RP të Kinës	192
97. — 4 korrik 1972. Populli kosovar nuk do të jetë kurrë mik i titistëve	193
98. — 5 korrik 1972. Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik — përgjegjës për gjenocidin në Vietnam	196
99. — 6 korrik 1972. Një ambasador që hiqet si komunist	200

	Faqe
100. — 9 korrik 1972. Gjetën jugosllavët titistë te ne kishë ku të falen	201
101. — 11 korrik 1972. Shqipëria nuk është han me dy porta	202
102. — 12 korrik 1972. Një «ide gjeniale» për bashkimin e Koresë që u leverdis imperialisto-revizionistëve	203
103. — 13 korrik 1972. Vietnami dhe «miqtë e mëdhenj» të tij	207
104. — 14 korrik 1972. Të mendojmë më mirë për marrëdhëniet tona me kinezët	213
105. — 18 korrik 1972. Bisedë me delegacionin e bujqësisë të RP të Kinës	214
106. — 19 korrik 1972. Një shuplakë e rëndë për socialimperializmin sovjetik	216
107. — 21 korrik 1972. Gjendja në Lindjen e Mesme ka qenë dhe mbetet e turbullt	218
108. — 22 korrik 1972. «Komploti i Lin Biaos»	220
109. — 24 korrik 1972. Sihanuku na njofton për presionet që i kanë bërë titistët	231
110. — 27 korrik 1972. Sihanuku u largua	235
111. — 30 korrik 1972. Dy të dhëna për Lin Biaon	236
112. — 1 shtator 1972. Vizita e një zëvendësministri të Jashtëm të Kinës në Tiranë	237
113. — 5 shtator 1972. Një vapor grek mbytet në ujërat tona territoriale	242
114. — 5 shtator 1972. Një delegacion ushtarak kinez do të vijë për vizitë	243
115. — 7 shtator 1972. Platformë pune me partitë komuniste (m-l) motra	244
116. — 8 shtator 1972. Shënim	256
117. — 9 shtator 1972. Takim me shokun Adil Çarçani	257

	Faqe
118. — 11 shtator 1972. Takim me Pol Miliezin	258
119. — 15 shtator 1972. Të një gjaku, të një kombi, të një gjeneze, të një gjuhe e të një flamuri	259
120. — 19 shtator 1972. Shënim	261
121. — 20 shtator 1972. Një kuvend që e vuri shkencën tonë në nivelin botëror	262
122. — 23 shtator 1972. Shënim	263
123. — 24 shtator 1972. Shtypi të shprehë mirë nuancat e politikës sonë ndaj veprimeve politike të Kinës	264
124. — 26 shtator 1972. Bisedë me shokët e tregtisë që shkojnë në Kinë	265
125. — 27 shtator 1972. Kina po i forcon pozitat në arenën ndërkombëtare	266
126. — 28 shtator 1972. Takimi me japonezët ishte në favor të Kinës	267
127. — 29 shtator 1972. Etapë e re në marrëdhëniet kino-japoneze	268
128. — 29 shtator 1972. Luftë dhe bisedime midis vietnamezëve e amerikanëve	269
129. — 30 shtator 1972. Kinezët akoma nuk kanë vendosur nga do ta marrin teknologjinë e kombinatit tonë metalurgjik	270
130. — 2 tetor 1972. Shënim	272
131. — 3 tetor 1972. Shënim	273
132. — 4 tetor 1972. Në bisedimet me grekët për problemet e kufirit të mbështetemi në protokollet ndërkombëtare	274
133. — 6 tetor 1972. Përgjigje e tërthortë e Çu En Lait	275
134. — 6 tetor 1972. Zhurmë rreth marrëveshjeve midis dy Vietnameve	276

	Faqe
135. — 13 tetor 1972. Pohime të hidhura të Titos për gjendjen e brendshme në Jugosllavi	278
136. — 13 tetor 1972. Takim me delegacionin e ushtrisë popullore çlirimtare kineze	281
137. — 15 tetor 1972. Qeveria kineze nuk e sheh të mundshëm plotësimin e kërkesave tonë ekonomike	282
138. — 19 tetor 1972. Titoja në konflikt me udhëheqësit e Serbisë	283
139. — 20 tetor 1972. Përsëri mbi çështjen e bisedimeve për problemet kufitare me grekët	284
140. — 21 tetor 1972. Vietnamezët na njoftojnë për marrëveshjen e tyre me imperialistët amerikanë	285
141. — 24 tetor 1972. Ç'mund të ngjasë në Jugosllavi pas vdekjes së Titos	287
142. — 25 tetor 1972. Bisedë me shokët e delegacionit ushtarak që do të shkojnë në RP të Kinës	290
143. — 26 tetor 1972. Titoja përpiqet të lajë hesapet me kundërshtarët e tij	291
144. — 29 tetor 1972. Udhëzime për delegacionin tonë tregtar qeveritar që ndodhet në Pekin	294
145. — 1 nëntor 1972. Shokët gjermanë kërkojnë mendim për statutin e partisë së tyre	295
146. — 1 nëntor 1972. Mbështetim politikën e Sihanukut kundër kompromisit me imperialistët amerikanë	296
147. — 2 nëntor 1972. Të tregohemi shumë miqësorë e dashamirë në bisedimet me shokët kinezë	297

	Faqe
148. — 2 nëntor 1972. Marrëveshja amerikano-vietnameze për paqe	298
149. — 3 nëntor 1972. Tragjedia vietnameze vazhdon	303
150. — 4 nëntor 1972. Jugosllavia është e krimbur përgjithmonë	305
151. — 6 nëntor 1972. Delegacioni ynë arriti në Pekin	309
152. — 7 nëntor 1972. Mësimet e pavdekshme të Revolucionit të Tetorit janë e do të jenë rrugërrëfyese për revolucionarët	310
153. — 8 nëntor 1972. Takim me delegacionin e rinisë kineze	311
154. — 9 nëntor 1972. Shënim	312
155. — 10 nëntor 1972. Çu En Lai priti dy delegacionet tona që ndodhen në Pekin	313
156. — 13 nëntor 1972. Shënim	314
157. — 15 nëntor 1972. Shënim	315
158. — 18 nëntor 1972. Nuk do të marrim pjesë në «Konferencën e përgjithshme evropiane mbi sigurimin dhe bashkëpunimin»	316
159. — 20 nëntor 1972. Gjuha shqipe po lulëzon e do të lulëzojë	317
160. — 21 nëntor 1972. Dijetarët kosovarë janë entuziastë për punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe	318
161. — 22 nëntor 1972. Serbët nuk duan që kosovarët të vijnë në festat tona të nëntorit	319
162. — 23 nëntor 1972. Një shqiptar me kurajë tradicionale	320
163. — 25 nëntor 1972. Takim me delegacionin e Ministrisë së Industrisë Metalurgjike të RP të Kinës	321

	Faqe
164. — 27 nëntor 1972. Shënim	322
165. — 28 nëntor 1972. Bisedë me vajzën e Isa Boletinit	323
166. — 10 dhjetor 1972. Mungesë sensi politik	325
167. — 15 dhjetor 1972. Manovrat e imperializmit amerikan dhe pleksja në to e verivietnamezeve	326
168. — 17 dhjetor 1972. Duke lexuar procesverbalin e një bisede të Çu En Lait	331
169. — 22 dhjetor 1972. Po luhet me gjakun e popullit heroik vietnamez	341
170. — 30 dhjetor 1972. «Demokraci socialiste» ala Kim Ir Sen	344

1973

1. — 6 janar 1973. Pengesa nga pala kineze për metalurgjikun	347
2. — 13 janar 1973. Në inaugurimin e Akademisë së Shkencave nuk do të ftojme të huaj	348
3. — 15 janar 1973. Disa deklarata antimarksis-te të Çu En Lait	350
4. — 18 janar 1973. Në Kinë propagandohet feja	367
5. — 23 janar 1973. Si duhet ta kuptojnë diplomacinë e shtetit tonë punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme	368
6. — 24 janar 1973. U sigluan dokumentet e përfundimit të luftës në Vietnam	375
7. — 25 janar 1973. Një paqe e mjerueshme pas një lufte të lavdishme	376

	Faqe
8. — 25 janar 1973. Panoramë e zhvillimit politik aktual në Evropë	386
9. — 26 janar 1973. Takim me ambasadorët vietnamezë	391
10. — 27 janar 1973. Shënim	392
11. — 28 janar 1973. U nënshkrua marrëveshja mbi mbarimin e luftës në Vietnam. Indokina — pre e ndarjes së zonave të influencës	393
12. — 29 janar 1973. Shënime	397
13. — 30 janar 1973. Vietnami ndihmohet vetëm duke qëndruar jashtë kombinacioneve imperialisto-revizioniste	398
14. — 31 janar 1973. Vërejtje për Ministrinë e Punëve të Jashtme	400
15. — 1 shkurt 1973. Kisingeri në Hanoi	401
16. — 2 shkurt 1973. Çi Pen Fei shtyn vizitën në vendin tonë	402
17. — 9 shkurt 1973. Përpjekje e paturpshme e revizionistëve sovjetikë	403
18. — 9 shkurt 1973. Një propozim i ri i qeverisë koreane	404
19. — 10 shkurt 1973. Kisingeri në Pekin	405
20. — 10 shkurt 1973. Megalomania e udhëheqësve vietnamezë	410
21. — 13 shkurt 1973. Shënim	412
22. — 15 shkurt 1973. Korrupsioni në Jugosllavi ka arritur kulmin	413
23. — 19 shkurt 1973. Me parimet ne nuk luajmë me asnjeri	414
24. — 19 shkurt 1973. Kina e ka kthyer kursin drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës	416
25. — 22 shkurt 1973. Shënim	418

	Faqe
26. — 27 shkurt 1973. Shënim	419
27. — 27 shkurt 1973. Titoja mendon se është kërthiza e botës	420
28. — 28 shkurt 1973. Ministria e Punëve të Jashtme të Kinës mban heshtje të plotë ndaj nesh	422
29. — 6 mars 1973. Bisedë me K. Mijalin	424
30. — 9 mars 1973. Për mosmarrëveshjet kufitare kinezët kanë rënë në kurthin e sovjetikëve	425
31. — 13 mars 1973. Vendimi ynë për të ndërtuar hidrocentralin e Fierzës është i paturdur	427
32. — 13 mars 1973. Provokacione të «specialistëve» kinezë si ato të revizionistëve sovjetikë	428
33. — 13 mars 1973. Shënim	430
34. — 14 mars 1973. Si t'i përgjigjemi një parulle bajate të kinezëve	431
35. — 15 mars 1973. Shënim	432
36. — 16 mars 1973. Manovra e kinezëve lidhur me ndërtimin e metalurgjikut	433
37. — 22 mars 1973. Pohime të ambasadorit kinez	434
38. — 29 mars 1973. Lajm i hidhur nga PK e Brazilit	435
39. — 7 prill 1973. Deri ku do të shkojë ftohësia e zvrtarëve kinezë ndaj nesh?	436
40. — 13 prill 1973. Provokacion fashist kundër ambasadës sonë në Romë	438
41. — 14 prill 1973. Takim me miq kinezë	439
42. — 15 prill 1973. Mao Ce Duni rehabiliton Ten Hsiao Pinin	440

	Faqe
43. — 18 prill 1973. Takim me ministrin vietnamez Ksuan Thui	445
44. — 20 prill 1973. Sihanuku dëshiron të vijë për vizitë miqësore e për pushime	446
45. — 20 prill 1973. «Grerëzat» borgjeze qëmtojnë mjaltin dhe lëshojnë helmin në kopshtin e «njëqind luleve»	447
46. — 23 prill 1973. Përse japonezët ngulin këmbë të lidhin marrëdhënie diplomatike me ne	454
47. — 27 prill 1973. Shënim	455
48. — 28 prill 1973. Të solidarizohemi me thirrjen e Asamblesë së Lartë Popullore të RDP të Koresë	456
49. — 29 prill 1973. Kthesë e kinezëve për metalurgjikun?	457
50. — 1 maj 1973. Shënim	458
51. — 2 maj 1973. Mbi vizitën e ardhsme të Sihanukut	459
52. — 7 maj 1973. Si të punohet për demaskimin e veprimeve dhe të politikës së imperialisto-revizionistëve	460
53. — 8 maj 1973. Një promemorje e nevojshme për qeverinë kineze	461
54. — 9 maj 1973. Të demaskojmë Kartën e re të Atlantikut	462
55. — 10 maj 1973. Giereku në Jugosllavi	463
56. — 11 maj 1973. Një vizitë që acaron kontradiktat midis revizionistëve gjermanë e sovjetikë	464
57. — 18 maj 1973. Një letër e Mao Ce Dunit drejtuar gruas së tij	465
58. — 18 maj 1973. Papa do të vizitojë Kinën!	470

	Faqe
59. — 19 maj 1973. Brezhnjevi do t'i bëjë lëshime të mëdha militarizmit gjerman	471
60. — 22 maj 1973. Shënim	472
61. — 23 maj 1973. Shënim	473
62. — 26 maj 1973. Politikë e çuditshme kineze	474
63. — 26 maj 1973. Në Kinë po fryn erë e Perëndimit	475
64. — 29 maj 1973. Për udhëtimin e Makarezosit në Kinë	476
65. — 31 maj 1973. Shënim	477
66. — 1 qershor 1973. Monarkia greke u rrëzua	478
67. — 4 qershor 1973. Erdhi Sihanuku	479
68. — 4 qershor 1973. NATO-ja interesohet për vendin tonë. Përse vallë?	480
69. — 5 qershor 1973. Mbi personalitetin e Sihanukut	486
70. — 6 qershor 1973. Udhëheqësit kamboxhianë nuk janë të kënaqur nga vietnamezët	489
71. — 7 qershor 1973. Disa qëndrime të komunistëve kamboxhianë janë pa kuptim	491
72. — 9 qershor 1973. Bisedë me Sihanukun	492
73. — 18 qershor 1973. Takim me delegacionin e Frontit Patriotik të Laosit	494
74. — 18 qershor 1973. Shënim	495
75. — 20 qershor 1973. Kryeministri i Maltës kërkon të vijë në Shqipëri	496
76. — 20 qershor 1973. Imperializmi amerikan pret me nderime e ceremoni të mëdha kreun e socialimperializmit sovjetik	497
77. — 21 qershor 1973. Sihanuku largohet nga vendi ynë shumë i kënaqur	498
78. — 23 qershor 1973. Takim me ambasadorin kinez	500

	Faqe
79. — 24 qershor 1973. Nuk do të futemi kurrë në kombinacione të rrezikshme	501
80. — 27 qershor 1973. Bankieri Rokfeler pritët me bankete në Kinë	502
81. — 28 qershor 1973. Marrëveshjet e reja sovjetico-amerikane — një sfidë e rëndë për të gjithë popujt	503
82. — 29 qershor 1973. Shënim	504
83. — 30 qershor 1973. Popujt nuk do t'ia falin Kinës këto qëndrime të rrezikshme	505
84. — 13 korrik 1973. Delegacion formal	519
85. — 15 korrik 1973. Të vegjlit duhet të ndërtojnë një politikë të tyre	522
86. — 17 korrik 1973. Përçapjet jugosllave nuk janë veçse intriga që kanë për qëllim mashtrimin	525
87. — 21 korrik 1973. Ambasadorët tanë duhet të jenë aktivë sidomos me kolegët e tyre kinezë	531
88. — 29 korrik 1973. Përse e shtynë kinezët thirrjen e kongresit të partisë?	533
89. — 30 korrik 1973. Një shprehje realiste e miqësore për vendin tonë	537
90. — 1 gusht 1973. Kinezët i kanë ftohur kontaktet politike me ne. Të përpiqemi të çajmë akullin	538
91. — 13 gusht 1973. Drekë për Eduard Hillin	540
92. — 21 gusht 1973. Taktika e shumë vijave në Kinë — një praktikë e ngritur në parim	541
93. — 23 gusht 1973. Kina nuk duhet ta neglizhojë Evropën	544
94. — 2 shtator 1973. Telegram urimi për Kongresin e 10-të të Partisë Komuniste të Kinës	547

	Faqe
95. — 3 shtator 1973. Shënim	548
96. — 6 shtator 1973. Shënim	549
97. — 8 shtator 1973. Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste të Kinës	550
98. — 13 shtator 1973. Të demaskohet grushti ushtarak fashist në Kili	553
99. — 14 shtator 1973. Shënim	554
100. — 16 shtator 1973. Udhëzime ambasadorit tonë të ri në Kinë	555
101. — 16 shtator 1973. Të mbrojmë popullin përparimtar kilian	557
102. — 18 shtator 1973. Shënim	558
103. — 19 shtator 1973. Gjermanëve t'ua kujtojmë se duhet të na paguajnë dëmshpërblimet e luftës	559
104. — 24 shtator 1973. Shënim	560
105. — 26 shtator 1973. Erdhi Rexh Bërci	561
106. — 27 shtator 1973. Protestë energjike qeverisë italiane për ndotjen e ujërave tona bregdetare	562
107. — 27 shtator 1973. Shënim	563
108. — 28 shtator 1973. Akt kriminal i qeverisë italiane	564
109. — 28 shtator 1973. Shënim	565
110. — 29 shtator 1973. Shënime	566
111. — 29 shtator 1973. Të përpiqemi për t'i kthyer qymyret tona të dobëta në koks	567
112. — 30 shtator 1973. Fjalimi i delegacionit tonë në OKB pritët mirë	568
113. — 30 shtator 1973. Në pritjen që dha ambasadori kinez në Tiranë	569
114. — 30 shtator 1973. Shënim	570

	Faqe
115. — 1 tetor 1973. Ngjarjet tragjike të Kilit — mësim për revolucionarët e gjithë botës	571
116. — 2 tetor 1973. Takim me Rexh Bërçin	572
117. — 7 tetor 1973. Luftë e re midis egjiptianëve, sirianëve dhe izraelitëve	573
118. — 12 tetor 1973. Lufta në Lindjen e Mesme vazhdon	575
119. — 25 tetor 1973. Armiqtë më të mëdhenj të popujve arabë	577
120. — 28 tetor 1973. Vjen në vendin tonë një delegacion vietnamez	578
121. — 31 tetor 1973. Takim me Fam Van Dongun	579
122. — 1 nëntor 1973. U nënshkrua deklarata e përbashkët shqiptaro-vietnameze	580
123. — 2 nëntor 1973. Delegacioni vietnamez largohet sot nga vendi ynë	581
124. — 6 dhjetor 1973. Mbi diplomacinë e fshehtë	582
125. — 15 dhjetor 1973. Diplomacia e fshehtë e dy superfuqive — rrezik i madh për lirinë dhe pavarësinë e popujve	585
1974	
1. — 28 janar 1974. Të demaskohen komplotet e revizionistëve	589
2. — 31 janar 1974. Në vendin tonë vjen një delegacion i «Al Fatahut»	595
3. — 13 shkurt 1974. Mbledhja e partive revizioniste — një mbledhje kundër revolucionit dhe komunizmit	596
4. — 13 shkurt 1974. Palestinezët duhet të vazhdojnë luftën e tyre	597

	Faqe
5. — 19 shkurt 1974. U nis për në Kinë një delegacion i Ministrisë së Ndërtimit	598
6. — 27 shkurt 1974. Shënim	599
7. — 12 mars 1974. Hidrocentrali i Fierzës dhe pozita e përbashkët e jugosllavëve dhe e kinezëve	600
8. — 15 mars 1974. Shënim	601
9. — 18 mars 1974. Shënim	602
10. — 19 mars 1974. Shënim	603
11. — 1 prill 1974. Rreth problemeve gjeologjike në Fierzë ngritur nga kinezët	604
12. — 1 prill 1974. Bisedë e ambasadorit kinez me shokun Ramiz Alia	605
13. — 2 prill 1974. Përse nuk duan kinezët që ne të ndërtojmë hidrocentralin e Fierzës?!	606
14. — 3 prill 1974. Udhëzime për bisedimet me shokët spanjollë	608
15. — 5 prill 1974. Shënim	609
16. — 5 prill 1974. Pritje jo e mirë nga kinezët	610
17. — 10 prill 1974. «Furtuna» për Fierzën përfundoi me turpin e kinezëve	611
18. — 20 prill 1974. Një delegacion i Frontit të Bashkuar Kombëtar të Kamboxhias vjen në vendin tonë	612
19. — 22 prill 1974. Takim me Kieu Samfanin	613
20. — 26 prill 1974. Miqtë kamboxhianë u larguan nga vendi ynë	615
21. — 24 maj 1974. Ten Hsiao Pinit po i bëhet reklamë e madhe	616
22. — 26 maj 1974. Kinezët e shtynë përsëri vizitën e delegacionit të Partisë e të Qeverisë sonë	618

	Faqe
23. — 5 qershor 1974. A është e vërtetë kjo që thonë agjencitë e lajmeve për Kinën?	621
24. — 6 qershor 1974. Takim me delegacionin e PK të Gjermanisë (m-l)	622
25. — 11 qershor 1974. Shënim	623
26. — 28 qershor 1974. Takim me nipin e Sami Frashërit	624
27. — 20 korrik 1974. Zbarkimi i forcave ushtarake të Turqisë në Qipro	625
28. — 23 korrik 1974. Të ruajmë ekuilibrin e dashamirësisë si ndaj popullit turk ashtu edhe ndaj atij grek	628
29. — 23 korrik 1974. Qiproja dhe planet hegemoniste të dy superfuqive në Mesdheun Lindor	631
30. — 10 gusht 1974. Shënim	632
31. — 15 shtator 1974. Një delegacion i Vietnamit të Jugut vjen nesër në vendin tonë	633
32. — 17 shtator 1974. Takim me delegacionin e Vietnamit të Jugut	634
33. — 19 shtator 1974. Miting për nder të miqve të shquar vietnamezë	635
34. — 30 shtator 1974. Në pritjen e dhënë nga ambasada kineze	636
35. — 3 tetor 1974. Politika jonë është e hapur, është politikë e parimeve proletare	637
36. — 19 tetor 1974. Asnjë lëshim titizmit	638
37. — 21 tetor 1974. Të përpunohet qëndrimi ynë i mëtejshëm në politikën e jashtme	642
38. — 1 nëntor 1974. Shënim	643
39. — 4 nëntor 1974. Kisingeri në Rumani e në Jugosllavi	644
40. — 25 nëntor 1974. Kisingeri në Pekin	645

	Faqe
41. — 28 nëntor 1974. Takim me delegacionin e partisë dhe të qeverisë së RP të Kinës	646
42. — 28 nëntor 1974. Takim me delegacionet e huaja që kanë ardhur për festën tonë	647
43. — 29 nëntor 1974. Nga biseda me Jao Ven Juanin	648
44. — 1 dhjetor 1974. Forcohen e thellohen marrëdhëniet kino-amerikane	649
45. — 13 dhjetor 1974. Kina nuk zbaton politikën e ndihmës internacionaliste midis vendeve socialiste	650
46. — 14 dhjetor 1974. Kinezët duan të tatojnë pulsën tonë	653
47. — 14 dhjetor 1974. Presidentët janë në hall	655
48. — 23 dhjetor 1974. Jo, shokë kinezë, ne me jugosllavët nuk jemi «si dhëmbët me buzët»	657
49. — 23 dhjetor 1974. Në koncertin e ansambllit artistik shtetëror «Mansude» të RDP të Koresë	659
Treguesi i lëndës	663
Treguesi i emrave	675
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera	681